Khaled Hosseini

# Dhe malet oshtinë

*Ky libër i kushtohet Harisit dhe Farahut,*
*të dy* noor *të syve të mi, dhe tim eti,*
*që do të kishte qenë krenar.*

*Për Elenën*

Atje, përtej idesë
Të së mirës e së keqes,
Gjendet një fushë.
Do të takohemi atje.

*Jelaluddin Rumi*, shekulli XIII

# Një

## *Vjeshtë 1952*

Mirë, pra. Ju doni një përrallë dhe unë po ju rrëfej një. Por vetëm një, ama. Asnjëri prej jush të mos më kërkojë tjetër. Është vonë dhe nesër na pret një ditë e gjatë rrugëtimi, Pahri, ty dhe mua. Sonte duhet të flesh. Edhe ti, Abdulla. Kam besim se do të jesh në këmbën time, djalë, kur unë dhe jot motër të mos jemi këtu. E po kështu edhe nëna juaj. Tani, ja përralla. Më dëgjoni që të dy, më dëgjoni mirë. Dhe mos më ndërprisni.

Njëherë e një kohë, kur divat, xhindet e gjigantët endeshin nëpër botë, na ishte një fermer që quhej Baba Ajubi. Ai jetonte tok me familjen e tij në një fshat të vogël të quajtur Maidan Sabz. Ngaqë kishte një familje të madhe për të ushqyer, ditët e Baba Ajubit ishin të gjitha të mbytura në punë. Çdo ditë, ai rropatej nga mëngjesi e deri në darkë, duke pluguar arën, duke u kujdesur për pemët thatime të stikave e duke ua prashitur dheun. Në çdo çast e gjeje aty në arën e vet, të përthyer në mes, me shpinën të harkuar njësoj si drapri që përdorte gjithë ditën e ditës. Duart i kishte përherë me kallo e ndonjëherë të gjakosura dhe çdo natë gjumi e rrëmbente menjëherë, me të mbështetur faqen në jastëk.

Më duhet ta pranoj se kjo nuk i kishte rënë në hise vetëm

atij. Jeta në Maidan Sabz ishte e vështirë për të gjithë banorët. Në veri, mes luginave, kishte fshatra të tjera më me fat, me drurë frutorë, lule, ajër të pastër e lumenj me ujë të freskët e të kulluar. Por Maidan Sabzi ishte një vend i izoluar dhe nuk përkonte as me përfytyrimin më të vogël që mund t'ju ngjallë emri i tij: Fusha e Gjelbër. Ai shtrihej në një pllajë të sheshtë e gjithë pluhur, që rrethohej nga një varg malesh të ashpra. Frynte një erë e ngrohtë aty që t'i mbushte sytë me pluhur. Gjetja e ujit ishte një mundim i përditshëm, sepse puset e fshatit, edhe ato më të thellat, kishin shumë pak ujë. Po, vërtet, kishte një lumë diku atje, por banorëve u duhej të ecnin gjysmë dite për të shkuar deri tek ai dhe, gjithsesi, ujërat e tij ishin të turbullta gjatë gjithë vitit. Lëre pastaj që, pas dhjetë vjetësh thatësirë, edhe lumi ishte mpakur shumë. Le të themi që njerëzit në Maidan Sabz punonin dy herë më fort për të siguruar vetëm gjysmën e jetesës.

E prapë Baba Ajubi e radhiste veten mes njerëzve me fat, sepse kishte një familje që e adhuronte mbi gjithçka tjetër. Ai e donte të shoqen dhe nuk ia ngrinte kurrë zërin, e aq më pak të vinte dorë mbi të. Ai ia vlerësonte këshillat dhe prania e saj i dhuronte kënaqësi të mirëfilltë. Për sa u përket fëmijëve, ai ishte i bekuar me aq fëmijë sa gishta ka dora: tre djem e dy vajza, dhe të gjithë i donte shumë. Vajzat e tij ishin të përkushtuara, të dashura, me karakter e me nam të mirë. Edhe djemve ua kishte mësuar tashmë se ç'vlerë ka ndershmëria, kuraja, miqësia e mirë dhe përballimi i punës së rëndë pa u ankuar. Ata i bindeshin, ashtu siç duhet të bëjnë bijtë e mirë, dhe e ndihmonin në punët e arës.

Edhe pse i donte të gjithë fëmijët, brenda vetes Baba Ajubi ushqente më shumë dashuri për njërin prej tyre, për më të voglin, Kehzin, që ishte vetëm tre vjeç. Kehzi ishte një djalë i vogël me sy blu. Ai i mrekullonte të gjithë ata që e takonin, me të qeshurën e vet çapkëne. Ishte një prej atyre fëmijëve me aq shumë energji shpërthyese, sa ua shteronte të tjerëve energjinë e tyre. Kur mësoi të ecte, e mori me aq

entuziazëm, sa nuk ndalej gjatë gjithë ditës, por, për bela, as edhe natën në gjumë: dilte somnambul nga shtëpia dhe bridhte jashtë nën dritën e hënës. Pa dyshim që prindërit u shqetësuan. Po sikur të binte në ndonjë pus a të humbiste rrugën, ose, më keq akoma, ta sulmonte ndonjë prej atyre bishave që endeshin pllajës nëpër natë?! Ata i dhanë shumë barna, por asnjëri nuk i bëri derman. Më në fund, Baba Ajubi gjeti një zgjidhje fare të thjeshtë, ashtu siç janë gjithmonë zgjidhjet më të mira: hoqi një këmborëz nga qafa e njërës prej dhive dhe ia vari Kehzit në qafë. Në këtë mënyrë, nëse Kehzi çohej në mes të natës, këmbora do të zgjonte patjetër dikë. Ecja somnambul u ndal pas njëfarë kohe, por Kehzi u mësua me këmborëzën dhe nuk pranonte kurrsesi që ta hiqte. Dhe kështu, edhe pse tani këmborëza nuk shërbente më për qëllimin për të cilin u vendos, ajo vazhdoi të qëndronte e varur në qafën e djalit. Kur Baba Ajubi kthehej në shtëpi pas një dite të gjatë pune, Kehzi do të vraponte nëpër shtëpi për t'i dalë përpara të atit, ndërsa këmborëza tringëllinte në çdo hap që hidhte ai me këmbkat e veta. Baba Ajubi e merrte në krahë dhe hynte brenda tok me të, pastaj Kehzi shihte gjithë admirim se si lahej i ati, e mandej ulej pranë tij për të ngrënë darkën. Pasi mbaronin së ngrëni, Baba Ajubi niste të rrufiste çajin, duke kundruar familjen e tij e duke përfytyruar ditët kur edhe fëmijët e tij do të martoheshin e do të bëheshin edhe vetë me fëmijë, kurse ai do të bëhej kryeplaku i një familjeje më të madhe.

Por, për fat të keq, të dashur Abdulla dhe Pahri, ditëve të lumtura të Baba Ajubit u erdhi fundi.

Një ditë, në Maidan Sabz na erdhi një Div. Ndërsa zbriste prej maleve drejt fshatit, toka nisi të dridhej nën hapat e tij. Fshatarët lëshuan kosat, shatet e plugjet dhe ia mbathën ku sytë këmbët. U mbyllën nëpër shtëpi dhe u mblodhën nëpër qoshe të përqafuar fort me njëri-tjetrin. Kur oshtima shurdhuese e hapave të Divit reshti, qielli mbi Maidan Sabz u errësua. Thoshin se në kokë kishte dy brirë të harkuar, shpinën dhe supet i kishte të mbuluara me qime të trasha të zeza, po ashtu

edhe bishtin e stërmadh. Thoshin se sytë i kishte të kuq. Askush nuk e dinte me siguri - e kuptoni vetë - të paktën asnjëri prej atyre që ishin ende gjallë: Divi i kullufiste me një kafshatë ata që guxonin t'i hidhnin qoftë edhe vjedhurazi një vështrim të shpejtë. Fshatarët e dinin këtë dhe i mbanin sytë përdhe.

Të gjithë në fshat e dinin për se kishte ardhur Divi. Ata e kishin dëgjuar se ç'kishte ndodhur kur kishte shkuar në fshatrat e tjera fqinjë, dhe habiteshin se si kishte mundësi që Maidan Sabzi kishte shpëtuar për kaq shumë kohë. Mbase, arsyetonin ata, jeta e mjerueshme, e varfër, që bënin ata në Maidan Sabz, kishte qenë një favor për ta, sepse fëmijët e tyre nuk ishin të ushqyer mirë e nuk kishin aq shumë mish në trup. Por, pavarësisht nga kjo, edhe fatit të tyre i kishte ardhur fundi.

Maidan Sabzi dridhej e mbante frymën. Familjet luteshin që Divi ta anashkalonte shtëpinë e tyre, sepse e dinin që, po të trokiste ai mbi çatinë e saj, duhej t'i jepnin një fëmijë. Pastaj Divi do ta fuste fëmijën në një thes, do ta hidhte thesin mbi shpinë dhe do të kthehej andej nga kishte ardhur. Askush nuk do ta shihte më kurrë fëmijën e gjorë. Dhe, nëse një familje do të kundërshtonte të jepte një fëmijë, divi do t'ia merrte të gjithë fëmijët që kishte.

Po ku i çonte Divi këta fëmijë? Në kështjellën e vet, që gjendej në majën e një mali shumë të lartë. Kështjella e Divit ishte shumë larg prej Maidan Sabzit. Lugina të tëra, një sërë shkretëtirash dhe dy vargje malesh duheshin kaluar përpara se të mbërrihej atje. Dhe, cili do të ishte ai njeri me mend në kokë që do të kërkonte vetë të takonte vdekjen?! Thuhej se kështjella ishte plot me bodrume, në muret e të cilave vareshin hanxharë. Nga tavanet vareshin çengelë. Thuhej se atje kishte gropa gjigante zjarri dhe hunj viganë. Thuhej edhe se, po t'i binte rruga ndonjërit andej, dihej që Divi e kthente vëmendjen te mishi i të rriturve.

Besoj se e kuptoni vetë se në çatinë e cilës shtëpi trokiti Divi. Me ta dëgjuar, Baba Ajubit i shpëtoi një klithmë tmerri nga buzët, kurse e shoqja humbi ndjenjat. Fëmijët nisën të

qanin të lebetitur e gjithë dëshpërim, sepse tashmë ishte më se e sigurt që njërin prej tyre do ta humbisnin. Familja kishte afat deri mëngjesin e nesërm për të bërë zgjedhjen e saj.

E ç'mund t'ju tregoj për dëshpërimin e Baba Ajubit dhe të gruas së tij atë natë? Asnjë prind nuk duhet të përballet me një zgjedhje të tillë. Duke bërë kujdes që të mos i dëgjonin fëmijët, Baba Ajubi dhe e shoqja diskutuan se ç'duhej të bënin. Ata folën e qanë dhe folën e qanë përsëri. Gjatë gjithë natës ecën tutje-tëhu nëpër shtëpi. Dhe, kur panë se për pak do të zbardhte dita, e kuptuan se duhej ta merrnin patjetër atë vendim: t'i jepnin Divit atë që kërkonte, përndryshe do ta paguanin pavendosmërinë e tyre me humbjen e të pesë fëmijëve. Më në fund, Baba Ajubi doli jashtë shtëpisë dhe mblodhi pesë gurë me formë e madhësi krejtësisht të njëjtë. Në secilin prej tyre shkroi emrin e njërit prej fëmijëve të tij dhe, kur mbaroi, i futi të gjithë gurët në një çantë cohe. Kur ia zgjati së shoqes, ajo e mbajti në dorë si të kishte brenda një gjarpër helmues.

- Nuk e bëj dot! - i tha të shoqit, duke tundur kokën mohueshëm. - Nuk mund të zgjedh unë. Nuk e përballoj dot.

- As unë nuk e bëj dot, - nisi të thoshte Baba Ajubi, por përtej dritares pa se diellit edhe pak çaste i duheshin që të dilte mbi majën e kodrave lindore. S'kishte më kohë. Ai i hodhi sytë gjithë tmerr mbi të pesë fëmijët e vet. Një gisht duhej të këputej, që të shpëtohej dora. Mbylli sytë dhe nxori një gur nga çanta.

Besoj se e kuptoni se cilin gur i kapi dora Baba Ajubit. Kur pa emrin e shkruar në të, ngriti sytë nga qielli dhe lëshoi një britmë therëse. Me zemër të thyer, e mori djalin e vet të vogël në krahë, ndërsa Kehzi, që kishte besim të verbër tek i ati, ia hodhi krahët në qafë gjithë lumturi. Vetëm pasi Baba Ajubi e nxori jashtë shtëpisë dhe mbylli derën, djali e kuptoi se diçka nuk shkonte. Dhe ja tek ishte Baba Ajubi, me sytë mbyllur fort, nga ku i rridhnin lotët lumë, mbështetur me shpinë në anën tjetër të portës, ndërsa djali i tij më i dashur, Kehzi, qëllonte derën me grushtet e veta të vogla dhe i kërkonte me

ngashërim babait që ta linte të hynte përsëri brenda. Por Baba Ajubi vazhdoi të qëndronte aty, duke mërmëritur: "Më fal! Më fal!", ndërsa toka dridhej nën hapat e Divit dhe i biri këlthiste. Dhe toka vazhdoi të dridhej sërish, ndërsa Divi largohej nga Maidan Sabzi, derisa oshtima e hapave të tij pak nga pak erdhi duke u shuar, sa më në fund reshti plotësisht. Dridhjet pushuan. Gjithçka ra në qetësi. Por Baba Ajubi vazhdonte ende të qante aty pas derës, duke iu lutur Kehzit që ta falte.

Abdulla, motrën tënde e zuri gjumi. Mbuloja këmbët me çarçaf. Ashtu. Mirë. Ndoshta është më mirë tani që ta ndërpres përrallën. Jo? Do që ta vazhdoj? Je i sigurt, djalë? Në rregull, atëherë.

Ku e lashë? Ah, po. Një periudhë zie dyzetditëshe pasoi në fshat. Fqinjët gatuanin përditë ushqime për familjen e Baba Ajubit dhe kujdeseshin për ta gjatë gjithë ditës. Njerëzit që erdhën, sollën me vete aq sa kishin mundësi: çaj, ëmbëlsira, bukë, arra dhe po ashtu edhe ngushëllimet e keqardhjen e tyre të dëshpëruar. Baba Ajubi mezi arrinte ta detyronte veten që të shqiptonte të paktën "Falemnderit!". Ai rrinte ulur në një qoshe duke qarë dhe lotët i rridhnin çurg nga të dy sytë, a thua se me këtë donte t'i jepte fund thatësirës së fshatit. Nuk do t'ia kishit uruar vuajtjen e mundimin e tij as edhe njeriut më të lig në botë.

Kaluan disa vjet. Thatësira vazhdoi dhe Maidan Sabzi u krodh në një varfëri edhe më të skajshme. Shumë foshnja vdiqën në djep nga etja. Uji i puseve shteroi edhe më shumë, lumi u tha edhe më, krejt ndryshe nga pikëllimi e Baba Ajubit: një lumë që shtohej e shtohej për çdo ditë që kalonte. Tashmë ai nuk i sillte asnjë të mirë familjes së vet. Nuk punonte, nuk lutej, mezi hante. E shoqja dhe fëmijët iu përgjëruan, por nuk bëri punë. Të dy djemtë e tjerë u detyruan të punonin në vend të tij, sepse çdo ditë Baba Ajubi nuk bënte gjë tjetër veçse ulej në një cep të arës: një siluetë e vetmuar, e kërrusur, me sytë në drejtim të maleve. Filloi të mos u fliste më fshatarëve të

tjerë, sepse i dukej sikur ata mërmërisnin pas shpinës së tij. I dukej sikur i dëgjonte të thoshin se ai ishte burracak, që e kishte dhënë ashtu fëmijën e vet. Se ishte një baba i padenjë. Një baba i vërtetë do të kishte luftuar me Divin. Do të kishte vdekur duke mbrojtur familjen e vet.

Një natë ia rrëfeu të gjitha këto së shoqes.

- Ata nuk thonë gjëra të tilla, - iu përgjigj e shoqja. - Askush nuk mendon se ti je burracak.

- Unë arrij t'i dëgjoj, - tha ai.

- Është zëri yt ai që dëgjon, o burrë, - i tha ajo. Por nuk i tregoi se ata vërtet flisnin pas shpinës së tij. Vetëm se thoshin që ndoshta ai ishte çmendur.

Dhe pastaj, një ditë, ai ua provoi pikërisht këtë. U ngrit që pa zbardhur mirë. Pa e zgjuar gruan dhe fëmijët, futi ca copa bukë në një çantë, mbathi këpucët, rregulloi draprin në brez dhe u nis për rrugë.

Eci për ditë e ditë të tëra. Eci derisa dielli u shndërrua në një vezullim të dobët të kuq në largësi. Netëve flinte nëpër shpella, ndërsa përjashta fërshëllente era. Ose flinte në breg të lumenjve, nën pemë, a në të çarat midis shkëmbinjve. Bukën që kishte marrë me vete, e mbaroi, kështu që nisi të hante ç'të gjente: kërpudha, manaferra, peshq që i kapte në lumë me duar. Por kishte edhe ditë kur nuk vinte gjë në gojë. Gjithsesi prapë vazhdoi të ecte përpara. U ndesh edhe me udhëtarë të tjerë, që e pyetën se ku po shkonte, dhe ai u tha të vërtetën. Disa qeshën me të, të tjerë iu larguan me hapa të shpejtë, nga frika se mos ishte i çmendur, por kishte edhe nga ata që thanë lutje për të, sepse edhe atyre u kishte marrë Divi nga një fëmijë. Baba Ajubi e mbante kokën ulur dhe vazhdonte të bënte përpara. Kur këpucët iu hapën, i shtrëngoi fort pas këmbës me gjalma dhe, kur iu këputën edhe këto, vazhdoi të çapitej këmbëzbathur. E kështu, ai kapërceu lugina, shkretëtira e male.

Dhe, më në fund, mbërriti rrëzë malit në majën e të cilit gjendej kështjella e Divit. Ishte kaq i paduruar për të përmbushur synimin e vet, saqë nuk u ul të pushonte aspak, por

menjëherë nisi t'i ngjitej, me rrobat e shkalufitura, këmbët e zbathura e të gjakosura, flokët e mbuluar nga pluhuri, por me një vendosmëri të patundur. Shkëmbinjtë e thepisur ia rropën lëkurën e pëllëmbëve. Shqiponjat ia çukitën gjoksin me sqep, kur kaloi pranë foleve të tyre. Era e fortë thuajse e shkuli nga faqja e malit. Por ai vazhdoi të kacavirrej, nga njëri shkëmb në tjetrin, derisa më në fund u gjend përpara portës gjigante të kështjellës së Divit.

- Kush na qenka ky guximtar?! - shungulloi zëri i Divit, kur Baba Ajubi hodhi një gur drejt portës.

Baba Ajubi shqiptoi emrin e vet.

- Vij nga fshati Maidan Sabz, - tha ai.

- Ke qejf të vdesësh? Pa dyshim që po, përderisa po më prish rehatin në shtëpinë time! Si e ke punën?

- Kam ardhur këtu për të të vrarë.

Në anën tjetër të portës ra heshtja. Mandej kanatet u hapën me kërcëllimë dhe ja tek doli Divi, duke sunduar mbi Baba Ajubin me një dinjitet që të ngjallte makth.

- Vërtet? - tha ai me zë të trashë si bubullimë.

- Po, - tha Baba Ajubi. - Në një mënyrë a në një tjetër, njëri prej nesh do të vdesë sot.

Për një çast u duk sikur Divi do ta shkulte Baba Ajubin nga toka dhe do ta kullufiste me një kafshatë të vetme midis dhëmbëve të tij të mprehtë si sfurk. Por diçka e bëri atë krijesë që të ngurronte. Picërroi sytë. Mbase nga fjalët e çmendura të plakut. Ose mbase prej pamjes së tij: rrobat copë e çikë, fytyra e gjakosur, trupi i mbuluar me pluhur nga koka te këmbët, plagët e hapura në lëkurë. Ose mbase ngaqë, në sytë e plakut, Divi nuk pa as grimën më të vogël të frikës.

- Nga the se vjen?

- Nga Maidan Sabzi, - tha Baba Ajubi.

- Me sa duket nga pamja jote, ky Maidan Sabzi duhet të jetë shumë larg.

- Nuk erdha deri këtu për të bërë muhabet. Erdha që të...

Divi ngriti dorën me gishtat si kthetra.

- Po, po. Erdhe këtu, që të më vrasësh. E mora vesh. Por besoj se kam të drejtë të them nja dy fjalë të fundit, përpara se të vdes.

- Shumë mirë, - tha Baba Ajubi. - Por vetëm dy fjalë, ama.

- Falemnderit, - buzëqeshi Divi. - A mund të të pyes se ç'të keqe kam bërë që të meritoj vdekjen?

- Më ke marrë djalin më të vogël, - iu përgjigj Baba Ajubi. - Ai ishte gjëja më e çmuar në botë për mua.

Divi hungëriti dhe fërkoi mjekrën.

- Unë u kam marrë shumë fëmijë shumë baballarëve, - tha ai.

Baba Ajubi iu kanos gjithë zemërim me draprin e vet.

- Atëherë unë do të hakmerrem edhe për ata.

- Më duhet ta pranoj që kuraja jote më mbush me admirim.

- Ti as nuk e di se ç'është kuraja, - tha Baba Ajubi. - Për të qenë i guximshëm, duhet të vësh në lojë diçka. Unë erdha këtu ngaqë s'kam ç'të humbas.

- Mund të humbasësh jetën, - i tha Divi.

- Atë ma ke marrë prej kohësh.

Divi hungëriti përsëri dhe po e vështronte Baba Ajubin mendueshëm. Pas disa çastesh iu përgjigj:

- Mirë. Pranoj të bëj duel me ty. Por më parë dua që të vish pas meje.

- Jepi shpejt, - i tha Baba Ajubi. - Po më soset durimi.

Por Divi ishte drejtuar ndërkaq drejt një korridori gjigant dhe Baba Ajubi nuk pati zgjedhje tjetër përveçse ta ndiqte pas. E ndoqi nëpër një labirint korridoresh me tavane shumë të larta e që mbaheshin nga shtylla të stërmëdha. Ata u ngjitën e zbritën nëpër shumë shkallë dhe kaluan nëpër dhoma aq të mëdha, sa mund të mbanin brenda të gjithë Maidan Sabzin. Dhe ecën kështu, derisa më në fund Divi e futi Baba Ajubin në një dhomë gjigante, fundi i së cilës ishte mbuluar me perde.

- Eja, afrohu, - ia bëri Divi me shenjë.

Baba Ajubi u afrua.

Divi hapi perdet. Prapa tyre gjendej një dritare. Përtej dritares, Baba Ajubi pa një kopsht shumë të madh. Radhë qiparisash kufizonin kopshtin, kurse në këmbët e tyre ishin mbjellë lule të të gjitha ngjyrave. Aty kishte pishina të ndërtuara me pllaka ngjyrëblu, tarraca të mermerta, parcela me bar të njomë jeshil. Baba Ajubi pa gëmusha me forma të bukura dhe shatërvanë me ujë gurgullues nën hijen e shegëve. Edhe tri jetë po të kishte pasur, s'do të kishte mundur të përfytyronte dot një vend kaq të bukur.

Por ajo që e bëri vërtet Baba Ajubin të binte në gjunjë, ishin fëmijët që po vraponin e po luanin të lumtur në kopsht. Ata ndiqnin njëri-tjetrin nëpër rrugina e përreth pemëve. Luanin kukafshehthi duke u shpëndarë nëpër gëmusha. Sytë e Baba Ajubit nisën të kërkonin mes fëmijëve dhe më në fund e gjeti atë që donte. Ja tek ishte! Biri i tij, Kehzi, i gjallë, me shëndet të plotë. Kishte hedhur shtat dhe flokët i ishin zgjatur më shumë nga ç'i mbante mend Baba Ajubi. Kishte veshur një bluzë të bardhë e të bukur, lëshuar mbi një palë pantallona të këndshme. Ai qeshte i lumtur, ndërsa vraponte pas dy shokëve të vet.

- Kehzi, - pëshpëriti Baba Ajubi dhe fryma e tij veshi xhamin e dritares. Pastaj e thirri me zë të lartë në emër.

- Ai nuk të dëgjon, - i tha Divi. - Dhe as nuk të sheh dot.

Baba Ajubi nisi të lëvizte lart e poshtë, duke tundur dorën e duke i rënë xhamit, derisa Divi i mbylli perdet përsëri.

- Nuk e kuptoj, - tha Baba Ajubi. - Unë mendova...

- Ky është shpërblimi për ty, - i tha Divi.

- Më sqaro, - e urdhëroi Baba Ajubi.

- Unë të vura në provë.

- Në provë?

- Vura në provë dashurinë tënde. Ishte sfidë e rëndë, e pranoj, dhe peshën e saj të rëndë mbi ty e pashë menjëherë. Por ti e kalove. Ky është shpërblimi yt. Dhe i tij.

- Po sikur të mos kisha bërë asnjë zgjedhje? - bërtiti Baba Ajubi. - Po sikur ta kisha kundërshtuar provën tënde?

- Atëherë të gjithë fëmijët e tu do të ishin zhdukur, - i tha Divi, - sepse gjithsesi do të ishin të mallkuar, ngaqë do të kishin një baba të dobët. Një baba burracak, që do të pranonte më mirë t'i shihte të gjithë të vdekur, sesa të përballej me ndërgjegjen e vet. Ti ndoshta mendon se nuk tregove që ke kurajë, por unë them se ke. Duhet kurajë për të bërë atë që bëre ti, e për të mbajtur këtë peshë të rëndë mbi supe. Dhe për këtë unë të respektoj. - Baba Ajubi nisi ta ulte draprin poshtë ngadalë, por ai i ra nga dora duke lëshuar në dyshemenë prej mermeri një tingëllimë shpuese. Gjunjët iu prenë dhe u detyrua të ulej. - Yt bir nuk të mban mend, - vazhdoi Divi. - Kjo është jeta e tij tani dhe ti e pe vetë se sa i lumtur është. Këtu ai ka rrobat dhe ushqimet më të mira, është i rrethuar nga miqësia dhe ngrohtësia. Atij i mësohen gjuhë, arte, shkencë. I mësohet se si të bëhet mendjendritur e zemërmadh. Atij nuk i mungon asgjë. Një ditë, kur të rritet e të bëhet burrë, mund të vendosë të ikë prej këtu dhe do të jetë i lirë ta bëjë këtë. Unë besoj se ai do të ndryshojë shumë jetë me mirësinë e vet dhe do t'u sjellë lumturi njerëzve të ngërthyer nga dëshpërimi.

- Dua ta takoj, - tha Baba Ajubi. - Dua ta marr me vete në shtëpi.

- Vërtet?

Baba Ajubi ngriti kokën dhe e vështroi Divin në sy.

Krijesa iu afrua një dollapi që ndodhej pranë perdeve, dhe nga njëri prej sirtarëve të tij nxori një orë rëre.

- A e di ti se ç'është ora e rërës, Abdulla? E di? Mirë.

- E po, Divi e mori orën e rërës, e ktheu përmbys dhe e vendosi përpara këmbëve të Baba Ajubit.

- Do të të lejoj ta marrësh me vete në shtëpi, - tha Divi. – Por, po qe se vendos ta bësh këtë, ai nuk do të mund të kthehet më kurrë këtu. Nëse vendos të mos e bësh, ti nuk do të mund të kthehesh më kurrë këtu. Kur e gjithë rëra të ketë rrjedhur poshtë, do të vij të të pyes se ç'vendim ke marrë.

Dhe, me të thënë këtë, Divi doli nga dhoma, duke e lënë Baba Ajubin që të bënte një tjetër zgjedhje të dhembshme.

"Do ta marr djalin me vete në shtëpi", - mendoi në çast Baba Ajubi. Kjo ishte gjëja që dëshironte më fort, me çdo qelizë të qenies së tij. A nuk e kishte ëndërruar këtë me qindra herë? Që ta merrte përsëri në krahë Kehzin e vet, ta puthte në faqe e të ndiente butësinë e doçkave të tij mbi të vetat? Por prapë... Po ta merrte me vete në shtëpi, ç'lloj jete do ta priste Kehzin në Maidan Sabz? Në rastin më të mirë, jeta e vështirë e një fshatari a pak më shumë se kaq. Edhe kjo, nëse Kehzi nuk vdiste për shkak të thatësirës, siç kishte ndodhur me shumë fëmijë të tjerë të fshatit. "A do të mund t'ia fal vetes këtë, - pyeti veten Baba Ajubi, - duke e ditur që e rrëmbeva nisur nga ndjenjat e mia egoiste, për ta larguar nga një jetë me gjithë të mirat e plot mundësi?" Nga ana tjetër, po ta linte Kehzin këtu, si do të mund ta duronte faktin që ai e dinte se i biri ishte gjallë, e dinte se ku ndodhej, por e kishte të ndaluar që ta shihte? Si do të mund ta duronte? Baba Ajubi nisi të qante. Dhe e pushtoi një dëshpërim kaq i madh, sa e mori orën e rërës dhe e përplasi pas murit. Ajo u thye në mijëra copa dhe rëra e imët u përhap në dysheme.

Divi hyri përsëri në dhomë dhe e gjeti Baba Ajubin në këmbë mbi orën e thyer, me supe të kërrusura.

- Ti je një bishë e tmerrshme! - tha Baba Ajubi.

- Kur ke jetuar aq gjatë sa unë, - ia ktheu Divi, - kjo egërsi dhe mirësi s'të duken gjë tjetër, veçse nuanca të së njëjtës ngjyrë. A e more vendimin?

Baba Ajubi fshiu lotët, e ngriti draprin nga toka dhe e rregulloi në brez. Pastaj u drejtua ngadalë për nga dera, me kokën që i varej poshtë.

- Ti je një baba i mirë, - i tha Divi, ndërsa Baba Ajubi i kalonte pranë.

- Lutem dhe shpresoj që të piqesh në zjarrin e ferrit për këtë që po më bën, - ia ktheu Baba Ajubi gjithë dëshpërim.

Ai doli nga dhoma dhe po ecte nëpër korridor, por Divi e ndoqi pas.

- Merre këtë, - i tha. Dhe i zgjati Baba Ajubit një shishe të vogël qelqi, të mbushur me një lëng me ngjyrë të errët. - Pije rrugës për në shtëpi. Lamtumirë!

Baba Ajubi e mori shishen dhe u largua pa thënë asnjë fjalë.

Shumë ditë më pas, gruaja e tij ishte ulur buzë arës së tyre, me sytë nga rruga, duke e pritur, ashtu siç ulej e priste Baba Ajubi dikur, që ta shihte Kehzin përsëri. Shpresa për ta parë sërish të shoqin po i shuhej gjithmonë e më shumë për çdo ditë që kalonte. Tashmë fshatarët kishin nisur të flisnin në kohën e shkuar për Baba Ajubin. Një ditë, ajo po qëndronte e ulur përsëri aty përtokë, duke mërmëritur një lutje nëpër buzë, kur syri i kapi një siluetë që po i afrohej Maidan Sabzit nga ana e maleve. Në fillim e mori për ndonjë dervish që kishte humbur rrugën: një burrë i dobët, i veshur me zhele, me sy të futur thellë në zgavrat e tyre e ballin tërë rrudha. Vetëm kur ai i erdhi fare pranë, vuri re se ishte i shoqi. Zemra i kërceu në kraharor nga gëzimi dhe një thirrmë lehtësimi i doli nga goja.

Pasi u la e pasi i vunë përpara për të ngrënë e për të pirë, Baba Ajubi u rrethua në shtëpinë e tij nga fqinjët, që nisën t'i bënin pyetje pas pyetjesh.

*Ku shkove, Baba Ajub?*

*Çfarë pe?*

*Çfarë të ndodhi?*

Baba Ajubi nuk mund t'u kthente përgjigje, sepse atij nuk i kujtohej asgjë nga ç'kishte ndodhur. Atij nuk i kujtohej aspak udhëtimi, ngjitja në malin e Divit, biseda me të, pallati madhështor ose dhoma e madhe me perde. Ai ndihej njësoj si të ishte zgjuar nga një ëndërr, por që e kishte harruar. Nuk i kujtohej kopshti i fshehtë, fëmijët dhe, mbi të gjitha, nuk i kujtohej aspak që e kishte parë Kehzin duke luajtur midis pemëve me shokët e vet. Në fakt, kur dikush përmendi emrin e Kehzit, Baba Ajubi përplasi qepallat i çuditur.

- Kush? - tha ai. Atij nuk i kujtohej as që kishte pasur ndonjëherë një fëmijë me atë emër.

A e kupton, Abdulla, që ky ishte një gjest mirëbërës nga ana e Divit? Ishte lëngu që i kishte fshirë këto kujtime. Ishte shpërblimi për Baba Ajubin, ngaqë e kishte kaluar edhe provën e dytë të Divit.

Më në fund, atë pranverë qielli mbi Maidan Sabz u ngarkua rëndë me re. Dhe poshtë nuk u lëshua një curril i hollë, si në vitet e shkuara, por një shi i madh, shi me gjyma. Pikat e mëdha të shiut ranë nga qielli dhe fshati u ngrit i tëri në këmbë, që të shuante etjen. Gjatë gjithë ditës, mbi çatitë e Maidan Sabzit dëgjoheshin trokitjet e shiut, që mbytnin çdo lloj tingulli tjetër në botë. Pika të mëdha, të rënda, lëshoheshin nga gjethet e pemëve. Puset u mbushën me ujë dhe lumi u fry. Kodrat në lindje u gjelbëruan sërish. Lule të egra çelën dhe, për herë të parë pas kaq vjetësh, fëmijët nisën të luanin mbi një luadh të gjelbër, kurse lopët mundën të ushqeheshin me bar.

Të gjithë u rigjallëruan.

Kur shirat reshtën, në fshat kishte shumë punë. Shumë puse ishin përmbytur e baltosur dhe disa çati ishin prishur. Parcela të tëra arash ishin shndërruar në moçale. Por, pas mjerimit të dhjetë vjetëve të fundit, njerëzit e Maidan Sabzit nuk mund të ankoheshin. Puset u ndërtuan sërish, çatitë u riparuan dhe kanalet e kullimit u pastruan. Atë vjeshtë, Baba Ajubi mblodhi stikat më të mirë në jetën e vet dhe, vërtet, vitin që pasoi dhe tjetrin në vijim, kokrrat e stikave qenë më të mëdha e më të shijshme. Në qytetet e mëdha ku shiste prodhimet e veta, Baba Ajubi qëndronte krenar pas piramidave të stikave, me pamjen e njeriut më të lumtur në botë.

Në Maidan Sabz nuk pati më thatësirë.

S'kam ç'të them më, Abdulla. Ti mund të më pyesësh nëse ndodhi ndonjëherë që një djali të ri hipur mbi kalë t'i binte rruga mespërmes fshatit, drejt aventurave të mëdha? A thua u ndal ai për të pirë ndonjë gllënjkë ujë, që tashmë fshati e kishte me bollëk, ose për ta ndarë bukën me fshatarët e, mbase, edhe me vetë Baba Ajubin? Nuk të përgjigjem dot,

bir. Por ajo që mund të të them, është se Baba Ajubi jetoi derisa u bë shumë plak. Mund të të them që ai i pa fëmijët e vet të martoheshin, ashtu siç kishte dëshiruar gjithmonë, dhe ata i dhanë shumë nipër e mbesa e secili prej këtyre i dhuroi lumturi të madhe.

Dhe mund të të them edhe që ndonjë natë, pa ndonjë arsye të veçantë, Baba Ajubin nuk e zinte gjumi. Ishte shumë plak tani, por ende mund të ecte vetë duke u mbështetur në bastun. Dhe, në ato net kur nuk e zinte gjumi, ai rrëshqiste jashtë shtratit pa e zgjuar të shoqen, merrte bastunin e dilte nga shtëpia. Ecte në errësirë, me shkopin që trokiste në tokë përpara tij, ndërsa flladi i freskët i natës ia përkëdhelte fytyrën. Në anë të arës gjendej një gur i sheshtë dhe ai ulej mbi të. Shpesh rrinte ulur aty për një orë a më shumë, duke kundruar yjet dhe retë që rrëshqisnin ndanë hënës. Kujtonte jetën e vet të gjatë dhe falënderonte Zotin për begatinë e bereqetin që i kishte dhënë. Ai e dinte se do të ishte mëkat të dëshironte më shumë, të kërkonte më shumë. Ai psherëtinte i lumtur dhe mbante vesh erën që vinte nga malet, e cicërimat e zogjve të natës.

Por, herë pas here, i dukej sikur shquante ca tinguj të veçantë në mes tyre. Ishin gjithmonë të njëjtët: tringëllima e mprehtë e një këmborëze. E, teksa qëndronte i vetëm në errësirë, mundohej të kuptonte se nga vinte ajo tringëllimë, tani që të gjitha delet e dhitë i kishte kapluar gjumi. Ndonjëherë mendonte se mos i kishin bërë veshët, por herë të tjera ishte më se i bindur se e kishte dëgjuar vërtet, aq sa thërriste në errësirë: "A ka njeri aty? Kush është aty? Dil të të shoh".

Por kurrë nuk merrte përgjigje. Baba Ajubi nuk e kuptonte. Ashtu siç nuk e kuptonte pse e kaplonte gjithmonë një valë dëshpërimi, njësoj si në fund të një ëndrre të trishtuar, sa herë që e dëgjonte atë tringëllimë, dhe kjo e habiste çdo herë, siç ndodh nga një shkulm i papritur ere. Por pastaj i kalonte, siç ndodh gjithmonë. I kalonte.

Ja, pra, kjo ishte, djalë. Këtu mbaron përralla. S'kam ç'të them më. Dhe tani është bërë vërtet vonë, unë jam i lodhur dhe tok me tët motër do të më duhet të zgjohem herët nesër në mëngjes. Prandaj fike qiririn. Vëre kokën në jastëk dhe mbylli sytë. Gjumë të ëmbël, bir. Do përshëndetemi përsëri në mëngjes.

# Dy

## *Vjeshtë 1952*

Babai nuk e kishte qëlluar kurrë më parë Abdullain. Kështu që, kur e bëri, kur e qëlloi anësh kokës, pak më sipër veshit, fort, papritur, me pëllëmbën e dorës të shtrirë mirë, lot habie shpërthyen nga sytë e djalit. Por ai puliti qepallat menjëherë dhe ata u përthanë.

- Kthehu në shtëpi! - i turfulloi Babai, duke kërcëllitur dhëmbët.

Aty pranë, Abdullai dëgjoi dënesën e Pahrit.

Dhe pastaj Babai e qëlloi përsëri, këtë herë më fort, në faqen e majtë. Aq fort, sa koka e djalit u kthye në anën tjetër. Faqja i përcëlloi dhe nga sytë i rrodhën lot. Veshi i majtë po i oshtinte. Babai u përkul mbi të, kaq pranë, saqë fytyra e tij e ashpër dhe në ngjyrë të errët i eklipsoi njëherazi shkretëtirën, malet dhe qiellin.

- Të thashë të kthehesh në shtëpi, djalë! - i tha ai, me një vështrim gjithë dhembje.

Abdullai nuk nxori zë. U gëlltit fort dhe e pa të atin me sy gjysmë të mbyllur, duke pulitur qepallat nën dorën që ia mbronte sytë nga dielli.

Nga karroca e vogël me ngjyrë të kuqe aty përpara tyre, Pahri e thirri në emër, me zë të lartë, por që i dridhej nga frika:

- Abolla!

I ati e urdhëroi të birin me sy që të mos lëvizte nga vendi, dhe u drejtua për te karroca. Nga shtrati i saj, Pahri zgjati të dyja duart drejt Abdullait. Ky fshiu lotët nga sytë me mollëzat e gishtërinjve dhe nisi sërish t'i ndiqte pas.

Pak çaste më vonë, Babai hodhi një gur drejt Abdullait, ashtu siç i gjuanin fëmijët e Shadbagut qenit të Pahrit, Shujës. Vetëm se ata e qëllonin qenin me qëllim që ta lëndonin. Kurse guri i Babait ra pak më tej Abdullait, i cili i ndali hapat dhe, kur Babai e Pahri nisën të ecnin përsëri, eci edhe ai pas tyre.

Më në fund, kur dielli doli plotësisht, Babai u ndal sërish. U kthye edhe një herë nga Abdullai, këtë radhë plotësisht i vëmendshëm ndaj tij, dhe bëri shenjë me dorë drejt tij.

- Nuk ke ndër mend të heqësh dorë, - i tha.

Nga shtrati i karrocës, Pahri menjëherë e zgjati dorën dhe e mbështeti mbi atë të Abdullait. Ajo po shihte drejt tij, me sy të njomur nga lotët, dhe po i buzëqeshte duke zbuluar ata dhëmbët e ndarë nga njëri-tjetri, si të ndiente se asnjë e keqe nuk do të mund t'i ndodhte, për sa kohë që do ta kishte pranë. Ai e mbështolli dorën e saj me gishtat e vet, ashtu siç bënte çdo natë, kur vëlla e motër flinin në shtratin e tyre, me kokët të mbështetura pas njëra-tjetrës e këmbët të ngatërruara me të njëri-tjetrit.

- Duhej të kishe qëndruar në shtëpi, - tha Babai. - Me mamanë dhe Ikbalin. Ashtu siç të thashë unë.

Abdullai mendoi me vete: "Ajo është gruaja jote. Nënën time, ne e kemi varrosur". Por ai dinte se si t'i mbyste ato fjalë brenda vetes, përpara se t'i dilnin nga goja.

- E po, në rregull, atëherë. Hajde, - tha Babai. - Por nuk dua ankesa. Më dëgjove?

- Po.

- Po të paralajmëroj. Nuk kam për të të duruar gjatë.

Pahri i qeshi Abdullait dhe ai uli kokën drejt fytyrës së saj me faqe të rrumbullakëta bojërozë e me sy të çelët dhe i buzëqeshi edhe ai.

Qysh prej atij çasti, ai eci përbri karrocës, ndërsa ajo kërcente mbi terrenin e thyer të shkretëtirës. Motër e vëlla qëndronin të kapur përdore e shkëmbenin vështrime të lumtura, por thoshin vetëm pak fjalë, nga frika se mos ia prishnin qejfin Babait dhe rrënonin të mirën që u ishte bërë. Për një kohë të gjatë ata qenë të vetmit udhëtarë në atë rrugëtim. Vetëm ata të tre, askush e asgjë tjetër sa të hante syri, përveç kanioneve të thella ngjyrë bakri dhe shkëmbinjve masivë ranorë. Shkretëtira shpalosej përpara tyre e gjatë dhe e gjerë, si të ishte krijuar vetëm për ata të tre, me një ajër që nuk lëvizte, një nxehtësi përvëluese dhe një qiell blu shumë të lartë. Gurët vezullonin në terrenin e thyer. Të vetmit tinguj që dëgjonte Abdullai, ishin ata të frymëmarrjes së vet dhe pingërimi ritmik i rrotave, ndërsa Babai e shtynte karrocën e kuqe drejt veriut.

Pak çaste më vonë, ata u ndalën për të pushuar nën hijen e një shkëmbi të gërryer në rrëzë. Babai rënkoi dhe e lëshoi dorezën e karrocës përtokë. Harkoi shpinën dhe e ngriti fytyrën drejt diellit duke u ngërdheshur.

- Edhe sa na duhet që të arrijmë në Kabul? - pyeti Abdullai.

Babai uli sytë drejt tyre. Ai quhej Sabor. Ishte një burrë me lëkurë të errët, me një fytyrë të ashpër, katrore dhe eshtake, hundë me kurriz si sqep fajkoi shkretëtire e sy të futur thellë në zgavra. Babai ishte i dobët si kallam, por një jetë e tërë e kaluar me punë ia kishte bërë muskujt të fuqishëm dhe fashat e tyre dukeshin si rripat në krahmbështetësen e një karrigeje të thurur me thupra.

- Nesër mbrëma, - tha ai, duke ngritur pagurin e lëkurtë drejt buzëve. - Po qe se nuk vonohemi. - Ai ktheu nja dy gllënjka të bollshme, ndërsa molla e Adamit i ulej e i ngrihej.

- Pse nuk na çoi dajë Nabi? - pyeti Abdullai. - Ai ka makinë. - I ati drejtoi sytë nga ai. - Dhe nuk do të na duhej ta bënim më këmbë gjithë këtë rrugë.

Babai nuk foli. E hoqi kapën e dalëboje dhe fshiu djersën e ballit me mëngën e bluzës.

Pahri bëri me gisht që nga karroca.

- Shiko, Abolla! - thirri ajo gjithë ngazëllim. - Edhe një tjetër.

Abdullai hodhi sytë andej nga tregonte gishti i saj, nën hijen e shkëmbit, aty ku gjendej një pendë e gjatë, ngjyrëgri, si qymyr i djegur. Abdullai iu afrua dhe e kapi nga bishti. Fryu pluhurin që gjendej mbi të. "Skifter, - mendoi me vete, duke e kthyer sa nga njëra anë në tjetrën. - Ose mbase ndonjë kumri a ndonjë laureshë shkretëtire." Kishte parë shumë të tilla atë ditë. Jo, ishte pendë skifteri. Ai i fryu përsëri dhe ia zgjati Pahrit, që ia mori nga duart gjithë gëzim.

Në shtëpinë e tyre, në Shadbag, Pahri mbante nën jastëk një kuti të vogël çaji që ia kishte dhuruar Abdullai. Kutia kishte një reze të ndryshkur dhe në kapak kishte një indian me mjekër, me çallmë në kokë e xhybe të gjatë të kuqe, i cili mbante me të dyja duart një filxhan me çaj që nxirrte avull. Brenda në kuti gjendeshin të gjitha pendët që kishte mbledhur Pahri. Kjo ishte pasuria e saj më e dashur. Pendë gjeli në ngjyrë jeshile të errët a të kuqërremtë; një pendë e bardhë pëllumbi; një pendë harabeli, ngjyrëçokollatë me pika të errëta; dhe ajo për të cilën Pahri ishte shumë krenare, një pendë e gjelbër e vezulluese palloi, me një sy të bukur në majë.

Këtë të fundit ia kishte dhuruar Abdullai dy muaj më parë. Ai kishte dëgjuar se familja e një djali në fshatin fqinj kishte një pallua. Një ditë, kur Babai ishte nisur për në një qytet në jug të Shadbagut për të ndërtuar kanale kulluese, Abdullai kishte shkuar në fshatin fqinjë, e kishte gjetur djalin dhe i kishte kërkuar një pendë të palloit. Kishin pasuar pazarllëqet dhe më në fund Abdullai kishte pranuar që ta këmbente pendën me këpucët e veta. Kur ishte kthyer përsëri në Shadbag, me pendën e palloit futur në rripin e pantallonave nën bluzë, thembrat i ishin çarë dhe linin gjurmë gjaku në tokë. Gjemba e guriçka i ishin ngulur në lëkurën e shputave.

Një dhembje e mprehtë i therte në këmbë në çdo hap që hidhte.

Kur kishte mbërritur në shtëpi, kishte gjetur njerkën, Parvanën, jashtë kasolles, të përkulur mbi *tandoor-in*[1], duke përgatitur *naan*[2] e përditshme.

Ai ishte fshehur menjëherë pas pemës gjigante të lisit pranë shtëpisë së tyre dhe kishte pritur derisa ajo të mbaronte. Që prapa trungut, ai e shihte ndërsa ajo punonte: një grua me supe të bëshme e krahë të gjatë, me duar të ashpra e gishta të shkurtër e të trashë; një grua me fytyrë të rrumbullakët e faqe të fryra, që nuk kishte asgjë të përbashkët me fluturën, emrin e së cilës mbante.

Abdullai uronte që ta donte ashtu siç kishte dashur nënën e tij. Nënën, që pati vdekur nga gjakrrjedhja, ndërsa lindte Pahrin, tre vjet e gjysmë më parë, kur Abdullai ishe shtatë vjeç. Nënën, fytyrën e së cilës ai nuk e kujtonte më tani. Nënën, që ia merrte kokën në duar dhe ia afronte pranë kraharorit të vet e pastaj i përkëdhelte faqen e i këndonte një ninullë për ta vënë në gjumë.

*Unë gjeta një zanë të vogël e të trishtuar*
*Nën hijen e një peme letre*[3].
*Unë njoh një zanë të vogël e të trishtuar*
*Që era e natës e mori me vete.*

Ai do të kishte dashur ta donte nënën e re me të njëjtën dashuri. Dhe mbase edhe Parvana, mendonte ai, do të kishte dëshiruar të njëjtën gjë: që edhe njerka të mund ta donte atë ashtu siç donte Ikbalin, që i çonte të ngjethura në trup sa herë që

---

1) Sobë prej argjile, tradicionale në Indi e Pakistan (*shën.i përkth.*).

2) Bukë tradicionale afgane (*shën.i përkth.*).

3) *Edgeworthia gardneri*, pemë dekorative, fibrat e së cilës përdoren për të bërë letër (*shën. i përkth.*).

kollitej ose teshtinte. Ose ashtu siç kishte dashur fëmijën e saj të parë, Omarin. Ajo e kishte adhuruar atë. Por ai kishte vdekur nga të ftohtët tre dimra më parë. Kishte qenë dy javësh. Parvana dhe Babai as që kishin arritur t'i vinin emrin. Ai kishte qenë njëra prej tri foshnjave që dimri i ashpër i atij viti kishte marrë në Shadbag. Abdullait i kujtohej se si e kishte shtrënguar Parvana fort trupin e pajetë të Omarit, me duart mbledhur grusht nga pikëllimi. I kujtohej edhe dita kur e kishin varrosur në kodër: një gropë e vogël në tokën e ngrirë, nën një qiell ngjyrë kallaji, Mullah Shekibi duke thënë lutjet dhe era që ua mbushte sytë me grimca të ngrira dëbore.

Abdullai besonte se Parvana do të tërbohej kur të merrte vesh se ai i kishte këmbyer këpucët e veta të vetme me një pendë palloi. Babait i kishte dalë shpina nën diell, që të fitonte paratë për t'i blerë ato. Ajo do t'ia merrte pendën, kur të mësonte për këtë. Madje, edhe mund ta qëllonte me shuplakë, kishte menduar Abdullai. Ajo e kishte qëlluar disa herë më parë. Dhe kishte duar të fuqishme, të rënda - për shkak të gjithë atyre viteve që i kishte shërbyer motrës së vet invalide, mendonte Abdullai - e dinte se si ta vërviste bishtin e fshesës ose si të jepte një flakërimë të mirë.

Por, të themi të drejtën, nuk dukej se Parvanës i jepte ndonjë kënaqësi të rrahurit e tij. Dhe as nuk mund të thuash se ishte e paaftë për t'i dashur thjeshtrit e saj. Dikur ai e kishte parë se si i kishte qepur Pahrit një fustan të ri ngjyrë jeshile në argjend me një cohë që Babai e kishte sjellë nga Kabuli. Ajo i kishte mësuar Abdullait, me një durim për t'u habitur, se si të thyente dy vezë njëkohësisht pa ua prishur të verdhën. I kishte mësuar që të dy se si të bënin kukulla prej kashte, ashtu siç kishin bërë ajo me të motrën, kur kishin qenë të vogla. U kishte mësuar edhe se si të qepnin rroba për kukulla me copat e mbetura.

Por këto i kishte bërë thjesht prej ndjenjës së detyrës - Abdullai e dinte këtë - diçka shumë më sipërfaqësore se ajo që ndiente për Ikbalin. Po qe se shtëpia e tyre do të merrte flakë

ndonjë natë, Abdullai nuk kishte pikë dyshimi se drejt cilit fëmijë do të vraponte Parvana për ta nxjerrë jashtë. Dhe nuk do të mendohej dy herë. Tek e fundit, gjërat ishin fare të thjeshta: ata, ai dhe Pahri, nuk ishin fëmijët e saj. Shumica e njerëzve donin vetëm fëmijët e tyre. Nuk kishe ç't'i bëje faktit që ai dhe e motra nuk ishin fëmijët e saj. Ata ishin mbeturina të një gruaje tjetër.

Ai kishte pritur derisa Parvana kishte futur bukën brenda në shtëpi, pastaj e kishte parë të dilte sërish, me Ikbalin në njërin krah dhe një kosh me rroba në krahun tjetër. E kishte parë teksa merrte rrugën e lumit, dhe kishte pritur derisa ajo i ishte zhdukur nga sytë, mandej kishte hyrë brenda në shtëpi, ndërsa shputat e këmbëve i thernin sa herë që i takonin në tokë. Brenda në shtëpi, ai kishte mbathur sandalet e vjetra plastike, të vetmet që i kishin mbetur tani. Abdullai e dinte se nuk ishte gjë e mirë ajo që kishte bërë. Por, kur ishte ulur në gjunjë përpara Pahrit, kur e kishte zgjuar butësisht nga gjumi dhe i kishte treguar pendën e palloit, që e kishte nxjerrë nga prapa shpinës si magjistar, e kishte kuptuar se gjithçka ia kishte vlejtur. Ia kishte vlejtur për atë habi që ishte shpalosur fillimisht në fytyrën e saj e që pastaj ia kishte zënë vendin mrekullimit; për mënyrën se si kishte nisur ta puthte ajo në faqe; për të qeshurën e saj, kur ai ia kishte përkëdhelur mjekrën me anën e butë të puplës. Dhe befas edhe këmbët nuk po i dhembnin më, aspak...

...Babai e fshiu fytyrën me mëngën e bluzës edhe një herë. Ata e kthyen pagurin e ujit me radhë. Kur mbaruan, Babai tha:

- U lodhe, djalë?

- Jo, - tha Abdullai, edhe pse në të vërtetë ndihej i këputur, i rraskapitur. Këmbët po i dhembnin. Nuk ishte e lehtë ta përshkoje shkretëtirën me sandale.

Babai tha:

- Hip në karrocë.

Abdullai u ul në karrocë, mbështeti shpinën pas anëve të

lëmuara prej druri, ndërsa vertebrat e vogla të shtyllës kurrizore të së motrës u mbështetën në kraharorin dhe barkun e tij. Teksa Babai tërhiqte karrocën, Abdullai nisi të kundronte qiellin, malet, radhët e kodrave të rrumbullakëta e të buta që mbështeteshin sup më sup me njëra-tjetrën atje tej. Ai shihte shpinën e kërrusur të të atit, që bënte përpara me kokën ulur, duke ngritur pufka-pufka pas çdo hapi rërën e kuqërremtë. Një karvan endacakësh *kuçí* u kaloi pranë, një procesion gjithë pluhur, këmbora tringëlluese e gamile që hungërinin, dhe një grua me qerpikë të zinj si qymyri e me flokët në ngjyrë gruri, që i buzëqeshi Abdullait.

Flokët e saj i kujtuan flokët e së ëmës dhe ai përsëri ndieu një dhembje përmallimi në kraharor: për butësinë e saj, për çiltërsinë e saj të lindur, për mënyrën se si habitej me ligësinë e njerëzve. Atij i kujtohej ende e qeshura e saj tingëlluese dhe mënyra se si e anonte ndonjëherë kokën gjithë butësi. E ëma kishte qenë një grua e brishtë, në trup e karakter; një grua elegante e belhollë, me një xhufkë flokësh që i dilte gjithmonë nga shamia e kokës. Ai vazhdimisht e kishte vrarë mendjen se si mundej ai trup aq i brishtë të strehonte brenda vetes aq shumë gëzim, aq shumë mirësi. Por ja që në të vërtetë nuk mundej t'i strehonte plotësisht. Mirësia e gëzimi shpërndaheshin përreth nga çdo qelizë e trupit të saj, shpërthenin nga sytë e saj. Kurse Babai ishte ndryshe. Babai ishte i ashpër. Sytë e tij shihnin po të njëjtën botë që shihnin edhe sytë e nënës, por ata gjenin vetëm mënjanësi. Punë shteruese pa fund. Bota e të atit ishte e pamëshirshme. Asgjë e mirë nuk vinte falas. As edhe dashuria. Duhej të paguaje për gjithçka. Dhe, për të varfrin, monedha me të cilën paguhej, ishte vuajtja. Abdullai hodhi sytë drejt vijës ndarëse të flokëve të së motrës, mandej te kyçi i brishtë i dorës së saj, që varej buzë karrocës. Ai e dinte se, kur e ëma kishte vdekur, diçka prej saj kishte kaluar te Pahri. Diçka nga përkushtimi i saj i mrekullueshëm, nga mungesa e ligësisë, nga shpresa e saj e përjetshme. Pahri

ishte i vetmi person në botë që nuk do të mund e nuk do ta lëndonte kurrë Abdullain. Ndonjëherë, djalit i dukej sikur ajo ishte i vetmi njeri i afërt që kishte në të vërtetë.

Ngjyrat e ditës u shkrinë dalëngadalë në grinë muzgore dhe majat e largëta të maleve u shndërruan në silueta opake gjigantësh të përthyer në mes. Gjatë ditës ata kishin kaluar nëpër disa fshatra, shumica e të cilave gjithë pluhur, njësoj si Shadbagu. Shtëpi të vogla prej qerpiçi, në formë katrore, ndonjëherë të vendosura në anë të malit e ndonjëherë jo, ndërsa nga oxhakët mbi çati ngriheshin fjolla tymi. Gra të vëna në rresht për të larë teshat, gra të tjera pranë zjarrit të gatimit. Ca plepa, ca pula, një grusht lopësh e dhish dhe gjithmonë një xhami. Fshati i fundit nëpër të cilin kaluan, gjendej në anë të një parcele me lulëkuqe, ku po punonte një burrë plak, i cili i përshëndeti me dorë. Ai bërtiti diçka, por Abdullai nuk arriti ta dëgjonte. Edhe Babai ia ktheu përshëndetjen me dorë.

Pahri tha:

- Abolla!

- Po.

- A është mërzitur Shuja?

- Them se ai ndihet shumë mirë.

- Nuk do t'i bëjë keq njeri?

- Ai është qen i madh tani, Pahri. Mund të mbrohet vetë.

Shuja ishte vërtet qen i madh. Babai thoshte se me siguri që e kishin përdorur për ndeshjet e qenve për disa kohë, sepse veshët e bishtin i kishte të dëmtuar. Nëse mundej ose donte apo jo ta mbronte veten, ishte tjetër gjë. Kur kafsha endacake ishte dukur në fillim në Shadbag, fëmijët kishin nisur t'i gjuanin me gurë, ta shponin me shkopinj a me tela rrotash biçiklete. Shuja kurrë nuk i sulmonte. Me kalimin e kohës, fëmijët e fshatit ishin mërzitur duke e ngacmuar dhe e kishin lënë të qetë, edhe pse Shuja kishte vazhduar të mos u zinte besë, të mos u afrohej e të tregonte kujdes, si të mos e harronte për asnjë çast mënyrën e ashpër me të cilën e patën trajtuar.

Ai iu shmangej të gjithëve në Shadbag, me përjashtim të

Pahrit. Vetëm përballë Pahrit Shuja e humbiste vetëpërmbajtjen. Dashuria e tij për të ishte e madhe dhe e pastër. Ajo ishte bota e tij. Në mëngjes, me të parë Pahrin të vinte këmbën në pragun e derës, Shuja kërcente përpjetë dhe i gjithë trupi i dridhej. Fundi i bishtit të prerë i tundej sa andej-këndej dhe kërcente si të ishte duke shkelur mbi qymyr të nxehtë. Kur Pahri dilte jashtë, ai vraponte i lumtur përreth saj. Mandej e ndiqte pas si hije gjatë gjithë ditës, duke nuhatur thembrat e saj, kurse natën, kur Pahri hynte në shtëpi, ai qëndronte jashtë derës, i përhumbur, duke pritur mëngjesin.

- Abolla!

- Po?

- Kur të rritem, a do të jetojmë bashkë?

Abdullai pa diellin si portokall që po ulej gjithmonë e më poshtë, duke iu afruar horizontit.

- Po qe se do, po. Por s'ke për të dashur.

- Po, do të dua.

- Ti do të duash një shtëpi që ta kesh të gjithën për vete.

- Por mund të jemi komshinj.

- Mbase.

- Ti nuk do të shkosh të banosh larg?

- Po sikur të të mërzitem?

Ajo i ra me bërryl.

- Jo!

Abdullai qeshi me vete.

- Në rregull, shumë mirë.

- Ti do të jetosh pranë meje.

- Po.

- Derisa të bëhemi pleq.

- Shumë pleq.

- Përgjithmonë.

- Po, përgjithmonë.

Ajo ktheu kokën, që ta vështronte në sy.

- A më premton, Abolla?

- Të premtoj... përgjithmonë.

Pak më vonë, Babai e hodhi Pahrin mbi shpinë, kurse Abdullai zbriti dhe nisi të tërhiqte karrocën bosh. Hapat e tij vijuan në një trajektore të pashoqëruar me mendime. Ndiente vetëm gjunjët që lëviznin, pikat e djersës që i rrëshqisnin në ballë, këmbët e vogla të Pahrit që përplaseshin pas shpinës së të atit. Ai vinte re vetëm hijen e të atit me të motrën në shpinë, që zgjatej në tokën gri të shkretëtirës dhe i largohej sa herë që ai ngadalësonte hapat.

Ishte dajë Nabi ai që ia kishte gjetur këtë punë Babait. Nabi ishte vëllai i madh i Parvanës, njerkës së tyre, megjithatë ata e thërrisnin dajë. Dajë Nabi ishte kuzhinier dhe shofer në Kabul. Ai vinte për vizitë tek ata në Shadbag një herë në muaj dhe mbërritja e tij trumbetohej nga boritë e ndërprera dhe britmat e kalamajve të fshatit, që ndiqnin pas trumba-trumba makinën e madhe ngjyrëblu, me çati të errët e disqe vezulluese. Ata i binin bagazhit dhe xhamave të dritareve me duar, derisa ai e fikte motorin e dilte duke qeshur. Ai, dajë Nabi i pashëm, me favoritet e gjata e flokët e rëndë pisë të zinj të ngritur mbi ballë, i veshur me kostumin ngjyrë ulliri pak të madh për trupin e tij dhe këpucët lustrafine bojëkafe. Të gjithë dilnin ta shihnin, ngaqë ai kishte makinë, paçka se ishte e padronit të tij, por edhe ngaqë ai vishej me kostum e punonte në një qytet të madh, në Kabul.

Dajë Nabi i kishte folur Babait për këtë punë herën e fundit që kishte ardhur në Shadbag. Njerëzit e pasur për të cilët punonte ai, do të ndërtonin një shtesë shtëpie: një shtëpi të vogël miqsh në kopshtin e pasmë, me një banjë, e ndarë nga pjesa tjetër e shtëpisë, dhe dajë Nabi u kishte sugjeruar që të merrnin në punë Babain, sepse kishte përvojë në ndërtim. Ai kishte thënë se pagesa do të ishte e mirë dhe nuk do të zgjaste më shumë se një muaj.

Babai kishte përvojë në ndërtim. Ai kishte punuar në

shumë vende të tilla. Me aq sa i kujtohej Abdullait, Babai ishte vazhdimisht në kërkim të një pune, vazhdimisht duke trokitur derë më derë për të gjetur qoftë edhe punë njëditore. Njëherë ai e kishte dëgjuar të atin t'i thoshte kryeplakut të fshatit, Mulla Shekibit: "Po të kisha lindur kafshë, Mulla Shekib, pa dyshim që do të kisha qenë mushkë". Ndonjëherë Babai e merrte edhe Abdullain me vete në punë. Një herë kishin mbledhur mollë në një qytet që ishte një ditë larg Shadbagut më këmbë. Abdullait i kujtohej i ati që kishte qëndruar hipur në shkallë deri në perëndim, me supet të kërrusura, me qafën që po i përvëlohej nga dielli, me lëkurën e parakrahëve të rreshkur, duke i këputur mollët njërën pas tjetrës me gishtat e tij të trashë. Në një qytet tjetër kishin përgatitur tulla për xhaminë. Babai i kishte treguar Abdullait se si të mblidhte dheun e mirë, atë që gjendej në thellësi e që kishte ngjyrë të çelët. Ata e kishin pastruar bashkë dheun, kishin përgatitur masën dhe babai e kishte mësuar se si ta derdhte ujin aq sa duhej, që përzierja të mos dilte e ujshme. Gjatë vitit të fundit, i ati kishte mbartur gurë, kishte pastruar mbeturinat, kishte pluguar arat. Ai kishte punuar edhe me një grup punëtorësh që kishin shtruar rrugën me asfalt.

Abdullai e dinte që i ati fajësonte veten për Omarin. Po qe se ai do të kishte pasur më shumë punë, ose një punë më të mirë, do të kishte mundur t'i blinte foshnjës rroba më të mira, mbulesa më të trasha e mbase edhe një sobë të vërtetë për të ngrohur shtëpinë. Këtë mendonte i ati. Ai nuk i kishte thënë asnjë fjalë Abdullait për Omarin qysh prej varrimit, por Abdullai e dinte.

Atij i kujtohej që, njëherë, disa ditë pasi kishte vdekur Omari, e kishte parë Babain të ulur vetëm rrëzë lisit gjigant. Ai lis ishte si një kullë për Shadbagun, ishte gjëja më e vjetër që gjëllonte në fshat. Babai thoshte se nuk do të çuditej aspak, po të merrte vesh që ajo pemë kishte qenë dëshmitare e marshimit të perandorit Babur dhe e ushtrisë së tij për në Kabul. Ai pohonte se e kishte kaluar gjysmën e fëmijërisë së vet nën

hijen e kurorës së saj masive ose duke u kacavjerrë nëpër degët e saj të forta. I ati i tij, gjyshi i Abdullait, kishte varur dy litarë të gjatë në njërën prej degëve të trasha dhe në fundin e tyre kishte lidhur një dërrasë, duke formuar kështu një shilarës, që i kishte mbijetuar një numri pafund stinësh të ashpra e kishte jetuar më gjatë se vetë plaku. Babai thoshte edhe se, kur kishin qenë fëmijë, ai kishte tundur me radhë Parvanën dhe të motrën, Masomën, në këtë shilarës.

Por, kohët e fundit, Babai ishte gjithmonë i rraskapitur nga puna, kur Pahri e kapte nga bluza dhe i lutej që ta tundte në shilarës.

- Nesër, Pahri.

- Vetëm pak fare, babi. Të lutem, çohu!

- Jo tani. Një herë tjetër.

Më në fund ajo hiqte dorë, ia lëshonte bluzën dhe largohej e dorëzuar. Ndonjëherë Babait i binte koka mbi kraharor, ndërsa ndiqte me sy Pahrin të largohej. Atëherë ai mbështillej me kapotë, ngrinte jakën dhe mbyllte sytë e rënduar.

Abdullai nuk arrinte ta përfytyronte dot që dikur edhe Babai ishte përkundur në shilarës. Nuk e përfytyronte dot që edhe i ati kishte qenë dikur fëmijë, si ai. Një fëmijë i shpenguar, i lirë. Që vraponte nëpër fusha tok me shokët e vet. Ai Baba, duart e të cilit tani ishin të mbuluara me kallo, kurse fytyrën ia brazdonin rrudhat e thella të mundimit. Ai Baba, që dukej sikur kishte lindur me lopatë në dorë e thonj gjithë baltë.

Atë natë qenë të detyruar të flinin në shkretëtirë. Hëngrën bukën dhe patatet e fundit të ziera që u kishte dhënë Parvana me vete. Babai ndezi zjarrin dhe vuri mbi flakë një enë për të bërë çajin.

Abdullai qëndronte pranë zjarrit, i mbështjellë me batanijen e leshit pranë Pahrit, kurse ajo i kishte mbështetur pas tij shputat e ftohta të këmbëve.

Babai u përkul mbi flakë dhe ndezi një cigare.

Abdullai u shtri në shpinë, kurse Pahri lëvizi për ta mbështetur faqen në gropëzën nën klavikulën e tij. Ai mori frymë thellë dhe tok me ajrin thithi edhe aromën e bakrit që vinte prej rërës së shkretëtirës. Pastaj ngriti sytë lart, drejt qiellit të mbushur me yje, që vezullonin si kristale akulli. Një hënë si drapër i hollë qëndronte varur në përvijimin e zbehtë fantazmagorik të qarkut të saj të plotë.

Abdullai mendoi përsëri për dimrin e tre vjetëve më parë, kur gjithçka ishte kredhur në errësirë, ndërsa era përplasej pas derës e pas tjegullave të çatisë duke fishkëllyer me tërbim. Gjithçka në fshat ishte mbuluar nga dëbora. Netët kishin qenë të gjata e pa yje, dita, e shkurtër, e vrenjtur, dielli rrallë dilte, madje edhe atëherë vetëm për pak çaste e zhdukej sërish. Atij iu kujtuan të qarat e Omarit, kur kishte lindur, dhe pastaj heshtja e tij. Pastaj Babai që punonte një kokë varri nën dritën e një hëne në formë drapri, njësoj si hëna e kësaj nate, për ta vendosur më pas në tokën e ngrirë kallkan, te koka e varrit të vogël.

Edhe tani po vinte përsëri fundi i vjeshtës. Dimri pó vërtitej sërish aty pas qoshes, edhe pse as Babai, as Parvana nuk e përmendnin, a thua se fjalët e tyre do ta bënin të vinte më shpejt.

- Baba! - foli ai. - Nga ana tjetër e zjarrit, i ati lëshoi një mërmërimë të butë. - A do të më lejosh të të ndihmoj? Për të ndërtuar shtëpinë e miqve, dua të them.

Tymi i cigares së Babait u ngjit lart në formë spiraleje. Ai i kishte ngulur sytë në një pikë të papërcaktuar në errësirë.

- Baba!

Babai lëvizi në gurin mbi të cilin ishte ulur.

- Besoj se mund të më ndihmosh të përziej llaçin, - tha ai.

- S'e di se si bëhet.

- Do të ta tregoj unë. Ke për ta mësuar.

- Po unë? - tha Pahri.

- Ti? - tha Babai me zë të ulët. Ai e thithi cigaren edhe

një herë dhe trazoi zjarrin me shkop. Xixa të vogla nisën të kërcenin duke u ngjitur lart në errësirë. - Ti do të jesh përgjegjëse për ujin. Do të sigurosh që të mos na marrë etja për asnjë çast. Sepse burrat nuk punojnë dot, po qe se kanë etje.

Pahri nuk po fliste.

- Babai ka të drejtë, - tha Abdullai. Ai e ndieu që Pahri do të kishte dashur t'i bënte duart pis, t'i zhyste ato në baltë deri në bërryla, ndaj ishte zhgënjyer nga detyra që i kishte caktuar Babai. - Po të mos të kemi ty që të na sjellësh ujë, nuk do të arrijmë ta ndërtojmë kurrë shtëpinë e miqve.

Babai futi shkopin nën dorezën e kusisë së çajit dhe e largoi këtë nga zjarri. E la mënjanë të ftohej.

- E di si është puna? - tha ai. - Ti do të më tregosh që di ta bësh mirë këtë punën e ujit, dhe unë do të të caktoj pastaj një detyrë tjetër.

Pahri ngriti kokën dhe vështroi Abdullain, me fytyrën të ndriçuar nga një buzëqeshje vesh më vesh.

Atij i kujtohej kur ajo kishte qenë foshnjë dhe e zinte gjumi mbi kraharorin e tij. Kur ndonjëherë i dilte gjumi në mes të natës, e gjente duke i buzëqeshur në heshtje, me po këtë shprehje në fytyrë.

Ai e kishte rritur atë. Me plot kuptimin e fjalës. Edhe pse kishte qenë edhe vetë fëmijë. Dhjetë vjeç. Kur Pahri ishte ende foshnjë, kishte qenë Abdullai ai që zgjohej natën nga të qarat e ankimet e saj, ai që çohej nga shtrati dhe e përkundte në errësirë. Ishte ai që ia ndërronte pelenat. Që e lante Pahrin. Këto nuk ishin punë për Babanë dhe, veç kësaj, ai gjithmonë ishte tejet i lodhur nga puna. Kurse Parvana, shtatzënë me Omarin, u përgjigjej me shumë ngathtësi nevojave të Pahrit. Kështu që i kishte rënë Abdullait të kujdesej për të, por ai nuk e kishte pasur aspak problem. E kishte bërë gjithçka me kënaqësi. Atë e ngazëllente ideja se e kishte ndihmuar ai të motrën që të hidhte hapin e parë, që të belbëzonte fjalën e

parë. Pikërisht ky ishte qëllimi i jetës së tij, mendonte Abdullai, kjo ishte arsyeja pse e kishte bërë Zoti: që ai të kujdesej për Pahrin, pasi Zoti ta merrte pranë tij nënën e tyre.

- Babi, - tha Pahri. - Na trego një përrallë.

- Po bëhet vonë, - iu përgjigj Babai.

- Të lutem!

Babai ishte natyrë e mbyllur. Ai rrallë thoshte më shumë se dy fjali njërën pas tjetrës. Por herë pas here, për shkaqe që Abdullai nuk i dinte, diçka te babai zbërthehej dhe prej tij nisnin të dilnin përrallat. Ndonjëherë Pahri dhe Abdullai uleshin përpara tij, ndërsa Parvana përplaste kusitë në kuzhinë, dhe ai niste t'u rrëfente historitë që ia kishte treguar gjyshja e vet dikur, kur kishte qenë edhe ai fëmijë, duke i futur që të dy në një botë plot me sulltanë, xhinde, diva keqbërës e dervishë të mençur. Herë të tjera ai i sajonte vetë përrallat. I sajonte aty për aty dhe ato përralla zbulonin një aftësi të tij për të imagjinuar e ëndërruar, që e habiste Abdullain. Dhe kurrë i ati nuk i dukej Abdullait më i gjallë, më i pranishëm, më i vërtetë e më vetvetja, sesa në ato çaste kur tregonte përralla, sikur ato të ishin të vetmet vrima në koracën e fortë e të padepërtueshme të botës së tij.

Por Abdullai e kuptonte nga shprehja e fytyrës së të atit se sonte ai nuk do të tregonte asnjë përrallë.

- Është vonë, - përsëriti Babai. E ngriti kusinë me fundin e shallit që i varej te supet, dhe mbushi një filxhan çaj për vete. I fryu paksa dhe e rrufiti, ndërsa fytyra i mori një ngjyrë portokallí nga flakët. - Tani duhet të flini. Nesër do të jetë një ditë e gjatë.

Abdullai mbuloi kokën e vet e të Pahrit me batanije. Nën të, ai nisi t'i këndonte Pahrit një ninullë:

*Unë gjeta një zanë të vogël e të trishtuar,*
*Nën hijen e një peme letre.*

Pahri, gati e kapluar tashmë nga gjumi, nisi të këndonte dy vargjet e tjera me zë të zvargur:

*Unë njoh një zanë të vogël e të trishtuar,*
*Që era e natës e mori me vete.*

Pa e mbaruar mirë fjalën e fundit, vogëlushja nisi të gërhiste lehtë.

Abdullai u zgjua pas njëfarë kohe dhe vuri re se Babai nuk ishte aty. U ngrit i trembur. Zjarri ishte shuar dhe kishin mbetur vetëm ca gaca të dobëta, që digjeshin midis hirit. Abdullai hodhi sytë majtas, mandej djathtas, por nuk arriti të shquante asgjë në atë errësirë që në çast iu duk e paanë dhe mbytëse. E ndieu se gjaku po i largohej nga fytyra. Zemra po i kërcente në kraharor. Mprehu veshët, mbajti frymën.

- Baba! - pëshpëriti ai.

Heshtje.

Thellë në kraharor nisi t'i ngjallej paniku. Ndenji pa lëvizur, me trupin të tendosur, dhe përgjoi heshtjen e natës për një kohë të gjatë. Por nuk dëgjoi asgjë. Ishin vetëm fare, ai dhe Pahri, të rrethuar nga errësira e dendur. Ishin të braktisur. Babai i kishte braktisur. Për herë të parë, Abdullai ndieu zbrazëtinë e vërtetë të shkretëtirës dhe... të botës. Sa lehtë mund ta humbisje rrugën aty. Nuk gjendej aty askush që të të ndihmonte, askush që të të tregonte rrugën. Dhe pastaj një mendim ogurzi nisi t'i gëlonte në kokë: Babai kishte vdekur. Ia kishin prerë gurmazin. Banditët. Ata e kishin vrarë dhe tani po i rrethonin atë dhe Pahrin, ngadalë, duke shijuar çdo çast, duke e shndërruar gjithçka në lojë.

- Baba! - thirri ai përsëri, këtë herë me zë të dridhur. Përsëri asnjë përgjigje. - Baba!

Ai e thirri përsëri të atin, ndërsa në grykë iu mblodh një nyje që po zmadhohej gjithmonë e më shumë. Nuk e mbante mend se sa herë e kishte thirrur të atin dhe për sa kohë pa marrë asnjë përgjigje nga errësira. Ai nisi të përfytyronte fytyra keqdashëse, të fshehura pas shkëmbinjve të malit, që i kundronin atë dhe Pahrin me ligësi. E pushtoi paniku, që po i shpërndahej në të gjithë trupin. Nisi të dridhej dhe fryma thuajse iu

mek fare. E ndiente se nga çasti në çast do të lëshonte një klithmë.

U dëgjuan hapa. Një siluetë u shfaq në errësirë.

- Mendova se kishe ikur, - tha Abdullai me zë të dridhur. Babai u ul pranë hirit të zjarrit. - Ku ishe?

- Bjer prapë të flesh, djalë.

- Ti nuk do të na lësh. Nuk do ta bësh këtë, apo jo, Baba?

Babai e vështroi, por fytyra i mori një shprehje që, në atë errësirë, Abdullai nuk e kuptoi dot.

- Do të zgjosh motrën.

- Mos na lër.

- Boll tani!

Abdullai u shtri përsëri, me zemrën që i rrihte me tërbim në kraharor, ndërsa e motra flinte e strukur në gjoksin e tij.

Abdullai nuk kishte qenë kurrë në Kabul. Gjithçka që dinte për Kabulin, ishin ato që i kishte treguar dajë Nabi. Ai kishte qenë në disa qytete të vogla për punë tok me Babain, por kurrë në një qytet të vërtetë dhe, afërmendsh, asgjë nga ato që i kishte rrëfyer dajë Nabi, nuk mund ta përgatitnin dot për zhurmën e gjullurdinë e qytetit më të madh nga gjithë të tjerat. Ngado kishte semaforë, çajhane, restorante, dyqane me vitrina të xhamta dhe tabela të ndritshme shumëngjyrëshe. Makinat nguteshin gjithë zhurmë nëpër rrugët e mbushura, duke u rënë borive e duke hyrë midis autobusëve, këmbësorëve e biçikletave. Nëpër bulevarde kalonin *garis*-e të tërhequra nga kuajt, me rrotat prej hekuri që kërcenin mbi asfalt. Këmbësoret nëpër të cilat po ecte ai tok me të atin dhe Pahrin, ishin të mbushura me shitës ambulatorë cigaresh e çamçakëzësh, stenda gazetash, nallbanë që punonin potkonj kuajsh. Nëpër kryqëzime, policët e veshur me uniforma të mëdha për trupin e tyre i frynin bilbilit dhe bënin gjeste autoritare me duar, të cilave dukej se nuk ua vinte veshin askush.

Abdullai ishte ulur në një stol përpara dyqanit të mishit,

me Pahrin në prehër, dhe të dy po hanin fasule të pjekura e *çutni*[1] me koriandër në një pjatë të vogël, që Babai ua kishte blerë në një stendë në rrugë.

- Shiko atje, Abolla, - i tha Pari, duke bërë me gisht drejt një dyqani në anën tjetër të rrugës. Në vitrinën e tij po qëndronte një grua e re, e veshur me një fustan të bukur jeshil, të zbukuruar me pasqyra të vogla dhe gurë të çmuar. Në qafë kishte një shall të gjatë me të njëjtën ngjyrë, bizhuteri argjendi dhe kishte veshur pantallona në ngjyrë të kuqe të thellë. Ajo po qëndronte pa lëvizur fare, duke i parë shpërfillshëm kalimtarët që kalonin aty pranë, dhe nuk i pupuliti sytë as edhe një herë. Ajo nuk bëri as edhe lëvizjen më të vogël, ndërsa Pahri e Abdullai hanin fasulet, dhe qëndroi pa lëvizur edhe pasi ata i mbaruan. Pak më tej, Abdullai pa një poster gjigant të varur në ballinën e një ndërtese të lartë. Aty shihej një vajzë e bukur indiane në një fushë me tulipanë, nën një shi të imët, duke vrapuar gjithë naze prapa një lloj shtëpie njëkatëshe. Mbi buzë kishte një buzëqeshje të ëmbël, kurse *sari*[1] i lagur prej shiut i ishte ngjitur pas trupit. Abdullai po vriste mendjen a ishte pikërisht ky ai vendi që dajë Nabi e kishte quajtur kinema, ku njerëzit shkonin për të parë filma. Ai po shpresonte që muajin e ardhshëm dajë Nabi t'i çonte edhe atë me Pahrin në kinema. Ky mendim e bëri të vinte buzën në gaz.

Nga një xhami me pllaka blu aty pranë erdhi thirrja për t'u lutur dhe ja tek u duk më në fund edhe dajë Nabi, që e ndali makinën ndanë këmbësores. Ai hapi derën e shoferit dhe gati sa nuk e hodhi në tokë një djalë të ri me biçikletë, të veshur me *çapan*[2] që arriti të shmangej në çastin e duhur.

Dajë Nabi, i veshur me kostumin e vet ngjyrë ulliri, i ra rrotull makinës nga përpara dhe u përqafua me Babanë. Kur

---

1) Salcë indiane me erëza (*shën. i përkth.*).

2) Rrobë e gjerë dhe e gjatë, e paqepur, që hidhet në trup në forma të ndryshme; tradicionale për gratë indiane (*shën. i përkth.*).

3) Një lloj kaftani, tradicional për Azinë Qendrore (*shën. i përkth.*).

pa Abdullain dhe Pahrin, mbi fytyrë i shpërtheu një buzëqeshje e fuqishme. U ndal përpara tyre dhe u ul galiç.

- Si po ju duket Kabuli, fëmijë?

- Ka shumë zhurmë, - tha Pahri, dhe dajë Nabi qeshi.

- Ashtu është. Ejani, hipni në makinë. Do të mund të shihni shumë më tepër gjëra nga makina. Fshijini këmbët, përpara se të hipni. Sabor, ti ulu përpara.

Ndenjësja e pasme ishte e ftohtë, e fortë dhe në ngjyrë blu, si edhe makina. Abdullai u ul pas ndenjëses së shoferit, u afrua pranë dritares dhe e mori Pahrin në prehër. Ai vuri re se me sa zili po e shihnin makinën njerëzit që kishin ndaluar aty pranë. Pahri kthehu kokën nga ai dhe të dy shkëmbyen një buzëqeshje.

Ata shikonin qytetin që rrëshqiste anash tyre, ndërsa dajë Nabi ngiste makinën. Ai u tha se do t'i binte nga një rrugë e gjatë, që ata të mund të shihnin më shumë gjëra. Pastaj u tregoi me dorë një kodrinë të quajtur *Tapa Maranjan*, në majën e së cilës gjendej një mauzole me kupolë të rrumbullakët, që sundonte mbi qytet. Siç u tha dajë Nabi, aty ishte varrosur Naber Shahu, babai i mbretit Zaher Shah. Pastaj ai u tregoi fortesën *Bala Hissar* në majë të malit *Koh-e-Shirdawaza*, të cilën e kishin përdorur britanikët gjatë luftës së tyre të dytë kundër Afganistanit.

- Ç'është ajo, dajë Nabi? - preku me gisht Abdullai xhamin e dritares, duke bërë me shenjë drejt një ndërtese të verdhë drejtkëndëshe.

- Fabrika e re e bukës. - Nabi e mbajti timonin me një dorë dhe u kthye nga ai për t'i shkelur syrin. - Falë miqve tanë, rusëve.

"Një fabrikë që bën bukë", - u mrekullua Abdullai, duke sjellë ndër mend imazhin e Parvanës në Shadbag, që përplaste topat e brumit nëpër anët e *tandoor*-it të tyre prej argjile.

Më në fund, dajë Nabi hyri në një rrugë të gjerë e të pastër, në të dy anët e së cilës bënin rojë dy radhë qiparisash me largësi të njëjtë nga njëri-tjetri. Shtëpitë këtu ishin elegante

dhe më të mëdha se shtëpitë që kishte parë Abdullai. Ishin të bardha, të verdha e bojëqielli. Shumica ishin me disa kate, të rrethuara me mure të larta, ku shquheshin dyer dykanatëshe. Ndanë rrugës, Abdullai pa të parkuara disa makina si ajo e dajë Nabit.

Dajë Nabi u ndal në një rruginë të kufizuar nga një radhë kaçubash të krasitura me formë të rregullt. Në anë të rrugës gjendej një shtëpi dykatëshe, me mure të bardha, shumë e madhe.

- Sa e madhe qenka shtëpia jote! - pëshpëriti Pahri, duke hapur fort sytë nga mrekullimi.

Dajë Nabi i dha kokës pas, ndërsa qeshte me të madhe.

- S'do të ishte keq të qe imja. Por jo, kjo është shtëpia e padronëve të mi. Tani do t'i takoni. Dhe ti do të sillesh me shumë edukatë.

Dajë Nabi i shoqëroi Babanë, Pahrin dhe Abdullain brenda dhe ata vunë re se ajo ishte edhe më mbresëlënëse. Abdullait iu duk sikur ishte aq e madhe, sa mund të strehonte gjysmën e familjeve të Shadbagut. Atij po i dukej sikur kishte hyrë në pallatin e Divit. Kopshti i pasmë ofronte një pamje shumë të bukur, me lule të të gjitha ngjyrave të mbjella në rreshta simetrikë, kaçuba deri te gjuri dhe drurë frutorë: qershi, mollë, kajsi dhe shegë. Në kopsht dilej nga një verandë me çati - kështu e quajti dajë Nabi - dhe kjo ishte e kufizuar nga dy radhë hardhish të shkurtra me rrush jeshil. Ndërsa drejtoheshin për te dhoma ku po i prisnin zoti dhe zonja Vahdati, Abdullai futi kokën në një banjë me WC porcelani dhe lavaman vezullues me rubinet ngjyrë bakri, që ishin tamam ashtu siç ua kishte përshkruar dajë Nabi. Abdullai, që çdo javë kalonte orë të tëra duke mbushur shtambat me ujë në pusin e përbashkët të Shadbagut, u mrekullua nga ajo jetë ku ujin e kishe sa të zgjatje krahun.

Tani që të tre: Abdullai, Pahri dhe Babai, ishin ulur në një divan të rëndë, me xhufka të florinjta. Jastëkët e butë ku kishin mbështetur shpinën, ishin të zbukuruar me pasqyra të vockla tetëkëndëshe. Përballë divanit ishte varur një pikturë që mbulonte gjithë murin: një gurgdhendës plak, i ulur në stolin e tij të punës, duke goditur një gur me çekanin e vet. Perde të kuqërremta me pala mbulonin dritaret e gjera që shihnin në një ballkon, i cili kufizohej me parmak hekuri në lartësinë e kyçit të dorës. Çdo gjë në dhomë ishte e pastër, pa pluhur. Kurse Abdullai ishte i vetëdijshëm sa asnjëherë më parë në jetën e vet se sa pis ishte.

Padroni i dajë Nabit, zoti Vahdati, ishte ulur në një karrige lëkure, me krahët të kryqëzuar në kraharor. Ai po i shihte me një shprehje fytyre që nuk ishte armiqësore, por e ftohtë, e padepërtueshme. Ishte më i gjatë se Babai; Abdullai e kishte vënë re këtë, sapo ai ishte çuar në këmbë për t'i përshëndetur. Ai kishte supe të ngushta, buzë të holla dhe një ballë të lartë të ndritshëm. Kishte veshur një kostum të bardhë, të prerë në bel, një këmishë jeshile pa jakë, manshetat e mëngëve të së cilës mbaheshin të mbërthyera nga gurë lapisi[1] në formë vezake. Gjatë gjithë kësaj kohe, ai nuk kishte thënë më shumë se një duzinë fjalësh.

Pahri ia kishte ngulur sytë një pjate me ëmbëlsira mbi tryezën prej xhami përpara tyre. Abdullai nuk e kishte menduar kurrë se ekzistonin kaq shumë lloje ëmbëlsirash. Çokollata në formë gishti me spirale kremi, çokollata të vogla të rrumbullakëta, me diçka ngjyrë portokalli në qendër, karamele jeshile në formë gjethesh dhe shumë të tjera.

- Dëshiron një? - e pyeti zonja Vahdati. Vetëm ajo fliste aty. - Merre. Merrni të dy. Për ju i kam nxjerrë.

Abdullai ktheu kokën nga i ati për t'i marrë leje dhe të

---

1) *Lapis lazuli* ose shkurt *lapis* është një gur i rrallë gjysmë i çmuar, që është përdorur qysh në lashtësi për shkak të ngjyrës së veçantë blu (*shën. i përkth.*).

njëjtën gjë bëri edhe Pahri. Kjo duket se i pëlqeu zonjës Vahdati, që harkoi vetullat, anoi kokën dhe buzëqeshi.

Babai pohoi lehtë me kokë.

- Një secili, - tha ai me zë të ulët.

- Oh, jo kështu, - tha zonja Vahdati. - Unë e çova Nabin enkas te një ëmbëltore gjysmë ore larg për t'i blerë këto.

Babai u skuq dhe uli sytë. Ai ishte ulur buzë divanit, duke e mbajtur me të dyja duart kapën e tij të ronitur. Gjunjët i mbante larg zonjës Vahdati dhe sytë mbi bashkëshortin e saj.

Abdullai mori dy ëmbëlsira dhe ia dha njërën Pahrit.

- Oh, merr edhe një tjetër. Nuk duam t'ia çojmë dëm mundimin Nabit, - vërejti zonja Vahdati me ëmbëlsi. Ajo i buzëqeshi dajë Nabit.

- Nuk ishte aspak mundim, - tha dajë Nabi dhe u skuq në fytyrë.

Dajë Nabi po qëndronte pranë derës, pranë një bufeje të lartë prej druri, me kanate të trasha xhami. Në raftet aty brenda, Abdullai pa fotografitë e zotit e të zonjës Vahdati, të vendosura në korniza argjendi. Ja tek ishin, bashkë me një çift tjetër, të veshur me pallto të rënda e shalle të trasha, ndërsa një lumë gjithë shkumë rridhte pas tyre. Në një fotografi tjetër, zonja Vahdati, duke mbajtur një gotë në dorë, e qeshur, me krahët e zhveshur rreth belit të një burri tjetër, i cili, e paimagjinueshme për Abdullain, nuk ishte zoti Vahdati. Aty ishte edhe një fotografi dasme: ai, i gjatë dhe i pashëm, me një kostum të zi; ajo, me një fustan të bardhë të derdhur, të dy duke buzëqeshur me gojët mbyllur.

Abdullai i hodhi një vështrim vjedhurazi belit të saj të hollë, gojës së vogël e të bukur, vetullave me harkim të përkryer, thonjve ngjyrërozë dhe buzëkuqit me të njëjtën ngjyrë. Tani iu kujtua që e kishte parë për herë të parë, kur Pahri ishte vetëm dy vjeç. Dajë Nabi e kishte sjellë në Shadbag, sepse ajo i kishte kërkuar të takonte familjen e tij. Atëherë ajo kishte veshur një fustan ngjyrë pjeshke pa mëngë - ai nuk e harronte shprehjen e habisë në fytyrën e të atit - dhe mbante

syze të errëta me skelet të trashë të bardhë. I kishte pyetur për fshatin, për jetën e tyre, për emrat dhe moshën e fëmijëve, gjatë gjithë kohës duke buzëqeshur. Ajo ishte sjellë si t'i përkiste asaj bote me shtëpi prej qerpiçi me tavane të ulëta, ndërsa qëndronte me shpinën mbështetur pas një muri të mbuluar nga myshku, e ulur pranë një dritareje të ndotur nga mizat dhe mushamasë plastike jo të tejdukshme që ndante dhomën e ndenjjes nga kuzhina, që ishte njëherazi edhe dhomë gjumi për Pahrin e Abdullain. Ajo kishte hyrë brenda në një mënyrë të bujshme, duke këmbëngulur që t'i hiqte këpucët me taka të larta te dera, dhe ishte ulur në dysheme, edhe pse Babai i kishte afruar një karrige. Si të ishte njëra prej tyre. Asokohe Abdullai ishte vetëm tetë vjeç, por i kishte kuptuar të gjitha shumë mirë.

Gjëja që ai mbante mend më mirë nga ajo vizitë, ishte Parvana, që, shtatzënë me Ikbalin, kishte qëndruar në një qoshe të errët, në heshtje të plotë, e mbledhur si top. Supet i mbante të kërrusura, krahët e këmbët të mbledhura nën barkun e fryrë, a thua se po përpiqej të zhdukej duke u futur brenda murit. Fytyrën e kishte mbuluar me një vel gjithë njolla, të cilin e kishte lidhur me spango nën mjekër. Por Abdullai kishte arritur të dallonte ndenjën e turpit që dilte prej saj si avull, sa e vogël ndihej ajo në ato çaste, dhe, për çudi, kishte ndier keqardhje për njerkën e vet.

Zonja Vahdati zgjati dorën drejt paketës që gjendej pranë pjatës me ëmbëlsira, dhe ndezi një cigare.

- I ramë nga rruga e gjatë dhe u tregova disa gjëra të qytetit, - tha dajë Nabi.

- Bukur! Bukur! - tha zonja Vahdati. - A kishit qenë më parë në Kabul, Sabor?

Babai u përgjigj:

- Një ose dy herë, Bibi Sahib.

- Dhe a mund t'ju pyes ç'përshtypje ju ka lënë?

Babai mblodhi supet.

- Ka shumë njerëz.

- Po. - Zoti Vahdati i ra me gisht një fijeje të bardhë në mëngën e xhaketës dhe uli sytë mbi tapet. - Shumë njerëz, po, dhe ndonjëherë është edhe i lodhshëm, - shtoi e shoqja. Babai pohoi me kokë, si ta kuptonte se ç'donte të thoshte. - Kabuli është si një ishull, vërtet. Disa thonë se është qytet që tregon progres, dhe kjo mund të jetë e vërtetë. Mjaftueshëm e vërtetë, besoj, por ama është si i shkëputur nga qytetet e tjera të vendit. - Babai uli sytë mbi kapën në duart e tij dhe puliti sytë. - Mos më keqkuptoni, - tha ajo. - Unë do ta mbështetja me gjithë zemër çdo plan progresi të këtij qyteti. Vetëm një Zot e di se sa ka nevojë për këtë ky vend. Por prapë më duket se këtij qyteti i pëlqen paksa vetja. Ju betohem, pompoziteti i këtij vendi, - ajo psherëtiu, - është shumë i lodhshëm. Unë gjithmonë e kam admiruar fshatin. E dua shumë. Provincat e largëta, *qarias*, fshatrat e vogla. Afganistani i vërtetë, pra. - Babai pohoi me një pamje të pasigurt. - Unë mbase nuk pajtohem me të gjitha ose me disa prej zakoneve fisnore, por kam përshtypjen se njerëzit atje bëjnë një jetë më të mirëfilltë. Kanë një lloj vendosmërie të veçantë. Një lloj përulësie përtëritëse. Dhe janë shumë mikpritës. Shumë elastikë. Por edhe krenarë. A është kjo fjala e saktë, Sulejman? Krenarë?

- Mjaft tani, Nila, - iu drejtua i shoqi me zë të shtruar.

Pasoi një heshtje e rëndë. Abdullai shihte zotin Vahdati që po trokiste gishtat mbi krahmbështetësen e kolltukut, dhe gruan e tij që po buzëqeshte lehtë: me fundçen e cigares të ngjyer me rozë, këmbët të kryqëzuara te kyçet, bërrylat në krahmbështetëset e karriges.

- Mbase nuk është kjo fjala e saktë, - tha ajo, duke thyer heshtjen. - Dinjitet, mbase? - Dhe buzëqeshi, duke zbuluar një radhë dhëmbësh të drejtë e të bardhë. Abdullai nuk kishte parë kurrë dhëmbë të tillë. - Kjo është. Shumë më e saktë. Njerëzit e fshatit kanë një lloj dinjiteti në vetvete. Ata e mbajnë mbi vete, apo jo? Si një çantë. Po tregohem e sinqertë tani: unë arrij ta dalloj këtë tek ti, Sabor.

- Falemnderit, Bibi Sahib, - mërmëriti Babai, duke lëvizur në divan, ende me sytë ulur mbi kapën e tij.

Zonja Vahdati pohoi me kokë. Ajo vështroi nga Pahri.

- Dhe a mund të të them që ti je një fëmijë shumë i ëmbël? - Pahri u ngjit më shumë pas Abdullait.

Ngadalë, zonja Vahdati nisi të recitonte

- *Sot sytë e mi panë sharmin, bukurinë, dinjitetin e padepërtueshëm të fytyrës që po kërkoja.* - Ajo buzëqeshi. - Rumiu. A ke dëgjuar për të? Më duket se ai e ka krijuar enkas për ty këtë poezi, e dashur.

- Zonja Vahdati është poete e afirmuar, - tha dajë Nabi.

Zoti Vahdati zgjati dorën të merrte një çokollatë, e ndau më dysh dhe kafshoi një copë të vogël.

- Nabi po tregohet shumë i mirë, - tha zonja Vahdati, duke i hedhur një vështrim të ngrohtë. Abdullai vuri re se faqet e dajë Nabit u skuqën. Zonja Vahdati e fiku cigaren, duke e përplasur majën disa herë në tavëll. - A mund t'i marr fëmijët të shohin ndonjë gjë? - tha ajo. Zoti Vahdati psherëtiu lehtë, përplasi të dyja pëllëmbët në krahmbështetëset e karriges dhe mori pozicion sikur do të ngrihej në këmbë, por nuk lëvizi nga vendi. - Do t'i çoj në Pazar, - i tha zonja Vahdati Babait. - Nëse nuk ke ndonjë kundërshtim për këtë, Sabor. Do të na çojë Nabi me makinë. Sulejmani mund të të tregojë jashtë se ku do të punosh. Kështu që mund ta shohësh vetë vendin e punës.

Babai pohoi me kokë.

Sytë e zotit Vahdati u mbyllën ngadalë.

Ata u ngritën për të ikur.

Papritur, Abdullai ndieu një dëshirë që Babai t'i falënderonte këta njerëz për ëmbëlsirat dhe çajin, ta kapte Pahrin për dore dhe të iknin nga ajo shtëpi e nga pikturat, perdet, luksi dhe rehatia e saj. Ata mund të mbushnin pagurin me ujë, të blinin bukë dhe ca vezë të ziera dhe të ktheheshin andej nga kishin ardhur: nëpër shkretëtirë, shkëmbinj, kodra, ndërsa Babai u tregonte përralla. Ata do ta shtynin karrocën e Pahrit

me radhë. Dhe mbase, pas dy a tri ditësh, me gjithë atë pluhur në mushkëri e me këmbët të lodhura, do të ishin përsëri në Shadbag. Shuja do t'i shihte ndërsa afroheshin dhe do të sulej vrik drejt tyre, duke kërcyer gjithë ngazëllim rrotull Pahrit. Do të ishin në shtëpi.

Por babai tha:

- Shkoni, fëmijë.

Abdullai bëri një hap përpara, me synimin që të thoshte diçka, por ndieu dorën e trashë të dajë Nabit në sup, që e ktheu nga ana tjetër dhe pastaj e drejtoi nëpër korridor, duke i thënë:

- Prit sa t'i shikosh pazaret e këtij qyteti. Nuk e keni parë kurrë një gjë të tillë, asnjëri prej jush.

Zonja Vahdati u ul tok me ta në ndenjësen e pasme, ndërsa ajri aty brenda u mbush me aromën e rëndë të parfumit të saj dhe nga diçka që Abdullai nuk po e përcaktonte dot, nga diçka e ëmbël, me një aromë paksa shpuese. Ajo i mbyti me pyetje, ndërsa dajë Nabi ngiste makinën. Ç'shokë kishin? A shkonin në shkollë? I pyeste për gjithçka që bënin në shtëpi, për fqinjët, për lojërat që luanin. Dielli ia ndriçonte gjysmën e djathtë të fytyrës dhe Abdullai arrinte të shquante pushin e lehtë në faqet e saj dhe vijën e zbehtë në nofullën e poshtme, atje ku mbaronte pudra e fytyrës.

- Unë kam një qen, - tha Pahri.

- Vërtet?

- Është i një lloji të veçantë, - shtoi dajë Nabi.

- Quhet Shuja. Ai e kupton kur unë jam e trishtuar.

- Kështu janë qentë, - tha zonja Vahdati. - Prandaj dhe janë më të mirë se shumë nga njerëzit që kam ndeshur në jetë.

Ata lanë pas tri vajza shkolle që po ecnin në këmbësore. Ato kishin veshur uniforma të zeza dhe mbanin shami të bardha të lidhura nën mjekër.

- E di se çfarë thashë pak më parë, por Kabuli nuk është aq i keq, - tha zonja Vahdati duke luajtur shpërfillshëm me varësen e saj. Ajo po shihte përtej dritares, me një lloj ngrysjeje në fytyrë. - Mua më pëlqen shumë në fund të pranverës, kur reshtin shirat. Ajri është shumë i pastër. Ngjyrat e para të verës. Mënyra se si dielli ndriçon malet. - Ajo qeshi lehtë. - Do të ishte gjë e mirë të kishim një fëmijë në shtëpi. Pak zhurmë, sa për të ndryshuar mjedisin. Pak jetë.

Abdullai vështroi nga ajo dhe një ndjesi alarmi iu krijua nga ajo grua që, thellë nën tualetin, parfumin e simpatinë që të ngjallte, fshihte diçka gjithë gjemba. Instinktivisht iu kujtua tymi i sobës së Parvanës dhe raftet e kuzhinës të mbushura me kusi të nxira, pjata e filxhanë çaji të tipave të ndryshëm. Po e merrte malli për dyshekun ku flinin tok me Pahrin, edhe pse ishte i pisët e me susta të këputura, që rrezikonin vazhdimisht t'i shponin. Të gjitha këto po i mungonin tani. Kurrë më parë nuk e kishte marrë malli kaq përdhembshëm për shtëpinë.

Zonja Vahdati u mbështet mirë në ndenjëse dhe lëshoi një psherëtimë, ndërsa e mbante çantën ashtu siç mban një grua shtatzënë barkun e saj të fryrë.

Dajë Nabi hapi krahun pranë një këmbësoreje të mbushur plot. Në anën tjetër të rrugës, pranë një xhamie me minare shumë të larta, gjendej Pazari: një labirint rruginash të mbuluara, por edhe të hapura. Ata ecën nëpër korridoret ku shiteshin pallto prej lëkure, unaza me gurë të çmuar shumëngjyrësh të të gjitha llojeve: dajë Nabi mbrapa, zonja Vahdati dhe ata të dy përpara. Tani që dolën jashtë, zonja Vahdati vuri në sy një palë syze të errëta që çuditërisht e bënë fytyrën e saj të ngjasonte me atë të maces.

Thirrjet e tregtarëve oshtinin ngado. Muzika përhapej thuajse nga çdo stendë. Ata kaluan ndanë dyqaneve të hapura që shisnin libra, radio, llamba dhe enë gatimi prej argjendi. Abdullai vuri re dy ushtarë me çizme gjithë baltë dhe kapota bojëkafe të errët, që po pinin me radhë një cigare e shihnin gjithë shpërfillje e mërzi cilindo që u kalonte pranë.

Ata ndaluan pranë një stende këpucësh. Zonja Vahdati nisi të rrëmonte nëpër kutitë me kapakë të hapur të vëna me radhë. Nabi shkoi te dyqani ngjitur, me duart mbërthyer pas kurrizit, dhe po shihte duke i afruar nën hundë ca monedha të vjetra.

- Si të duken këto? - e pyeti zonja Vahdati Pahrin. Në dorë mbante një palë atlete të reja të verdha.

- Shumë të bukura, - tha Pahri, duke i parë këpucët me mosbesim.

- Le t'i provojmë.

Zonja Vahdati e ndihmoi Pahrin që të mbathte atletet, dhe ia lidhi rripat. Pastaj ngriti kokën drejt Abdullait dhe e pa përmes syzeve.

- Mund të blesh edhe ti një palë. S'më besohet që ke ardhur nga fshati deri këtu me këto sandale.

Abdullai mohoi me kokë dhe i largoi sytë prej aty. Në fund të rruginës, një burrë plak me një mjekër të shkalafitur dhe sakat nga këmbët po zgjaste dorën drejt kalimtarëve.

- Shiko, Abolla! - Pahri ngriti njërën këmbë, pastaj tjetrën. Pastaj, me të dyja këmbët në tokë, kërceu përpjetë. Zonja Vahdati thirri dajë Nabin dhe i tha që ta ndihmonte Pahrin të lëvizte nëpër rruginë, që të provonte të ecte me këpucët e reja. Dajë Nabi e mori Pahrin për dore dhe e shoqëroi nëpër rruginë.

Zonja Vahdati pa nga Abdullai.

- Ti mendon se unë jam njeri i keq, - i tha, - nisur nga ato gjërat që thashë më parë.

Abdullai pa Pahrin dhe Nabin që kaluan pranë lypësit plak me këmbë të shformuara. Plaku i tha diçka Pahrit, ajo ngriti kokën, vështroi dajë Nabin dhe ky i dha lypësit një monedhë.

Abdullai nisi të qante pa zë.

- Oh, djalë i mirë! - tha zonja Vahdati, e prekur. - Oh, i dashur fëmijë i gjorë.

Ajo nxori shaminë nga çanta dhe ia zgjati.

Abdullai ia largoi dorën.

- Të lutem, mos e bëj! - i tha ai, me zërin që po i dridhej.

Ajo u ul në gjunjë përpara tij dhe ngriti syzet lart mbi kokë. Edhe sytë e saj ishin të njomur dhe, kur i fshiu me shami, kjo u nxi.

- Nuk të vë faj nëse më urren tani. Ke të drejtë. Por ... dhe unë nuk pres që të më kuptosh tani për tani... Fundja, është për mirë. Vërtet që është për mirë, Abdulla. Është gjëja më e mirë. Një ditë ke për ta kuptuar, Abdulla.

Abdullai ngriti kokën drejt qiellit dhe filloi të qante me dënesa tamam në çastin kur Pahri po vinte drejt tij duke kërcyer një herë mbi njërën këmbë e një herë mbi tjetrën, me sytë që i ndritnin nga mirënjohja dhe me fytyrën që i vetëtinte nga lumturia.

Një mëngjes të atij dimri, Babai mori sëpatën dhe e preu pemën gjigante të lisit. E ndihmuan djali i Mulla Shekibit, Bejtullai, dhe disa burra të tjerë. Askush nuk u përpoq ta ndalte. Abdullai qëndronte më tej, bashkë me disa djem të tjerë, dhe shihte se ç'po ndodhte. E para gjë që bëri Babai, ishte heqja e shilarësit. Ai u ngjit në pemë dhe ia preu litarët me thikë. Pastaj ai dhe burrat e tjerë nisën të goditnin trungun e trashë, deri pasdite vonë, kur lisi plak më në fund ra në tokë duke lëshuar një rënkim të fuqishëm. Babai i tha Abdullait se u duheshin dru për dimër. Por ai i kishte mëshuar sëpatës me shumë mllef mbi pemën e moçme, me dhëmbët shtrënguar fort e fytyrëngrysur, si të mos e shihte dot më me sy.

Tani, nën një qiell ngjyrë guri, burrat ishin ulur mbi trungun e shtrirë, me hundët dhe faqet të përskuqura nga të ftohtët, ndërsa sëpatat gjëmonin teksa goditnin trungun. Pak më tej, Abdullai po këpuste ca degë të vogla. Dëbora e parë e atij dimri kishte rënë dy ditë më parë. E lehtë, ende jo e plotë, thjesht si një kërcënim për çka do të vinte më pas. Shumë shpejt mbi Shadbag do të zbriste dimri i plotë, me akullsinë

dhe flokët e dëborës që zgjatnin me javë të tëra, dhe me erërat që ta plasaritnin lëkurën e trinës së dorës në çast. Tani për tani, ngjyra e bardhë mbi tokë ishte e zbehtë, e ndërprerë nga pjesë toke ngjyrëbezhë, që nga shtëpia e tyre e deri në këmbë të kodrave.

Abdullai mblodhi një tufë degësh të holla dhe i çoi drejt grumbullit të përbashkët aty pranë. Kishte mbathur çizmet e reja të dëborës dhe një xhup dimëror. Vërtet që i përdorur, por, përveç zinxhirit të prishur, që ia kishte rregulluar Babai, ishte po aq i mirë sa edhe po të kishte qenë i ri: i mbushur me vatinë përbrenda, në ngjyrë blu të errët, me astar portokallí. Kishte katër xhepa të thellë dhe një kapuç që i mblidhej përreth fytyrës Abdullait, kur ia shtrëngonte rripin. Tani, ai e hoqi kapuçin nga koka dhe psherëtiu thellë.

Dielli po rrëzohej poshtë në horizont. Abdullai ende arrinte të shihte mullirin e vjetër me erë, që sundonte i ashpër e gri mbi muret prej qerpiçi të fshatit. Krahët e tij lëshonin një britmë therëse, sa herë që nga kodrat vinte një shkulm i mprehtë ere. Në verë mulliri ishte strehë për çafkat, por tani që kishte ardhur dimri, ato kishin shtegtuar dhe vendin e tyre e kishin zënë korbat. Çdo mëngjes, Abdullai zgjohej nga britmat dhe krokatjet e tyre të forta.

Në të djathtë, në tokë, syri i kapi diçka. U afrua dhe u përkul drejt saj.

Një pendë. E vockël. E verdhë.

E hoqi njërën dorashkë dhe e mori në dorë.

Në darkë do të shkonin në një festë: ai, Babai dhe vëllai Ikbal. Bejtullai ishte bërë me një djalë tjetër. Një *motreb* do të vinte të këndonte për burrat dhe dikush do t'i binte tamburit. Do të qerasnin me çaj, bukë të sapopjekur e supë *shorva* me patate. Më vonë, Mulla Shekibi do t'i kridhte gishtat në një tas me ujë me sheqer dhe do t'ia afronte foshnjës te buzët, që t'i thithte. Ai do të nxirrte gurin e zi vezullues dhe thikën me dy tehe e do t'i hiqte foshnjës rrobën e mesit. Një ritual i zakonshëm ky. Jeta në Shadbag vazhdonte.

Abdullai e rrotulloi pendën nëpër gishta.

"Nuk do të qaj, - kishte thënë Babai. - S'ka lot. Nuk do të qaj." Dhe nuk kishte qarë askush. Askush në fshat nuk kishte pyetur për Pahrin. Askush nuk e përmendte më emrin e saj. Abdullai habitej se si ishte fshirë ajo ashtu plotësisht nga jetët e tyre.

Vetëm te Shuja e gjente Abdullai të pasqyruar trishtimin e vet. Qeni vinte te dera e tyre çdo ditë. Parvana e qëllonte me gurë. Babai e përzinte me shkop. Por ai vazhdonte të kthehej. Çdo natë e dëgjonin të kuiste me pikëllim dhe çdo mëngjes e gjenin të shtrirë përpara derës, me mjekrën mbështetur në putrat e përparme, duke ua ngulur sytë agresorëve të tij me një vështrim melankolik, joakuzues. Kjo vazhdoi për javë të tëra, derisa një mëngjes Abdullai e pa që po ecte drejt kodrave, me kokën të ulur poshtë. Qysh atëherë askush nuk e pa më në Shadbag.

Abdullai e futi pendën e verdhë në xhep dhe nisi të çapitej drejt mullirit me erë.

Ndonjëherë, kur Babai nuk e kishte mendjen, ai e shihte vjedhurazi dhe vinte re fytyrën e tij të ngrysur, të mbuluar nga hije emocionesh të paqarta. Tani Babai dukej si i mbyllur në vetvete, si i zhveshur nga diçka e rëndësishme. Ai vinte vërdallë nëpër shtëpi pa ndonjë qëllim ose ulej pranë sobës së re prej gize për t'u ngrohur dhe ua ngulte sytë e zmadhuar flakëve. Tani në zërin e tij kishte një zvargie që Abdullai nuk e kishte dëgjuar kurrë më parë, sikur fjalët që nxirrte nga goja, peshonin shumë. Herë të tjera kridhej në një heshtje të plotë, me një fytyrë pa shprehje. Nuk tregonte më përralla, nuk kishte thënë as edhe një të vetme, qysh kur ishin kthyer nga Kabuli bashkë me Abdullain. Mbase, mendonte djaloshi, Babai u kishte shitur Vahdatëve edhe muzën e vet.

Kishte ikur përgjithmonë.

Ishte zhdukur.

Nuk kishte mbetur asgjë.

Nuk thuhej më asgjë.

Përveç atyre fjalëve të Parvanës: "Ja që duhej të ishte ajo. Më vjen keq, Abdulla. Duhej të ishte pikërisht ajo"

Gishti që duhej prerë për të shpëtuar dorën.

Ai u ul në gjunjë pranë mullirit me erë, te këmbët e kullës së rrënuar prej guri. Hoqi dorashkat dhe gërmoi në tokë. Përpara syve i dolën vetullat e trasha të motrës dhe balli i rrumbullakët, buzëqeshja me dhëmbët të ndarë nga njëri-tjetri. Me veshët e mendjes dëgjoi tingëllimën e së qeshurës së saj që shpërndahej nëpër shtëpi si dikur. Iu kujtua skena ngjethëse që pasoi kur u kthyen nga pazari. Pahri në gjendje paniku. E lebetitur. Dajë Nabi që e mori hopa dhe e largoi me të shpejtë prej aty... Abdullai vazhdoi të gërmonte derisa gishtat i prekën diçka metalike. Futi gishtërinjtë poshtë saj dhe nxori nga gropa një kuti çaji. Pastaj fshiu baltën e ftohtë mbi kapakun e saj.

Kohët e fundit Abdullai e sillte shpesh në mendje përrallën që u kishte treguar Babai një natë përpara se të niseshin për në Kabul, me fshatarin plak Baba Ajub dhe Divin. Shumë shpesh ai e gjente veten në vendet ku Pahri kishte qëndruar dikur: mungesa e saj ngrihej lart nga toka nën këmbët e tij si një aromë e pakëndshme dhe atëherë atij i dridheshin gjunjët dhe zemra i ndalej në kraharor. E tamam në ato çaste do të donte të kishte pak nga ai lëngu magjik që Divi i kishte dhënë Baba Ajubit... për të harruar.

Por ai vetë nuk arrinte të harronte. Pahri i dilte përpara syve ngado që shkonte. Ajo ishte si pluhuri që i ngjitej pas bluzës. Si heshtja që ishte bërë kaq e zakontë në shtëpinë e tyre, heshtja që ndehej midis fjalëve, ndonjëherë e ftohtë dhe e rëndë, ndonjëherë e ngarkuar me fjalë të pathëna, si një re e mbarsur me një shi që nuk bie kurrë. Ndonjëherë, netëve, ai ëndërronte sikur ishte përsëri në shkretëtirë, i vetëm, i rrethuar nga malet dhe në largësi shihte një pikë të vogël drite që ndizej e fikej, si të ishte duke i dërguar një mesazh.

Ai e hapi kutinë e çajit. Ato ishin të gjitha aty, pendët e Pahrit, të rëna nga gjelat, patat, pëllumbat. Ishte edhe penda e

palloit. E futi pendën e verdhë në kuti. "Një ditë..." - mendoi me vete.

Shpresoi.

Ditët e tij në Shadbag ishin të numëruara, njësoj si ato të Shujës. Ai e dinte këtë tani. Këtu nuk kishte mbetur më asgjë për të. Këtu nuk kishte shtëpi. Do të priste derisa të dilte dimri e të vinte pranvera dhe një mëngjes do të ngrihej që pa gdhirë e do të dilte nga dera. Do të zgjidhte një rrugë dhe do të niste të ecte. Do të shkonte aq larg Shadbagut, sa ta çonin këmbët. Dhe, nëse një ditë, duke ecur nëpër një fushë të gjerë, do ta pushtonte dëshpërimi, do të ndalej e do të mbyllte sytë dhe do të sillte ndër mend pendën e skifterit që kishte gjetur Pahri në shkretëtirë. Do ta shihte atë pendë se si shkëputej nga zogu, atje lart pranë reve, gjysmë milje mbi botën, e si fluturonte duke u përdredhur e duke bërë spirale në ajër, e mbartur nga erërat e forta mbi milje të tëra shkretëtire, mbi male e kodra, derisa më në fund të zgjidhte për t'iu afruar tokës, përkundër çdo mundësie, pikërisht në rrëzën e atij shkëmbi, që ta gjente e motra. Dhe atëherë kjo do ta mbushte me çudi, por edhe me shpresë se të tilla gjëra ndodhin. Dhe ai do ta mblidhte veten, do të hapte sytë dhe do të vazhdonte rrugëtimin.

# Tre

## *Pranverë 1949*

Parvana ia ndien erën, përpara se ta largojë jorganin e ta shohë. Është përhapur në të gjithë gjerësinë e të ndenjurave të Masomës, ka rrjedhur nëpër kofshët e saj, në dyshek e çarçafë, madje edhe në jorgan. Masoma e sheh që përmbi supin e saj, një lutje e druajtur për falje i ndehet në fytyrë, por edhe turp: përsëri turp, edhe pas gjithë kësaj kohe, edhe pas gjithë këtyre viteve.

- Më fal! - mërmërit Masoma.

Parvana do të donte të ulërinte, por e detyron veten të buzëqeshë lehtë. Në të tilla çaste i duhet të bëjë një përpjekje të mundimshme për të mos harruar një të vërtetë të pamohueshme: e gjitha kjo është vepër e saj. Asgjë që i ka rënë mbi krye, nuk është e padrejtë ose e pamerituar. E ka hak vërtet këtë. Ajo psherëtin, ndërsa sheh teshat e ndragura dhe tmerrohet nga detyra që e pret.

- Do të të pastroj, - thotë ajo.

Masoma nis të qajë pa zë, por pa shtrembëruar asnjë tipar. Vetëm lotët i rrjedhin nëpër fytyrë.

Jashtë, në ajrin e ftohtë të mëngjesit, Parvana ndez zjarrin. Kur ngrihen flakët, ajo mbush një kusi me ujin e pusit të

përbashkët të Shadbagut dhe e vë të ngrohet. Duart i afron pranë zjarrit. Prej aty mund të shohë mullirin e erës dhe xhaminë e fshatit, ku dikur Mulla Shekibi i mësonte të lexonin, atë dhe Masomën, kur ishin të vogla. Pak më tej, shtëpia e Mulla Shekibit, në këmbët e një pjerrine të butë. Më vonë, kur të lindë dielli, çatia e saj do të ngjasojë me një katror të përkryer, të kuq e vezullues, prej domateve që gruaja e tij ka vënë aty për t'i tharë në diell. Parvana ngre sytë drejt yjeve të mëngjesit, që gjithë shpërfillje lëshojnë një vezullim të zbehtë e të dobët drejt saj. Ajo e mbledh veten.

Brenda, ajo e kthen Masomën përmbys. Lag një rrobë në ujin e kusisë dhe me të pastron të ndenjurat e Masomës, duke larguar pisllëkun nga fundshpina e saj dhe nga mishi i flashkët i kofshëve.

- E pse e ngrohe ujin? - pyet Masoma me kokën në jastëk. - Pse duhej të shqetësoheshe? Nuk ke pse e bën. Unë nuk arrij ta dalloj ndryshimin.

- Mbase. Por unë do ta ngroh, - thotë Parvana, duke shtrembëruar fytyrën. - Tani, boll fole e më lër të mbaroj punë.

Që nga ky çast, ditët e Parvanës vazhdojnë të shpalosen të njëtrajtshme, ashtu siç kanë rrjedhur qysh kur u vdiqën prindërit. Ajo ushqen pulat. Çan drutë dhe shkon e vjen me kovat me ujë, që i mbush në pusin e fshatit. Përgatit brumin dhe pjek bukën në *tandoor*-in jashtë shtëpisë së tyre prej qerpiçi. Lan dyshemenë. Pasdite, ulet ndanë lumit, bashkë me gra të tjera të fshatit, për të fërkuar teshat pas shkëmbinjve. Më pas, meqenëse është e premte, ajo shkon te varret e prindërve dhe thotë nga një lutje të shkurtër për secilin. Dhe gjatë gjithë ditës, midis këtyre punëve, do të gjejë kohën që t'ia ndërrojë pozicionin Masomës, duke e vendosur jastëkun herë në njërën anë të të ndenjurave të saj e herë në anën tjetër.

Dy herë gjatë kësaj dite, sytë i ndeshin Saborin.

Ai është në oborrin e shtëpisë prej qerpiçi, duke ndezur

zjarrin, me sytë e picërruar të ngulur mbi tymin, me të birin, Abdullain, pranë vetes. Më vonë e sheh përsëri, duke folur me burrat e tjerë, burra që, njësoj si Sabori, kanë familjet e tyre tani, por dikur kanë qenë djem të fshatit, me të cilët Sabori lodronte, ngrinte balona në ajër, ndiqte qentë, luante kukafshehthi. Por këto ditë mbi Saborin rëndon një hidhërim, një tragjedi: një grua e vdekur dhe dy fëmijë pa nënë, njëri foshnjë. Tani ai flet me zë të lodhur, që mezi dëgjohet. Nëpër fshat tani endet një trajtë e re, e kërrusur, e zymtë e tij.

Parvana e sheh nga larg, me një përgjërim që thuajse ia pret gjunjët plotësisht. Mundohet të fshehë sytë, kur i kalon pranë. Dhe, nëse rastësisht vështrimet e tyre ndeshen, ai e përshëndet lehtë me kokë, dhe asaj i vërshon gjaku në fytyrë.

Në darkë, kur shtrihet për të fjetur, Parvana nuk ka fuqi as t'i ngrejë krahët lart. Koka i lëshohet në jastëk nga lodhja shteruese. Qëndron e mbështjellë me pallton e saj, duke pritur gjumin.

Por pastaj, në errësirë:

- Parvana?

- Po.

- A të kujtohet kur shëtitnim me biçikletë të dyja?

- Hëmm.

- Sa shpejt që i jepnim! Si zbrisnim teposhtë kodrës. Dhe qentë na ndiqnin pas.

- Më kujtohet.

- Dhe ne të dyja që bërtisnim. Dhe kur u përplasëm pas atij gurit... - Parvana thuajse arrin ta dëgjojë të motrën që po qesh në errësirë. - Mamaja u zemërua keq me ne. Dhe pastaj Nabi: ia prishëm biçikletën.

Parvana mbyll sytë.

- Parvana?

- Po.

- A mund të flesh pranë meje sonte? - Parvana largon jorganin e vet, drejtohet për në anën tjetër të dhomës, ku është

shtrirë Masoma, dhe rrëshqet nën shtresat e saj. Masoma mbështet faqen në supin e Parvanës, me njërin krah të hedhur mbi kraharorin e së motrës, dhe pëshpërit:

- Ti meriton një fat më të mirë se ky.

- Mos fillo prapë me këtë, - ia kthen Parvana me pëshpërimë. Ajo ia përkëdhel flokët Masomës, me ledhatime të gjata, ashtu siç i pëlqen asaj.

Ato flasin për një kohë të gjatë, me zë të ulët, për gjëra pa lidhje me njëra-tjetrën, ndërsa fryma e njërës ngroh faqen e tjetrës. Këto janë çaste relativisht të lumtura për Parvanën. Këto i kujtojnë ditët kur ishin të vogla e qëndronin hundë më hundë nën batanije, duke pëshpëritur sekrete e thashetheme e duke qeshur pa zë. Shumë shpejt Masomën e zë gjumi dhe mërmërit diçka nëpër ëndërr, ndërsa Parvana hedh sytë tej dritares, drejt një qielli të zi. Në mendje i kalojnë fragmente të ndryshme mendimesh, derisa ndalet te një fotografi që kishte parë vite më parë në një revistë të vjetër: dy vëllezër nga Siami, të ngjitur me njëri-tjetrin në kraharor me anë të një rripi të trashë mishi. Dy qenie njerëzore të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me njëra-tjetrën, gjaku që formohej në palcën e kockave të njërit, rridhte nëpër venat e tjetrit; lidhja e tyre ishte e përjetshme. Parvana ndien një lloj dëshpërimi, një lloj angështie, si ta shtrëngojë fort një dorë brenda kraharorit. Merr frymë thellë. Mundohet ta çojë përsëri mendjen te Sabori dhe e kap veten duke menduar për thashethemet që ka dëgjuar në fshat, se ai po kërkon të martohet përsëri. E largon fytyrën e tij nga mendja. Dhe e mbyt mendimin e çmendur.

Parvana kishte qenë surprizë.

Masoma kishte dalë tashmë e po përkundej e qetë në krahët e mamisë, kur nëna kishte lëshuar një britmë dhe një tjetër kokë kishte dalë prej saj. Lindja e Masomës ishte pa probleme. "Ajo lindi vetë, si engjëll", - do të thoshte më pas

mamia. Kurse lindja e Parvanës ishte e gjatë, agonizuese për nënën, stërmunduese për vetë foshnjën. Mamia ishte detyruar ta çlironte nga kordoni kërthizor që i qe përdredhur rreth qafës, si në një krizë vrastare të ankthit të ndarjes nga nëna. Në çastet e saj më të këqija, kur nuk e ndalte dot veten që të mos e përmbyste rryma e vetakuzimit, Parvana mendonte se mbase kordoni kërthizor dinte shumë. Mbase ai e dinte se cila ishte gjysma më e mirë.

Masoma flinte me orar, pinte me orar. Ajo qante vetëm kur e merrte uria ose kur kishte nevojë të ndërrohej. Kur ishte zgjuar, ishte e qeshur, lojcake, ngazëllehej lehtë: një bohçe të qeshurash e gugatjesh të lumtura. Asaj i pëlqente të tërhiqte vëmendjen me gugatjet e veta.

"Ç'fëmijë i lezetshëm!" - thoshin njerëzit.

Parvana ishte një tirane e vërtetë. Ajo ushtronte mbi të ëmën gjithë autoritetin e vet. Babai, i tmerruar nga të qarat histerike të foshnjës, kishte marrë vëllanë e tyre të madh, Nabin, dhe kishte shkuar të flinte në shtëpinë e të vëllait. Nata ishte një mjerim me përmasa epike për nënën e vajzave: vetëm pak minuta pushimi aty-këtu. Ajo e merrte Parvanën në krahë dhe ecte nëpër shtëpi gjatë gjithë natës. E përkundte, i këndonte këngë. Shtrembëronte fytyrën, kur Parvana i sulej gjirit të saj të fryrë dhe e kapte thithin me gojë si të ishte duke u munduar që ta pinte qumështin drejt e aty ku formohej. Por edhe të ushqyerit me gji nuk bënte punë me të. Edhe me barkun plot, Parvana lëshonte klithma e piskama, e pandjeshme ndaj përkëdheljeve të së ëmës.

Masoma e shihte nga ana tjetër e dhomës me sy të menduar, me një shprehje trishtimi, thua se i vinte keq për këtë fat që i kishte rënë për hise së ëmës.

- Nabi nuk ka bërë kurrë kështu, - i kishte thënë një ditë e ëma babait të tyre.

- Foshnjat ndryshojnë nga njëra-tjetra.

- Por kjo po më vret.

- Do të kalojë, - i kishte thënë ai. - Ashtu siç kalon moti i keq.

Dhe vërtet që kishte kaluar. Mbase e kishte pasur nga koliti ose nga ndonjë tjetër sëmundje kronike e foshnjërisë. Por ishte shumë vonë. Parvana i kishte lënë gjurmët e saj.

Një mbrëmje të vonë vere, kur binjaket ishin dhjetë-muajshe, fshatarët e Shadbagut ishin mbledhur në një dasmë. Gratë kishin nisur gjithë zell të formonin nëpër pjata piramida pilafi të zbukuruara me copa shafrani. Ato kishin prerë bukën, kishin shpërndarë pjatat me patëllxhanë të skuqur, të lyer përsipër me salcë kosi me mente të thara. Nabi ishte jashtë duke luajtur me djemtë. Mamaja e vajzave ishte ulur tok me ca gra të tjera të fshatit në një qilim të shtruar rrëzë pemës gjigante të lisit. Herë pas here, ajo hidhte sytë nga vajzat, që po flinin pranë njëra-tjetrës pak më tej, nën hijen e pemës.

Pasi kishin ngrënë drekë, teksa pinin çajin, vogëlushet binjake ishin zgjuar dhe thuajse në çast dikush e kishte marrë Masomën hopa. Atë e kishin kaluar dorë më dorë, nga një kushërirë te një teze e më pas te një dajë. E hidhnin hopthi në një prehër, e ngrinin mbi ca gjunjë të tjerë. Shumë duar përkëdhelnin barkun e saj të butë. Shumë hundë fërkoheshin pas së sajës. Dhe ia kishin plasur së qeshurës, kur ajo kishte kapur gjithë ledha mjekrën e Mulla Shekibit. I mrekullonte fakti se sa shpejt miqësohej ajo me njerëzit, sa e afrueshme ishte me ta. Ata e ngrinin lart dhe admironin faqet e saj rozë, sytë blu si safiri, harkun dinjitoz të vetullave, shenja treguese të një bukurie magjepsëse që do të shpërthente vetëm pas pak vjetësh.

Parvana kishte mbetur në prehrin e së ëmës. Ndërsa Masoma argëtohej, Parvana shihte si e hutuar përreth: i vetmi pjesëtar i asaj audience adhuruese që nuk kuptonte aspak se çfarë po ndodhte. Herë pas here, e ëma ulte kokën mbi të dhe zgjaste dorën për t'ia përkëdhelur lehtë këmbët e vogla, si për t'i kërkuar ndjesë. Kur dikush kishte vënë re se Masomës po

i dilnin dy dhëmbë të tjerë, nëna e Parvanës i kishte thënë me zë të dobët se Parvanës po i dilnin tre. Por askush nuk ia kishte vënë veshin.

Kur vajzat kishin qenë nëntë vjeç, familja e tyre ishte mbledhur në shtëpinë e Saborit për të ngrënë iftarin pas agjërimit për Ramazan. Të rriturit ishin ulur nëpër jastëkët e shtruar përgjatë gjithë perimetrit të dhomës dhe flisnin me njëri-tjetrin me zë të lartë. Çaji, urimet e thashethemet kalonin nga njëri tek tjetri. Burrat pleq numëronin tespihet. Parvana qëndronte ulur në heshtje, e lumtur që po thithte të njëjtin ajër si edhe Sabori, e lumtur që gjendej pranë syve të tij të zinj të mëdhenj. Disa herë gjatë mbrëmjes e kishte hedhur vështrimin vjedhurazi nga ai. Një herë e kishte parë teksa kafshonte një kub sheqeri, një herë tjetër duke fërkuar lëkurën e lëmuar të ballit ose duke qeshur me gjithë shpirt për diçka që kishte thënë xhaxhai i vet. Dhe, kur ai e kapte që ajo po e shihte, siç edhe kishte ndodhur një a dy herë, ajo menjëherë i largonte sytë prej tij, e ngrirë nga turpi. Gjunjët nisnin t'i dridheshin. Goja i thahej aq shumë, sa nuk arrinte dot të lidhte asnjë fjalë.

Iu kujtua blloku i shënimeve që e kishte fshehur mes një pirgu të gjërave të saj në shtëpi. Sabori gjithmonë rrëfente histori, përralla me xhinde, zana, demonë e diva; shumë shpesh, fëmijët e fshatit mblidheshin përreth tij dhe e dëgjonin në heshtje të plotë, kur ai krijonte rrëfenja për ata. Nja gjashtë muaj më parë Parvana e kishte dëgjuar Saborin t'i thoshte Nabit se shpresonte që një ditë t'i hidhte në letër të gjitha përrallat e veta. Vetëm pak kohë pas kësaj, Parvanës, që kishte shkuar bashkë me të ëmën në pazarin e një fshati fqinjë, i kishte kapur syri, në një stendë ku shiteshin libra të përdorur, një bllok shënimesh shumë të bukur, me fletë fëshfëritëse dhe me një lidhëse bojëkafe prej lëkure në njërën anë. E kishte marrë në dorë, por e dinte që e ëma nuk do të mund t'ia blinte dot. Kështu që, në çastin kur shitësi nuk e kishte mendjen, e kishte futur menjëherë nën pulovër.

Por në gjashtë muajt që kaluan qysh prej asaj dite, Parvana

ende nuk e kishte gjetur guximin për t'ia dhuruar bllokun Saborit. Atë e tmerronte ideja se ai mund të qeshte me dhuratën ose se mund ta kuptonte qëllimin e vërtetë dhe mund t'ia kthente mbrapsht. Kështu që, çdo natë, ndërsa qëndronte shtrirë në dyshekun e vet, ajo e shtrëngonte fort bllokun nën mbulesë dhe me mollëzat e gishtave ia përkëdhelte relievet e lëkurta. "Nesër, - i premtonte vetes çdo natë. - Nesër do të shkoj tek ai dhe do t'ia jap."

Atë mbrëmje, më vonë, pas iftarit, fëmijët ishin mbledhur në një dhomë për të luajtur. Parvana, Masoma dhe Sabori kishin nisur të lëkundeshin me radhë në shilarësin që i ati i Saborit kishte varur në degën e lisit gjigant. I kishte ardhur radha edhe Parvanës, por Sabori harronte ta shtynte, sepse po tregonte një tjetër përrallë. Këtë herë ishte për lisin gjigant, për të cilin thoshte se kishte fuqi magjike. Nëse dëshironin diçka, thoshte ai, duhej të uleshin në gjunjë përpara pemës dhe ta shprehnin dëshirën me zë të ulët. Dhe, nëse pema pranonte t'ua plotësonte, atë çast do të hidhte saktësisht dhjetë gjethe mbi kokën e tyre.

Kur shilarësi thuajse ishte ndalur fare, Parvana kishte kthyer kokën nga Sabori, që t'i kërkonte ta tundte përsëri, por fjalët i ishin mekur në grykë: Sabori dhe Masoma po i buzëqeshnin njëri-tjetrit dhe Parvana kishte parë në duart e Saborit bllokun. Bllokun e saj!

- E gjeta në shtëpi, - i kishte thënë më vonë Masoma. - Yti ishte? Do të gjej një mënyrë që të ta paguaj. Nuk e ke problem, apo jo? Thjesht mendova se ishte gjëja e përkryer për të. Për përrallat e tij. A e pe ç'pamje i mori fytyra? A e pe, Parvana?

Parvana i ishte përgjigjur se nuk e kishte problem, por përbrenda po turfullonte. Vazhdimisht e vazhdimisht ajo rikujtonte mënyrën se si i kishin buzëqeshur njëri-tjetrit Masoma dhe Sabori, vështrimet që kishin shkëmbyer. Parvanën nuk e kishin vënë re thuajse fare, ajo kishte qenë e padukshme për ta, ashtu si zanat në përrallat e Saborit. Kjo i kishte therur

deri në kockë. Atë natë, nën shtresat e saj, kishte qarë pa zë.

Kur ajo dhe e motra kishin mbushur njëmbëdhjetë vjeç, Parvana kishte arritur ta kuptonte pse silleshin aq çuditshëm djemtë, kur gjendeshin pranë vajzave që u pëlqenin. Ajo e vinte re këtë sidomos kur ktheheshin nga shkolla tok me Masomën. Shkolla, në fakt, ishte një dhomë në pjesën e pasme të xhamisë së fshatit, ku, përveç që mësonin të lexonin Kuranin, Mulla Shekibi u mësonte të gjithë fëmijëve të fshatit shkrim e lexim dhe i vinte të mësonin përmendsh poezi. Shadbagu ishte me fat që kishte një burrë kaq të ditur për *malik*[1], u kishte thënë i ati vajzave.

E, ndërsa ktheheshin në shtëpi nga kjo shkollë, vajzat ndeshnin shpesh një grup djemsh të ulur mbi një mur. Kur kalonin përpara tyre, ata herë i ngacmonin me zë të lartë, herë u gjuanin me guralecë. Parvana zakonisht u bërtiste dhe iu përgjigjej guralecëve të tyre me gurë, kurse Masoma gjithmonë e tërhiqte prej bërryli dhe i thoshte me zë të shtruar që të shpejtonte hapat e të mos e prishte gjakun për ta. Por ajo e keqkuptonte të motrën. Parvana nuk tërbohej me ta, ngaqë hidhnin guralecë drejt tyre, por ngaqë i hidhnin vetëm drejt Masomës. Parvana e dinte: ata hiqeshin sikur talleshin, por mundoheshin vetëm të binin në sy, dhe, sa më të thellë që e kishin dëshirën, aq më shumë zhurmë bënin. Ajo e vinte re se si kalonin rrëshqitazi vështrimet e tyre mbi të dhe ndaleshin mbi Masomën, të përvëluar nga dëshira, pa mundur të shkëputeshin prej saj. Ajo e dinte se përtej shakave të tyre të ashpra dhe nënqeshjeve të liga, ata ishin të shtënë kokë e këmbë pas Masomës.

Dhe pastaj, një ditë, njëri prej tyre kishte hedhur një gur. Ai kishte rënë në këmbët e së motrës. Kur Masoma e kishte marrë në dorë, djemtë kishin nisur të qeshnin nën hundë dhe i kishin rënë me bërryl shoku-shokut. Guri ishte mbështjellë

---

1) Kryeplak (*shën. i përkth.*).

me një letër, që ishte kapur aty me një llastik. Ato kishin bërë më tej dhe, kur kishin dalë jashtë rrezes së shikimit të djemve, Masoma e kishte çmbështjellë letrën. Dhe që të dyja kishin lexuar shënimin:

*Të betohem se, që kur kam parë fytyrën tënde,*
*E gjithë bota më duket mashtrim e fantazi.*
*Kopshti nuk di më cila është gjethja e cila petla,*
*Zogjtë, të hutuar, nuk e dallojnë dot melin nga laku.*

Poezi e Rumiut, që ua kishte mësuar Mulla Shekibi.

- Po bëhen më të sofistikuar, - kishte thënë Masoma duke qeshur.

Nën poezi, djali kishte shkruar: "Dua të martohem me ty". Dhe, nën këtë, kishte shtuar: "Për motrën tënde kam një kushëri. Janë bërë për njëri-tjetrin. Mund të kullotin bashkë në arën e xhaxhait tim".

Masoma e kishte grisur letrën më dysh.

- Mos ua vër re, Parvana, - i kishte thënë. - Ata janë budallenj.

- Idiotë! - kishte pranuar Parvana.

Me mundim të madh kishte arritur të sajonte një buzëqeshje në fytyrë. Shënimi ishte vërtet shumë fyes, por ajo që e kishte vrarë vërtet, ishte përgjigjja e Masomës. Djali nuk e kishte shprehur qartë se kujt ia adresonte pusullën, por Masoma kishte supozuar që poezia ishte për të dhe shënimi për të motrën. Për herë të parë, Parvana e kishte parë veten me sytë e së motrës. Dhe e kishte kuptuar se ç'mendim kishte e motra për të. Ishte i njëjti mendim që kishin të gjithë. Ajo që i kishte thënë Masoma, e kishte tronditur. Ia kishte prerë gjunjët.

- Përveç kësaj, - kishte shtuar Masoma, duke mbledhur supet e duke buzëqeshur, - unë jam e zënë.

Nabi ka ardhur për vizitën e tij të përmuajshme. Ai është historia e suksesshme e familjes e, mbase, edhe e të gjithë fshatit, për shkak të punës në Kabul dhe makinës së padronit të tij, me të cilën vjen në Shadbag, një makinë blu vezulluese, me një kokë shqiponje mbi kapakun e motorit, që i bën të gjithë njerëzit e fshatit të dalin e ta shohin, ndërsa fëmijët e ndjekin pas me sokëllima.

- Si keni qenë? – i pyet ai.

Të tre janë brenda kasolles, duke pirë çaj e duke ngrënë arra. Nabi është shumë i pashëm, mendon Parvana me vete, me ato mollëza fine si të bëra me dorë, me sytë larushë, me favoritet e gjata dhe atë mur të dendur flokësh që i ngrihet mbi ballë. Ai ka veshur kostumin e tij të zakonshëm ngjyrë ulliri, që duket një a dy numra më i madh për trupin e tij. Nabi është krenar për këtë kostum. Parvana e di. Ai vazhdimisht i pastron me dorë mëngët, rregullon jakën, shtrin pantallonat, edhe pse kurrë nuk ka mundur t'ia heqë atë erën e padurueshme të qepës së djegur.

- E po, dje na erdhi për vizitë mbretëresha Homaira, pimë çaj e hëngrëm ëmbëlsira, - thotë Masoma. - Ajo na përgëzoi për zgjedhjen me shije të dekorit. - Ajo i buzëqesh me ëmbëlsi të vëllait duke zbuluar dhëmbët e verdhë dhe Nabi qesh, duke ulur sytë mbi filxhanin e vet. Përpara se të gjente punë në Kabul, Nabi kishte ndihmuar Parvanën që të kujdesej për të motrën. Më saktë, ishte përpjekur për një farë kohe. Por e kishte kuptuar që nuk e bënte dot. Ishte shumë për të. Kabuli kishte qenë shpëtimi i Nabit. Parvana e kishte zili të vëllanë, por nuk do të kishte dashur të ishte në vendin e tij: ajo e dinte se pagesa mujore që sillte ai në shtëpi, mbartte mbi vete më shumë se një sakrificë.

Masoma ka krehur flokët dhe ka lyer qerpikët me qymyr të tretur në ujë, ashtu siç bën gjithmonë, kur vjen Nabi në shtëpi. Parvana e di që, në një farë mënyre, ajo e bën këtë për t'ia bërë qejfin të vëllait, por më shumë, ngaqë ai është lidhja e saj e vetme me Kabulin. Për Masomën, ai është lidhja e saj

me luksin e lavdinë, me një qytet me makina, drita, restorante të këndshme e pallate mbretërore, pavarësisht se sa e largët është kjo lidhje. Parvanës i vjen ndër mend tani se, shumë kohë më parë, Masoma thoshte se ishte një vajzë qyteti e ngecur në fshat.

- Po ti, ç'na thua? A ke gjetur ndonjë grua? - e pyet Masoma me zë lozonjar. Nabi tund dorën duke qeshur, siç bënte edhe kur prindërit i bënin të njëjtën pyetje. - Pra, kur do të më marrësh përsëri në Kabul, vëlla? - e pyet Masoma.

Nabi i kishte marrë një herë në Kabul, një vit më parë. Kishte ardhur me makinë në Shadbag, i kishte marrë dhe i kishte çuar në Kabul, ku i kishte shëtitur nëpër rrugët e qytetit. U kishte treguar të gjitha xhamitë, pazaret, kinematë, restorantet. Ai i kishte treguar Masomës pallatin *Bagh-e-Bala* me kupolë, që gjendej në majën e një kodre që sundonte mbi qytet. Në kopshtet e Baburit, e kishte marrë Masomën në krahë për ta nxjerrë nga ndenjësja e përparme e makinës dhe e kishte çuar te varri i perandorit Mughal. Aty ishin lutur, që të tre, në xhaminë Shah Jahan, dhe mandej, buzë shatërvanit me pllaka blu, kishin ngrënë ushqimin që kishte marrë Nabi me vete për ato. Kjo kishte qenë mbase dita më e bukur në jetën e Masomës që prej aksidentit, dhe për këtë Parvana i ishte mirënjohëse të vëllait.

- Së shpejti, *inshallah*, - thotë Nabi, duke trokitur me gisht mbi filxhan.

- E ke problem të ma rregullosh këtë jastëkun poshtë gjurit, Nabi? Ah, tani është shumë më mirë. Falemnderit! - Masoma psherëtin. - E adhuroj Kabulin. Po të mundja, gjëja e parë që do të bëja nesër në mëngjes, do të ishte që të nisesha më këmbë për atje.

- Mbase do ta bësh një ditë, - thotë Nabi.

- Çfarë, të eci?!

- Jo, - mërmërin ai. - Doja të thosha... - dhe pastaj buzëqesh, kur Masoma shpërthen në të qeshura.

Jashtë, Nabi i jep paratë Parvanës. Ai mbështet njërin

sup te muri dhe ndez një cigare. Masoma është brenda, po bën gjumin e drekës.

- Para se të vija këtu, pashë Saborin, - thotë ai, duke ngacmuar thonjtë. - Sa e tmerrshme! Ma tha edhe emrin e foshnjës. Por e harrova.

- Pahri, - i thotë Parvana.

Ai pohon me kokë.

- Nuk e pyeta, por më tha se do që të martohet përsëri. - Parvana hedh sytë larg, duke u munduar të hiqet sikur kjo nuk i intereson, por zemra po i buçet në veshë. Mbi lëkurë ndien një vesë djerse. - Siç të thashë, unë nuk e pyeta. Ishte vetë Sabori që ma hapi këtë muhabet. Ai më mori veçan. Më mori veçan e ma tha.

Parvana dyshon se Nabi e di se ç'ndjenja ka fshehur ajo brenda vetes për Saborin gjatë gjithë këtyre viteve. Masoma është binjakja e saj, por është Nabi ai që e ka kuptuar pothuajse gjithmonë. Por Parvana nuk arrin ta kuptojë pse ai po merr mundimin për t'ia thënë këto gjëra. E ç'e mirë vjen prej kësaj? Sabori ka nevojë për një grua që nuk ka detyrime të tjera, për një grua që do t'ia përkushtojë veten e saj plotësisht atij, djalit të tij, vajzës së sapolindur. Koha e Parvanës pothuajse ka kaluar tashmë. Ditët e rinisë së saj janë të numëruara. Ditët e të gjithë jetës së saj janë të numëruara.

- Jam e sigurt që do të gjejë dikë, - thotë Parvana.

Nabi pohon me kokë.

- Do të vij përsëri muajin që vjen. - Ai e hedh cigaren në tokë, e fik me këmbë dhe niset të ikë.

Kur Parvana hyn brenda në shtëpi, habitet që e gjen Masomën zgjuar.

- Mendova se po flije.

Masoma hedh sytë drejt dritares, duke i pulitur qepallat ngadalë, e lodhur.

Kur vajzat ishin trembëdhjetë vjeç, e ëma i dërgonte ndonjëherë për të blerë në pazaret e rrëmujshme të qyteteve fqinje. Nga rrugët e pashtruara ngrihej lart aroma e ujit që sapo ishte derdhur. Të dyja ecnin nëpër rrugina, pranë stendave që shisnin enë nargjilesh, shalle mëndafshi, enë bakri, orë të vjetra. Pula të rrjepura, të varura për këmbësh, tundeshin mbi kofshët e qengjave e të viçave.

Në çdo rruginë, Parvana shihte se si e thithte Masoma vëmendjen e meshkujve, kur u kalonte pranë. Ajo e vinte re se si mundoheshin ata të tregoheshin mënjanës, por nuk ia dilnin dot t'i shkëputnin prej saj vështrimet e përvëluara. Nëse Masoma shihte në drejtim të tyre, ata merrnin një pamje prej budallai të privilegjuar. U dukej sikur sapo kishin kaluar një çast me të. Ajo ua priste njerëzve fjalën në buzë, duhanxhinjve ua ngecte tymin në fyt. Ajo ishte njeriu që i bënte gjunjët të dridheshin, filxhanët e kafes të thyheshin.

Ndonjëherë e gjitha kjo ishte shumë e lodhshme për Masomën, gati-gati dukej sikur i vinte turp për këtë, dhe i thoshte Parvanës se nuk donte të dilte, nuk donte që ta shikonin. Në të tilla ditë, Parvana mendonte se, mbase thellë brenda vetes, e motra e kuptonte që bukuria e saj ishte si një armë vrastare. Një pushkë e mbushur, me tytën të drejtuar drejt vetë kokës së saj. Por, gjithsesi, shumicën e ditëve dukej sikur vëmendja që tërhiqte, i pëlqente. Shumicën e ditëve, ajo e përdorte pushtetin e saj për t'i turbulluar mendimet e një burri me një buzëqeshje të vetme, fluturake, por strategjike, që i bënte gjuhët të belbëzonin.

Një bukuri si e saj i verbonte sytë.

Por pranë saj ishte Parvana, me gjoksin e vet të rrafshët dhe kompleksin e inferioritetit. Me flokët e ashpër si tel, fytyrën e ngrysur e të ashpër, kyçet e trasha dhe shpatullat si të mashkullit. Një hije patetike, e ndarë më dysh midis zilisë dhe dëshirës që ta shihnin pranë Masomës, vazhdimisht duke u përpjekur që të thithte sadopak nga vëmendja që i kushtohej

së motrës, ashtu si një bimë e keqe mundohet të thithë ujin që u hidhet zambakëve.

Gjatë gjithë jetës së vet, Parvana i kishte shmangur pasqyrat në prani të Masomës. Sepse, kur e shihte fytyrën e vet pranë asaj të së motrës, pasqyrat ia shuanin shpresën, i tregonin qartë se çfarë i ishte mohuar. Por, mes njerëzve të panjohur, çdo sy ishte një pasqyrë. Dhe aty nuk mund të shmangej.

Ajo e nxjerr Masomën jashtë. Të dyja ulen në *sharpoj-*
*-in*[1] që ka rregulluar Parvana. Ajo ka vendosur disa jastëkë, që Masoma të mund të ndihet rehat e mbështetur pas murit. Nata është e qetë, dëgjohet vetëm kënga e bulkthave. Dhe është edhe e errët, e ndriçuar vetëm nga dritat e atyre pak fenerëve që derdhen përtej dritareve, dhe nga një hënë tre-çerekëshe.

Parvana mbush enën e nargjilesë me ujë dhe, me një llullë duhani, hedh aty dy masa të njëjta opiumi të grirë. Mandej ndez qymyrin në magjen metalike dhe ia zgjat pipën së motrës. Masoma e thith fort, mbështetet në jastëk dhe pyet nëse mund t'i mbështetë këmbët në prehrin e Parvanës. Parvana zgjat duart dhe ia tërheq këmbët e paralizuara mbi të vetat.

Kur thith pipën, faqet e Masomës futen brenda. Qepallat i varen poshtë. Koka i anohet, zëri i meket dhe i bëhet sikur vjen nga larg. Një hije buzëqeshjeje i formohet në cepat e buzëve, ironike, mënjanëse, një nënshtrim ndaj fatit, aspak kënaqësi. Kur Masoma është në këtë gjendje, ato nuk flasin shumë me njëra-tjetrën. Parvana mban vesh flladin që fryn, ujin që gurgullon në enën e nargjilesë. Kundron yjet dhe tymin që ngrihet lart, drejt qiellit. Heshtja është kënaqësi dhe as ajo, as Masoma nuk ndiejnë nevojën që ta mbushin me fjalë të panevojshme.

---

1) Lloj shtrati, tradicional në Indi, i thurur me litarë, kapur në një skelet prej druri (*shën. i përkth.*).

Derisa Masoma thotë:

- A do të bësh diçka për mua?

Parvana vështron nga ajo.

- Dua që të më çosh në Kabul. - Masoma e nxjerr tymin ngadalë dhe ai ngrihet lart si spirale, pastaj shndërrohet në rrathë e më në fund në forma të papërcaktuara, që shpërbëhen në ajër.

- Seriozisht e ke?

- Dua të shoh Pallatin Darulaman. Herën e fundit që ishim, nuk na u dha rasti. E mbase edhe shkoj përsëri te varri në Babur.

Parvana përkulet përpara për të kuptuar shprehjen e fytyrës të së motrës. Kërkon për ndonjë gjurmë shakaje, por nën dritën e hënës sheh vetëm sytë e qetë, me qepalla të palëvizura, të së motrës.

- Është të paktën dy ditë larg. Ndoshta tri.

- Përfytyro fytyrën e Nabit, kur t'i trokasim në derë pa e lajmëruar.

- Ne as që e dimë se ku banon ai.

Masoma tund dorën gjithë përtesë.

- Ai na e ka treguar se në cilën lagje është shtëpia. Do të trokasim në ndonjë derë e do të pyesim. Nuk është aq e vështirë.

- E si do të shkojmë deri atje, Masoma, në këtë gjendje që je ti?

Masoma largon pipën e nargjilesë nga goja.

- Sot, kur ti po punoje jashtë, erdhi Mulla Shekibi dhe folëm për një kohë të gjatë. I thashë se do të shkojmë për disa ditë në Kabul. Vetëm unë dhe ti. Dhe ai më në fund më dha bekimin. Por më ofroi edhe mushkën e vet. E sheh? I kam rregulluar të gjitha.

- Ti je e çmendur, - i thotë Parvana.

- E po, kjo është ajo që dua. Kjo është dëshira ime.

Parvana mbështetet në mur, duke tundur kokën mohueshëm. Ngre sytë lart, drejt qiellit të errët të ndërprerë nga retë.

- Po vdes nga mërzia, Parvana!

Parvana ofshan me një psherëtimë të thellë dhe sheh nga e motra.

Masoma afron pipën te buzët.

- Të lutem! Mos ma moho këtë!

Një mëngjes herët, kur ishin shtatëmbëdhjetë vjeç, të dy binjaket ishin ngjitur në pemën e lisit dhe ishin ulur në një degë me këmbët varur poshtë.

- Sabori do të më kërkojë! - i kishte pëshpëritur Masoma.

- Do të të kërkojë? - e kishte pyetur Parvana, pa kuptuar asgjë, të paktën jo menjëherë.

- Mirë, jo ai vetë, sigurisht. - Masoma kishte vënë dorën përpara gojës e kishte qeshur. - Sigurisht që jo. Do të jetë i ati ai që do të vijë të më kërkojë.

Dhe Parvana e kishte kuptuar. Zemra i kishte rënë në fund të këmbëve.

- E nga e di ti? - kishte mërmëritur ajo me buzët të mpira.

Masoma kishte nisur të fliste, duke i shqiptuar fjalët me një shpejtësi të çmendur, por Parvana thuajse nuk kishte dëgjuar asnjë prej tyre. Ajo po përfytyronte dasmën e së motrës me Saborin: Fëmijë me rroba të reja, duke mbajtur në duar enët e kënasë të zbukuruara me lule, dhe pas tyre muzikantët me *shahnai*-e[1] dhe *dohol*-e[2]. Sabori që hapte pëllëmbën e Masomës dhe vendoste aty kënanë, e më pas e lidhte me një fjongo të bardhë. Njerëzit që thoshin lutje. Bekimi i bashkimit. Dhuratat. Sytë e Masomës, nën një vel të zbukuruar me qëndisma ari, që nuk ndaheshin nga sytë e Saborit, ndërsa i futnin njëri-tjetrit në gojë një lugë sherbet dhe *malida*[3].

---

1) Lloj oboje (*shën. i përkth.*).

2) Lloj daulleje e madhe cilindrike (*shën. i përkth.*).

3) Ëmbëlsirë tradicionale e Azisë Jugore (*shën. i përkth.*).

Dhe ajo, Parvana, do të ishte aty, mes të ftuarve, duke e parë të gjithë këtë. Ajo duhej të qeshte, të duartrokiste, të tregohej e lumtur, edhe pse zemra do t'i çahej e do t'i bëhej copash në kraharor.

Era kishte fryrë midis degëve të pemës, degët përreth tyre ishin tundur dhe gjethet kishin fëshfërirë. Parvana ishte detyruar ta mblidhte veten.

Masoma nuk po fliste më. Ajo po buzëqeshte, ndërsa kafshonte me dhëmbë buzën e poshtme.

- Më pyete se nga e di që ai do të më kërkojë të martohemi. Do të ta them. Jo. Prit. Do të ta tregoj.

Ajo ia kishte kthyer shpinën Parvanës dhe kishte futur dorën në xhep.

Dhe mandej kishte ardhur pjesa për të cilën Masoma nuk dinte asgjë. Ndërsa e motra ishte me shpinë nga ajo, duke rrëmuar në xhepin e vet, Parvana ishte mbështetur me pëllëmbë në degën e lisit, kishte ngritur vithet dhe pastaj ishte ulur përsëri me forcë. Dega ishte dridhur. Masoma kishte klithur dhe kishte humbur drejtpeshimin. Krahët i ishin hapur në ajër. Trupi i ishte harkuar përpara. Parvana kishte parë duart e veta që ishin zgjatur drejt saj. Nuk është se me ato duar kishte shtyrë Masomën, por në të mijtën e sekondës kishte pasur një kontakt mes mollëzave të gishtave të Parvanës dhe shpinës së Masomës. Kishte zgjatur fare pak dhe pastaj Parvana kishte bërë ta kapte të motrën nga bluza, përpara se Masoma ta thërriste në emër e pushtuar nga paniku dhe Parvana të thërriste emrin e saj. Parvana e kishte kapur bluzën dhe për një çast ishte dukur sikur do të arrinte ta shpëtonte të motrën. Por bluza ishte grisur dhe ajo i kishte rrëshqitur nga duart.

Masoma kishte rënë nga pema. Ishte dukur sikur rënia kishte zgjatur një jetë të tërë. Trupi i përplasej pas degëve, ndërsa binte poshtë, duke trembur zogjtë e duke shkundur gjethet. Ai kërcente, përplasej, fërkohej pas degëve të vogla, derisa fundshpina i ishte përplasur më në fund me zhurmë në

një degë të trashë, ku qe lidhur shilarësi. Shpina e Masomës ishte harkuar pas, gati ishte thyer më dysh.

Pak minuta më vonë, një rreth njerëzish ishte formuar rrotull saj. Nabi dhe babai i vajzave e thërrisnin e mundoheshin ta sillnin në vete. Fytyrat ishin përkulur të gjitha mbi të. Dikush ia kishte kapur dorën. Ishte ende e mbështjellë grusht. Kur ia kishin hapur gishtat, kishin gjetur dhjetë gjethe të vogla lisi të mbështjella në pëllëmbën e saj.

Masoma thotë me zërin që i dridhet lehtë:

- Duhet ta bësh tani. Po qe se do të presësh mëngjesin, nuk do të ta bëjë më zemra.

Përreth tyre, përtej flakës së dobët të zjarrit në vatër, që Parvana e ka ndezur me degë shkurresh e barishte të egra, shtrihet shkretëtira e gjerë, e vetmuar e rërës dhe malet e përpira nga errësira. Kanë dy ditë rresht që ecin nëpër terrenin e thyer, për të shkuar në Kabul, Parvana përbri mushkës, Masoma e lidhur pas shalës, ndërsa Parvana ia mban dorën. Ato kanë ecur nëpër shtigje të pjerrëta, që harkoheshin e dredhonin nëpër shkëmbinj të thepisur, me tokën nën këmbët e tyre të mbuluar nga barishte të egra ngjyrë okre e ndryshku, me plasaritje që ngatërroheshin nga të katër anët si rrjeta merimange.

Parvana është ulur pranë zjarrit, duke parë Masomën e mbuluar me batanije, që duket si një e ngritur pa formë mbi tokë, në anën tjetër të zjarrit.

- Sikur kërkove të shkoje në Kabul? - i thotë Parvana.

- Oh, dhe të mendosh se pritej që ti të ishe më e zgjuara.

Parvana thotë:

- Nuk mund të ma kërkosh ta bëj këtë.

- Jam e lodhur, Parvana. Kjo imja nuk është jetë. Ekzistenca ime është një ndëshkim për të dyja ne.

- Më mirë të kthehemi pas, - thotë Parvana, ndërsa fyti nis t'i ngushtohet. - Unë nuk e bëj dot. Nuk të lë dot këtu.

- Nuk je ti që po më lë, - Masoma nis të qajë. - Po të lë unë të shkosh. Po të liroj nga detyrimi.

Parvanës i kujtohet një natë e shumë vjetëve më parë: Masoma e ulur në shilarës, ndërsa ajo e tundte. Ajo e kishte parë Masomën teksa shtrinte këmbët përpara e hidhte kokën pas çdo herë që shilarësi arrinte lartësinë maksimale, ndërsa flokët e gjatë i valëviteshin si çarçafët e nderur në tel. Iu kujtua se si bënin dikur bashkë kukulla me kashtë misri e i vishnin me fustane nusesh, që i qepnin me copat nga rrobat e vjetra.

- Më thuaj diçka, motër.

Parvana pulit qepallat për të larguar lotët, që po ia veshin sytë, dhe fshin hundët me trinën e dorës.

- Djalin e tij, Abdullain. Dhe foshnjën, Pahrin. A beson se mund t'i duash si të ishin fëmijët e tu?

- Masoma!

- A mundesh?

- Mund ta provoj, - thotë Parvana.

- Shumë mirë. Atëherë martohu me Saborin. Kujdesu për fëmijët e tij. Bëj edhe ti fëmijë.

- Ai të dashuronte ty. Ai nuk më dashuron mua.

- Do të të dashurojë. Thjesht jepi pak kohë.

- E gjitha kjo është për fajin tim, - thotë Parvana. - Gjithçka.

- Nuk e di se ç'po thua dhe as që dua ta di. Në këto çaste, kjo është e vetmja gjë që dua. Njerëzit do ta kuptojnë, Parvana. Mulla Shekibi duhet t'ua ketë thënë tani. Ai do t'u thotë se më dha bekimin për këtë. - Parvana ngre sytë drejt qiellit të errët. - Ji e lumtur, Parvana, të lutem ji e lumtur. Bëje për mua.

Parvana e ndien se është gati të rrëfejë gjithçka: t'i tregojë Masomës se e ka gabim, se e njeh shumë pak atë motër me të cilën kishte jetuar nëntë muaj brenda së njëjtës mitër, se jeta e Parvanës prej vitesh është shndërruar në një kërkim të heshtur

për falje. Por me çfarë kostoje? Do ta gjejë shpëtimin e saj në kurriz të Masomës edhe këtë herë? Ajo i mbyt fjalët brenda vetes. Mjafton ajo dhembje që ndërkaq i ka shkaktuar së motrës.

- Tani dua të pi nargjile, - thotë Masoma. Parvana nis të kundërshtojë, por Masoma ia pret shkurt, - Tani është koha, - thotë ajo me zë më të ashpër, më të vendosur.

Nga çanta e varur në shalën e mushkës, Parvana nxjerr nargjilenë. Me duart që i dridhen, fillon të përgatitë përzierjen e zakonshme në enën e nargjilesë.

- Më shumë, - thotë Masoma. - Hidh më shumë.

Duke rrufitur hundët, me faqet të njomura nga lotët, Parvana hedh edhe një tjetër masë, pastaj një tjetër, e përsëri një tjetër. Ajo e ndez qymyrin dhe e vendos enën e nargjilesë pranë së motrës.

- Tani, - thotë Masoma, ndërsa drita portokallí e flakëve të zjarrit vezullon në faqet e saj, në sytë e saj, - po qe se më ke dashur ndonjëherë, Parvana, po qe se ke qenë ndonjëherë motra ime e vërtetë, ik. Pa puthje. Pa lamtumirë. Mos më detyro të të lutem.

Parvana bën të thotë diçka, por Masoma lëshon një rënkim të dhembshëm dhe kthen kokën nga ana tjetër.

Parvana ngrihet ngadalë në këmbë. I afrohet mushkës dhe e lidh shalën mirë. E kap kafshën prej kapistre. Por befas e kupton se ajo nuk di si të jetojë pa Masomën. Nuk e di a mundet. Si do t'i durojë ditët, kur mungesa e Masomës do t'i duket një mundim shumë më i madh se prania e saj? Si do të arrijë t'i vijë anash vrimës së madhe që do të zërë vendin e Masomës?

"Trego që ke paksa shpirt", - i duket sikur i thotë Masoma.

Parvana tërheq kapistrën, e kthen kafshën në anën tjetër dhe nis të ecë.

Ajo ecën nëpër errësirë, ndërsa era e ftohtë e natës ia fshikullon fytyrën. Por ajo vazhdon të ecë përpara. E kthen kokën vetëm një herë pas, më vonë. Përmes perdes së lotëve

në sy, arrin të shquajë zjarrin e largët: një flakë e dobët e verdhë. Përfytyron motrën binjake të shtrirë ndanë zjarrit, e vetme në errësirë. Së shpejti zjarri do të shuhet dhe Masoma do të ketë ftohtë. Instinkti i kërkon të kthehet pas, ta mbulojë të motrën me batanije dhe të shtrihet edhe vetë pranë saj.

Por Parvana e detyron veten të shohë përpara dhe nis të ecë sërish.

Dhe tamam në atë çast dëgjon diçka. Një tingull të largët, të turbullt, një si rënkim. Parvana ndal hapat. Kthen kokën dhe e dëgjon përsëri. Zemra nis t'i rrahë fort në kraharor. Dhe pyet me vete, me tmerr, se mos, vallë, është Masoma që po e thërret të kthehet, që ka ndërruar mendje... Apo, ndoshta, është ndonjë çakall a ndonjë dhelpër e shkretëtirës që kuis në errësirë? Parvana nuk e di. Mendon se mbase është era.

"Mos më lër, motër. Kthehu!"

E vetmja mënyrë që ta dijë me siguri, është që të kthehet pas, andej nga ka ecur, dhe Parvana pikërisht këtë nis të bëjë: ajo kthehet pas dhe bën disa hapa në drejtim të Masomës. Por pastaj ndalet. Masoma kishte të drejtë. Po qe se kthehet tani, nuk do të ketë guxim të ikë, pasi të lindë dielli. Nuk do t'i bëjë zemra të ikë dhe, si përfundim, do të qëndrojë. Do të qëndrojë përgjithmonë pranë saj. Ky është shansi i saj i vetëm.

Parvana mbyll sytë. Era ia përplas shaminë e kokës në fytyrë.

Nuk ka pse ta dijë asnjeri. Asnjeri nuk do ta dijë. Ky do të jetë sekreti i saj, një sekret që ajo do ta ndajë veç me malet. Problemi është nëse mund të jetojë ajo me këtë të fshehtë, dhe Parvana mendon se e di përgjigjen. Ajo ka jetuar me sekrete gjatë gjithë jetës së saj.

Ajo e dëgjon përsëri rënkimin e largët.

*Të gjithë të donin ty, Masoma.*

*Asnjëri mua.*

*Pse, motër? Ç'kisha bërë unë?*

Parvana qëndron pa lëvizur në errësirë për një kohë të gjatë.

Më në fund, vendos. Kthehet, ul kokën dhe ecën drejt një horizonti që nuk arrin ta shohë. Dhe pas kësaj nuk e kthen më kokën pas. E di që, po ta bëjë këtë, do t'i mpaket guximi. Do të humbasë çdo lloj vendosmërie, sepse përpara syve do t'i shfaqet një biçikletë e vjetër që ecën me shpejtësi tatëpjetë kodrës, duke kërcyer nëpër gurë e hendekë, ndërsa ndenjëset metalike u dërrmojnë të ndenjurat dhe pluhuri ngrihet lart si re pas çdo frenimi të papritur. Ajo është ulur te hekuri, kurse Masoma në shalë; është Masoma që sulet me biçikletë në një shteg të pjerrët dhe i merr kthesat pa e ulur aspak shpejtësinë. Por Parvana nuk ka frikë. Ajo e di që e motra nuk do ta vërvitë fluturimthi përtej timonit, e motra nuk do ta lëndojë. E gjithë bota shkrihet me entuziazmin e tyre dhe era u fishkëllen në veshë. Parvana kthen kokën e sheh të motrën, edhe e motra e sheh atë dhe që të dyja qeshin me ngazëllim, ndërsa qentë endacakë i ndjekin pas.

Parvana vazhdon të ecë drejt jetës së saj të re. Ecën e ecën, në mes të errësirës, që e mbështjell si një mitër nëne. Dhe, kur terri fashitet e ajo ngre kokën lart, mes mjegullës së agimit, sytë i kapin një rrip të zbehtë drite në lindje, që përkëdhel shpatin e një shkëmbi. Dhe i duket sikur ka rilindur.

# Katër

Në emër të Allahut, më Bujarit, më të Mëshirshmit.

E di që, kur ta lexoni këtë letër, unë nuk do të jem më në këtë botë, zoti Markos, sepse, kur jua dhashë, ju kërkova që të mos e lexonit për sa kohë që unë do të isha gjallë. Më lejoni t'ju shpreh se ç'kënaqësi e madhe ka qenë njohja me ju gjatë këtyre shtatë vjetëve të fundit, zoti Markos. Ndërsa po shkruaj këto radhë, më vjen ndër mend me shumë respekt rituali i përvitshëm i mbjelljes së domateve në kopsht, ardhja juaj çdo mëngjes për çaj në shtëpinë time, mësimet e pandërprera të anglishtes dhe të gjuhës farsi. Ju falënderoj për miqësinë që më dhuruat, për bujarinë tuaj dhe për punën që keni bërë në këtë vend, dhe kam besim se do t'ia përcillni mirënjohjen time edhe kolegëve tuaj zemërmëdhenj, veçanërisht mikes sime, zonjës Amra Ademoviç, që ka një aftësi të veçantë për të ndier dhembshuri, si edhe vajzës së saj të dashur e kurajoze, Roshit.

Më duhet ta them që këtë letër nuk po e shkruaj vetëm për ju, zoti Markos, por edhe për dikë tjetër, të cilit shpresoj t'ia përcillni këtë letër, siç do t'jua shpjegoj më tej. Të më falni, po qe se përsërit gjëra që ju i dini tashmë. Jam i detyruar

t'i shkruaj, për të mirën e saj. Siç do ta shihni, në këtë letër gjenden shumë elemente rrëfimi, zoti Markos, por ka edhe disa çështje pragmatike që më nxitin të shkruaj. Për këto, druhem se do të kem nevojë për ndihmën tuaj, mik.

Jam menduar gjatë se nga duhet ta nis rrëfimin. Nuk është detyrë e lehtë kjo për një burrë që duhet të ketë arritur në mesin e të shtatëdhjetave. Mosha ime është mister për mua, sikurse është edhe për çdo afgan të brezit tim, por jam i bindur që i jam afruar mjaft, sepse kam një kujtim mjaft të gjallë të një zënke me grushte me shokun tim, që më vonë do të bëhej kunati im, me Saborin, pikërisht atë ditë kur dëgjuam që Nader Shahun e kishin qëlluar me pushkë dhe e kishin vrarë dhe në vend të tij ishte ngjitur në fron i biri, Zahiri i vogël. Kjo ndodhi në vitin 1933. Këtu duhet t'ia nis, besoj. Ose ndoshta diku tjetër. Rrëfimi është si një tren që ecën: pavarësisht se ku i hipën, herët a vonë do të mbërrish në destinacion. Por besoj se është më mirë ta nis këtë rrëfim me të njëjtën gjë me të cilën do ta përfundoj. Po, them se është më se e arsyeshme që ta nis këtë histori me Nila Vahdatin.

Atë e njoha në vitin 1949, kur u martua me zotin Vahdati. Në atë kohë më bëheshin dy vjet që kur kisha nisur punë te zoti Sulejman Vahdati. Në vitin 1946, kisha ardhur në Kabul nga Shadbagu, fshati ku pata lindur, dhe për një vit kisha punuar në një tjetër shtëpi në po atë lagje. Rrethanat e largimit tim nga Shadbagu nuk më bëjnë të ndihem krenar, zoti Markos. Konsiderojeni si rrëfimin tim të parë, pra, kur ju them se ndihesha i fundosur nga jeta që bëja në fshat me dy motrat e mia, njëra prej të cilave ishte e paralizuar. Jo se kjo më justifikon, por unë isha shumë i ri, zoti Markos, i etur për të njohur botën, plot me ëndrra, sado modeste a të turbullta që të ishin ato, dhe më dukej sikur rinia po më venitej, sikur e ardhmja po më cungohej çdo ditë e më shumë. Kështu që ika

prej aty. Që të ndihmoja motrat ekonomikisht, po, kjo është e vërtetë, por edhe nga nevoja për t'u arratisur.

Meqenëse punoja me kohë të plotë për zotin Vahdati, banoja në shtëpinë e tij po me kohë të plotë. Asokohe, shtëpia nuk i ngjante aspak asaj ndërtese të mjeruar që gjetët ju, kur erdhët në Kabul në vitin 2002, zoti Markos. Në atë kohë ajo ishte një vend dinjitoz dhe i bukur. Shtëpia vezullonte nga bardhësia, si të ishte mbuluar me diamante. Porta kryesore hapej e të nxirrte në një rrugë të gjerë të shtruar me asfalt. Me të hyrë brenda, gjendeshe në një holl të madh me tavan të lartë, zbukuruar me vazo të larta qeramike dhe me një pasqyrë të rrumbullakët në një kornizë prej druje are të inkrustruar, që gjendej pikërisht në atë vend ku ju vendosët për ca kohë atë fotografinë e vjetër në plazh të shoqes suaj të fëmijërisë, të nxjerrë me një aparat fotografik të bërë vetë. Dyshemeja prej mermeri e dhomës së ndenjjes shndrinte e tëra dhe një pjesë e saj ishte e mbuluar me një qilim turkmen[1)] në ngjyrë të kuqe të errët. Qilimi nuk është më tani, as divanet prej lëkure, as tryeza e kafes e punuar me dorë dhe kutia e shahut, as edhe bufeja e lartë me ngjyrë të kuqërremtë. Shumë pak nga mobiliet e vjetra kanë mbijetuar dhe unë druaj se edhe këto nuk janë më në gjendjen që ishin dikur.

Kur hyra për herë të parë në kuzhinën me pllaka prej guri, mbeta gojëhapur. Mendova se ajo ishte mjaftueshëm e madhe sa për të ushqyer të gjithë banorët e fshatit tim, Shadbagut. Unë kisha në dispozicion një sobë me gjashtë nivele nxehtësie, një frigorifer, një thekëse buke dhe një mori tenxheresh, tiganësh, thikash e enësh të tjera kuzhine. Banjat, që të katra, ishin të shtruara me pllaka mermeri dhe kishin duarlarëse prej porcelani. Dhe ato hapësirat katrore në banakun e duarlarëses në banjën e katit të dytë, zoti Markos, dikur ishin të veshura me pllaka lapisi.

---

1) Qilim i punuar me dorë, tradicional për Azinë e Vogël, e veçanërisht për Turkmenistanin dhe Afganistanin (*shën. i përkth.*).

Pastaj ishte edhe kopshti i pasmë. Duhet të uleni ndonjë ditë në dhomën tuaj të punës, zoti Markos, të hidhni sytë mbi kopsht e të mundoheni ta përfytyroni si ka qenë dikur. Në atë kopsht dilje përmes një verande në formë gjysmëhëne, që kufizohej nga dy radhë hardhish të ulëta. Bari asokohe ishte i njomë e jeshil, i ndërprerë nga shtretër lulesh: jaseminë, tulipanë, trëndafila eglantinë, barbaroza, dhe i kufizuar nga dy radhë pemësh frutore. Njeriu mund të shtrihej nën një pemë qershie, zoti Markos, të mbyllte sytë, të dëgjonte flladin që fëshfërinte nëpër gjethet e pemëve, dhe mund të mendonte se nuk ekzistonte në këtë botë një vend më i mirë për të jetuar.

Unë vetë jetoja në një shtëpizë në kopshtin e pasmë. Ajo kishte një dritare, mure të pastra të lyera me bojë të bardhë, si dhe një hapësirë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e një djaloshi beqar. Kisha një shtrat, një tryezë pune dhe një karrige, dhe mjaft hapësirë për të shtruar pesë herë në ditë një qilim për t'u falur. Ishte më se e mjaftueshme për mua në atë kohë dhe është më se e mjaftueshme edhe tani.

Unë gatuaja për zotin Vahdati, zanat ky që e kisha mësuar duke parë mamanë time të ndjerë e më vonë nga një kuzhinier plak uzbekistanas në një shtëpi në Kabul, ku kisha shërbyer për një vit si ndihmës i tij. Isha gjithashtu, për fatin tim të mirë, edhe shoferi i zotit Vahdati. Ai kishte një *Chevrolet*, model i mesit të viteve '40, ngjyrëblu e me çati të errët, me ndenjëse të kadifenjtë po ngjyrëblu dhe me disqe rrotash të kromuara, një makinë shumë e bukur, që thithte mbi vete të gjithë sytë, ngado që shkonte. Ai më lejonte ta ngisja, sepse kisha dëshmuar se sa shofer i zoti e i kujdesshëm isha dhe, veç kësaj, ai ishte një nga ato specie të rralla mashkullore që nuk i pëlqente t'i jepte makinës.

Ju lutem, zoti Markos, mos mendoni se po mburrem, kur ju them se isha shërbëtor i mirë. Përmes vëzhgimeve të kujdesshme, unë e dija shumë mirë se çfarë pëlqente e çfarë nuk pëlqente zoti Vahdati, ia njihja tekat. Madje ia njihja edhe zakonet dhe huqet. Për shembull, çdo ditë, pasi hante më-

ngjesin, atij i pëlqente të dilte për të shëtitur më këmbë. Por nuk i pëlqente të ecte vetëm, dhe unë isha gjithmonë i detyruar që ta shoqëroja. Pa dyshim që u bindesha dëshirave të tij, paçka se nuk e kuptoja për se i nevojitej prania ime. Ai rrallë më thoshte ndonjë fjalë gjatë këtyre shëtitjeve dhe gjithmonë më dukej i kredhur në mendimet e veta. Ecte me hapa të shpejtë, me duart të lidhura pas shpine, duke përshëndetur kalimtarët, ndërsa takat e këpucëve prej lëkure, të pastra e të lustruara, trokisnin mbi këmbësore. Dhe, ngaqë shumë shpesh këmbët e tij të gjata ecnin me hapa që unë nuk i arrija dot, vazhdimisht mbetesha pas e detyrohesha të shpejtoja për ta arritur. Pjesën tjetër të ditës ai e kalonte thuajse i mbyllur në dhomën e tij të punës, në katin e dytë, duke lexuar ose duke luajtur shah me veten. I pëlqente të pikturonte, edhe pse nuk mund të thosha asgjë për talentin e tij, të paktën jo në atë kohë, sepse ai kurrë nuk m'i tregonte ato që bënte. Shpeshherë, e gjeja pranë dritares në dhomën e tij të punës, ose në verandë, me ballin të ngrysur e plotësisht i përqendruar, ndërsa lapsi prej karboni vallëzonte mbi bllokun e skicave.

Herë pas here e nxirrja me makinë nëpër qytet. Një herë në javë shkonte të shihte të ëmën. Pastaj ishin edhe takimet me kushërinjtë. Dhe, edhe pse zoti Vahdati i shmangte shumicën e tyre, në ndonjë rast shkonte: funerale, ditëlindje, dasma. Një herë në muaj e çoja te një dyqan që shiste gjëra pikture, ku blinte lapsat me ngjyra, lapsat e zinj, gomat, prefëset e lapsave dhe blloqet e fletëve, për të pikturuar. Ndonjëherë i pëlqente të ulej në ndenjësen e pasme dhe unë vetëm t'i jepja makinës. Unë e pyesja: "Ku doni të shkoni, *Sahib*[1])? - dhe, ndërsa ai mblidhte supet, unë vazhdoja - Shumë mirë, *Sahib*"; atëherë i jepja gaz dhe vetëm ecnim me makinë. Unë i bija qytetit rreth e përqark, për orë të tëra, pa ndonjë synim, nga njëra lagje në tjetrën, përgjatë lumit të Kabulit, te *Bala Hissari* e ndonjëherë edhe te *Pallati Darulaman*. Ditë të tjera e nxirrja

1) Titull mirësjelljeje për një burrë, zotëri (*shën. i përkth.*).

jashtë Kabulit dhe ngjiteshim te *Liqeni Ghargha*, ku ndalesha aty pranë ujit. E fikja motorin dhe zoti Vahdati qëndronte në heshtje të plotë në ndenjësen e pasme, pa thënë asnjë fjalë: i pëlqente vetëm të ulte xhamin e dritares e të shihte zogjtë që fluturonin nga njëra pemë tek tjetra, si edhe rrezet e diellit që përplaseshin mbi sipërfaqen e liqenit dhe thërrmoheshin në mijëra vezullime të vogla në ujë. Unë e shihja nga pasqyra e shoferit, siç më shihte edhe ai, me vështrimin e njeriut më të vetmuar në botë.

Një herë në muaj, zoti Vahdati, me shumë bujari, më linte të merrja makinën e tij dhe unë shkoja në Shadbag, në fshatin tim të lindjes, ku takoja motrën time, Parvanën, dhe burrin e saj, Saborin. Çdo herë që shkoja me makinë në fshat, më ndiqnin pas turma fëmijësh që bërtisnin, që vraponin anash makinës, duke trokitur në xhamin e dritares e duke i rënë kapakut të bagazhit. Kishte edhe nga ata miushë të vegjël që mundoheshin të ngjiteshin sipër në makinë dhe mua më duhej t'i largoja prej aty, nga frika se mund ta gërvishtnin ose mund të dëmtonin bojën.

- Pa shih, Nabi, - më thoshte Sabori. - Je bërë i famshëm!

Ngaqë fëmijët e tij, Abdullai dhe Pahri, nuk e kishin të ëmën (Parvana ishte njerka e tyre), unë gjithmonë mundohesha t'u kushtoja vëmendje, veçanërisht djalit, që dukej se kishte vërtet nevojë për këtë. Herë pas here e merrja me vete për ta shëtitur me makinë dhe ai gjithmonë këmbëngulte që të merrte me vete edhe motrën e vet të vogël, që e mbante të shtrënguar fort në prehrin e vet, ndërsa ecnim nëpër rrugën kryesore jashtë fshatit. E lija që të lëvizte marshin, t'i binte borisë dhe e kisha mësuar se si t'i ndryshonte dritat e makinës.

Pasi mbaronte rrëmuja e shkaktuar nga makina, unë ulesha për të pirë çaj me time motër e Saborin dhe u rrëfeja për jetën time në Kabul. Gjithmonë tregoja kujdes të mos flisja shumë për zotin Vahdati. Të them të drejtën, unë e doja dhe e respektoja shumë atë njeri, sepse më trajtonte shumë mirë dhe,

po të flisja për të pas shpinës së tij, më dukej sikur e shisja. Po qe se do të kisha qenë një shërbëtor më llafazan, do t'u kisha thënë atyre se zoti Vahdati më dukej si një qenie e mistershme, një burrë që dukej se kënaqej duke jetuar me të ardhurat e pasurisë së tij, që nuk kishte asnjë zanat, asnjë pasion të dukshëm dhe as edhe ndonjë dëshirë që të linte pas ndonjë gjë të vetën në këtë botë. Do t'u kisha thënë atyre se ai bënte një jetë pa kurrfarë pikësynimi ose ambiciesh. Tamam si ato endjet e kota me makinë që bënim bashkë. Një jetë e je-tuar që nga ndenjësja e pasme e makinës, një jetë e kundruar anashkalimthi. Një jetë mënjanëse.

Këto do t'u kisha thënë atyre, por unë nuk e bëra kurrë. Dhe është gjë e mirë që nuk e bëra, sepse sa shumë që gabohesha atëherë.

Një ditë, zoti Vahdati erdhi në kopsht i veshur me një kostum elegant me vija, kostum që nuk ia kisha parë kurrë më parë, dhe më kërkoi që ta çoja në një lagje të pasur të qytetit. Kur mbërritëm atje, ai më tha të parkoja pranë një shtëpie të bukur me mure të larta. E pashë kur i ra ziles dhe një shërbëtor ia hapi derën, që të hynte brenda. Shtëpia ishte gjigante, më e madhe se ajo e zotit Vahdati dhe shumë më e bukur. Qiparisat shtatlartë e elegantë qëndronin në radhë në të dy anët e rrugës, pranë një lloj shkurreje me lule, së cilës nuk ia dija emrin. Kopshti i pasmë ishte rreth dy herë më i madh se ai i shtëpisë së zotit Vahdati dhe muret rrethuese ishin kaq të larta, sa, edhe sikur një burrë të hipte mbi supet e dikujt, përsëri do të ishte larg majës së tyre. Dhe e kuptova se kjo ishte pasuri me përmasa të tjera.

Ajo ishte një ditë e bukur fillimvere dhe qielli ndrinte nga rrezet e diellit. Nga dritaret e hapura të makinës hynte një ajër i ngrohtë. Edhe pse detyra e një shoferi është që të ngasë makinën, ai e kalon pjesën më të madhe të kohës duke pritur. Duke pritur jashtë dyqaneve, me motorin ndezur; jashtë sallës

së dasmës, ndërsa dëgjon tingujt e mbytur të muzikës. Atë ditë, për të kaluar kohën, bëra disa lojë me letra, dola nga makina dhe bëra disa hapa në njërin drejtim e pastaj në tjetrin. Mandej u futa përsëri në makinë, me mendimin që të merrja një sy gjumë, derisa të kthehej zoti Vahdati.

Tamam në atë çast, porta e shtëpisë u hap dhe prej saj doli një grua e re me flokë të zinj. Kishte vënë syze dielli dhe kishte veshur një fustan portokallí me mëngë të shkurtra, që i arrinte deri te gjunjët. Këmbët i kishte të zbuluara e pa çorape. Nuk e di a më vuri re mua brenda në makinë, por, edhe në ishte kështu, nuk reagoi fare. Ajo e mbështeti thembrën e njërës këmbë në murin pas saj dhe fundi i fustanit iu ngrit paksa lart e iu zbulua paksa kofsha. Unë provova një ndjesi nxehtësie që m'u shpërnda nga faqet në drejtim të qafës.

Më lejoni t'ju rrëfej edhe diçka tjetër, zoti Markos, një rrëfim paksa i turpshëm, që lë pak vend për shprehje elegante. Asokohe duhet të kem qenë në fillim të të njëzetave, një djalosh në kulmin e dëshirës për shoqërinë e një gruaje. Krejt ndryshe nga shumica e djemve me të cilët u rritëm në fshat, djem të rinj që nuk e kishin parë kurrë kofshën e zhveshur të një gruaje dhe që martoheshin, nga njëra anë, edhe thjesht për të gëzuar një të drejtë të tillë, unë kisha njëfarë përvoje. Në Kabul, kisha gjetur një vend, që e frekuentoja herë pas here, ku nevojat e një burri përmbusheshin në fshehtësi të plotë e në mënyrën e duhur. Po jua them këtë, sepse asnjë nga ato prostituta me të cilat kisha shkuar, nuk mund të krahasohej me këtë krijesë të bukur, dinjitoze, që sapo kishte dalë nga shtëpia e madhe.

Ajo ndezi një cigare e nisi ta pinte më nge, me një dinjitet magjepsës, duke e mbajtur me majën e dy gishtave dhe duke e vënë dorën përpara gojës, sa herë që e vinte në buzë. Unë po e kundroja me vëmendje si i mrekulluar. Mënyra se si i harkohej kyçi elegant i dorës, më kujtonte një ilustrim që kisha parë dikur në një libër me përmbledhje poezish: një grua me qerpikë të gjatë, me flokë të zinj valëvitës, që qëndronte shtrirë

në kopsht tok me të dashurin e saj dhe po i zgjaste atij një gotë verë me gishtat e saj të hajthëm. Në një çast, u duk sikur diçka në anën tjetër të rrugës thithi vëmendjen e gruas, dhe unë e shfrytëzova këtë çast që të rregulloja me gishta flokët, që kishin nisur të më lëshoheshin nga vapa. Kur ajo u kthye përsëri me kokën këtej, unë ngriva edhe një herë tjetër. Ajo e thithi cigaren edhe një a dy herë të tjera, e fiku duke e ngjeshur pas murit dhe u kthye përsëri brenda.

Të paktën tani mund të merrja frymë.

Atë natë, zoti Vahdati më thirri në dhomën e ndenjjes dhe më tha:

- Kam një lajm të ri, Nabi. Do të martohem.

Me sa duket, unë e kisha mbivlerësuar nevojën e tij për vetmi.

Lajmi për fejesën e tij u përhap si era. Dhe po ashtu edhe thashethemet. I dëgjoja nga punëtorët që hynin e dilnin në shtëpinë e zotit Vahdati. Më llafazani nga të gjithë ishte Zahidi, një kopshtar që vinte një herë në tri ditë për të mirëmbajtur lulet e për të krasitur shkurret dhe pemët, një njeri i pakëndshëm, që e kishte zakon të përplaste gjuhën pas çdo fjalie, një gjuhë me të cilën ai i nxirrte thashethemet po aq shpesh sa përdorte plehruesin. Ai ishte pjesë e një grupi punëtorësh të përjetshëm, të cilët, njësoj si unë, punonin në atë lagje si kuzhinierë, kopshtarë, shërbëtorë. Një a dy net në javë, pasi mbaronte dita e punës, ata vinin në shtëpizën time për të pirë çaj pas darkës. Nuk më kujtohet se si nisi ky ritual, por, pasi zuri fill, unë nuk munda ta ndalja më, ca nga frika se mund të dukesha si njeri i ashpër e jo mikpritës, e ca nga më e keqja, se mund të kujtonin që më dukej vetja më lart se të tjerët në çdo drejtim.

Një natë, ndërsa pinim çaj, Zahidi u tha burrave të tjerë se familja e zotit Vahdati nuk e miratonte këtë fejesë për shkak të karakterit të dobët të nuses së ardhshme. Ai tha se në Kabul dihej shumë mirë që ajo nuk kishte as *nang*, as namuz, as nder dhe, edhe pse ishte vetëm njëzet vjeç, "e kishte marrë

mbarë tërë qytetin", njësoj si makina e zotit Vahdati. Më e keqja nga të gjitha, tha ai, ishte se jo vetëm që ajo nuk kishte bërë asnjë përpjekje për t'i mohuar këto thënie, por edhe kishte shkruar poezi për to. Kur ai tha këto, në dhomë u përhap një mërmërimë mosmiratimi. Njëri nga burrat tha se, po të kishte qenë në fshatin e tij, asaj do t'ia kishin prerë gurmazin me kohë.

Tamam në atë çast unë u ngrita në këmbë dhe u bërtita se mjaftonte me kaq. I shava se po merreshin me thashetheme si plakat, kur mblidheshin për të qepur, dhe u kujtova që, po të mos ishte për njerëz si zoti Vahdati, ne të gjithë do të ishim duke mbledhur bajgat e lopës në fshatrat tona. "Ku e keni besnikërinë dhe respektin?" - i pyeta.

Pasoi një çast i shkurtër heshtjeje, gjatë të cilit unë besova se fjalët e mia bënë njëfarë efekti tek ata budallenj, por pastaj shpërthyen të qeshurat. Zahidi më quajti sahanlëpirës dhe shtoi se zonja e re e shtëpisë mbase do të më kushtonte një poezi të titulluar "Ode për Nabin, lëpirësi i shumë sahanëve". Unë dola i zemëruar nga shtëpiza, duke lënë pas një gumëzhimë të qeshurash.

Por nuk shkova shumë larg. Thashethemet e tyre, të them të drejtën, më revoltonin, por edhe më magjepsnin njëherazi. Dhe, pavarësisht se tregohesha i drejtë në sy të tyre, i pagojë e besnik, përsëri i mbaja veshët mprehur. Nuk doja të humbisja as edhe një hollësi të çmuar.

Fejesa zgjati vetëm pak ditë dhe kulmoi jo me një ceremoni madhështore me këngëtarë, valltarë e urime, por thjesht me një vizitë të shkurtër të mullait, të një dëshmitari, dhe me hedhjen e dy firmave në një copë letër. Dhe me këtë, më pak se dy javë pasi unë e kisha parë për herë të parë, zonja Vahdati u shpërngul në këtë shtëpi.

Më lejoni të bëj një ndalesë të shkurtër këtu, zoti Markos, për t'ju thënë se që këtu e tutje unë do ta quaj Nila zonjën

Vahdati. Nuk është nevoja të them se në atë kohë nuk mund ta quaja kështu, dhe nuk do ta kisha bërë këtë, edhe sikur të ma kishin kërkuar. Unë gjithmonë i drejtohesha si *Bibi Sahib*, me respektin që pritej prej meje. Por, në këtë letër, do të heq dorë nga etika dhe do të flas për të ashtu siç kam menduar gjithmonë.

Tani, unë e dija qysh në fillim se ajo nuk ishte një martesë e lumtur. Shumë rrallë mund të shihja ndonjë vështrim të ëmbël të hedhur nga njëri drejt tjetrit ose të dëgjoja të mërmëritej ndonjë fjalë e ndier. Ata ishin dy njerëz që banonin në të njëjtën shtëpi, rrugët e të cilëve dukej se kryqëzoheshin fare rrallë.

Mëngjeseve, unë i shërbeja zotit Vahdati mëngjesin e tij të parapëlqyer: një copë *naan* të thekur, gjysmë gote me arra, çaj jeshil me xhenxhefil e pa sheqer dhe një vezë të zier. Atij i pëlqente që e verdha të derdhej sapo ta shponte vezën, dhe, në fillim, dështimet e mia në këtë drejtim ishin një burim ankthi të vazhdueshëm. Ndërsa shoqëroja zotin Vahdati në shëtitjen e tij të zakonshme mëngjesore, Nila vazhdonte të flinte, ndonjëherë deri në mesditë, e madje edhe më vonë. Kur ajo ngrihej, unë isha bërë gati t'i shërbeja drekën zotit Vahdati.

Gjatë gjithë mëngjesit, ndërsa merresha me detyrat e mia, mezi prisja çastin kur Nila do të hapte derën prej xhami që lidhte dhomën e ndenjjes me verandën. Çdo ditë mendja ime mundohej të përfytyronte se si do të paraqitej ajo. Do ta shihja me flokë të kapur lart apo të mbledhur topuz në zverk, apo thjesht të lëshuar, të derdhur shpinës? Do të kishte vënë syze? Do të kishte mbathur sandale? Do të kishte veshur rrobën e dhomës prej mëndafshi ngjyrëblu me rrip, apo atë në ngjyrë magente me kopsa të mëdha të rrumbullakëta?

Dhe, kur ajo shfaqej më në fund, unë do të gjeja patjetër një punë në kopsht: bëja gjoja sikur pastroja karkasën e makinës ose sikur ujitja ndonjë shkurre, por gjatë gjithë kohës vëzhgoja atë. E shihja kur ngrinte syzet dhe fërkonte sytë ose kur hiqte llastikun nga flokët dhe i jepte kokës pas, duke i lënë kaçurrelat e ndritshëm të valëviteshin lirisht. Dhe e shihja edhe kur

mbështeste mjekrën mbi gjunjë, me sytë ngulur mbi kopsht, duke thithur cigaren fort. Ose kur e vinte njërën këmbë përmbi tjetrën dhe e tundte lart e poshtë, gjest ky që fliste qartë për mërzitinë ose nervozizmin, a, mbase, për mospërfilljen e saj ndaj kësaj jete të re për të.

Ndonjëherë në krah të saj ishte edhe zoti Vahdati, por më shpesh ajo ishte vetëm. Ai vazhdonte t'i kalonte ditët e veta ashtu siç kishte bërë më parë, duke lexuar në dhomën e tij të punës në katin e dytë, duke pikturuar. Rutina e tij nuk kishte ndryshuar aspak nga fakti që ishte martuar. Nila shkruante gjatë gjithë ditës, në verandë ose në dhomën e ndenjjes, me lapsin në dorë, me fletët e letrës të shpërndara në prehër dhe gjithmonë me cigaret pranë. Në mbrëmje u shërbeja darkën, që të dy e hanin në heshtje të plotë, me sytë mbi pjatën me pilaf, qetësi që prishej vetëm nga falënderimet mërmëritëse dhe tingëllima e lugës në pjatat prej porcelani.

Një a dy herë në javë, më duhej ta shoqëroja Nilën për të blerë cigare ose ndonjë komplet të ri stilolapsash, ndonjë bllok të ri shënimesh, gjëra tualeti. Po qe se e dija që më parë se në ç'orë do ta shoqëroja, gjithmonë i krihja flokët dhe laja dhëmbët. Laja fytyrën, lyeja gishtat e duarve me limon për të hequr erën e qepës, pastroja kostumin nga pluhuri dhe lustroja këpucët. Kostumin ngjyrë ulliri ma kishte dhënë zoti Vahdati nga të vetët dhe unë shpresoja që ai të mos ia kishte thënë këtë edhe Nilës, ndonëse druaja se duhej ta kishte bërë. Jo nga keqdashja, jo, por se njerëzit në pozitën e zotit Vahdati ndonjëherë nuk arrijnë ta kuptojnë se si edhe gjëra të tilla kaq të vogla e të parëndësishme mund ta turpërojnë një burrë si puna ime. Ndonjëherë, unë vija në kokë edhe kapën prej lëkure qengji që kishte qenë e të ndjerit tim atë. Atëherë qëndroja përpara pasqyrës, me kapën në dorë, duke e vënë sa në njërën anë të kokës në tjetrën, krejtësisht i përthithur nga ideja që të shfaqesha i paraqitshëm përpara Nilës, saqë, edhe po të më ulej një grerë në majën e hundës, nuk do ta kisha vënë re që ishte aty, po të mos ma ngulte thumbin.

Me t'u nisur me makinë, unë filloja të vrisja mendjen se si mund ta zgjatja sadopak rrugën, mbase një a dy minuta - por jo më shumë, se asaj mund t'i lindnin dyshime - duke zgjatur kështu edhe kohën e qëndrimit pranë saj. I mbaja të dyja duart të shtrënguara fort në timon dhe sytë të ngulur te rruga. Ushtroja mbi veten një vetëkontroll të rreptë dhe nuk e shihja kurrë përmes pasqyrës së shoferit, përveçse kur ajo vetë më drejtohej. Unë kënaqesha thjesht me praninë e saj në ndenjësen e pasme, kënaqesha duke thithur tok me ajrin edhe aromat e saj: sapun i shtrenjtë; parfum, çamçakëz, tym cigareje. E gjitha kjo, në pjesën më të madhe të ditëve, ishte më se e mjaftueshme që shpirti im të bëhej me flatra.

Pikërisht në makinë bëmë edhe bisedën tonë të parë. Bisedën tonë të parë të vërtetë, pra, pa marrë parasysh ato mijëra herë kur ajo më kishte kërkuar t'i sillja aksh gjë ose të mbaja atë tjetrën. Po e çoja në farmaci për të blerë barna dhe ajo më tha:

- Si është fshati yt, Nabi? Si quhet? Ma thuaj edhe një herë.

- Shadbag, *Bibi Sahib*.

- Po, Shadbag. E si është ai? Më trego.

- Nuk është se ka shumë gjëra për të thënë për të, *Bibi Sahib*. Është një fshat si gjithë të tjerët.

- Oh, pa dyshim që do të ketë diçka të veçantë!

Në pamje ruajta gjakftohtësinë, por përbrenda po vloja me dalldi, duke bluar gjithë dëshpërim me mendje për të gjetur diçka të veçantë, ndonjë gjë të çuditshme të vlefshme, që mund t'i bënte përshtypje asaj, që mund ta argëtonte. Por ishte e pamundur. E çfarë mund të thoshte një burrë si puna ime, një fshatar, një njeri i vockël me një jetë të vockël, që të tërhiqte vëmendjen e të argëtonte një grua si ajo?!

- Rrushi është i shkëlqyer, - thashë dhe, me të më dalë ato fjalë nga goja, më erdhi t'ia futja vetes me shuplakë fytyrës. "Rrushi?!"

- Vërtet? - tha ajo me zë të thatë.

- Është shumë i ëmbël.

- Ah!

Përbrenda po vdisja me mijëra herë. Sqetullat po më njomeshin nga djersa.

- Aty rritet një rrush shumë i veçantë, - nxora më në fund nga një gojë thuajse e tharë plotësisht. - Thonë se rritet vetëm në Shadbag. Është shumë i brishtë, e kuptoni? Po qe se do të përpiqeshin ta kultivonin në një fshat tjetër, për shembull në fshatin fqinjë, do të thahej plotësisht. Do të zhdukej. Do të thahej nga dëshpërimi, thonë njerëzit e Shadbagut, por, sigurisht, kjo s'është e vërtetë. Thjesht ka të bëjë dheu dhe uji. Por kështu thonë ata, *Bibi Sahib*. Nga dëshpërimi.

- Kjo është vërtet gjë e këndshme, Nabi.

Unë i hodha një vështrim të shpejtë nga pasqyra e shoferit dhe vura re se po shihte tej dritares, por vura re gjithashtu, për lehtësimin tim, se cepat e buzëve i ishin harkuar lart, me një hije buzëqeshjeje. Duke marrë zemër tani, e dëgjova veten të thoshte:

- A mund t'ju rrëfej një tjetër histori, *Bibi Sahib*?

- Patjetër.

Çakmaku kërciti dhe tymi i duhanit u valëvit drejt meje.

- E po, në Shadbag kemi një mulla. Të gjithë fshatrat kanë, në fakt, mullain e tyre. Ky yni quhet Mulla Shekibi dhe nuk i shterojnë kurrë historitë. Nuk jua them dot se sa shumë di. Por një gjë na e përsëriste gjithmonë: po të studioni pëllëmbën e dorës të një myslimani, pavarësisht se ku gjendet në këtë botë, do të vini re diçka vërtet të habitshme: të gjithë kanë të njëjtat vija. Që do të thotë? Që do të thotë se vijat në pëllëmbën e majtë të një myslimani formojnë numrin arab tetëdhjetëenjë dhe ato në dorën e djathtë, numrin tetëmbëdhjetë. Hiqni tetëmbëdhjetën nga tetëdhjetëenjëshi dhe çfarë ju del? Ju del gjashtëdhjetë e tre. Mosha e Profetit kur vdiq, u prehtë në paqe! - Në ndenjësen e pasme u dëgjua një e qeshur e lehtë. - E po, një ditë, një udhëtar erdhi në fshat dhe atë natë e hëngri darkën tok me Mulla Shekibin, siç edhe është zakoni.

Udhëtari e dëgjoi këtë histori, po mendohej e pastaj tha: "Por, mulla Shekib, me gjithë respektin që kam, një herë kam takuar një çifut dhe të betohem që kishte të njëjtat vija në pëllëmbën e dorës. Si e shpjegoni ju këtë?" Dhe mullai iu përgjigj: "Domethënë që ai çifut ishte mysliman në shpirt".

Ajo shpërtheu papritur në të qeshura, që më lanë si të magjepsur gjatë gjithë pjesës tjetër të ditës. Zoti më faltë për këtë blasfemi, por ishte njësoj sikur vetë kopshti i parajsës të kishte zbritur në tokë, kopshti i së drejtës, siç thotë Libri i Shenjtë, nën të cilin rrjedhin vazhdimisht lumenj dhe drurët e hijet brenda tij janë të përjetshëm.

Duhet ta kuptoni që nuk ishte vetëm bukuria e saj, zoti Markos, që më magjepste në këtë mënyrë, edhe pse vetëm kjo mjaftonte për të më trullosur. Në jetën time, unë nuk kisha ndeshur kurrë një grua si Nila. Çdo gjë që bënte ajo: mënyra se si fliste, mënyra se si ecte, si vishej, si buzëqeshte, ishte krejt e panjohur për mua. Nila kishte rrënuar çdo lloj ideje që kisha pasur unë deri në ato çaste për mënyrën se si duhej të sillej një grua, një tipar dallues ky që ndeshte në mosmiratimin e njerëzve si puna e Zahibit dhe, pa dyshim, edhe të atyre si Sabori, por dhe të çdo burri tjetër në fshat, madje edhe të të gjitha grave; por për mua kjo i shtohej shkëlqimit dhe misterit të saj.

Dhe kështu, e qeshura e saj vazhdoi të tingëllonte në veshët e mi gjatë gjithë ditës, ndërsa vijova të merresha me punët e zakonshme, por edhe më vonë, kur punëtorët erdhën në shtëpizën time për çajin e përditshëm. Unë e mbaja vazhdimisht buzën në gaz, kakarisjet e tyre mbyteshin në veshët e mi nga gurgullima e ëmbël e së qeshurës së saj. Dhe tani ndihesha krenar që historia ime e mençur kishte dhuruar pak ngazëllim në atë martesë të palumtur. Ajo ishte një grua e ja-shtëzakonshme dhe atë natë unë u shtriva në shtrat duke u ndier një njeri diçka më shumë se i zakonshëm. Ky ishte efekti që bënte ajo tek unë.

Shumë shpejt, unë dhe Nila nisëm të bisedonim çdo ditë, zakonisht vonë në mëngjes, ndërsa ajo rrufiste kafen në verandë. Unë vazhdimisht do të gjeja një pretekst a ndonjë tjetër dhe ja tek isha, i mbështetur mbi një lopatë ose me një filxhan çaji jeshil në dorë, duke biseduar me të. Ndihesha i privilegjuar që ajo më kishte zgjedhur mua. Unë nuk isha i vetmi shërbyes aty; aty ishte edhe ai Zahidi i pështirë e i paskrupullt që jua përmenda më parë, dhe një grua *hazara*[1] me fytyrën tërë pala, që vinte dy herë në javë për të larë teshat. Por ajo m'u drejtua mua. Unë isha i vetmi, besoja unë - përfshi edhe burrin e saj - që mund t'ia largoja asaj ndjenjën e vetmisë. Zakonisht ishte ajo që fliste, çka mua më shkonte shumë për shtat; isha mjaft i lumtur që të isha unë ena ku ajo derdhte të gjitha rrëfimet e veta. Ajo më tregoi, për shembull, se si njëherë kishte dalë për gjah me të atin në Jalalabad dhe për net me radhë e kishin përndjekur në gjumë makthet me drerë të ngordhur, me sy të qelqtë. Më tregoi se, kur kishte qenë fëmijë, përpara Luftës së dytë Botërore, kishte qenë tok me të ëmën në Francë. Atje kishin shkuar edhe me tren, edhe me anije. Ajo më përshkroi se si i kishte ndier kërcimet e trenit mbi shina në brinjët e saj. Dhe i kujtoheshin edhe perdet e varura nëpër litarë, që ndanin kompartimentet nga njëri-tjetri, si dhe shfryrja e fishkëllima ritmike e lokomotivës me avull. Më tregoi edhe për ato gjashtë javë që kishte kaluar një vit më parë në Indi, bashkë me të atin, kur kishte qenë shumë e sëmurë.

Herë pas here, kur ajo fikte cigaren në taketuke, unë i hidhja një vështrim të shpejtë vjedhurazi thonjve të saj të lyer me manikyr të kuq, shkëlqimit të florinjtë të kaviljeve të saj të pastra, harkimit të lartë të kurrizit të këmbës, pa harruar asnjëherë gjinjtë e saj të plotë e me formë të përkryer. Dhe vazhdimisht më mrekullonte ideja që burrat e kësaj bote kishin

---

1) Populisi që flet persisht, e vendosur kryesisht në Afganistanin Qendror (*shën. i përkth.*).

pasur mundësinë t'i preknin e t'i puthnin ata gjinj, ndërsa bënin dashuri me të. E ç'mbetej tjetër për t'u bërë në jetë, pasi e kishe bërë këtë?! E ku mund të shkonte tjetër një burrë, pasi kishte qenë një herë në majë të botës? Dhe vetëm me një vullnet të fortë arrija t'i largoja sytë prej saj, kur kthehej me fytyrë nga unë.

Ndërsa ndihej gjithmonë e më rehat në praninë time, në ato biseda mëngjesore ajo nisi të përfshinte edhe ankesat e saj për zotin Vahdati. Një ditë më tha se e konsideronte të ftohtë dhe arrogant.

- Me mua ka qenë shumë bujar, - i thashë unë.

Ajo përplasi njërën dorë në shenjë mohimi.

- Nabi, të lutem! S'është nevoja ta thuash këtë.

Me mirësjellje, unë ula sytë poshtë. Kjo që po thoshte ajo, nuk ishte plotësisht e pavërtetë. Zoti Vahdati e kishte zakon, për shembull, që të më korrigjonte mua mënyrën e të folurit me një pamje epërsie, që mund edhe të interpretohej, ndoshta edhe me të drejtë, si arrogancë. Ndonjëherë unë hyja në dhomën e tij, i vija një pjatë me ëmbëlsira përpara, i çoja një çajnik tjetër me çaj, pastroja tryezën nga thërrimet dhe prania ime aty nuk i bënte atij më shumë përshtypje se ajo e një mize mbi derën prej xhami; duke mos më hedhur as sytë, ai më tregonte se sa i parëndësishëm isha. Në fund të fundit, mendoja unë, kjo ishte veç një e metë e parëndësishme, sepse unë njihja njerëz në atë lagje, njerëz për të cilët kisha punuar, që i rrihnin shërbyesit e tyre me kamxhik e me rrip.

- Ai nuk e ka fare ndjenjën e argëtimit a të aventurës, - tha ajo, duke lëvizur në karrige me nervozizëm. - Sulejmani është një plak i mërzitshëm, i futur në trupin e një të riu.

Mbeta paksa pa mend nga ky përcaktim i saj.

- Është e vërtetë që zoti Vahdati e gjen kënaqësinë e vet më të madhe te vetmia, - thashë unë, duke u përpjekur që të sillesha me kujdes e me diplomaci.

- Mbase duhet të jetojë me të ëmën. Si thua, Nabi? Ata shkojnë shumë me njëri-tjetrin dhe kjo është më se e sigurt.

E ëma e zotit Vahdati ishte një grua pompoze dhe hijerëndë, që jetonte në një tjetër pjesë të qytetit, me shërbyesit e vet të përhershëm dhe dy qentë e vet të dashur. Ajo i përkëdhelte qentë vazhdimisht dhe i trajtonte si më superiorë se shërbëtorët e vet, madje si shumë rangje më lart se ata. Ata ishin dy krijesa të vogla të neveritshme, pa qime, që trembeshin edhe nga bishti i vet e kishin një të lehur që të shponte veshët. Mua për vete nuk më pëlqenin aspak, sepse, sapo vija këmbën në atë shtëpi, ata kërcenin mbi këmbët e mia dhe mundoheshin të ngjiteshin nëpër to si torollakë.

E kisha vënë re mjaft mirë tashmë se, sa herë që i shoqëroja Nilën dhe zotin Vahdati për tek ajo grua, te ndenjësja e pasme e makinës ndehej tensioni; balli i ngrysur i Nilës më linte të kuptoja se ata ishin zënë për këtë. Më kujtohet se, kur prindërit e mi ziheshin, asnjëri nuk lëshonte pe, derisa njëri prej tyre të shpallej fitimtar. Dhe unë e kisha kuptuar se kjo ishte mënyra e tyre për t'u dhënë fund gjërave të pakëndshme, për t'u vënë një vulë që do t'i mbyllte përgjithmonë e nuk do t'i lejonte të mbarteshin në normalitetin e së nesërmes. Por nuk ndodhte kështu me Vahdatët. Zënkat e tyre nuk kishin një përfundim, ato shpërhapeshin, ashtu siç shpërhapet një pikë bojë në ujë, duke lënë gjithmonë një njollë të dukshme.

Nuk duhej ndonjë zgjuarsi e madhe që të kuptoje se gruaja plakë nuk e kishte miratuar atë martesë, dhe se Nila e dinte.

E ndërsa vazhdonim me bisedat tona, unë me Nilën, një pyetje më trokiste vazhdimisht e vazhdimisht në kokë: Pse ishte martuar me zotin Vahdati? Por më mungonte guximi për t'ia thënë me zë të lartë. Një kapërcim i tillë i asaj që më takonte, nuk ishte në natyrën time. I vetmi shpjegim që arrija të jepja, ishte se, për disa njerëz, e në mënyrë të veçantë për gratë, një martesë, qoftë edhe një martesë e keqe si kjo, ishte një arratisje nga një e keqe më e madhe.

Një ditë, në vjeshtën e vitit 1950, Nila më thirri.

- Dua të më marrësh edhe mua me vete në Shadbag, - më kërkoi ajo. Ajo tha se donte të takonte familjen time, të shihte

vendin nga vija unë. Më tha se ishte bërë viti që i shërbeja vaktet e ditës dhe e shoqëroja me makinë nëpër Kabul, dhe ajo nuk dinte asgjë për mua. Kërkesa e saj më çoroditi, sepse, të them të drejtën, nuk ishte gjë e zakontë që një grua e rangut të saj të kërkonte të njihej me familjen e një shërbëtori. Por po në të njëjtën masë edhe u mbusha me shpresa të reja, aq sa m'u shtua ankthi – e njëherazi edhe turpi, po – që do të më duhej t'i tregoja asaj varfërinë në të cilën kisha lindur.

U nisëm një mëngjes. Ajo kishte mbathur këpucë me taka të larta dhe kishte veshur një fustan ngjyrë pjeshke pa mëngë, por nuk m'u duk se më takonte mua t'i thosha se kjo nuk ishte veshja e përshtatshme. Rrugës, ajo më pyeti për fshatin, për njerëzit që njihja, për time motër e Saborin, për fëmijët e tyre.

- Më thuaj si quhen.

- E po, - i thashë unë, - njëri është Abdullai, thuajse nëntë vjeç. E ëma vdiq vitin e kaluar, kështu që ai është thjeshtri i sime motre, Parvanës. Motra e tij, Pahri, po bëhet dy vjeç. Parvana lindi një djalë dimrin e shkuar, Omar e quajtën, por ai vdiq kur ishte dyjavësh.

- Çfarë ndodhi?

- Dimri, *Bibi Sahib*. Ai zbret mbi këto fshatra dhe merr një a dy fëmijë çdo vit. E vetmja gjë që mund të bësh, është të shpresosh të mos trokasë në derën tënde.

- O Zot! - mërmëriti ajo.

- Por lajmi i mirë, - vazhdova unë, - është se ime motër pret një fëmijë tjetër.

Në fshat na mikpriti si zakonisht turma e fëmijëve këmbëzbathur, që nisën të rendnin pas makinës, edhe pse në çastin kur Nila doli nga ndenjësja e pasme, ata bënë disa hapa pas dhe heshtën në çast, mbase nga frika se ajo mund t'u bërtiste. Por Nila u tregua mjaft e duruar dhe e dashur. Ajo u përkul mbi ta dhe u buzëqeshi, i foli secilit prej tyre, u toku duart, u përkëdheli faqet dhe flokët e palarë. Për turpin tim, njerëzit po mblidheshin për ta parë. Aty ishte edhe Bejtullai,

një shok fëmijërie imi, ngjitur në çatinë e shtëpisë së vet, duke krokatur si korbat tok me të vëllezërit e duke përtypur duhan *nasvar*. Dhe ja tek ishte edhe i ati, Mulla Shekibi dhe tre burra të tjerë mjekërbardhë, të ulur nën hijen e një muri, duke numëruar gjithë nervozizëm tespihet, me sytë e pamoshë të ngulur mbi Nilën dhe krahët e saj të zhveshur.

Unë e paraqita Nilën me Saborin dhe hymë në shtëpinë e tij prej qerpiçi, të ndjekur pas nga dhjetëra sy. Te dera, Nila nguli këmbë që t'i hiqte këpucët, edhe pse Sabori i tha se nuk ishte e nevojshme. Kur hymë në dhomën e ndenjjes, pashë Parvanën të mbledhur kutullaç në një cep, në një pozicion që e bënte të dukej si një top i madh. Ajo e përshëndeti Nilën me një zë që i doli si pëshpërimë.

Sabori lëvizi vetullat në drejtim të Abdullait:

- Na sill çajin, djalë.

- Oh, jo, ju lutem! - tha Nila, duke u ulur në dysheme pranë Parvanës. - Nuk është nevoja.

Por Abdullai ishte zhdukur ndërkaq në të ndarën fqinjë, që funksiononte njëherazi si kuzhinë dhe si dhomë gjumi për atë dhe Pahrin. Një mushama e patejdukshme e ndante atë nga dhoma ku ishim ulur të gjithë. U ula edhe unë, duke vërvitur çelësat e makinës ndër gishta, me dëshirën që të më ishte dhënë mundësia ta lajmëroja time motër për këtë vizitë, që t'i kisha dhënë sadopak kohë për të pastruar disi. Muret e plasaritura prej qerpiçi ishin gjithë njolla të zeza, dysheku i grisur ku ishte ulur Nila, ishte gjithë pluhur, e vetmja dritare në dhomë ishte gjithë të ndotura mizash.

- Ky qenka qilim shumë i bukur! - tha Nila me zë të ëmbël, duke e ledhatuar qilimin me gishta. Ishte një qilim në ngjyrë të kuqe të ndritshme, me motive gjurmësh elefanti. Ishte e vetmja gjë me njëfarë vlere në shtëpinë e Saborit e të Parvanës, që mund të shitej, siç rezultoi më vonë atë dimër.

- Ka qenë i babait tim, - tha Sabori.

- Është qilim turkmen?

- Po.

- E adhuroj leshin e deles që përdorin ata. Bëjnë një punim dore të jashtëzakonshëm.

Sabori pohoi me kokë. Ai nuk shihte nga ajo as edhe kur fliste me të.

Mushamaja u hap dhe Abdullai hyri me një tabaka me filxhanë çaji dhe e vendosi atë në tokë përpara Nilës. I mbushi asaj një filxhan me çaj dhe u ul këmbëkryq në anën tjetër. Nila u mundua t'i fliste, ta afronte me disa pyetje të thjeshta, por Abdullai vetëm pohonte me kokën e vet të rruar dhe e shihte gjithë mosbesim. Unë mendova me vete se nuk duhej të harroja t'i flisja djalit me të butë e ta këshilloja për mënyrën se si duhej të sillej. Do ta bëja këtë miqësisht, sepse më pëlqente ai djalë, me atë natyrë serioze e të matur që kishte.

- Sa muajshe je? - e pyeti Nila Parvanën.

Kokulur, ime motër iu përgjigj se foshnja pritej të lindte në dimër.

- Ti je e bekuar, - i tha Nila. - Që pret një fëmijë. Dhe që ke një thjeshtër kaq të edukuar. - Ajo i buzëqeshi Abdullait, fytyra e të cilit mbeti përsëri pa shprehje.

Parvana mërmëriti diçka nëpër dhëmbë, mbase po e falënderonte.

- Dhe keni edhe një vajzë të vogël, nëse më kujtohet mirë? - tha Nila. - Pahri?

- Ajo po fle, - tha prerazi Abdullai.

- Ah, kam dëgjuar se është shumë e dashur.

- Shko zgjoje motrën, - i tha Sabori.

Abdullai u mëdysh, duke parë sa të atin, sa Nilën, por pastaj u ngrit në këmbë, dukshëm gjithë ngurrim, dhe doli, të sillte të motrën.

Po të doja tani, edhe në këtë orë të vonë, që të qetësoja deri diku ndërgjegjen time, do të thosha se lidhja ndërmjet Abdullait dhe së motrës ishte më se e zakonshme. Por nuk ishte aspak e tillë. Vetëm Zoti e di pse ata të dy kishin zgjedhur njëri-tjetrin. Ishte mister. Unë nuk kam parë kurrë një lidhje të tillë mes dy qeniesh njerëzore. Të them të drejtën, Abdullai

ishte për Pahrin po aq baba sa edhe vëlla. Kur ajo ishte foshnjë dhe qante natën, ishte Abdullai ai që zgjohej dhe e merrte në krahë për ta qetësuar. Ishte ai që ia ndërronte pelenat e ndotura, që e ushqente, që e përkundte për ta vënë në gjumë. Durimi i tij me të ishte i pashtershëm. Ai e nxirrte shëtitje nëpër fshat, duke ua treguar të gjithëve, sikur ajo të ishte trofeu më me vlerë në botë.

Kur Abdullai solli në dhomë një Pahri ende të përgjumur, Nila i kërkoi që ta merrte në krahët e saj. Abdullai ia zgjati me një vështrim shpues gjithë mosbesim, sikur sapo të ishte aktivizuar brenda tij një alarm instinktiv.

- Oh, sa e mirë që qenka! - tha Nila, ndërsa lëvizjet e çuditshme që bëri, dëshmuan qartë mungesën e përvojës me fëmijët e vegjël. Pahri shihte e hutuar sa Nilën, sa Abdullain dhe nisi të qante. Dhe ky ia mori menjëherë Nilës nga krahët.

- Pa shih çfarë sysh! - tha Nila. - Oh, dhe këto faqe! A nuk është fëmijë i bukur, Nabi?

- Po, *Bibi Sahib*, ashtu është, - i thashë unë.

- Dhe i kanë vënë tamam emrin që i shkon: Pahri. Si zanë e vogël qenka, vërtet.

Abdullai nuk po ia ndante sytë Nilës, duke e shtrënguar Pahrin më fort në krahë, ndërsa fytyra erdhi duke iu ngrysur.

Ndërsa ktheheshim në Kabul, Nila u struk në ndenjësen e pasme me kokën të mbështetur pas xhamit të dritares. Për një kohë të gjatë nuk tha asnjë fjalë. Dhe pastaj, befas, nisi të qante.

Unë e ndala makinën në anë të rrugës.

Ajo përsëri nuk foli për një kohë të gjatë. Supet i dridheshin, teksa dëneste me fytyrën të mbuluar me duar. Më në fund, fshiu hundët me shami.

- Falemnderit, Nabi, - tha.

- Për çfarë, *Bibi Sahib*?

- Që më solle këtu. Ishte privilegj për mua që njoha familjen tënde.

- Privilegji ishte i tyre. Dhe imi. Na nderove.

- Fëmijët e motrës sate janë të mrekullueshëm. - Ajo hoqi syzet e diellit dhe fshiu sytë.

Nisa të vrisja mendjen se çfarë duhet të bëja; në fillim mendova se mbase ishte më mirë të mos thosha asgjë. Por ajo kishte qarë në praninë time dhe në një çast kaq intim unë besoja se duhej të thosha ndonjë fjalë të ëmbël. Me zë të butë i thashë:

- Së shpejti do të kesh edhe ti fëmijët e tu, *Bibi Sahib*. *Inshallah* Zoti ta plotëson dëshirën. Duhet të presësh.

- Nuk besoj se ka për ta bërë. Edhe ai nuk e bën dot këtë.

- Sigurisht që Zoti e bën, *Bibi Sahib*. Ti je shumë e re. Po qe se do ai, është e mundur.

- Ti nuk e kupton, - tha ajo me zë të lodhur. Nuk e kisha parë kurrë aq të dorëzuar, aq të shteruar. - Është e pamundur. M'i kanë hequr të gjitha në Indi. Unë jam bosh përbrenda.

Nuk dita ç't'i thosha pas kësaj. Mendova të kaloja në ndenjësen e pasme për ta shtrënguar fort në krahë e për ta ngushëlluar me puthje. Dhe përpara se ta kuptoja edhe vetë se çfarë po bëja, isha ulur aty dhe ia kisha marrë dorën në dorën time. Mendova se ajo do ta largonte dorën nga imja, por gishtat e saj nisën të përkëdhelnin të mitë me mirënjohje dhe ne vazhduam të qëndronim të ulur aty në makinë, pa e vështruar njëri-tjetrin, por pllajat përreth nesh, të verdha e të përzhitura nga njëri horizont në tjetrin, të përshkuara nga kanalet e thara ujitëse, të ndërprera nga shkëmbinjtë, gëmushat e ca gjurmë jete aty-këtu. Me dorën e Nilës në timen, shihja kodrat dhe shtyllat elektrike. Sytë më zunë një kamion, që po ecte larg nesh, i ndjekur pas nga një re pluhuri. Dhe do të kisha dashur me gjithë shpirt të qëndroja aty, ashtu i ulur, deri në mbrëmje.

- Më ço në shtëpi, - tha ajo më në fund, duke e larguar dorën prej times. - Do të kthehem herët sonte.

- Po, *Bibi Sahib*. - Unë qërova fytin dhe e vura makinën në lëvizje me duart që më dridheshin.

Ajo hyri në dhomën e vet dhe nuk doli prej aty për ditë me radhë. Nuk ishte hera e parë që e bënte këtë. Herë pas here afronte një karrige pranë dritares së dhomës së saj të gjumit në katin e dytë dhe ngulej aty për orë të tëra, duke pirë cigare, duke tundur këmbën hedhur mbi këmbën tjetër, me sytë përtej dritares, me një fytyrë pa shprehje. Nuk thoshte asnjë fjalë. Qëndronte me këmishë nate. Nuk lahej, nuk krihej, nuk i lante dhëmbët. Edhe këtë herë as nuk po hante, dhe pikërisht kjo shkaktoi një alarm të pazakontë te zoti Vahdati.

Ditën e katërt trokitën te porta. E hapa dhe përpara syve më doli një burrë plak shtatlartë, me një kostum të ngrirë e me këpucë lustrafine. Kishte diçka imponuese në pamjen e tij, diçka kërcënuese, urdhëruese: mënyra se si m'i nguli sytë, si po e mbante bastunin e ndritshëm si të ishte spektër. Ai nuk kishte thënë ende asnjë fjalë, por unë e ndieva se ishte nga ata njerëz që ishin mësuar të jepnin urdhra.

- Mora vesh se ime bijë nuk është mirë, - tha ai.

Pra, ky ishte i ati. Unë nuk e kisha parë kurrë më parë.

- Po, *Sahib*, druaj se kështu është, - iu përgjigja unë.

- Atëherë më hap rrugën, djalosh, - ai kaloi anash meje.

Në kopsht, unë i gjeta punë vetes duke çarë drutë e zjarrit. Prej aty ku po qëndroja, kisha një pamje të plotë të dritares së dhomës së gjumit të Nilës. Prej aty arrija të shihja të atin, të përkulur mbi Nilën, me njërën dorë mbi supin e saj. Fytyra e Nilës kishte marrë një pamje si ajo e njerëzve që papritur kanë dëgjuar një zhurmë të fuqishme: një fishekzjarr që shpërthen papritur ose një derë e përplasur fort nga era.

Atë mbrëmje, ajo hëngri më në fund.

Pak ditë më vonë, Nila më thirri e më tha se do të organizonte një festë. Kur zoti Vahdati jetonte vetëm në këtë shtëpi, rrallë bëhej ndonjë festë, për të mos thënë asnjëherë. Por, pasi Nila erdhi të jetonte aty, ajo nisi të organizonte dy a tri festa në muaj. Një ditë përpara, Nila më shpjegonte deri në hollësi se çfarë pijesh duhej të nxirreshin e çfarë ushqimesh do të përgatiteshin, dhe unë shkoja me makinë në treg për të

blerë gjërat që duheshin. Dhe më kryesorja ndër këto gjëra ishin pijet alkolike, që nuk i kisha blerë kurrë më parë, sepse zoti Vahdati nuk pinte, edhe pse kjo nuk kishte aspak të bënte me besimin fetar, por me faktin e thjeshtë se ai nuk i pëlqente efektet e alkolit. Kurse Nila i njihte mjaft mirë të tilla vende, që me shaka i quante "farmaci", ku një shishe "ilaç" kushtonte sa gjysma e rrogës që merrja unë në muaj. Unë e kryeja këtë detyrë gjithë dyshim, duke e konsideruar veten si një njeri që ndihmonte në mëkat, por fakti që po i bindesha Nilës, sundonte mbi gjithçka tjetër.

Duhet ta kuptoni, zoti Markos, se, kur ne bënim festa në Shadbag, qoftë për dasma, qoftë për synete, gratë festonin në një dhomë e burrat në një tjetër. Kurse në festat e Nilës burra e gra mblidheshin në të njëjtin mjedis. Shumica e grave visheshin njësoj si Nila, me fustane që ua linin plotësisht zbuluar krahët në të gjithë gjatësinë e tyre e po ashtu edhe një pjesë të mirë të këmbëve. Ato pinin duhan, alkol po ashtu, me gota me likere pa ngjyrë, me ngjyrë të kuqe ose bakri, rrëfenin anekdota e i ceknin pa kurrfarë druajtje krahët e burrave që - unë e dija mirë - ishin të martuar me dikë tjetër që ndodhej në atë dhomë. Unë shërbeja pjata të vogla me *bolani*[1] dhe *lola kabob*[2] nga njëri cep i dhomës së mbushur me tym duhani në tjetrin, nga një grup të ftuarish tek tjetri, ndërsa dëgjohej muzika e gramafonit. Muzika nuk ishte afgane, por diçka që Nila e quante xhaz, një lloj muzike që, siç mësova disa dhjetëvjetësha më vonë, ju pëlqente edhe juve, zoti Markos. Veshit tim, tingujt e pianos dhe rënkimi i çuditshëm i veglave frymore i dukej si një përzierje aspak harmonike. Por Nila e pëlqente dhe unë e dëgjoja vazhdimisht, teksa u thoshte të ftuarve se duhej të dëgjonin këtë disk ose atë tjetrin. Gjatë gjithë natës ishte me gotë në dorë dhe e kthente atë shumë më shpesh sesa hante nga ushqimi që shërbeja unë.

---

1) Pite Afganistani të mbushura me perime (*shën. i përkth.*).

2) Qofte stërgjatëshe Afganistani (*shën. i përkth.*).

Zoti Vahdati nuk para përzihej me të ftuarit. Ai i takonte të gjithë, por pjesën më të madhe të kohës qëndronte në një kënd të dhomës, me një fytyrë pa shprehje, me një gotë me ujë të gazuar në dorë, duke ua kthyer buzëqeshjen gjithë mirësjellje e me buzë të mbyllura njerëzve që i flisnin. Dhe, siç e kishte bërë zakon, gjithmonë kërkonte leje për t'u larguar andej, kur Nila niste të recitonte poezitë e veta.

Kjo ishte pjesa ime më e parapëlqyer gjatë gjithë festës. Kur ajo fillonte, unë gjithmonë do të gjeja mundësi që të merresha me diçka që do të më lejonte të qëndroja aty pranë. Dhe ja tek isha, i ngrirë në atë vend, me pecetën në dorë, duke i mprehur veshët mirë për të dëgjuar. Poezitë e Nilës nuk u ngjanin aspak poezive me të cilat isha rritur unë. Siç e dini edhe ju, ne afganët i duam shumë poezitë tona; edhe njeriu më i paarsimuar është në gjendje që të recitojë vargje të Hafezit, Khajamit ose Saadiut. A ju kujtohet, zoti Markos, kur më thatë, vitin e shkuar, se sa shumë i donit afganët? Kurse unë ju pyeta pse e ju qeshët e ma kthyet: "Sepse edhe pikturat tuaja në grafit janë vargje të Rumiut nëpër mure".

Por poezitë e Nilës nuk kishin asnjë lidhje me traditën. Ato nuk ruanin as gjatësinë karakteristike të vargut e as veçoritë e rimës. Dhe as nuk u këndonin gjërave tradicionale: pemëve, luleve pranverore, bilbilave. Nila shkruante për dashurinë, dhe me dashuri unë nuk e kam fjalën për lëngimet platonike të Rumiut a të Hafezit, por për dashurinë fizike. Ajo shkruante për pështërimat e të dashuruarve në jastëkë, ndërsa preknin njëri-tjetrin. Shkruante për kënaqësinë fizike. Unë kurrë nuk kisha dëgjuar fjalë të atilla të nxjerra nga goja e një gruaje. Qëndroja aty, duke dëgjuar zërin e Nilës, që mezi vinte deri në korridor, me sy të mbyllur e veshët të skuqur që më përvëlonin, duke përfytyruar sikur ajo po m'i lexonte mua ato gjëra, sikur ne të dy ishim të dashuruarit e asaj poezie, derisa dikush më thërriste për të shërbyer çajin ose derisa skuqja e vezëve ta prishte magjinë dhe Nila të më thërriste në emër e unë të vrapoja drejt saj.

Atë natë, poezia që kishte vendosur të lexonte, më kapi të pambrojtur. Ishte për një burrë e një grua, në një fshat, që po mbanin zi për foshnjën që u kishte marrë dimri i acartë. U duk se të ftuarve u pëlqeu poezia, po të nisem nga mërmërimat e pohimet miratuese me kokë dhe nga duartrokitjet e ndiera, kur Nila ngriti kokën nga fleta. E prapë mbeta i habitur e paksa i zhgënjyer që fatkeqësia e sime motre ishte përdorur në këtë mënyrë për të argëtuar të ftuarit dhe po më shqetësonte ndjesia e vagët se ishte kryer një lloj tradhtie.

Disa ditë pas festës, Nila më tha se i duhej një çantë e re. Zoti Vahdati po lexonte gazetën në tryezë, ku i kisha shërbyer drekën: *naan* dhe thjerrëza.

- Po ty, Sulejman, të duhet ndonjë gjë? - e pyeti Nila.

- Jo, *aziz*, falemnderit, - tha ai. Rrallë e kisha dëgjuar që t'i drejtohej asaj *aziz*, që do të thotë "e dashur", e prapë ky çift nuk më ishte dukur më shumë i largët, sesa në çastin kur ai e tha këtë, dhe kjo fjalë përkëdhelëse nuk më ishte dukur kurrë më e ftohtë, sesa e shqiptuar nga buzët e tij.

Rrugës për në dyqan, Nila më tha se donte të merrte edhe një shoqe, dhe më udhëzoi se si ta çoja në shtëpinë e saj. Parkova ndanë rrugës dhe e pashë të hynte në një shtëpi dykatëshe me mure ngjyrërozë. Në fillim e lashë motorin të ndezur, por, pasi kaluan pesë minuta dhe Nila nuk po kthehej, e fika. Bëra gjënë e duhur, sepse kaluan dy orë, derisa e pashë përsëri siluetën e saj të hajthme të dilte nga dera e të drejtohej për te makina. Ia hapa derën e pasme dhe, ndërsa ajo rrëshqiste në ndenjëse, unë nuhata një tjetër aromë, përveç asaj të parfumit të saj: një aromë të dobët dru cedri ose xhenxhefili, një aromë që e njoha, sepse e kisha ndier në festën e dy netëve më parë.

- Nuk gjeta asgjë që të më pëlqente, - tha Nila që nga ndenjësja e pasme, ndërsa lyente sërish buzët.

Ajo e vuri re fytyrën time të habitur në pasqyrën e shoferit. E uli buzëkuqin dhe m'i nguli sytë fort nën qerpikë.

- Ti më çove në dy dyqane të ndryshme, megjithatë unë nuk munda të gjeja një çantë siç e dua unë.

Sytë e saj u ngulën mbi të mitë në pasqyrë dhe u ndalën aty për njëfarë kohe, në pritje, dhe unë e kuptova se sapo më kishin kërkuar të mbaja një të fshehtë. Ajo po vinte besnikërinë time në provë. Po më kërkonte të bëja një zgjedhje.

- Them se mbase ke parë në tri dyqane, - i thashë me zë të dobët.

Ajo buzëqeshi.

- *Parfois je pense que tu es mon seul ami*, Nabi.

Unë përplasa qepallat.

- Që do të thotë "Ndonjëherë më duket se ti je i vetmi mik që kam, Nabi".

Dhe më fali një buzëqeshje rrezëllitëse, por kjo nuk ma ngrohu dot shpirtin e lënduar.

Pjesën tjetër të asaj dite, vazhdova punët e përditshme me gjysmën e shpejtësisë normale dhe vetëm me një pjesë të entuziazmit tim të zakonshëm. Kur burrat erdhën të pinin çajin atë natë, njëri prej tyre nisi të këndonte, por kënga e tij nuk më ngushëlloi dot. Më dukej vetja si një njeri që i kanë vënë brirët. Dhe isha i bindur se tërheqja që kisha pasur drejt saj, ishte shuar më në fund.

Por, kur u zgjova në mëngjes, ja tek ishte përsëri, duke mbushur hapësirën ku jetoja unë, nga dyshemeja e deri në tavan, e shkrirë nëpër mure, në ajrin që thithja, si avull. Ishte e kotë, zoti Markos!

Nuk mund t'jua them me saktësi se kur më lindi ideja.

Ndoshta më lindi atë mëngjes vjeshte me erë, kur po i shërbeja Nilës çajin, po i prisja një copë kek dhe nga radioja e vendosur në parvazin e dritares u dëgjua lajmi se dimri i vitit 1952 do të ishte edhe më i egër se ai i një viti më parë. Ose ndoshta edhe më parë, ditën kur e çova tek ajo shtëpia me muret bojërozë; e ndoshta edhe më herët, kur po ia shtrëngoja dorën në makinë, ndërsa ajo qante me dënesë.

Kurdo që të ketë ndodhur, me të lindur ajo ide në mendjen time, ishte e pamundur që ta nxirrja prej andej.

Më lejoni të them, zoti Markos, se unë isha më se i bindur që propozimi im kishte lindur nga dëshira e mirë dhe kishte synimin më të mirë. Diçka që, edhe pse mund të ishte e dhembshme për një kohë të shkurtër, në vijimësi do të sillte vetëm përfitime për të gjithë njerëzit e përfshirë në të. Por unë kisha edhe arsyet e mia egoiste, më pak të nderuara, sigurisht. Dhe më kryesorja nga të gjitha ishte fakti që kjo ide do t'i jepte Nilës atë që nuk mund t'ia jepte dot asnjë burrë tjetër, as edhe vetë bashkëshorti i saj ose burri i asaj shtëpisë me muret bojëroze.

Në fillim fola me Saborin. Për vetëmbrojtje, i thashë se, po të kisha menduar se ai do t'i pranonte paratë e mia, do t'ia kisha dhënë ato me kënaqësi, pa qenë nevoja që të bëja një propozim të tillë. E dija që ai kishte nevojë për pará, sepse ai vetë m'i kishte rrëfyer mundimet që hiqte për të gjetur punë. Unë do të kisha marrë paradhënie disa rroga prej zotit Vahdati, që familja e Saborit ta kalonte pa probleme dimrin që po afronte. Por Sabori, si shumica e burrave të fshatit tim, ishte shumë krenar, një krenari njëherazi e papjekur dhe e patrandur nga asgjë. Ai nuk do t'i pranonte kurrë paratë e mia. Madje, kur u martua me Parvanën, ai më kërkoi që ta ndërprisja ndihmën ekonomike që i kisha dhënë asaj deri atëherë. Ishte ai burri i saj dhe i takonte atij ta mbante familjen e vet. Dhe pikërisht këtë ishte duke bërë edhe kur vdiq, pa i mbushur ende as të dyzetat, duke korrur një arë me kallam sheqeri, diku pranë Baghalanit. Mora vesh se vdiq me draprin në dorën e gjakosur e gjithë kallo.

Unë nuk jam bërë ndonjëherë baba dhe nuk mund të them se e kuptoj ç'lloj arsyetimesh të ankthshme e bënë Saborin që ta pranonte propozimin tim. Dhe as nuk mora pjesë ndonjëherë në diskutimet e çiftit Vahdati. Kur ia shfaqa Nilës si ide, i kërkova vetëm që ajo ta paraqiste si të vetën, kur të fliste me zotin Vahdati. E dija që zoti Vahdati nuk do të pranonte lehtë.

Për asnjë çast nuk kisha vënë re tek ai ndonjë lloj instinkti atëror. Në fakt, pyesja veten se mos ishte pikërisht fakti që Nila nuk mund të bënte fëmijë, që e kishte bindur atë të martohej me të. Gjithsesi, e ndieja mjaft mirë atmosferën e tendosur mes atyre të dyve. Kur bija në darkë për të fjetur, shihja vetëm lotët e papritur që rrodhën nga sytë e Nilës, teksa ia propozoja si ide, dhe se si ajo m'i shtrëngoi të dyja duart e më pa me një vështrim gjithë mirënjohje e - isha i bindur për këtë - me diçka që ngjasonte me dashurinë. Unë vetëm mendoja se po i bëja një dhuratë që asnjë prej burrave me të ardhme mjaft më të mirë se imja nuk do të mund t'ia jepte dot. Unë mendoja se me sa dëshirë ia kisha dhuruar veten time asaj dhe sa i lumtur isha për këtë. Mendoja, madje shpresoja, edhe pse me budallallëk, pa dyshim, se edhe ajo mund të niste të më konsideronte si diçka më shumë se thjesht një shërbëtor.

Kur zoti Vahdati u dorëzua më në fund, çka nuk më habiti aspak, sepse Nila ishte një grua me vullnet të jashtëzakonshëm, e vura në dijeni Saborin dhe i ofrova që, tok me Pahrin, t'i shoqëroja unë për në Kabul. Nuk e kam kuptuar kurrë pse ai vendosi të vinte më këmbë që nga Shadbagu. Ose pse pranoi që edhe Abdullai të vente me ta. Mbase donte t'i shfrytëzonte edhe ato orë të fundit që i kishin mbetur, me të bijën. Ose mbase kërkonte ta shlyente ndjenjën e fajit përmes atij rrugëtimi të vështirë. Por mbase ishte thjesht krenaria e Saborit, që nuk e lejonte të hipte në makinën e burrit që po i blinte të bijën. Por, më në fund, ja tek ishin, që të tre, të mbuluar nga pluhuri, duke pritur, ashtu siç ishim marrë vesh, përpara xhamisë. E, ndërsa i shoqëroja për në shtëpinë e zotit Vahdati, u mundova të tregohesha sa më dashamirës për hir të fëmijëve, të fëmijëve që nuk e dinin aspak se çfarë fati i priste, se çfarë skenë e tmerrshme do të shpalosej së shpejti.

Nuk ka kuptim që t'jua përshkruaj me përimtime, zoti Markos, skenën që u shpalos tamam ashtu siç kisha pasur frikë unë. Por edhe pas gjithë këtyre viteve, unë ende e ndiej zemrën të më mpaket në kraharor, kur kujtimi i asaj dite del

sërish në sipërfaqe. E si të mos ndodhë kështu? Unë i ndava nga njëri-tjetri ata dy fëmijë, tek të cilët dashuria kishte gjetur folenë e saj më të thjeshtë e më të pastër. Nuk do ta harroj kurrë skenën e papritur tragjike: Pahri, që dridhej mbi supin tim, në gjendje paniku, duke përplasur këmbët e duart, duke thirrur "Abolla! Abolla!", ndërsa unë e largoja prej aty. Abdullai, që thërriste emrin e së motrës, duke u munduar t'i shkëputej të atit nga duart. Nila, me sy të shqyer, me gojën të mbuluar me të dyja duart, mbase për të mposhtur britmën e saj. Kjo barrë më rëndon edhe sot. Me gjithë vitet që kanë kaluar, zoti Markos, kjo barrë ende më rëndon në shpirt.

Pahri ishte pothuajse katër vjeç në atë kohë, por, pavarësisht moshës së saj, kishte në jetën e saj forca të tilla që duhej t'u jepej një tjetër formë. Atë e mësuan që të mos më thërriste më Kaka Nabi, por thjesht Nabi. Dhe, sa herë që më thërriste ndryshe, e korrigjonin me shumë butësi, madje edhe unë vetë, vazhdimisht e vazhdimisht, derisa ajo nisi të besonte se ne nuk kishim asnjë lidhje me njëri-tjetrin. Unë u bëra për të Nabi shoferi dhe Nabi kuzhinieri. Nila u bë "mami" dhe zoti Vahdati "babi". Nila filloi t'i mësonte frëngjishten, që kishte qenë gjuha e nënës së vet.

Pritja e ftohtë që i bëri zoti Vahdati Pahrit, zgjati vetëm për pak kohë. Ndoshta, për habinë edhe të vetë atij, ishin lotët e ankthi i saj, malli për shtëpinë, që e çarmatosën zotin Vahdati. Shumë shpejt nisi të vinte edhe Pahri në shëtitjet tona mëngjesore. Zoti Vahdati e ulte në një karrocë dhe e shtynte nëpër lagje, ndërsa ecnim. Ose e ulte në prehrin e vet në ndenjësen e shoferit dhe qeshte me durim, kur ajo i binte borisë. Ai punësoi një marangoz, i cili ndërtoi për Pahrin një shtrat me tri rafte në pjesën e poshtme, një dollap për lodrat dhe një dollap tjetër më të vogël e të ulët. Kërkoi që të gjitha mobiliet në dhomën e Pahrit të lyheshin me bojë të verdhë, sepse vuri

re që kjo ishte ngjyra e saj e parapëlqyer. Dhe një ditë e gjeta të ulur këmbëkryq përpara dollapit të vogël, me Pahrin pranë tij, duke vizatuar në kanatet e tij, me një talent që binte në sy, gjirafa e majmunë bishtgjatë. Mund ta kuptoni mjaft mirë natyrën e tij të mbyllur, zoti Markos, po t'ju them se pas gjithë atyre viteve që kisha punuar për të, kjo ishte e para herë që munda t'i shihja vizatimet e tij.

Një nga efektet e pranisë së Pahrit në shtëpi ishte fakti që për herë të parë ajo po dukej tani si e banuar nga një familje e vërtetë. Të lidhur tashmë nga dashuria e tyre për Pahrin, Nila dhe i shoqi nisën t'i hanin vaktet bashkë. Ata e nxirrnin Pahrin në një park aty pranë, uleshin pranë njëri-tjetrit në stol dhe e kundronin të kënaqur, ndërsa ajo luante. Kur u shërbeja çajin në mbrëmje, pasi kisha pastruar tryezën, gjeja herë njërin e herë tjetrin duke i lexuar Pahrit ndonjë libër, ndërsa ajo qëndronte ulur në prehër. Dhe, për çdo ditë që kalonte, ajo e harronte gjithmonë e më shumë jetën e saj të mëparshme dhe njerëzit e Shadbagut.

Pasoja tjetër e ardhjes së Pahrit ishte diçka që nuk e kisha parashikuar: unë mbeta në sfond. Më gjykoni me dashamirësi, zoti Markos, dhe kujtohuni që unë isha veç një djalë i ri, por më duhet ta pranoj që kisha ushqyer shpresa, sado të kota që të ishin. Tek e fundit, unë kisha qenë njeriu që e kisha ndihmuar Nilën të bëhej nënë. Unë kisha zbuluar burimin e mungesës së lumturisë së saj dhe ia kisha gjetur edhe antidotin. Tani, a mendova se do të bëheshim të dashur? Do të dëshiroja të thosha se nuk isha kaq budalla, zoti Markos, por kjo nuk do të ishte plotësisht e vërtetë. Sepse besoj që të gjithë ne shpresojmë, përkundër të gjitha mundësive, që të na ndodhë diçka e ja-shtëzakonshme.

Por ajo që nuk e kisha parashikuar, ishte se unë do të kthehesha në hije. Tani ishte Pahri ajo që e rrëmbente të gjithë kohën e Nilës: mësime, lojëra, gjumë, shëtitje, lojëra përsëri. Bisedat tona të përditshme reshtën. Kur ato të dyja ishin të zëna me ndërtimin e shtëpive prej lodre ose me lojëra me

elemente, Nila rrallëherë më vinte re kur i çoja kafen ose që ndodhesha ende në dhomë. Dhe, kur flisnim, ajo dukej e shpërqendruar dhe gjithmonë e paduruar për ta ndërprerë bisedën. Në makinë, qëndrimi i saj ishte i largët. Dhe për këtë arsye, edhe pse më vjen turp, më duhet ta pranoj që nisa të ndieja njëfarë zilie ndaj mbesës sime.

Marrëveshja mes Vahdatëve dhe familjes së Pahrit nënkuptonte që këta nuk duhej të vinin ta shihnin vajzën. Nuk u lejohej asnjë lloj kontakti me të. Unë shkova në Shadbag me makinë të nesërmen e asaj dite që Pahri erdhi të jetonte në shtëpinë e Vahdatëve. Me vete kisha një dhuratë të vogël për Abdullain dhe një tjetër për Ikbalin, djalin e vogël të sime motre, që asokohe ishte ende foshnjë.

Sabori m'u drejtua me zë të ashpër:

- Dhuratat na i dhe. Tani është koha që të shkosh.

I thashë se nuk e kuptoja arsyen e kësaj pritjeje të ftohtë dhe sjelljen e tij të ashpër ndaj meje.

- Ti e kupton mjaft mirë, - më tha ai. - Dhe nuk ka pse të ndihesh i detyruar që të vish të na takosh patjetër.

Dhe kishte të drejtë. Unë e kuptoja. Midis nesh ishte krijuar një hendek. Prania ime aty ishte e çuditshme, e tendosur, madje edhe konfliktuese. Tani nuk dukej më si gjë e natyrshme që të uleshim bashkë, të rrufitnim çajin e të flisnim për motin a për vjeljen e rrushit. Unë dhe Sabori po shtireshim sikur gjërat ishin normale, kur në të vërtetë ato nuk ishin më kështu. Pavarësisht nga qëllimi që kisha pasur, tek e fundit, unë isha arsyeja e krisjes në familjen e tij. Sabori nuk donte të më shikonte më me sy, dhe unë e kuptoja. Kështu që i ndërpreva vizitat e mia të përmuajshme. Dhe kurrë nuk i pashë më, asnjërin prej tyre.

Por një ditë, në fillim të pranverës së vitit 1955, zoti Markos, jeta e të gjithëve ne në atë shtëpi ndryshoi përgjith-

monë. Më kujtohet që binte shi. Jo nga ai shiu me gjyma që i bën bretkosat të kuasin ngado, por ishte një shi i imët që pushonte e fillonte prapë gjatë gjithë mëngjesit. Më kujtohet kjo, ngaqë kopshtari, Zahidi, ishte aty, si gjithmonë ai dembeli i zakonshëm, i mbështetur në bishtin e një shati, duke thënë se mund ta linte punën për atë ditë, për shkak të motit të keq. Unë po kthehesha në shtëpizën time, në njëfarë mënyre edhe për t'u larguar prej tij, kur dëgjova Nilën që më thirri në emër nga brenda shtëpisë së madhe.

U turra me vrap nëpër kopsht dhe hyra në shtëpi. Zëri i saj vinte nga kati i dytë, nga dhoma e padronit.

E gjeta Nilën në një qoshe, të mbështetur pas murit, me dorën mbi gojë.

- Diçka nuk shkon tek ai, - tha ajo, pa e hequr dorën nga goja.

Zoti Vahdati qëndronte ndenjur në shtrat, i veshur me një bluzë të brendshme të bardhë. Dhe po nxirrte ca tinguj të çuditshëm grykorë. Fytyrën e kishte të zbehtë e të hequr, flokët të shprishur. U mundua disa herë të lëvizte krahun e djathtë, por të gjitha herët dështoi dhe unë po e shihja me tmerr se nga cepi i djathtë i buzëve po i rridhte pështymë.

- Nabi! Bëj diçka!

Pahri, që atëkohë ishte gjashtë vjeç, hyri në dhomë, iu afrua shtratit të zotit Vahdati dhe e tërhoqi nga bluza.

- Babi! Babi!

Ai vështroi nga ajo me sy të shqyer, duke hapur e mbyllur gojën. Vogëlushja ia dha ulërimës.

Unë e mora menjëherë në krahë, e afrova pranë Nilës dhe i thashë kësaj që të shkonin të dyja në një dhomë tjetër, sepse Pahri nuk duhej ta shihte të atin në atë gjendje. Nila mbylli sytë, si të ishte duke dalë nga një gjendje hipnoze, më pa në fillim mua, pastaj Pahrin, e më në fund e kapi vajzën për dore. Vazhdoi të më pyeste se çfarë nuk shkonte me burrin e saj. Vazhdoi të më thoshte se duhej të bëja diçka.

Unë e thirra Zahidin nga dritarja dhe për herë të parë njeriu që s'vlente për asgjë, na erdhi në ndihmë. Ai më ndihmoi që t'i vishja zotit Vahdati një palë pizhame, pastaj e morëm hopa, e zbritëm poshtë dhe e futëm në ndenjësen e pasme të makinës. Nila u ul pranë tij. Unë i thashë Zahidit që të kthehej në shtëpi e të kujdesej për Pahrin. Ai nisi të kundërshtonte, por unë e qëllova në tëmth, me pëllëmbën të hapur fort, me sa më hëngri dora. E shava "gomar" dhe e urdhërova që të bënte atë që po i kërkonin.

Pas kësaj, u ula në timon e i dhashë gaz makinës.

Kaluan plot dy javë, derisa e kthyem përsëri zotin Vahdati në shtëpi. Pasoi kaosi. Të afërmit vërshuan në shtëpi turma-turma. Unë pothuajse punoja 24 orë në ditë, duke gatuar diçka për njërin dajë, duke bërë çajin për njërën hallë, duke përgatitur diçka tjetër për aksh kushëri. Gjatë gjithë ditës zilja e derës kryesore nuk pushonte dhe takat trokisnin mbi dyshemenë prej mermeri të dhomës së ndenjjes, ndërsa korridori mbushej me mërmërimat e njerëzve që dyndeshin në shtëpi. Shumicën e tyre rrallë i kisha parë më parë në shtëpi dhe e kuptoja se ata më shumë vinin sa për sy e faqe, për të respektuar nënën e zotit Vahdati, sesa për të parë vërtet të sëmurin, me të cilin kishin një lidhje të largët. Edhe ajo erdhi, pa dyshim, nëna e tij, falë Zotit pa qentë e saj. Ajo hyri në shtëpi me nga një shami në secilën dorë, duke fshirë sytë e skuqur e duke shfryrë hundët. U ngul buzë shtratit të tij dhe vetëm qante. Ajo që më bëri më shumë përshtypje, ishte se qe veshur me të zeza, a thua se i biri ndërkaq kishte vdekur.

Por, në njëfarë mënyre, ai i vdekur ishte. Të paktën varianti i tij i mëparshëm. Tani gjysma e fytyrës së tij ishte veç një maskë e ngrirë. Këmbët thuajse nuk arrinte t'i lëvizte fare. Krahun e majtë arrinte ta lëvizte nga pak, por krahu i djathtë ishte thjesht një trung mishi e kockash. Nga goja nxirrte vetëm hungërima e rënkime, që askush nuk i kuptonte.

Mjeku na tha se zoti Vahdati ende provonte emocione

dhe i kuptonte gjërat po aq mirë sa edhe më parë se të pësonte ishemi në tru, por, të paktën tani për tani, nuk arrinte të reagonte ashtu siç i ndiente ose i kuptonte.

Por kjo nuk ishte plotësisht e vërtetë. Në fakt, pas javës së parë, ai na i bëri mjaft të qarta ndjenjat e veta për vizitorët, përfshi këtu edhe të ëmën. Edhe pse tmerrësisht i sëmurë, ai mbeti një krijesë thellësisht e vetmuar. Dhe nuk kishte aspak nevojë për mëshirën e tyre, për vështrimet e tyre të përdëlluara a për mohimet hipokrite me kokë për atë qenie të gjymtë në të cilën ishte shndërruar tani. Kur ata hynin në dhomën e tij, ai tundte gjithë zemërim dorën e vetme që përdorte ende. Kur i flisnin, e kthente kokën nga ana tjetër. Kur uleshin buzë shtratit të tij, e mblidhte dorën grusht dhe i binte këmbës me hungërima, derisa ata ngriheshin të iknin. Kurse Pahrin e përzinte me shumë butësi. Ajo vinte të luante me kukullat e veta në anë të shtratit të tij dhe ai shihte nga unë, me një vështrim lutës, me sytë të njomur nga lotët, me mjekrën që i dridhej, derisa unë e nxirrja Pahrin nga dhoma: ai nuk bënte përpjekje që t'i fliste ndonjë fjalë, sepse e dinte që tingujt e çoroditur do ta trembnin vajzën.

Ajo dyndje masive vizitorësh e lehtësoi së tepërmi Nilën. Kur ata u ngjeshën brenda në shtëpi, cep më cep, ajo u tërhoq në dhomën e gjumit të Pahrit, për tërbimin e mëtejshëm të nënës së zotit Vahdati, e cila priste, mbase me të drejtë, që Nila të qëndronte në krah të të shoqit, qoftë edhe sa për sy e faqe. Por pa dyshim që Nila nuk e vriste mendjen aspak për dukjen e jashtme ose për ç'mund të thoshin të tjerët për të. Dhe shumica me siguri që thoshin: "E ç'grua na qenka kjo?!" E kisha dëgjuar shumë herë vjehrrën e saj ta thoshte këtë. Ajo u ankohej të gjithëve se Nila ishte njeri pa shpirt, se në vend të zemrës kishte vetëm një zgavër bosh. Ku ishte ajo tani, kur i shoqi kishte nevojë për të? Cila grua do ta braktiste kështu burrin e saj të dashur e besnik?

Pa dyshim, ca gjëra nga ato që thoshte gruaja plakë, ishin më se të vërteta. Në fakt, isha unë ai që gjendej vazhdimisht te

koka e zotit Vahdati, isha unë që i jepja barnat dhe që sajdisja njerëzit që hynin në dhomë. Isha unë që flisja më shpesh me mjekun dhe isha unë, e jo Nila, ai që njerëzit pyesnin për gjendjen e zotit Vahdati.

Ikja e mysafirëve të zotit Vahdati e shpëtoi Nilën nga një shqetësim, por e vuri përballë një tjetri. Duke u mbyllur në dhomën e Pahrit, ajo i kishte qëndruar larg jo vetëm vjehrrës së saj gërnjare, por edhe asaj krijese në të cilën ishte shndërruar i shoqi tani. Tani që shtëpia ishte bosh, ajo duhej të përballej me detyrat e saj si bashkëshorte, gjëra për të cilat ishte plotësisht e paaftë.

Ajo nuk mund t'i bënte.

Dhe nuk i bëri.

Nuk po them se ishte e ligë ose mizore. Unë kam jetuar shumë gjatë, zoti Markos, dhe e kam kuptuar se njeriu duhet ta gjykojë thelbin e zemrës së tjetrit me përulësi dhe bujari njëherazi. Ajo që po them, është se një ditë hyra në dhomën e zotit Vahdati dhe e gjeta Nilën duke qarë mbi barkun e tij, me një lugë në dorë, ndërsa supa me pure thjerrëzash po i rridhte atij nëpër mjekër e në pecetën që i kishim vënë në gushë.

- Ma lër mua, *Bibi Sahib*, - i thashë me zë të butë. Ia mora lugën nga dora, ia fshiva buzët atij dhe bëra ta ushqeja, por ai rënkoi, mbylli sytë fort dhe ktheu kokën nga ana tjetër.

Jo shumë kohë pas kësaj unë e pashë veten duke zbritur dy valixhe nëpër shkallë dhe duke ia zgjatur ato shoferit, që i futi në bagazhin e makinës me motor të ndezur. Pastaj e ndihmova Pahrin, që kishte veshur pallton e saj të parapëlqyer në ngjyrë të verdhë, që të ulej në ndenjësen e pasme.

- Nabi, do ta sjellësh babin të na takojë në Paris, siç tha mami? - më pyeti vogëlushja, duke më buzëqeshur me gojën ku i mungonin dhëmbët e përparmë.

Iu përgjigja se do ta bëja patjetër, sapo që i ati të ndihej më mirë. Ia putha trinën e secilës dorë dhe vazhdova:

- *Bibi* Pahri, të uroj fat dhe lumturi.

Nilën e takova ndërsa zbriste shkallët, me sy të ënjtur e

të nxirë nga rimeli që i kishte kulluar. Kishte qenë në dhomën e zotit Vahdati për t'i thënë lamtumirë.

E pyeta si ishte ai.

- I lehtësuar, besoj, - tha ajo e mandej shtoi: - edhe pse besoj ngaqë ashtu do të doja unë të ishte. - Ajo e mbylli zinxhirin e çantës dhe e hodhi rripin e saj në sup. - Mos i thuaj asnjeriu se ku po shkoj. Më mirë kështu.

I premtova se nuk do të thosha asgjë.

Ajo më tha se do të më shkruante së shpejti. Pastaj më vështroi për disa çaste në sy dhe unë besoj se pashë aty ndjenja të mirëfillta. Ajo ma vuri pëllëmbën e dorës në faqe.

- Jam e lumtur, Nabi, që po të lë ty me të. - Pastaj m'u afrua e më përqafoi, duke e ngjitur faqen pas simes. Hunda m'u mbush me aromën e flokëve të saj, të parfumit të saj. - Ke qenë ti, Nabi, - më tha ajo në vesh. - Ke qenë gjithmonë ti. Nuk e dije?

Unë nuk e kuptova. Por ajo u shkëput prej meje përpara se unë të arrija ta pyesja. Me kokën ulur, me çizmet me taka që trokisnin mbi asfalt, ajo nxitoi nëpër rruginë. U ul në ndenjësen e pasme të taksisë, pranë Pahrit, vështroi edhe një herë nga unë dhe e mbështeti pëllëmbën e dorës pas xhamit. Pëllëmba e saj e bardhë mbi xham ishte gjëja e fundit që arrita të shihja prej saj, ndërsa taksia u nis.

E ndoqa pas me sy, teksa largohej, prita derisa makina humbi në kthesën në fund të rrugës, mandej mbylla portën kryesore. Dhe pastaj u mbështeta pas kanateve e nisa të qaja si fëmijë.

Pavarësisht nga dëshirat e zotit Vahdati, disa mysafirë vazhduan të vinin edhe për ca kohë në shtëpi. Më në fund, ishte vetëm e ëma që vinte ta shihte, rreth një herë në javë. Kërciste gishtat drejt meje dhe unë i sillja një karrige, që e vendosja në anë të shtratit të të birit. Dhe, pa u ulur mirë në

të, ajo fillonte me një kaskadë shfryrjesh për karakterin e nuses së saj tashmë të ikur. Ajo ishte kurvë. Gënjeshtare. Pijanece. Një femër me karakter të dobët, që një Zot e dinte se ku ia kishte mbathur tani që i shoqi kishte nevojë më shumë se kurrë për të. Këtë, zoti Vahdati e duronte në heshtje, me vështrimin pa shprehje të hedhur përtej supeve të saj, drejt dritares. Dhe pastaj ajo niste një tjetër lumë të rejash më të fundit, shumica e të cilave ishin thuajse edhe fizikisht të dhembshme në banalitetin e tyre: Një kushërirë që ishte zënë me të motrën, sepse kjo kishte pasur paturpësinë të blinte një tryezë kafeje identike me të sajën. Filanit i ishte shpuar goma e makinës, ndërsa kthehej të premten nga Paghmani. Filania kishte ndryshuar modelin e flokëve. E të tilla pa fund. Ndonjëherë zoti Vahdati hungërinte diçka dhe e ëma kthehej nga unë.

- Hej, ti! Çfarë tha? - Ajo gjithmonë më drejtohej në këtë mënyrë, me fjalë të ashpra e therëse.

Ngaqë isha thuajse gjatë gjithë ditës te koka e shtratit të tij, kisha nisur dalëngadalë t'ia zbuloja enigmën e së folurës. Përkulesha mbi të dhe në atë rrëmujë mërmërimash e hungërimash pa kuptim për të tjerët, arrija të deshifroja një kërkesë për ujë, nevojën për oturakun ose për ta kthyer nga ana tjetër. Isha bërë vërtet përkthyesi i tij.

- Djali juaj thotë se do të donte të flinte.

Plaka psherëtinte dhe thoshte s'kishte asnjë problem, tek e fundit edhe ajo vetë po mendonte që të çohej e të ikte. Ajo përkulej mbi të, e puthte në ballë dhe i premtonte se do të vinte ta shihte së shpejti. Me ta përcjellë deri jashtë derës, ku e priste shoferi i vet, kthehesha pranë shtratit të zotit Vahdati, ulesha në karrige dhe ndanim heshtjen bashkë. Ndonjëherë ai më shihte në sy, tundte kokën në shenjë mohimi dhe sajonte një buzëqeshje ngërdheshëse.

Tani nuk kishte për mua aq shumë punë sa më parë: shkoja për të blerë ushqime vetëm një herë ose dy herë në javë dhe gatuaja vetëm për dy vetë, prandaj po më dukej e kotë që t'i paguaja shërbyesit e tjerë për gjëra që fare mirë mund t'i

bëja vetë. Ia thashë këtë edhe zotit Vahdati dhe ai më bëri shenjë me dorë. U përkula mbi të..

- Do të rraskapitesh fare.

- Jo, *Sahib*. Do t'i bëj me shumë kënaqësi.

Ai më pyeti nëse isha i sigurt, dhe unë iu përgjigja se po.

Sytë iu veshën nga një vesë lotësh dhe gishtat shtrënguan dobët kyçin tim. Ai kishte qenë burri më stoik që kisha njohur unë ndonjëherë, por qysh se i kishte rënë ishemia në tru, ishte bërë nevrik, ankthioz, qaraman.

- Nabi, më dëgjo.

- Po, *Sahib*.

- Merr sa pará të duash si rrogë.

I thashë se nuk ishte nevoja të flisnim për këtë.

- Ti e di se ku i mbaj unë paratë.

- Nuk më intereson se sa është rroga. - I thashë se po mendoja të bëja *shorva* për drekë. - Si të duket *shorva*? Mua për vete do të më pëlqente.

I dhashë fund edhe takimeve në darkë me punëtorët e tjerë. Nuk më interesonte më se çfarë mund të mendonin ata për mua; nuk mund t'i lejoja më të vinin në shtëpinë e zotit Vahdati dhe të argëtoheshin në kurriz të tij. Me një kënaqësi të jashtëzakonshme, e pushova nga puna edhe Zahidin. Dhe i thashë të mos vinte më edhe gruas *hazara* që lante teshat. Kështu që tani i laja vetë rrobat dhe i nderja në tel për t'u tharë. Krasitja degët e pemëve dhe u jepja formë kaçubave, kositja barin, mbillja lule të reja e perime. E pastroja vetë shtëpinë, duke shkundur tapetet, duke larë dyshemenë, duke shkundur pluhurin nga perdet e duke fshirë mobiliet; laja xhamat, rregulloja rubinetat që prisheshin, zëvendësoja tubat që dëmtoheshin.

Një ditë isha në dhomën e zotit Vahdati dhe, ndërsa ai po flinte, po pastroja pluhurin e mobilieve. Ishte verë dhe vapa ishte mbytëse. Unë ia kisha hequr çarçafin zotit Vahdati dhe ia kisha përthyer këmbët e pizhameve. Kisha hapur dritaren,

kisha ndezur ventilatorin, që kërriste, por asgjë nuk bënte fajde, sepse ajri i nxehtë vazhdonte të vërshonte nga të katër anët.

Në dhomën e tij ishte një dollap relativisht i madh, të cilin kisha kohë që doja ta pastroja dhe, më në fund, vendosa ta bëja atë ditë. Hapa kanatet dhe nisa të merresha fillimisht me kostumet, duke ia shkundur pluhurin secilit, edhe pse e dija se, pak gjasa kishte që zoti Vahdati të vishte ndonjërin përsëri. Aty kishte stiva librash që ishin mbuluar me pluhur dhe unë i shkunda e i fshiva edhe ata një nga një. Pastrova këpucët dhe i vura me rregull në radhë pranë njëra-tjetrës. Pastaj gjeta një kuti të madhe kartoni, e fshehur mirë nga palltot e rënda të dimrit që vareshin mbi të. E tërhoqa dhe e hapa. Ishte e mbushur me blloqet e vjetra të pikturave të zotit Vahdati, të vendosura njëri mbi tjetrin, secili një relike e trishtuar e jetës së tij të dikurshme.

Mora në dorë bllokun e sipërm dhe e hapa. M'u prenë gjunjët e gati më lëshuan. E shfletova faqe për faqe atë bllok. Pastaj e vura në vend dhe nxora një bllok tjetër e mandej një tjetër, e përsëri një tjetër. Faqet shkisnin përpara syve të mi, duke më lëshuar një rrymë të lehtë ajri drejt fytyrës, secila me të njëjtin personazh të vizatuar me laps karboni. Dhe isha unë aty, duke pastruar xhamin e përparmë të makinës, parë nga dritarja e dhomës së gjumit të katit të dytë. Në një tjetër isha mbështetur në bishtin e një lopate pranë verandës. Në ato faqe e gjeta veten duke lidhur këpucët, duke çarë drutë e zjarrit, duke ujitur lulet, duke hedhur çajin në filxhan me çajnik, duke u falur, duke marrë një sy gjumë. Ja tek ishte makina e parkuar në breg të liqenit *Ghargha*, unë prapa timonit, xhami i dritares i ulur, krahu im i varur përtej saj, një figurë e turbullt në ndenjësen e pasme, zogjtë që fluturonin mbi makinë.

"*Ishe ti, Nabi.*

*Ke qenë gjithmonë ti.*

*Nuk e dije?*"

Ktheva kokën nga zoti Vahdati. Ai po flinte si qengj, kthyer në një anë. I futa përsëri blloqet me shumë kujdes në

kutinë prej kartoni, e mbylla kapakun dhe e vura sërish në qoshen ku e fshihnin palltot e dimrit. Pastaj dola nga dhoma, duke e mbyllur derën me kujdes, që të mos e zgjoja. Eca nëpër korridorin e errët dhe zbrita shkallët. Doja vetëm të ecja. E gjeta veten jashtë shtëpisë, mu në mes të zhegut përvëlues: dola jashtë derës, nëpër rruginë, mora kthesën në fund të saj dhe vazhdova të ecja pa e kthyer kokën pas për asnjë çast.

"E si mund të qëndroj unë tani?" - pyesja veten. Nuk ndihesha i neveritur dhe as i lumtur me zbulimin që kisha bërë, zoti Markos, por prapë nuk ndihesha rehat. Mundohesha ta përfytyroja veten ende aty, duke e ditur atë që dija tani. U ishte vënë dërrma të gjithave, tani që kisha gjetur ato vizatime në kuti. Një gjë të tillë nuk mund ta shmangie, nuk mund të shtireshe sikur nuk e dije. Por prapë, si mund të ikja tani që ai nuk ishte aspak i zoti i vetes? Nuk mundesha, të paktën jo pa gjetur dikë që do të mund të merrte përsipër punët e mia. I detyrohesha zotit Vahdati për këtë, sepse ai gjithmonë ishte sjellë mirë me mua, ndërkohë që unë vetë, nga ana tjetër, kisha punuar pas shpinës së tij, që të fitoja zemrën e së shoqes.

U ktheva në dhomën e ngrënies, u ula përpara tryezës prej xhami dhe mbylla sytë. Nuk mund t'jua them se për sa kohë qëndrova ashtu, pa lëvizur fare, zoti Markos. Kur i hapa më në fund sytë, pasi dëgjova një zhurmë në katin e dytë, pashë se ishte errur. Atëherë u ngrita dhe vura çajnikun në zjarr.

Një ditë, hyra në dhomën e tij dhe i thashë se kisha një surprizë për të. Ishte diku andej nga fundi i viteve '50, shumë më parë se televizori të hynte në Kabul. Ato ditë ne e kalonim kohën duke luajtur me letra dhe, nga fundi, edhe shah, që ma kishte mësuar ai dhe kisha nisur të tregoja se kisha njëfarë talenti. Një pjesë të mirë të kohës e kaloja duke mësuar të lexoja. Ai u tregua një mësues shumë i duruar. Mbyllte sytë,

më dëgjonte kur lexoja, dhe tundte kokën lehtë në shenjë mohimi kur bëja ndonjë gabim.

- Përsërite, - më thoshte. Me kalimin e kohës, të folurit i ishte përmirësuar së tepërmi. - Lexoje edhe një herë, Nabi.

Falë Mulla Shekibit të fshatit tim, unë dija të lexoja kur u punësova tek ai, në vitin 1947, por vetëm me Sulejmanin si mësues pata një përparim të vërtetë, madje edhe në të shkruar. Ai e bënte për të më ndihmuar mua, pa dyshim, por edhe për veten e vet, sepse tani unë mund t'i lexoja librat që i pëlqenin. Ai mund t'i lexonte edhe vetë, sigurisht, por e humbiste përqendrimin shumë shpejt.

Po të isha duke u marrë me ndonjë gjë dhe s'mund të isha pranë tij, ai nuk kishte me se ta kalonte kohën. Zakonisht dëgjonte muzikë. Ndonjëherë edhe shihte nga dritarja zogjtë nëpër degët e pemëve, qiellin, retë dhe dëgjonte fëmijët që luanin në rrugë, shitësit shëtitës që tërhiqnin pas vetes gomarët e tyre e thërrisnin: "Hajde qershi! Qershi të sapokëputura!"

Kur i thashë se kisha një surprizë për të, më pyeti se ç'ishte. Ia shkova njërën dorë poshtë njërit krah e tjetrën ia vendosa në zverk dhe iu përgjigja se në fillim duhej të zbrisnim në katin e parë. Asokohe nuk e kisha problem ta mbaja, sepse isha ende i ri dhe i fuqishëm. E mora në krahë pa vështirësi dhe e zbrita në dhomën e ndenjjes, ku e ula ngadalë në divan.

- Hë? - më pyeti prapë.

Unë solla një karrocë me rrota nga holli. Për pothuajse një vit rresht, isha munduar t'ia mbushja mendjen për një të tillë dhe ai më kishte kundërshtuar me kokëfortësi. Tani e kisha ndërmarrë vetë nismën dhe e kisha blerë një. Ai nisi menjëherë të tundte kokën mohueshëm.

- Ke hallin e fqinjëve? - e pyeta. - Ke turp nga ajo që mund të thonë ata?

Ai më tha ta çoja përsëri në dhomën e vet, lart.

- E po, unë nuk e çaj kokën fare se ç'do të thonë ose ç'do të mendojnë fqinjët, - i thashë. - Kështu që sot do të dalim të shëtitim. Është ditë shumë e bukur jashtë, ndaj ne do të dalim

të shëtitim dhe pikë. Sepse, po nuk dolëm nga kjo shtëpi, mua do të më ikë truri dhe ç'do të bëhet me ty pastaj, po të çmendem unë? Dhe, të them të drejtën Sulejman, boll qave. Më je bërë si ato gratë plaka.

Tani ai po qeshte e po qante njëherazi, por prapë vazhdonte të thoshte: "Jo! Jo!", edhe ndërsa unë e ngrija dhe e ulja në karrigen me rrota, e mbuloja me batanije dhe e shtyja drejt derës së jashtme.

Më duhet ta them këtu që unë, në fakt, kisha kërkuar gjatë kësaj kohe për ndokënd që të më zëvendësonte. Nuk ia thashë këtë Sulejmanit, ngaqë mendova se do ishte më mirë ta gjeja një herë personin e duhur e mandej t'ia thosha atij. Shumë njerëz erdhën të kërkonin punë. Unë i takoja jashtë shtëpisë, që të mos i lindnin dyshime Sulejmanit. Por këto përpjekje rezultuan me shumë më tepër probleme nga sa e kisha përfytyruar fillimisht. Shumica e kandidatëve ishin bërë nga i njëjti brumë si edhe Zahidi dhe këta, që i dalloja me erë që në sekondën e parë, sepse kisha pasur të bëja një jetë të tërë me llojin e tyre, i përzija në çast. Të tjerë nuk kishin aftësitë e duhura për të gatuar, sepse, siç e kaın thënë edhe më sipër, Sulejmani ishte shumë sqimatar në të ngrënë. Ose kishte nga ata që nuk dinin të ngisnin makinën. Shumica nuk dinin të lexonin, çka ishte shndërruar në një problem serioz, tani që unë i lexoja Sulejmanit çdo pasdite. Disa m'u dukën njerëz pa durim, që ishte një e metë e madhe, sepse Sulejmani tani sillej si një fëmijë i llastuar. E për disa të tjerë intuita më thoshte se u mungonte temperamenti i nevojshëm për të kryer atë detyrë të rëndë.

Dhe kështu kaluan tre vjet e unë isha ende në atë shtëpi, ende duke thënë me vete se do të ikja prej aty, sapo të gjeja dikë që t'ia besoja Sulejmanin. Pas tre vjetësh, isha përsëri unë ai që ia pastronte trupin çdo ditë me një rrobë të lagur, i rruaja mjekrën, i prisja thonjtë, i qethja flokët. E ushqeja, i çoja oturakun në shtrat dhe e pastroja tamam ashtu siç pastrohet një foshnjë, dhe pastaj laja pelenat e ndotura. Gjatë kësaj kohe,

kishim krijuar një lloj afërsie, familjariteti, po ashtu edhe një komunikim pa fjalë dhe, pa dyshim, tashmë kishte mbetur shumë pak nga formalizmi i mëparshëm në marrëdhënien tonë.

Me të arritur ta bindja që të përdorte karrocën me rrota, filluam përsëri zakonin e vjetër të shëtitjeve mëngjesore. Unë e nxirrja me karrocë nga shtëpia dhe përshëndetnim fqinjët që na kalonin pranë në rrugicë. Njëri prej tyre ishte zoti Bashiri, një djalë i ri, që sapo ishte diplomuar në Universitetin e Kabulit dhe punonte në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ai dhe i vëllai, tok me gratë e tyre, ishin shpërngulur në lagjen tonë dhe ishin vendosur në një shtëpi të madhe dykatëshe pak më tej shtëpisë sonë. Ndonjëherë e takonim ndërsa ishte duke ngrohur makinën, që të shkonte në punë, dhe gjithmonë ndalesha që të shkëmbenim ca fjalë. Herë të tjera e çoja Sulejmanin te parku *Shar-e-Nau*, ku uleshim nën hijen e vidheve dhe shihnim trafikun, shoferët e taksive që u binin vazhdimisht borive, dëgjonim zilet e biçikletave, gomarët që pëllisnin, kalimtarët që vraponin si të çmendur përpara autobusëve, për të kaluar rrugën. Ne u bëmë fytyra të njohura, unë dhe Sulejmani, në park e përreth tij. Gjatë kthimit për në shtëpi, ndaleshim shpesh për të shkëmbyer ndonjë bisedë gjithë humor me shitësit ambulantë të gazetave ose me kasapët, ndonjë fjalë me policin e trafikut a me shoferët e taksive të mbështetur pas makinës në pritje të ndonjë pasagjeri.

Ndonjëherë e ulja në ndenjësen e pasme të *Chevrolet*-it, futja karrocën në bagazh dhe shkonim në *Paghman*, ku gjenim gjithmonë një lëndinë të gjelbër të bukur dhe një përrua me ujë të shkumëzuar që rridhte nën hijen e pemëve. Ai nisi të përpiqej të vizatonte përsëri, pasi hanim drekën, por ishte mundim i madh, sepse ishemia ia kishte marrë dorën zotëruese, të djathtën. E megjithatë, duke përdorur dorën e majtë, ai ia dilte mbanë të përvijonte linjat e pemëve, kodrat dhe lulet natyrale mjaft më mirë nga sa mundesha unë me të djathtën time të shëndetshme. Sigurisht që lodhej shpejt dhe hiqte dorë, lapsi i binte nga dora. Unë ia mbuloja këmbët me një batanije

dhe qëndroja shtrirë në bar pranë karriges. Mbaja vesh flladin e lehtë, që tundte degët e pemëve, ose kundroja shkumën e reve në qiellin mbi kokët tona.

Herët a vonë, mendimet më arratiseshin instinktivisht drejt Nilës, që tani ishte një kontinent larg. Me sytë e mendjes shihja valëvitjen e flokëve të saj të butë, këmbën që tundej hedhur përmbi këmbën tjetër, sandalen që shkelte bishtin e cigares. Mendoja për harkimin e shpinës së saj dhe lakoren e gjinjve. Dëshiroja me gjithë shpirt që të isha sërish pranë saj, të rrethohesha nga aroma e saj, të ndieja rrahjet e dikurshme të zemrës sa herë që ajo prekte dorën time. Nila më kishte premtuar se do të më shkruante, dhe, megjithëse kishin kaluar shumë vjet dhe kishte shumë mundësi që të më kishte harruar, do të gënjeja tani po të thosha se nuk përjetoja një lloj padurimi e ankthi, sa herë që postieri sillte letra.

Një ditë, në *Paghnam*, isha ulur në bar dhe po shqyrtoja me vëmendje fushën e shahut. Kjo ndodhi disa vjet më vonë, më 1968, një vit pas vdekjes të së ëmës së Sulejmanit dhe po atë vit kur zoti Bashir dhe i vëllai u bënë baballarë djemsh, të cilëve ua vunë emrin Idriz dhe Timur. I shihja shpesh të dy kolopuçët kushërinj, kur nënat e tyre i nxirrnin shëtitje me karrocë nëpër lagje. Atë ditë, unë dhe Sulejmani kishim nisur një lojë shahu, përpara se atë ta kaplonte dremitja, dhe unë tani po studioja fushën, që të arrija të barazoja pas gambitit të tij.

- Më thuaj, Nabi, sa vjeç je?

- E po, i kam kaluar të dyzetat, - iu përgjigja. - Këtë e di mirë.

- Mendoj se duhet të martohesh, - tha ai. - Përpara se ta humbasësh sharmin e jashtëm. Kanë filluar të të thinjen flokët.

Ne shkëmbyem nga një buzëqeshje. I thashë se edhe ime motër, Masoma, kështu më thoshte gjithmonë.

Ai më pyeti nëse më kujtohej dita kur më kishte marrë në punë, në vitin 1947, njëzet e një vjet më parë.

Sigurisht që më kujtohej. Kisha punuar si ndihmës-

kuzhinier në një shtëpi pak blloqe më tej se vila e Vahdatëve, por nuk isha i kënaqur. Me të dëgjuar që ai kishte nevojë për kuzhinier, sepse ai që kishte pasur, ishte martuar dhe ishte larguar nga qyteti, shkova drejt e në derën e tij dhe i rashë ziles.

- Kuzhinier më i keq nuk bëhej, - tha Sulejmani. - Tani bën mrekullira, por ai gatimi i parë... O Zot! Po hera e parë kur më shoqërove me makinë? Më dukej sikur nga çasti në çast do të më binte pika.

Këtu ai heshti, pastaj qeshi, i habitur edhe vetë me shakanë e vet të pamenduar.

Këto fjalë qenë një surprizë e vërtetë për mua, zoti Markos, një shok i vërtetë, sepse Sulejmani kurrë nuk më ishte ankuar, gjatë gjithë atyre viteve, për mënyrën se si gatuaja ose si e ngisja makinën.

- Atëherë, pse më more në punë? - e pyeta.

Ai u kthye me fytyrë nga unë.

- Sepse, kur ti hyre brenda, unë mendova me vete se nuk kisha parë kurrë gjë më të bukur. - Unë ula sytë mbi fushën e shahut. - E dija, që kur të pashë, se ne nuk ishim njësoj, ti dhe unë, se ajo që doja unë, ishte e pamundur. E prapë, dilnim bashkë shëtitje çdo mëngjes dhe dilnim edhe me makinë. Nuk mund të them se kaq mjaftonte, por ishte më mirë sesa të mos të kisha fare. U mësova që t'ia dilja mbanë me praninë tënde, - ai heshti për një çast, pastaj vazhdoi. - Dhe besoj se ti e kupton shumë mirë atë që po të them, Nabi. E di që e kupton. - Këtë herë nuk i ngrita dot sytë, që ta shihja në sy. - Unë duhet të ta them, qoftë edhe një herë të vetme, se të kam dashur për një kohë shumë, shumë të gjatë, Nabi. Të lutem, mos u zemëro. - Unë mohova me kokë. Për çaste të tëra, asnjëri nga ne nuk tha asnjë fjalë. Po qëndronte pezull në ajrin ndërmjet nesh ajo që ai kishte thënë: dhembja e një jete të shtypur, një lumturi që nuk mund të arrihej kurrë. - Edhe tani, po ta them këtë, - vazhdoi ai, - që ta kuptosh pse dua që

ti të ikësh. Ik dhe gjej një grua për veten tënde. Krijo familjen tënde, Nabi, si e gjithë bota. Je ende në kohë.

- Mirë, - thashë unë më në fund, duke u munduar që ta shpërbëja tensionin e krijuar me pak humor, - do ta bëj në një nga këto ditë. Por do të bëhesh pishman. Dhe do t'i bjerë kokës me grushte edhe ai bastardi i mjerë që do të të ndërrojë pelenat.

- Ti gjithmonë e ke mendjen të bësh shaka.

Sytë më zunë një brumbull mbi një gjethe të gjelbër.

- Nuk ke pse të qëndrosh për mua, Nabi. Këtë po të them. Nuk ke pse të qëndrosh për mua.

- Tani po i bën qejfin vetes.

- Prapë ti me këto shaka, - tha ai me zë të lodhur.

Nuk i ktheva përgjigje, edhe pse ai nuk e kishte kuptuar thelbin. Unë nuk po bëja shaka në ato çaste. Unë nuk po qëndroja më për të. Kisha qëndruar në fillim, sepse Sulejmani kishte nevojë për mua, sepse ishte plotësisht i varur nga unë. Isha arratisur njëherë nga dikush që kishte pasur nevojë për mua, dhe them se do ta marr me vete edhe në varr ndjenjën e pendimit, që nuk më është shuar as edhe sot. Prandaj nuk mund të bëja përsëri të njëjtën gjë. Por pak nga pak, pa e kuptuar as vetë, arsyeja e qëndrimit tim ndryshoi. Nuk mund t'ju them se, kur dhe si ndodhi ky ndryshim, zoti Markos, por tani unë po qëndroja për veten time. Sulejmani po më thoshte se duhej të martohesha. Por e vërteta ishte që unë bëja bilancin e jetës dhe e ndieja se e kisha tashmë atë që kërkonin dhe prisnin të tjerët nga martesa. Kisha rehatinë dhe praninë e njeriut, si dhe një shtëpi ku isha gjithmonë i mirëpritur, ku më donin dhe ma kishin nevojën. Nevojat fizike që kisha si burrë, dhe i kisha ende, edhe pse më pak të shpeshta se kur kisha qenë djalë i ri, mund t'i përmbushja përsëri në mënyrën që jua kam shpjeguar më parë. Për sa u përket fëmijëve, edhe pse më pëlqenin, nuk kisha ndier kurrë ndonjë lloj instinkti atëror te vetja.

- Po qe se ke vendosur të qëndrosh mushkë e të mos martohesh, - tha Sulejmani, - atëherë kam një kërkesë për ty. Por me kusht që ta pranosh përpara se ta them me zë të lartë.

I thashë se nuk mund të ma kërkonte këtë gjë.

- E po, unë po ta kërkoj.

Ngrita sytë dhe e vështrova në sy.

- Mund të thuash jo, - vazhdoi ai.

Ai më njihte mjaft mirë. Unë sajova vetëm një buzëqeshje ngërdheshëse. I dhashë premtimin tim dhe ai shprehu kërkesën e vet.

E ç'mund t'ju them, zoti Markos, për vitet që pasuan? Ju e njihni mjaft mirë historinë e këtij vendi të stërmunduar. Nuk është nevoja t'i përmend ato vite të errëta. Më lodh vetëm ideja se duhet t'i përshkruaj; vuajtjet e këtij vendi janë përshkruar mjaftueshëm tashmë edhe nga pena mjaft më të talentuara e më elokuente se kjo imja.

Unë thjesht mund ta përmbledh me një fjalë: luftë. Ose, më saktë, luftëra. Jo një, jo dy, por shumë luftëra, të vogla e të mëdha, të drejta e të padrejta, luftëra ku heronjtë e batakçinjtë këmbenin vendet, ndërsa secili hero i ri shpaloste nostalgjinë e vet për batakçiun e mëparshëm. Ndryshonin emrat, si edhe fytyrat, por të gjitha e meritonin t'i pështyje për armiqësitë e vogla, snajperët, minat, bombardimet ajrore, raketat, plaçkitjet, përdhunimet, vrasjet. Ah, mjaft! Kjo detyrë është njëherazi shumë e madhe dhe shumë e pakëndshme. I kam jetuar njëherë ato ditë dhe tani dua t'i përmbledh në këto faqe sa më shkurt që të mundem. E vetmja e mirë që fitova nga ato ditë, ishte një lloj ngushëllimi për Pahrin e vogël, e cila tani duhet të kishte arritur moshën e rinisë. E kisha ndërgjegjen më të lehtësuar tani, nisur nga fakti se ajo ishte e sigurt, shumë larg prej këtyre vrasjeve.

Vitet 1980, siç e dini, zoti Markos, nuk ishin edhe aq të

tmerrshme për Kabulin, sepse luftimet zhvilloheshin kryesisht nëpër provinca. E prapë, ishte një kohë mërgimi dhe shumë familje të lagjes sonë mblodhën gjërat e tyre dhe mërguan në Pakistan ose në Iran, me shpresën se prej aty do të mund të shpërnguleshin në Perëndim. Më kujtohet mjaft mirë dita kur zoti Bashir erdhi të na thoshte lamtumirë. I toka dorën dhe i urova gjithë të mirat. I thashë lamtumirë edhe djalit të tij, Idrizit, që tani ishte një adoleshent i gjatë e i dobët katërmbëdhjetëvjeçar, me flokë të gjatë dhe një push ngjyrë pjeshke mbi buzën e sipërme. I thashë Idrizit se do të më merrte malli shumë për ditët kur e shihja tok me kushëririn e vet, Timurin, duke ngritur balona ose duke luajtur futboll në rrugicë. Nëse ju kujtohet, zoti Markos, ne i takuam ata dy kushërinj shumë vjet më vonë, në festën që ju organizuat në shtëpi në pranverën e vitit 2003, kohë kur ata ishin bërë burra.

Vetëm në vitet '90 lufta erdhi në rrethinat e qytetit. Kabuli u bë pre e burrave që dukej sikur kishin dalë nga barku i nënës me kallashnikov në dorë, zoti Markos, të gjithë vandalë, hajdutë, vrasës me tituj bombastikë që ia kishin vënë vetë vetes. Kur predhat nisën të fluturonin mbi kokët tona, Sulejmani qëndroi në shtëpi dhe nuk pranoi të largohej prej aty. Ai nuk pranonte të dëgjonte asgjë për ç'ndodhte jashtë mureve të shtëpisë së tij. E hoqi antenën e televizorit. Hoqi edhe spinën e radios. Nuk blinte më gazeta. Dhe më kërkoi edhe mua që të mos sillja asnjë fjalë në shtëpi për sa u përkiste luftimeve. Ai pothuajse nuk e dinte fare se kush po luftonte e me kë, kush po fitonte ose kush po humbiste, a thua se, po ta shpërfillte luftën, edhe ajo do ta shpërfillte atë.

Por sigurisht që nuk ndodhi kështu. Rrugica jonë, dikur aq e qetë, aq e pastër e vezulluese, tani u shndërrua në zonë luftimi. Plumbat goditnin çdo shtëpi. Predhat fishkëllenin mbi kokët tona. Granatat kundërtank binin në rrugë dhe krijonin kratere në asfalt. Natën, plumbat gjurmues bardhekuq fluturonin lart e poshtë deri në agim. Kishte ditë që kishim ndopak

qetësi për disa orë, por pastaj mitralozat shpërthenin përsëri, nga të katër anët, dhe njerëzit jashtë në rrugë nisnin të ulërinin.

Pikërisht gjatë këtyre viteve, zoti Markos, shtëpia pësoi dëmtimet më të mëdha, që i patë edhe ju vetë me sytë tuaj në vitin 2002. Sigurisht, një pjesë e tyre ishin edhe për shkak të lënies pas dore për vite të tëra; unë tashmë isha plakur dhe nuk kisha më as energjinë dhe as vullnetin e duhur që të merresha me shtëpinë, ashtu siç isha marrë dikur. Pemët ishin tharë fare, kishin vite që nuk lidhnin asnjë frutë, bari ishte zverdhur, lule nuk kishte më. Por lufta u tregua e pamëshirshme me këtë shtëpi dikur aq të bukur. Xhamat e dritareve u thyen nga plasja e granatave kundërtank përreth saj. Një predhë e shkatërroi plotësisht murin lindor që binte në kopsht, dhe po ashtu edhe gjysmën e verandës, ku unë me Nilën kishim bërë aq shumë biseda dikur. Një granatë dëmtoi çatinë. Muret u bënë vrima-vrima nga plumbat.

Dhe pastaj filluan plaçkitjet, zoti Markos. Milicët hynin brenda dhe merrnin ç't'u pëlqente. Ata i morën të gjitha mobiliet, pikturat, qilimat turkmenë, statujat, shandanët prej argjendi, vazot e kristalta. Deri edhe pllakat prej lapisi i shkulën nga banakët e banjave. Një mëngjes u zgjova nga zhurma që bënin disa njerëz në hollin e shtëpisë. Dhe gjeta një bandë milicësh uzbekë duke shkulur qilimin e shkallëve me thika të harkuara. Vetëm ndenja aty dhe po i shihja. E ç'mund të bëja tjetër? E ç'e kishin ata të qëronin edhe një plak më shumë me një plumb në kokë?

Si shtëpia, edhe unë e Sulejmani po roniteshim nga dita në ditë. Shikimi m'u dobësua, gjunjët nisën të më dhembnin pothuajse çdo ditë. Të më falni për këtë vulgaritet, zoti Markos, por edhe urinimi u kthye në një torturë të vërtetë. Sigurisht, pleqëria e goditi Sulejmanin më ashpër se mua. Ai u mpak, u dobësua dhe u ligështua tej mase. Dy herë qe gati duke ikur, një herë gjatë ditëve më të këqija të luftës ndërmjet grupit të Ahmad Shah Masudit dhe atij të Gulbudin Hekmatjarit, kur kufomat dergjeshin në rrugë për ditë të tëra e askush nuk u

dilte për zot. Asokohe Sulejmani u sëmur nga pneumonia, nga aspirimi i vetë pështymës së vet, na tha mjeku. Edhe pse si mjekët, ashtu edhe barnat që na jepnin, mezi i gjeja, unë prapë ia dola mbanë që ta ktheja Sulejmanin nga ajo që ishte vdekje më se e sigurt.

Mbase nga izolimi prej botës ose mbase nga afria që kishim me njëri-tjetrin në ato ditë, unë e Sulejmani nisëm edhe të ziheshim shpesh. Ziheshim ashtu siç zihen çiftet e të martuarve, me kokëfortësi, me gjaknxehtësi edhe për gjëra nga më të kotat.

*- Por na bëre një herë bizele këtë javë!*

*- Jo, nuk bëra.*

*- Po, bëre. I bëre të hënën!*

Debate se sa lojë shahu kishim luajtur një ditë më parë. Pse ia vendosja gjithmonë ujin te parvazi i dritares, kur e dija që dielli do ta ngrohte?

*- Pse nuk më thirre kur kishe nevojë për oturakun, Sulejman?*

*- Të thirra. Të thirra njëqind herë.*

*- Për çfarë po më merr, për shurdh apo për dembel?*

*- S'është nevoja që të zgjedh, të dyja i ke.*

*- E bukur kjo, të të thërrasë dembel një njeri që e kalon gjithë ditën e tij në shtrat.*

Dhe vazhdonim kështu hidh e prit me orë të tëra.

Ai tundte kokën fort majtas e djathtas, kur unë përpiqesha ta ushqeja. Atëherë e lija dhe dilja duke e përplasur derën fort. Ndonjëherë, e pranoj, e mërzitja me qëllim. Ikja nga shtëpia. Ai bërtiste: "Ku po shkon?" - por unë nuk i ktheja përgjigje. Shtiresha sikur po ikja, sepse nuk kisha zgjidhje tjetër. Sigurisht, thjesht dilja pak më tej në rrugicë e pija ndonjë cigare, një zakon i ri, i fituar vonë. Por këtë e bëja vetëm kur isha vërtet i zemëruar. Ndonjëherë rrija jashtë për orë të tëra. Dhe, po qe se më kishte mërzitur vërtet shumë, rrija jashtë, derisa errësohej. Por gjithmonë kthehesha. Hyja në dhomën e tij pa thënë asnjë fjalë dhe e ktheja nga ana tjetër, ose ia

rregulloja jastëkun, ndërsa të dy i shmangeshim vështrimit të tjetrit, me buzë të shtrënguara fort, duke pritur që fjalën e parë të pajtimit ta thoshte tjetri.

Këto zënka, në fakt, morën fund me ardhjen e talebanëve, ata djelmosha fytyrëmprehtë me mjekra të zeza, sy të nxirë me qymyr dhe kamxhikë në dorë. Mizoritë dhe teprimet e tyre janë po ashtu të dokumentuara mjaft mirë dhe, edhe në këtë pikë, më duket e tepërt që t'i përmend këtu, zoti Markos. Më duhet ta pranoj se gjatë viteve të sundimit të tyre në Kabul, unë, si për ironi, pata një periudhë qetësie personale. Ata e ruanin zellin dhe poshtërsinë e tyre për të rinjtë, veçanërisht për gratë e gjora. Unë, unë isha plak tashmë. I vetmi nënshtrim imi ndaj regjimit të tyre ishte mjekra e gjatë, por edhe ajo, të them të drejtën, më kurseu mundimin e rruajtjes së përditshme.

- I ke vënë vulën, Nabi, - pëshpërinte Sulejmani nga shtrati, - nuk e ke më bukurinë e mëparshme. Tani dukesh si profet.

Në rrugë, talibanët më anashkalonin si të isha një lopë e mbarsur. Por edhe unë u vija në ndihmë me atë pamje si lopë në fytyrë, për të shmangur çdo lloj vëmendjeje të padëshirueshme. Por më ngjethet mishi, kur përfytyroj se çfarë do të kishte ndodhur ose çfarë mund t'i kishin bërë ata Nilës. Ndonjëherë, kur e sillja në mendje si kishte qenë dikur: duke qeshur në një festë me një gotë shampanjë në dorë, me krahët të zhveshur, me këmbët e gjata e të hajthme, më dukej sikur të gjitha këto i kisha sajuar unë. Sikur asgjë prej këtyre të mos kishte qenë ndonjëherë reale, jo vetëm ajo, por as edhe unë vetë, as Pahri, as Sulejmani i ri, i shëndetshëm dhe as ajo kohë e as shtëpia ku jetonim dikur të gjithë bashkë.

Dhe pastaj, një mëngjes të vitit 2001, hyra në dhomën e Sulejmanit me një tabaka me çaj dhe bukë të saponxjerrë nga furra. E kuptova në çast se diçka kishte ndodhur. Frymëmarrjen e kishte të rëndë. Faqja i ishte lëshuar edhe më shumë dhe, kur u mundua të thoshte diçka, nxori vetëm disa tinguj

kakarritës e pështëritës. Unë e lashë tabakanë dhe vrapova drejt tij.

- Po shkoj të thërras mjekun, Sulejman, - i thashë. - Vetëm prit, do të bëhesh më mirë, si gjithmonë.

Unë bëra të ikja, por ai po e tundte kokën me shumë forcë. Më bëri shenjë me gishtat e dorës së majtë.

U mundua disa herë të thoshte diçka, por unë nuk arrija të kuptoja asgjë.

- Më vjen keq, Sulejman, - i thashë, - më lër të shkoj e të gjej një mjek. Nuk vonohem.

Ai tundi përsëri kokën në shenjë mohimi, këtë herë më ngadalë, dhe nga të dy sytë e gërryer nga katarakti i rrodhën lot. Goja iu hap dhe iu mbyll. Më bëri shenjë me kokë drejt komodinës që gjendej te koka e shtratit. E pyeta a kishte nevojë për ndonjë gjë që gjendej aty. Ai mbylli sytë dhe pohoi me kokë.

Hapa sirtarin e sipërm. Por s'më zuri syri asgjë, përveç barnave, syzeve për afër, një shisheje të vjetër kolonje, një blloku shënimesh, lapsave prej karboni, që kishte vite që nuk i përdorte më. Po bëhesha gati ta pyesja se çfarë duhej të kërkoja, kur e pashë, nën bllokun e shënimeve. Ishte një zarf me emrin tim përsipër, shkruar me shkrimin e shtrembër të Sulejmanit. Brenda kishte një fletë letre, në të cilën ishte shkruar vetëm një paragraf. E lexova.

Pastaj pashë nga ai: thellimet tek tëmthat, faqet e fishkura, sytë e futur thellë në gropat e tyre.

Ai më bëri përsëri shenjë dhe unë u përkula mbi të. Ndieva frymën e tij të ftohtë, të ashpër mbi faqe. Dëgjova përplasjen e gjuhës në gojën e tharë ndërsa mundohej ta mblidhte veten. Dhe në njëfarë mënyre, mbase me një forcë të jashtëzakonshme vullneti - e fundit e tij - ia doli mbanë të më pështërinte në vesh.

Ajri më doli si shkulm nga mushkëritë. Mezi arrita t'i nxirrja fjalët që më ngecën në nyjen e formuar në fyt.

- Jo. Të lutem, Sulejman!

*"Më premtove."*

- Ende jo. Do të kujdesem unë për ty. Do ta shohësh. Do ta kalojmë edhe këtë, ashtu siç kemi bërë gjithmonë.

*"Më premtove."*

Sa kohë qëndrova aty, i ulur pranë tij? Sa gjatë u mundova ta bindja? Nuk mund t'jua them, zoti Markos. Më kujtohet që më në fund u ngrita në këmbë, dola nga ana tjetër e shtratit dhe u shtriva pranë tij. E ktheva me fytyrë nga unë. Dukej i lehtë si një ëndërr. I dhashë një puthje mbi buzët e thata, të plasaritura. Vendosa një jastëk mbi kraharorin tim, e mbështeta aty kokën e tij dhe e mbajta ashtu të përqafuar për një kohë të gjatë.

E vetmja gjë që më kujtohet pas kësaj, është mënyra se si i ishin zmadhuar bebëzat e syve.

U drejtova për te dritarja e dhomës dhe u ula aty, ndërsa tabakaja me çajin e Sulejmanit gjendej ende te këmbët e mia. Ishte një mëngjes me diell. Më kujtohet shumë mirë. Dyqanet do të hapeshin së shpejti, nëse nuk ishin hapur ende. Djemtë e vegjël do të niseshin për në shkollë. Pluhuri po ngrihej lart në ajër që tani. Një qen qëndronte shtrirë me përtaci në rrugë dhe mbi kokë i sillej një re e zezë mushkonjash. Dy djem të rinj me motoçikleta kaluan përpara shtëpisë. Edhe një kalimtar, që kishte hedhur një ekran kompjuteri në njërin sup dhe një shalqi në tjetrin.

Unë mbështeta ballin pas xhamit të ngrohtë të dritares.

Letra në sirtarin e Sulejmanit ishte testamenti i tij, me anë të të cilit ai më linte mua gjithçka. Shtëpinë, paratë, gjërat e tij personale, madje edhe makinën, edhe pse ajo ishte prishur prej kohësh. Karkasa e saj gjendej ende në kopshtin e shtëpisë, me goma të shpuara, si një grumbull hekurishtesh të ndryshkura.

Për disa kohë e humba toruan krejt, me plot kuptimin e

fjalës, dhe nuk dija më me se të merresha. Kisha kaluar më se gjysmë shekulli duke u kujdesur për Sulejmanin. Ekzistenca ime e përditshme kishte marrë trajtë sipas nevojave të tij, pranisë së tij. Tani isha i lirë të bëja çfarë të doja, por kjo liri po më dukej iluzion, sepse gjërat që i kisha dashur më shumë, nuk i kisha. Thonë që në jetë duhet të kesh një synim e të jetosh për ta përmbushur atë. Por, ndonjëherë, vetëm pasi ke jetuar gjatë, e kupton që jeta jote ka pasur një qëllim, një qëllim që nuk e kishe menduar kurrë. Dhe tani që unë e kisha përmbushur qëllimin tim, më dukej vetja i kotë e pa pikësynime.

Fillova të mos flija dot më në shtëpi; madje as edhe nuk mund të rrija më aty. Tani që Sulejmani nuk ishte më, ajo shtëpi më dukej shumë e madhe. Çdo cep i saj, çdo vrimë e skutë më zgjonte kujtime. Kështu që u ktheva përsëri në shtëpizën time të vjetër, në fund të kopshtit të pasmë. Pagova ca elektricistë për të bërë instalimet elektrike, që të paktën të kisha dritë për të lexuar e të mund të ndizja ventilatorin për t'u freskuar në verë. Për sa i përket hapësirës, nuk kisha nevojë për shumë. Gjërat e mia nuk përbënin më shumë se një shtrat, ca rroba për të veshur dhe një kuti me vizatimet e Sulejmanit. E di që kjo mund t'ju duket e çuditshme, zoti Markos. Paçka se, nga ana ligjore, shtëpia dhe gjithçka tjetër ishin tani të miat, unë vetë nuk ndihesha pronari i tyre i mirëfilltë dhe e dija që nuk do të ndihesha kurrë i tillë.

Lexoja nga pak, libra që i merrja në dhomën e vjetër të punës të Sulejmanit. Dhe i ktheja përsëri aty, pasi i mbaroja. Mbolla ca domate, ca fara mentesh. Dilja shëtitje më këmbë nëpër lagje, por gjunjët nisnin të më dhembnin përpara se të mund të arrija dy blloqe më tej, e kështu detyrohesha të kthehesha mbrapsht. Ndonjëherë thjesht nxirrja një karrige në kopsht e qëndroja aty pa bërë asgjë. Unë nuk isha si Sulejmani: vetmia nuk më shkonte fare për shtat.

Dhe pastaj, një ditë të vitit 2002, ju i ratë ziles së derës.

Në atë kohë, Aleanca Veriore i kishte përzënë talebanët

dhe në Afganistan kishin ardhur amerikanët. Me mijëra njerëz ishin dyndur në Kabul nga të katër anët e botës, për të ndërtuar klinika e shkolla, për të rindërtuar rrugët dhe kanalet e kullimit, për të sjellë ushqime, për të krijuar vende strehimi e për të hapur vende pune.

Përkthyesi që ju shoqëronte, ishte një djalosh i ri afgan, i veshur me një xhaketë lejla dhe me syze dielli në sy. Ai kërkoi pronarin e shtëpisë. Ju shkëmbyet ca vështrime të shpejta, kur unë i thashë përkthyesit se po flisnit me vetë pronarin. Ai nënqeshi e tha:

- Jo, Kaka, duam pronarin.

Unë ju ftova të dyve brenda për çaj.

Biseda që pasoi, në atë pjesë të verandës që kishte arritur të mbijetonte, ndërsa pinim çaj jeshil, u bë në gjuhën farsi. Por, siç e dini edhe vetë, zoti Markos, falë udhëzimeve dhe bujarisë suaj, unë kam mësuar pak anglisht qysh prej asaj kohe. Përkthyesi tha se ishit nga Tinosi, një ishull i Greqisë. Ishit mjek kirurg, pjesë e grupit mjekësor që kishte ardhur në Afganistan për të operuar fëmijët që kishin pësuar dëmtime të fytyrës nga lufta. Më thatë se ju dhe kolegët tuaj kishit nevojë për një shtëpi, për një shtëpi miqsh, siç e quajnë sot.

Dhe përkthyesi më pyeti se sa kushtonte qiraja.

Unë iu përgjigja:

- Asnjë metelik.

Ende më kujtohet se si i pulitët sytë, kur djaloshi me xhaketë lejla jua përktheu këto fjalë. E përsëritët pyetjen, mbase duke menduar se unë nuk e kisha kuptuar.

Përkthyesi u zhvendos në cep të karriges dhe u përkul drejt meje. Po fliste me një ton gjithë vetëbesim. Ai më pyeti se mos, vallë, isha i çmendur, a e kuptoja se ç'fitime po nxirreshin aktualisht në Kabul nga qiratë? Më tha se po qëndroja ulur mbi një minierë floriri.

I thashë së pari të hiqte syzet e diellit, kur fliste me një të moshuar. Dhe pastaj e këshillova që të bënte punën e tij, pra

të përkthente, dhe jo të më jepte këshilla, pastaj u ktheva nga ju dhe ju thashë, për shumë arsye, atë që ju e dini tashmë:

- Ju keni lënë vendin tuaj, - ju thashë, - keni lënë miqtë, familjen, dhe keni ardhur në këtë qytet të harruar nga Zoti për të ndihmuar vendin tim, njerëzit e tij. Si mund të përfitoj unë prej jush?

Përkthyesi i ri, të cilin nuk e pashë kurrë më, ngriti duart dhe po qeshte me përbuzje. Ky vend ka ndryshuar shumë, zoti Markos. Nuk ka qenë gjithmonë kështu.

Ndonjëherë, natën vonë, ndërsa qëndroj shtrirë i vetëm në dhomën time, shoh dritat e shtëpisë që vezullojnë. Ju shoh juve dhe shokët tuaj, veçanërisht zonjën e guximshme Amra Ademoviç, për zemrën e madhe të së cilës kam një admirim të pamatë, duke qëndruar në verandë ose në kopsht, duke ngrënë ose duke pirë cigare ose verë. Dëgjoj edhe muzikën që vjen prej andej, e ndonjëherë është muzikë xhaz, që më kujton Nilën.

Ajo tani ka vdekur, këtë e di. Ma tha zonja Amra. Unë i kisha folur për Vahdatët dhe i kisha treguar se Nila kishte qenë poete. Vitin e shkuar, zonja Amra gjeti një botim në frëngjisht në internet. Ishte një antologji e shkrimeve më të mira franceze të dyzet vjetëve të fundit. Aty ishte edhe një shkrim për Nilën. Dhe aty thuhej që ajo kishte vdekur në vitin 1974. Thjesht mendova se sa të kota kishin qenë ato vite shprese, kur prisja një letër nga një grua, ndërkohë që ajo kishte vdekur. Nuk më habiti aspak fakti që ajo kishte vrarë veten. Tani e di që disa njerëz janë po aq të palumtur sa ç'janë të tjerët të dashuruar: në fshehtësi, intensivisht, pashpresmërisht.

Më lejoni tani që ta mbyll, zoti Markos.

Orët e mia janë të numëruara tashmë. Po më lënë fuqitë çdo ditë e më shumë. Nuk ka për të zgjatur edhe shumë. Dhe falënderoj Zotin për këtë. Por edhe ju, zoti Markos, jo vetëm për miqësinë tuaj, por edhe për faktin që gjeni kohë të uleni me mua për të pirë çaj në kopsht e për të më rrëfyer për nënën

tuaj në Tanos e shoqen tuaj të fëmijërisë, Talian, po ashtu edhe për dashamirësinë tuaj ndaj bashkatdhetarëve të mi, sikurse edhe për shërbimet e paçmuara që po u ofroni fëmijëve.

Ju falënderoj, po ashtu, edhe për riparimet që po i bëni shtëpisë. Kam kaluar thuajse tërë jetën time aty, ajo është me plot kuptimin e fjalës shtëpia ime dhe jam i sigurt se edhe frymën e fundit do ta jap nën çatinë e saj. Unë e kam parë me dhembje e dëshpërim se si rrënohej dita-ditës. Por tani po shoh me gëzim të madh se si e kanë lyer sërish, si e kanë riparuar murin e kopshtit, si janë zëvendësuar dritaret dhe si është rindërtuar veranda, ku kam kaluar shumë e shumë orë të lumtura. Ju falënderoj, miku im, edhe për pemën që keni mbjellë, edhe për lulet që kanë lulëzuar përsëri në kopsht. Nëse vërtet kam dhënë njëfarë ndihmese për shërbimet që ju u keni ofruar njerëzve të këtij qyteti, atëherë ajo që keni bërë ju me shumë bujari për këtë shtëpi, është shpërblimi më i mirë për mua.

Por, edhe pse mund të dukem si njeri i pangopur, do të doja t'ju kërkoja dy ndere: një për veten time dhe një për dikë tjetër. E para, do të doja që të varrosesha në varrezën e *Ashuan-Arefan*-it, këtu në Kabul. Jam i bindur që e dini se ku është. Ecni në drejtim të skajit verior nga hyrja kryesore dhe, po të kërkoni aty, do të gjeni varrin e Sulejman Vahdatit. Gjeni një vend aty pranë dhe më varrosni aty. Kjo është e vetmja gjë që dua për veten time.

Gjëja e dytë është që ju të kërkoni mbesën time, Pahrin, pasi unë të kem vdekur. Po qe se ajo është ende gjallë, nuk do të jetë shumë e vështirë. Ky interneti na qenka një gjë kaq e mrekullueshme! Siç do ta shihni edhe vetë, i mbyllur në zarf, tok me këtë letër, është edhe testamenti im, me anë të të cilit unë po i lë asaj shtëpinë, paratë dhe gjithçka timen. Dua t'ju kërkoj që t'ia jepni asaj edhe këtë letër, edhe testamentin. Dhe ju lutem t'i thoni, t'i thoni se unë nuk e di aspak se ç'pasoja pati ajo që stisa unë. Thuajini se unë e gjeta ngushëllimin

vetëm te shpresa. Te shpresa se, mbase, kudo qoftë ajo tani, ka gjetur shumë më tepër paqe, mirësi, dashuri dhe lumturi nga sa lejon kjo botë.

Ju falënderoj, zoti Markos. Zoti ju mbrojttë!
Miku juaj i përjetshëm,
Nabi.

# Pesë

## *Pranverë 2003*

Ndihmësmjekja, që quhej Amra Ademoviç, i kishte paralajmëruar Idrizin dhe Timurin. Ajo i kishte tërhequr veçmas dhe u kishte thënë:

- Po qe se bëni ndonjë reagim sado të vogël, ajo do të trembet dhe unë do t'ju nxjerr jashtë.

Tani ata po qëndrojnë në fund të një korridori të gjatë të ndriçuar dobët, në pavionin e burrave, në spitalin "*Wazir Akbar Khan*". Amra u kishte thënë se i vetmi i afërm që i kishte mbetur vajzës, ishte daja, por, po ta kishin shtruar në pavionin e grave, ai nuk do të mund ta shihte dot. Prandaj stafi i kishte gjetur vajzës një vend në pavionin e burrave: jo në një dhomë të zakonshme, sepse do të ishte gjë e turpshme ta lije vajzën në një mjedis me burra të panjohur, por këtu, në fund të korridorit, në një zonë që nuk u përkiste as burrave, as grave.

- Dhe unë që besoja se talebanët kishin ikur nga qyteti, - thotë Timuri.

- Është çmenduri, apo jo? - thotë Amra, dhe pastaj qesh me djallëzi. Javën e parë të mbërritjes në Kabul, Idrizi e ndeshte shpesh këtë lloj të qeshure të shpenguar te punonjësit e huaj, të cilëve u duhej të mësoheshin me problemet dhe huqet e

kulturës afgane. Ai ndihet disi i ofenduar nga kjo lloj talljeje gazmore, nga kjo mënyrë e shpalosjes së epërsisë, edhe pse vendasit nuk duket se e vënë re, ose, të paktën, nuk e marrin për fyerje, kështu që mendon se edhe ai nuk duhet ta quajë të tillë.

- Por ty ata të lënë të vish këtu. Ti vjen dhe ikën, - i thotë Timuri.

Amra ngre njërën vetull përpjetë.

- Unë nuk vihem në hesap. Nuk jam afgane. Domethënë, unë nuk jam grua e vërtetë. S'e dinit këtë?

Timuri bën një buzëqeshje të pafajshme.

- Amra. Emër polak?

- Boshnjak. Pra, mos bëni asnjë reagim. Ky është spital, jo kopsht zoologjik. Më premtoni.

Timuri thotë:

- Të betohem.

Idrizi e sheh ndihmësmjeken i shqetësuar se mos ky ngacmim, paksa pa takt e i panevojshëm, mund ta ketë fyer, por, me sa duket, Timuri e ka hedhur lumin edhe këtë herë. Idrizit njëherazi i vjen keq dhe e ka zili kushëririn e vet për këtë aftësi. Atij Timuri gjithmonë i është dukur i ashpër, pa imagjinatë e pa ngjyra. Ai e di që Timuri e tradhton të shoqen, madje mashtron edhe me taksat. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Timuri është pronari i një kompanie që merret me vlerësimin e pasurive të patundshme, dhe Idrizi është më se i bindur që ai është i zhytur në mashtrime deri në fyt. Por Timuri është njeri tejet social, askush nuk ia vë re gabimet, ngaqë është tip me shumë humor, tepër miqësor dhe ka një fytyrë të pafajshme, që i bën për vete të gjithë ata që e takojnë. Edhe të qenët i pashëm nuk i ka sjellë ndonjë dëm: trup gjithë muskuj, sy jeshilë, gropëza që i formohen në faqe, kur qesh. Timuri - mendon Idrizi - është një burrë i rritur që gëzon privilegjet e një fëmije.

- Mirë, - thotë Amra. - Në rregull atëherë.

Ajo e largon çarçafin që kanë ngulur me gozhdë në tavan e që luan rolin e një perdeje për ndarje hapësirash, dhe i lë të hyjnë brenda.

Vajza, Roshi, siç e quajti Amra, që është shkurtimi i emrit Roshana, duket se është nja nëntë vjeç, mbase dhjetë. Ajo është ulur në një shtrat me kornizë hekuri, është mbështetur në mur dhe ka mbledhur e shtrënguar gjunjët pranë kraharorit. Idrizi ul sytë menjëherë. Ai ia del mbanë ta mbytë rënkimin, përpara se ky t'i dalë nga goja. Duket qartë që të njëjtën gjë ndien edhe Timuri. Ai bën "nc nc nc" me gjuhë dhe pastaj lëshon me një pështërimë të dhembshme: "Oh! Oh! Oh!". Idrizi sheh nga Timuri dhe nuk habitet aspak, kur vë re lotët teatrorë që ia rrëmbushin sytë.

Vajza shtrembëron fytyrën dhe lëshon një tingull hungëritës.

- E po, mbaruam, tani do të dalim, - thotë Amra prerazi.

Jashtë, te shkallët e përparme të dëmtuara, ndihmësmjekja nxjerr nga xhepi i sipërm i uniformës së saj bojëqielli një paketë *Marlboro* të kuqe. Timuri, lotët e të cilit janë tharë po aq shpejt sa edhe iu shfaqën në sy, merr një cigare dhe mandej ndez cigaren e saj e më pas të vetën. Idrizi ndien të përziera, i merren mendtë. Goja i është tharë. Ka frikë se nga çasti në çast do të vjellë dhe do të bëjë figurë të keqe, duke vërtetuar opinionin që ka Amra për të, për ata: të mërguarit e pasur, që kthehen në atdhe tani që gogolët kanë ikur, dhe shohin syshqyer kasaphanën që kanë lënë.

Idrizi pret që Amra t'i vërë në lojë, të paktën Timurin, por sjellja e saj është më shumë flirtuese se tallëse. Ky është ndikimi që ka Timuri mbi gratë.

- Pra, - thotë ajo me një ton kokete, - ç'do të më thuash ndonjë gjë për veten tënde, Timur?

Në Shtetet e Bashkuara, Timuri quhet Tim. Ai e ndryshoi emrin pas 11 shtatorit dhe thotë se qysh atëherë i ka dyfishuar fitimet e biznesit. Heqja e atyre dy shkronjave, i kishte thënë ai Idrizit, i pati sjellë më shumë përfitime karrierës së tij, nga

sa do t'i kishte sjellë një diplomë kolegji, po qe se do të kishte shkuar ndonjëherë në kolegj, çka ai nuk e kishte bërë; Idrizi është doktori i shkencave i familjes Bashiri. Por, qysh se kanë ardhur në Kabul, Idrizi e ka dëgjuar të kushëririn që të paraqitet vetëm si Timur. Është një hipokrizi krejtësisht e padëmshme, madje e domosdoshme. Gjithsesi, është e bezdisshme.

- Më fal për atë që ndodhi atje brenda, - thotë Timuri.

- Mbase duhet të të ndëshkoj.

- Hej, merre shtruar, mackë.

Amra kthehet nga Idrizi.

- Domethënë, ky është kauboji. Kurse ti, ti je njeriu i shtruar, i ndjeshëm. Ti je ... si e quajnë? *Introvert*.

- Ai është mjek, - thotë Timuri.

- Ah? Atëherë ky spital duhet të jetë shokues për ty.

- Ç'i ka ndodhur asaj? - thotë Idrizi. - Roshit. Kush e ka bërë ashtu?

Amra ngryset në fytyrë. Dhe, kur zë e flet, e bën me një ton të ashpër e të vendosur amënor:

- Unë po luftoj për të. Po luftoj me qeverinë, me burokracinë e spitalit, me neurokirurgët bastardë. Në çdo hap që hedh, unë luftoj për të. Dhe nuk kam për t'u ndalur. Ajo nuk ka njeri tjetër në këtë botë.

Idrizi thotë:

- Sikur na the se kishte një dajë.

- Edhe ai bastard është, - ajo shkund hirin e cigares. - Atëherë, për se u kthyet këtu, çuna?

Timuri nis të japë sqarimet. Në vija të përgjithshme po thotë pak a shumë të vërtetën. Që ata janë kushërinj, që familjet e tyre ishin larguar prej aty kur kishin ardhur sovjetikët, që kishin qëndruar një vit në Pakistan e mandej ishin vendosur përfundimisht në Kaliforni në fillimet e viteve tetëdhjetë. Që kjo është hera e parë që kthehen pas njëzet vjetësh. Por pastaj ai shton se janë kthyer për të "rikrijuar lidhjet", për "t'u mësuar", "për t'u bërë dëshmitarë" të rindërtimit pas gjithë atyre viteve të gjata lufte e shkatërrimi. Ata duan të kthehen

përsëri në Shtetet e Bashkuara - vazhdon ai - që të ndërgjegjësojnë njerëzit, të grumbullojnë fonde e "të ndihmojnë vendin e tyre".

- Ne duam të ndihmojmë vendin tonë, - thotë, duke e përsëritur me kaq sinqeritet atë fjali të lodhur, saqë Idrizi vihet në siklet.

Afërmendsh që Timuri nuk mund ta thotë arsyen e vërtetë të kthimit në Kabul: që të marrin përsëri pronën që u përkiste dikur baballarëve të tyre, shtëpinë ku kishin jetuar ai dhe Idrizi gjatë katërmbëdhjetë vjetëve të parë të jetës. Vlera e saj po rrok qiejt tani që në Kabul kanë ardhur mijëra punonjës të huaj e kanë nevojë për një vend ku të vendosen. Ata kishin qenë po atë ditë atje, te shtëpia e tyre, që tani ishte kthyer në vendstrehim për një grup të çorganizuar ushtarësh fytyrëlodhur të Aleancës Veriore. Ndërsa po largoheshin prej aty, kishin takuar një mesoburrë që jetonte në një shtëpi pak më tej, në të njëjtën rrugicë: një kirurg plastik grek, që quhej Marko Varvaris. Ai i kishte ftuar për drekë dhe i kishte marrë me vete në spitalin "*Wazir Akbar Khan*", ku kishte zyrën e vet edhe organizata jofitimprurëse për të cilën punonte ai. Markoja i kishte ftuar edhe në një festë që do të organizohej atë mbrëmje. Ata kishin mësuar për atë vajzë vetëm pasi kishin arritur në spital: duke dëgjuar dy punonjës të spitalit që po flisnin për të te shkallët e përparme. Atëherë Timuri e kishte kapur Idrizin për bërryli dhe i kishte thënë:

- Duhet të shkojmë ta shohim këtë rast, vëlla.

Amra duket se po mërzitet nga historia e Timurit.

Ajo flak tutje bishtin e cigares dhe rregullon llastikun me të cilin i ka lidhur topuz flokët e verdhë kaçurrelë.

- Atëherë, çuna, do të shihemi sonte në festë?

Ishte i ati i Timurit, xhaxhai i Idrizit, ai që i kishte dërguar djemtë përsëri në Kabul. Shtëpia e familjes Bashiri kishte

ndërruar disa herë pronar gjatë dy dhjetëvjetëshave të fundit të luftës. Rikthimi te pronarët origjinalë kërkonte kohë dhe pará. Gjykatat e vendit ishin tashmë të mbushura me qindra raste mosmarrëveshjesh për pronësinë. I ati i Timurit u kishte thënë se duhej "të manovronin" me burokracinë afgane, e famshme për përgjumjen dhe ngadalësinë e vet, një eufemizëm për shprehjen "duhen gjetur e lyer pëllëmbët e duhura".

- Kjo i takon sektorit tim, - kishte thënë Timuri, a thua se vërtet kishte qenë e nevojshme që ta thoshte.

I ati i Idrizit kishte vdekur nëntë vjet më parë, pas një lufte të gjatë me kancerin. Ai kishte vdekur në shtëpinë e vet, me gruan, të dy vajzat e Idrizin te koka e shtratit. Ditën kur kishte vdekur, një turmë njerëzish ishin dyndyr në shtëpi: xhaxhallarë e daja, teze e halla, kushërinj, miq e të njohur, që ishin ulur nëpër divane, kolltukë e karrige dhe, kur të gjitha këto ishin zënë, edhe te shkallët e mandej në dysheme. Gratë ishin mbledhur në dhomën e ngrënies e në kuzhinë. Dhe kishin përgatitur termos pas termosi me çaj. Idrizi, si djali i vetëm, ishte detyruar të nënshkruante të gjitha dokumentet e nevojshme: dokumentet e mjekut që erdhi të vërtetonte vdekjen e të atit; dokumentet për djalin e sjellshëm të zyrës funerale, që e kishte marrë trupin e të atit me arkivol.

Timuri nuk i ishte ndarë për asnjë çast. Ai e kishte ndihmuar që t'u përgjigjej telefonatave. Kishte mikpritur valët e njerëzve që kishin ardhur për të shprehur ngushëllimet e tyre. Kishte porositur oriz me mish qengji te "Qebaptorja e Abit", një restorant afgan ky që kishte për pronar një shokun e Timurit, Abdullanë, të cilin Timuri e thërriste me të qeshur Dajë Abi. Timuri kishte parkuar makinat e mysafirëve të moshuar, kur kishte nisur shiu. Krejt ndryshe nga Idrizi, Timuri ishte i lidhur ngushtë me komunitetin afgan në Amerikë; ai i pati thënë njëherë Idrizit se kishte mbi treqind emra dhe numra në telefonin e tij celular. Dhe atë natë ai edhe kishte ndërhyrë që njoftimi të jepej në një televizion afgan.

Pasditen e asaj dite, Timuri e kishte çuar Idrizin me makinë te zyra e funeralit në *Hayward*. Shiu po binte me gjyma dhe trafiku thuajse nuk lëvizte fare.

- Yt atë ishte njeri klase, vëlla. Ai ishte brumë i vjetër, - ishte ngashëryer Timuri, ndërsa ngiste makinën dhe vazhdonte të fshinte lotët me pëllëmbën e dorës së lirë.

Idrizi kishte pohuar fytyrëngrysur. Gjatë gjithë jetës së vet, ai nuk kishte qenë kurrë në gjendje që të qante në prani të njerëzve, madje as nëpër funerale, ku e donte zakoni. Ai e quante këtë si një lloj defekti të vogël, njësoj si verbëria ndaj ngjyrave. E prapë ndiente njëfarë zemërimi të lehtë ndaj Timurit - paçka se e kuptonte edhe vetë që ishte i paarsyeshëm - ngaqë në shtëpi ishte marrë ai me të gjitha e, madje, edhe me vajtimin dramatik. A thua se pati vdekur babai i vet.

Ata i kishin shoqëruar në një dhomë të qetë e të ndriçuar dobët, me mobilie të rënda me ngjyrë të errët. Aty i kishte pritur një burrë i veshur me xhaketë të zezë e flokët të ndarë me vijë në mes. I vinte era kafe e shtrenjtë. Me një ton zëri profesional, ai i kishte ofruar Idrizit ngushëllimet e veta dhe i kishte vënë përpara për të nënshkruar formularin e varrimit, si edhe i kishte pyetur se sa certifikata vdekjeje dëshironin. Në fund, i kishte vënë përpara Idrizit me shumë takt një broshurë me titullin "Lista e përgjithshme e çmimeve".

Pasi kishte pastruar fytin, drejtori i zyrës funerale i kishte thënë:

- Sigurisht që këto çmime nuk vlejnë, nëse babai yt ka qenë anëtar i xhamisë afgane në *Mission*. Ne kemi nënshkruar kontratë me ta. Ata do të paguajnë për gjithçka, për të gjitha shërbimet. Çdo gjë do ta keni të mbuluar prej tyre.

- S'e kam idenë në ishte apo jo anëtar, - kishte thënë Idrizi, duke shfletuar broshurën. I ati kishte qenë besimtar, ai e dinte këtë, por besimtar për veten e vet. Ai rrallë kishte shkuar në xhami edhe për lutjet e së premtes.

- Mund ta merrni në telefon xhaminë. Nuk ka problem.

- Jo, or mik. Nuk është nevoja, - kishte thënë Timuri. - Ai nuk ka qenë anëtar.

- Je i sigurt?

- Po. Më kujtohet një bisedë që kam dëgjuar.

- E kuptoj, - kishte thënë drejtori i zyrës funerale.

Jashtë ata kishin ndezur një cigare pranë *SUV*-it. Shiu kishte pushuar.

- Vjedhje me shumë klasë, - kishte thënë Idrizi.

Timuri kishte kapërcyer një pellg me ujë shiu.

- Biznes i fuqishëm, gjithsesi... vdekja... na duhet ta pranojmë. Njerëzit gjithmonë kanë nevojë. Ta hajë dreqi, ia kalon edhe shitjes së makinave.

Në atë kohë, Timuri kishte një firmë për shitjen e makinave të përdorura. Në fillim kishte qenë duke falimentuar, keq fare, derisa më në fund kishte vendosur të përfshinte në biznes edhe një shokun e vet. Dhe, në më pak se dy vjet, ai e kishte shndërruar në një ndërmarrje me shumë përfitime. "Një njeri që e ka bërë fatin me duart e veta", - thoshte shpesh i ati i Idrizit për nipin e vet. Kurse Idrizit po i bëhej viti i dytë që punonte me një rrogë prej skllavi si mjek në Departamentin e Sëmundjeve të Brendshme në Qendrën Mjekësore të "*University of California, Davis*". Dhe gruaja e tij prej një viti, Nahila, punonte tridhjetë orë në javë si sekretare në një firmë ligjore, ndërkohë që mësonte për provimin e *LSAT*-it[1].

- Po i pranoj si hua, - i kishte thënë Idrizi. - Ti e kupton, Timur. Do të t'i kthej paratë.

- Pa merak, vëlla. Si të duash ti.

Kjo nuk ishte hera e parë ose e fundit që Timuri e ndihmonte ekonomikisht Idrizin. Kur Idrizi ishte martuar, Timuri i kishte bërë dhuratë për dasmë një *Ford Explorer*. Timuri u kishte huajtur paratë, kur Idrizi dhe Nahila kishin blerë një apartament në një kompleks me administrator qendror

---

1) *Low School Admission Test* = Testi i pranimit në shkollën e drejtësisë në SHBA (*shën. i përkth.*).

në Davis. Në familje, ai kishte qenë gjithmonë xhaxhai i parapëlqyer për çdo fëmijë. Nëse Idrizi do të detyrohej ndonjëherë të bënte vetëm një telefonatë të vetme, personi të cilit do t'i telefononte, ishte Timuri.

Por prapë, Idrizit i kishte rënë në vesh se që të gjithë njerëzit e fisit e dinin për paratë që i pati huajtur Timuri. Ua kishte thënë vetë ai. Dhe në dasmë Timuri i kishte kërkuar këngëtarit që të pushonte pak, se do të bënte një lajmërim, dhe i kishte zgjatur Idrizit e Nahilës çelësat e *Ford Explorer*-it me shumë ceremoni, madje në tabaka, përpara dasmorëve tejet të vëmendshëm. Blicet e aparateve fotografike kishin vetëtirë nga të katër anët. Pikërisht kjo nuk i pëlqente Idrizit: buja, kapardisja, dëshira e pacipë për t'u dukur, trimaçëria. Ai nuk donte t'i mendonte të tilla gjëra për kushëririn e vet, të cilin e kishte tamam si vëlla, por i ishte krijuar përshtypja se Timuri qe nga ata njerëz që ia bënin vetë reklamën vetes, dhe bujaria e tij - dyshonte Idrizi - ishte thjesht një element i përllogaritur mirë i karakterit të tij të ndërlikuar.

Një natë, ndërsa ndërronin çarçafët e shtratit, Idrizi dhe Nahila kishin bërë një debat të vogël për këtë.

*- Të gjithë duan që të pëlqehen nga të tjerët, - i kishte thënë ajo. - Pse, ti nuk do?*

*- Në rregull, por unë nuk do të paguaja për ta fituar këtë.*

Ajo i kishte thënë se po tregohej i padrejtë, madje mosmirënjohës, pas gjithë atyre gjërave që pati bërë Timuri për ta.

*- Nahila, ti nuk po më kupton. Unë po të them se është mungesë ndjeshmërie t'i nxjerrësh në gazetë të mirat që ke bërë. Janë gjëra që bëhen në heshtje, me dinjitet. Bujaria nuk tregohet duke i nënshkruar çeqet në publik.*

- *E po,* - i kishte thënë Nahila, duke shtrirë çarçafin e larë, - *gjithsesi është shumë ndihmuese, zemër.*

- O Zot, më kujtohet ky vend, - thotë Timuri, duke par shtëpinë. - Si quhej pronari, ma thuaj edhe një herë?

- Më duket se Vahdati, - thotë Idrizi. - S'më kujtohe emri i tij.

Atij i kujtohet ajo pafundësi herësh që kanë luajtur përpar kësaj dere, kur ishin fëmijë, dhe vetëm tani pas njëzet vjetësh për herë të parë po e kalojnë pragun e saj.

- Zoti dhe mënyrat e veta, - mërmërit Timuri.

Është një shtëpi e zakonshme dykatëshe, që në lagjen e Idrizit në *San Jose* do të kishte zemëruar edhe HOA[1]-t. Por sipas standardeve të Kabulit është një pronë e këndshme, me mure të larta, dyer metalike dhe një rruginë të gjerë. Ndërsa një rojë e armatosur i shoqëron brenda të dy kushërinjtë, Idriz vë re përsëri atë që ka parë gjatë gjithë këtyre ditëve në Kabul: shtëpia e ruan shkëlqimin e vjetër edhe nën peshën e rëndë të rrënimit që i kanë shkaktuar vitet, të cilat kanë lënë gjurmë të dukshme aty: vrima plumbash, plasaritje zigzage në mure, tulla të zbuluara nga rënia e suvasë në zona të tëra, gëmusha të thara, drurë pa gjethe në kopshtin e pasmë, bar i tharë. Më shumë se gjysma e verandës që sheh në kopshtin e pasmë, është shkatërruar. Por po ashtu, si edhe në shumë gjëra të tjera në Kabul, tani aty duken edhe shenjat e para të një ringjalljeje të ngadaltë, ngurruese. Dikush ka nisur ta lyejë shtëpinë përsëri, ka mbjellë trëndafila në kopsht, po rindërtohet përsëri pjesa lindore e munguar e murit të kopshtit, edhe pse po del pak si i shtrembër. Një skelë ngrihet në anën e shtëpisë që sheh nga rruga, çka e shtyn Idrizin të mendojë se kanë nisur ta riparojnë çatinë. Dhe duket që ka nisur edhe riparimi i verandës.

Në hollin e shtëpisë takojnë Markosin. Ai është një burrë me sy bojëqielli dhe flokë të hollë të thinjur. Ka veshur një

---

1) HOA është një minoritet në Vietnam, që e konsideron veten si kinezë: kinezë *han* (*shën. i përkth.*).

petk afgan ngjyrëgri dhe në kokë ka vënë një *kafijeh*[1] që e ka lidhur me shumë elegancë rreth qafës. Ai i fut në një dhomë të zhurmshme gjithë tym duhani.

- Kam çaj, verë dhe birrë. Apo doni ndonjë gjë më të rëndë?

- Ti vetëm na thuaj çfarë do të na japësh, dhe ne i mbushim gotat vetë, - thotë Timuri.

- Oh, ti më pëlqyeke! Ja atje, pranë magnetofonit. Për akullin mos kini merak. Është bërë me ujë shishesh.

- Falë Zotit!

Timuri është plotësisht vetvetja në të tilla raste dhe Idrizi nuk mund të mos ia admirojë sjelljen e shpenguar, shakatë e holla e të pasforcuara, hijeshinë e tij. Ai e ndjek pas kushëririn te bari, ku Timuri mbush nga një gotë për të dy nga një shishe me pije ngjyrë rubini.

Në dhomë gjenden nja njëzet a më shumë të ftuar, që janë ulur në jastëkët e shtruar përreth saj. Dyshemeja është e mbuluar me një qilim afgan në ngjyrë të kuqe të errët. Dekori nuk bie shumë në sy, por është ujdisur me shumë shije, çka Idrizi e quan "elegancë e mërgimtarëve". Disku në magnetofon shpërndan tingujt e butë të Nina Simones. Të gjithë po pinë, thuajse të gjithë po pinë duhan, po flasin për luftën e re në Irak dhe ç'pasoja do të ketë ajo për Afganistanin. Televizori në qoshe të dhomës është ndalur në kanalin e *CNN*-it ndërkombëtar, pa zë. Nata në Bagdad, nën darën e "*Shoko dhe paralizo*"[2], shpaloset nën vezullimin e dritave jeshile.

Me gotën me vodkë e akull në dorë, pranë tyre vijnë zoti Markos dhe dy djem të rinj gjermanë tejet seriozë, që punojnë për *World Food Program*. Si shumica e të huajve të ardhur në

---

1) Mbulesë koke prej pambuku, tipike për arabët (*shën. i përkth.*).

2) Sulm i shpejtë e i fuqishëm ushtarak, që ka për qëllim zotërimin e menjëhershëm të kundërshtarit dhe paralizimin e fuqisë e të vullnetit të tij për të luftuar (*shën. i përkth.*).

Kabul për ndihmë, edhe ata i duken Idrizit njerëz fjalëkursyer, që të shtien disi frikën e që nuk emocionohen lehtë.

Ai i thotë Markosit:

- Kjo shtëpi është e bukur.

- Thuaja pronarit këtë, - i thotë Markosi dhe mandej drejtohet për në anën tjetër të dhomës e kthehet me një burrë të moshuar e të dobët. Burri ka një mur flokësh të dendur, të pathinjur plotësisht, të krehur lart mbi ballë. Ai ka lënë pak mjekër dhe faqet i ka të futura brenda si një njeri thuajse pa dhëmbë. Ka veshur një kostum ngjyrë ulliri të dalë boje, që duhet të ketë qenë në modë në vitet 1940. Markosi i buzëqesh me shumë ngrohtësi plakut.

- Nabi xhan? - shpërthen Timuri dhe edhe Idrizit i kujtohet në çast.

Plaku buzëqesh me druajtje.

- Më falni, jemi takuar gjë më parë?

- Unë jam Timur Bashiri, - thotë Timuri në gjuhën farsi. - Shtëpia jonë ka qenë në të njëjtën rrugicë me tuajën.

- Oh, o Zot i madh! - psherëtin plaku. - Timur xhan? Kurse ti duhet të jesh Idriz xhani?

Idrizi pohon me kokë dhe buzëqesh edhe ai.

Nabi i përqafon që të dy. I puth në faqe duke buzëqeshur e duke i vështruar i çuditur. Idrizit i kujtohet kur Nabi shtynte nëpër lagje karrocën e padronit të tij, zotit Vahdati. Ndonjëherë këta të dy ndaleshin në rrugicë dhe shikonin Timurin e Idrizin, teksa luanin futboll me djemtë e tjerë të lagjes.

- Nabi xhani ka jetuar në këtë shtëpi qysh prej vitit 1947, - thotë Markosi, duke ia hedhur Nabit krahun në qafë.

- Domethënë tani je ti pronari i kësaj shtëpie, - thotë Timuri.

Nabi buzëqesh me fytyrën e habitur të Timurit.

- Unë i shërbeva zotit Vahdati këtu qysh prej vitit 1947 e deri në 2000-shin, kur vdiq. U tregua shumë zemërgjerë që ma la mua shtëpinë me testament.

- Ta dhuroi? - pyet i habitur Timuri.

Nabi pohon me kokë:

- Po.

- Duhet të kesh qenë kuzhinier i jashtëzakonshëm!

- Kurse ti, po qe se më lejohet ta them, ke qenë paksa i prapë, me sa më kujtohet.

Timuri qesh.

- S'e kam vrarë ndonjëherë mendjen që të jem i urtë dhe i butë, Nabi xhan. Këto ia kam lënë këtij kushëririt tim këtu.

Markosi, duke tundur gotën me pije në dorë, i thotë Idrizit:

- Nila Vahdati, gruaja e pronarit të mëparshëm, ka qenë poete. Madje me njëfarë fame, kam marrë vesh. Ke dëgjuar ndonjëherë për të?

Idrizi mohon me kokë.

- E vetmja gjë që di unë për të, është se ajo kishte ikur nga ky vend përpara se të lindja unë.

- Ajo ka jetuar në Paris me të bijën, - thotë njëri nga gjermanët, Tomasi. - Vdiq në vitin 1974. Vrau veten, më duket. Kishte probleme me alkolin ose të paktën kështu shkruhej aty. Një a dy vjet më parë më dhanë një përkthim në gjermanisht të njërit prej vëllimeve të saj të hershme me poezi dhe m'u dukën vërtet të mira. Edhe pse paksa erotike, me sa më kujtohet.

Idrizi pohon me kokë, duke u ndier disi i paaftë, sepse tani është një i huaj që po i mëson diçka për një artiste afgane. Pak hapa më tej, Timuri po debaton me këmbë e me duar me Nabin për koston e qirave. Në gjuhën farsi, sigurisht.

- A e ke idenë se sa i shkon qiraja një vendi të tillë, Nabi xhan? - po i thotë ai plakut.

- Po, - thotë Nabi, duke pohuar me kokë e duke qeshur. - E di se sa kanë shkuar qiratë në qytet.

- Ti mund t'i mjelësh këta djem.

- E mirë...

- Kurse ti po i lë të rrinë këtu falas.

- Ata kanë ardhur për të ndihmuar vendin tonë, Timur xhan. Kanë lënë shtëpitë e tyre dhe kanë ardhur këtu. Nuk më duket e drejtë që, siç e thua ti, "t'i mjel".

Timuri lëshon një psherëtimë dhe e kthen gotën e vodkës me fund.

- E po, ti ose i urren paratë, mik i vjetër, ose je njeri shumë më i mirë se unë.

Amra hyn në dhomë e veshur me një tunikë afgane ngjyrë safiri dhe me një palë xhinse me ngjyrë të zbehtë.

- Nabi xhan! - thërret ajo. Nabi duket paksa i çuditur, kur ajo e puth në faqe dhe i shkon krahun. - E dua fort këtë njeri, - u drejtohet ajo të tjerëve. - Dhe më pëlqen ta vë në siklet.

Pastaj i drejtohet Nabit për t'ia thënë të njëjtat fjalë në gjuhën farsi. Ai tund kokën sa para-mbrapa dhe qesh, ndërsa faqet i skuqen lehtë.

- Si thua sikur të më vësh edhe mua në siklet? - thotë Timuri.

Amra i bie lehtë në kraharor.

- Ky është njeri shumë i prapë.

Ajo puthet me Markosin sipas traditës afgane tri herë në faqe, pastaj edhe me gjermanët.

Markosi i shkon krahun rreth belit.

- Amra Ademoviç. Gruaja më punëtore në Kabul. S'do të donit të ndesheshit me një vajzë të tillë. Dhe, po ashtu, ajo ju lë të gjithëve në bisht, kur është fjala për të pirë.

- Pa ta provojmë një herë, - thotë Timuri, duke kapur një gotë te banaku pas tij.

Burri plak, Nabi, kërkon leje për t'u larguar prej aty.

Në atë njëorësh a më shumë në vijim, Idrizi përzihet me të tjerët, ose të paktën mundohet ta bëjë. Ndërsa shishet me pije alkolike zbrazen, bisedat arrijnë kulmin. Idrizi dëgjon gjermanisht, frëngjisht e një gjuhë që duhet të jetë greqisht. Ai pi një tjetër gotë me vodkë dhe pas saj një birrë. Me një grup tjetër merr guximin të rrëfejë një anekdotë për Mulla

Omarin[1], që ia kishin treguar në gjuhën farsi në Kaliforni. Por anekdotës nuk i del kuptimi, kur përkthehet në anglisht, dhe në fund rezulton në një shaka pa kripë. Ai i afrohet një tjetër grupi, ku dëgjon një bisedë për një pab irlandez që do të hapet së shpejti në Kabul. Të gjithë pohojnë se nuk do ta ketë jetën të gjatë.

Ai ecën nëpër dhomë, me krikllën me birrë të ngrohur në dorë. Kurrë nuk është ndier mirë në festa të tilla. Mundohet ta kalojë kohën duke kundruar dekorin. Aty sheh fotografi gjigante të Budave të Bamjënit[2], të lojës Buzkashí[3], të një porti të quajtur Tinos, në Greqi. Nuk e ka dëgjuar kurrë këtë emër. Dhe pastaj syri i zë një fotografi në holl: bardhezi, paksa e turbullt, si e nxjerrë me një aparat fotografik të bërë vetë. Aty duket një vajzë e re me flokë të gjatë të zinj, që i ka kthyer shpinën aparatit. Ajo është në plazh, ulur mbi një shkëmb, me fytyrë nga deti. Cepi i poshtëm i majtë i fotografisë duket sikur është djegur.

Për darkë shërbejnë kofshë qengji të marinuar me rozmarinë e thelpinj të vegjël hudhrash. Gjithashtu edhe sallatë me djathë deleje dhe makarona me salcë *pesto*[4]. Idrizi merr pak sallatë dhe shkon ta hajë në një cep të dhomës. Sytë i zënë Timurin, ulur pranë dy grave tërheqëse holandeze. "Gjithmonë

---

1) *Mullah Mohammed Omar* (lindur rreth 1959), udhëheqësi shpirtëror i talebanëve dhe Kryetari i Këshillit të Lartë të Afganistanit në vitet 1995 - 2001 (*shën. i përkth.*).

2) The *Buddhas of Bamiyan*, dy statuja gjigante të Budës, që datojnë në shekullin e 6-të, të gdhendura në një faqe shkëmbore në lartësinë 2.500 metra në luginën e *Bamiyan*-it në rajonin e *Hazarajatit*, 230 km në veriperëndim të Kabulit (*shën. i përkth.*).

3) Lloj sporti i ngjashëm me polon, tradicional për Azinë Qendrore (*shën. i përkth.*).

4) Salcë me borzilok, vaj ulliri, hudhra të shtypura, stika pishe dhe djathë parmixhiano (*shën. i përkth.*).

tërheq vëmendjen", - mendon Idrizi me vete. Të qeshurat shpërthejnë dhe njëra nga gratë i prek gjurin Timurit.

Idrizi del në verandë me një gotë verë në dorë dhe ulet në stolin prej druri. Tani ka rënë mbrëmja dhe veranda ndriçohet vetëm nga dy llamba të zbehta që varen nga tavani. Që këtu ai arrin të shohë format e një shtëpize në fund të kopshtit dhe, në të djathtë të tij, karkasën e një makine: e gjatë, e madhe, e vjetër, me shumë gjasa amerikane, nisur nga harkimet e saj. Një model i viteve dyzet, mbase pesëdhjetë, Idrizi s'mund ta thotë dot dhe, veç kësaj, ai vetë nuk ka qenë kurrë i dhënë pas makinave. Por është i sigurt se Timuri do ta njihte. Kushëriri do ta përcaktonte me saktësi modelin, vitin e prodhimit, fuqinë e motorit dhe gjithçka tjetër. Makina duket se po qëndron mbi katër rrota të shfryra. Një qen nga një shtëpi aty pranë nis të lehë me tërbim. Brenda, dikush vendos në magnetofon një disk të Leonard Kohenit.

- I qetë dhe i ndjeshëm.- Amra ulet pranë tij, ndërsa akulli tringëllin në gotën e saj. Është këmbëzbathur. - Kushëriri yt kauboj, ai është shpirti i festës.

- Nuk habitem.

- Është shumë i pashëm. I martuar është?

- Me tre fëmijë.

- Shumë keq. Atëherë duhet të sillem mirë.

- Jam i bindur që ai do të mërzitej, po ta dëgjonte këtë.

- E po, unë kam rregullat e mia, - thotë ajo. - Sikur ty nuk të pëlqen shumë ai.

Idrizi i thotë të vërtetën, pra që Timuri është thuajse si vëlla për të.

- Por ama ai të vë në siklet.

Është e vërtetë. Timuri e ka vënë në siklet. Ai është sjellë si një afganoamerikan tipik i shëmtuar, mendon Idrizi. Ai sillet nëpër këtë qytet të dërrmuar nga lufta si t'i përkasë atij, u rreh supet vendasve tejet miqësisht dhe i thërret *vëlla, motër, dajë*; u jep pará lypsarëve me shumë bujë, nga ajo që ai e quan *qeska e bakshisheve*; bën shaka me gratë e moshuara, që i

thërret *nëne,* dhe i nxit që t'i rrëfejnë historinë e tyre përpara kamerës së aparatit të tij, ndërsa sajon në fytyrë një shprehje dhembjeje, si të jetë një prej tyre, si të ketë qenë gjithmonë këtu, si të mos kishte qenë kurrë në palestrën e *San Joses*, duke u stërvitur për të tonizuar muskujt e barkut e të kraharorit, kur këta njerëz këtu plaçkiteshin, vriteshin, përdhunoheshin. Kjo është hipokrizi dhe gjë e shpifur. Dhe Idrizi habitet se si askush nuk e kupton këtë.

- Ajo që të tregoi ai, nuk është e vërtetë, - thotë Idrizi. - Ne kemi ardhur këtu që të marrim prapë shtëpinë e baballarëve tanë. Kjo është e gjitha. Fare e thjeshtë.

Amra shpërthen në të qeshura.

- Sigurisht që e di. Pse, ti mendon se e hëngra? Mua më është dashur të merrem me gjeneralë lufte e me talebanë në këtë vend. Kam parë nga të gjitha. Asgjë nuk më habit më. Asgjë e askush nuk ma hedh dot më.

- Them se është e vërtetë.

- Ti je njeri i ndershëm, - thotë ajo. - Të paktën, ti je i ndershëm.

- Unë thjesht mendoj që këta njerëz... e gjithë ajo që kanë kaluar... e po ne duhet të kemi respekt për ta. Dhe, kur them "ne", e kam fjalën për njerëz si puna ime dhe e Timurit. Ne, njerëzit me fat. Ne, që nuk ishim këtu, kur mbi këtë vend po binin bombat e ferrit. Ne nuk jemi si këta njerëz. Dhe nuk duhet ta pretendojmë këtë. Historitë që tregojnë ata... nuk na përkasin neve. Unë po llomotit...

- Po llomotit?

- Po them gjëra pa kuptim.

- Jo, e kuptoj se çdo të thuash, - thotë ajo. - Po më thua që historitë e tyre janë dhurata që ata jua japin juve.

- Dhuratë. Po.

Ata kthejnë një gllënjkë verë. Flasin për pak kohë dhe kjo është biseda e parë e vërtetë që ka bërë Idrizi qysh kur ka ardhur në Kabul, pa ngacmime ose qesëndisje të lehta dhe pa atë mosmirëtimin e vagët që kishte ndier te vendasit, te zyrtarët

ose te punonjësit e fondacioneve të bamirësisë. Ai e pyet për punën e saj dhe ajo i tregon se ka qenë në Kosovë me forcat e Kombeve të Bashkuara, në Ruandë pas gjenocidit, në Kolumbi, madje edhe në Burgundi. Në Kamboxhia është marrë me fëmijët që i kishin mbijetuar prostitucionit të detyruar. Në Kabul po mbush vitin tani, punësimi i saj i tretë, këtë herë për një organizatë të vogël jofitimprurëse, që ndihmon në spital dhe në një klinikë ambulatore të hënave. Dy herë e martuar, të dy herët e divorcuar, pa fëmijë. Idrizi e ka të vështirë ta përcaktojë moshën e Amrës, edhe pse mendon se ajo është më e re nga sa duket. Pas atyre dhëmbëve të verdhë e atyre rrathëve të lodhjes nën sy, fshihet një hije bukurie, një lloj seksualiteti i ashpër. Por, pas katër a pesë vjetësh, mendon Idrizi, do ta humbasë edhe këtë.

Dhe pastaj ajo thotë.

- Dëshiron të dish se çfarë i ka ndodhur Roshit?

- Nuk është nevoja të ma tregosh, - ia kthen ai.

- Mendon se jam e dehur?

- Je?

- Paksa, - thotë ajo. - Por ti je njeri i ndershëm. - Ajo troket butë me gishta në supin e tij, paksa lozonjare. - Ti më pyet për arsye të drejta. Afganët e tjerë si puna jote, ata afganët që vijnë nga Perëndimi, gati - si i thoni ju - sa s'thyejnë qafën.

- U shtrembërohet qafa duke parë. Kanë kërshëri të tepruar.

- Tamam.

- Siç do të shihnin diçka pornografike.

- Por ti mbase je djalë i mirë...

- Po të ma thuash, - ia kthen ai, - do ta konsideroj si dhuratë.

Dhe kështu ajo nis t'i rrëfejë.

Roshi jetonte me prindërit, dy motrat dhe vëllanë e vogël, në një fshat në një të tretën e rrugës nga Kabuli për në Bagram. Një të premte, muajin e shkuar, xhaxhai i saj, vëllai i madh i

të atit, kishte shkuar për vizitë. Për gati një vit i ati i Roshit dhe xhaxhai ishin zënë për shtëpinë ku jetonte Roshi me familjen e vet, që xhaxhai mendonte se i takonte atij, meqë ishte vëllai më i madh. Por gjyshi i saj ia kishte lënë shtëpinë djalit më të vogël, babait të saj, që ishte edhe fëmija më i dashur për të. Atë ditë që xhaxhai shkoi për vizitë, nuk pati asnjë problem. Ai i kishte thënë se donte t'u jepte fund zënkave.

Prandaj nëna e Roshit kishte therur e rrjepur dy pula, kishte përgatitur një tenxhere të madhe me pilaf dhe kishte blerë shegë të freskëta në treg. Kur kishte ardhur xhaxhai, ai dhe babai i Roshit ishin përqafuar e puthur. I ati i Roshit e kishte përqafuar e rrokur të vëllanë aq fort, sa këtij i ishin shkëputur këmbët nga tapeti. Nëna e Roshit kishte qarë nga lehtësimi. Familja ishte ulur për të ngrënë. Të gjithë kishin ngrënë edhe pjatën e dytë, edhe një të tretë. Dhe pastaj shegët. Pas kësaj, nëna kishte shërbyer çajin jeshil me ca çokollata. Dhe xhaxhai kishte kërkuar ndjesë, pasi i duhej të shkonte në banjën jashtë shtëpisë.

Kur ishte kthyer përsëri brenda, mbante një sëpatë në dorë.

- Nga ato që përdoren për të prerë pemët, - thotë Ambra.

Të parin qëlloi babanë e Roshit.

- Roshi më tha se i ati as që e mori vesh se çfarë ndodhi. Nuk arriti të shihte asgjë.

Një goditje e vetme në qafë, nga pas shpine. Gati ia preu kokën. E dyta ishte nëna e Roshit. Roshi e pa të ëmën teksa mundohej të luftonte, por ai i lëshoi ca goditje në fytyrë e në kraharor, kështu që heshti edhe ajo. Fëmijët tani po ulërinin e po ia mbathnin në të katër anët. Xhaxhai nisi t'i ndiqte. Roshi pa njërën nga motrat që po vraponte në korridor, por xhaxhai e kapi për flokësh dhe e shtriu përtokë. Motra tjetër arriti të largohej nga korridori. Xhaxhai e ndoqi pas dhe Roshi e dëgjoi teksa ky shqyente derën e dhomës, pastaj klithma e pastaj asgjë.

- Dhe kështu, Roshi vendosi të ikte bashkë me vëllanë e vogël. Vrapuan të dilnin jashtë shtëpisë, por dera ishte e mbyllur. E kishte mbyllur xhaxhai, sigurisht.

Ata nisën të vraponin në oborrin e pasmë, gjithë panik e dëshpërim, e mbase edhe harruan që aty nuk kishte derë dhe muret ishin shumë të larta e s'mund t'i kapërcenin. Xhaxhai doli nga shtëpia dhe u nis drejt tyre. Roshi pa të vëllanë, që ishte vetëm pesë vjeç, që u hodh në *tandoor*-in, ku, vetëm një orë më parë, e ëma kishte pjekur bukën. Ajo e dëgjoi teksa ulërinte e bërtiste mes flakëve, ndërkohë që ajo vetë u pengua dhe ra në tokë. E ktheu kokën tamam në çastin kur pa qiellin blu dhe sëpatën që po i vërsulej. Dhe pastaj asgjë.

Amra hesht. Brenda, Leonard Koheni këndon një version *dal vivo* të *"Who By Fire"* [*Kush do të ikë mes zjarrit*?[1]]. Edhe po qe se goja do t'ia bënte të thoshte ndonjë gjë, Idrizi prapë nuk do të kishte ditur ç'të thoshte. Ai mund të thoshte diçka, mund të kishte pasur ndonjë shpërthim zemërimi, po të kishte mësuar se këtë e kishin bërë talebanët ose Al-Kaeda, ose ndonjë komandant muxhahedin maniak i tërbuar. Por për këtë nuk mund t'ia vësh fajin Hekmatjarit, as Mulla Omarit, as Bin Ladenit, as Bushit dhe as luftës së tij kundër terrorizmit. Arsyeja më banale dhe më e zakonshme e masakrave ndonjëherë është shumë më e tmerrshme, shumë më shokuese. Në mendje i vjen menjëherë fjala "i pandjeshëm". Kjo është ajo që thonë njerëzit gjithmonë. "Një akt dhune i pandjeshëm". "Një vrasës i pandjeshëm". A thua se do të mund të kishte ndonjëherë ndonjë vrasës të ndjeshëm.

Ai mendon përsëri për Roshin në atë spital: e mbështetur pas murit, me këmbët përthyer e shtrënguar pranë kraharorit, me një pamje fëmijërore në fytyrë. Hapja në kokën e saj të rruar, ajo masë e shkëlqyeshme indi trunor, sa një grusht, që kërcen prej aty e qëndron mbi kokën e saj si nyja e turbanit të një sikhiu.

---

1) Në kuptimin "Kush do të vdesë prej zjarrit" (*shën. i përkth.*).

- Ta ka treguar vetë këtë histori? - e pyet ai më në fund.

Amra tund kokën fort në shenjë pohimi.

- Asaj i kujtohet gjithçka shumë pastër. Çdo hollësi. Është në gjendje të tregojë çdo imtësi. Unë uroj që të harrojë, për shkak të ëndrrave të këqija.

- Po me të vëllanë, ç'u bë?

- Shumë djegie.

- Dhe xhaxhai?

Amra ngre supet.

- Thuhet që duhet të jemi të kujdesshme, - thotë ajo. - Në punën time, thuhet që duhet të tregohemi të kujdesshme, të sillemi me profesionalizëm. Nuk është gjë e mirë të lidhemi ngushtë me pacientët. Por Roshi dhe unë....

Befas muzika hesht. Kanë ikur dritat. Për pak çaste gjithçka kridhet në errësirë, ndriçohet vetëm nga drita e hënës. Idrizi dëgjon njerëzit që shfryjnë brenda në shtëpi. Llambat halogjene ndizen njëra pas tjetrës.

- Unë luftoj për të, - thotë Amra, pa i ngritur sytë për asnjë çast. - Unë nuk ndalem.

Të nesërmen Timuri shkon bashkë me gjermanët në qytetin Istalif, që njihet për prodhimin artizanal të enëve prej bakri.

- Duhet të vish edhe ti.

- Sot do të rri brenda e do të lexoj, - ia kthen Idrizi.

- Mund të lexosh kur të kthehesh në *San Jose*, vëlla.

- Kam nevojë të pushoj pak. Më duket se piva shumë mbrëmë.

Pasi gjermanët vijnë dhe e marrin Timurin, Idrizi qëndron edhe për pak kohë në shtrat, me sytë ngulur te një poster reklame i viteve gjashtëdhjetë i varur në mur: katër turistë biondë që po buzëqeshin, ndërsa i ngjiten shkëmbit përgjatë liqenit Band-e-Amir, një relikte e fëmijërisë së vet në Kabul përpara luftërave, përpara tmerrit. Pasdite del të bëjë një

shëtitje. Për drekë ha qebap në një restorant të vogël. E ka të vështirë ta shijojë ashtu i rrethuar nga fytyra të ngërdheshura fëmijësh që ia ngulin sytë dhe e shohin ndërsa ha. Është frymëmekëse. Idrizi e pranon që Timuri ia del mban mjaft më mirë se ai në të tilla raste. Timuri do ta shndërronte në lojë. Ai fërshëllen dhe fëmijët lypsarë i mblidhen përreth dhe ai i jep secilit disa kartëmonedha nga *qesja e bakshisheve*. Ndërsa i nxjerr kartëmonedhat njërën pas tjetrës, ai përplas thembrat e këpucëve dhe përshëndet. Fëmijët e adhurojnë. E përshëndetin edhe ata. E thërrasin *Kaka*. Dhe ndonjëherë edhe i qepen pas.

Pas drekës, Idrizi merr një taksi dhe i kërkon ta çojë në spital.

- Por më parë do të ndalosh në Pazar, - thotë ai.

Me kutinë në dorë, ai ecën nëpër korridor midis muresh të veshura me zhgarravina: dhoma me qese plastike në vend të dyerve, një burrë plak këmbëzbathur me njërin sy të lidhur, pacientë që qëndrojnë të shtrirë në shtretërit e tyre në dhoma shumë të nxehta, që nuk kanë llamba ndriçuese. Gjithçka mban era thartirë. Në fund të korridorit ai ndalet përpara perdes dhe e ngre. Në zemër ndien një shtrëngim, kur e sheh vajzën të ulur buzë shtratit. Amra është ulur në gjunjë përpara saj dhe po i lan dhëmbët e vegjël.

Në anën tjetër të shtratit është ulur një burrë thatim, i djegur nga dielli, me një mjekër si qime miu dhe flokë të zinj të ashpër. Kur Idrizi hyn brenda, burri çohet menjëherë në këmbë, vendos pëllëmbën e hapur të dorës në gjoks dhe përkulet. Idrizit përsëri i bën përshtypje fakti që vendasit e kuptojnë shumë shpejt se ai është një afgan që jeton në Perëndim; fakti që vetëm ideja se ai ka pará e pushtet, i jep në këtë qytet një përparësi që nuk i takon. Burri i paraqitet Idrizit si daja i Roshit.

- Erdhe përsëri? - i thotë Amra, duke futur furçën e dhëmbëve në një gotë me ujë.

- Shpresoj të mos përbëjë problem.

- Aspak, - ia kthen ajo.

Idrizi pastron fytin.

- *Salaam*, Roshi.

Vajza sheh nga Amra për t'i marrë leje. Zëri i del si pëshpërimë.

- *Salaam.*

- Të kam sjellë një dhuratë.

Idrizi e vë kutinë në tokë dhe e hap. Sytë e Roshit gjallërohen, kur ai nxjerr nga kutia një televizor të vogël dhe një *videoplejër*. Ai i tregon edhe katër filmat që ka blerë. Shumica e kasetave në dyqan ishin me filma indianë ose filma me aksion, ose me arte marciale me Xhet Linë, Zhan Klod Van Damin, të gjithë filmat e Stiven Sigalit. Por ai ia ka dalë mbanë të gjejë edhe "*EjTi-Jashtëtokësori*", "*Derrkuci Bejbi*", "*Historia e lodrave*" dhe "*Gjiganti i hekurt*". Ai i ka parë të gjithë këta tok me djemtë e vet në shtëpi.

Në gjuhën farsi, Amra e pyet Roshin se çfarë dëshiron të shohë. Roshi zgjedh "*Gjigantin e hekurt*".

- Do të të pëlqejë shumë, - i thotë Idrizi. Ai e ka të vështirë ta shohë drejtpërdrejt. Sytë e tij rrëshqasin mbi kokën e saj të dëmtuar, mbi atë masë vezulluese truri, mbi rrjetën e venave e të kapilarëve.

Në këtë dhomë në fund të korridorit nuk ka prizë elektrike dhe Amrës i duhet pak kohë sa të gjejë një zgjatues, por, kur Idrizi e vendos televizorin në prizë dhe ndez ekranin, buzët e Roshit shtrijnë një buzëqeshje vesh më vesh. Në buzëqeshjen e saj Idrizi kupton se sa pak e njeh botën ai vetë, edhe pse është tridhjetë e pesë vjeç: sa pak e njeh egërsinë, mizorinë, kafshërinë e saj të pafund.

Kur Amra kërkon ndjesë që të shkojë të shohë pacientët e tjerë, Idrizi ulet buzë shtratit pranë Roshit dhe nis ta shohë

filmin bashkë me të. Daja është vetëm një hije e heshtur në dhomë. Në gjysmë të filmit ikin dritat. Roshi nis të qajë dhe daja përkulet mbi të e ia përkëdhel dorën. Ai i pëshpërit ca fjalë të shkurtra në gjuhën pashto, që Idrizi nuk e kupton. Roshi ngërdheshet dhe mundohet të largohet prej tij. Idrizi sheh dorën e saj të vogël, që humbet në dorën e madhe, të fuqishme e të shtrënguar fort të dajës.

Idrizi vesh pallton.

- Do të vij përsëri nesër, Roshi, dhe do të shohim një film tjetër bashkë. Ke qejf?

Roshi mblidhet kruspull nën batanije. Idrizi sheh dajën dhe përfytyron se si do të ishte sjellë Timuri me këtë burrë: Timuri, i cili, krejt ndryshe nga ai, nuk përjeton dot as emocionin më të vogël. "Më lër dhjetë minuta vetëm për vetëm me të", - do të kishte thënë ai.

Daja e ndjek pas deri jashtë. Te shkallët, ai e lë pa mend Idrizin, kur i thotë:

- Unë jam viktima e vërtetë këtu, *Sahib*. - Por, me sa duket, e vë re pamjen që merr fytyra e Idrizit, sepse e ndreq menjëherë atë që ka thënë. - Sigurisht, ajo është viktima. Por, dua të them, edhe unë jam një viktimë. Ti e kupton këtë, sigurisht, ti je afgan. Por këta të huajt, këta nuk e kuptojnë.

- Më duhet të shkoj, - thotë Idrizi.

- Unë *mazdoor* jam, punëtor i thjeshtë. Në ditët më të mira fitoj një dollar, mbase dy, *Sahib*. Por kam pesë fëmijë. Njërin e kam të verbër. Dhe ja tani, edhe këtë kisha mangët, - psherëtin ai. - Ndonjëherë i them vetes - Zot më fal - i them vetes se mbase Allahu duhet ta kishte lënë Roshin të... e po, ju e kuptoni. Mbase do të kishte qenë më mirë. Sepse, po ju pyes ju, *Sahib*, cili është ai burrë që do të pranonte të martohej me të tani? Ajo nuk ka për të gjetur kurrë burrë. Dhe kujt i ngelet të kujdeset për të? Mua. Mua do të më duhet të kujdesem përgjithmonë për të. - Idrizi e kupton që e kanë vënë me shpatulla për muri. Fut dorën në xhep dhe nxjerr portofolin. - Sa të kesh mundësi, *Sahib*. Jo për mua, sigurisht. Për Roshin.

Idrizi i zgjat dy kartëmonedha. Daja pulit sytë dhe sheh paratë. Dhe bën të thotë:

- Dy... - pastaj mbyll gojën dhe i shtrëngon buzët fort, a thua se ka frikë se mos Idrizi e kupton gabimin.

- Bliji një palë këpucë të mira, - i thotë Idrizi, duke zbritur shkallët.

- Allahu ju bekoftë, *Sahib*! - thotë daja. - Ti je njeri i mirë. Ti je njeri i mirë dhe i dhembshur.

Idrizi vjen ta shohë përsëri të nesërmen, po ashtu edhe të pasnesërmen. Shumë shpejt kjo i bëhet rutinë dhe ai e gjen veten çdo ditë të ulur pranë Roshit. Ai tani i njeh të gjithë punonjësit e spitalit me emër, ndihmësmjekët që punojnë në katin e parë, portierin, rojat e paushqyera e me pamje të lodhur te dyert e spitalit. Ai mundohet t'i mbajë krejtësisht të fshehta vizitat e tij. Në telefonatat me shtëpinë, nuk i tregon asgjë Nahilës për Roshin. Dhe as Timurit nuk i thotë se ku po shkon, pse nuk po shkon bashkë me të në Paghman a për të takuar nëpunësin e Ministrisë së Brendshme. Por Timuri e merr vesh, gjithsesi.

- Gjë e mirë për ty, - i thotë ai. - Është gjë e mirë kjo që po bën, - dhe, pasi hesht për një çast, shton: - Vetëm tregohu i kujdesshëm.

- Do të thuash që të mos shkoj më?

- Për një javë do të ikim, vëlla. Nuk besoj se do që ajo të lidhet shumë pas teje.

Idrizi pohon me kokë. Dhe vret mendjen se mos ndoshta Timuri është paksa xheloz për marrëdhënien e tij me Roshin e mbase edhe i vjen pak keq, sepse ai, Idrizi, mund t'ia ketë vjedhur mundësinë për të luajtur rolin e heroit. Idrizi e përfytyron Timurin, në një skenë me lëvizje të ngadalta, duke dalë nga një ndërtesë në flakë, me një foshnjë në krahë. Turma

shpërthen në brohoritje. Idrizi është i vendosur këtë herë: ai nuk do ta lejojë Timurin ta ekspozojë Roshin në këtë mënyrë.

Por prapë, Timuri ka të drejtë. Ata do të kthehen në shtëpi pas një jave dhe Roshi tani ka nisur ta thërrasë *Kaka* Idriz. Po qe se i shkon me vonesë, e gjen të nervozuar. Ajo ia lidh krahët rreth belit dhe lehtësimi i përhapet valë-valë në fytyrë. Ardhja e tij është gjëja që ajo mezi pret më shumë gjatë një dite, ia ka thënë ajo vetë këtë. Ndonjëherë ajo ia shtrëngon dorën fort me të dyja duart e veta, ndërsa shohin filmin. Kur nuk është pranë saj, ai mendon shpesh për pushin e zbehtë në krahët e saj, për sytë e vegjël larushë, për këmbët e bukura, faqet e rrumbullakëta, për mënyrën se si i vë pëllëmbët e duarve nën mjekër, kur ai nis t'i lexojë ndonjë nga ata librat për fëmijë që i ka blerë te dyqani pranë liceut francez. Disa herë edhe ia ka lejuar vetes që të përfytyrojë se si mund ta marrë me vete në Shtetet e Bashkuara, se si mund ta afrojë me djemtë, Zabin dhe Lemarin. Vitin e fundit, ai dhe Nahila e kishin diskutuar mundësinë për të bërë një fëmijë të tretë.

- Po tani? - i thotë Amra një ditë përpara nisjes.

Po atë ditë, disa orë më parë, Roshi i kishte dhuruar Idrizit një vizatim me laps në një fletë spitali: dy silueta pranë njëra-tjetrës duke parë televizor.

Ai kishte bërë me gisht drejt siluetës me flokë të gjatë:

- *Ti je kjo.*

- *Dhe ky këtu je ti, Kaka Idriz.*

- *Domethënë ti i ke pasur flokët të gjatë? Dikur?*

- *Motra m'i krihte çdo natë. Ajo dinte se si të m'i krihte e të mos më dhembnin.*

- *Duhet të ketë qenë motër e mirë.*

- *Kur të më rriten prapë, do të m'i krehësh ti.*

- *Them se do të më pëlqejë.*

- *Mos ik, Kaka. Mos më lër.*

- Ajo është vajzë e dashur, - i thotë ai Amrës. Dhe është e vërtetë. Ajo sillet mirë dhe është fëmijë i shtruar. Me një lloj ndjenje faji atij i vijnë ndër mend djemtë e tij në *San Jose,*

Zabi dhe Lemari, të cilët ka kohë që i urrejnë emrat e tyre afganë dhe që po shndërrohen me të shpejtë në dy tiranë të vegjël, në ata fëmijët tipikë e të llastuar amerikanë, tamam si ata që ai e Nahila ishin betuar se nuk do t'i bënin kurrë.

- Ajo është një e mbijetuar, - thotë Amra.

- Tamam.

Amra mbështetet pas murit. Disa ndihmës kalojnë pranë tyre, duke shtyrë një shtrat me rrota. Aty është shtrirë një djalë i ri, me një fashë gjithë gjak rreth kokës dhe me një plagë të hapur në kofshë.

- Afganët e tjerë nga Amerika, ose nga Europa, - thotë Amra, - vijnë që t'i bëjnë fotografi Roshit. Bëjnë edhe video. Bëjnë premtime. Dhe pastaj kthehen në shtëpitë e tyre dhe ua tregojnë njerëzve të shtëpisë. Si të jetë një kafshë kopshti zoologjik. Unë i lejoj, se mendoj që mund të ndihmojnë. Por ata harrojnë. Unë nuk dëgjoj më asgjë për ta. Dhe prandaj po të pyes përsëri, po tani?

- Për operacionin që ka nevojë ajo? - thotë ai. - Do të përpiqem që ta bëj të mundur.- Ajo e sheh gjithë ngurrim. - Ne kemi një klinikë neurokirugjikale në spital. Do të flas me shefen time. Do ta rregullojmë që ajo të vijë me avion në Kaliforni dhe t'i nënshtrohet operacionit.

- Në rregull, po paratë?

- Do t'i gjejmë. Në rastin më të keq, do ta paguaj unë.

- Nga kuleta jote.

Ai qesh.

- Shprehja është "nga xhepi im", gjithsesi, po.

- Do të na duhet t'i marrim leje dajës.

- Po qe se duket prapë..

Daja s'është bërë më i gjallë, që kur Idrizi i dha ata dyqind dollarët.

Amra i buzëqesh. Ai nuk e ka bërë kurrë më parë diçka të tillë. Seç ka diçka entuziazmuese, helmuese, madje euforike në mënyrën se si ai po përfshihet kokë e këmbë në këtë detyrë.

Idrizi ndihet gjithë energji. Dhe kjo gati ia mek frymën. Për habinë e vet, edhe sytë i mbushen me lot.

- *Hvala!* - thotë ajo. - Falemnderit!

Pastaj ngrihet në majat e gishtave dhe e puth në faqe.

- Bëra seks me një nga ato holandezet, - thotë Timuri. - Një nga ato që takuam në festë. - Idrizi largon vështrimin nga dritarja. Ai po mrekullohej me majat e buta bojëkafe të masivit malor Hindu Kush nën ta. Kthen kokën nga Timuri që është ulur në ndenjësen aty pranë. - Me atë brunen. Mora një gjysmë kokrre vitaminë V[1] dhe s'u ndala derisa erdhi ora e lutjes së mëngjesit.

- O Zot! A do të rritesh ndonjëherë ti?! - thotë Idrizi, i acaruar se Timuri e ka shkarkuar sërish mbi të tradhtinë e vet, sjelljen e vet jonormale, sjelljen prej adoleshenti të papërmbajtshëm.

Timuri qesh nën hundë.

- Kushëri, mos harro: ajo që ndodh në Kabul...

- Të lutem, mos e mbaro atë fjali.

Timuri qesh.

Andej nga fundi i avionit po bëhet një lloj feste. Dikush po këndon në gjuhën pashto, ndërsa një tjetër po i bie një pjate plastike si të jetë *tamburá*, daulle.

- S'më besohet që takuam plakun Nabi, - mërmërin Timuri. - O Jezus!

Idrizi nxjerr nga xhepi pilulën kundër turbullimit prej avionit, të cilën është munduar të mos e përdorë, dhe e gëlltit pa ujë.

- Kështu pra, do të kthehem përsëri muajin që vjen, - thotë Timuri, duke kryqëzuar krahët e duke mbyllur sytë. - Me siguri që do të më duhet të vij edhe disa herë të tjera, por s'do të kemi probleme.

---

1) Viagra *(shën. i përkth.)*

- Ti i zë besë këtij Farukut?

- Për atë dreq, jo! Prandaj dhe jam i detyruar të vij përsëri.

Faruku është avokati që ka punësuar Timuri. Ai merret pikërisht me çështjet e afgane që kanë jetuar në mërgim e janë kthyer tani për të rimarrë pronat që kanë humbur në Kabul. Timuri vijon më tej duke folur për dokumentet që do të plotësojë Faruku, për gjykatësin që shpresohet ta marrë përsipër çështjen e që është një kushëri i dytë i gruas së Farukut. Idrizi e mbështet përsëri kokën pas xhamit të dritares dhe pret që pilula të nisë të bëjë efekt.

- Idriz! - thotë Timuri me zë të qetë.

- Po?

- Shumë gjëra të shëmtuara pamë atje, ë?

- "Gjithë surpriza je përbrenda, vëlla". Po, - thotë Idrizi me zë.

- Një mijë tragjedi për kilometër katror, o burrë.

Shumë shpejt Idrizi nis të dremitë, sytë i vishen. Ndërsa e kaplon gjumi, ai rikujton sërish ndarjen me Roshin: ai që po i mban gishtat, duke i thënë se do shihen përsëri, ajo që dënes lehtë, thuajse në heshtje, me kokën mbështetur pas barkut të tij.

Rrugës për në shtëpi nga aeroporti i San Franciskos, Idrizi kujton me përmallim kaosin e trafikut të Kabulit. Tani i duket si çudi që po ecën me *Lexus*-in e tij nëpër korsitë e shtruara e të rregullta të autostradës 101, që është e mbushur me tabela udhëzuese të vlefshme e ku të gjithë shoferët ecin me rregull e bëjnë vazhdimisht shenja me sinjale. Kujtimi i atyre adoleshentëve të krisur me taksi, të cilëve ua besonin veten ai dhe Timuri në Kabul, e bën të vërë buzën në gaz.

Në ndenjësen e pasagjerit, Nahilës nuk i reshtin pyetjet. A ishte e sigurt jeta në Kabul? Si ishte ushqimi? A u sëmur? A i mori të gjitha në fotografi ose në video? Ai mundohet t'i përgjigjet sa më saktë që mundet. I përshkruan shkollat e

shkatërruara, të pastrehët që jetonin në ndërtesa pa çati, lypsarët, dritat që iknin e vinin. Por është njësoj si të mundohesh të përshkruash muzikën me fjalë. Ai nuk mund t'i përshkruajë të gjitha ashtu siç kanë qenë. Ato hollësitë e gjalla, mbresëlënëse: një palestër badibildingu në Kabul, në mes të rrënojave, me një fotografi të Arnold Shvarcenegerit në xham. Të tilla hollësi i shpëtojnë tani dhe përshkrimi që po bën, i duket i përgjithshëm, i thatë, pa ngjyra, si kronikat që përshkruajnë gazetat.

Në ndenjësen e pasme, djemtë qeshin me të dhe herë pas here e dëgjojnë, ose të paktën bëjnë sikur e dëgjojnë. Idrizi e ndien mërzitinë e tyre. Dhe pastaj Zabi, që është tetë vjeç, i kërkon Nahilës që të vërë filmin. Lemari, që është vetëm dy vjet më i madh, mundohet të dëgjojë për një kohë më të gjatë, por shumë shpejt Idrizit i kap veshi zhurmën e një makine gare në "*Nintendo DS*" të tij.

- Si është puna me ju, çuna? - i ngacmon Nahila. - Babi sapo është kthyer nga Kabuli. S'jeni aspak kureshtarë të mësoni diçka? Nuk keni ndonjë pyetje?

- S'ka problem, - thotë Idrizi. - Lëri.

Por atë e mërzit kjo mungesë interesi, injoranca e tyre e shpenguar, pasojë e lotarisë arbitrare gjenetike që u ka dhuruar një jetë të privilegjuar. Befas ai ndien një lloj largësie midis tij e familjes së vet, edhe nga Nahila, shumica e pyetjeve të së cilës lidhen me restorantet dhe mungesën e banjave të brendshme. Ai tani i sheh në mënyrë akuzuese, ashtu siç duhet ta kenë parë atë vetë vendasit, kur arriti fillimisht në Kabul.

- Më ka marrë uria, - thotë ai.

- Çfarë ke qejf të hash? - thotë Nahila. - Sushi? Gatim italian? Në *Oakridge* është hapur një restorant i ri.

- Më mirë ushqim afgan, - thotë ai.

Ata shkojnë te "Qebaptorja e Abit" në anën lindore të *San Jose*-s, pranë tregut të vjetër të gjërave të përdorura "*Berryessa Flea Market*". Pronari, Abdullai, është një burrë

flokëbardhë në fillimet e të gjashtëdhjetave, me mustaqe të varura dhe krahë të fuqishëm. Ai është një nga pacientët e Idrizit, ashtu si dhe e shoqja. Abdullai ngre kokën nga regjistri dhe i përshëndet, teksa Idrizi dhe familja e tij hyjnë brenda në restorant. "Qebaptorja e Abit" është një biznes i vogël familjar. Aty gjenden vetëm tetë tryeza, me mbulesa kadifeje shpesh gjithë vaj e menu të laminuara, fotografi të mëdha të Afganistanit nëpër mure, një automat i vjetër pijesh dhe një banak, në një qoshe të të cilit janë ekspozuar gatimet. Abdullai mirëpret klientët, merret me faturat, pastron. Gruaja e tij, Sulltana, qëndron në pjesën e pasme: ajo është njeriu përgjegjës për gatimet magjike. Idrizi e përfytyron tani në kuzhinë, me flokët të mbledhur nën një kapuç të pastër, me sytë e picërruar ngulur mbi avullin që del nga tenxheret. Siç i kanë thënë ata vetë Idrizit, Abdullai dhe Sulltana janë martuar andej nga fundi i viteve '70 në Pakistan, kur komunistët pushtuan Afganistanin. Në vitin 1982 fituan azilin në Shtetet e Bashkuara dhe po këtë vit kishte lindur edhe vajza e tyre, Pahri.

Ajo tani po merr porositë e tyre. Pahri është një vajzë miqësore dhe e sjellshme, ajo ka lëkurën e zbehtë të së ëmës dhe të njëjtin vezullim fortësie emocionale në sy. Çuditërisht, ka një trup jo në përpjesëtimet e duhura: e hollë e shpatullngushtë në pjesën e sipërme, por vithegjerë e me këmbë të trasha. Tani ka veshur njërin prej fundeve të saj të zakonshme të gjera.

Idrizi dhe Nahila porositin mish qengji me bollgur dhe *bolani*. Djemtë porositin *çapli* qebap, gjëja më e afërt me qoften e hamburgerit që gjejnë në menu. Ndërsa presin porosinë, Zabi i tregon Idrizit se ekipi i tij i futbollit ka arritur në finale. Ai është mesfushor i djathtë. Ndeshja do të luhet të dielën. Lemari thotë se të shtunën ka koncert recital me kitarë.

- Çfarë do të luash? - e pyet Idrizi me një zë gjithë përtesë, ndërsa ndien përsëri efektin e udhëtimit me avion.

- "*Paint it black*" ["*Lyeje me bojë të zezë*"].

- Shumë mirë.

- Nuk e di a je ushtruar sa duhet, - thotë Nahila, me një zë qortues të kujdesshëm.

Lemari hedh në tryezë pecetën prej letre që po rrotullonte në dorë.

- Ou, mami! Vërtet? Nuk e sheh se sa shumë gjëra kam për të bërë çdo ditë?

Nga mesi i drekës, Abdullai u vjen pranë për t'i përshëndetur, duke fshirë duart me përparësen që ka lidhur në brez. I pyet a po u pëlqen gatimi, a duan që t'u sjellë ndonjë gjë tjetër.

Idrizi i thotë se ai e Timuri sapo janë kthyer nga Kabuli.

- Me çfarë po merret Timur xhani tani? - pyet Abdullai.

- Si gjithmonë, me gjëra jo fort të mira. - Abdullai buzëqesh. Idrizi e di se sa shumë e do ai Timurin. - Po ty, si po të shkon biznesi i qebapit?

Abdullai psherëtin.

- Doktor Bashiri, po qe se do të doja ndonjëherë të mallkoja njeri, do t'i thosha: "Zoti të dhëntë një restorant".

Ata qeshin të tërë.

Pak më vonë, ndërsa largohen nga restoranti dhe hipin në *SUV*-in e tyre, Lemari thotë:

- Babi, të gjithëve ua jep drekën falas ai?

- Sigurisht që jo, - ia kthen Idrizi.

- Po atëherë, pse ty nuk t'i pranoi paratë?

- Ngaqë jemi afganë dhe ngaqë unë jam mjeku i tij, - thotë Idrizi, por kjo është vetëm një pjesë e së vërtetës. Arsyeja e vërtetë, dyshon ai, është fakti që ai është kushëriri i Timurit dhe pati qenë Timuri ai që, vite më parë, i kishte huajtur Abdullait paratë për të hapur restorantin.

Në shtëpi, Idrizi habitet kur i gjen të ngritura tapetet e hollit e të dhomave, dërrasat e gozhdët e shkallëve e të dyshemeve të ekspozuara. Dhe pastaj i kujtohet që ata ishin duke rregulluar shtëpinë, duke i zëvendësuar tapetet me parket: pllaka të gjera prej druje qershie, me një ngjyrë që personi përgjegjës për zgjedhjen e dyshemesë e kishte quajtur "tenxhere

bakri". Dyert e bufesë në kuzhinë ishin hequr dhe aty ku dikur qëndronte furra me mikrovalë, tani gjendet një vrimë e madhe. Nahila i thotë se të hënën do të punojë vetëm gjysmë dite, kështu që do të ketë mundësi të takojë Xhezonin dhe punëtorët që do të shtrojnë dyshemenë.

- Xhezonin? - dhe pastaj i kujtohet: Xhezon Spiri, djali që do të ndërtonte kinemanë në shtëpi.

- Ai do të vijë të marrë masat. Fortafolësit dhe projektorin i ka sjellë, dhe na ka bërë edhe ulje çmimi. Të mërkurën do të sjellë tre djem që të fillojnë punën.

Idrizi pohon me kokë. Kinemaja në shtëpi kishte qenë ideja e tij, diçka që ai e kishte dëshiruar gjithmonë. Por tani ndihet si i shkëputur nga e gjitha kjo: Xhezon Spiri, bufeja e re, dyshemeja si "tenxhere bakri", atletet me qafa 160--dollarëshe të djemve, mbulesa prej kadifeje e shtratit në dhomën e tij, energjia me të cilën i kanë ndjekur këto gjëra ai dhe Nahila. Frytet e ambicies së tij tani po i duken të kota. Ato tani i kujtojnë vetëm pabarazinë e egër që ekziston ndërmjet jetës së tij dhe asaj në Kabul.

- Si është puna, zemër?

- Më ka zënë avioni, - thotë Idrizi. - Kam nevojë të marr një sy gjumë.

Të shtunën ai shkon të dëgjojë recitalin me kitarë të Lemarit dhe të dielën sheh pjesën më të madhe të ndeshjes së Zabit. Gjatë pjesës së dytë, përvidhet në parking dhe e zë gjumi për rreth gjysmë ore. Për fat, Zabi nuk e vë re këtë. Të dielën në mbrëmje u vijnë për darkë disa fqinjë. Ata i kalojnë dorë më dorë fotografitë që ka bërë Idrizi në Kabul, dhe shohin me shumë qetësi videon njëorëshe që ka xhiruar ai, për çka ngul këmbë Nahila, përkundër mosdëshirës së Idrizit. Gjatë darkës, ata e pyesin Idrizin se si është situata në Afganistan. Ai rrufit *mojiton* e vet dhe u përgjigjet me fraza të shkurtra.

- S'arrij ta përfytyroj dot se si mund të jetë jeta atje, - thotë Sinthia. Ajo është instruktore fitnesi në palestrën ku shkon Nahila.

- Kabuli është... - Idrizi mundohet të gjejë fjalët e sakta, - ...një mijë tragjedi për kilometër katror.

- Duhet të ketë qenë një shok kulturor vajtja atje.

- Po ishte, - por Idrizi nuk mund të pohojë që në të vërtetë shok kulturor qe kthimi në shtëpi.

Në përfundim, biseda zhvendoset te vjedhja e letrave postare që ka ndodhur kohët e fundit në lagjen e tyre.

I shtrirë në shtrat atë natë, Idrizi thotë:

- Mendon se na duhen patjetër të gjitha këto?

- "Të gjitha këto"? - përsërit Nahila. Ai arrin ta shohë atë në pasqyrë, duke larë dhëmbët mbi duarlarëse.

- Po, të gjitha këto. Të gjitha këto gjëra.

- Jo, nuk është se na duhen patjetër, po qe se do të thuash këtë, - thotë ajo, mandej shpëlan gojën dhe pështyn në duarlarëse.

- Nuk të duket se është shumë, e gjitha kjo?

- Idriz, ne kemi punuar shumë. A të kujtohen MCAT-i, LSAT-i, mjekësia, juridiku, vitet që kaluam në shtëpi me qira? Askush nuk na dhuroi asgjë. Nuk kemi pse t'i justifikohemi njeriu për të gjitha këto.

- Por me paratë që po blejmë kinemanë, unë mund të ndërtoja një shkollë në Afganistan.

Ajo kthehet në dhomën e gjumit dhe ulet në shtrat për të hequr lentet e syve. Nahila ka një profil shumë të bukur. Ai i adhuron mollëzat e saj të kërcyera, qafën e hollë dhe mënyrën se si i pjerrësohet balli aty ku i fillon hunda.

- Atëherë i bëjmë të dyja, - i thotë ajo, duke u kthyer nga ai e duke pulitur sytë, pasi ka hedhur pikat. - S'e kuptoj pse të mos i bëjmë të dyja.

Disa vjet më parë, Idrizi kishte zbuluar që Nahila kishte ndihmuar një fëmijë kolumbian të quajtur Miguel. Asokohe ajo nuk i kishte thënë asgjë dhe Idrizi as që kishte nuhatur gjë, sepse ishte ajo që merrej me postën dhe financat. Idrizi e kishte marrë vesh vetëm disa vjet më vonë, kur e kishte parë një ditë që po lexonte një letër të Miguelit. Letrën e kishte përkthyer

nga spanjishtja një murgeshë. Në zarf ishte edhe një fotografi: një djalë i gjatë e elegant, që po qëndronte pranë një kasolleje prej kashte, me një top futbolli në dorë, dhe prapa tij vetëm ca lopë kockë e lëkurë dhe kodra të gjelbra. Nahila kishte nisur ta ndihmonte Miguelin kur kishte qenë në juridik. Për gati njëmbëdhjetë vjet çeqet e Nahilës ishin pasuar në heshtje nga fotografitë e Miguelit dhe letrat e tij të falënderimit, të përkthyera nga murgesha.

Ajo heq unazat nga gishtat.

- Atëherë, si është puna? Mos të zuri gjë ndjesia e fajit e njeriut të mbijetuar kur ishe atje?

- Tani i shoh gjërat paksa ndryshe.

- Shumë mirë. Atëherë fute në punë këtë. Por hiqe atë vështrim prej narcisti nga sytë.

Atë natë ai e ndien që s'ka gjumë. Lexon për pak kohë, mandej zbret poshtë, sheh serinë e radhës të "*Krahu perëndimor*" dhe përfundon përpara kompjuterit në dhomën e miqve, të cilën tani Nahila e ka kthyer në dhomë pune. Amra i ka dërguar *e-mail*. Ajo shpreson që ai të jetë kthyer shëndoshë e mirë në shtëpi dhe ta ketë gjetur mirë edhe familjen. Në Kabul ka rënë një shi "i tërbuar", i shkruan ajo, dhe rrugët janë mbuluar me baltë deri te kaviljet. Shiu ka shkaktuar përmbytje dhe nja dyqind familje të Shomalit, në veri të Kabulit, u desh të evakuoheshin me helikopter. Masat e sigurisë janë shtuar shumë, sepse mbështetja që po i jep Kabuli luftës së Bushit në Irak, pritet të sjellë reagime nga Al-Kaeda. Dhe fjalia e saj e fundit është: "A fole me shefen tënde?"

Në fund të *e-mailit*, Amra ka shtuar edhe përshëndetjen e Roshit, që e ka përkthyer në anglisht. Ai lexon:

*Salaam, Kaka Idriz,*

Inshallah *ke arritur shëndoshë në Amerikë. Jam e sigurt që familja jote është e lumtur që po të sheh. Çdo ditë mendoj për ty. Çdo ditë shoh filmat që më bleve ti. Më pëlqejnë të*

*gjithë. Jam e trishtuar që ti nuk je këtu me mua, që t'i shohim bashkë. Unë ndihem mirë dhe Amra xhan po kujdeset shumë për mua. Të lutem thuaji* "Salaam" *familjes sate nga unë.* Inshallah *shihemi së shpejti në Kaliforni.*

*Me respekt,*

*Roshana.*

Ai i kthen përgjigje Amrës, e falënderon, i shkruan se i vjen keq që po merr vesh për përmbytjet, dhe se shpreson që shiu të pushojë së shpejti. I thotë edhe se do të flasë me shefen e vet për punën e Roshit brenda kësaj jave. Në fund i shkruan edhe Roshit:

Salaam, *Roshi xhan:*

*Falemnderit për mesazhin e ngrohtë. U lumturova shumë që lexova diçka nga ti. Edhe unë mendoj shumë për ty. I kam treguar familjes sime gjithçka për ty dhe ata mezi po presin të të takojnë, veçanërisht djemtë e mi, Zabi xhani dhe Lemar xhani, që më pyesin vazhdimisht për ty. Ne të gjithë mezi po presim të na vish këtu. Të dua shumë,*

Kaka *Idrizi.*

Ai e mbyll *e-mailin* dhe bie përsëri në shtrat.

Të hënën, në zyrë, gjen një pirg me mesazhe telefonike përshëndetëse. Një shportë është mbushur plot me recetat që presin firmën e tij. Në kompjuter ka njëqind e gjashtë *e-maile* të reja që duhen kontrolluar, dhe sekretaria telefonike nuk mban më. Kontrollon axhendën në kompjuter dhe stresohet kur i gjen të gjitha oraret e javës të zëna me pacientë: shtrydhje tërësore, siç e quan ai. Dhe më e keqja nga të gjitha është se ai

duhet të vizitojë zonjën e tmerrshme Rasmusen atë pasdite, një grua gërnjare dhe e pakëndshme, që ka vite me ca simptoma të paqarta, të cilave nuk u bën fajde asnjë trajtim. Ideja se do t'i duhet të përballet me natyrën e saj armiqësore, e mbush me djersë.

Dhe, së fundi, një nga mesazhet në sekretarinë telefonike është nga shefja e tij, Xhoana Shefer, që i thotë se pacienti që ai e kishte diagnostikuar me pneumoni një ditë përpara se të nisej për në Kabul, ka rezultuar me insuficiencë kardiake kongjestive. Rasti do të trajtohet në mbledhjen e javës në vijim, në një videokonferencë me të gjithë mjekët e spitaleve, që mbahet një herë në muaj, gjatë së cilës gabimet e bëra nga mjekët, që mbeten anonimë, përdoren për të ilustruar rastet që është e nevojshme të kihen parasysh. Anonimiteti nuk ruhet për shumë kohë, Idrizi e di këtë. Të paktën gjysma e njerëzve të pranishëm në sallë do ta dinë se cili është fajtori. Ai e ndien se po i fillon dhembja e kokës.

Ai nuk arrin t'i përmbahet orareve atë mëngjes. Në pavion vjen një rast urgjent astme, që ka nevojë për frymëmarrje artificiale dhe monitorim të furnizimit me oksigjen. Një mesoburrë që punon si drejtues ekzekutiv, që Idrizi e ka parë për herë të fundit tre vjet më parë, vjen me një infarkt progresiv të miokardit të përparmë. Edhe pushimin e drekës është i detyruar ta nisë me vonesë, gjysmë ore pasi ka kaluar mesdita. Në sallën e mbledhjeve ku hanë mjekët, ai ha gjithë ngut e me kafshata të mëdha sanduiçin me mish gjeldeti dhe mundohet që të përfundojë shënimet. Ai u përgjigjet vazhdimisht të njëjtave pyetje të kolegëve të tij. A ishte i sigurt qëndrimi në Kabul? Çfarë mendojnë afganët për praninë e trupave amerikane atje? Ai jep përgjigje të shkurtra klishe, ndërsa mendjen e ka te zonja Rasmusen, te mesazhet në sekretarinë telefonike që kërkojnë një përgjigje, te recetat që duhet të firmosë, tek tri rastet shtrydhëse që do të ketë atë pasdite, te mbledhja e javës që vjen, te punëtorët që ngulin e shkulin gozhda në

shtëpinë e tij. Bisedat për Afganistanin tani i duken si diskutime për një film të parë kohët e fundit, që i ka ngjallur një pafundësi emocionesh, por efektet e të cilit kanë nisur të shuhen tashmë. Dhe edhe ai vetë po habitet se sa shpejt i ka ndodhur kjo.

Java në vijim rezulton të jetë më e vështira në karrierën e tij. Edhe pse e ka vazhdimisht ndër mend, ai nuk gjen aspak kohë që t'i flasë Xhoana Sheferit për Roshin. Një humor i keq e mban të pushtuar gjatë gjithë javës. Në shtëpi tregohet i prerë me djemtë, e mërzitin punëtorët që hyjnë e dalin, dhe zhurma që bëjnë ata. Oraret e gjumit i janë prishur. Nga Amra merr dy *e-maile* të tjera, të dy për të rejat e fundit lidhur me situatën në Kabul. "*Rabia Balkhi*", spitali i grave, është hapur përsëri. Kabineti i Karzait do t'i lejojë përsëri televizionet kabllore që të shfaqin programe, duke i sfiduar kështu ithtarët islamikë që ishin kundër kësaj. Si poshtëshënim në fund të *e-mailit* të dytë, ajo i thotë se Roshi është mbyllur në vetvete, qysh se ka ikur ai, dhe e pyet përsëri nëse ka folur me shefen e vet. Ai largohet nga kompjuteri. Por kthehet sërish më vonë, me një ndjesi turpi për faktin që mesazhi i Amrës e ka acaruar në atë mënyrë, dhe për ngurrimin që kishte pasur për t'iu përgjigjur, me shkronja të mëdha: "DO TA BËJ. SË SHPEJTI".

- Shpresoj të mos jesh ndier keq. - Xhoana Sheferi qëndron prapa tryezës së saj, me duart të mbështetura në prehër. Ajo është një grua gjithë energji pozitive, me një fytyrë të rrumbullakët dhe flokë të bardhë të fryrë. Ajo e sheh që përtej syzeve të vogla të mbështetura në kurrizin e hundës. - Besoj se e kupton që qëllimi nuk ishte që të të ndëshkonim ty.

- Po, sigurisht, - thotë Idrizi. - E kuptoj.

- Dhe s'ka pse të ndihesh keq. Kjo mund t'i kishte ndodhur secilit prej nesh. Zakonisht është e vështirë ta dallosh në grafi rëntgeni pneuominë nga insuficienca kongjestive e zemrës.

- Falemnderit, Xhoana - Ai ngrihet dhe drejtohet për te dera, por ndalet te pragu i saj. - Oh! Kam diçka që do të doja ta diskutoja me ju.

- Patjetër. Patjetër. Ulu.

Ai ulet përsëri. Dhe i flet për Roshin, i përshkruan dëmtimin e saj, i tregon për mungesën e pajisjeve në spitalin *"Wazir Akbar Khan"*. Ai i rrëfen për premtimin që i ka bërë Amrës dhe Roshit. Tani që po e shqipton me zë të lartë, Idrizit i duket sikur ai premtim po i rëndon mbi shpinë në një mënyrë që nuk e kishte ndier në Kabul, kur ia kishte thënë ato fjalë Amrës në korridor dhe ajo e kishte puthur në faqe. Tani po e turbullon fakti që ndjenjat e tij i ngjasojnë pendimit të blerësit.

- O Zot, Idriz! - i thotë Xhoana, duke tundur kokën mohueshëm. - E vlerësoj shumë. Por sa e tmerrshme! E gjora vajzë. Nuk arrij ta përfytyroj dot.

- E di, - thotë ai. Ai e pyet nëse do të pranonte spitali që të mbulonte shpenzimet për ndërhyrjen kirurgjikale. - Më saktë, ndërhyrjet. Nuk besoj se do të mjaftonte një.

Xhoana psherëtin.

- Do të doja. Por, të tregohem e sinqertë, druaj se bordi drejtues nuk ka për ta miratuar, Idriz. Vërtet dyshoj se kështu do të bëjnë. Ti e di që ne kemi dalë me këpucë të kuqe këta pesë vjetët e fundit. Dhe do të kishte edhe një sërë procedurash ligjore, procedura të ndërlikuara.

Ajo pret përgjigjen e tij, mbase edhe po përgatitet që ai ta kundërshtojë, por ai nuk e bën.

- E kuptoj, - thotë ai.

- Duhet të gjesh ndonjë shoqatë bamirësie që merret me të tilla gjëra, apo jo? Do të të duhet ca kohë, por...

- Do të kërkoj për këtë. Falemnderit, Xhoana. - Ai ngrihet përsëri, i habitur edhe vetë që përgjigjja e saj e ka bërë të ndihet më i lehtë, thuajse i lehtësuar.

Kalon edhe një tjetër muaj, derisa kinemaja në shtëpi përfundon, por është vërtet e mrekullueshme. Filmi, i shfaqur me anë të projektorit të vendosur në tavan, duket fare pastër dhe lëvizjet në ekranin 259 cm duken si reale. Fortafolësit në të katër qoshet e dhomës, përforcuesit dhe pastruesit e zërit tregojnë se janë bërë mrekullira me anën akustike. Ata shohin "Piratët e Karaibeve", tok me të dy djemtë që, të mrekulluar nga teknologjia, janë ulur në secilin krah të tij e po hanë kokoshka nga tasi në prehrin e tij. Ata i zë gjumi përpara betejës në skenën e fundit.

- Po i çoj në shtrat, - i thotë Idrizi Nahilës.

Ai ngre në fillim njërin dhe pastaj tjetrin. Djemtë po rriten, trupat e tyre po hedhin shtat me një shpejtësi alarmuese. Ndërsa e çon secilin në shtratin e vet, ai bëhet sërish i vetëdijshëm për lëndimin që e pret nga ata djem. Brenda fare pak vitesh, ai do të zëvendësohet. Djemtë do të nisin të adhurojnë gjëra të tjera, njerëz të tjerë, dhe do t'u vijë turp prej atij dhe Nahilës. Idrizi kujton me përmallim ditët kur ata ishin të vegjël dhe kishin gjithmonë nevojë për të, kur ishin të varur prej tij. Sjell ndër mend se si tmerrohej Zabi nga pusetat, kur ishte i vogël, dhe si u binte përqark. Kurse Lemari, ndërsa shihte një herë një film të vjetër, e kishte pyetur Idrizin nëse kishte qenë gjallë edhe ai kur bota ishte bardhezi. Këto kujtime e bëjnë të vërë buzën në gaz. Ai i puth djemtë në faqe.

Mandej ulet në errësirë dhe kundron Lemarin, teksa fle. Tani e kupton që i ka gjykuar djemtë më kot, i ka paragjykuar pa të drejtë. Dhe e ka gjykuar edhe veten shumë ashpër. Ai nuk është kriminel. Ai e ka fituar me mund çdo gjë që ka tani. Në vitet nëntëdhjetë, kur gjysma e shokëve të tij e kalonin kohën nëpër klube nate e rendnin pas femrave, ai mbyllej në një dhomë me libra e studionte ose ecte nëpër korridoret e spitalit në orën dy të mëngjesit, duke harruar pushimin, gjumin, argëtimet. Ai ia kishte dhuruar mjekësisë të njëzetat e veta. I kishte paguar detyrimet e tij. E pse duhej të ndihej keq tani? Kjo ishte familja e tij. Kjo ishte jeta e tij.

Gjatë muajit të fundit, Roshi ishte shndërruar në një gjë abstrakte, në një personazh filmi. Lidhja në mes tyre ishte shuar. Afërsia e papritur që kishte ndier në atë spital, aq urgjente e akute, ishte shpërbërë plotësisht. Ajo përvojë e kishte humbur fuqinë e vet. Dhe ai tani e kupton se ajo vendosmëri e atëhershme ishte thjesht një mirazh, një iluzion. Ai kishte rënë nën ndikimin e diçkaje që ishte e ngjashme me drogën. Largësia midis tij dhe vajzës duket e madhe tani. Duket e pakapërcyeshme, e pafund, kurse premtimet i duken një gabim i shkujdesur, një keqkuptim i tmerrshëm, një vlerësim i keq i mundësive, i dëshirës dhe karakterit të vet. Është më mirë ta harrojë këtë histori. Ai nuk është i aftë për të tilla gjëra. Është fare e thjeshtë. Gjatë dy javëve të fundit kishte marrë tri *e-maile* të tjera nga Amra. E kishte lexuar të parin, por nuk i ishte përgjigjur. Dhe i kishte fshirë pa i lexuar dy të tjerët.

Dymbëdhjetë a trembëdhjetë veta janë vënë në radhë në librari. Ajo fillon nga banaku e deri te raftet e librave. Një grua e gjatë, fytyrëgjerë, u zgjat njerëzve letra të vogla me ngjyrë të verdhë për të shënuar emrin dhe ndonjë mesash që duan ta kenë të shkruar në libër. Një shitëse në krye të radhës i ndihmon njerëzit që ta hapin librin në faqen e titullit.

Radha e Idrizit, me libër në dorë, po afrohet. Gruaja përpara tij, rreth të pesëdhjetave, me flokë të shkurtër të verdhë, kthehet nga ai dhe i thotë:

- E ke lexuar librin?

- Jo, - përgjigjet ai.

- Ne kemi ndër mend ta lexojmë muajin tjetër në klubin tonë. E kam unë radhën të zgjedh.

- Ah!

Ajo ngrys vetullat dhe vendos pëllëmbën në kraharor.

- Shpresoj që njerëzit ta lexojnë. Është një histori kaq prekëse. Kaq frymëzuese. Vë bast që do ta bëjnë film.

Ajo që i tha ai asaj është e vërtetë. Ai nuk e ka lexuar librin dhe dyshon nëse do ta bëjë ndonjëherë. Ai nuk beson se do t'ia tretë stomaku atë që do të gjejë për veten në ato faqe. Por të tjerët do ta lexojnë. Dhe, kur ta bëjnë këtë, ai nuk do të mund të fshihet më. Njerëzit do ta mësojnë të vërtetën. Nahila, djemtë e tij, kolegët. Vetëm ideja e kësaj e bën të ndihet keq.

Ai e hap librin sërish, kapërcen faqen e falënderimeve, biografinë e bashkautorit, që është ai që e ka shkruar historinë. Dhe sheh përsëri fotografinë në libër. Asnjë shenjë plage. Edhe nëse ka ndonjë vrajë, dhe padyshim që ndonjë ka mbetur, ajo është mbuluar plotësisht nga flokët e zinj të gjatë e të rëndë. Roshi ka veshur një bluzë me temina të florinjta, një varëse Allah, vathë prej lapisi. Ajo është mbështetur pas një peme dhe po sheh drejt e tek aparati, duke buzëqeshur.

Atij i kujtohen siluetat pranë njëra-tjetrës që kishte vizatuar ajo. "Mos ik. Mos më lër, *Kaka*". Ai nuk dallon te kjo vajzë e re as edhe një grimë të asaj krijesës së tmerrshme që kishte gjetur prapa asaj perdeje gjashtë vjet më parë.

Idrizi lexon faqen me përkushtimin:

*Për dy engjëjt e jetës sime: nënën time Amra dhe Kaka Timurin. Ju jeni shpëtimtarët e mi. Juve ju detyrohem për gjithçka.*

Radha ecën. Gruaja me flokët e verdhë të shkurtër merr autografin e vet. Ajo i hap rrugë dhe Idrizi, me zemrën që po i mpaket në kraharor, bën një hap përpara. Roshi ngre kokën. Ka vënë një shall afgan mbi bluzën me mëngë të gjata ngjyrë kungulli, kurse në veshë ka varur një palë vathë prej argjendi në formë ovale. Sytë i ka më të errët nga sa ia mban mend ai, dhe trupi i ka marrë linja të plota femërore. Ajo e sheh pa i rrahur qepallat dhe, ndonëse asgjë tek ajo nuk jep ndonjë shenjë se e ka njohur, ndonëse ajo vazhdon t'i buzëqeshë me mirësjellje, ka diçka të largët e argëtuese në shprehjen e fytyrës së saj, një lloj lozonjariteti, një mungesë druajtjeje. E gjitha

kjo e përmbyt atë dhe, papritur, të gjitha fjalët që kishte formuluar në mendje, e madje edhe i kishte shkruar dhe i kishte përsëritur me mend, ndërsa vinte këtu, tani i shuhen. Dhe nuk arrin dot ta detyrojë veten të thotë diçka. Tani vetëm qëndron aty, me një pamje prej budallai.

Shitësja qëron fytin.

- Zotëri, ma jepni librin që ta hap në faqen e parë, dhe Roshi do t'ju shkruajë autografin.

Librin. Idrizi ul kokën dhe e sheh të shtrënguar fort në pëllëmbët e veta. Ai nuk ka ardhur këtu për të marrë autografin, sigurisht. Ky do të ishte një veprim acarues, acarues në mënyrë groteske, pas gjithçkaje që ka ndodhur. E prapë, ai e gjen veten duke ia zgjatur librin asaj dhe shitësja e hap me zhdërvjelltësi në faqen e duhur, ndërsa dora e Roshit rrëshqet duke shkruar diçka nën titull. Atij ende i kanë mbetur disa sekonda për të thënë diçka, jo se kjo do ta zbutë sadopak atë që ka bërë ai, por sepse mendon se i detyrohet për dy fjalë. Por, edhe kur shitësja ia kthen librin përsëri, ai nuk arrin t'i nxjerrë fjalët nga goja. Dhe tani do të donte të kishte qoftë edhe një grimë nga kuraja e Timurit. Ai e sheh përsëri Roshin. Vështrimi i saj rrëshqet tek tjetri në radhë pas tij.

- Unë jam..., - fillon ai.

- Radha duhet të lëvizë, zotëri, - i thotë shitësja.

Ai ul kokën dhe largohet prej aty.

Makinën e ka parkuar pas dyqanit. Rruga deri atje po i duket si më e gjata në jetën e vet. E hap derën e makinës dhe ndalet përpara se të futet brenda. Me duart që nuk i kanë reshtur së dridhuri për asnjë çast, ai e hap përsëri librin. Ajo që është shkruar aty, nuk është nënshkrim. Në anglisht, ajo i ka shkruar vetëm dy fjali.

Ai e mbyll librin, mandej mbyll edhe sytë. Normalisht duhej të ishte ndier i lehtësuar. Por jo, diçka brenda tij do të kishte dashur të ndodhte ndryshe. Ai kishte pritur që ajo të bënte ndonjë grimasë, a mbase t'i thoshte diçka fëmijërore, gjithë urrejtje e mllef. Një shpërthim zemërimi. Ndoshta do të

kishte qenë më mirë. Por ajo thjesht i ka dhuruar një mohim diplomatik, të pastër. Dhe këtë shënim: "Mos u shqetëso. Ti nuk je aty." Një gjest dashamirës. Ose mbase, më saktë, një gjest bujar. Ai duhej të ndihej i lehtësuar. Por kjo i dhemb. Ai ia ndien goditjen, si një sëpatë në kokë.

Aty pranë gjendet një stol, nën një vidh. Ai drejtohet për aty dhe e lë librin mbi stol. Kthehet te makina dhe futet brenda. Por kalon pak kohë, derisa nis t'i zërë sërish besë vetes, rrotullon çelësin dhe largohet prej aty.

# Gjashtë

## *Shkurt 1974*

Shënim i botuesit, "*Parallaxe 84*" (dimër 1974), f. 5

Të nderuar lexues,

Pesë vjet më parë, kur nisëm buletinin tonë të përtremuajshëm me intervistat e poetëve pak të njohur, nuk e parashikuam dot se sa popullor do të rezultonte ai. Shumë prej jush deshën të dinin më shumë dhe, vërtet, letrat tuaja gjithë entuziazëm shtruan rrugën që këto intervista të shndërroheshin në një traditë të përvitshme të "*Parallaxe*-it". Po ashtu, të intervistuarit janë shndërruar në artistët e parapëlqyer të intervistuesve tanë. Të gjitha këto kanë çuar në zbulimin ose rizbulimin e disa poetëve me vlerë dhe në vlerësimin e merituar të veprës së tyre.

Për fat të keq, mbi këtë buletin endet një hije. Artistja që do të përshkruajmë në këtë numër, është Nila Vahdati, një poete afgane e intervistuar nga Etjen Bustuleja dimrin e shkuar në qytetin Kurbëvua, pranë Parisit. Zonja Vahdati, siç do ta pranonit edhe ju - e them me shumë bindje këtë - i dha zotit Bustule një nga intervistat më të sinqerta e më të hapura që ne kemi botuar ndonjëherë. Por vetëm pak kohë pasi u mor kjo intervistë, ne mësuam me hidhërim të thellë për vdekjen e saj

të parakohshme. Ajo do t'i mungojë komunitetit të poetëve. Nila Vahdati ka lënë pas një vajzë.

Është koha më e papërshtatshme. Dyert e ashensorit hapen tamam në çastin kur telefoni nis të bjerë.

Pahri e dëgjon zilen e tij, sepse vjen nga apartamenti i Zhyljenit, i cili gjendet në krye të korridorit të ngushtë e të ndriçuar dobët dhe është apartamenti më pranë ashensorit. Intuitivisht, ajo e di se kush po telefonon. Shprehja e fytyrës së Zhyljenit tregon se edhe ai e di.

Zhyljeni, që sapo ka hyrë në ashensor, thotë:

- Lëre të bjerë.

Pas tij gjendet fqinja fytyrashpër e katit të mësipërm. Ajo ia ka ngulur sytë Pahrit gjithë padurim. Zhyljeni e quan *la chévre* [dhia], për shkak të qimeve si të cjapit në mjekër.

Ai ka rezervuar një tryezë për në orën shtatë fiks në një restorant të ri në lagjen nr. 16, që ka bërë paksa bujë me *poulet braise*[1], *sole cardinale*[2], dhe me mëlçitë e kaut me uthull qershie. Aty do të takojnë Kristianin dhe Aurelën, shokë të vjetër fakulteti të Zhyljenit: të kohës kur studionte e jo kur nisi të jepte mësim aty.

Ata do të takohen për të pirë diçka në orën gjashtë e gjysmë dhe ora tani është gjashtë e një çerek. E atyre u duhet që të shkojnë te stacioni i metrosë, të marrin trenin nëntokësor deri në *Muette* dhe pastaj të përshkojnë më këmbë gjashtë blloqe për të arritur te restoranti.

Telefoni vazhdon të tringëllijë.

Gruaja-dhi kollitet.

Zhyljeni thotë me zë më të vendosur tani:

- Pahri?

---

1) Pulë në prush (*shën. i përkth.*).

2) Fileto gjuhëze me salcë *kardinal* të përgatitur me qumësht, miell, gjalpë, verë, krem dhe mish gaforreje (*shën. i përkth.*).

- Me siguri është Mamaja, - thotë Pahri.

- Po, këtë e di.

Jashtë çdo logjike, Pahri mendon se Mamaja, me nevojën e saj të përhershme për tragjedi, ka zgjedhur pikërisht këtë çast për ta marrë në telefon, që ta detyrojë të zgjedhë: të hipë në ashensor tok me Zhyljenin apo të kthehet pas e t'i përgjigjet telefonatës së saj.

- Mund të jetë e rëndësishme, - thotë ajo.

Zhyljeni psherëtin.

Ndërsa dyert e ashensorit mbyllen pas shpinës së tij, ai mbështetet në murin e korridorit. Kërkon thellë në xhepat e palltos dhe për një çast duket si një personazh i filmave policeskë të Melvilit.

- Vetëm një minutë, - thotë Pahri.

Zhyljeni i hedh një vështrim mosbesues.

Apartamenti i Zhyljenit është i vogël. Me gjashtë hapa të shpejtë, ajo ka lënë pas korridorin, kuzhinën dhe është ulur tani buzë shtratit për të kapur telefonin që gjendet në komodinën e vetme që kanë në dhomën e gjumit. Pamja që aty është magjepsëse. Tani po bie shi, por në një ditë të kthjellët ajo mund të shohë nga dritarja që bie nga lindja, shumicën e lagjeve të shekullit të nëntëmbëdhjetë e të njëzetë.

- *Oui, alo*? - ia bën ajo në receptor.

Një zë burri i përgjigjet:

- *Bonsoir*[1]. Flas me zonjushën Pahri Vahdati?

- Kush jeni ju?

- Ju jeni vajza e zonjës Nila Vahdati?

- Po.

- Unë quhem doktor Delonej. Po ju marr për mamanë tuaj.

Pahri mbyll sytë. Një ndjesi e shpejtë faji i kalon nëpër trup, përpara se ta kaplojë plotësisht frika e zakonshme. Ajo ka marrë shumë telefonata të tilla edhe më parë, aq shumë, sa

---

1) Mirëmbrëma (*shën. i përkth.*).

nuk numërohen dot, qysh kur ishte adoleshente, madje, në të vërtetë, që më parë: një herë, kur ishte në klasë të pestë, mu në mes të provimit të gjeografisë, mësuesja ishte detyruar ta ndërpriste, e kishte nxjerrë në korridor dhe i kishte shpjeguar me zë të ngutur se çfarë kishte ndodhur. Pahri është mësuar me këto telefonata, gjithsesi denduria e tyre nuk e ka bërë aspak shpërfillëse. Në çdo telefonatë të re ajo mendon: "Kjo është, erdhi çasti". Dhe çdo herë ajo e mbyll telefonin e sulet për te Mamaja. Me gjuhën e ekonomisë, Zhyljeni i ka thënë Pahrit se, po t'ia presë burimin e vëmendjes, mbase kërkesa e saj për vëmendje do të shuhet.

- I ka ndodhur një aksident, - i thotë doktor Deloneji.

Pahri afrohet pranë dritares dhe dëgjon shpjegimet e mjekut. Ajo mbështjell e çmbështjell telin e telefonit në gishta, ndërsa ai i përshkruan mënyrën se si ka përfunduar e ëma në spital, gërvishtjet në ballë, qepjet, gjilpërën kundër tetanosit, shpëlarjet me ujë të oksigjenuar, pomadat me antibiotikë, veshjen e spitalit. Përpara syve të Pahrit shfaqet kujtimi i asaj dite kur ajo ishte dhjetë vjeç dhe, pas kthimit nga shkolla në shtëpi, kishte gjetur njëzet e pesë franga dhe një pusullë me shkrim dore mbi tryezën e kuzhinës: "Po shkoj me Markun në Alsasë. Besoj se e mban mend Markun. Kthehem pas disa ditësh. Bëhu vajzë e mbarë. (Mos rri zgjuar deri vonë!). *Je t'aime*. Mamaja." Pahri kishte mbetur duke u dridhur në kuzhinë, me sytë mbushur me lot, duke u munduar ta bindte veten se dy ditë kalojnë shpejt dhe se nuk do të ishte edhe aq keq.

Mjeku po e pyet për diçka.

- Më falni?

- Po ju pyesja a do të vini ta merrni për ta çuar në shtëpi, zonjushë? Dëmtimi nuk është serioz, ju e kuptoni, por besoj se është më mirë që të mos kthehet vetëm në shtëpi. Ose mund t'i marrim ne një taksi.

- Jo. S'është nevoja. Do të jem aty pas gjysmë ore. - Ajo ulet në shtrat. Zhyljeni do të mërzitet e mbase edhe do të ndihet keq në sy të Kristianit e Aurelës, mendimi i të cilëve

duket se ka shumë vlerë për të. Pahri nuk dëshiron të dalë jashtë në korridorin e shkallëve e të përballet me Zhyljenin. Por nuk do as që të shkojë në Kurbëvua e të përballet me të ëmën. Gjëja që do të donte të bënte tani, është që të shtrihet e të dëgjojë erën që harbon duke përplasur pikat e shiut mbi xham, derisa ta zërë gjumi.

Ajo ndez një cigare dhe, kur Zhyljeni hyn në dhomë e që pas shpinës së saj e pyet:

- Nuk do të vish? - ajo nuk i kthen përgjigje.

FRAGMENTE NGA "CICËRIMA AFGANE",
INTERVISTË ME NILA VAHDATIN NGA ETJEN BUSTULEJA.
"*Parallaxe* 84" (dimër 1974), f. 33

EB: Pra, me sa kuptoj unë, ju jeni, në fakt, gjysmë afgane, gjysmë franceze?

NV: Po. Mamaja ime ishte franceze. Ishte parisiane.

EB: Por ajo u njoh me babanë tuaj në Kabul. Ju keni lindur atje.

NV: Po. Ata u njohën në vitin 1927. Në një darkë zyrtare në Pallatin Mbretëror. Mamaja ime ishte shoqëruesja e të atit, gjyshit tim, të cilin e kishin dërguar në Kabul si këshilltar të mbretit Amanullah për reformat e tij. A keni dëgjuar për të, për mbretin Amanullah?

Ne jemi ulur në dhomën e ndenjjes në apartamentin e vogël të Nila Vahdatit, në katin e tridhjetë të një ndërtese banimi në qytetin Kurbëvua, në veri të Parisit. Dhoma është e vogël, e ndriçuar dobët dhe me fare pak mobilie: një divan me mbulesë ngjyrë shafrani, një tryezë kafeje, dy rafte të lartë librash. Ajo është ulur me shpinë nga dritarja, të cilën e ka hapur, që të ajroset dhoma nga tymi i cigareve që ajo i ndez njërën pas tjetrës.

Nila Vahdati thotë se është dyzet e katër vjeçe. Ajo është një grua tërheqëse që bie në sy, që mbase e ka kaluar tashmë kulmin e bukurisë së vet, por jo prej shumë

kohësh. Mollëzat e saj janë si të një mbretëreshe, lëkura e lëmuar, beli i hollë. Ajo ka sy inteligjentë, flirtues dhe një vështrim depërtues nën të cilin njeriu ndihet njëherazi i vlerësuar, i vënë në provë, i joshur e i vënë në lojë. Besoj se ata janë një mjet i shkëlqyer joshjeje. Ajo nuk ka bërë tualet, por ka vënë vetëm pak buzëkuq, që i ka rrëshqitur paksa nën vijën e buzës. Rreth ballit ka lidhur një shami trekëndëshe, ka veshur një bluzë në ngjyrë lejla të zbehtë dhe pantallona xhinse, s'ka mbathur këpucë, as çorape. Edhe pse ora është vetëm njëmbëdhjetë e mëngjesit, ajo mbush një gotë me verë "*Chardonnay*". Me shumë dashamirësi më ofron edhe mua një gotë, por unë e refuzoj.

NV: Ai ishte mbreti më i mirë që kanë pasur ata ndonjëherë.

Më duket interesant përemri vetor që zgjedh të përdorë ajo.

EB: "Ata"? Ti nuk e konsideron veten si afgane?

NV: Le të themi që unë jam divorcuar nga gjysma ime më problematike.

EB: Jam kureshtar të di pse e keni bërë këtë.

NV: Po qe se ai do të kishte qenë i suksesshëm, e kam fjalën për mbretin Amanullah, mund t'i isha përgjigjur ndryshe pyetjes suaj.

Unë i kërkoj të ma sqarojë këtë.

NV: Shikoni, ai, mbreti, pra, u zgjua një mëngjes dhe shpalli planin e vet për t'i dhënë një tjetër formë vendit - me grushte e me shkelma, po të ishte nevoja - për ta shndërruar në një vend të ri e më të ndritshëm. "Me vullnetin e Zotit!" - tha ai. Që do të fillonte që nga mosmbajtja e ferexhesë. Përfytyrojeni vetë, zoti Bustule: një grua në Afganistan që arrestohet pse ka veshur ferexhe! Dhe kur gruaja e tij, mbretëresha Soraja, doli në publik me fytyrën të zbuluar...! *Oh la-la*! Mushkëritë e mullave

shfrynë mjaftueshëm ajër për të mbushur me mijëra Hindenburg-e[1] e për t'i vënë në lëvizje. "Dhe nuk do të ketë më poligami", - tha ai! Tani, ju e kuptoni, kjo u tha në një vend ku mbretërit kishin pasur një legjion të tërë me konkubina dhe as që i njihnin për fytyrë fëmijët që kishin lindur me to. "Që këtej e tutje, - deklaroi ai, - asnjë burrë nuk do t'ju detyrojë më që të martoheni me të. Dhe nuk do të ketë më blerje të nuses, gra kurajoze të Afganistanit, dhe as martesa qysh në djep. Dhe, për më tepër: ju do të ndiqni shkollën."

EB: Domethënë ai ishte njeri largpamës.

NV: Ose budalla. Mua për vete më është dukur gjithmonë si një vijë fare e hollë kufiri midis të dyjave.

EB: Ç'u bë me të?

NV: Përgjigjja është po aq trishtuese sa ç'është edhe e parashikueshme, zoti Bustule. Xhihadi, pa dyshim. Ata shpallën xhihadin kundër tij, mullatë, krerët e fiseve. Përfytyroni mijëra grushte që ngrihen lart! Mbreti e kishte bërë tokën të lëvizte - e kuptoni? - por ishte i rrethuar nga një oqean fanatikësh dhe ju e dini shumë mirë se ç'ndodh kur dridhet tabani i oqeanit, zoti Bustule. Një cunami rebelësh me mjekra u përplas mbi mbretin e gjorë dhe e mori me vete, me gjithë përpjekjet e tij të kota për t'i shpëtuar, dhe e përplasi si fillim në brigjet e Indisë e mandej në Itali e në fund në Zvicër, ku ai u zvarrit këmbadorazi për të dalë nga llumi e vdiq si një burrë i zhgënjyer në mërgim.

EB: Dhe vendi që doli nga kjo, besoj se nuk ju shkonte fare për shtat.

NV: Edhe e kundërta është njësoj e vërtetë.

---

1) Anije ajrore gjermane për pasagjerë që në 6 maj 1937 mori zjarr në ajër gjatë një fluturimi transatlantik, përpara se të ulej në aeroportin e Lajkhërstit, Nju-Xhersi. Zjarri u mori jetën 13 pasagjerëve dhe 23 anëtarëve të ekuipazhit (*shën. i përkth.*).

EB: Dhe besoj po ashtu se kjo është arsyeja pse u shpërngulët në Francë në vitin 1955.

NV: Unë erdha në Francë, sepse doja ta shpëtoja time bijë nga një lloj mënyre jetese.

EB: E për ç'lloj jetese bëhet fjalë?

NV: Unë nuk doja që ajo, përkundër vullnetit dhe natyrës së saj, të shndërrohej në një nga ato gratë e trishtuara e të zellshme, që përulen gjatë një jete të tërë si shërbyese të heshtura, gjithmonë me frikën se mos bëjnë ose mos thonë gjënë e gabuar. Gra që admirohen nga disa njerëz në Perëndim - këtu në Francë, për shembull - dhe konsiderohen si heroina prej jetës së vështirë që bëjnë, gra që admirohen në largësi nga njerëz që nuk do të mund të ecnin në hapat e tyre as edhe për një ditë të vetme. Gra që shohin se si u shuhen dëshirat dhe si heqin dorë nga ëndrrat dhe prapë - e kjo është më e keqja, zoti Bustule - takohesh me to e ato buzëqeshin e hiqen sikur nuk kanë kurrfarë problemi në jetën e tyre. A thua se jetojnë një jetë për t'u pasur zili. Por, po t'i shohësh me vëmendje, nga afër, do të vësh re sytë e trishtuar, dëshpërimin, si e tradhtojnë këta humorin e tyre të mirë. Është krejtësisht patetike, zoti Bustule. Unë nuk e doja një gjë të tillë për vajzën time.

EB: Besoj se ajo e kupton këtë.

Ajo ndez një tjetër cigare.

NV: E po, fëmijët kurrë nuk bëhen ashtu siç ke ëndërruar, zoti Bustule.

Në dhomën e urgjencës, një infermiere me humor të keq e udhëzon Pahrin që të qëndrojë tek tryeza e regjistrimit, pranë një rafti me rrota të mbushur me mbajtëse letrash dhe fletë ekzaminimi. Pahrin e habit fakti që ekzistojnë njerëz që me

dëshirën e tyre e çojnë dëm rininë duke u trajnuar në profesione që i detyrojnë të punojnë në të tilla vende. Ajo nuk e kupton dot këtë. Ajo vetë i urren spitalet. Urren t'i shohë njerëzit në formën e tyre më të keqe, urren aromën e sëmundjes, shtretërit me rrota që pingërojnë, muret e lyera me bojë të zbehtë, atë numër të pafund infermierësh te koka.

Doktor Deloneji është më i ri nga sa e kishte përfytyruar Pahri. Ai ka një hundë të hollë, gojë të vogël dhe kaçurrela të verdhë të imët. Ai e nxjerr nga dhoma e urgjencës dhe përmes një dere me dy kanate dalin në korridorin kryesor.

- Kur mamaja jote mbërriti këtu, - thotë ai me ton konfidencial, - ishte plotësisht e dehur... Nuk po më dukesh e habitur.

- Nuk jam.

- Dhe as disa prej ndihmësmjekëve këtu nuk ishin. Më thanë se ajo i ka bërë kapicë faturat e këtij spitali. Unë jam i ri këtu, kështu që, pa dyshim, nuk e kam pasur kurrë këtë kënaqësi.

- Si ishte kur erdhi?

- Në humor shumë të keq, - thotë ai. - Dhe, më duhet ta them, paksa teatrore.

Ata shkëmbejnë një buzëqeshje të shpejtë.

- A do të bëhet mirë?

- Po, për njëfarë kohe, - thotë doktor Deloneji. - Por mua më duhet të të këshilloj, me shumë dashamirësi, që ajo ta pakësojë sasinë e alkolit. Këtë herë ishte me fat, por askush s'mund të thotë gjë për herën tjetër...

Pahri pohon me kokë.

- Ku është tani?

Ai e kthen përsëri në dhomën e urgjencës dhe e çon në një qoshe.

- Shtrati numër tre. Do të vij edhe unë aty pas pak, që të sjell fletëdaljen dhe t'i jap këshillat e zakonshme.

Pahri e falënderon dhe afrohet te shtrati i së ëmës.

- *Salut*[1], Mama!

Mamaja i bën një buzëqeshje të lodhur. Flokët i janë shprishur dhe në këmbë ka mbathur çorape të ndryshme. Ballin ia kanë lidhur me fashë, ndërsa në krahun e majtë ka të vendosur një tub serumi, nëpër të cilin rrjedh një lëng pa ngjyrë. Fundin e spitalit e ka veshur mbrapsht dhe nuk e ka lidhur siç duhet. Fundi i është hapur paksa mbi bark dhe Pahri arrin të dallojë vrajën e errët e të trashë vertikale të operacionit cezarian. Ajo e ka pyetur disa herë më parë se pse asaj nuk i kanë bërë atë vijën e zakonshme horizontale, dhe Mamaja i është përgjigjur se mjekët i kishin dhënë shumë sqarime teknike asokohe, të cilat asaj nuk i kujtoheshin mirë. "Gjëja më e rëndësishme, - i kishte thënë ajo, - është që të nxorën ty prej aty".

- Ta shkatërrova mbrëmjen, - i mërmërit Mamaja.

- Aksidentet ndodhin. Erdha të të çoj në shtëpi.

- Tani mund të fle një javë rresht.

Sytë i mbyllen, edhe pse vazhdon të flasë si përçart.

- Sapo isha ulur për të parë televizor. Më mori uria. Shkova në kuzhinë që të bëja pak bukë me marmelatë. Rrëshqita. Nuk e di as vetë se si ose ku rrëshqita, por duke rënë, koka m'u përplas pas dorezës së sobës. Besoj se më ka rënë të fikët për një a dy minuta. Ulu, Pahri. Po më rri si gjigant aty.

Pahri ulet.

- Mjeku më tha se kishe pirë.

Mamaja hap njërin sy. I ka frekuentuar mjekët kaq shpesh, sa tani nuk i duron dot fare.

- Ai çunaku? Ai e tha këtë? *Le petit salaud*[1]? E ku merr vesh ai? Ai ende mban erë qumësht gjiri.

- Ti gjithmonë bën shaka, sa herë unë ta hap këtë bisedë.

- Tani ndihem e lodhur, Pahri. Mund të më ngacmosh

---

1) Ç'kemi? *(shën. i përkth.)*.

1) Kopuku i vogël *(shën. i përkth.)*.

një herë tjetër. Shtyllën e kamxhikimit aty e ke, nuk lëviz nga vendi.

Tani atë e zë gjumi vërtet. Dhe nis edhe të gërhasë, shëmtuar, ashtu siç bën gjithmonë, pasi e ka tepruar me pijen.

Pahri ulet në stolin pranë shtratit, në pritje të doktor Delonejit, duke përfytyruar Zhyljenin e ulur në një tryezë me ndriçim të dobët, ndërsa po mundohet t'ua shpjegojë krizën Kristianit dhe Aurelës me gotën e gjatë të mbushur me *"Bordeaux"*. Ai i kishte thënë që ta shoqëronte në spital, por shumë thatë. E kishte thënë më shumë sa për sy e faqe. Gjithsesi, ardhja këtu do të kishte qenë një ide e keqe. Nëse doktor Deloneji mendonte se kishte parë teatër pak më parë... E prapë, edhe pse nuk kishte ardhur këtu me të, Pahri do të kishte dashur që ai të mos kishte shkuar as në atë darkë. Ajo ende është e habitur që ai shkoi. Fare mirë mund t'ia kishte shpjeguar situatën Kristianit dhe Aurelës. Mund të caktonin një mbrëmje tjetër, mund ta ndryshonin rezervimin. Por Zhyljeni kishte shkuar. Nuk ishte një veprim i pamenduar mirë. Jo. Kishte diçka të ligë, të qëllimshme, ndëshkuese, në këtë veprim. Pahri e njeh mirë dhe e di që ai e ka aftësinë për të bërë të tilla gjëra. Madje kohët e fundit ajo e kishte pyetur veten herë pas here nëse i jepnin kënaqësi atij këto gjëra, kur i bënte.

Pikërisht në një dhomë urgjence pak a shumë si kjo e kishte takuar Mamaja për herë të parë Zhyljenin. Kjo kishte ndodhur dhjetë vjet më parë, në vitin 1963, kur Pahri kishte qenë katërmbëdhjetë vjeç. Ai kishte sjellë këtu një shok pune që vuante nga migrena. Mamaja kishte sjellë Pahrin, kishte qenë ajo vetë pacientja në atë rast, sepse kishte ndrydhur keq kyçin e këmbës gjatë orës së gjimnastikës në shkollë. Pahri po qëndronte shtrirë në një shtrat me rrota, kur Zhyljeni hyri me gjithë karrige në dhomë e nisi të bisedonte me Mamanë. Pahrit nuk i kujtohej se ç'kishin thënë. Por i kujtohej që Zhyljeni kishte thënë: "Paris? Si qyteti?" Dhe Mamaja i kishte kthyer

përgjigjen e zakonshme: "Jo, pa *s*. Do të thotë "zanë" në gjuhën farsi".

Ato e kishin takuar Zhyljenin përsëri po atë javë, në një ditë gjithë shi, për të darkuar në një restorant të vogël në Bulevardin *Sen Zhërmë*. Sa ishin ende në shtëpi, Mamaja e kishte zgjatur shumë shfaqjen teatrore se çfarë të vishte dhe në fund kishte vendosur për një fustan ngjyrëblu pastel me bel të ngushtë, dorashka mbrëmjeje dhe sandale me majë. Dhe edhe pas gjithë kësaj, e kishte pyetur përsëri Pahrin në ashensor:

- Nuk dukem shumë e ngrefosur, apo jo? Hë, si të dukem?

Përpara se të hanin, kishin pirë duhan, që të tre dhe Mamaja e Zhyljeni kishin pirë birrë me kriklla gjigante të ngrira. Pasi kishin mbaruar krikllën e parë, Zhyljeni kishte porositur një tjetër dhe pas kësaj edhe një të tretë. Zhyljeni, i veshur me këmishë të bardhë, kollare dhe një jelek mbrëmjeje, kishte sjelljen e kontrolluar e aristokrate të një njeriu të edukuar mirë. Ai buzëqeshte i shpenguar dhe qeshte pa sforcim. Në tëmtha i ishin shfaqur ca fije të bardha, të cilat Pahri nuk ia kishte vënë re nën dritën e zbehtë të dhomës së urgjencës dhe tani po mendonte se ai duhej të kishte moshën e së ëmës. Ai i njihte mirë të gjitha zhvillimet e fundit në politikat europiane dhe tani po diskutonte për veton e De Golit lidhur me hyrjen e Anglisë në Tregun e Përbashkët, çka, për habinë e Pahrit, ia doli mbanë të nxiste edhe interesimin e Mamasë. Dhe vetëm pasi e kishte pyetur Mamaja, ai e kishte kthyer bisedën te vetja dhe i kishte treguar se sapo kishte nisur të jepte leksione ekonomie në Universitetin e Sorbonës.

- Profesor? Punë shumë dinjitoze.

- Oh, jo edhe aq, - ishte përgjigjur ai. - Duhet ta provosh ndonjëherë. Ka për të ta larguar menjëherë nga mendja atë mendim.

- Mbase e provoj.

Pahri e kishte ndier që Mamanë e kishte zënë ndërkaq pija.

- Mbase hyj vjedhurazi në klasë ndonjë ditë. Të të shoh në veprim.

- "Veprim"? Besoj se të kujtohet që unë jap teorinë e ekonomisë, Nila. Po qe se vjen, do të gjesh vetëm ca studentë që mendojnë se unë jam i shkundur.

- E po, për këtë kam ca dyshime.

Edhe Pahri nuk e kishte besuar këtë. Asaj i ishte krijuar përshtypja se shumica e studenteve të Zhyljenit ëndërronin të flinin me të. Gjatë darkës, ajo kishte treguar kujdes që askush të mos e vinte re kur e shihte. Ai kishte një fytyrë që dukej sikur ishte bërë për filmat bardhezi, ndërsa perdet veneciane hidhnin hije paralele mbi të dhe tymi i cigares ngjitej në formë spiraleje përpara saj. Një tufë e hollë flokësh në formën e një kllape katrore i binte mbi ballë: me shumë dinjitet, e mbase me më shumë nga ç'duhet. E, ndërkohë që ajo tufëz flokësh kishte rrëshqitur aty vetvetiu, Pahri kishte vënë re se ai nuk e kishte vrarë mendjen për asnjë çast që ta largonte nga balli.

Ai e kishte pyetur mamanë për dyqanin e vogël të librave që kishte ajo, ku shiste vetë. Ishte buzë Senës, në anën tjetër të *Pont d'Arkol*.

- Ke libra për muzikën xhaz?

- *Bah, oui*[1], - ia kishte kthyer Mamaja.

Shiu përjashta kishte nisur të binte me gjyma dhe restoranti kishte nisur të gumëzhinte nga njerëzit. Ndërsa kamerieri u shërbente pufka djathi dhe feta sallami, ja tek kishte nisur mes Zhyljenit e Mamasë një diskutim i gjatë për Bad Pauellin, Soni Stitin, Dizi Xhillespin dhe për të parapëlqyerin e Zhyljenit, Çarli Parkerin. Mamaja, nga ana e saj, kishte thënë se pëlqente më shumë stilin e Bregdetit Perëndimor, Çet Bejkerin dhe Majls Dejvisin. A e kishte dëgjuar ai "*Kind of Blue*"? Pahri ishte habitur tani që po merrte vesh se Mamaja e adhuronte xhazin kaq shumë dhe dinte kaq shumë gjëra për gjithë ata muzikantë të ndryshëm. Ajo, jo për herë të parë, kishte mbetur

---

1) Po patjetër (*shën. i përkth.*).

si e goditur, njëherazi nga një ndjenjë fëmijërore admirimi për të ëmën dhe nga ndjesia e pakëndshme se ajo nuk e njihte plotësisht nënën e vet. Por ajo që nuk e kishte habitur aspak, ishte mënyra se si e kishte joshur e ëma Zhyljenin pa kurrfarë sforcimi. Kjo ishte pika më e fortë e Mamasë. Ajo nuk kishte vuajtur kurrë për të thithur vëmendjen e meshkujve. Ajo i gllabëronte meshkujt.

Pahri e shihte Mamanë teksa mërmërinte gjithë lozonjaritet, teksa qeshte si koketë me shakatë e Zhyljenit, duke anuar paksa kokën e duke përdredhur me gishta një bukle flokësh. Ajo përsëri ishte mrekulluar me faktin që e ëma dukej aq e re dhe aq e bukur: ajo, Mamaja, që ishte njëzet vjet më e madhe se ajo. Me flokët e gjatë e të zinj, gjinjtë e plotë, sytë vezullues dhe fytyrën e lëmuar, që shkëlqente me ato tiparet klasike e imponuese të një princeshe. Dhe mrekullohej edhe me faktin se ajo vetë nuk i ngjante pothuajse aspak së ëmës: me sytë e zbehtë, hundën e gjatë, hapësirën midis dhëmbëve të përparmë kur qeshte, dhe gjinjtë e vegjël. Po qe se mund të quhej ndonjëherë e bukur, kjo ishte një bukuri modeste krejtësisht tokësore. Të qenët pranë së ëmës i kujtonte gjithmonë Pahrit se pamja e saj e jashtme ishte si një rrobë e zakonshme. Ndonjëherë, ishte vetë Mamaja që ia kujtonte këtë, edhe pse gjithmonë me anën e një kali Troje të veshur me komplimente.

Ajo i thoshte:

*- Ti je me fat, Pahri. Nuk do të kesh nevojë të lodhesh që burrat të të marrin seriozisht. Ata do të të kushtojnë vëmendje. Një bukuri shumë e madhe, hedh në erë gjithçka.* - Dhe pastaj qeshte. *- Oh, dëgjo këtu: Nuk është se po flas nga përvoja ime. Pa dyshim që jo. Thjesht e kam vënë re.*

*- Ti po më thua se nuk jam e bukur.*

*- Po të them se nuk ke ç'e do të jesh e bukur. Veç kësaj, ti je shumë e pashme; dhe kjo është gjë shumë e mirë.* Je t'assure, ma cherie[1]. *Është shumë më mirë.*

---

1) Ta kesh prej meje, e dashur (*shën. i përkth.*).

Ajo nuk ngjante as me të atin. Ai kishte qenë një burrë i gjatë me fytyrë serioze, ballë të lartë, mjekër të ngushtë dhe buzë të holla. Pahri kishte ca fotografi të tij në dhomën e saj, që i kishte marrë nga shtëpia në Kabul. Ai ishte sëmurur në vitin 1955 - koha kur ajo dhe e ëma erdhën në Paris - dhe kishte vdekur pak kohë më pas. Ndonjëherë Pahri e gjente veten duke parë fotografitë e tij të vjetra, në mënyrë të veçantë ato bardhezi ku kishin dalë të dy bashkë, ajo dhe i ati, përpara një makine të vjetër amerikane. Ai ishte mbështetur mbi kapakun e përparmë dhe ajo ishte në krahët e tij, të dy duke buzëqeshur. Asaj i kujtohej se si njëherë ishin ulur të dy bashkë në dysheme përpara dollapit të saj dhe ai kishte vizatuar aty gjirafa e majmunë bishtgjatë. Ai e kishte lënë që ta ngjyroste ajo njërin prej majmunëve, duke ia mbajtur dorën e duke e mësuar me durim se si të ngjyroste me furçë.

Çdo herë që e shihte fytyrën e të atit në ato fotografi, Pahrit i ngjallej një ndjesi e vjetër, një ndjesi që e kishte pasur prej aq kohësh sa arrinte të mbante mend. Ndjesia se në jetën e saj mungonte diçka ose dikush që ishte thelbësor për ekzistencën e saj. Ndonjëherë ishte një ide e turbullt, si një mesazh i dërguar nga shumë larg ose nga rrugë të tërthorta të turbullta, si një sinjal i dobët radioje, me zhurmë, i paqartë. Ndonjëherë këtë mungesë e ndiente shumë qartë, aq qartë sa niste t'i dhembte zemra. Për shembull, në Provansë, dy vjet më parë, kur kishte parë një lis gjigant pranë një shtëpie në një fermë. Një herë tjetër në Kopshtin e Tyilerive, kur kishte parë një nënë të re ndërsa merrte në krah djalin që e kishte shtrirë në një karrocë të vogël të kuqe. Pahri nuk e kuptonte. Dikur ajo kishte lexuar një histori për një mesoburrë turk, që ishte kredhur befas në depresion të thellë, kur vëllai i vet binjak, që ai deri në ato çaste nuk e kishte ditur se ekzistonte, kishte pësuar një infarkt fatal, ndërkohë që po shëtiste me kanoe në mes të pyllit të Amazonës. Kjo ishte gjëja që i ishte përafruar më shumë se çdo tjetër asaj që ndiente ajo.

Një herë i kishte folur edhe Mamasë për këtë.

*- E po, nuk është ndonjë gjë e panjohur,* mon amour[1], *- i ishte përgjigjur Mamaja. - Të mungon yt atë. Ai nuk është më në jetën tënde. Është normale që të ndihesh në këtë mënyrë. Pa dyshim që kështu është. Eja këtu. Jepi mamit një puthje.*

Përgjigjja e së ëmës kishte qenë më se e arsyeshme, por nuk e kishte kënaqur. Pahri besonte se do të ndihej më e plotë, nëse i ati do të ishte ende gjallë, nëse do të kishte ardhur edhe ai të jetonte këtu me to. Por asaj i kujtohej që ndjesi të tilla ajo i kishte pasur qysh fëmijë, që kur jetonte me të dy ata në shtëpinë e madhe në Kabul.

Pak pasi kishin mbaruar darkën, Mamaja kishte kërkuar ndjesë se i duhej të shkonte në tualetin e restorantit, dhe Pahri kishte mbetur vetëm me Zhyljenin për disa minuta. Ata të dy kishin nisur të flisnin për një film që Pahri e kishte parë një javë më parë, një film me Zhanë Moronë në rolin e një kumarxheshe, mandej edhe për shkollën e për muzikën. Ndërsa fliste ajo, ai i kishte mbështetur të dy bërrylat në tryezë dhe ishte përkulur paksa drejt saj, duke e dëgjuar me interesim të madh, njëherazi ballëngrysur e duke buzëqeshur, pa i hequr për asnjë çast sytë nga ajo. "Thjesht po luan lojën, - kishte menduar Pahri me vete, - ai thjesht po shtiret." Një veprim i rafinuar që ai e bënte shpesh me gratë e që kishte vendosur ta bënte edhe tani, në këto pak çaste, për të luajtur me të e për t'u argëtuar në kurriz të saj. Ajo e gjeti veten duke folur me një ton artificialisht të sofistikuar, qesharak, që nuk ngjasonte aspak me mënyrën se si fliste ajo zakonisht. Dhe ishte e vetëdijshme për këtë, por ja që nuk e frenonte dot veten.

Ai i kishte thënë se kishte qenë një herë i martuar, për pak kohë.

- Vërtet?

- Ca vjet më parë. Kur isha tridhjetë. Në atë kohë jetoja në Lion.

Ai kishte qenë i martuar me një grua të moshuar. Dhe

---

1) Zemra ime (*shën. i përkth.*).

martesa nuk kishte zgjatur shumë, ngaqë ajo kishte qenë shumë zotëruese ndaj tij. Zhyljeni nuk e kishte thënë këtë në sy të Mamasë.

- Ishte një lidhje krejtësisht fizike, me gjithë mend, - i kishte thënë ai. - *C'était complétement sexuelle*[1]. Ajo donte të më kishte pronë të vetën.

Ai po e shihte në sy teksa e thoshte këtë, dhe mbi buzë kishte vënë një buzëqeshje të lehtë shkatërrimtare, duke pritur me kujdes reagimin e saj. Pahri kishte ndezur një cigare dhe ishte hequr sikur nuk i kishte bërë përshtypje, ishte treguar e ftohtë si Brixhit Bardoja, a thua se dëgjonte përditë të tilla gjëra nga meshkujt. Por përbrenda po dridhej e tëra. Ajo e dinte se në atë tryezë ishte kryer një akt i vogël tradhtie. Diçka paksa ilegale, jo plotësisht dëmtuese, por joshëse. Kur Mamaja ishte kthyer sërish, me flokët e krehur dhe buzët e lyera rishtaz me buzëkuq, ai çast intim mes tyre ishte shpërbërë dhe Pahri kishte ndier një lloj zemërimi ndaj Mamasë, që po hynte midis tyre, por ishte penduar menjëherë për këtë.

Ajo e kishte takuar përsëri Zhylienin një javë më vonë. Ishte mëngjes dhe ajo po hynte në dhomën e Mamasë me një filxhan me kafe. E kishte gjetur të ulur në anë të shtratit të Mamasë, duke tundur orën e dorës. Ajo nuk e dinte që ai e kishte kaluar natën aty. Pahri e kishte parë nga korridori, nga një e çarë te dera. Dhe kishte mbetur aty, e shtangur, me filxhanin me kafe në dorë, me një ndjesi në gojë sikur sapo kishte futur aty një shuk balte të thatë, me sytë të ngulur tek ai: lëkura pa njolla e shpinës së tij, kërcimi i lehtë i barkut, zona e errët midis kofshëve, që mbulohej vetëm pjesërisht nga çarçafi i mbledhur. Ai e kishte vënë orën në dorë, kishte marrë një cigare nga komodina te koka e shtratit, e kishte ndezur dhe pastaj kishte vështruar nga ajo, a thua se e pati ditur që ajo kishte kohë që qëndronte aty. Dhe i kishte buzë-

---

1) Ishte krejtësisht seksuale (*shën. i përkth.*).

qeshur me buzët të puthitura. Pastaj Mamaja kishte thënë diçka që nga dushi dhe Pahri ishte bërë erë. Ishte një mrekulli që nuk e kishte derdhur kafen mbi trupin e vet.

Mamaja dhe Zhyljeni qenë të dashur për gjashtë muaj. Ata shkonin shpesh në kinema dhe nëpër muze, sikurse edhe në galeritë e vogla të artit që ekspozonin veprat e piktorëve të panjohur me emra të huaj. Një fundjavë ata kishin shkuar me makinë në Arkashon, pranë Bordosë dhe ishin kthyer me fytyra të nxira dhe me një arkë me verë të kuqe. Zhyljeni e merrte me vete në veprimtaritë që zhvillonte universiteti i tij, dhe mamaja e ftonte në rastet kur autorët vinin në librarinë e saj për të lexuar fragmente nga librat e tyre. Në fillim shkonte edhe Pahri me ta - ia kërkonte Zhyljeni, çka dukej se edhe Mamasë i pëlqente - por shumë shpejt nisi të gjente justifikime për të qëndruar në shtëpi. Ajo nuk donte të shkonte, nuk mundej. Nuk e përballonte dot. Atyre u thoshte se ishte shumë e lodhur ose se nuk ndihej mirë. Ose thoshte se do të shkonte në shtëpinë e shoqes së saj, Koletës, për të mësuar. Koleta, shoqe shkolle që nga klasa e dytë fillore, ishte një vajzë thatime, me pamje të brishtë, flokë të gjatë të butë e një hundë si sqep korbi. Asaj i pëlqente t'i ngacmonte njerëzit e të thoshte gjëra të pacipa, skandaloze.

- Unë vë bast se tani po ndihet i zhgënjyer, - thoshte Koleta. - Ngaqë nuk ke shkuar edhe ti me ta.

- E po, edhe në është, nuk e bën veten.

- Ai nuk mund ta bëjë veten, apo jo? Ç'do të mendonte mamaja jote pastaj?

- Për çfarë? - thoshte Pahri, edhe pse e dinte përgjigjen, sigurisht. Ajo e dinte, por donte që ta dëgjonte të thënë nga të tjerët.

- Për çfarë?! - vazhdonte Koleta me një ton të entuziazmuar, ngacmues. - Që ai po rri me mamanë tënde për të arritur tek ti! Që je ti ajo që do ai!

- Kjo është e neveritshme, - thoshte Pahri duke mohuar fuqishëm.

- Ose mbase ju do që të dyja. Mbase i pëlqejnë shumë njerëz në shtrat. Në është kështu, mund të të kërkoj t'i thuash një fjalë të mirë edhe për mua.

- Sa e pacipë që je, Koleta!

Ndonjëherë, kur Mamaja kishte dalë me Zhyljenin, Pahri zhvishej në korridor dhe niste të shihej në pasqyrë. Ajo gjithmonë gjente të meta në trupin e vet. Ishte shumë i gjatë, mendonte ajo, pa forma, shumë... praktik. Ajo nuk kishte trashëguar asnjë prej harkimeve magjepsëse të së ëmës. Ndonjëherë ajo hynte ashtu, pa asgjë në trup, në dhomën e së ëmës dhe shtrihej në shtratin ku - ajo e dinte - Mamaja dhe Zhyljeni bënin dashuri. Pahri qëndronte shtrirë aty, krejtësisht e zhveshur, me sytë mbyllur, me zemrën që i rrihte fort në kraharor, duke shijuar atë çast shpengimi të plotë, ndërsa një si lloj drithërime i shpërndahej në kraharor, mbi bark e më poshtë.

Një ditë kishte marrë fund, afërmendsh. Historia e Mamasë me Zhyljenin kishte marrë fund. Pahri ndihej e lehtësuar, por jo e habitur. Burrat asnjëherë nuk dinin ta mbanin Mamanë përgjithmonë. Gjithmonë rezultonte se ata ishin katastrofisht të paaftë për çdo lloj ideali që ajo besonte se ata kishin. Ajo që fillonte me pasion të çmendur e gjallëri të madhe, gjithmonë përfundonte me akuza të hidhura dhe fjalë urrejtjeje, me tërbim, lot dhe flakje të enëve të kuzhinës. Tragjedi e rëndë. Mamaja ishte e paaftë për të nisur a për të përfunduar një marrëdhënie pa teprime.

Mandej kishte pasuar periudha e parashikueshme, kur Mamaja ndiente befas një nevojë për vetmi. Ajo qëndronte në shtrat, e veshur me një pallto të vjetër dimri mbi pizhamet: një siluetë e gërmuqur, si hije, që nuk i qeshte kurrë buza në shtëpi. Pahri e dinte se duhej ta linte vetëm. Përpjekjet e saj të mëparshme për ta ngushëlluar nuk kishin qenë të mirëpritura. Dhe ky humor i mbrapshtë zgjaste me javë të tëra. Por me Zhyljenin, kishte zgjatur shumë më gjatë.

- *Ah, merde*![1] - thotë Mamaja tani.

Ajo ngrihet ndenjur në shtrat, e veshur ende me fundin e spitalit. Doktor Deloneji ia ka dhënë Pahrit fletëdaljen dhe ndihmësmjekja po i heq serumin nga krahu.

- Si është puna?

- Tani m'u kujtua. Pas ca ditësh kam një intervistë.

- Intervistë?

- Po, për një revistë me poezi.

- Po kjo është fantastike, mami.

- Ata do ta shoqërojnë intervistën me fotografi, - dhe ajo bën me shenjë drejt qepjeve në ballë.

- Jam e bindur se do të gjesh një mënyrë shumë elegante për t'i mbuluar, - i thotë Pahri.

Mamaja psherëtin, hedh sytë nga ana tjetër. Kur ndihmësmjekja ia heq gjilpërën nga krahu, Mamaja ngërdheshet dhe i gërmushet gruas me fjalë të pakëndshme e të pamerituara.

FRAGMENTE NGA "CICËRIMA AFGANE",
INTERVISTË ME NILA VAHDATIN NGA ETJEN BUSTULEJA.
"*Parallaxe* 84" (dimër 1974), f. 36

Unë hedh përsëri sytë nëpër apartament dhe më tërheq vëmendjen një fotografi në raftin e librave. Është një vajzë e vogël, e ulur galiç në një fushë me gëmusha të egra, krejtësisht e përhumbur në këputjen e diçkaje, si punë luleshtrydheje. Ajo ka veshur një pallto të verdhë të ndritshme, të mbyllur deri në fyt, që bën kontrast me qiellin gri të errët mbi kokën e saj. Në sfond duket një shtëpi ferme prej guri, me grila të mbyllura dhe çati të pjerrët me tjegulla. E pyes për fotografinë.

NV: Vajza ime, Pahri. Unë e thërras si qyteti, por pa "s". Do të thotë "zanë". Fotografinë e kemi bërë në

1) Ah, dreq (*shën. i përkth.*).

Normandi, kemi qenë bashkë atje. Në vitin 1957, besoj. Duhet të ketë qenë tetë vjeç atëherë.

EB: Në Paris jeton edhe ajo?

NV: Studion për matematikë në Sorbonë.

EB: Duhet të jesh krenare. - Ajo mbledh supet e buzëqesh. - Bëj çudi që ajo ka zgjedhur një degë të tillë, nisur nga fakti që ju ia keni dedikuar veten tuaj artit.

NV: Nuk e di se nga e ka trashëguar këtë talent. Gjithë ato formula e teori të pakuptueshme. Por them se për të nuk janë të pakuptueshme. Unë për vete nuk di as tabelën e shumëzimit.

EB: Mbase kjo është mënyra e saj për t'u rebeluar. Ti besoj se e njeh njëfarësoj rebelimin.

NV: Po, por unë u rebelova ashtu siç duhej. Unë pija alkol e duhan e zija dashnorë. Kush rebelohet me matematikën? - Ajo qesh. - Veç kësaj, ajo do të ishte një rebele proverbiale pa arsye. Unë i kam dhënë asaj çdo lloj lirie që mund të merret me mend. Ajo nuk ka nevojë për asgjë. Sime bije nuk i mungon asgjë. Ajo po bashkëjeton me dikë tani. Ai është shumë më i madh. Gjithë sharm, deri në mëkat, me kulturë, me humor. Një narcist, pa dyshim. Me një ego të jashtëzakonshme.

EB: Ti nuk e miraton këtë lidhje.

NV: Miratimi ose mosmiratimi im nuk ka lidhje. Këtu jemi në Francë, zoti Bustule, jo në Afganistan. Të rinjtë nuk jetojnë e nuk vdesin me vulën e miratimit të prindërve.

EB: Domethënë vajza juaj nuk ruan asnjë lidhje me Afganistanin?

NV: Ne ikëm prej andej, kur ajo ishte gjashtë vjeç. Ajo ka fare pak kujtime nga koha e qëndrimit atje.

Unë i kërkoj të më tregojë diçka për jetën e saj të mëparshme.

Ajo më kërkon ndjesë dhe del nga dhoma për një çast. Kur kthehet, ka në dorë një fotografi të vjetër e të

rrudhosur bardhezi. Një burrë i ashpër e i rëndë, me syze, me flokë të shkëlqyer, të ndarë me një vijë fare të drejtë, është ulur prapa një tryeze pune e po lexon një libër. Ka veshur një kostum me xhaketë me xhepa me kapakë, jelek me dy radhë kopsash, këmishë të bardhë me jakë të lartë, ka dhe një papijon.

NV: Im atë. Një mijë e nëntëqind e njëzet e nëntë. Viti kur jam lindur unë.

EB: Duket si aristokrat.

NV: Ai bënte pjesë në aristokracinë pashtune të Kabulit. Shumë i kulturuar, me sjellje të paqortueshme, mjaftueshëm i shoqërueshëm. Dhe një rrëfimtar i shkëlqyer. Të paktën në publik.

EB: Po në shtëpi?

NV: A e gjeni vetë përgjigjen e kësaj pyetjeje, zoti Bustule?

Unë e marr fotografinë dhe e shoh me vëmendje.

EB: I ftohtë, do të thosha. I ashpër. I padepërtueshëm. Nuk bën kompromise.

NV: Unë vërtet po këmbëngul që të pini edhe ju një gotë me mua. E urrej të pi vetëm. - Ajo më mbush një gotë me "*Chardonnay*". Për mirësjellje, unë kthej një gllënjkë. - Im atë kishte duar të ftohta. Pavarësisht nga moti. Vishej me kostume të qepura në mënyrë të përkryer. Dhe me kapelë cilindrike. Me këpucë me dy lloje lëkurësh, dyngjyrëshe, pa dyshim. Them se ishte i pashëm, edhe pse në një mënyrë solemne. Po ashtu - dhe këtë e kuptova vetëm shumë më vonë - ai imitonte në mënyrë paksa qesharake veset europiane: lojëra të përjavshme bullingu dhe poloje dhe kishte një grua franceze, të gjitha këto me miratimin e mbretit të ri progresist. - Ajo nis të brejë thonjtë me dhëmbë dhe nuk thotë asgjë për disa çaste. Unë fik regjistruesin. - Im atë flinte në dhomën e vet, unë dhe im më në tonën. Në më të shumtën e ditëve ai e hante drekën me ministrat dhe këshilltarët e mbretit. Ose

ishte duke kalëruar, duke luajtur polo, ose dilte për gjah. E kishte pasion gjuetinë.

EB: Domethënë ti nuk e shihje shpesh. Ai ishte një figurë munguese.

NV: Jo plotësisht. Ai e kishte bërë zakon që një herë në disa ditë të kalonte pak kohë me mua. Vinte në dhomën time dhe ulej në shtratin tim, që për mua ishte sinjali që të kërceja mbi prehrin e tij. Për disa çaste më tundte mbi gjunjët e veta, asnjëri nuk fliste shumë dhe në fund ai thoshte: "E po, po tani, ç'do të bëjmë, Nila?" Ndonjëherë më linte t'ia merrja shaminë nga xhepi i si-përm i xhaketës dhe ta shpalosja. Sigurisht, unë e bëja shuk dhe ia futja përsëri në xhep, ndërsa ai më shihte me një shprehje fytyre gjoja të habitur, që mua më bënte shumë për të qeshur. Dhe ne e bënim këtë, derisa ai lodhej, çka ndodhte shumë shpejt. Dhe pastaj ai më përkëdhelte kokën me duart e veta të ftohta e më thoshte: "Babi duhet të ikë tani, sorkadhja ime". - Ajo e çon fotografinë në dhomën tjetër dhe kthehet përsëri, nxjerr një paketë të re nga një sirtar dhe ndez një cigare. - Kështu më thërriste ai mua. Unë e adhuroja. Kërceja e vrapoja në kopsht - ne kishim një kopsht shumë të madh - duke kënduar: "Unë jam sorkadhja a babit! Unë jam sorkadhja e babit". Vetëm shumë më vonë e kuptova se sa i mbrapshtë ishte ai emër.

EV: Më fal? Si thatë?

Ajo buzëqesh.

NV: Im atë vriste drerë, zoti Bustule.

Ato mund të shkojnë më këmbë në shtëpinë e Mamasë, por shiu e ka marrë shtruar. Në taksi, Mamaja ulet në ndenjësen e pasme, e mbështjellë me pallton e Pahrit, duke vështruar përtej dritares pa thënë asnjë fjalë. Në këto çaste ajo i duket Pahrit e plakur, shumë më e madhe se dyzet e katër vjeçe. E plakur dhe e brishtë.

Pahri ka kohë që nuk ka qenë në shtëpinë e Mamasë. Kur hap derën dhe hyjnë brenda, ajo e gjen banakun e kuzhinës të mbushur me gota vere të palara, kuti të hapura patatinash e makaronash, pjata me mbeturina ushqimore të fosilizuara e të padallueshme. Mbi tryezë gjendet një qese letre e mbushur me shishe vere bosh, gati për të rënë në tokë. Pahri sheh gazeta në tokë, një nga të cilat me pikat e gjakut të mamasë dhe, mbi të, një çorape leshi bojërozë. Kjo gjendje e shtëpisë së Mamasë e tmerron Pahrin. Dhe ajo ndihet fajtore. Çka duhet të ketë qenë edhe qëllimi i Mamasë; ajo e njeh mirë të ëmën. Pastaj e urren veten që e çoi një gjë të tillë nëpër mend. Kjo është ajo që do të mendonte Zhyljeni: "Ajo do që ti të ndihesh keq". Ai ia ka thënë këtë disa herë gjatë vitit të fundit: "Ajo do që ti të ndihesh keq". Kur e kishte thënë për herë të parë, Pahri ishte ndier e lehtësuar, e mirëkuptuar. Ajo i ishte mirënjohëse që ai kishte gjetur fjalët për të shprehur atë që ajo nuk mundej ose nuk do të donte ta thoshte me zë të lartë. Ajo besonte se kishte gjetur një aleat. Por, këto kohët e fundit, nuk i duket më kështu. Ajo vë re një hije ligësie në fjalët e tij. Një mungesë turbulluese dashamirësie.

Dyshemeja e dhomës së gjumit është e mbuluar me veshje të ndryshme, disqe, libra, gazeta të tjera. Mbi parvazin e dritares gjendet një gotë me ujë që është zverdhur nga bishtat e cigares që po notojnë aty. Ajo heq librat dhe revistat e vjetra nga shtrati dhe e ndihmon mamanë që të futet nën mbulesa.

Mamaja sheh nga ajo, me shpinën e njërës dorë të mbështetur në fashën në ballë. Në këtë pozë ajo duket si një aktore në një film pa zë që nga çasti në çast do t'i bjerë të fikët.

- Do të jesh mirë, mami?

- Nuk besoj, - i thotë ajo. Por nuk duket si lutje për vëmendje. Mamaja e thotë këtë me një zë të zvargët, të lodhur. Ajo duket e lodhur, e sinqertë dhe e vendosur.

- Mami, po më tmerron.

- Do të ikësh tani?

- Do që të qëndroj?
- Po.
- Atëherë do të qëndroj.
- Fike dritën.
- Mami?
- Po?
- A po i merr barnat? Apo i ke ndërprerë? Kam frikë se nuk po i merr më dhe kjo më shqetëson.
- Mos u gërric me mua tani. Fike dritën.

Dhe Pahri ashtu bën. Ajo ulet në anë të shtratit dhe e sheh të ëmën, ndërsa fle. Pastaj shkon në kuzhinë, që t'i përvishet punës së jashtëzakonshme të pastrimit. Ajo gjen një palë doreza dhe nis të lajë enët. Lan gotat që mbajnë erë qumështi të thartuar prej një kohe të gjatë, pastron orizin e ngjitur në tenxhere, pjatat me mbeturina ushqimore të mbuluara vende-vende nga njolla jeshile myku. I kujtohet hera e parë kur kishte larë enët në apartamentin e Zhyljenit, mëngjesin pas asaj nate kur kishin fjetur bashkë për herë të parë. Zhyljeni kishte bërë omëletë për mëngjes. Sa i kishte pëlqyer ky veprim i thjeshtë shtëpiak: larja e enëve në sqollin e tij, ndërkohë që ai vinte një pllakë të Xhejn Birkingut në gramafon.

Ajo ishte ritakuar me të një vit më parë, në 1973, për herë të parë pas pothuaj dhjetë vjetësh. E kishte takuar në një marshim në rrugë përpara Ambasadës Kanadeze, një protestë studentore kundër gjuetisë së fokave. Pahri nuk kishte dashur të shkonte. Aq më tepër që i duhej të përfundonte një punim për funksionet meromorfike. Por Koleta kishte ngulur këmbë. Asokohe ato jetonin në një shtëpi, çka ishte bërë ndërsjelltazi e pakëndshme për të dyja.

Koleta në atë kohë kishte nisur hashashin. Ajo lidhte shirita në kokë dhe vishte tunika ngjyrë magente të zbukuruara me zogj e luledele. Ajo sillte në shtëpi djem shkatarraqë e flokëgjatë, që hanin ushqimin e Pahrit dhe i binin shumë keq kitarës. Koletën gjithmonë e gjeje në rrugë, duke bërtitur, duke denoncuar egërsinë ndaj kafshëve, racizmin, skllavërinë,

provat bërthamore të Francës në Paqësor. Gjithmonë do të gjendej dikush që do të trokiste në derë; në shtëpi hynin e dilnin vazhdimisht njerëz që Pahri as nuk i kishte parë ndonjëherë për fytyrë. Dhe, kur mbeteshin vetëm ndonjëherë, Pahri e ndiente tensionin midis të dyjave, një lloj mosmiratimi te Koleta, një lloj mosmiratimi të heshtur ndaj saj.

- Ata gënjejnë, - kishte thënë Koleta gjithë pasion. - Ata thonë se metodat e tyre janë njerëzore. Njerëzore! E ke parë se me çfarë i kapin? Me ata *hakapikët*! Në gjysmën e rasteve kafsha e gjorë as nuk ka ngordhur ende dhe ata bastardë ia ngulin grepat për ta nxjerrë nga uji dhe e plasin në varkë. Ata ua rrjepin lëkurën për së gjalli, Pahri! Për së gjalli! - Mënyra se si e kishte thënë Koleta këtë fjalinë e fundit, mënyra se si e kishte theksuar, e kishte bërë Pahrin që të kërkonte ndjesë. Se për çfarë, ajo nuk e dinte as vetë, por një gjë e dinte mirë: kohët e fundit, të qenët pranë Koletës, e rrethuar nga shfryrjet e saj ndaj të gjitha krimeve makabre në botë, po i merrte frymën.

Vetëm tridhjetë veta kishin ardhur në atë manifestim. Kishte zëra që thoshin se do të vinte edhe Brixhid Bardoja, por më në fund doli se ishin thjesht fjalë. Koleta kishte mbetur e zhgënjyer. Ajo ishte zënë ashpër me një djalosh të gjatë, të dobët e me syze, që quhej Erik, i cili, me sa kishte kuptuar Pahri, ishte organizatori i marshimit. I gjori Erik. Pahrit i kishte ardhur shumë keq për të. Duke turfulluar, Koleta kishte dalë në krye të manifestuesve. Pahri kishte ngadalësuar hapat dhe kishte mbetur në fund, pranë një vajze me gjoks të rrafshët, që thërriste parulla të ndryshme me një zë histerik. Ajo vetë i mbante sytë poshtë gjatë gjithë kohës dhe mundohej të mos dilte nga rreshti.

Në një qoshe rruge, një burrë e kishte prekur lehtë me gishta në sup.

- Duket sikur mezi po pret që të të shpëtojë ndokush.

Ai kishte veshur një xhaketë tuid, një pulovër, pantallona xhinse dhe një shall të leshtë. Flokët i kishte më të gjatë dhe

dukej disi më i moshuar, por në një mënyrë elegante, që grave të moshës së tij mund t'i dukej e padrejtë e, madje, acaruese. Ende elegant e me muskuj të formuar mirë, ca rrudha poshtë syve, ca fije gri më shumë në tëmtha, mbi fytyrën e tij vihej re vetëm një hije e lehtë mërzie.

- Në atë gjendje jam, - i ishte përgjigjur ajo.

Ata ishin puthur në faqe dhe, kur ai e kishte ftuar për të pirë një kafe, ajo kishte pranuar.

- Shoqja jote duket e zemëruar. Vërtet e zemëruar .

Pahri kishte kthyer edhe një herë kokën nga marshuesit dhe e kishte parë Koletën pranë Erikut, ende duke bërtitur e duke tundur grushtin lart, por po ashtu, në mënyrë absurde, duke parë nga ata të dy. Pahri e kishte mposhtur të qeshurën që gati e kishte pushtuar në atë çast: dëmi do të kishte qenë i pariparueshëm. Ajo thjesht kishte mbledhur supet në shenjë ndjese dhe ishte larguar prej aty.

Ata kishin shkuar në një kafene të vogël dhe ishin ulur në një tryezë pranë dritares. Ai kishte porositur kafe dhe nga një *milfëj* për secilin. Pahri e shihte teksa i fliste kamerierit me një ton autoritar gjenial, që asaj i kujtohej mirë dhe i shkaktonte të njëjtën dridhje në stomak që pati ndier edhe kur ishte adoleshente dhe ai vinte ta merrte Mamanë për të dalë. Befas ishte ndier e vetëdijshme për thonjtë që i hante, për fytyrën pa tualet, për flokët e patharë kaçurrelë. Tani do të kishte dashur që t'i kishte tharë pasi kishte dalë nga dushi, por ishin bërë vonë dhe Koleta kishte nisur të ulërinte si kafshë kopshti zoologjik.

- Nuk të mbaja mend si tip protestueseje, - i tha Zhyljeni, duke i ndezur një cigare.

- Nuk jam. Ishte më shumë nga ndjenja e fajit, sesa nga bindja.

- Ndjenja e fajit? Për gjuetinë e fokave?

- Ndaj Koletës.

- Ah. Po. Ti e di që unë mendoj se duhet t'ia kemi paksa frikën.

- Ashtu ndihemi të gjithë.

Ata kishin qeshur. Ai kishte zgjatur dorën drejt saj dhe i kishte prekur shallin. Pastaj e kishte ulur dorën.

- Do të tregohesha pa takt po të thosha se ju jeni rritur të gjithë, kështu që nuk po e them. Por dukesh vërtet magjepsëse, Pahri.

Ajo kishte kapur etiketën e palltos së vet.

- Si, me këtë veshje "*Clouseau*"? - Koleta ia kishte qortuar atë zakon të kotë, këtë humor vetënënvlerësues prej klouni, me të cilin Pahri mundohej të maskonte nervozizmin e vet përballë burrave që e tërhiqnin. Veçanërisht kur ata i bënin komplimente. Jo për herë të parë, e aspak për herë të fundit, ajo përsëri kishte ndier zili për natyrën e shpenguar e të sigurt në vetvete të Mamasë.

- Pastaj do të thuash se unë jam bërë po aq e mirë sa ç'pritej, - tha ajo.

- Oh, jo. Të lutem! Kjo duket qartë. Është art më vete t'i bësh komplimente një gruaje, ti e di.

- Jo. Por jam e bindur që ti e zotëron.

Kamerieri solli ëmbëlsirat dhe kafen. Pahri u përqendrua te duart e kamerierit, ndërsa ai vendoste filxhanët dhe pjatat në tryezë, kurse pëllëmbët e duarve të veta po i mbusheshin me djersë. Ajo kishte pasur vetëm katër të dashur në jetën e vet, një numër modest, ajo e dinte, po të krahasohej me Mamanë, kur kishte qenë në moshën e saj e, madje, edhe me Koletën. Ajo ishte shumë e kujdesshme, shumë e ndjeshme, njeri që bënte kompromise e përshtatej lehtë, ajo kërkonte lidhje tërësisht të qeta e aspak shteruese si ato të Mamasë ose të Koletës. Por këto nuk ishin cilësi që ua hiqnin trurin meshkujve. Dhe ajo nuk kishte dashur asnjërin prej tyre, edhe pse njërin e kishte gënjyer duke i thënë se e donte. Thellë brenda vetes ajo mbante të fshehura mirë ndjenjat për Zhyljenin, për fytyrën e tij të bukur, që dukej sikur rrezatonte dritën që gjendej brenda tij.

Ndërsa hanin, ai kishte nisur të fliste për punën e vet. E kishte lënë punën si pedagog disa vjet më parë. Dhe për disa vjet ishte marrë me kreditë afatgjata që u jepte Fondi Monetar Ndërkombëtar vendeve me të ardhura të ulëta ekonomike. Gjëja më e mirë e kësaj pune kishin qenë udhëtimet.

- Ku ke qenë?

- Në Jordani, në Irak. Pastaj u tërhoqa për disa vjet për të shkruar një libër për ekonomitë informale.

- E botove?

- Ashtu thuhet, - kishte buzëqeshur ai. - Tani punoj për një firmë konsulente private këtu në Paris.

- Edhe unë dua të udhëtoj, - kishte thënë Pahri. - Koleta më thotë vazhdimisht se duhet të shkojmë në Afganistan.

- Them se e di pse do ajo që të shkojë atje.

- E po, unë jam menduar për këtë. E kam fjalën, për të shkuar atje. Nuk më intereson hashashi, por dua të shkoj në atë vend, të shoh se ku kam lindur. Mbase edhe e gjej shtëpinë e vjetër të prindërve.

- Nuk e kisha vënë re që e kishe këtë fiksim.

- Jam kureshtare. Dua të them, mua më kujtohen kaq pak gjëra.

- Më kujtohet që një herë the diçka për kuzhinierin e shtëpisë.

Pahri ishte ndier e magjepsur përbrenda, ngaqë atij i kujtohej diçka që i pati thënë ajo shumë vjet më parë. Ai me siguri kishte menduar për të asokohe, kur mbetej vetëm. Me siguri që ajo kishte qenë në mendjen e tij.

- Po. Ai quhej Nabi. Ishte edhe shoferi ynë. Ngiste makinën e babait, një makinë amerikane, ngjyrëblu, me çati të errët. Më kujtohet që kishte një shqiponjë mbi kapakun e motorit.

Më pas ai e kishte pyetur për shkollën dhe ajo kishte nisur t'i fliste për studimet e veta dhe fokusimin te ndryshoret komplekse. Ai po e dëgjonte ashtu si Mamaja nuk e kishte dëgjuar kurrë, Mamaja, që dukej e mërzitur për vdekje nga

këto lloj bisedash dhe e çmeritur nga pasioni i Pahrit për to. Mamaja as nuk arrinte të shtirej sikur i interesonte. Ajo bënte shaka mendjelehta që, në sipërfaqe, dukej sikur talleshin me vetë padijen e vet. "*Oh, la-la*, - ia bënte ajo, duke qeshur - Koka! Koka! Po më tundet si totem! Do të bëj një marrëveshje me ty, Pahri. Unë do të të jap çaj dhe ti do të kthehesh përsëri në Tokë, mirë?

Ajo qeshte, dhe qeshte edhe Pahri tok me të, por ajo e ndiente thelbin e këtyre ngacmimeve, një lloj qortimi i tërthortë, një lloj sugjerimi se njohuritë e saj i dukeshin jashtëtokësore dhe fokusimi tek ato, si humbje kohe. *Humbje kohe*. Që ishte gjë e madhe - mendonte Pahri - e dalë nga goja e një poeteje, edhe pse këtë nuk do t'ia thoshte kurrë së ëmës.

Zhyljeni e kishte pyetur se çfarë pëlqente te matematika, dhe ajo i ishte përgjigjur se i dukej ngushëlluese.

- Unë do të thosha "e frikshme", si një epitet më i përshtatshëm, - kishte thënë ai.

- Edhe ajo është.

Ajo i kishte thënë se ngushëllimin e gjente tek të vërtetat e përjetshme të matematikës, te mungesa e arbitraritetit dhe e dykuptimësisë. Te fakti se përgjigjet mund të ishin të padukshme, por në fund të fundit gjendeshin diku. Ato ishin aty, në pritje, si shkarravina karboni.

- Me fjalë të tjera, nuk është si jeta, - tha ai. - Në jetë është fjala për mungesë përgjigjesh ose për përgjigje të paqarta.

- Kaq e tejdukshme qenkam?! - Ajo kishte qeshur dhe e kishte mbuluar fytyrën me pecetë. - Më duket vetja si idiote.

- Aspak, - kishte thënë ai dhe ia kishte larguar pecetën. - Aspak.

- Si një prej studenteve të tua. Unë thjesht të kujtoj studentet e tua.

Ai i kishte bërë më shumë pyetje, përmes të cilave Pahri kishte kuptuar se ai e njihte teorinë e numrave analitikë dhe i njihte, qoftë edhe përciptazi, Karl Gausin dhe Bernard Rimanin. Ata kishin folur gjatë, derisa qielli ishte errur. Kishin pirë

kafe, pastaj birrë e më në fund verë. Dhe pastaj, kur ishte e pamundur që pyetja të shtyhej edhe më, Zhyljeni ishte përkulur drejt saj dhe i kishte thënë me një ton të sjellshëm e gjithë respekt:

- Tani më thuaj, si është Nila?

Pahri kishte fryrë faqet dhe e kishte nxjerrë ajrin jashtë ngadalë.

Zhyljeni kishte pohuar me kokë: e kuptonte.

- Mund ta humbasë librarinë, - kishte thënë Pahri.

- Më vjen keq që po e dëgjoj këtë.

- Biznesi ka ardhur në rënie gjatë këtyre viteve. Dhe mund t'i duhet ta mbyllë. Ajo nuk do që ta pranojë, dhe kjo ka për t'i rënë si bombë. Do ta lëndojë fort.

- Shkruan ende?

- Ka ca kohë që jo.

Ai e kishte ndryshuar temën shpejt. Pahri ishte ndier e lehtësuar. Ajo nuk donte të fliste për Mamanë, për pijen e saj dhe për përpjekjet e veta për ta bindur që të vazhdonte të pinte barnat. Pahrit i kujtoheshin të gjitha vështrimet e çuditshme, në të gjitha rastet kur ajo e Zhyljeni mbeteshin vetëm. Ndërsa Mamaja vishej në dhomën tjetër, Zhyljeni e shihte Pahrin dhe ajo vriste mendjen që të gjente diçka për të thënë. Mamaja duhej ta kishte ndier. A thua të ishte kjo arsyeja e ndarjes së saj nga Zhyljeni? Po qe se kjo ishte e vërtetë, atëherë Pahri ishte e prirë të besonte se Mamaja e kishte bërë këtë më shumë prej ndjenjave të një të dashure xheloze, sesa prej atyre të një nëne mbrojtëse.

Pak javë më vonë, Zhyljeni i kishte kërkuar Pahrit që të shkonte të jetonte me të. Ai jetonte në një apartament të vogël në *Left Bank,* në lagjen 7. Pahri kishte pranuar. Tani thumbimet armiqësore të Koletës e kishin bërë të padurueshëm qëndrimin në të njëjtën shtëpi.

Pahrit i kujtohet e diela e parë në shtëpinë e Zhyljenit. Ata ishin ulur në divanin e tij e ishin mbështetur te njëri-tjetri. Pahri ishte në një gjendje kënaqësie gjysmëzgjimi, ndërsa

Zhyljeni po pinte çaj, me këmbët e gjata të mbështetura në tryezën e kafes. Ai po lexonte faqen e opinioneve në një gazetë. Nga gramafoni vinin tingujt e Zhak Brelit. Herë pas here Pahri ndërronte pozicionin e kokës në gjoksin e tij dhe Zhyljeni përkulej mbi të dhe e puthte lehtë në sy, në vesh, në hundë.

- Duhet t'ia themi Mamasë. - Ajo e kishte ndier se si ishte tendosur ai. Kishte palosur gazetën, kishte hequr syzet për afër dhe i kishte vendosur në krahun e divanit. - Ajo duhet ta dijë.

- Besoj se po, - kishte thënë ai.

- Beson?

- Jo, sigurisht. Ke të drejtë. Duhet ta marrësh në telefon. Por trego kujdes që të mos i kërkosh leje ose bekimin, sepse s'ke për të marrë asnjërin. Thjesht thuaja. Dhe sigurohu që ta kuptojë se nuk ka alternativë tjetër.

- Ti e ke të lehtë ta thuash këtë.

- E mirë, mbase. Gjithsesi, mos harro që Nila është grua hakmarrëse. Më vjen keq që po ta them këtë, por kjo është arsyeja pse gjërat kanë marrë fund në mes nesh. Ajo është tmerrësisht hakmarrëse. Dhe prandaj e di shumë mirë: nuk do ta kesh të lehtë.

Pahri kishte psherëtirë dhe kishte mbyllur sytë. Vetëm ideja po ia pështjellonte stomakun.

Zhyljeni ia kishte përkëdhelur kurrizin me pëllëmbën e dorës.

- Mos u sëmur tani.

Pahri e kishte marrë në telefon të nesërmen dhe kuptoi që Mamaja e kishte marrë vesh ndërkaq.

- Kush ta tha?

- Koleta.

- "Pa dyshim", - mendoi Pahri me vete. - Do të ta thosha vetë.

- E di që do të ma thoshe. Ja, po ma thua tani. Kjo s'është nga ato gjëra që mund të fshihen.

- Je zemëruar me mua?

- Pse, ka rëndësi kjo?

Pahri po qëndronte pranë dritares. Po përshkonte me gisht buzën ngjyrëblu të taketukes së vjetër e të krisur të Zhyljenit. Ajo kishte mbyllur sytë.

- Jo, Mama. Nuk ka rëndësi.

- E po, do të kisha dashur të thosha që kjo nuk ishte lënduese.

- Nuk e bëra me qëllim.

- Besoj se kjo lë goxha vend për diskutim.

- E pse do të doja të të lëndoja, mami?

Mamaja kishte qeshur. Një tingëllimë e shëmtuar, pingëritëse.

- Ndonjëherë të shoh dhe nuk gjej asgjë timen tek ti. Sigurisht që s'ka se si. Tek e fundit, besoj se kjo është diçka që pritet. Unë nuk e di se çfarë njeriu je ti, Pahri. Nuk e di se kush je, se për çfarë gjërash je e aftë, se çfarë ke në gjak. Unë nuk të njoh fare.

- Nuk po e kuptoj se çfarë do që të thuash, - kishte thënë Pahri.

Por Mamaja e kishte mbyllur ndërkaq telefonin.

FRAGMENTE NGA "CICËRIMA AFGANE",
INTERVISTË ME NILA VAHDATIN NGA ETJEN BUSTULEJA.
"*Parallaxe* 84" (dimër 1974), f. 38

EB: Këtu e mësuat frëngjishten?

NV: Ma mësoi mamaja në Kabul, kur isha e vogël. Ajo më fliste vetëm frëngjisht. Dhe më vinte të mësoja çdo ditë. E pata shumë të vështirë, kur ajo u largua nga Kabuli.

EB: Për të ardhur në Francë?

NV: Po. Prindërit e mi u divorcuan në vitin 1939, kur unë isha dhjetë vjeç. Unë isha fëmija i vetëm i babait.

As që bëhej fjalë të më linte të shkoja me të. Kështu që qëndrova, kurse ajo shkoi në Paris për të jetuar me motrën e vet, Anjezen. Im atë u mundua të ma mbushte mungesën e saj duke më marrë një kujdestare private e duke më çuar në kurse kalërimi e arti. Por asgjë nuk e zëvendëson nënën.

EB: Ç'i ndodhi asaj?

NV: Oh, vdiq. Kur nazistët pushtuan Parisin. Nuk e vranë ata. Ata vranë Anjezen. Mamaja ime vdiq nga pneumonia. Im atë nuk më tha gjë, derisa Parisi u çlirua nga Forcat Aleate, por atëherë unë e kisha kuptuar. Thjesht e kisha nuhatur.

EB: Duhet të ketë qenë e vështirë.

NV: Ishte shkatërruese. Unë e adhuroja mamanë. Kisha bërë plane që të shkoja të jetoja me të në Francë, pasi të mbaronte lufta.

EB: Kjo do të thotë se ti dhe yt atë nuk merreshit vesh.

NV: Mes nesh kishte tensione. Ziheshim. Shumë. Çka ishte gjë e re për të. Ai nuk ishte mësuar që t'ia kthenin fjalën, mbi të gjitha jo një femër. Ai vazhdimisht do të grindej me mua se ku shkoja, çfarë vishja, çfarë thosha, si e thosha e kujt ia thosha. Unë u bëra e keqe dhe aventuriere, kurse ai, më shumë asketik dhe i ashpër. Ishim shndërruar në kundërshtarë. - Ajo qesh dhe pastaj shtrëngon nyjen e shamisë që ka vënë në kokë. - Dhe pastaj unë fillova të bija në dashuri. Shpesh, gjithë dëshpërim dhe, për tmerrin e tim eti, me sojin e gabuar. Njëherë me djalin e një shërbyeseje, një herë tjetër me një njeri të shërbimit publik që merrej me disa çështje të biznesit të tim eti. Pasione të vrullshme, të pakontrolluara, të gjitha të katranosura qysh në fillim. Unë mundësoja takime të fshehta dhe përvidhesha nga shtëpia dhe, sigurisht, dikush do t'ia thoshte tim eti se më kishte parë diku në rrugë. Ata i thoshin se unë po bëja pirueta - ata

gjithmonë këtë fjalë përdornin "unë po bëja pirueta". Ose i thoshin se e kisha nxjerrë veten në "paradë". Im atë dërgonte dikë që të më kthente përsëri në shtëpi. Më mbyllte brenda. Për ditë të tëra. Dhe nga ana tjetër e derës më thoshte: "Ti je bërë turpi im. Pse po më turpëron kështu? Si duhet të sillem me ty?" Dhe ndonjëherë i përgjigjej vetë asaj pyetjeje me rripin e mesit ose me një grusht të shtrënguar mirë. Më ndiqte pas nëpër dhomë. Besoj se e bënte këtë për të më terrorizuar, që të nënshtrohesha. Asokohe kam shkruar shumë. Poezi të gjata, skandaloze, ku përshkruaja pasionet e adoleshencës. Druaj se janë më shumë melodramatike dhe të shtira. Zogj në kafaz dhe dashnorë të lidhur me zinxhirë, këto lloj gjërash. Nuk jam krenare për to.

Unë e ndiej se modestia e rreme nuk është karakteristike për të dhe prandaj mund të pohoj se ky është vlerësimi i saj i sinqertë për shkrimet e saj të para. Nëse është e vërtetë kjo, atëherë është tmerrësisht e pafalshme. Në të vërtetë, poezitë e saj të kësaj periudhe mua më duken magjepsëse, edhe të përkthyera, veçanërisht po të marrim parasysh moshën e saj shumë të re në kohën kur i ka shkruar. Ato janë prekëse, të pasura në imagjinatë e emocione, të thella e gjithë dinjitet rrëfimi. Ato flasin shumë bukur për vetminë dhe trishtimin e papërmbajtshëm. Ato pasqyrojnë zhgënjimet e saj, uljet e ngritjet e dashurisë vajzërore në të gjithë shkëlqimin e vet, me premtimet e kurthet e veta. Dhe aty gjen shpesh një ndjesi klaustrofobie tejshqisore, ndjesinë e një horizonti që po ngushtohet, e një lufte të vazhdueshme me rrethanat tirane: shumë shpesh në trajtën e një burri të lig pa emër, që endet nëpër vargje si një hije e egër. Dikush do të mendonte se është një aludim jo dhe aq i fshehtë për të atin. Dhe ia them edhe asaj të gjitha këto:

EB: Dhe në këto poezi ti thyen ritmin, rimën dhe metrin e vargut që, siç e kam kuptuar unë, janë thelbi i poezisë klasike farsi. Ti e lë imagjinatën të rrjedhë lirisht. Lartëson detajet e zakonshme, banale. Dhe kjo ka qenë një risi, unë e kuptoj. A nuk do të ishte më e drejtë të thoshim se, po të kishe lindur në një vend më të pasur - le të themi, për shembull, në Iran - me shumë siguri që ti do të ishe njohur si një pioniere e letërsisë?

Ajo qesh me druajtje.

NV: E kuptoj.

EB: E prapë, mua më bën përshtypje ajo që the pak më parë. Që ti vetë nuk je krenare për këto poezi. A të pëlqen ndonjë nga poezitë e tua?

NV: Pyetje shpuese, kjo. Besoj se do të mundja t'i përgjigjesha pozitivisht, po qe se do të arrija t'i ndaja ato nga vetë procesi krijues.

EB: Do të thuash: të veçosh qëllimin nga mjetet?

NV: Unë e shoh procesin krijues si një vjedhje e domosdoshme me paramendim. Gërmoni nën një shkrim të shkurtër, zoti Bustule, dhe do të gjeni të gjitha mënyrat e pandershme të krijimit. Të krijosh, do të thotë të vërsulesh me vandalizëm mbi jetët e të tjerëve, t'i shndërrosh ata në pjesëmarrës të veprës sate pa dëshirën e vullnetin e tyre. Ti ua vjedh dëshirat, ëndrrat, përvetëson të këqijat, vuajtjen e tyre. Merr atë që nuk është jotja. Dhe e bën këtë me vetëdije të plotë.

EB: Dhe ti e bëje shumë mirë këtë.

NV: Unë nuk e bëja për hir të një koncepti të lartë për artin ose për hir të një qëllimi fisnik, por sepse nuk kisha zgjidhje tjetër. Nevoja për të shkruar ishte tmerrësisht e fuqishme. Po të mos i isha nënshtruar asaj, do të më kishte ikur mendja. Ti më pyet nëse jam krenare për këtë. Është e vështirë të mburresh për diçka që e ke fituar me mënyra që janë moralisht të diskutueshme. Unë ua lë të tjerëve vendimin për t'i vlerësuar ose jo meritat

e mia. - Ajo e kthen me fund gotën e verës dhe e mbush përsëri me atë që ka mbetur në shishe. - Ajo që mund të të them, gjithsesi, është që në Kabul askush nuk i vlerësonte meritat e mia. Askush në Kabul nuk më konsideronte si pioniere të ndonjë gjëje, përveçse të shijes së keqe, shthurjes dhe karakterit imoral. Dhe jo më pak im atë. Ai thoshte se poezitë e mia ishin përçartje të një kurve. Dhe pikërisht kjo ishte fjala që përdorte. Ai më thoshte se e kisha tradhtuar. Dhe më pyeste vazhdimisht pse e kisha kaq të vështirë që të isha një njeri i respektueshëm.

EB: Dhe ti si i përgjigjeshe?

NV: I thosha se nuk më interesonte aspak koncepti që kishte ai për të qenët i respektueshëm. I thosha edhe se nuk kisha aspak dëshirë që t'ia lidhja vetë vetes la-kun në tyt.

EB: Them se kjo thjesht e acaronte më keq.

NV: Sigurisht.

Unë ngurroj për një çast, por mandej vijoj.

EB: Por unë e kuptoj zemërimin e tij. - Ajo ngre njërën vetull. - Ai ishte patriarkal, apo jo? Dhe ti po sfidoje haptazi atë që njihte ai, atë që ai kishte më të shtrenjtë. Duke kërkuar, në njëfarë mënyre, qoftë përmes mënyrës së jetesës, qoftë përmes të shkruarit, mundësi të reja për gratë, që ato të mund të thoshin fjalën e vet për statusin e tyre, që ato të mund të fitonin të drejtat që u takonin, ti po sulmoje një monopol që burrat si puna e tij e kishin mbajtur fort për shekuj me radhë. Ti po thoshe atë që nuk duhej thënë. Ti po bëje një revolucion të vogël, me një grua të vetme, do të thosha unë.

NV: Dhe gjatë gjithë kësaj kohe unë kam besuar se kam shkruar për seksin.

EB: Por edhe kjo është pjesë e kësaj, apo jo?

Unë shfletoj shënimet e mia dhe i përmend titujt e disa poezive haptazi erotike: "*Gjemba*", "*Për hir të*

*pritjes*", "*Jastëku*". I pohoj gjithashtu se këto nuk janë më të parapëlqyerat e mia. Unë vë re aty mungesën e nuancave e të dykuptimësisë. Ato duken sikur janë shkruar me qëllimin e vetëm që të shokojnë e skandalizojnë ata që do t'i lexojnë. Ato më duken si polemika, si akuzat e një njeriu të zemëruar ndaj roleve gjinore në Afganistan.

NV: E po, unë e zemëruar isha. Isha e zemëruar prej asaj idesë se duhej të më mbronin nga seksi. Duhej të më mbronin nga vetë trupi im. Ngaqë isha grua. Dhe gratë - a nuk e dini edhe ju? - janë të papjekura emocionalisht, moralisht dhe intelektualisht. Atyre u mungon vetëkontrolli - e kuptoni? - ato bien lehtë pre e tundimit fizik. Ato janë krijesa hiperseksuale që duhen mbajtur shtrënguar, përndryshe do të kërcejnë nga njëri shtrat në tjetrin me çdo Ahmet e Mehmet që u del përpara.

EB: Por, më falni që po e them këtë, a nuk ishte pikërisht kjo ajo çka bënit ju?

NV: Vetëm në shenjë proteste pikërisht ndaj këtij koncepti. - Ajo ka një të qeshur ngazëllyese, tërësisht ngacmuese e gjithë zgjuarsi. Pastaj më pyet nëse dua të ha drekë. Më thotë se e bija e ka mbushur frigoriferin plot dhe i afrohet atij që të më përgatitë diçka që rezulton të jetë një sanduiç i shkëlqyer me *jambon fumé* [proshutë e pjekur]. Dhe përgatit vetëm një. Për vete, hap një tjetër shishe vere dhe ndez një tjetër cigare. Dhe ulet. - A do të pranosh, për hir të kësaj bisede, që të vazhdojmë të sillemi miqësisht, zoti Bustule? - I përgjigjem se pranoj. - Atëherë më bëj dy favore. Ha sanduiçin dhe mos e shih më gotën time.

Nuk është nevoja të them se kjo ia pret rrugën plotësisht çdo instinkti për ta pyetur për punën e pijes.

EB: Çfarë ndodhi më vonë?

NV: Në vitin 1948, kur isha thuajse nëntëmbëdhjetë vjeç, u sëmura. Ishte një sëmundje e rëndë dhe po e mbyll me kaq. Im atë më çoi në Delhi për trajtim. Ai qëndroi

gjashtë javë me mua atje, ndërsa mjekët kujdeseshin për mua. Më thanë se mund të kisha vdekur. E mbase duhej. Vdekja mund të jetë lëvizja e duhur për karrierën e një poeteje të re. Kur u kthyem, isha e brishtë dhe mënjanëse. Nuk më interesonte më të shkruarit. As ushqimet, bisedat ose argëtimet. Isha armiqësore me vizitorët. Thjesht doja të mbuloja kokën me batanije dhe të flija gjatë gjithë ditës. Çka edhe e bëja në pjesën më të madhe të kohës. Sigurisht, më në fund, dola nga shtrati dhe nisa t'i kthehesha ngadalë rutinës së përditshme, me të cilën nënkuptoj gjërat kryesore që i duhen një njeriu për të mbetur funksionalisht dhe minimalisht civil. Por ndihesha e mpakur. Si të kisha lënë në Indi diçka me rëndësi jetike për mua.

EB: A ishte i shqetësuar babai?

NV: Përkundrazi. Ai mori zemër. Ai mendonte se takimi me vdekjen i kishte larguar më në fund prej meje papjekurinë dhe impulsivitetin. Ai nuk e kuptonte që unë ndihesha e humbur. Kam lexuar, zoti Bustule, se, po të përpiu orteku e të mbulon gjithë ajo borë, nuk mund të thuash se nga i bie të jetë lart e nga poshtë. Ti do që të gërmosh e të dalësh jashtë, por mund të zgjedhësh drejtimin e gabuar dhe mund të rrëmihësh me duart e tua varrin tënd. Kështu ndihesha unë: e çorientuar, në gjendje pezullie nga çoroditja, pa busull. Në një gjendje depresive, aq sa s'mund të përshkruhet. Dhe në një gjendje të tillë je e hapur ndaj gjërave të këqija. Që ka shumë gjasa të jetë arsyeja pse thashë "po" një vit më vonë, më 1949, kur Sulejman Vahdati i kërkoi tim eti dorën time.

EB: Ti ishe njëzet vjeç.

NV: Ai nuk ishte. - Ajo më ofron një sanduiç tjetër, të cilin unë e refuzoj, dhe një filxhan me kafe, që e pranoj. Ajo vë ujin për të zier e më pyet në jam i martuar. I them se jo dhe se dyshoj nëse do të jem ndonjëherë. Ajo më sheh që përmbi supin e saj, m'i ngul sytë për disa çaste e mandej buzëqesh. - Ah! Zakonisht unë e kuptoj këtë.

EB: Surprizë!

NV: Mbase e kam nga kontuzioni. - Dhe tregon me dorë shaminë në kokë. - Nuk e kam vënë për modë. Ca ditë më parë rrëshqita, rashë dhe çava ballin. E prapë... duhej ta kisha kuptuar. E kam fjalën për ty. Nga përvoja ime, burrat që i kuptojnë gratë aq mirë sa ç'i kuptoni ju, nuk duan të kenë të bëjnë aspak me to. - Ajo më zgjat filxhanin e kafes, ndez një cigare dhe ulet. - Unë kam teorinë time për martesën, zoti Bustule. Unë them se pothuajse gjithmonë e kupton që dy javët e para nëse do funksionojnë gjërat apo jo. Është e habitshme se si shumica e njerëzve mbeten të ngërthyer për vite të tëra, madje për dhjetëvjetësha të tërë, në një gjendje vetëshkatërrimi të zgjatur e të ndërsjellë dhe me shpresa të rreme, ndërkohë që përgjigjen, në fakt, e kanë marrë që gjatë atyre dy javëve të para. Mua për vete as nuk m'u desh aq shumë kohë. Im shoq ishte një burrë i ndershëm. Por ishte tej mase serioz, shumë monoton dhe nuk i interesonte asgjë. Dhe... kishte rënë në dashuri me shoferin.

EB: Ah! Ky mund të ketë qenë një shok i vërtetë.

NV: E po, siç thuhet në të tilla raste, gjërat u trashën shumë. - Ajo buzëqesh paksa me trishtim. - Mua më vinte keq për të. Ai nuk mund të kishte zgjedhur një kohë ose një vend më të gabuar për të lindur me atë prirje që kishte. Vdiq nga iskemia e trurit kur vajza jonë ishte vetëm gjashtë vjeç. Në ato çaste unë mund të kisha qëndruar në Kabul. Shtëpia dhe pasuria e tim shoqi ishin të miat tashmë. Aty ishte edhe një kopshtar dhe shoferi që të përmenda. Do të kishte qenë një jetë shumë e rehatshme. Por unë bëra gati valixhet dhe ikëm prej aty, unë me Pahrin, dhe erdhëm në Francë.

EB: Çka, siç e thatë edhe më parë, e bëtë për të mirën e saj.

NV: Çdo gjë që kam bërë, zoti Bustule, e kam bërë për time bijë. Jo se ajo e kupton ose e vlerëson, të paktën

jo në të gjithë përmasën e asaj që kam bërë për të. Ime bijë mund të jetë aq mospërfillëse, sa të merr frymën. Sikur ta kishte ditur se ç'jetë e priste atje, nëse unë nuk do të merrja atë vendim...

EB: A është zhgënjim për ju vajza juaj?

NV: Zoti Bustule, unë kam arritur në bindjen se ajo është ndëshkimi im.

Një ditë të vitit 1975, Pahri kthehet në shtëpi dhe gjen një pako të vogël mbi shtrat. Ka kaluar një vit qysh prej ditës kur e nxori të ëmën nga urgjenca e spitalit dhe nëntë muaj që kur është ndarë me Zhyljenin. Pahri tani jeton me një studente të infermierisë që quhet Zahia, një vajzë e re algjeriane, me flokë kaçurrelë bojëkafë dhe sy jeshilë. Ajo është një vajzë kompetente, gjithmonë e gjindshme në një mënyrë dashamirëse e të qetë dhe po jetojnë në të njëjtën shtëpi pa kurrfarë problemi, edhe pse tani Zahia është fejuar me të dashurin e saj, Samiun, dhe ka shkuar të qëndrojë në shtëpinë e tij në fund të semestrit.

Pranë pakos gjendet një pusullë e palosur: " Kjo erdhi për ty. Unë po shkoj të fle në shtëpinë e Samiut. Shihemi nesër. *Je t'embrasse*[1]. Zahia".

Pahri e hap pakon. Brenda gjendet një revistë dhe ngjitur mbi të një tjetër pusullë, këtë herë e shkruar me një shkrim dore të njohur, thuajse femëror e dinjitoz: "Këtë ia kishin dërguar Nilës, pastaj çiftit që jeton tani në shtëpinë e vjetër të Koletës dhe së fundmi përfundoi tek unë. Duhet t'u japësh njerëzve adresën më të fundit postare. Merre parasysh rrezikun, përpara se ta lexosh. Druaj se askush prej nesh nuk di të thotë lamtumirë siç duhet. Zhyljeni."

Pahri e hedh revistën mbi shtrat dhe përgatit një sallatë

---

1) Të përqafoj (*shën .i përkth.*).

me spinaq dhe pak kuskus[1]. Ajo vesh pizhamet dhe ha duke parë televizor: një ekran i vogël bardhezi. Pa e pasur shumë mendjen, i kap syri imazhet e refugjatëve vietnamezo-jugorë që mbërrijnë me avion në Guam. I shkon mendja te Koleta, që pati dalë për të protestuar në rrugë edhe kundër luftës së Shteteve të Bashkuara në Vietnam; Koleta, që kishte sjellë një buqetë me lule shpate dhe margarita te varri i Mamasë, që e kishte përqafuar e puthur fort Pahrin dhe kishte recituar një nga poezitë e Mamasë në podium.

Zhyljeni nuk kishte ardhur në varrim. Ai e kishte marrë në telefon dhe i kishte thënë, me zë të dobët, se nuk i pëlqenin varrimet, se i dukeshin depresionuese.

- E kujt nuk i duken? - i kishte thënë Pahri.

- Them se është më mirë të rri larg.

- Bëj si të duash, - ia kishte kthyer Pahri në telefon, ndërsa me vete kishte menduar: "Por mosardhja nuk ka për të të shfajësuar. Ashtu siç nuk do të më shfajësojë vajtja mua. Sa budallenj që ishim. Sa mendjelehtë. Oh, o Zot!" Pahri e kishte mbyllur telefonin duke e ditur se, që këtej e tutje, herë pas here, ndjenja e fajit, brejtja e tmerrshme e ndërgjegjes, do ta kapnin të pambrojtur e do ta godisnin dhe kjo do t'i therte deri në kockë. Tani e tutje, në ditët që do të vinin, ajo me këtë ndjenjë do të luftonte. Kjo do të ishte rubineti i prishur në thellësi të mendjes.

Ajo bën një banjë pas darkës dhe rishikon disa shënime për provimin e radhës. Sheh përsëri televizor, lan e than enët, lan dyshemenë e kuzhinës. Por asgjë nuk ka vlerë. Nuk e humbet dot mendjen. Revista gjendet ende mbi shtrat: duket sikur po e thërret me një mërmërimë monotone të pandërprerë.

Pak më vonë, ajo vesh një pallto me kapuç mbi pizhamet dhe del për të ecur më këmbë në *Boulevard de la Chapelle*, që gjendet pak më tej, në jug të shtëpisë së saj. Ajri është i freskët

---

1) Gatim afrikano-verior: një lloj makaronash të vogla, të gatuara me mish e perime (*shën. i përkth.*).

dhe pikat e shiut bien mbi asfalt e në xhamat e vitrinave, por me atë nervozizëm që ndien tani, ajo e ka të pamundur të qëndrojë në shtëpi. Pahri ka nevojë për ajrin e ftohtë e të lagësht, për mjedise të hapura.

Kur ishte e vogël - Pahrit i kujtohet shumë mirë - ajo nuk reshtte së pyeturi: *A kam unë kushërinj në Kabul, mami? A kam halla dhe xhaxhallarë? Po gjyshër, a kam unë gjysh e gjyshe? Pse nuk vijnë asnjëherë për vizitë ata? A mund t'u shkruajmë letra? Të lutem, a mund të shkojmë t'i takojmë?*

Por shumica e pyetjeve ishin për të atin: *Çfarë ngjyre pëlqente ai më shumë, mami? Mami, më thuaj, a notonte mirë ai? A dinte shumë gazmore?* Asaj i kujtohet se si po e ndiqte ai një herë nëpër dhomë duke luajtur. Si e rrotullonte në tapet dhe si ia kilikoste barkun dhe shputat e këmbëve. I kujtohet aroma e kolonjës së tij dhe shkëlqimi i ballit të lartë, gishtat e tij të gjatë; kopsat prej lapisi në formë ovale të manshetave dhe pantallonat e kostumit të hekurosura me vizë. Dhe tani sheh edhe pluhurin që ngrinin bashkë mbi tapet.

Ajo çka kishte kërkuar gjithmonë Pahri nga e ëma, ishte ngjitësi që do t'i bënte bashkë pjesët e shkëputura e të turbullta të kujtimeve të saj e do t'i kthente ato në një lloj rrëfimi me lidhje logjike. Por Mamaja kurrë nuk i tregonte shumë. Ajo gjithmonë i fshihte hollësitë e jetës së vet, të jetës së tyre në Kabul. Dukej qartë që ajo mundohej ta mbante Pahrin larg nga e kaluara e tyre e përbashkët, kështu që edhe Pahri më në fund i rreshti pyetjet.

Dhe tani po dilte që Mamaja i kishte treguar shumë më tepër gazetarit të kësaj reviste, këtij Etjen Bustulesë, sesa i kishte treguar ndonjëherë vajzës së saj për veten dhe jetën e saj.

Apo nuk i kishte treguar?

Pahri e ka lexuar artikullin edhe tri herë të tjera. Dhe tani nuk di ç'të mendojë, nuk di ç'të besojë. Shumë gjëra aty duken si të rreme. Pjesë të tëra duken si parodi. Një melodramë bukurish ogurzeza të mbërthyera me vargonj, romançash të

rrënuara e shtypjesh të gjithanshme, të gjitha në një mënyrë kaq prekëse, kaq frymëmekëse.

Pahri drejtohet për në lagjen "Pigal", me hapa të nxituar, me duart futur në xhepat e palltos. Qielli po errësohet me të shpejtë dhe shiu që i bie mbi fytyrë, po bëhet më i dendur e më këmbëngulës: ai troket fort në xhama, vesh ndriçuesit e rrugës. Pahrit nuk i kujtohet ta ketë takuar ndonjëherë atë burrë, gjyshin e saj, të atin e Mamasë. Ajo ka parë vetëm fotografinë e tij në tryezën e saj të punës, por nuk beson se ai është ai njeriu i lig me mustaqe të përdredhura që ka përshkruar mamaja. Pahrit i duket se arrin të lexojë midis rreshtave të kësaj historie. Ajo ka krijuar idenë e vet. Sipas variantit të saj, ai është një burrë që me të drejtë shqetësohet për mirëqenien e vajzës së tij thellësisht të palumtur dhe vetëshkatërruese, e cila nuk është në gjendje të vërë rregull në jetën e vet. Ai është një burrë që vuan poshtërimin dhe sulmet e përsëritura mbi dinjitetin e vet dhe përsëri është në anën e së bijës, e çon në Indi, kur ajo sëmuret, qëndron me të për gjashtë javë. Dhe, në atë kohë, ç'sëmundje kishte vërtet Mamaja? Çfarë i kishin bërë mjekët në Indi? Pahri vret mendjen, kujton vrajën vertikale në barkun e Mamasë: Pahri ka pyetur Zahian dhe ajo i ka thënë që prerjet e operacioneve cezariane bëhen horizontalisht.

Dhe pastaj, ajo që i kishte thënë Mamaja intervistuesit për burrin e saj, për babanë e Pahrit. Të ishte shpifje? Apo ishte e vërtetë që ai dashuronte Nabin, shoferin? Dhe, nëse ishte e vërtetë, pse duhej ta nxirrte këtë të fshehtë tani, pas kaq shumë kohësh, nëse jo për t'i turbulluar të tjerët, për t'i poshtëruar e, mbase, edhe për t'i lënduar? Dhe nëse ishte vërtet kështu, kë?

Vetë Pahri nuk habitet aspak nga trajtimi i hidhur që kishte rezervuar Mamaja për të, sidomos pas historisë me Zhyljenin, dhe as nuk i vjen si surprizë përshkrimi përzgjedhës, i sterilizuar, që i ka bërë amësisë së saj.

Gënjeshtra?

Por prapë...

Mamaja ishte poete e talentuar. Pahri kishte lexuar gjithë ç'kishte shkruar ajo në frëngjisht, si edhe çdo poezi që kishte përkthyer nga gjuha farsi. Bukuria dhe fuqia e shkrimeve të saj ishin të pamohueshme. Por, nëse përshkrimi që i kishte bërë Mamaja jetës së vet në intervistë ishe i rremë, atëherë ku e kishin burimin gjithë ato imazhe që gjendeshin në veprën e saj? Ku e merrte frymëzimin për të gjetur ato fjalë që ishin të ndershme, dashamirëse, të ashpra e të trishtuara? A mos ndoshta ajo ishte thjesht një iluzioniste e talentuar? Një magjistare, me një penë në vend të shkopit magjik, e aftë që ta prekte thellë lexuesin, duke shpalosur emocione që vetë nuk i kishte provuar kurrë? A ishte vërtet e mundur kjo?

Pahri nuk e di këtë: nuk ka si ta dijë. Por mbase ky ka qenë synimi i vërtetë i Mamasë: ta tronditë tokën nën këmbët e Pahrit. Me qëllim që t'ia prishë drejtpeshimin, ta bëjë t'i merren këmbët; ta shndërrojë Pahrin në një njeri të huaj për veten e vet, t'i injektojë peshën e dyshimit në mendje, në gjithçka që Pahri besonte se dinte për jetën e vet. Që ta bëjë të ndihet e humbur, si të ishte duke u endur në shkretëtirë nëpër natë, e rrethuar nga errësira dhe e panjohura, por dhe nga e vërteta e pakapshme, që xixëllon në errësirë si një dritë e vogël e vetmuar, gjithmonë në lëvizje, duke iu larguar gjithmonë e më shumë.

Mbase, mendon Pahri, kjo është hakmarrja e Mamasë. Jo vetëm për Zhyljenin, por edhe për zhgënjimin që i ka sjellë gjithmonë Pahri; që presupozohej t'i jepte fund pijes, burrave, viteve të shkapërderdhura në një kërkim të dëshpëruar të lumturisë, të gjitha rrugicave qorre të shkelura e të braktisura. Çdo vërshimi zhgënjimi që e linte Mamanë më të rrënuar, më të copëtuar dhe ia bënte lumturinë edhe më iluzore. "Çfarë isha unë, Mama? - mendon Pahri. - Çfarë pritej të isha unë, ndërsa rritesha në barkun tënd, gjithmonë nëse jam ngjizur vërtet në barkun tënd? Njëfarë shprese? Një biletë e blerë për

t'i hipur trenit që të nxjerr ngą errësira? Një kapak për atë vrimë që ke mbartur ti në zemër? Nëse është kështu, atëherë unë nuk qeshë e mjaftueshme. Unë nuk qeshë aspak e mjaftueshme. Nuk qeshë aspak balsam për dhembjen tënde, por vetëm një tjetër rrugicë qorre, një tjetër ngarkesë, dhe ti duhet ta kesh kuptuar këtë qysh herët. Duhet ta kesh vënë re këtë. Po ç'mund të bëja unë? Unë isha nga ai mall që blihet e nuk kthehet më."

Mbase ajo intervistë ishte e qeshura e fundit e Mamasë.

Pahri ndalet nën tendën e një birrarie, që të mbrohet nga shiu, pak blloqe në perëndim të spitalit ku Zahia po trajnohet për t'u bërë ndihmësmjeke. Ndez një cigare. Mendon se duhet ta marrë Koletën në telefon. Ato kanë folur vetëm një a dy herë qysh prej ditës së varrimit. Kur ishin të vogla, ato përtypnin çamçakëzë, derisa nisnin t'u dhembnin nofullat dhe pastaj uleshin përpara pasqyrës së Mamasë, ia krihnin flokët njëra-tjetrës e i kapnin me kapëse. Në këmbësoren përkarshi i kap syri një grua të moshuar, të veshur me një mushama plastike, që ecën nëpër shi e ndjekur pas nga qeni i saj i vogël *terrier* me ngjyrë të errët. Jo për herë të parë, një hije e patrajtë shkëputet nga mjegulla e kujtimeve të Pahrit dhe merr formën e një qeni. Jo një kukull e vogël si ajo e gruas, por një specie e madhe, e pistë, me bisht dhe veshë të dëmtuar. Pahri nuk është e sigurt në është ky një kujtim ose fantazma e një kujtimi, ose asnjëra nga të dyja. Ajo e kishte pyetur një herë Mamanë nëse kishin pasur ndonjëherë qen në Kabul, dhe Mamaja i ishte përgjigjur: "Ti e di që mua nuk më pëlqejnë qentë. Ata nuk kanë respekt për veten. Ti i përzë, kurse ata prapë të duan. Është shumë depresionuese." - Por Mamaja kishte thënë edhe diçka tjetër: "Unë nuk e shoh veten time tek ti. Unë nuk e di kush je ti".

Pahri e fik cigaren. Dhe vendos të marrë në telefon Koletën. Ta lënë që të takohen diku për çaj. Ta shohë si është. Me kë është tani. Të dalin për të blerë, ashtu siç bënin dikur.

Të shohë nëse është ende e gatshme shoqja e saj e fëmijërisë për të shkuar në Afganistan.

Pahri takohet me Koletën në një kafene popullore të tipit maroken, me perde ngjyrëvjollcë dhe jastëkë portokallí ngado, ndërsa në skenë ka dalë një muzikant me flokët kaçurrelë që po i bie një *odi*[1]. Koleta nuk ka ardhur vetëm. E shoqëron një djalë i ri. Ai quhet Erik Lakomb. Jep lëndën e dramës te klasat e shtata e të teta në një liceu në lagjen 18. Ai i thotë Pahrit se janë takuar edhe një herë tjetër, disa vjet më parë, në një protestë studentore kundër gjuetisë së fokave. Në fillim Pahrit nuk i kujtohet, pastaj i vjen ndër mend që ai ishte njeriu me të cilin ishte zemëruar aq shumë Koleta për organizimin e dobët, dhe i kishte rënë me grusht në kraharor. Ata ulen shesh në dysheme, mbi ca jastëkë të mëdhenj ngjyrë mangoje dhe porositin pije alkolike. Në fillim Pahrit i krijohet përshtypja se Koleta dhe Eriku janë të lidhur bashkë, por Koleta vazhdon ta lavdërojë Erikun dhe shumë shpejt Pahri e kupton se ajo e ka sjellë këtu për të. Ndjenja e nervozizmit që e pushton zakonisht në të tilla situata, pasqyrohet te vetë shqetësimi i Erikut dhe, madje, edhe lehtësohet prej tij. Pahrit i duket e habitshme, por edhe argëtuese njëherazi, mënyra se si skuqet ai vazhdimisht e si tund kokën në shenjë ndjese nga sikleti. Ndërsa hanë bukë me sallatë me ullinj të shtypur, Pahri i hedh vjedhurazi një vështrim. Nuk mund t'i thuash i pashëm. Flokët i ka të gjatë e të yndyrshëm, të lidhur me llastik në zverk. Ka duar të vogla e lëkurë të zbehtë. Hundën e ka shumë të ngushtë, ballin shumë të dalë përpara, mjekër thuajse nuk ka fare, por ka një buzëqeshje që ia ndrit sytë dhe një zakon për ta përfunduar çdo fjali duke buzëqeshur, si të jetë duke i vënë

1) Lloj vegle muzikore arabe, e ngjashme me lahutën ose mandolinën (*shën. i përkth.*).

një shenjë pikësimi lumturie. Dhe, ndonëse fytyra e tij nuk e magjeps Pahrin ashtu si ajo e Zhyljenit, asaj i duket një fytyrë shumë më dashamirëse dhe, siç ka për ta mësuar shumë shpejt, një ambasador i jashtëm për vëmendjen, vetëpërmbajtjen e qetë dhe mirësjelljen e durueshme që gjendet brenda Erikut.

Ata martohen në një ditë të ftohtë pranvere të vitit 1977, disa muaj pasi Xhimi Karter zgjidhet president i Amerikës. Kundër dëshirës së prindërve të tij, Eriku këmbëngul që të bëhet vetëm një ceremoni e vogël, ku të jenë të pranishëm vetëm ata të dy dhe Koleta si dëshmitare. Ai thotë se dasmat e zakonshme janë një ekstravagancë që ai nuk e përballon dot. I ati, që është bankier, i ofron t'i mbulojë shpenzimet. Tek e fundit, Eriku është fëmija i tij i vetëm. Ai ia ofron fillimisht si dhuratë e mandej si hua. Por Eriku nuk e pranon. Dhe, megjithëse nuk e pohon kurrë me zë të lartë, Pahri e di që ai kërkon ta shpëtojë nga një ceremoni e bezdisshme, gjatë së cilës ajo do të jetë vetëm fare, pa asnjë të afërm që të mund të ulet në karrige, pa asnjë njeri për ta shoqëruar në altar ose për të derdhur një lot gëzimi për të.

Kur ajo i flet atij për planet e veta për të shkuar në Afganistan, ai e kupton në njëfarë mënyre që Pahri beson se Zhyljeni s'do ta kishte kuptuar kurrë. Dhe po ashtu në njëfarë mënyre që ajo nuk ia ka pranuar kurrë haptazi vetes këtë.

- Ti beson se je fëmijë i birësuar, - thotë ai.

- A do të vish me mua?

Ata vendosin të shkojnë atje në verë, kur shkolla mbyllet për Erikun dhe vetë Pahri mund të bëjë një pushim të shkurtër në studimet për doktoraturën. Eriku i regjistron të dy në një kurs të gjuhës farsi, me një mësues që e ka njohur me ndihmën e nënës së një nxënësit të tij. Pahri e gjen shpesh në divan me kufje në vesh, me kasetofon mbi gjoks, me sy të mbyllur për t'u përqendruar më mirë, duke përsëritur mbyturazi e me theks të rëndë "Falemnderit", "Tungjatjeta" dhe "Si jeni?" në gjuhën farsi.

Pak javë përpara verës, tamam atëherë kur Eriku nis të kontrollojë agjencitë e udhëtimit për të gjetur një avion, Pahri zbulon se është shtatzënë.

- Mund të shkojmë, - thotë Eriku. - Ne përsëri mund të shkojmë.

Por është Pahri ajo që vendos se është më mirë të mos nisen.

- Do të ishte një veprim i papërgjegjshëm, - thotë ajo.

Ata jetojnë në një studio me nxehtësi problematike, tuba që rrjedhin, pa ajër të kondicionuar dhe me mobilie të vjetra.

- Kjo nuk është shtëpi për foshnja, - thotë ajo.

Eriku gjen një punë si mësues pianoje, të cilën e kishte mësuar përpara se t'i përkushtohej plotësisht teatrit, dhe pak përpara se të lindë Izabela, ajo Izabelë e ëmbël, me lëkurë të zbehtë, me sytë në ngjyrën e sheqerit të djegur, ata shpërngulen në një apartament me dy dhoma e një kuzhinë jo shumë larg Kopshtit të Luksemburgut, edhe me ndihmën financiare të të atit të Erikut, të cilën ata e kanë pranuar këtë herë, me kushtin që të jetë hua.

Pahri bën tre muaj pushim. Ajo e kalon të gjithë ditën e saj me Izabelën. I duket sikur fluturon pranë vogëlushes. Dhe ndien sikur gjithçka përreth vezullon kur Izabela kthen kokën drejt saj. Kur Eriku kthehet nga liceu në mbrëmje, gjëja e parë fare është që lë çantën e pallton te dera, vrapon të ulet në divan dhe zgjat duart e lëviz gishtat drejt saj:

- Ma jep mua, Pahri. Ma jep mua.

Dhe, ndërsa ajo e vë Izabelën në kraharorin e tij, Pahri nis t'i tregojë të gjitha vogëlimat e ditës: sa qumësht ka pirë Izabela, sa herë ka fjetur, çfarë kanë parë bashkë në televizor, ç'lojëra gjallëruese kanë luajtur, zhurmat e reja që ka nisur të bëjë ajo. Dhe Eriku nuk lodhet kurrë së dëgjuari të gjitha këto.

Ata e kanë shtyrë nisjen për në Afganistan. E vërteta është se Pahri nuk e ndien më atë nevojën shpuese për të gjetur përgjigjet dhe rrënjët e veta. Pikërisht sepse Eriku i

ofron ngushëllim dhe mbështetje. Por edhe prej Izabelës, që e ka fortësuar sërish tokën nën këmbët e Pahrit, edhe pse aty ka ende hapësira të zbrazëta dhe pika të vdekura, me qindra pyetje pa përgjigje. Të gjitha gjërat që Mamaja nuk i zbuloi kurrë, janë ende aty. Por Pahri thjesht nuk është më e etur për përgjigjet, ashtu siç ishte dikur.

Dhe ajo ndjenja e vjetër që ka pasur gjithmonë: se dikush ose diçka mungon në jetën e saj, tani është errësuar. Ende i kthehet herë pas here, ndonjëherë e fuqishme dhe e kap në befasi, por shumë më rrallë se më parë. Pahri kurrë nuk ka qenë kaq e kënaqur në jetën e vet, kurrë nuk është ndier kaq e lumtur.

Në vitin 1981, kur Izabela mbush tre vjeç, Pahri, shtatzënë disamuajshe me Alenin, duhet të shkojë në një konferencë në Mynih. Ajo do të paraqitë një punim në bashkautorësi për përdorimin e formave modulare jashtë teorisë së numrave, në mënyrë më specifike në tipologjinë dhe teorinë e fizikës. Paraqitja pritet mirë dhe pas konferencës, tok me disa shkencëtarë të tjerë, Pahri shkon në një lokal të zhurmshëm për të pirë birrë e për të ngrënë *Brezel* dhe *Weiswurst*[1]. Ajo kthehet në dhomën e hotelit përpara mesnatës dhe bie në shtrat pa i ndërruar rrobat e pa e larë fytyrën. Në orën 2:30 të mëngjesit e zgjon zilja e telefonit. Është Eriku, nga Parisi.

- Mora për Izabelën, - thotë ai. - Ka temperaturë. Mishrat e dhëmbëve iu frynë papritur dhe i janë skuqur. Sa t'ia prekësh, del gjak. Nuk arrij t'ia shoh dhëmbët, Pahri, dhe nuk di ç'të bëj. Lexova diku se mund të jetë...

Ajo do që ai të heshtë. Do që t'i thotë që ta qepë, që ajo nuk mund ta durojë dot një gjë të tillë, por tashmë është shumë vonë. Ajo dëgjon fjalët *leucemi e fëmijërisë*, ose mbase ai ka thënë *limfomë*, po ku qëndron dallimi, gjithsesi? Pahri ulet bu-

---

1) Pjatë tradicionale bavareze: biskota me kripë dhe salsiçe të bardha me mish derri *(shën. i përkth.)*.

zë shtratit dhe qëndron aty si gur, me kokën që po i pëlcet e lëkurën të larë në djersë. Dhe ndihet e tërbuar me Erikun, që ia ka ngulur në mendje këtë gjë kaq të tmerrshme mu në mes të natës, kur ajo është shtatëqind kilometra larg Parisit dhe nuk mund të bëjë asgjë. Por është e tërbuar edhe me veten, me budallallëkun e vet që është hapur në këtë mënyrë ndaj një jete gjithë shqetësime e angështi. Ishte çmenduri. Ishte një budallallëk spektakolar dhe besim i pabazë, përkundër të gjitha mundësive, se një botë që nuk e kontrollon dot, nuk do të të marrë gjënë e vetme që ti nuk mund ta përballosh ta humbësh. Besimi se bota nuk do të të shkatërrojë. "Këtë nuk e përballoj dot! - thotë ajo me zë të ulët. - Këtë nuk e përballoj dot!" Në këto çaste mendja e saj nuk gjen dot një gjë më të çmendur e më jashtë arsyes, sesa vendimi për t'u bërë prind.

Dhe një pjesë e saj - "O zot, më ndihmo! - mendon ajo. - O zot, më fal për këtë!" - një pjesë e saj ndihet e tërbuar edhe me Izabelën që po ia bën këtë, që po e bën të vuajë në këtë mënyrë.

- Erik. Erik! *Ecoute moi*[1]. Do të të marr unë në telefon. Më duhet ta mbyll tani.

Ajo zbraz çantën mbi shtrat dhe gjen një bllok të vogël ngjyrë gështenje, ku ka shënuar numrat e telefonit. Merr në telefon Lionin. Koleta jeton në Lion tok me të shoqin, Didierin, dhe ka hapur atje një agjenci të vogël udhëtimesh. Didieri studion për mjekësi. Është Didieri që e ngre telefonin.

- Pahri, ti e di që unë po studioj për psikiatri, apo jo? - i thotë ai.

- E di. E di. Thjesht mendova...

Ai i bën disa pyetje. A ka rënë në peshë Izabela? A djersin natën, a ka njolla të pazakonta në trup, a ndihet e lodhur, a ka temperaturë kronike?

Më në fund ai i thotë se Eriku duhet ta çojë te mjeku të nesërmen në mëngjes. Por, nëse i kujtohet mirë nga ajo ç'ka

---

1) Më dëgjo *(shën. i përkth.)*.

mësuar gjatë shkollës së mjekësisë së përgjithshme, i duket si gingivostomatit[1] akut.

Pahri e shtrëngon telefonin kaq fort në dorë, saqë nis t'i dhembë kyçi.

- Të lutem, - thotë ajo me durim, - Didier!

- Ah, më fal! Dua të them që këto më duken si shenjat e para të herpesit.

- Herpes?

Dhe pastaj ai shton fjalën më të lumtur që ka dëgjuar ndonjëherë Pahri në jetën e vet.

- Them se do të jetë për mrekulli.

Pahri e ka takuar Didierin vetëm dy herë, një herë përpara dhe një herë pasi u martua me Koletën. Por në atë çast e do vërtet, e do me gjithë shpirt. Dhe ia thotë edhe atij, duke qarë në telefon. I thotë se e do fort, disa herë, dhe ai qesh e i uron natën e mirë. Pahri merr në telefon Erikun, i cili do ta çojë të nesërmen në mëngjes Izabelën te doktor Perrini. Dhe pas gjithë kësaj, me veshët që i kumbojnë, ajo shtrihet në shtrat dhe sheh rrezet e dritave të rrugës, që hyjnë në dhomë përmes grilave prej druri në ngjyrë jeshile të errët. I kujtohet kur ishte shtruar vetë në spital me pneumoni, kur qe ende tetë vjeç. Mamaja nuk kishte pranuar të kthehej në shtëpi, por kishte ngulur këmbë që të flinte në karrigen pranë shtratit të saj. Dhe tani ajo ndien një afërsi të re, krejt të papritur, të vonuar, me nënën e vet. Ajo e ka ndier mungesën e saj disa herë gjatë këtyre viteve të fundit: Në dasmën e saj. Kur lindi Izabela. Dhe në miliona çaste të rëndomta. Por kurrë nuk ia ka ndier mungesën kaq shumë sa në këtë natë të tmerrshme, në këtë dhomë hoteli në Mynih.

Të nesërmen, në Paris, ajo i thotë Erikut se nuk duhet të bëjnë më fëmijë, pasi të ketë lindur Aleni. Kjo vetëm ua shton mundësitë që t'u thyhet zemra.

Në vitin 1985, kur Izabela është shtatë vjeç, Aleni katër

---

1) Sëmundje e mishrave të dhëmbëve (*shën. i përkth.*).

dhe Tierri i vogël dy vjeç, Pahri pranon që të japë mësim në një universitet me famë në Paris. Për pak kohë ajo shndërrohet në epiqendrën e agresivitetit dhe të shpërfilljes akademike, që nuk është një gjë aspak e habitshme, sepse, në moshën tridhjetegjashtëvjeçare, ajo është e vetmja pedagoge e re në një departament ku ka vetëm dy femra. Ajo përshtatet me këtë në një mënyrë që Mamaja nuk do të kishte mundur ose nuk do ta kishte bërë dot. Asaj nuk i rritet mendja dhe as nuk entuziazmohet. Ajo nuk përfshihet në asnjë debat të ashpër e nuk ankohet për asgjë. Gjithmonë do të ketë njerëz skeptikë ndaj saj. Por në kohën e rënies së Murit të Berlinit, kanë rënë njëherazi edhe të gjitha muret në jetën e saj akademike dhe ajo është ngjitur ngadalë mbi shumicën e kolegëve të saj, nëpërmjet natyrës sociale çarmatosëse dhe ndjeshmërisë së vet. Ajo bën miq në departamentin e saj, madje edhe tek të tjerat, merr pjesë në të gjitha veprimtaritë e universitetit, në ato për bamirësi, në koktejet e herëpashershme a darkat e punës. Edhe Eriku e shoqëron nëpër të tilla mbrëmje. Si një shaka personale, ai këmbëngul që të vërë gjithmonë të njëjtën kravatë prej leshi dhe xhaketën prej kadifeje me pafta te bërrylat. Ai sillet nëpër sallën e mbushur plot, duke shijuar gatime të ndryshme, duke pirë verë, me një pamje të magjepsur e gjithë humor dhe herë pas here Pahrit i duhet ta largojë nga një ndonjë grup matematikanësh përpara se ai të shprehë opinionin e vet për hapësirat tripërmasore dhe përafrimet diofantine.

Si përherë, në të tilla festa, është e pashmangshme që dikush të mos e pyesë Pahrin për të rejat e fundit në Afganistan. Një mbrëmje, një profesor paksa i pirë, i quajtur Shatëlar, kërkon të dijë mendimin e Pahrit për atë që mund të ndodhë në Afganistan, pasi të largohen sovjetikët.

- A mendoni se njerëzit e vendit tuaj do të gjejnë paqe, *madamë* profesoreshë?

- Nuk e di, - i përgjigjet ajo. - Të them të drejtën, unë vetëm emrin kam nga Afganistani.

- *Non mais, quand-même*[1], - thotë ai. - Megjithatë, intuita mund t'ju thotë diçka.

Ajo buzëqesh dhe përpiqet të mos e tregojë se sa e bezdisin të tilla pyetje.

- Unë thjesht di ato që lexoj në "*Le Monde*". Njësoj si ju.

- Por ju jeni rritur atje, apo jo?

- Kam qenë shumë e vogël, kur jam larguar andej. A e keni parë burrin tim?... Është ai me pafta te bërrylat.

Ajo thotë të vërtetën. Ajo lexon gazetat, dëgjon lajmet për luftën: Perëndimi po armatos muxhahedinët, por Afganistani ka përfunduar tani në skutat e thella të mendjes së saj. Ajo ka shumë gjëra me se të merret në shtëpi, që tani është një shtëpi e këndshme me katër dhoma gjumi në Gyijankur, rreth njëzet kilometra larg qendrës së Parisit. Ata jetojnë në një kodër të vogël pranë një parku me rrugina për të shëtitur. Eriku tani edhe shkruan drama, përveç që jep mësim. Njëra prej dramave të tij, një farsë e lehtë politike, do të vihet në skenë në vjeshtë në një teatër të vogël pranë *Hôtel de Ville* në Paris dhe ai ka nënshkruar ndërkohë një kontratë për të shkruar një tjetër dramë.

Izabela është rritur dhe është bërë një adoleshente e qetë, e zgjuar dhe e gjindshme. Ajo mban ditar dhe lexon një roman në javë. I pëlqen Shinejd O'Konër. Ka gishta të gjatë e të bukur dhe merr mësime violonçeli. Pas disa javësh do të luajë "*Këngë e trishtuar*" të Çajkovskit në një koncert recital. Në fillim nuk donte që t'i vihej violonçelit, por Pahri mori disa mësime tok me të në shenjë solidariteti. Dhe kjo rezultoi njëherazi e panevojshme dhe e pamundur. E panevojshme, sepse Izabela u lidh ngushtë me atë instrument shumë shpejt, dhe e pamundur, sepse Pahrit i dhembnin gishtat sa herë që luante në violonçel. Ka një vit tashmë që Pahri zgjohet çdo mëngjes me duar e kyçe të rënduara e të ngrira dhe mezi e

---

1) S'ka se si, gjithsesi (*shën. i përkth.*).

merr veten pas gjysmë ore, ndonjëherë pas një ore. Eriku i ka kërkuar vazhdimisht që të shkojë të vizitohet te një mjek dhe tani po ngul këmbë seriozisht.

- Je vetëm dyzet e tre vjeç, Pahri, - thotë ai. - Kjo nuk është normale.

Dhe Pahri më në fund ka lënë një orar për t'u vizituar.

Aleni, djali i dytë, ka sharmin e një njeriu të zgjuar e paksa të pacipë. Ai është i fiksuar pas arteve marciale. Ka lindur para kohe dhe ka shtat të vogël për një djalë njëmbëdhjetëvjeçar, por atë që i mungon në trup, ai e kompenson me vullnetin dhe përkushtimin e vet. Kundërshtarët e tij gjithmonë gënjehen nga silueta e tij e brishtë dhe këmbët e holla. Ata e nënvlerësojnë. Pahri dhe Eriku, ndërsa qëndrojnë shtrirë natën në shtrat, mrekullohen shpesh me vullnetin e tij të jashtëzakonshëm dhe energjinë e pashtershme. Pahri nuk shqetësohet as për Izabelën e as për Alenin.

Është Tierri meraku i saj. Tierri, i cili në një nivel të errët primitiv e ndien se ishte i papritur, i paplanifikuar, i paftuar. Karakteristikë e Tierrit është heshtja lënduese dhe shikimet e picërruara, nervozizmi dhe shpërfillja sa herë që Pahri e pyet për diçka. Ai e sfidon atë pa kurrfarë shkaku dhe pastaj sfidon edhe vetveten. Ndonjëherë, mbi kokën e tij mblidhen retë. Pahri e kupton. Ajo thuajse i sheh ato. Ato mblidhen e ngarkohen derisa më në fund shpërthejnë në një stuhi që ia bën faqet t'i dridhen, këmbët t'i përplasen me tërbim, çka i shtie dridhmat Pahrit, ndërsa Eriku pulit sytë e buzëqesh me dëshpërim. Intuita i thotë Pahrit se Tierri do të jetë për të, ashtu si edhe dhembja e kyçeve, një shqetësim për gjithë jetën.

Ajo shpesh pyet veten se ç'lloj gjysheje do të kishte qenë Mamaja. Në mënyrë të veçantë me Tierrin. Instinktivisht Pahri mendon se Mamaja do t'i kishte ardhur në ndihmë me të. Ajo mbase do të gjente diçka nga vetja tek ai - dhe pse jo biologjike, pa dyshim, Pahri ka kohë që është bindur për këtë.

Fëmijët dinë gjithçka për Mamanë. Veçanërisht Izabela

është shumë kureshtare të mësojë për të. Ajo ka lexuar shumë poezi të saj.

*Do të doja ta kisha njohur, - thotë ajo.*

*Ajo më duket e mrekullueshme.*

*Them se do të ishim bëre mike të mira, ajo dhe unë. Si thua? Do të kishim lexuar të njëjtët libra. Do t'i kisha rënë violonçelit për të.*

- E po, asaj do t'i kishte pëlqyer shumë, - thotë Pahri. - Për këtë jam plotësisht e sigurt.

Pahri nuk u ka thënë gjë fëmijëve për vetëvrasjen e saj. Ata mund ta mësojnë një ditë, me shumë gjasa që do ta mësojnë. Por ama nuk kanë për ta mësuar nga goja e saj. Ajo nuk do të mbjellë në kokën e tyre atë farë të shëmtuar: se një prind është i aftë t'i braktisë fëmijët e vet, se mund t'u thotë "Ju nuk mjaftoni". Pahrit gjithmonë i kanë mjaftuar fëmijët dhe Eriku. Dhe gjithmonë do t'i mjaftojnë.

Në verën e vitit 1994, Pahri tok me Erikun e fëmijët shkojnë në Majorka. Këto pushime ua ka organizuar Koleta, agjencia e së cilës tani po lulëzon plotësisht. Koleta dhe Didieri i takojnë në Majorka dhe ata qëndrojnë atje të gjithë bashkë për dy javë, në një shtëpi me qira në breg të detit. Koleta dhe Didieri nuk kanë fëmijë, jo si fatkeqësi biologjike, por se nuk duan të kenë. Kurse për Pahrin koha është më se e përkryer. Reumatizmin e ka plotësisht nën kontroll. Ajo merr një dozë metotreksati një herë në javë, të cilën organizmi po ia toleron mirë. Për fat të mirë, kohët e fundit nuk e ka pasur të nevojshme të marrë kortizonikë dhe ka shpëtuar nga pagjumësia që i shkaktojnë ata.

- Pa folur pastaj për shtimin në peshë, - i thotë ajo Koletës.

- Për më tepër kur e di që do të dal me rroba banje në Spanjë.

- Ajo qesh. - Ah, gjëra pa vlerë.

Ata i kalojnë ditët duke shëtitur në ishull. Përshkojnë me makinë bregdetin veriperëndimor në këmbët e maleve Serra de Tramuntana dhe ndalen pranë ullishtave e pyjeve të pishave.

Hanë *porcela*[1] dhe *lubina:* levrek i vogël deti i gatuar në mënyrë të shkëlqyer, sikurse edhe *tumbet*: turli me patëllxhanë e kunguj të skuqur. Tierri nuk pranon të hajë asgjë nga këto dhe në çdo restorant Pahri është e detyruar t'i kërkojë kamerierit që atij t'i përgatitin një pjatë me makarona me salcë të thjeshtë domatesh, pa mish e pa djathë. Me kërkesën e Izabelës, së cilës ka nisur t'i pëlqejë opera kohët e fundit, ata shkojnë një natë për të parë një variant të "*Toskës*" të Xhakomo Puçinit. Që t'i mbijetojnë kësaj përvoje të tmerrshme, Pahri dhe Koleta kthejnë me radhë një pagur argjendi me vodkë të lirë. Nga mesi i aktit të dytë, janë që të dyja të dehura e po qeshin si adoleshente me vokalizat e këngëtarit që luan rolin e Skarpias.

Një ditë, Pahri, Koleta, Izabela dhe Tierri marrin drekën me vete dhe shkojnë në plazh. Didieri, Aleni dhe Eriku janë nisur herët në mëngjes, që t'i ngjiten malit përgjatë *Sóller Bay*. Rrugës për në plazh, ato hyjnë në një dyqan për t'i blerë Izabelës një palë rroba banje ku i ka mbetur syri. E, ndërsa hyjnë brenda, Pahri vë re shëmbëlltyrën e vet në xhamin e vitrinës. Normalisht, veçanërisht kohët e fundit, sa herë që del përpara një pasqyre, brenda saj aktivizohet menjëherë një proces automatik që e përgatit për t'u përballur me moshën e vet. Kjo e mbron, e zbut efektin shokues. Por shëmbëlltyra në vitrinën e dyqanit e kap papritur; ajo e gjen me një mekanizëm mbrojtës të paaktivizuar, të pafuqishëm ndaj një realiteti që nuk mund të shpërfillet nga iluzioni. Ajo që sheh Pahri aty, është një mesogrua me një bluzë të gjerë dhe një fund plazhi, që nuk ia mbulon aspak palat e lëkurës mbi kupat e gjunjëve. Dielli ia nxjerr më në pah flokët e thinjur. Dhe, pavarësisht nga rimeli e buzëkuqi, ajo ka tani një fytyrë që kalimtarët do ta shihnin për një çast e pastaj do t'i largonin sytë prej aty, ashtu siç do të bënin me një tabelë rrugore ose me një numër

---

1) Gatim tradicional i ishujve Balearikë, që përmban mëlçi derri, mollë, kumbulla, vezë, bukë, erëza (por mund të përmbajë edhe përbërës të tjerë) dhe mund të gatuhet në shumë forma, por kryesisht shërbehet i pjekur (*shën. i përk.*).

postar. Ky çast është i shkurtër, edhe më i shkurtër se një rrahje pulsi, por mjafton që vetvetja e saj iluzive të vërejë realitetin te gruaja që po sheh te xhami i vitrinës. Është paksa shkatërruese. "Kjo është plakja, - mendon ajo, ndërsa hyn pas Izabelës në dyqan, - këto çaste të rastësishme, të pakëndshme, që të sulmojnë tamam atëherë kur nuk i pret."

Më vonë, kur kthehen në shtëpi nga plazhi, burrat janë kthyer nga ngjitja në mal.

- Babi po plaket, - thotë Aleni. - Që prapa banakut, ku po hedh *Sangrian* në kanë, Eriku shqyen sytë e mbledh supet me naivitet. - M'u duk sikur do të na duhej të të merrnim hopa, babi.

- Prit deri vitin tjetër. Do të vijmë prapë këtu vitin tjetër dhe kam për të të gjëmuar nëpër të gjithë ishullin, *mon pote*[1].

Por ata nuk vijnë më në Majorka. Një javë pasi kthehen në Paris, Eriku pëson një infarkt. I ndodh në punë, ndërsa është duke folur me një punonjës ndriçimi. I mbijeton këtij ataku, por në tri javët në vijim do të pësojë edhe dy të tjerë, i fundit prej të cilëve është fatal. Dhe kështu, në moshën dyzetetetëvjeçare, Pahri e gjen veten njësoj si Mamaja e saj: vejushë.

Një ditë, andej nga fillimi i pranverës së vitit 2010, Pahri merr një telefonatë nga një vend i largët. Telefonata nuk i vjen e papritur. Ajo e ka përgatitur veten për të gjatë gjithë mëngjesit. Përpara se të dëgjojë zilen e telefonit, Pahri sigurohet që të jetë fare vetëm në shtëpi. Kësaj radhe ajo i kërkon Izabelës që të largohet më herët nga shtëpia nga ç'ikën zakonisht. Izabela dhe bashkëshorti i saj, Alberti, jetojnë në veri të Il Sen-Denis, disa blloqe pallatesh më tej se apartamenti me një dhomë e një kuzhinë i Pahrit. Izabela vjen ta shohë Pahrin në mëngjes një

1) Shoku (*shën. i përkth.*).

herë në dy ditë, pasi lë fëmijët në shkollë. Ajo i sjell një bukë-bagetë dhe fruta të freskëta.

Pahri nuk ka përfunduar ende në karrige me rrota, por po e përgatit veten për këtë. Një vit më parë u detyrua të dilte në pension të parakohshëm për shkak të sëmundjes. Megjithatë ajo ende është në gjendje të shkojë vetë në treg e të dalë për të shëtitur çdo ditë. Por janë duart, duart e shëmtuara, me gishtat gjithë gunga, që e lënë në baltë më shpesh, duart që në mot të keq duken sikur kanë copa kristali shpues përreth kyçeve. Pahri vesh doreza kurdoherë që del jashtë shtëpisë, që t'i mbajë duart të ngrohta, por më së shumti ngaqë i vjen turp prej tyre, nga nyejt gjithë gunga, nga gishtat e shtrembër, një shformim që mjeku e quan "qafa e mjellmës", për shkak të gishtit të vogël të dorës së majtë, i shtrembëruar përgjithmonë.

- Ah, gjëra pa vlerë! - i thotë ajo Koletës.

Këtë mëngjes, Izabela i ka sjellë ca fiq, ca sapunë, pastë dhëmbësh dhe një tas me supë gështenjash. Alberti mendon ta përfshijë në menunë e restorantit ku punon si kuzhinier i dytë. Ndërsa zbraz çantat, Izabela i tregon Pahrit për punën e re që ka nisur. Ajo tani kompozon muzikën e emisioneve televizive e të reklamave dhe shpreson që së shpejti të shkruajë edhe muzikën e një filmi. Ajo thotë se shpreson të fitojë të drejtën për të kompozuar muzikën e një seriali televiziv që po xhirohet aktualisht në Madrid.

- Do të shkosh atje? - e pyet Pahri. - Në Madrid?

- Jo. Buxheti është shumë i vogël. Ata nuk m'i mbulojnë dot shpenzimet e udhëtimit.

- Sa keq! Mund të qëndroje në shtëpinë e Alenit.

- Oh, a mund ta imagjinosh, mama? I gjori Alen. Ai nuk ka kohë as të marrë frymë.

Aleni është këshilltar financiar. Ai jeton në një apartament të vogël në Madrid, me gruan dhe katër fëmijët e tyre. Ai i dërgon rregullisht Pahrit me *e-mail* fotografitë dhe videot e shkurtra të fëmijëve.

Pahri e pyet Izabelën nëse ka marrë ndonjë lajm nga Tierri, dhe përgjigjja është jo. Tierri është në Afrikë, në pjesën lindore të Çadit, ku punon në një kamp për refugjatët nga Darfuri. Pahri e di këtë, ngaqë Tierri komunikon herë pas here me Izabelën. Ajo është e vetmja së cilës i flet ai. Dhe kjo është rruga përmes së cilës Pahri i merr vesh në vija të përgjithshme ngjarjet e jetës të së birit: për shembull, që ai ka kaluar ca kohë në Vietnam. Dhe që, për ca kohë, në moshën njëzet-vjeçare, ka qenë i martuar me një vietnameze.

Izabela vë ujin për të zier dhe merr dy filxhanë nga bufeja.

- Jo sot, Izabela. Në fakt, më duhet të të kërkoj të ikësh tani. - Izabela i hedh një vështrim të lënduar dhe Pahri e qorton veten që nuk mundi të gjente fjalë më të përshtatshme. Izabela gjithmonë ka qenë natyrë e brishtë. - E kam fjalën se pres një telefonatë dhe kam nevojë të jem vetëm.

- Telefonatë? Nga kush?

- Do të ta them më vonë, - thotë Pahri.

Izabela kryqëzon krahët e buzëqesh.

- Mos ke zënë të dashur, mami?

- Të dashur? Mos je gjë e verbër? Ti sikur ke shekuj pa më parë e s'e di si jam bërë.

- Nuk ka asgjë që nuk shkon tek ti.

- Duhet të shkosh tani. Do të t'i sqaroj të gjitha më vonë. Të premtoj.

- *"D'accord, d'accord."* - Izabela hedh çantën në shpinë, merr pallton dhe çelësat. - Por nuk mund të rri pa të thënë që po më bën tej mase kureshtare.

Burri që e merr në telefon në orën 9:30, është Marko Varvarisi. Ai e ka gjetur Pahrin përmes adresës së saj në *Facebook* dhe i ka dërguar një mesazh: "*A jeni ju vajza e poetes Nila Vahdati? Nëse po, do të doja të flisja me ju për diçka që mund t'ju interesojë*". Pahri bëri kërkime në *Google* për emrin e tij dhe zbuloi se ai ishte kirurg plastik, që punonte për një organizatë jofitimprurëse në Kabul. Tani, në telefon,

ai e përshëndet Pahrin në gjuhën farsi dhe vazhdon të flasë në farsi, derisa ajo e ndërpret.

- Zoti Varvaris, më vjen keq, por a nuk do të ishte më mirë të flisnim në anglisht?

- Ah, patjetër. Më falni! Mendova se... Ndonëse, sigurisht, ka kuptim, ju jeni larguar prej këtu kur ishit fare e vogël, apo jo?

- Po, e vërtetë.

- Unë për vete e mësova këtu gjuhën farsi dhe arrij të komunikoj deri diku. Jetoj këtu qysh prej vitit 2002, erdha pak kohë pasi ikën talebanët. Sa ditë optimiste ato! Po, të gjithë u turrëm këtu, që të jepnim ndihmesë në rindërtimin e demokracisë e gjëra të tilla. Por tani është një histori krejt tjetër. Natyrisht, po përgatitemi për zgjedhjet presidenciale, por është një histori krejt tjetër. Kam frikë se kështu është.

Pahri e dëgjon me shumë durim, ndërsa Marko Varvarisi nis të shtjellojë sfidat me të cilat po përballen zgjedhjet në Afganistan, të cilat, sipas tij, do t'i fitojë Karzai. Pastaj ai nis të flasë për trazirat që ende vazhdojnë të shkaktojnë talebanët në veri, për veprimet e dhunshme të islamikëve, që kanë pushtuar të gjitha kronikat e mediave, për nja dy vëzhgime për mbipopullimin e Kabulit, mandej për çmimet e shtëpive e, më në fund, e mbyll qarkun duke thënë:

- Unë ka vite që jetoj në këtë shtëpi. Me sa kam kuptuar, edhe ju keni jetuar në këtë shtëpi.

- Më falni?

- Kjo ka qenë shtëpia e prindërve tuaj. Të paktën kështu më kanë thënë mua, gjithsesi.

- A mund t'ju pyes se cili jua ka thënë këtë?

- Pronari. Quhet Nabi. Në fakt, duhet të them se quhej Nabi. Tani nuk është më, ka pak kohë. A ju kujtohet?

Emri i kujton Pahrit një fytyrë të re e të pashme djaloshare, favorite të gjata dhe një mur flokësh të zinj të krehur lart mbi ballë.

- Po. Si emër më kujtohet. Ai ka qenë kuzhinieri i shtëpisë. Po ashtu edhe shoferi ynë.

- Po, i bënte të dyja, po. Ai ka jetuar këtu, në këtë shtëpi, qysh prej vitit 1947. Gjashtëdhjetë e tre vjet. Paksa e pabesueshme, apo jo? Por, siç ju thashë, ai nuk është më. Ka ndërruar jetë muajin e shkuar. Unë e doja shumë. Të gjithë e donim shumë.

- E kuptoj.

- Nabi më ka lënë një letër, - thotë Marko Varvarisi. - Por që duhej ta lexoja vetëm pas vdekjes së tij. Pasi vdiq, një koleg afgan ma përktheu të gjithën në anglisht. Kjo letër, që në fakt është më shumë se një letër, është mjaft e veçantë. Nabi rrëfen shumë gjëra aty. Unë kërkova emrin tënd, jo vetëm sepse një pjesë e saj ka lidhje me ty, por edhe sepse e kërkon ai vetë që të ta dorëzoj letrën ty. Të kërkuam për ca kohë, por më në fund të gjetëm. Falë internetit. - Dëgjohet një e qeshur e tij e shkurtër.

Një pjesë brenda Pahrit do të donte ta mbyllte telefonin. Instinkti i thotë të mos dyshojë aspak në atë që ka rrëfyer ai burrë në atë letër, ai njeri i së shkuarës së saj të largët, nga gjysma tjetër e botës, sepse gjithçka është e vërtetë. Ajo ka vite që e di tashmë se Mamaja e kishte gënjyer për fëmijërinë e saj. Por edhe pse toka nën këmbët e saj u nda më dysh nga ajo gënjeshtër dhe ajo çka Pahri ka mbjellë aty qysh atëherë, është më se e vërtetë, e qëndrueshme dhe e patundshme, si një pemë gjigante lisi. Eriku, fëmijët, nipërit, karriera, Koleta. Atëherë, për se do t'i vlejë kjo? Pas gjithë kësaj kohe, ç'vlerë ka? Mbase është më mirë ta mbyllë telefonin.

Por ajo nuk e bën. Me pulsin që po i kërcen, dhe me pëllëmbët e duarve të djersitura, ajo thotë:

- Çfarë... çfarë thuhet në këtë letër?

- E po, pikë së pari, ai thotë se është daja yt.

- Daja im?!

- Për të qenë i saktë, dajë nga njerka. Dhe thotë edhe më shumë. Thotë shumë gjëra të tjera.

- Zoti Varvaris, a e keni këtë letër, këtë përkthim? A e keni tani me vete?

- Po.

- A mund të ma lexoni me zë? A mundeni?

- Tani?

- Po qe se keni kohë. Mund t'ju marr unë në telefon, e paguaj unë telefonatën.

- Nuk është nevoja. Por, a jeni e sigurt?

- *Oui*, - thotë ajo në telefon. - Jam e sigurt, zoti Varvaris.

Dhe ai nis t'ia lexojë. Ia lexon të gjithën. Kalon pak kohë. Dhe, kur mbaron, ajo e falënderon dhe i thotë se do ta marrë në telefon së shpejti.

Pasi e mbyll telefonatën, ajo vë ekspresin për të bërë kafen dhe afrohet te dritarja. Aty i shpaloset e gjithë pamja e përditshme: rrugica e ngushtë me kalldrëm, farmacia e lagjes, restoranti i drejtuar nga një familje baske.

Duart e Pahrit dridhen. Diçka e çuditshme po ndodh tek ajo. Diçka vërtet e veçantë. Njësoj si në ato çaste kur kazma godet fuqishëm tokën dhe nafta bulëzon papritur në sipërfaqe. Kjo po ndodh tani në mendjen e saj, me kujtimet e saj, që po dalin nga skutat e thella të trurit. Ajo hedh sytë përtej dritares në drejtim të restorantit bask, por sytë nuk i shohin kamerierin e dobët nën tendë, që ka lidhur një përparëse të zezë në bel e po pastron tryezat me leckë. Sytë e Pahrit shohin tani një karrocë të vogël të kuqe, me rrota pingërritëse që, nën një qiell të veshur me re të pambukta, kërcen mbi shkëmbinj e kanale të thara ujitëse, ngjitet e zbret nëpër kodrat ngjyrë okre, që shndërrohen në forma të vagëta e pastaj zhduken krejt. Ajo sheh pemishtet me drurë të ndryshëm frutorë, flladin që përkëdhel gjethet e tyre dhe rreshtat e hardhive që shtrihen midis shtëpive të vogla me çati të sheshta. Sheh gratë e vëna në rresht buzë lumit për të larë teshat e mandej litarët e një shilarësi të varur në një pemë gjigante, një qen të madh, që kërkon strehim për të shpëtuar nga ngacmimet e djemve të fshatit, një burrë me hundë si sqep fajkoi, që po hap një gropë,

ndërsa bluza i është ngjitur pas kurrizit nga djersa, një grua me shami në kokë, të përkulur mbi zjarrin e gatimit.

Por ka edhe diçka tjetër në sfondin e kësaj pamjeje, në rrethinat e vizionit, dhe kjo është ajo që ia tërheq më shumë vëmendjen: një hije e paqartë. Një siluetë njeriu. Njëherazi e butë dhe e ashpër. Butësia e një dore që mban të sajën. Fortësia e gjunjve ku dikur mbështeste faqen. Ajo përpiqet ta shohë fytyrën e tij, por ajo i ikën, i rrëshqet, sa herë që mundohet ta shquajë. Pahri e ndien se përbrenda saj po hapet një vrimë. Në jetën e saj, gjatë gjithë jetës, ajo ka ndier një mungesë të madhe. Instinktivisht, ajo gjithmonë e ka ditur.

- Vëllai, - thotë ajo, pa e kuptuar që po flet me zë të lartë. Pa e kuptuar që po qan.

Befas i vijnë ndër mend dy vargje të një ninulle në farsi:

*Unë njoh një zanë të vogël e të trishtuar,*
*Që era e natës e mori me vete.*

Ninulla ka edhe dy vargje të tjera, me të cilat fillon, ajo është e bindur për këtë, por edhe kjo i rrëshqet nga mendja.

Pahri ulet. Duhet të ulet. Nuk i duket se mund ta mbajnë këmbët tani. Pret që kafja të ziejë dhe mendon se, kur të jetë gati, do të pijë një filxhan, e mbase edhe një cigare, dhe pastaj do të shkojë në dhomën e ndenjjes e do të marrë në telefon Koletën në Lion. Ndoshta shoqja e saj e fëmijërisë i rregullon një udhëtim për në Kabul.

Por tani për tani ajo qëndron ulur. Mbyll sytë, ndërsa ekspresi nis të gurgullojë, dhe përtej qepallave sheh kodrat e buta dhe qiellin e lartë blu mbi to, diellin që bie mbi mullirin me erë dhe gjithmonë, gjithmonë, një varg malesh të mjegulluara që shtrihen larg në horizont.

# Shtatë

## *Verë 2009*

- Babai yt është një burrë i mrekullueshëm. - Adeli ngriti kokën. Ishte mësuesja Malalai, që ishte përkulur mbi të dhe po i pëshpëriste këto fjalë në vesh. Një mesogrua e mbushur, me një shall ngjyrë vjollcë të hapur mbi supe, që tani po i buzëqeshte atij me sy të mbyllur. - Dhe ti je djalë me fat.

- E di, - ia ktheu ai me pëshpërimë.

- "Shumë mirë", - lëvizi buzët ajo.

Ata po qëndronin te shkallët e hyrjes të shkollës së re për vajza të qytetit, një ndërtesë drejtkëndëshe ngjyrëbizele, me çati të sheshtë dhe dritare të mëdha, ndërsa i ati i Adelit, Baba xhani i tij, po mbante një lutje të shkurtër dhe një fjalim të zjarrtë. Përpara tyre, nën nxehtësinë përvëluese të mesditës, ishte mbledhur një turmë e madhe fëmijësh të zhurmshëm, prindërish e të moshuarit, rreth nja njëqind a më shumë banorë të qytetit të vogël *Shadbag-e-Nau*, Shadbagu i ri.

- Afganistani është mëmëdheu ynë, - tha i ati i Adelit, duke ngritur drejt qiellit njërin prej gishtave të tij të trashë tregues. Dielli vezulloi mbi rrethin e unazës së tij prej agati. - Por është një mëmë e sëmurë, që ka vuajtur për një kohë të gjatë. Tani, është e vërtetë që një mëmë ka nevojë për djemtë

e vet që ta marrë veten. Po, por ajo ka nevojë edhe për vajzat e veta... po aq shumë, nëse jo më shumë!

Kjo shkaktoi duartrokitje të fuqishme dhe një sërë britmash e ovacionesh miratimi. Adeli nisi të shqyrtonte fytyrat në turmë. Ishin të përqendruara plotësisht tek i ati. Baba xhani, me vetullat e trasha e të zeza dhe mjekrën e plotë, i gjatë, i fuqishëm e i shëndoshë, sundonte mbi ta, kurse supet i kishte mjaftueshëm të gjera sa për ta zënë të gjithë derën e shkollës pas krahëve të tij.

I ati vazhdoi. Dhe sytë e Adelit ndeshën ata të Kabirit, njëri prej truprojave të Baba xhanit, që po qëndronte me një fytyrë pa shprehje në njërin krah të Baba xhanit, me kallash-nikovin në dorë. Adeli arrinte të shihte turmën që pasqyrohej në syzet me xhama të errët prej aviatori që kishte vënë Kabiri. Kabiri ishte i shkurtër, i hollë, thuajse i brishtë dhe kishte veshur një kostum me ngjyra të ndezura: livande, portokallí, ngjyrë bruzi. Por Baba xhani thoshte se ai ishte si skifteri dhe, ta nënvlerësoje, ishte një gabim i rrezikshëm.

- Prandaj dhe po jua them këtë sot juve, vajza të reja të Afganistanit, - e mbylli Baba xhani fjalimin, ndërsa hapte krahët e trashë e të gjatë në një gjest mikpritjeje. - Ju keni një detyrë solemne tani: të mësoni, të afirmoheni, të shkëlqeni në mësime, të bëni krenarë jo vetëm baballarët e nënat tuaja, por edhe këtë vend, që është mëma e të gjithëve ne. E ardhmja e tij është në duart tuaja, jo në të miat. Unë dua që ju të mos e quani këtë shkollë si një dhuratë që po ju bëj unë juve. Kjo është thjesht një ndërtesë, kurse dhurata e vërtetë gjendet brenda saj dhe kjo dhuratë jeni ju. Ju jeni dhurata, motra të vogla, jo vetëm për mua dhe komunitetin e Shadbag-e-Naut, por, në radhë të parë, për vetë Afganistanin! Allahu ju bekoftë!

Shpërthyen të tjera duartrokitje. Disa njerëz nisën të bërtisnin:

- Allahu ju bekoftë juve, Komandant *Sahib*!

Baba xhani ngriti njërin grusht lart dhe buzëqeshi me gjithë shpirt. Sytë e Adelit thuajse u njomën nga krenaria.

Mësuesja Malalai i zgjati Baba xhanit një palë gërshërë. Një fjongo e kuqe ishte lidhur te dera e shkollës. Turma u afrua më pranë, që të shihte më mirë, dhe Kabiri shtyu disa njerëz pas, duke i goditur disa prej tyre në gjoks. Duart u ngritën lart mbi turmë, me telefona celularë, për të regjistruar në video prerjen e shiritit. Baba xhani mori gërshërët në dorë, u kthye nga Adeli dhe i tha:

- Ja ku i ke, bir, do ta bësh ti nderimin. - Dhe ia zgjati gërshërët Adelit.

Adeli puliti sytë.

- Unë?

- Jepi, - tha Baba xhani, duke i shkelur syrin.

Adeli e preu fjongon. Përreth shpërthyen duartrokitje të gjata. Adeli dëgjoi klikun e disa aparateve fotografike, zërat që thërrisnin: *"Allah - u - akbar!"*

Baba xhani qëndroi te pragu i derës dhe nxënëset u vunë në rresht e hynë njëra pas tjetrës në klasë. Ishin vajza të vogla, tetë deri në pesëmbëdhjetë vjeç, të gjitha me shalle të bardha dhe uniformat e zeza me viza gri që u kishte dhuruar Baba xhani. Adeli shihte se si çdo nxënëse i paraqitej gjithë druajtje Baba xhanit, ndërsa hynte brenda. Baba xhani u buzëqeshte ngrohtë, ua përkëdhelte kokën dhe u thoshte nja dy fjalë zemërdhënëse:

- Të uroj suksese, Bibi Miriam. Mëso shumë, Bibi Homaira. Na bëj të krenohemi me ty, Bibi Ilham.

Më vonë, pranë *Land Cruiser*-it të zi, Adeli po qëndronte në krah të të atit, që tani po djersinte nga vapa e po tokte duart me vendasit. Baba xhani mbante në dorë një tespihe dhe dëgjonte me durim, paksa i përkulur mbi folësin, me ballin të ngrysur, duke pohuar me kokë, i vëmendshëm ndaj çdo njeriu që vinte ta falënderonte, të lutej për të a t'i shprehte respektin. Dhe shumica e tyre gjenin rastin të kërkonin ndonjë favor. Një nënë, djali i së cilës kishte nevojë të vizitohej te një kirurg në Kabul; një burrë, që kishte nevojë për një hua për të hapur

një dyqan për riparimin e këpucëve; një mekanik që kërkonte një komplet veglash të reja pune.

*Komandant Sahib, vëreni dorën në zemër...*

*Nuk kam kujt t'i drejtohem tjetër, Komandant Sahib...*

Adeli nuk kishte dëgjuar ndonjëherë ndonjë njeri që nuk ishte i familjes, që ta thërriste ndryshe të atin, përveçse "Komandant *Sahib*", edhe pse rusët kishin vite që kishin ikur dhe Baba xhani kishte më se dhjetë vjet a më shumë që nuk e kishte shkrepur një herë pushkën. Në shtëpinë e tyre, dhoma e ndenjjes ishte e mbushur me fotografi të Baba xhanit në ditët e xhihadit. Adeli i kishte vënë qëllim vetes që të ruante në kujtesë deri në përimtime secilën nga fotografitë: i ati i përkulur mbi kapakun e motorit të një xhipi të vjetër gjithë pluhur; duke u ngjitur në kullën e një tanku të djegur; duke pozuar gjithë krenari me njerëzit e vet, me gjerdanin e fishekëve të vendosur diagonalisht në kraharor; pranë një helikopteri që e kishin rrëzuar ata. Aty më tej ishte një fotografi ku ai kishte dalë me jelek e gjerdan fishekësh, me ballin të mbështetur në tokën e shkretëtirës, për t'u lutur. Asokohe babai i Adelit ishte shumë më i dobët dhe gjithmonë pas tij nëpër fotografi nuk shihej asgjë tjetër përveç maleve e rërës.

Baba xhani ishte plagosur dy herë nga rusët në betejë. Ai ia kishte treguar Adelit plagët, njëra në anën e majtë, mu nën brinjë - ai kishte thënë se kjo i kishte kushtuar shpretkën - dhe tjetra sa gjatësia e gishtit të madh të dorës pranë kërthizës. Ai kishte thënë se kishte qenë me fat, po të merrej parasysh gjithçka. Disa nga shokët e tij kishin humbur krahët, këmbët, sytë, disa të tjerëve u ishte djegur fytyra. Ata e kishin bërë këtë për atdheun e tyre, kishte thënë Baba xhani, dhe e kishin bërë edhe për hir të Zotit. Sepse kështu ishte xhihadi. Sakrificë. Sakrifikoje gjymtyrët e tua, shikimin, madje edhe jetën, dhe e bëje këtë me kënaqësi. Xhihadi gjithashtu të dhuronte disa të drejta e privilegje, kishte thënë ai, sepse Zoti kujdeset që t'u japë më shumë shpërblime atyre që sakrifikojnë më shumë.

- Si në këtë jetë, ashtu edhe në tjetrën, - kishte thënë Baba xhani, duke e drejtuar gishtin e tij të trashë në fillim poshtë e mandej lart.

Kur kundronte fotografitë, Adeli donte që të kishte lindur që në atë kohë e të kishte luftuar për xhihadin përkrah të atit në ato ditë me më shumë aventura. Atij i pëlqente që ta përfytyronte veten duke qëlluar helikopterët rusë tok me Baba xhanin, duke hedhur në erë tanket, duke iu përvjedhur plumbave, duke jetuar nëpër male e duke fjetur nëpër shpella. Babë e bir, heronj të luftës.

Aty ishte edhe një tjetër fotografi e Baba xhanit, duke buzëqeshur në krah të presidentit Karzai në *Arg*, Pallati Presidencial në Kabul. Kjo ishte bërë së fundmi, në një ceremoni të vogël, gjatë së cilës Baba xhanit i kishin dhënë një dekoratë për punën humanitare që kishte bërë në Shadbag-e-Nau. Ishte një dekoratë që Baba xhani e meritonte plotësisht. Shkolla e re e vajzave nuk ishte projekti i tij i fundit. Adeli e dinte që gratë e qytetit kishin vdekur vazhdimisht gjatë lindjes. Por tani kjo nuk ndodhte më, sepse i ati kishte hapur një klinikë të madhe, që drejtohej nga dy mjekë dhe tri ndihmësmjeke, rrogat e të cilëve ai i paguante nga xhepi i vet. Të gjithë njerëzit e fshatit përfitonin trajtim falas në klinikë, asnjë fëmijë në Shadbag-e-Nau nuk mbetej pa u vaksinuar. Baba xhani kishte shpërndarë grupe për të lokalizuar pikat ujëmbledhëse nëpër qytet dhe për të hapur puse. Ishte Baba xhani ai që e kishte sjellë dritën elektrike në Shadbag-e-Nau për njëzet e katër orë rresht. Të paktën një gjysmë duzine biznesesh ishin hapur falë huave që kishte dhënë ai, i kishte thënë Kabiri Adelit, ndërkohë që vetëm pak prej tyre, në mos asnjëri, ia kishin kthyer borxhin.

Adeli ia kishte thënë me sinqeritet mësueses ato fjalë. Ai e dinte që ishte me fat që ishte djali i një njeriu të tillë.

Ndërsa radhës që po priste të tokte duart me Baba xhanin, po i vinte fundi, Adeli vuri re një burrë të dobët që po i afrohej të atit. Ai kishte vënë një palë syze të rrumbullakëta me skelet të hollë dhe kishte një mjekër të shkurtër gri e dhëmbë të

vegjël si kokat e shkrepëseve të djegura. Nga pas e ndiqte një djalë që duhej të kishte moshën e Adelit. Atletet e djalit kishin nga një vrimë nga ku i dilnin gishtat e mëdhenj të këmbëve. Flokët i kishte si një masë leshi të pakrehur, të ngjitur pas kokës e të palëvizshëm. Xhinset i kishte gjithë baltë e shumë të shkurtra për këmbët e tij. Përkundrazi, bluza i arrinte thuajse deri te gjunjët.

Kabiri zuri vend midis burrit plak dhe Baba xhanit.

- Të thashë që nuk është ky çasti i përshtatshëm, - tha ai.

- Thjesht dua të flas pak me Komandantin, - tha burri plak.

Baba xhani e kapi Adelin për krahun dhe gjithë butësi e drejtoi për në ndenjësen e pasme të *Land Cruiser*-it.

- Eja të ikim, bir. Mamaja po të pret.

Ai u fut në makinë pas Adelit dhe e mbylli derën.

Brenda në makinë, ndërsa dritarja e errët po mbyllej, Adeli pa Kabirin t'i thoshte diçka plakut, por nuk arriti të dëgjonte asgjë. Pastaj Kabiri i ra makinës përqark dhe u ul në ndenjësen e shoferit, e vuri kallashnikovin në ndenjësen e përparme të pasagjerit dhe ndezi motorin.

- Për çfarë ishte fjala? - pyeti Adeli.

- Asgjë me rëndësi, - tha Kabiri.

Ata hynë në rrugën kryesore, që e ndante Shadbag-e--Naun në dy gjysma. Disa nga djemtë që ishin përzier me turmën, e ndoqën për njëfarë kohe *Land Cruiser*-in, derisa më në fund makina u largua prej tyre. Kabiri tani po e ngiste makinën nëpër një rrugë të mbushur plot me njerëz, duke i rënë vazhdimisht borisë, ndërsa manovronte mes trafikut. Të gjithë thërrisnin drejt tyre. Disa njerëz i përshëndetën me dorë. Adeli shihte këmbësoret në të dyja anët e rrugës, të mbushura me njerëz, dhe vështrimi i kapte gjëra të njohura, që i largoheshin me shpejtësinë e makinës: mishi i therur që varej në çengelët e dyqanit të kasapit, farkëtarët duke punuar rrotat prej druri e duke rrahur hekurin në kudhër, shitësit e frutave

duke përzënë mizat nga rrushi e qershitë; berberi në karrigen e thurur me thupra, duke tundur briskun në dorë. Ata kaluan pranë çajhaneve, qebaptoreve, një dyqani për riparimin e makinave, një xhamie, përpara se Kabiri të hynte mespërmes me makinë në sheshin e madh publik të qytetit, në qendër të të cilit gjendej një shatërvan blu dhe një muxhahid nëntë këmbë i gjatë prej guri të zi, me vështrimin nga lindja, me çallmën të lidhur gjithë dinjitet në kokë, me një granatë antitank në sup. Baba xhani kishte gjetur e kishte paguar vetë një skulptor në Kabul, që ta gdhendte atë statujë.

Në veri të rrugës ishte një zonë e vogël banimi, e përbërë kryesisht nga rrugë të pashtruara dhe blloqe shtëpish të vogla me çati të sheshtë, të lyera me ngjyrë të verdhë, të bardhë ose blu. Në çatitë e disave prej tyre shiheshin tasat e satelitit, kurse në dritaret e disa të tjerave valëvitej flamuri i Afganistanit. Baba xhani i kishte thënë Adelit se shumica e shtëpive dhe e bizneseve në Shadbag-e-Nau ishin ndërtuar gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit. Edhe ai vetë kishte dhënë ndihmesë në ndërtimin e tyre. Shumica e njerëzve që jetonin këtu, e konsideronin atë si themeluesin e Shadbag-e-Naut dhe Adeli e dinte se pleqtë kishin kërkuar që t'i vinin qytetit emrin e Baba xhanit, por ai nuk kishte pranuar.

Prej aty, rruga kryesore shtrihej dy milje drejt veriut, përpara se të përfundonte në Shadbag-e-Kohna, Shadbagu i vjetër. Adeli nuk e kishte parë kurrë fshatin ashtu siç kishte qenë dikur. Në kohën kur Baba xhani e kishte sjellë atë këtu tok me të ëmën nga Kabuli, fshati nuk ekzistonte më. Nuk kishte mbetur asnjë shtëpi aty. E vetmja mbijetojë e së shkuarës që kishte mbetur, ishte një mulli me erë, edhe ai i rrënuar. Në Shadbag-e-Kohna, Kabiri doli nga rruga kryesore dhe hyri në një shteg të gjerë e të pashtruar një çerek miljeje të gjatë, që lidhte rrugën kryesore me muret e trasha e dymbëdhjetë këmbë të larta të vilës ku jetonte Adeli me prindërit e tij: e vetmja ndërtesë më këmbë tani në Shadbagh-e-Kohna, pa marrë

parasysh mullirin me erë. Adeli arrinte t'i shihte muret e bardha tani që makina po kërcente e po lëkundej nëpër shteg. Mbi mure shtriheshin rrathë telash me gjemba.

Një rojë me uniformë, që qëndronte gjithmonë në hyrjen kryesore të vilës, i përshëndeti dhe u hapi derën. Kabiri e futi makinën brenda dhe mandej eci nëpër një rruginë të shtruar me zhavorr në drejtim të shtëpisë.

Shtëpia ishte katërkatëshe dhe e lyer me bojë rozë të lehtë e gurkali. Ajo kishte shtylla të larta, ullukë me majë dhe një xham të lartë pasqyrues, që vezullonte nën dritën e diellit. Kishte parapete, një verandë me mozaikë xixëllues dhe ballkone të gjera me parmakë të harkuar prej hekuri, të punuar si dantella elegante. Brenda, ata kishin nëntë dhoma gjumi e shtatë banja dhe ndonjëherë Adeli e Baba xhani luanin aty symbyllazi: Adeli vinte rrotull nëpër shtëpi për gati një orë për ta gjetur të atin. Të gjithë banakët e duarlarëseve në banja e në kuzhinë ishin prej graniti e mermeri me ujëra. Kohët e fundit Baba xhani kishte folur edhe për ndërtimin e një pishine në bodrum, çka e kishte magjepsur Adelin.

Kabiri hyri në rruginën rrethore anash kangjellave të larta të shtëpisë. Ai e fiku motorin.

- A mund të na lësh vetëm për një minutë? - i tha Baba xhani.

Kabiri pohoi me kokë dhe doli nga makina. Adeli e pa të ngjiste shkallët prej mermeri të derës dhe t'i binte ziles. Ishte Azmarai, truproja tjetër, një djalë i shkurtër, trupngjeshur e i zymtë, që e hapi derën. Të dy burrat shkëmbyen disa fjalë, pastaj u mbështetën pas parmakut të shkallëve dhe ndezën nga një cigare.

- Duhet patjetër të shkosh? - i tha Adeli. I ati do të nisej të nesërmen në mëngjes për në jug të vendit, që të shihte fushat e pambukut në Helmand dhe të takohej me punëtorët e fabrikës së pambukut që kishte ndërtuar atje. Ai do të qëndronte atje dy javë, një periudhë kohe që Adelit i dukej pa fund.

Baba xhani ktheu kokën nga ai. Adeli dukej si xhuxh përpara të atit, që zinte më shumë se gjysmën e ndenjëses së pasme.

- Edhe unë do të kisha dashur të mos shkoja, bir.

Adeli pohoi me kokë.

- Sot u ndjeva krenar. U ndjeva krenar për ty.

Baba xhani e vuri dorën e vet të rëndë mbi gjurin e Adelit.

- Falemnderit, Adel. E vlerësoj shumë këtë. Por unë të marr me vete në të tilla raste që ti të mësosh, që të kuptosh se njerëzit si puna jonë, njerëzit e pasur, duhet të përballen me përgjegjësitë e tyre.

- Unë thjesht do të doja që ti të mos ishe larg gjatë gjithë kohës.

- Edhe unë, bir. Edhe unë. Por sot jam këtu. Do të kthehem në shtëpi në mbrëmje.

Adeli pohoi me kokë, me sytë të ngulur mbi duart e tij.

- Shiko, - i tha i ati me zë të butë. - Njerëzit e këtij qyteti kanë nevojë për mua, Adel. Ata kanë nevojë për mua, që të kenë një shtëpi, të gjejnë punë dhe të sigurojnë jetesën. Kabuli ka problemet e veta. Nuk ka për t'i ndihmuar kurrë. Dhe, nëse nuk e bëj unë, askush tjetër nuk ka për ta bërë. Dhe atëherë këta njerëz do të vuajnë.

- E di këtë, - mërmëriti Adeli.

Baba xhani ia përkëdheli gjurin butësisht.

- Ty të ka marrë malli për Kabulin, e di, dhe për shokët e tu. E di që mezi u përshtatët këtu, edhe ti, edhe mamaja. Dhe e di edhe që unë jam gjithmonë në udhëtim ose nëpër takime me njerëz dhe që shumë njerëz kanë nevojë për kohën time. Por... më shiko, bir.

Adeli ngriti sytë që të ndeshte ata të Baba xhanit, që po e shihnin me një vështrim dashamirës nën vetullat e trasha si shkurre.

- Askush në këtë botë nuk ka për mua më shumë rëndësi sesa ti, Adel. Ti je djali im. Dhe unë me kënaqësi do të kisha hequr dorë nga të gjitha këto për ty. Do të jepja edhe jetën për

ty, biri im. - Adeli pohoi me kokë, ndërsa sytë iu mjegulluan paksa nga lotët. Ndonjëherë, kur Baba xhani i fliste në këtë mënyrë, Adeli ndiente t'i shkrihej zemra në kraharor dhe e kishte të vështirë të mbushej me frymë. - A më kupton?

- Po, Baba xhan.

- A më beson?

- Po.

- Shumë mirë. Tani puthe babin.

Adeli ia hodhi Baba xhanit krahët në qafë dhe i ati e përqafoi fort. Adelit i kujtohej se si, kur ishte i vogël, trokiste me gishta në supin e të atit, ndërsa ishte ende duke u dridhur nga një ëndërr e keqe, dhe i ati ia largonte batanijen dhe e merrte në shtratin e vet, e mbulonte dhe e puthte në ballë, derisa Adelit i ndalonin dridhjet dhe e kaplonte gjumi përsëri.

- Mbase të sjell ndonjë gjë që të vogël nga Helmandi, - tha Baba xhani.

- Nuk ka pse, - i tha Adeli, me zë të mekur. Ai kishte aq shumë lodra, sa nuk dinte ç'të bënte me to. Dhe nuk ekzistonte lodër në këtë botë që mund t'ia zëvendësonte mungesën e të atit.

Më vonë atë ditë, Adeli u përkul mbi parmakun e shkallëve dhe po mbante vesh bisedën që po zhvillohej te dera. Zilja e derës kishte rënë dhe derën e kishte hapur Kabiri. Tani ai ishte mbështetur pas shtalkës së derës, me krahë të kryqëzuar, duke e bllokuar hyrjen plotësisht, dhe po fliste me njeriun që gjendej në anën tjetër të pragut. Ishte ai burri plak që u ishte afruar te shkolla: Adeli e njohu burrin me syze me xhama të trashë, me dhëmbët si kunja të djegur shkrepësesh. Edhe djali me këpucët me vrima ishte aty e po qëndronte pas të atit.

Burri plak tha:

- Ku ka shkuar?

Kabiri u përgjigj:

- Për punë. Në jug.

- Unë dëgjova se do të nisej nesër. - Kabiri mblodhi supet. - Sa kohë do të qëndrojë?

- Dy, mbase tre muaj. E kush mund ta thotë?

- Nuk është kjo ajo që kam dëgjuar unë.

- Tani po ma vë durimin në provë, o plak, - tha Kabiri, duke shkryqëzuar krahët.

- Do ta pres.

- Jo këtu, nuk ke për ta pritur këtu.

- E kam fjalën, ndanë rrugës.

Kabiri e kaloi peshën gjithë padurim nga njëra këmbë në tjetrën.

- Merre më nge, - i tha ai. - Komandanti është njeri me shumë punë. Asnjeri s'mund të thotë se kur do të kthehet.

Burri plak pohoi me kokë dhe u nis të ikte; djali e ndoqi pas.

Kabiri e mbylli derën.

Adeli hapi perden e dritares së dhomës së ndenjjes dhe i pa plakun me djalin që po ecnin më këmbë nëpër rrugën e pashtruar që lidhte vilën e tyre me rrugën kryesore.

- Ti e gënjeve, - tha Adeli.

- Për këtë më paguajnë: që ta mbroj babanë tënd nga njerëzit grabitqarë.

- Çfarë kërkon ai? Punë?

- Diçka të tillë.

Kabiri u afrua te divani dhe hoqi këpucët. Ai ngriti kokën dhe i shkeli syrin Adelit. Adelit i pëlqente Kabiri shumë më tepër se Azmarai, që ishte njeri i mërzitshëm dhe rrallë i thoshte ndonjë fjalë. Kabiri luante me letra me Adelin dhe e merrte pranë, që të shihnin filma në DVD bashkë. Kabiri i adhuronte filmat. Ai kishte një koleksion që e kishte blerë në tregun e zi, dhe shihte dhjetë deri në dymbëdhjetë filma në javë: filma iranianë, francezë, amerikanë e, pa dyshim, edhe filmat indianë

të Bollivudit[1]. Dhe ndonjëherë, kur mamaja e Adelit ishte në një dhomë tjetër dhe Adeli premtonte që s'do t'i thoshte gjë të atit, Kabiri zbrazte karikatorin e kallashnikovit të vet dhe e linte Adelin ta mbante, si një muxhahid i vërtetë. Tani kallashnikovi gjendej i mbështetur pranë murit te dera e hyrjes.

Kabiri u shtri në divan, mbështeti këmbët te krahu i tij dhe nisi të shfletonte gazetën.

- Por ata duken si njerëz të parrezikshëm, - tha Adeli, duke mbyllur perden e duke u kthyer nga Kabiri. Ai arrinte të shihte ballin e truprojës që dilte mbi gazetën.

- Mbase duhej t'i kisha ftuar brenda për çaj, - mërmëriti Kabiri. - E mbase t'u jepja edhe pak kek.

- Mos u tall.

- Të gjithë të parrezikshëm duken.

- A do t'i ndihmojë Baba xhani?

- Me siguri, - psherëtiu Kabiri. - Yt atë është si lumë për njerëzit e vet. - Ai uli gazetën dhe buzëqeshi. - Si ishte ai emri? Hë pra, Adel. Ai filmi që pamë muajin e shkuar.

Adeli mblodhi supet. U drejtua për te shkallët, që të ngjitej lart.

- Lorenc, - thirri Kabiri që nga divani. - "Lorenci i Arabisë". Entoni Kuin. - Dhe, tamam në çastin kur Adeli arriti në krye të shkallëve, ai vazhdoi: - Ata janë të gjithë grabitqarë, Adel. Mos u gënje nga mënyra se si sillen. Po t'u jepej mundësia, do ta kishin zhvatur plotësisht tët atë.

Një mëngjes, disa ditë pasi i ati ishte nisur për në Helmand, Adeli shkoi në dhomën e gjumit të prindërve. Muzika në anën tjetër të derës ishte e lartë dhe ritmike. Ai hyri brenda dhe gjeti të ëmën me pantallona të shkurtra e bluzë pambuku, për-

1) Termi popullor për industrinë kinematografike me qendër në Bombej (*shën. i përkth.*).

para një televizori me ekran të sheshtë, duke imituar lëvizjet e tri biondeve të lara në djersë: kërcime, ulje e ngritje majtas e djathtas dhe pompa.

Ajo e vuri re nga pasqyra e madhe e dollapit të rrobave.

- Do të vish të kërcejmë bashkë? - bërtiti ajo, që t'i dëgjohej zëri mbi muzikën e lartë.

- Po rri ulur këtu, - tha ai. U ul mbi tapet dhe nisi të shihte të ëmën, që quhej Aria, duke kërcyer si bretkosë nga njëri cep i dhomës në tjetrin.

Mamaja e Adelit kishte duar e këmbë delikate, hundë të vogël me majë të kthyer përpjetë dhe fytyrë të bukur si një prej atyre aktoreve të filmave bollivudianë të Kabirit. Ajo ishte e dobët, e brishtë dhe e re në moshë: kishte qenë vetëm katërmbëdhjetë vjeç, kur ishte martuar me Baba xhanin. Adeli kishte edhe një tjetër mama, më të madhe në moshë, dhe tre vëllezër të tjerë më të rritur, por Baba xhani i kishte sistemuar ata në Lindje, në Jalalabad, dhe Adeli i shihte vetëm një herë në muaj a më rrallë, kur Baba xhani e merrte me vete që të shkonin t'i takonin. Ndryshe nga e ëma dhe e njerka, që nuk e duronin dot fare njëra-tjetrën, Adeli dhe vëllezërit e tij shkonin shumë mirë bashkë. Kur ai shkonte t'i takonte në Jalalabad, ata e shëtitnin nëpër parqe, e çonin në kinema, e çonin për të parë kampionatin e buzkashit. Ata luanin bashkë lojëra elektronike si "*Resident Evil*", vrisnin zombit e "*Call of Duty*" dhe gjithmonë e merrnin në skuadrën e tyre, kur luanin futboll me shokët e lagjes. Adeli dëshironte me gjithë shpirt që edhe ata të jetonin këtu, tok me ta.

Adeli e pa të ëmën, që u shtri në shpinë dhe ngriti lart këmbët e shtrira, mandej i uli përsëri, duke mbajtur midis kyçeve të zhveshura një top të vogël plastik ngjyrëblu.

E vërteta ishte që Adelin po e vriste mërzia këtu në Shadbag. Ata kishin dy vjet që jetonin këtu dhe ai nuk kishte bërë as edhe një shok. Ai nuk mund të dilte me biçikletë nëpër qytet, të paktën jo vetëm fare, me gjithë atë valë rrëmbimesh që kishte pushtuar atë zonë, edhe pse ndonjëherë ai përvidhej

për pak kohë, por gjithmonë qëndronte brenda perimetrit të vilës. Ai nuk kishte as shokë klase, sepse Baba xhani nuk e çonte në shkollën e qytetit - për "arsye sigurie" thoshte ai - kështu që çdo mëngjes vinte një mësues në shtëpi për t'i shpjeguar mësimet. Adeli e kalonte pjesën më të madhe të kohës duke lexuar ose duke luajtur i vetëm me top futbolli, ose duke parë tok me Kabirin të njëjtët filma që i kishte parë nja njëqind herë. Ai ecte pa pushim nëpër korridorin me tavan të lartë të shtëpisë së tyre gjigante, hynte nëpër dhomat e mëdha boshe ose ulej te dritarja e dhomës së tij të gjumit në katin e dytë. Ai jetonte në një vilë të madhe, por në një botë të mpakur. Ndonjëherë ndihej kaq i mërzitur, sa do të kishte qenë i gatshëm të çante edhe drutë.

Adeli e dinte se edhe e ëma ndihej tmerrësisht e vetmuar këtu. Ajo mundohej ta mbushte ditën me veprime rutinë: gjimnastikë në mëngjes, dush, ngrënia e mëngjesit, pastaj lexim, përkujdesje për kopshtin, telenovela indiane pasdite. Kur Baba xhani nuk ishte në shtëpi, çka ndodhte shpesh, ajo rrinte gjithmonë e veshur me tuta gri e atlete dhe vinte vërdallë në shtëpi me fytyrën pa tualet e flokët të kapur topuz në zverk. Ajo e hapte shumë rrallë kutinë e bizhuterive, ku mbante gjithë ato unaza, varëse e vathë që ia kishte sjellë Baba xhani nga Dubai. Ndonjëherë kalonte orë të tëra duke folur në telefon me njerëzit e familjes së saj në Kabul. Vetëm një herë në dy a tre muaj, kur e motra dhe prindërit vinin të qëndronin në shtëpinë e tyre për disa ditë, e shihte Adeli të ëmën të gjallërohej vërtet. Ajo vishte një fustan të gjatë e sandale me taka të larta dhe bënte tualet. Sytë i vezullonin dhe e qeshura e saj kumbonte në tërë shtëpinë. Dhe vetëm atëherë Adeli arrinte të kuptonte se çfarë njeriu mund të kishte qenë ajo dikur.

Kur Baba xhani nuk ishte në shtëpi, Adeli dhe e ëma mundoheshin t'i bënin shoqëri njëri-tjetrit. Ata luanin me lojëra formuese, ose golf e tenis në minikompjuterin e Adelit. Por loja që i pëlqente më shumë Adelit, ishte ndërtimi i shtëpive me kunja dhëmbësh. E ëma vizatonte një shtëpi tripërmasore

në letër, me një gardh me derë, me çati trekëndëshe, me shkallë nga brenda dhe mure që ndanin dhomat e ndryshme nga njëra-tjetra. Në fillim ndërtonin themelet, pastaj muret e brendshme dhe shkallët, duke vrarë kohën, ndërsa ngjitnin me kujdes kunjat e dhëmbëve me njëri-tjetrin dhe i linin të thaheshin. Mamaja e Adelit thoshte se, kur kishte qenë e vogël, përpara se të martohej me të atin e Adelit, kishte ëndërruar të bëhej arkitekte.

Njëherë, ndërsa ndërtonin së bashku një rrokaqiell, ajo i kishte rrëfyer Adelit se si ishin martuar ajo e Baba xhani.

- Ai, në fakt, donte të martohej me motrën time të madhe, - kishte thënë ajo.

- Me teze Nargisin?

- Po. Dhe kjo ndodhi në Kabul. Ai e kishte parë një ditë në rrugë dhe kaq qe e gjitha: donte të martohej me të. Ai erdhi që të nesërmen në shtëpinë tonë, bashkë me pesë burra nga të vetët. Pak a shumë hynë vetë brenda, pa i ftuar njeri. Dhe të gjithë kishin mbathur çizme. - Ajo tundi kokën mohueshëm dhe qeshi, a thua se ishte diçka për të qeshur ajo që kishte bërë Baba xhani, por nuk kishte atë të qeshurën e zakonshme, që i shpërthente kur gjërat ishin vërtet argëtuese. - Veç ta shihje shprehjen e fytyrës të gjyshërve të tu.

Ata ishin ulur në dhomën e ndenjjes: Baba xhani, burrat e tij dhe prindërit e saj. Ajo kishte qenë në kuzhinë duke përgatitur çajin, ndërsa ata kishin nisur të flisnin. Problemi ishte, kishte thënë ajo, se Nargisi ndërkaq ishte e fejuar me një kushëri që jetonte në Amsterdam dhe që studionte për inxhinieri. "E si mund të prishet fejesa?" - kishin pyetur prindërit e saj.

- Dhe tamam në atë çast hyra unë brenda, me një tabaka me çaj e ëmbëlsira. I mbusha filxhanët e tyre dhe i lashë ëmbëlsirat mbi tryezë dhe yt atë më pa e, ndërsa unë bëra të largohesha, tha: "Mbase ke të drejtë, zotëri. Nuk është e drejtë të prishet fejesa. Por po më the se e ke të zënë edhe këtë tjetrën, atëherë kam frikë se s'kam zgjidhje tjetër, përveçse të

mendoj se s'e vret mendjen fare për mua". Dhe pastaj ia plasi së qeshurës. Dhe kështu u martuam ne.

Ajo kishte ngritur tubetin me ngjitës.

- A të pëlqeu ai? - e kishte pyetur Adeli.

Ajo kishte mbledhur supet.

- Të them të drejtën, më shumë e kisha frikë.

- Por tani të pëlqen, apo jo? Ti e do.

- Sigurisht që po, - kishte thënë mamaja e Adelit. - Ç'pyetje!

- Dhe nuk të vjen keq që u martove me të.

Ajo kishte ulur poshtë tubetin me ngjitës dhe kishte heshtur për disa sekonda, përpara se t'i kthente përgjigje.

- Shiko jetët tona, Adel, - i kishte thënë ajo ngadalë. - Hidhi sytë përreth teje. Ka ndonjë gjë për të të ardhur keq? - Ajo kishte qeshur dhe ia kishte tërhequr lehtë veshin. - Veç kësaj, po të mos ishte kështu, nuk do të kisha pasur mundësi të të kisha ty.

Tani mamaja e Adelit e fiku televizorin dhe u ul në dysheme, duke dihatur e duke tharë djersën e qafës me peshqir.

- Pse nuk bën diçka vetë sot? - i tha ajo, duke shtriqur shpinën. - Tani do të shkoj të bëj një dush e pastaj do të ha mëngjesin. Dhe po mendoja të merrja në telefon gjyshërit e tu. Ka ca ditë që s'kam folur me ta.

Adeli psherëtiu dhe u ngrit në këmbë.

Në dhomën e tij, një kat më poshtë e në anën tjetër të shtëpisë, mori topin e futbollit dhe veshi fanellën e Zidanit, që ia kishte dhuruar i ati për ditëlindjen e vet të fundit, kur kishte mbushur dymbëdhjetë vjeç. Kur zbriti poshtë, Kabirin e gjeti duke dremitur, me gazetën të hapur në kraharor si çarçaf. Ai mori një kanaçe me lëng molle nga frigoriferi dhe doli jashtë.

Adeli eci nëpër rruginën e shtruar me zhavorr drejt portës kryesore të vilës. Shtëpiza ku qëndronin rojat e armatosura, ishte bosh. Ai e dinte se kur ndërroheshin rojat. E hapi derën

me kujdes dhe doli jashtë duke e mbyllur derën pas vetes. Thuajse menjëherë pati përshtypjen se në këtë anë të murit mund të merrte frymë më mirë. Ndonjëherë, kompleksi i ngjasonte më shumë me një burg.

Ai eci përgjatë hijes që lëshonte muri në tokë, në drejtim të murit të prapmë të vilës, larg rrugës kryesore. Atje gjendej pemishta e Baba xhanit, për të cilën ai ishte shumë krenar. Disa akra tokë të mbjellë me radhë paralele mollësh, pjeshkësh, kajsish, qershish, fiqsh e, madje, edhe muçmollash. Kur Adeli dilte me të atin për të shëtitur në këtë pemishtë, Baba xhani e ngrinte mbi supet e veta dhe Adeli këpuste dy kokrra mollë. Midis vilës dhe pemishtës gjendej një si punë depoje, thuajse e zbrazët, ku kopshtarët linin veglat e punës. E vetmja gjë tjetër aty ishte një trung i trashë i prerë, që dikur duhej të kishte qenë një pemë gjigante lisi. Baba xhani i kishte numëruar unazat e saj tok me Adelin dhe kishin arritur në përfundimin se ajo pemë duhej të kishte parë t'i kalonin pranë edhe ushtritë e Xhingiz Khanit. Ai kishte thënë, duke tundur kokën fuqishëm në shenjë mohimi, se ai që e kishte prerë, duhej të kishte qenë budalla i madh.

Dita ishte e ngrohtë dhe dielli po vezullonte në një qiell blu të pastër, të ngjashëm me ata qiejt që vizatonte Adeli me lapsa me ngjyra, kur ishte i vogël. Ai e vuri kanaçen me lëngun e mollës mbi trungun e pemës dhe nisi të godiste lart topin me këmbë, pa e lënë të binte në tokë. Rekordi i tij më i mirë kishte qenë gjashtëdhjetë e tetë goditje. E kishte vendosur atë rekord në pranverë dhe tani, në mes të verës, po mundohej që ta thyente. Kishte arritur ndërkaq në goditjen e njëzet e tetë, kur ndieu se dikush po e shihte. Ishte ai djali, ai që shoqëronte burrin plak që i ishte afruar Baba xhanit në përfundim të ceremonisë së përurimit të shkollës. Djaloshi tani ishte shtrirë nën hijen e murit me tulla të depos.

- Ç'do ti këtu? - i tha Adeli, duke u munduar t'i hungërinte fjalët, ashtu siç bënte Kabiri, kur u fliste të panjohurve.

- Po rri në hije, - tha djali. - Mos më spiuno.

- Nuk duhej të ishe këtu.

- As ti.

- Çfarë?

Djali nisi të qeshte.

- S'ka rëndësi. - Ai u ngrit në këmbë, hapi krahët dhe u shtriq. Adeli u mundua të shihte nëse i kishte të mbushur xhepat. Mbase kishte ardhur për të vjedhur fruta. Djali iu afrua Adelit, ia mori topin, nisi ta godiste me të shpejtë dhe pastaj i dha një goditje me thembër në drejtim të Adelit. Adeli e kapi topin dhe e mbajti nën krah. - Aty ku na tha të prisnim ai demi yt, aty në rrugë, mua dhe tim eti, aty s'ka hije. Dhe në qiell nuk kishte as edhe një dreq reje.

Adeli e ndjeu se duhej të reagonte në mbrojtje të Kabirit.

- Ai nuk është dem.

- E po, ai u bind mirë që ne e pamë kallashnikovin e tij, këtë ta them me siguri. - Ai po e shihte Adelin me një nënqeshje përtace mbi buzë. Dhe pështyu përpara këmbëve të tij. - Domethënë, ti na qenke tifoz i atij që e përdor kokën për të qëlluar kundërshtarët.

Adelit iu desh një çast për të kuptuar se për kë e kishte fjalën ai.

- Nuk mund ta gjykosh nisur nga një gabim i vetëm që ka bërë, - tha ai. - Ai ishte më i miri. Ishte magjistar në mesfushë.

- Kam parë edhe më të mirë.

- Ou? E kë?

- Maradonën.

- Maradona? - tha Adeli, i tërbuar. Ai e kishte bërë një debat të tillë edhe me një nga gjysmëvëllezërit e tij në Jalalabad. - Maradona ishte mashtrues! "Dora e Zotit", të kujtohet?

- Të gjithë mashtrojnë e të gjithë gënjejnë.

Djali gromësiu dhe u nis të ikte. Ai ishte pothuajse po aq i gjatë sa Adeli, mbase pak më i gjatë dhe mbase kishte edhe të njëjtën moshë, mendoi Adeli. Por ai ecte sikur ishte më

i madh, pa u ngutur, dhe me një pamje sikur kishte parë gjithçka e sikur asgjë s'mund ta habiste më tani.

- Unë quhem Adel.

- Gholam.

Ata tokën duart. Dora e Gholamit ishte gjithë kallo dhe e thatë, shtrëngimin e kishte të fuqishëm.

- Sa vjeç je?

Gholami mblodhi supet.

- Besoj se trembëdhjetë. Mbase katërmbëdhjetë.

- Pse, ti nuk e di se kur ke lindur?

Gholami buzëqeshi.

- Vë bast se ti e di. Vë bast se i numëron ditëlindjet.

- Jo, - u mbrojt Adeli. - E kam fjalën që nuk i numëroj.

- Më duhet të iki. Im atë po pret aty vetëm.

- Unë mendova se ishte gjyshi yt.

- E ke menduar gabim.

- Do që të luajmë me gjuajtje? - e pyeti Adeli.

- Do të thuash me gjuajtje si ato të penalltive?

- Nga pesë secili... si në finale.

Gholami pështyu përsëri, hodhi sytë drejt rrugës dhe pastaj përsëri drejt Adelit. Adeli vuri re se ai kishte një mjekër pak të vogël për fytyrën e tij dhe kishte dy dhëmbë qeni jashtë harkut, njëri prej të cilëve i thyer keq. Vetullën e majtë e kishte të ndarë më dysh nga një vrajë e hollë, e shkurtër. E po ashtu mbante erë të keqe. Por Adeli kishte dy vjet që s'kishte shkëmbyer asnjë fjalë me ndonjë djalë të moshës së vet - për të luajtur as që bëhej fjalë - po të hiqje vizitat që kishte bërë në Jalalabad. Adeli u përgatit për zhgënjimin, por Gholami mblodhi supet dhe iu përgjigj:

- Ta hajë dreqi! E pse jo? Por do të gjuaj unë i pari.

Hapësirën e portës e krijuan me dy gurë, që i vendosën tetë hapa larg njëri-tjetrit. Gholami bëri pesë gjuajtjet e veta. Shënoi një, doli jashtë dy herë dhe në dy rastet e tjera Adeli e priti topin me lehtësi. Gholami si portier ishte edhe më i keq se si lojtar. Adeli ia doli mbanë që të shënonte në katër gjuajtje,

duke e mashtruar e duke e bërë që të hidhej në drejtimin e gabuar dhe gjuajtjen që humbi, as që e nisi për në portë.

- Ta hajë dreqi! - tha Gholami, i përkulur më dysh, me pëllëmbët mbështetur mbi kupat e gjunjëve.

- Do të luajmë përsëri? - Adeli u mundua të mos e shihte me vetëkënaqësi, por e kishte të vështirë. Përbrenda po fluturonte nga gëzimi.

Gholami pranoi dhe rezultati ishte edhe më i thellë. Gholami përsëri shënoi vetëm një herë, kurse Adeli shënoi në të pesta gjuajtjet.

- Boll me kaq, dorëzohem, - tha Gholami, duke ngritur duart lart. Ai u drejtua për te trungu i prerë dhe u ul duke lëshuar një psherëtimë lodhjeje. Adeli mori topin në dorë dhe u ul pranë tij.

- Këto me siguri që s'kanë për të më ndihmuar, - tha Gholami, duke nxjerrë paketën e cigareve nga xhepi i xhinseve. Vetëm një i kishte mbetur. Ai ndezi shkrepësen me një të goditur të kutisë, ndezi cigaren, e thithi fort dhe pastaj ia zgjati Adelit. Adeli deshi ta merrte për një çast, qoftë edhe thjesht për t'i bërë përshtypje Gholamit, por pastaj hoqi dorë, nga frika se Kabiri ose mamaja do t'ia ndienin erën.

- Gjë e mirë, - tha Gholami, duke i dhënë kokës pas.

Ata folën në përgjithësi për futbollin dhe, për habinë dhe kënaqësinë e Adelit, Gholami kishte njohuri të mira. Ata diskutuan për ndeshjen dhe golat më të parapëlqyer. Secili bëri një listë me pesë lojtarët më të mirë sipas tij: në fakt ishin të njëjtët lojtarë, vetëm se në listën e Gholamit gjendej Ronaldo i Brazilit, kurse në atë të Adelit ishte Ronaldo i Portugalisë. Ishte e pamundur të shmangej të folurit për finalen e Kampionatit Botëror të vitit 2006 dhe për incidentin me kokë, që ishte një kujtim i dhembshëm për Adelin. Gholami tha se e kishte parë të gjithë ndeshjen duke qëndruar në këmbë mes një grupi njerëzish përpara një dyqani televizorësh jo shumë larg kampit.

- Kamp?

- Kampi ku jam rritur unë. Në Pakistan.

Ai i tha Adelit se kishte ardhur tani për herë të parë në Afganistan. Deri atëherë kishte jetuar në Pakistan, në kampin e refugjatëve në Jalozai[1)], ku edhe kishte lindur. Ai tha se Jalozai ishte si qytet më vete: një labirint gjigant tendash, shtëpish prej balte, shtëpish me materiale plastike ose llamarina, të ngjitura me njëra-tjetrën e me rrugë të ngushta kalimi, të mbuluara nga balta. Ai ishte një qytet brenda një qyteti të madh. Gholami ishte rritur në kamp tok me të vëllezërit, ai vetë ishte fëmija më i madh dhe kishte tre vjet diferencë me vëllanë tjetër. Ai, të vëllezërit, e ëma, i ati, që quhej Ikbal, dhe e gjyshja, Parvana, kishin jetuar në një shtëpi prej balte. Pikërisht në ato rrugë të ngushta e të pista kishin mësuar ai e të vëllezërit që të ecnin e të flisnin. Atje kishin shkuar edhe në shkollë. Kishin luajtur me shkopinj e me rrotat e ndryshkura të biçikletave, bashkë me fëmijët e refugjatëve të tjerë, derisa dielli perëndonte dhe e gjyshja e thërriste që të hynte brenda.

- Më pëlqente atje, - tha ai. - Atje kisha shokë. I njihja të gjithë. Atje nuk ishim keq. Unë kam xhaxhanë në Amerikë, xhaxha Abdullanë, vëllanë nga babai të tim eti. Nuk e kam takuar kurrë. Por ai na çonte pará që andej çdo muaj. Dhe kjo na ndihmonte. Na ndihmonte shumë.

- E pse ikët prej aty?

- U detyruam të iknim. Pakistanezët e mbyllën kampin. Na thanë që afganët e kanë vendin në Afganistan. Në atë kohë filluam të mos merrnim më as paratë nga xhaxhai. Kështu që im atë tha se mbase mund të ktheheshim në shtëpi e t'ia nisnim nga e para, tani që talebanët kishin kaluar në Pakistan. Ai tha se ne ishim bujtës në Pakistan, që kishin qëndruar më gjatë nga ç'duhej. Unë vërtet u mërzita shumë. Ky vend, - ai bëri shenjë me dorë përreth, - ky vend është i huaj për mua. Edhe

---

1) Një nga kampet më të mëdha të refugjatëve afganë, 35 kilometra larg Peshavarit, që në kulmin e vet mbajti 70 000 njerëz (*shën. i përkth.*).

fëmijët që ishin në kamp, ata që kishin lindur në Afganistan, asnjë prej tyre nuk thoshte një fjalë të mirë për të.

Adeli donte t'i thoshte që e dinte se si ndihej Gholami. Ai donte t'i tregonte atij se sa shumë e kishte marrë malli për Kabulin, për shokët, për gjysmëvëllezërit në Jalalabad. Por pati frikë se Gholami mund të qeshte me të. Kështu që, në vend të kësaj, vetëm tha:

- E po, ky vend është shumë i mërzitshëm.

Por Gholami prapëseprapë qeshi.

- Nuk besoj se ishte kjo ajo që donin të thoshin ata, - tha ai.

Adeli e kuptoi që e kishin vënë në lojë.

Gholami thithi cigaren dhe e nxori tymin në trajtë rrathësh. Dhe të dy panë se si u ngjitën rrathët lart e u prishën në ajër.

- Im atë na tha mua e vëllezërve: "Prisni... prisni sa të thithni ajrin e Shadbagut, djema, e të pini ujin e tij". Im atë ka lindur këtu, dhe këtu është rritur. Ai tha: "Kurrë nuk keni pirë ujë aq të ftohtë dhe aq të ëmbël, djema". Ai na fliste gjithmonë për Shadbagun, që unë besoj se ka qenë thjesht një fshat i vogël, kur ai jetonte këtu. Ai thoshte se Shadbagu kishte një lloj rrushi që rritej vetëm aty dhe në asnjë vend tjetër të botës. Të dukej sikur po përshkruante parajsën.

Adeli e pyeti se ku po qëndronin tani. Gholami shtypi bishtin e cigares, ngriti kokën drejt qiellit dhe po shihte shkëlqimin e tij.

- E di atë fushën pranë mullirit me erë?

- Po. - Adeli priti që ai t'i thoshte diçka më shumë, por tjetri nuk po shtonte asgjë. - Ti jeton në fushë?

- Tani për tani, - mërmëriti Gholami. - Kemi ngritur një tendë.

- Nuk ke njerëz këtu?

- Jo. O kanë vdekur, o kanë ikur që këtu. E po, im atë ka një dajë në Kabul. Ose të paktën e kishte një. Por ne as që e dimë në është ende gjallë. Ishte vëllai i gjyshes sime, punonte për një familje të pasur atje. Por besoj se Nabi dhe gjyshja

ime ka vite që nuk kanë folur me njëri-tjetrin, mbase pesëdhjetë vjet a më shumë. Praktikisht janë të huaj për njëri-tjetrin. Besoj se, po të mos kishte nga t'ia mbante, im atë do të shkonte ta takonte. Por ai do që t'ia dalë mbanë me forcat e veta këtu. Kjo është shtëpia e tij.

Ata kaluan disa çaste në heshtje të ulur në trungun e prerë, duke parë gjethet në pemishtë, që tundeshin nga era e ngrohtë. Adeli po mendonte për Gholamin dhe familjen e tij, që natën flinin në tendë, ndërsa përreth tyre zvarriteshin gjarpërinjtë dhe akrepat.

Adeli nuk e kuptoi as vetë pse ia tha Gholamit shkakun e largimit të familjes së tij nga Kabuli. Ose, më saktë, ai nuk dinte se cila prej arsyeve ishte e vërteta. Ai nuk e dinte në e bëri për t'ia hequr Gholamit përshtypjen se ai bënte një jetë të shpenguar thjesht ngaqë jetonte në një shtëpi të madhe. Por mbase ishte njësoj si në ato rastet kur shokët e klasës shkëmbejnë përvojën e tyre në oborrin e shkollës. Mos ndoshta e bëri nga nevoja që atij t'i vinte keq për të? Apo mos e bëri që të ngushtonte largësinë midis tyre? Ai nuk e dinte. Mbase e bëri për të gjitha këto arsye së bashku. Dhe as nuk e dinte pse i interesonte kaq shumë që Gholami ta pëlqente; ai arrinte në njëfarë mënyre të kuptonte se arsyet e vërteta ishin më të ndërlikuara sesa thjesht ndjenja e shpeshtë e vetmisë ose dëshira për të pasur një shok.

- Ne erdhëm në Shadbag, sepse dikush u përpoq të na vriste në Kabul, - tha ai. - Një ditë, një motoçikletë ndaloi përpara shtëpisë dhe ai që e ngiste, e zbrazi të gjithë karikatorin e armës drejt shtëpisë. Nuk e kapën. Por, falë Zotit, asnjëri prej nesh nuk u lëndua.

Ai nuk dinte se çfarë reagimi duhej të priste, por u habit që Gholami nuk shprehu asgjë. Ende me sytë drejt qiellit, Gholami tha:

- Po, e di.

- E di?

- Njerëzit e marrin vesh edhe kur yt atë kruan hundët.

Adeli e pa ndërsa ai e mblodhi shuk paketën bosh të cigareve dhe e futi në xhepin e përparmë të xhinseve.

- Ai ka armiqtë e vet... babai yt, - psherëtiu Gholami.

Adeli e dinte këtë. Baba xhani i kishte shpjeguar se disa nga njerëzit që kishin luftuar përkrah tij kundër sovjetikëve në vitet 1980, ishin fuqizuar e pasuruar shumë dhe ishin shumë të korruptuar. "Ata kanë dalë nga rruga e drejtë", - kishte thënë ai. Dhe, ngaqë ai nuk pranonte të bashkëpunonte me ta në skemat e tyre kriminale, ata gjithmonë mundoheshin t'i vinin shkopinj nën rrota e t'ia fëlliqnin emrin, duke përhapur thashetheme të rreme e lënduese për të. Dhe prandaj Baba xhani gjithmonë ishte munduar ta mbronte Adelin: për shembull, ai nuk lejonte që gazetat të futeshin në shtëpi dhe nuk donte që Adeli të shihte televizor ose të hynte në internet.

Gholami u përkul përpara e tha:

- Kam dëgjuar po ashtu se ai është thjesht fermer.

Adeli mblodhi supet.

- Mund ta shohësh vetë. Vetëm disa akra me pemishte. E po, edhe fusha e pambukut në Helmand, besoj se për fabrikën.

Gholami po hetonte sytë e Adelit dhe një buzëqeshje iu shpërnda ngadalë në fytyrë, që ia nxori në pah dhëmbin e thyer të qenit.

- Pambuk. Ti qenke fare torollak. S'di ç'të them.

Adeli vërtet nuk e kuptoi këtë përgjigje. Ai u ngrit në këmbë dhe e përplasi topin përtokë.

- Mund të thuash: "Luajmë përsëri".

- Luajmë përsëri!

- Eja.

- Vetëm se, këtë herë, vë bast se s'ke për të bërë asnjë gol.

Tani ishte Adeli ai që po buzëqeshte.

- Me çfarë do ta vësh bastin?

- Shumë e thjeshtë. Me Zidanin.

- Dhe po fitova unë, jo, dhe kur të fitoj unë?

- Po të isha në vendin tënd, - tha Gholami, - nuk do ta vrisja mendjen për një gjë kaq të pamundur.

Ishte një ndeshje e shkëlqyer. Gholami kërceu sa majtas, sa djathtas gjatë gjithë kohës dhe i priti të gjitha gjuajtjet e Adelit. Adeli e hoqi bluzën dhe u ndie si një budalla që po i merrnin atë që ishte e tij, e mbase gjënë më të çmuar që kishte. Por ia zgjati Gholamit. Me një ndjesi alarmi se sytë po i visheshin me lot, megjithatë arriti t'i largonte.

Të paktën Gholami u tregua me takt dhe nuk e veshi përpara syve të tij. Duke u larguar prej aty, ai ktheu kokën dhe i buzëqeshi.

- Yt atë nuk ka ikur për tre muaj, apo jo?

- Do të luajmë nesër përsëri për atë, - tha Adeli. - Për bluzën.

- Të shohim.

Gholami u drejtua për te rruga kryesore. Në gjysmë të rrugës u ndal, nxori nga xhepi paketën e cigareve të bërë shuk dhe e vërviti mbi murin e shtëpisë së Adelit.

Për rreth një javë, çdo ditë, pasi mbaronte mësimet në mëngjes, Adeli merrte topin dhe dilte nga shtëpia. Dy herët e para ia doli mbanë të përvidhej në kohën kur po ndërroheshin rojat e armatosura. Por herën e tretë njëri prej tyre e kapi dhe nuk donte ta linte të dilte. Adeli hyri përsëri brenda në shtëpi dhe u kthye me një *iPod* dhe një orë dore. Që nga ai çast, roja nisi ta lejonte që të hynte e të dilte, me kusht që djali të mos shkonte më larg se brezi i parë i pemishtës. Për sa i përket Kabirit e së ëmës, ata pothuajse nuk e vinin re fare mungesën e tij për një a dy orë. Kjo ishte një nga përparësitë e të jetuarit në një shtëpi aq të madhe sa e tij.

Adeli luante vetëm prapa vilës, pranë trungut të vjetër të prerë, duke shpresuar çdo ditë që ta shihte Gholamin duke u çapitur drejt tij. Ai e kontrollonte vazhdimisht rrugën e pashtruar

që të nxirrte në xhade, teksa hidhte e priste topin në ajër, teksa rrinte ulur në trungun e prerë duke kundruar ndonjë avion luftarak që fluturonte në qiell, teksa hidhte andej-këndej gjithë përtesë guralecë. Pas njëfarë kohe, merrte topin dhe kthehej kokulur brenda në vilë.

Por më në fund ja tek u duk Gholami, me një qese letre në dorë.

- Ku ke qenë?

- Në punë, - u përgjigj Gholami.

Ai i tha Adelit se bashkë me të atin kishin gjetur një punë për disa ditë: i ati si përgatitës tullash, Gholami për përgatitjen e llaçit. I tregoi se si shkonte e vinte me kovat me ujë, si mbante thasët me çimento e me rërë, që ishin më të rëndë se ai vetë. I shpjegoi gjithashtu se si e përgatiste llaçin në një karrocë dore: ai e përziente masën e formuar me shat, vazhdimisht e vazhdimisht, mandej shtonte ujë e pastaj rërë dhe vazhdonte ta përziente derisa formohej një masë e trashë dhe e squllët, jo e ujshme. Pas kësaj e çonte karrocën pranë muratorëve dhe ia niste përzierjes nga e para. Ai hapi duart dhe i tregoi Adelit flluskat në pëllëmbët e tij.

- Uau! - ia bëri Adeli. E kuptoi edhe vetë që u soll si budalla, por nuk diti si të reagonte ndryshe. E vetmja punë krahu që kishte bërë ndonjëherë, ishte ndihma që i kishte dhënë, tre vjet më parë, kopshtarit të tyre në Kabul për të mbjellë disa fidanë mollësh.

- Kam një surprizë për ty, - i tha Gholami. Futi dorën në qesen e letrës dhe nxori prej aty fanellën e Zidanit.

- Nuk po e kuptoj, - i tha Adeli, i habitur dhe i magjepsur njëherazi.

- Ia pashë dje një djali në qytet, - tha Gholami, duke i bërë shenjë që t'ia hidhte topin. Adeli e gjuajti me këmbë në drejtim të tij dhe Gholami nisi ta hidhte e ta priste në ajër ndërsa i rrëfente ç'kishte ndodhur. - A e beson dot? Unë iu afrova dhe i thashë: "Hej, ajo është bluza e shokut tim". Kurse ai më hodhi një vështrim që.... Që t'i bie shkurt, e lamë ta

zgjidhnim problemin në një rrugicë të ngushtë. Erdhi puna që, në fund, ai po më lutej vetë që ta merrja fanellën! - Ai e kapi topin në ajër, pështyu në tokë dhe i buzëqeshi Adelit. - E po, mbase ia kisha shitur unë vetë disa ditë më parë.

- Nuk është e drejtë. Po qe se ia kishe shitur, ishte e tij.

- Çfarë? Do të thuash se nuk e do? Pas gjithë asaj që bëra për të ta kthyer? Nuk është se e rraha vetëm unë. Edhe ai më dha ca grushte të mira.

- Por prapë..., - mërmëriti Adeli.

- Veç kësaj, unë të punova një rreng në fillim, dhe për këtë më vjen keq. Kështu që tani po ta kthej fanellën. Sa për mua..., - ai bëri me shenjë drejt këmbëve të veta dhe Adeli pa një palë atlete të reja bardheblu.

- A është mirë ai djali? - pyeti Adeli.

- Do të mbijetojë. Tani, si e ke punën, do të grindemi apo do të luajmë?

- Ka ardhur edhe babi yt bashkë me ty?

- Sot jo. Ka shkuar në gjykatë në Kabul. Eja të luajmë tani.

Ata luajtën për pak kohë, duke ia pasuar topin njëri-tjetrit e duke vrapuar nëpër fushë pas tij. Pastaj shëtitën pak. Adeli e theu premtimin që i kishte bërë rojës dhe hyri tok me Gholamin në pemishtë. Aty hëngrën muçmolla dhe pinë *fanta* nga kanaçja që kishte marrë Adeli fshehurazi në kuzhinë.

Shumë shpejt, djemtë nisën të takoheshin kështu çdo ditë. Luanin futboll, luanin e ka kush e ka nëpër rreshtat paralelë të pemëve, flisnin për sportin e filmat dhe, kur nuk kishin ç'të thoshin më, shihnin qytetin Shadbag-e-Nau, kodrat e buta aty larg dhe vargun e mjegullt të maleve diku edhe më larg, çka, edhe kjo, u dukej gjë e bukur.

Tani Adeli çohej çdo mëngjes me padurimin për t'u takuar me Gholamin dhe përshkonte rrugën gjithë pluhur, për të dëgjuar zërin e tij të lartë e tërë vetëbesim. Shumë shpesh nuk e kishte fare mendjen në mësim, shpërqendrohej ndërsa mendonte për lojërat që do të luanin më vonë, për historitë që

do t'i rrëfenin njëri-tjetrit. Atë e shqetësonte ideja se mund ta humbiste Gholamin. E shqetësonte fakti që i ati i Gholamit, Ikbali, mund të mos gjente punë ose një vend për të jetuar në këtë qytet dhe mund të detyrohej të ikte prej aty, të shkonte në një tjetër qytet, në një tjetër skaj të vendit. Adeli mundohej ta përgatiste veten për këtë çast, mundohej të bëhej i fortë për të përballuar lamtumirën që do ta pasonte këtë.

Një ditë, ndërsa qëndronin ulur në trungun e pemës, Gholami i tha:

- A ke shkuar ndonjëherë me ndonjë vajzë, Adel?

- E ke fjalën...

- Po, atë po them...

Adeli ndjeu t'i skuqeshin veshët. Për një çast mendoi të gënjente, por ai e dinte se Gholami arrinte t'ia lexonte mendjen. Vetëm mërmëriti:

- Po ti?

Gholami ndezi një cigare dhe i zgjati një edhe Adelit. Këtë herë ky e mori, por hodhi një herë sytë pas shpinës së tij, për të kontrolluar se mos ishte shfaqur roja te cepi i murit ose se mos Kabirit i ishte shkrepur të dilte jashtë. Ai e thithi një herë dhe në çast e zuri një kollë e zgjatur, çka e bëri Gholamin të zgërdhihej e t'i binte në shpinë.

- Domethënë, as ti nuk ke shkuar? - belbëzoi Adeli, me sytë të mbushur me lot.

- Kisha një shok në kamp, - tha Gholami, me zë fare të ulët, sikur po thurte ndonjë komplot, - ai ishte më i madh se unë. Më çoi në një shtëpi publike në Peshavar.

Dhe ia tregoi historinë. Dhoma e vogël, tejet e pistë. Perdet portokallí, muret e plasaritura, llamba e vetme që varej nga tavani, miu që kishte parë të vraponte në dysheme. Zhurma e *rikshave*[1] që venin e vinin jashtë në rrugë, makinat që u binin borive. Vajza e re në dyshek, që po hante një pjatë

1) Karroca për transportim njerëzish, të tërhequra nga biçikleta ose nga njerëz (*shën.i përkth.*).

*ani*[1], duke u përtypur e duke parë nga ai pa kurrfarë
ehjeje në fytyrë. Ai arrinte të shquante, edhe nën atë dritë
ehtë, se ajo kishte një fytyrë të bukur dhe zor se ishte më
adhe se ai. Ajo e kishte fshirë edhe kokrrën e fundit të
it me *naan*, e kishte shtyrë pjatën, ishte shtrirë në shtrat
i kishte fshirë gishtat në pantallona, ndërsa po i hiqte.

Adeli e dëgjonte si i magjepsur, i përthithur nga rrëfimi.
urrë nuk kishte pasur një shok të tillë. Gholami e njihte
n shumë më mirë se vëllezërit e tij nga babai, që ishin disa
më të mëdhenj se ai. Kurse, për sa u përket shokëve të tij
abul, ata ishin të gjithë fëmijë burokratësh, nëpunësish e
istrash. Të gjithë bënin variante të ndryshme të po asaj
që bënte edhe Adeli. Ato copëza nga jeta e vet që Gholami
hte rrëfyer Adelit, flisnin për një njëmendje gjithë trazira,
aparashikueshme, të vështirë, por njëherazi të mbushur
aventura, një jetë në një botë të cilën Adelit ia mbanin
, edhe pse ajo shpalosej vetëm disa hapa larg tij. Duke
juar historitë e Gholamit, Adelit, shpesh, jeta e vet i dukej
t e mërzitshme.

- Pra, e bëre? - i tha Adeli. - A e... domethënë, ia fute?

- Jo. Pimë nga një filxhan çaj dhe folëm për Rumiun. E
si thua ti?

Adeli u skuq.

- E si ishte?

Por Gholami kishte kaluar ndërkaq në një tjetër histori.
ndodhte shpesh, kur flisnin bashkë: ishte Gholami ai që e
dhte temën e bisedës, që fillonte një histori shumë inte-
nte, e bënte Adelin të përthithej i tëri pas saj, por ai vetë e
biste interesin e hidhej në një tjetër temë, ndërsa Adeli
tej si i varur në ajër.

Dhe tani, në vend që ta përfundonte historinë që kishte
r, Gholami tha:

- Gjyshja më ka thënë që burri i vet, gjyshi im, Sabori, i

---

[1] oj gjelle me oriz e me mish (*shën. i përkth.*).

*biryani*[1], duke u përtypur e duke parë nga ai pa kurrfarë shprehjeje në fytyrë. Ai arrinte të shquante, edhe nën atë dritë të zbehtë, se ajo kishte një fytyrë të bukur dhe zor se ishte më e madhe se ai. Ajo e kishte fshirë edhe kokrrën e fundit të orizit me *naan*, e kishte shtyrë pjatën, ishte shtrirë në shtrat dhe i kishte fshirë gishtat në pantallona, ndërsa po i hiqte.

Adeli e dëgjonte si i magjepsur, i përthithur nga rrëfimi. Ai kurrë nuk kishte pasur një shok të tillë. Gholami e njihte botën shumë më mirë se vëllezërit e tij nga babai, që ishin disa vjet më të mëdhenj se ai. Kurse, për sa u përket shokëve të tij në Kabul, ata ishin të gjithë fëmijë burokratësh, nëpunësish e ministrash. Të gjithë bënin variante të ndryshme të po asaj jete që bënte edhe Adeli. Ato copëza nga jeta e vet që Gholami i kishte rrëfyer Adelit, flisnin për një njëmendje gjithë trazira, të paparashikueshme, të vështirë, por njëherazi të mbushur me aventura, një jetë në një botë të cilën Adelit ia mbanin larg, edhe pse ajo shpalosej vetëm disa hapa larg tij. Duke dëgjuar historitë e Gholamit, Adelit, shpesh, jeta e vet i dukej krejt e mërzitshme.

- Pra, e bëre? - i tha Adeli. - A e... domethënë, ia fute?

- Jo. Pimë nga një filxhan çaj dhe folëm për Rumiun. E po, si thua ti?

Adeli u skuq.

- E si ishte?

Por Gholami kishte kaluar ndërkaq në një tjetër histori. Kjo ndodhte shpesh, kur flisnin bashkë: ishte Gholami ai që e zgjidhte temën e bisedës, që fillonte një histori shumë interesante, e bënte Adelin të përthithej i tëri pas saj, por ai vetë e humbiste interesin e hidhej në një tjetër temë, ndërsa Adeli mbetej si i varur në ajër.

Dhe tani, në vend që ta përfundonte historinë që kishte nisur, Gholami tha:

- Gjyshja më ka thënë që burri i vet, gjyshi im, Sabori, i

---

1) Lloj gjelle me oriz e me mish (*shën. i përkth.*).

kishte treguar dikur një histori për këtë pemën këtu. Normale, shumë kohë përpara se ta priste, sigurisht. Gjyshi ia kishte treguar atë histori, kur kishin qenë që të dy fëmijë. Dhe, sipas kësaj historie, po qe se kishe ndonjë dëshirë, duhej të uleshe në gjunjë përpara pemës dhe ta pëshpëritje atë. Dhe, po qe se pema pranonte të ta plotësonte, do të lëshonte mbi kokën tënde dhjetë gjethe të vogla.

- Nuk e kam dëgjuar kurrë këtë, - tha Adeli.

- E po, s'kishe si ta dëgjoje, apo jo?

Vetëm tani Adeli e kuptoi se çfarë kishte dashur të thoshte Gholami.

- Prit. Gjyshi yt e preu pemën tonë?

Gholami u kthye nga ai.

- Pemën tuaj? Kjo nuk është pema juaj.

Adeli puliti sytë.

- Ç'do të thuash?

Gholami ia nguli sytë fort Adelit. Dhe ky, për herë të parë, nuk pa asnjë gjurmë nga ajo gjallëria e zakonshme e shokut të tij, asnjë lloj buzëqeshjeje a nënqeshjeje djallëzore. Fytyra e tij ishte shndërruar: kishte marrë një shprehje të zymtë, si fytyra e një të rrituri.

- Kjo ka qenë pema e familjes sime. Ka qenë toka e familjes sime kjo. Ka qenë jona brez pas brezi. Babai yt e ndërtoi vilën e tij në tokën tonë. Kur ne ishim në Pakistan, gjatë luftës. - Ai bëri me gisht drejt pemishtës. - Aty... aty ka patur shtëpi. Por yt atë u futi buldozerin dhe i rrafshoi plotësisht. Ashtu siç rrafshoi edhe shtëpinë ku ka lindur im atë, ku është rritur. - Adeli puliti qepallat. - Ai e mori për vete tokën tonë dhe ndërtoi atë, - zëri i tij mori një nuancë tallëse, ndërsa bënte me gisht drejt vilës, - atë gjënë atje.

Me një ndjenjë përzierjeje në stomak, me zemrën që po i rrihte fort në kraharor, Adeli tha:

- Unë kujtoja se ishim shokë. Pse po m'i thua këto gënjeshtra të tmerrshme?

- A të kujtohet kur të mashtrova dhe të mora fanellën e

Zidanit? - tha Gholami, ndërsa faqet iu skuqën. - Gati sa s'ia plase të qarit. Mos e moho. Dhe të mendosh: vetëm për një bluzë. Një bluzë. Pa mendo pak si u ndie familja ime, që bëri gjithë atë rrugë që nga Pakistani, për të zbritur nga autobusi e pastaj për të gjetur këtë gjënë këtu, në tokën tonë! Dhe atë demin tuaj me kostum rozë, që na përzinte nga toka jonë.

- Babai im nuk është hajdut! - ia plasi Adeli. - Pyeti njerëzit e Shadbag-e-Naut, ik e pyeti se çfarë ka bërë ai për këtë qytet.

- Ai mendoi për mënyrën se si i priste Baba xhani njerëzit në xhaminë e qytetit, i ulur përdhe, me një filxhan çaji përpara, me tespihet në dorë. Një radhë solemne njerëzish, që zgjatej që nga jastëku përballë tij e deri te dera e jashtme: njerëz me duar gjithë baltë, plaka pa dhëmbë, vejusha të reja me fëmijë, të gjithë në hall e në nevojë për diçka, të gjithë duke pritur radhën që t'i kërkonin një favor, një punë, një hua të vogël për të riparuar çatinë ose një kanal kullues, ose pak pará për ndonjë nevojë të tyre. Dhe i ati që tundte kokën, që i dëgjonte të gjithë me shumë durim, a thua se çdo njeri në atë radhë ishte një i afërm i tij.

- Ou?! Atëherë si shpjegohet që im atë ka dokumentin e pronësisë? - tha Gholami. - Atë që ia dha gjykatësit?

- Jam i sigurt që, po të flasë babi yt me babin tim...

- Yt atë nuk pranon të flasë me të. Sepse nuk e pranon atë që ka bërë. Ai na kalon pranë me makinë si të jemi qen rrugësh.

- Ju nuk jeni qen, - tha Adeli. Tani nuk po arrinte ta ruante më qetësinë në zë. - Ju jeni grabitqarë! Tamam ashtu siç tha Kabiri. Dhe unë duhej ta kisha besuar.

Gholami u ngrit në këmbë, bëri një hap përpara, pastaj një tjetër e më pas u ndal.

- Vetëm sa për ta ditur, - i tha ai, - unë nuk kam asgjë me ty. Ti je thjesht një djalë i vogël injorant. Por herën tjetër që yt atë do të niset për në Helmand, pyete pak se çfarë fabrike ka atje. Shko shikoje se çfarë ka mbjellë ai atje. Dhe po të jap një ndihmë: nuk është pambuk.

Më vonë atë mbrëmje, përpara darkës, Adeli po qëndronte shtrirë në vaskën e mbushur me ujë të ngrohtë e shkumë sapuni. Nga kati i parë vinte zëri i lartë i televizorit: Kabiri po shihte një film me piratë. Zemërimi që e kishte pushtuar atë pasdite, ishte shuar tashmë dhe Adeli po mendonte se ishte treguar shumë i ashpër me Gholamin. Baba xhani i kishte thënë një herë se, pavarësisht nga ajo që bën për të varfrit, ndonjëherë këta flasin keq për të pasurit. Në përgjithësi e bëjnë thjesht ngaqë janë të zhgënjyer nga jeta e tyre. Kjo s'mund të ndryshohet. Është më se e natyrshme. "Dhe ne nuk duhet t'i bëjmë me faj, Adel,"- kishte thënë ai.

Adeli nuk ishte aq naiv, sa të mos e kuptonte që bota nuk ishte një vend i drejtë: mjaftonte të hidhte sytë jashtë dritares së dhomës së tij. Por, mendonte ai, një e vërtetë e tillë nuk u mjaftonte njerëzve si Gholami. Mbase ata kishin nevojë për një shënjestër, një shënjestër prej mishi e gjaku, që të mund ta tregonin me gisht si përgjegjësin për jetën e tyre të vështirë, që të mund ta shanin, ta fajësonin, të shfrynin dufin e tyre. Dhe mbase Baba xhani kishte të drejtë, kur thoshte se ky ishte një reagim që duhej ta kuptonin, që nuk duhej ta gjykonin. Madje duhej t'u përgjigjeshin me dashamirësi. Ndërsa shihte flluskat e sapunit që ngriheshin në sipërfaqe dhe kërcenin në ajër, Adeli mendoi për të atin, që po ndërtonte shkolla dhe klinika, ndërkohë që e dinte se çfarë thashethemesh të liga përhapnin njerëzit e qytetit për të.

Ndërsa po fshihej me peshqir, e ëma futi kokën në banjë.

- Do të vish poshtë të hamë darkë?

- Nuk më hahet, - i tha ai.

- Oh! - Ajo hyri brenda dhe mori një peshqir në sirtar. - Këtu. Ulu. Më lër të të fshij kokën.

- E bëj vetë, - i tha Adeli.

Ajo ndenji pas tij, duke vrojtuar fytyrën e tij në pasqyrë.

- Je mirë, Adel?

Ai mblodhi supet.

E ëma mbështeti njërën dorë mbi supin e tij dhe po e

shihte sikur po priste që ai ta fërkonte faqen pas saj. Por ai nuk e bëri.

- Mami, a e ke parë ti fabrikën e Baba xhanit?

Ai vuri re se si e ëma ngriu për një çast.

- Sigurisht, - i tha ajo. - Edhe ti e ke parë.

- S'po them në fotografi. A e ke parë në të vërtetë? A ke qenë atje?

- E si mund të shkoj unë atje?! - i tha e ëma, duke anuar paksa kokën. - Helmandi nuk është vend i sigurt. Yt atë nuk do të na çonte kurrë në një vend ku mund ta pësojmë.

Adeli pohoi me kokë.

Nga kati i parë erdhën shpërthimet e topave dhe britmat e piratëve që po hidheshin në sulm.

Tri ditë më vonë, Gholami u duk përsëri. Ai eci me hapa të shpejtë drejt Adelit dhe ndaloi përpara tij.

- Më vjen mirë që erdhe, - i tha Adeli. - Të kam sjellë diçka. - Ai ngriti nga trungu i pemës pallton që e kishte sjellë këtu me vete çdo ditë pas zënkës së tyre. Ishte një pallto lëkure ngjyrëçokollatë, me jakë me lesh deleje të butë dhe një kapuç që mund t'i hiqej e t'i vihej me zinxhir. Dhe ia zgjati Gholamit. - E kam veshur vetëm nja dy herë. Më rri pak e madhe. Por ty duhet të të bëjë.

Gholami nuk bëri asnjë lëvizje.

- Dje morëm autobusin për në Kabul dhe shkuam në gjykatë, - tha ai me zë të thatë. - E gjen dot se çfarë na tha gjykatësi? Ai tha se kishte lajme të këqija. Na tha se kishte ndodhur një aksident. Një zjarr i vogël. Dhe dokumentet e pronësisë së tim eti ishin djegur aty. Nuk ishin më. Ishin shkrumbosur... zhdukur, - dora e Adelit që mbante pallton, u lëshua poshtë ngadalë. - Dhe, kur ai po na thoshte se s'mund të bënte asgjë pa ato letra, e di se çfarë kishte në dorë? Një orë të re fringo prej floriri, markë e fundit, që nuk e kishte pasur herën tjetër, kur e kishte takuar im atë.

Adeli puliti sytë.

Gholami hodhi sytë mbi pallton. Ishte një vështrim therës,

akuzues, një vështrim që donte ta bënte tjetrin me turp. Dhe ia doli mbanë. Adeli u mpak. Palltoja në dorën e tij u shndërrua nga një dhuratë pajtimi në një ryshfet.

Gholami i ktheu shpinën dhe u drejtua për te rruga e pashtruar me hapa të shpejtë e të prerë.

Atë ditë që u kthye, Baba xhani organizoi në mbrëmje një festë në shtëpi. Adeli rrinte ulur pranë të atit, përpara një pecete të madhe, që e kishin shtruar në dysheme për të ngrënë. Baba xhanit i pëlqente që herë pas here të ulej në dysheme e të hante me gishta, veçanërisht atëherë kur takonte shokët e tij të viteve të xhihadit. "Më kujton ditët që kam kaluar nëpër shpella," - qeshte ai. Gratë po hanin në dhomën e ngrënies, me thika e pirunë, në tryezë, në krye të së cilës ishte ulur e ëma e Adelit. Adeli i dëgjonte bisedat e tyre, që kumbonin në muret prej mermeri. Njëra prej tyre, një grua me flokë të gjatë të kuq, ishte fejuar me njërin nga shokët e Baba xhanit dhe do të martohej së shpejti me të. Pak më herët ajo i kishte treguar mamasë së Adelit, në aparatin fotografik dixhital, fotografitë e një dyqani me fustane nusesh që kishin parë në Dubai.

Teksa pinin çajin pas darke, Baba xhani po u tregonte të ftuarve se si kishte sulmuar njësia e tij një kolonë sovjetikësh në veri të vendit, që të mos i lejonte të hynin në luginë. Të gjithë po e dëgjonin me shumë vëmendje.

- Kur ata hynë në shënjestrën e armëve tona, - tha Baba xhani, duke ia përkëdhelur lehtë kokën Adelit, - ne hapëm zjarr. Qëlluam makinën që printe kolonën, pastaj disa xhipa. Mendova se ata do të prapseshin ose do të mundoheshin të çanin përpara. Por ata bij kurvash ndaluan, zbritën nga makinat dhe filluan të na qëllonin me pushkë. E besoni dot? - Nëpër dhomë u përhap një mërmërimë. Kokët e pranishme nisën të tundeshin në shenjë mohimi. Adeli e dinte se të paktën gjysma

e burrave në atë dhomë kishin qenë dikur muxhahedinë. - Ne ishim më të shumtë në numër, mbase tre me një, por ata kishin armatime të rënda dhe shumë shpejt do të fillonin t'i përdornin edhe ato. Do të na qëllonin aty, ashtu siç ishim, të fshehur pas pemëve. Kështu që shpejt e shpejt ia mbathëm me të katra. Po iknim të shpëtonim kokën. Unë dhe një djalë, Muhamed a si quhej, po vraponim pranë njëri-tjetrit. Po vraponim krah për krah në një fushë me rrush, jo nga ai i hardhive, por nga ai lloji që njerëzit e mbjellin në vresht. Plumbat na fishkëllenin nga të katër anët... ne po vraponim për të shpëtuar dhe befas që të dy u penguam e u rrëzuam. Pa kaluar as një sekondë, unë brofa prapë në këmbë e po vrapoja, por s'po ma zinte më syri atë Muhamedin, a si quhej. U ktheva e i bërtita: "Ngrihu, o gomar!" - Baba xhani heshti për një çast, që të krijonte efekt më të madh dramatik. Ai e vuri grushtin përpara gojës, që të mposhtte të qeshurën. - Dhe ja ku kërceu përpjetë ai dhe filloi të vraponte përsëri. Dhe, e besoni dot? Ai bir kurve i çmendur i kishte mbushur krahët me rrush! Nga një mal me rrush në secilin krah!

Shpërthyen të qeshurat. Qeshi edhe Adeli. I ati i fërkoi shpinën dhe e afroi pranë vetes. Dikush nisi të tregonte një ngjarje tjetër dhe Baba xhani zgjati dorën drejt paketës së cigareve pranë pjatës së tij, por nuk arriti ta ndizte, sepse befas u dëgjua një xham që u thye diku brenda shtëpisë.

Në dhomën e ngrënies, gratë nisën të ulërinin. Diçka metalike, mbase një pirun, a mbase një thikë gjalpi, u përplas me tingëllimë në dyshemenë prej mermeri. Burrat kërcyen në këmbë. Azmarai dhe Kabiri hynë me vrap në dhomë, me pushkët gati.

- Erdhi nga hyrja, - tha Kabiri. Dhe, ndërsa ai fliste, u dëgjua një tjetër thyerje xhami.

- Prit këtu, Komandant *Sahib*, po shkojmë ne të shohim, - tha Azmarai.

- Ta hajë dreqi, jo! - buluriti Baba xhani, që po bënte me

ngut përpara. - Nuk kam ndër mend të fshihem në shtëpinë time unë!

Ai u drejtua për te holli, i ndjekur pas nga Adeli, Azmarai, Kabiri dhe të gjithë burrat e ftuar. Rrugës, Adeli pa Kabirin që mori në dorë mashën metalike që përdornin në dimër për të prushitur zjarrin në sobë. Pa edhe të ëmën, që vrapoi drejt tyre, me fytyrë të prerë e të zbehtë. Kur mbërritën në holl, një gur hyri fluturimthi nga dritarja dhe copat e xhamit ranë në dysheme. Gruaja me flokë të kuq, ajo që do të martohej së shpejti, ia dha ulërimës. Jashtë, dikush po bërtiste.

- Si dreqin arritën t'i përvidhen rojës? - tha dikush pas shpinës së Adelit.

- Komandant *Sahib*, jo! - buluriti Kabiri. Por i ati i Adelit e kishte hapur ndërkaq derën e jashtme.

Drita po zbehej, por ishte verë dhe qielli ende ndriçohej nga një dritë e verdhë e zbehtë. Adeli pa dritat e vogla që kishin nisur të vezullonin në Shadbag-e-Nau: njerëzit po uleshin të darkonin bashkë me familjet e tyre. Kodrat që zgjateshin në horizont, ishin errësuar dhe shumë shpejt nata do t'i gllabëronte majat e tyre. Por ende nuk ishte errësuar plotësisht, nuk ishte errësuar ende aq shumë sa për të mos e lejuar Adelin që të shihte plakun që po qëndronte në këmbë te shkallët e shtëpisë, me një gur në secilën dorë.

- Çoje lart! - i tha Baba xhani përmbi sup mamasë së Adelit. - Tani!

Mamaja e kapi Adelin për supesh dhe e ngjiti nëpër shkallë, pastaj nëpër korridor e më në fund hynë në dhomën e gjumit, ku flinin ajo e Baba xhani. Ajo e mbylli derën me çelës, mbylli perdet dhe ndezi televizorin. Pastaj e afroi Adelin te shtrati dhe u ulën që të dy aty. Në ekran, dy arabë, të veshur me bluza të gjera e të gjata dhe kapuça të ngushtë, po merreshin me një kamion gjigant.

- Çfarë do t'i bëjë ai atij plakut? - pyeti Adeli, ndërsa po dridhej i tërë. - Mami, çfarë do t'i bëjë ai atij?

Djali e vështroi të ëmën, vuri re renë e zezë që mbuloi

fytyrën e saj, dhe befas e kuptoi, e kuptoi në çast se çfarëdo që të nxirrte ajo nga goja tani, nuk do të ishte aspak e besueshme.

- Ai do të flasë me të, - iu përgjigj ajo duke u dridhur. - Do të arsyetojë me të për çfarëdolloj gjëje qoftë. Këtë bën babai yt. Ai i bën njerëzit të arsyetojnë.

Adeli mohoi me kokë. Tani po qante, me dënesë.

- Çfarë do t'i bëjë, mami?! Çfarë do t'i bëjë ai atij plakut?

Mamaja vazhdonte të përsëriste të njëjtën gjë: që gjithçka do të shkonte më së miri, që ai do ta zgjidhte problemin, që nuk do të lëndohej askush. Por, sa më shumë që e përsëriste ajo këtë, aq më shumë dëneste ai, derisa kjo e lodhi plotësisht dhe erdhi një çast që e zuri gjumi mbi prehrin e së ëmës.

*"Një komandant i dikurshëm arrin t'i shpëtojë përpjekjes për ta vrarë."*

Adeli e lexoi artikullin në studion e të atit, në kompjuterin e të atit. Artikulli e përshkruante sulmin si "të ashpër" dhe sulmuesin si një refugjat të dikurshëm "që dyshohej se kishte lidhje me talebanët". Aty nga mesi i artikullit ishin cituar edhe fjalët e të atit të Adelit, që thoshte se ishte trembur për familjen e vet. "Në mënyrë të veçantë për djalin tim të vogël e të pafajshëm", - kishte thënë ai. Në artikull nuk përmendej emri i atij që e kishte sulmuar, dhe as se ç'ishte bërë me të.

Adeli e mbylli kompjuterin. Ai nuk duhej ta përdorte atë, tani i kishte shkelur rregullat duke hyrë në dhomën e të atit. Një muaj më parë, ai as që do të kishte guxuar të hynte aty. U kthye në dhomën e vet, u shtri në shtrat dhe nisi të përplaste topin e vjetër të tenisit pas murit. Bamp! Bamp! Bamp! Pak çaste më pas e ëma futi kokën në dhomë dhe e pyeti ç'po bënte e mandej i tha ta ndalte atë marifet, por ai nuk iu bind. Ajo qëndroi e mbështetur pas derës për disa çaste, pastaj u largua.

Bamp! Bamp! Bamp!

Në dukje, asgjë nuk kishte ndryshuar. Po qe se veprimtaritë e përditshme të Adelit do të mbaheshin shënim, do të shihej se ai i ishte kthyer përsëri ritmit të zakonshëm: përsëri zgjohej në të njëjtën orë, lahej, hante mëngjesin bashkë me prindërit, bënte mësimet me mësuesin privat. Pas kësaj hante drekë dhe e kalonte pasditen duke u vërdallosur nëpër shtëpi, duke parë filma me Kabirin ose duke luajtur lojëra elektronike.

Por në të vërtetë asgjë nuk ishte më si më parë. Mbase ishte Gholami që e kishte shqyer derën përpara tij, por ama ishte Baba xhani ai që e kishte shtyrë të kalonte nëpër të. Tani makineritë e përgjumura në trurin e Adelit ishin vënë në lëvizje. Ai ndihej sikur, brenda natës, kishte fituar edhe një shqisë të gjashtë, që e ndihmonte të perceptonte gjërat që nuk i kishte vënë re kurrë më parë, edhe pse i kishte pasur përpara syve gjatë gjithë atyre viteve. Ai shihte, për shembull, se sa shumë sekrete ruante përbrenda e ëma. Ia lexonte në fytyrë sa herë që e hidhte vështrimin nga ajo. E ndiente se si mundohej ajo t'i mbante të fshehura prej tij gjërat që dinte, t'i mbante të kyçura mirë, me shumë kujdes, t'i ruante me syçeltësi, ashtu siç ndodhte me ata të dy në shtëpinë e madhe. Për herë të parë ai arriti ta shihte shtëpinë e të atit ashtu siç ishte ajo në të vërtetë: e përçudshme, e turpshme, një monument padrejtësie, ashtu siç e shihnin të gjithë të tjerët, por nuk e shprehnin me zë të lartë. Ai shihte njerëzit që nguteshin për t'i bërë qejfin Baba xhanit, dhe dallonte tek ata frikën, tmerrin, që fshiheshin realisht nën mënyrat se si ia bënin respektin dhe nderimet. Dhe mendoi se Gholami do të kishte qenë krenar për të që më në fund arriti t'i kuptonte këto gjëra. Për herë të parë, Adeli e kuptoi plotësisht se çfarë lëvizjesh gjigante e kishin qeverisur gjithmonë jetën e tij.

Dhe kuptoi, po ashtu, edhe sa kontradiktore ishin të vërtetat që strehoheshin brenda një njeriu të vetëm. Jo vetëm tek i ati, tek e ëma ose te Kabiri.

Por edhe brenda atij vetë.

Dhe kjo e fundit ishte, në njëfarë mënyre, gjëja që e habiti më shumë Adelin. Ajo ç'kishte zbuluar tani, ajo që kishte bërë i ati, në fillim në emër të xhihadit e më pas për atë që ai e quante "shpërblimi i drejtë për sakrificën", e kishte tronditur Adelin. Të paktën për pak kohë. Për ditë me radhë qysh prej asaj mbrëmjeje kur gurët fluturuan drejt dritareve të shtëpisë, Adelit niste t'i dhembte stomaku, sa herë që i ati hynte në dhomën e tij. Ai e shihte të atin si bulurinte në telefonin e tij celular, madje e dëgjonte edhe duke mërmëritur në banjë, dhe e ndiente se si i tkurrej shtylla kurrizore e i thahej fyti, aq sa i shkaktonte dhembje. I ati e puthte për t'i uruar natën e mirë, por instinkti e shtynte Adelin që t'i largohej. Natën shihte ëndrra-makthe. I bëhej sikur qëndronte në buzë të pemishtës e shihte një njeri që po e rrihnin: vezullimi i një mashe metalike që ngrihej e ulej, zhurma e metalit që përplasej pas mishit e kockave. Ai zgjohej nga këto ëndrra me një ulërimë të cilën e mbyste në kraharor. Dhe herë pas here e pushtonte dënesa.

Por prapë.

Por prapë.

Kishte ndodhur edhe diçka tjetër. Ajo që ai kishte zbuluar kohët e fundit, nuk ishte zbehur në mendjen e tij, por thjesht i kishte hapur vendin edhe diçkaje tjetër, që të rritej pranë saj. Një tjetër rrymë ndërgjegjeje, e kundërt me të parën, përshkonte mendjen e tij tani, një rrymë që nuk ia zinte vendin së parës, por kishte gjetur hapësirën e vet përkrah saj. Adeli e ndiente se si po zgjohej kjo pjesë tjetër, pjesa më turbulluese e vetes së tij. Kjo pjesë që, me kalimin e kohës, dalëngadalë e thuajse pa u kuptuar fare, do ta pranonte këtë identitet të ri, që në ato çaste po e shponte si një fanellë prej leshi të papërpunuar e veshur drejt e në mish. Adeli e kuptoi se, në fund të fundit, ai do t'i pranonte gjërat, ashtu siç kishte bërë edhe e ëma. Në fillim ai ishte zemëruar me të, por tani e ndiente që po e falte. Ndoshta ajo e kishte pranuar të shoqin nga frika. Ose mbase si një çmim që duhej paguar për të bërë atë jetë luksoze. Por, mbi të gjitha - dyshonte Adeli - ajo e kishte pranuar atë për të

njëjtën arsye që po e pranonte edhe ai: sepse duhej ta bënte këtë. E ç'zgjidhje tjetër kishte?! Adeli nuk mund të arratisej nga jeta e vet, ashtu si edhe Gholami nuk mund të arratisej nga e tij. Njerëzit mësoheshin të bashkëjetonin me gjëra nga më të paimagjinueshmet. Ashtu siç do të bënte ai. Kjo ishte jeta e tij. Kjo ishte nëna e tij. Ky ishte babai i tij. Dhe ky ishte ai vetë, edhe pse nuk e kishte ditur gjithmonë këtë.

Adeli e dinte se nuk do ta donte dot më të atin ashtu siç e kishte dashur më parë, kur flinte i lumtur i strukur në krahun e tij të trashë. Tashmë kjo ishte e papërfytyrueshme. Por ai do të mësonte ta donte përsëri, edhe pse këtë herë do të ishte ndryshe, më e ndërlikuar, më e vështirë. Adeli thuajse e ndiente se si po kërcente nga fëmijëria në një moshë tjetër. Shumë shpejt ai do të ishte i rritur. Dhe, kur të ndodhte kjo, nuk do të kishte më kthim pas, sepse edhe të qenët i rritur ishte njësoj si ajo që i kishte thënë i ati dikur për të qenët hero lufte: me t'u bërë i tillë, vdes i tillë.

Ndërsa qëndronte natën shtrirë në shtrat, Adeli mendonte se një ditë, mbase të nesërmen ose të pasnesërmen, ose mbase javën që do të vinte, ai do të dilte nga shtëpia dhe do të shkonte te fusha pranë mullirit me erë ku kishin qëndruar Gholami dhe familja e tij. Ai mendonte se do ta gjente fushën të zbrazët. Ai do të qëndronte buzë rrugës dhe do të përfytyronte Gholamin dhe nënën e tij, të vëllezërit dhe gjyshen, një familje e tërë, me plaçkat të hedhura mbi shpinë, duke u çapitur ngadalë nëpër rrugët e pashtruara e gjithë pluhur të vendit, në kërkim të një vendi për t'u strehuar. Gholami ishte tani kreu i shtëpisë. Ai duhej të punonte. Ai tani do ta kalonte tërë rininë e tij duke hapur gropa, duke gërmuar kanalet e kullimit, duke përgatitur tullat e duke korrur arat. Pak nga pak Gholami do të shndërrohej në njërin prej atyreve burrave me fytyrë të vyshkur, që Adeli i shihte gjithmonë me plug në dorë.

Adeli mendonte se do të qëndronte aty në fushë për njëfarë kohe, duke kundruar kodrat dhe malet që sundonin mbi Shadbagun e Ri. Dhe pastaj do të fuste dorën në xhep e do të

nxirrte prej aty atë që kishte gjetur një ditë, ndërsa shëtiste në pemishtë: anën e majtë të një palë syzesh, të thyera në mes, me një xham të krisur si rrjetë merimange, me njolla gjaku të tharë në pjesën e bishtit pranë tëmthit. Ai do t'i fuste syzet e thyera në një gropë. Dhe besonte se, pasi ta bënte këtë e të kthente kurrizin për të ecur në drejtim të shtëpisë, ajo çka do të ndiente, më së shumti do të ishte lehtësim.

# Tetë

## *Vjeshtë 2010*

Në mbrëmje, kthehem në shtëpi nga klinika dhe gjej një mesazh nga Talia në sekretarinë telefonike që ndodhet në dhomën time të gjumit. E dëgjoj regjistrimin, ndërsa heq këpucët dhe ulem në tryezën time të punës. Ajo më thotë se është me grip, se është e sigurt që ia ka ngjitur mamaja ime, dhe pastaj më pyet si jam, më pyet si po më shkon puna në Kabul. Në fund, pak përpara se ta mbyllë, thotë: "Odi vazhdon të ankohet pse ti nuk e merr në telefon. Sigurisht që ty nuk do të ta thotë këtë. Kështu që po e bëj unë. Markos, për atë Zot, merre në telefon mamanë tënde. Trap!"

Unë buzëqesh.

Talia.

Mbi tryezën e punës kam një fotografi të sajën, një fotografi të bërë shumë vjet më parë në një plazh në Tinos: Talia e ulur në një shkëmb, me shpinën të kthyer nga aparati fotografik. E kam vënë fotografinë në kornizë, edhe pse, po ta shohësh nga shumë pranë, arrin të dallosh një njollë në ngjyrë kafe të errët në cepin e poshtëm të majtë, falë një italianeje të çmendur, që u mundua t'i vinte flakën shumë vjet më parë.

Unë ndez laptopin dhe nis të shkruaj aty raportin për operacionin kirurgjikal të një dite më parë. Dhoma ime është sipër: njëra nga tri dhomat e gjumit në katin e dytë të kësaj shtëpie ku kam jetuar qysh se erdha në Kabul, në vitin 2002. Tryeza ime e punës është pranë dritares që sheh nga kopshti i pasmë. Unë shikoj pemët e nespullave që mbollëm disa vjet më parë tok me Nabin, pronarin e shtëpisë. Dhe arrij të shquaj edhe shtëpizën e dikurshme të Nabit në fund të kopshtit, tani e lyer rishtazi me bojë. Pas vdekjes së tij, ia dhashë atë një djaloshi holandez që ndihmon shkollat e mesme vendase me programet e teknologjisë informatike. Dhe, në anë të djathtë, gjendet *Chevrolet*-i i vjetër i Sulejman Vahdatit, model i viteve '40, i palëvizur për dhjetëvjetësha të tërë, i mbuluar nga ndryshku, si një shkëmb i veshur me myshk, tani i veshur me një shtresë të hollë nga dëbora e parakohshme që ra dje papritur, e para për këtë vit. Pasi vdiq Nabi, unë mendova ta çoja makinën në një nga varrezat e makinave në Kabul, por nuk ma bëri zemra. Më dukej si një pjesë tepër thelbësore e së kaluarës së kësaj shtëpie, e historisë së saj.

E përfundoj raportin dhe shoh orën. Është 9:30 e mbrëmjes. Shtatë e gjysmë e mbrëmjes në Greqi.

"Merre në telefon mamanë tënde. Trap!"

Po qe se kam ndër mend ta marr mamanë në telefon, nuk mund ta shtyj më gjatë. Më kujtohet që Talia më ka shkruar në një *e-mail* se mamaja ka nisur të flejë gjithmonë e më herët. Unë marr frymë dhe e mbledh veten. Ngre receptorin e telefonit dhe formoj numrin.

Unë e takova Talian për herë të parë në verën e vitit 1967, kur isha dymbëdhjetë vjeç. Ajo dhe e ëma, Madalina, erdhën në shtëpinë tonë në Tinos për vizitë. Im më, që quhet Odelia, më tha se kishin kaluar disa vjet, pesëmbëdhjetë, për të qenë e saktë, që kur ajo e Madalina e kishin parë njëra-

-tjetrën për herë të fundit. Madalina ishte larguar nga ishulli në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare dhe kishte shkuar në Athinë për t'u bërë aktore. Dhe kishte fituar njëfarë fame, edhe pse për fare pak kohë.

- Nuk u habita fare, - më tha mamaja, - kur dëgjova se luante filma. Për shkak të pamjes së saj të jashtme. Të gjithëve ua merrte mendjen. Do ta shohësh vetë, kur ta takosh.

Unë e pyeta mamanë pse nuk më kishte folur kurrë për të.

- Nuk të kam folur? Je i sigurt?

- Më se i sigurt.

- Mund të isha betuar për të kundërtën, - e pastaj vazhdoi. - Vajza e saj... Talia... duhet të tregohesh i kujdesshëm me të, sepse ka pësuar një aksident. E ka kafshuar një qen. Dhe ka një vrajë.

Mamaja nuk shtoi asnjë fjalë më tepër dhe unë e dija shumë mirë që s'do të mund t'i nxirrja më asgjë. Por kjo e dyta më intrigoi më shumë se fakti që Madalina kishte luajtur nëpër filma e në skena teatri; kjo e ushqeu kërshërinë me dyshimin se ajo vrajë duhej të ishte e madhe dhe e dukshme, përderisa ishte e nevojshme që të tregohesha i kujdesshëm me atë vajzë. Me një padurim gërryes, mezi po prisja ta shihja me sytë e mi atë vrajë.

- Unë dhe Madalina jemi takuar në meshë, kur ishim të vogla, - tha mamaja.

Ato ishin bërë menjëherë shoqe të ngushta e të pandashme, tha ajo. Qëndronin të kapura për dore poshtë bankës në klasë ose në kishë, ose kur shëtitnin nëpër fushat e elbit. Ato ishin betuar që do të ishin përgjithmonë motra. I kishin premtuar njëra-tjetrës se do t'i merrnin shtëpitë pranë e pranë, edhe pasi të martoheshin. Do të ishin fqinja dhe, nëse ndonjëri prej burrave të tyre do të ngulte këmbë që të shpërnguleshin prej aty, do të divorcoheshin. Më kujtohet që mamaja po buzëqeshte ndërsa m'i tregonte të gjitha këto, me një ton zëri sikur po tallej me veten, si për t'u distancuar nga ky budallallëk e kjo

harlisje e fëmijërisë, nga të gjitha ato betime të rrëmbyera, frymëmekëse. Por po ashtu vura re në fytyrën e saj një re lëndimi të heshtur, një hije zhgënjimi, të cilën mamaja, duke qenë shumë krenare, nuk e pranonte me zë.

Madalina tani ishte e martuar me një burrë shumë të pasur e më të madh në moshë, njëfarë zoti Andreas Janakos, që disa vjet më parë kishte qenë producenti i filmit të saj të dytë e të fundit. Tani ai i kishte hyrë biznesit të ndërtimit dhe kishte një firmë të madhe në Athinë. Kohët e fundit ata ishin grindur ashpër. Mamaja nuk më tha asgjë nga këto; unë i gjeta vetë këto informacione, duke lexuar fshehurazi e me ngut pjesë të letrës që Madalina i kishte shkruar mamasë, kur i thoshte se do të vinte të na takonte.

*"Është shumë e lodhshme - po të them - të qëndrosh tani pranë Andreasit dhe shokëve të tij të djathtë e muzikës së tyre luftarake. Unë e mbaj gojën të kyçur mirë gjatë gjithë kohës. Nuk them asnjë fjalë kur ata i ngrenë në qiell këta ushtarakë kriminelë që po marrin nëpër këmbë demokracinë tonë. Po të guxoja të nxirrja qoftë edhe një fjalë kundërshtuese nga goja, jam e bindur që ata do të më etiketonin si komuniste anarkiste dhe atëherë as ndikimi i Andreasit nuk do të më shpëtonte dot nga biruca. E mbase ai as nuk do ta vriste mendjen që ta vinte në punë ndikimin e vet. Oh, sa më ka marrë malli për ty, Odi! Sa më ka marrë malli për shoqërinë tënde...!"*

Atë ditë që pritej të vinin mysafiret tona, mamaja u zgjua herët në mëngjes për të rregulluar shtëpinë. Ne jetonim në një shtëpi të vogël që gjendej në shpatin e një kodre. Si shumica e shtëpive në Tinos, edhe jona ishte e ndërtuar me gurë të bardhë dhe kishte një çati të sheshtë, me tjegulla në formë diamanti. Dhoma e vogël e gjumit në katin e dytë, ku flinim unë me mamanë, nuk kishte derë: aty hyje me të ngjitur ca shkallë të ngushta, por ajo kishte një dritare në formë freskoreje dhe një tarracë të ngushtë me një parmak prej hekuri dekorativ, në lartësinë e belit, prej nga ku mund të shihje çatitë e shtëpive të tjera, ullinjtë, dhitë, rrugicat e shtruara me kalldrëm e ku

fishkëllente era, dhe, pa dyshim, edhe detin Egje: blu dhe i qetë në një mëngjes vere dhe i mbuluar me shkumë pasdite, kur nga veriu frynte *meltemi*[1].

Kur mbaroi së pastruari, mamaja veshi atë që e mbante për kostumin e saj më të mirë, që e vishte çdo pesëmbëdhjetë gusht, me rastin e Festës për Ngjitjen në Qiell të Shën Mërisë, në kishën e *Panagia Evangelistria*-s[2], kur pelegrinët vinin në Tinos nga i gjithë Mesdheu, për t'u lutur përpara ikonës së famshme të kishës. Mamaja ime ka edhe një fotografi me atë kostum: një fustan i gjatë ngjyrë floriri me jakë të rrumbullakët, një triko e bardhë e ngushtë, çorape të gjata, këpucë të zeza të rënda. Mamaja, që me çdo qelizë të trupit të saj reflekton pamjen e vejushës fanatike, me fytyrën e ashpër, vetullat e dendura, hundën me majë, trupin në drejtqëndrim, si një besimtare e devotshme, si të jetë edhe ajo vetë një pelegrine. Edhe unë jam në atë fotografi, duke qëndruar si i ngrirë përbri saj. Kam veshur një këmishë të bardhë, pantallona të shkurtra të bardha dhe çorape të bardha deri te gjuri me llastikat të përveshura. Mund ta kuptosh nga shprehja e zymtë e fytyrës sime që më kanë thënë të qëndroj drejt, pa qeshur, që fytyrën ma kanë rrjepur me shparcë e flokët m'i kanë ulur poshtë me ujë, përkundër dëshirës sime e me ankesa të shumta. Aty mund të arrish të dallosh edhe një lloj pakënaqësie ndërmjet nesh. Duket qartë në qëndrimin tonë të ngurtë, tek trupat tanë, që nuk e cikin fare njëri-tjetrin.

Mbase të tjerët nuk e vënë re një gjë të tillë. Por unë mundem, sa herë që e shoh atë fotografi dhe për herë të fundit përpara dy vjetësh. Unë vetë nuk mund të mos e vë re ajrin e rëndë, padurimin, tendosjen. Aty shoh vetëm dy njerëz të lidhur

---

1) *Meltemi* (turqisht) ose *etesian* (greqisht) = erërat veriore në Mesdheun Verilindor (*shën. i përkth.*).

2) *Shën Mëria e Tinosit*. Ikona në fjalë është një ikonë e Shën Mërisë së ulur në gjunjë duke u lutur, punuar nga Shën Luka Evangjelisti dhe që besohet se ka fuqi shëruese (*shën. i përkth.*).

bashkë prej një detyrimi gjenetik, të mallkuar për të çmeritur dhe zhgënjyer njëri-tjetrin, secili i betuar deri në deje për ta mposhtur tjetrin.

Nga dritarja e dhomës së gjumit në katin e dytë, e pashë mamanë që u nis për në portin e qytetit të Tinosit. Me një shami të lidhur nën mjekër, ajo po turrej me hapa të shpejtë drejt një dite blu me një diell në kupë të qiellit. Ajo ishte e lehtë, një grua kockëvogël me trupin e një fëmije, por, kur e shihje të vinte drejt teje, bëje mirë t'i hapje rrugë. Më kujtohet kur më shoqëronte për në shkollë çdo mëngjes: tani ajo është në pension, por dikur ka qenë mësuese. Ndërsa ecnim, mamaja nuk më kapte kurrë për dore. Mamatë e tjera i kapnin fëmijët e tyre për dore, por imja jo. Ajo më thoshte se duhej të më trajtonte si të gjithë nxënësit e tjerë. Ecte përpara, me grushtin të mbyllur në jakën e pulovrit dhe unë mundohesha ta arrija, me kutinë me ushqimin në dorë, duke vrapuar pas gjurmëve të saj. Në klasë, gjithmonë ulesha në bankën e fundit. Më kujtohet mamaja ime në dërrasën e zezë dhe mënyra se si e gozhdonte ajo një nxënës të prapë me një vështrim të vetëm, përvëlues, si një gur i lëshuar nga një llastik. Ajo mund të të ndante në dy pjesë me një vështrim të vetëm të ngrysur dhe një fshikullimë të papritur heshtjeje.

Mbi gjithçka, mamaja besonte te besnikëria, qoftë edhe me çmimin e vetëmohimit. E veçanërisht me çmimin e vetëmohimit. Ajo, po ashtu, besonte se gjëja më e mirë është gjithmonë e vërteta, e vërteta e pastër, e thënë pa lajka, pa dredha dhe, sa më e papranueshme të jetë kjo e vërtetë, aq më herët duhet thënë ajo. Ajo nuk kishte durim t'i zbuste gjërat. Por ishte dhe është një grua me vullnet të çeliktë, një grua që s'dinte të kërkonte ndjesë dhe me të s'do të donit të hapnit kurrë ndonjë debat, edhe pse unë kurrë nuk e kam kuptuar plotësisht nëse këtë temperament e kishte të lindur apo e kishte fituar nga nevoja, pasi i shoqi i vdiq pa u mbushur as një vit nga martesa, duke e lënë që të më rriste mua fare e vetme.

Mua më kaploi gjumi në katin e dytë, pak pasi doli

mamaja. Kërceva përpjetë më vonë nga një zë gruaje, i lartë e tingëllues. U ngrita në këmbë dhe ja tek ishte ajo: gjithë buzëkuq, pudër, parfum e me harkime të buta, duke më dërguar një buzëqeshje të drejtpërdrejtë përmes velit të hollë të kapelës së saj. Ajo po qëndronte në mes të dhomës, me një fustan të shkurtër ngjyrë jeshile neoni, me një valixhe lëkure te këmbët e saj, me flokët e kuqërremtë dhe këmbët e gjata, duke m'u drejtuar mua e duke më buzëqeshur me një fytyrë të ndritshme, me një zë gjithë nuanca, që rrezatonte vetësiguri dhe dashamirësi.

- Pra, ti na qenke Markosi i vogël i Odit! Ajo nuk më tha që ishe kaq i pashëm! Oh, dhe po arrij ta shoh atë tek ti, te sytë e tu... po, ju të dy keni të njëjtët sy, kështu më duket mua, jam e bindur që ta kanë thënë këtë. Mezi po prisja të të takoja. Unë dhe mamaja jote... ne... oh, pa dyshim që Odi ta ka thënë, kështu që mund ta përfytyrosh vetë, mund ta marrësh vetë me mend se sa fantastike më duket mua që t'ju shoh të dyve, që të të takoj ty, Markos. Markos Varvarisi! E po, unë jam Madalina Janakosi dhe - a mund ta them? - ndihem e mrekulluar.

Ajo hoqi dorashkat ngjyrë kremi të gjata deri te bërryli, nga ato që unë i kisha parë vetëm nëpër revista në duart e grave elegante nëpër mbrëmje, teksa pinin duhan me një çibuk të hollë e të gjatë në një teatër opere ose ndërsa i ndihmonin të zbrisnin nga një makinë e zezë vezulluese, me fytyrën të ndriçuar nga dritat e bliceve të aparateve fotografike. Asaj iu desh ta tërhiqte disa herë secilin gisht, përpara se të arrinte ta hiqte dorashkën plotësisht dhe, pasi e vuri dorën për disa sekonda në ijë, ma zgjati mua.

- Gëzohem që po njihemi, - tha ajo. Dorën e kishte të butë dhe të ftohtë, paçka se në dorashka. - Kurse kjo është vajza ime, Talia. E dashur, përshëndete Markos Varvarisin.

E bija po qëndronte te dera e dhomës, në krah të mamasë sime, me vështrimin drejt meje, me një vështrim pa shprehje: një vajzë e gjatë thatime, me lëkurë të zbehtë e flokë të hollë

me onde. Por nuk mund të them asnjë fjalë më shumë se kaq. Nuk mund të them ngjyrën e fustanit që kishte veshur atë ditë - nëse vërtet kishte veshur fustan - ose çfarë këpucësh kishte mbathur, ose në kishte mbathur çorape a kishte vënë orë në dorë, ose ndonjë varëse, ndonjë unazë a ndonjë palë vathë. Do të ishte tjetër gjë, po qe se dikush do të kërcente mbi tryezë papritur, fare lakuriq e duke bërë zhonglerin me lugët e ëmbëlsirës, këtë njeriu jo vetëm që do ta shihte, por do të ishte e vetmja gjë që do të mund të shihte, kurse maska që mbante vajza në gjysmën e poshtme të fytyrës, ishte e tillë, që nuk të lejonte të vije re hollësitë e tjera.

- Talia, përshëndete, e dashur. Mos u bëj vajzë e keqe.

Mua m'u duk se ajo më përshëndeti fare lehtë me kokë.

- Ç'kemi? - iu drejtova unë, me gjuhën si eshkë. Në ajër po ndehej një valë elektromagnetike. Një rrymë. Unë ndihesha i ngarkuar me diçka që ishte njësoj tmerruese e magjepsëse njëherazi; diçka që u ngjit lart me vrull e u mblodh si lëmsh brenda meje. Unë ia kisha ngulur sytë fort dhe, ndonëse isha i vetëdijshëm për këtë, nuk po arrija t'i largoja dot prej saj. Nuk po mundesha t'i largoja sytë nga maska prej cohe ngjyrëblu si qielli, nga dy shiritat që e mbanin atë të lidhur në pjesën e pasme të kokës, nga e çara e ngushtë horizontale mbi gojën e saj. E kuptova qysh në atë çast se nuk do të mund ta përballoja dot të shikuarit e asaj që gjendej poshtë asaj maske, çfarëdolloj gjëje që të ishte ajo. Por njëherazi edhe mezi po prisja që ta shihja. Asgjë në jetën time nuk do t'i rikthehej rrjedhës, ritmit e rregullit të natyrshëm, derisa ta shihja me sytë e mi atë gjë aq të tmerrshme, aq ngjethëse, sa të tjerët duhej të mbroheshin duke mos e parë atë.

Mundësia tjetër, që ajo maskë ishte vënë për ta mbrojtur Talian nga ne, nuk më shkoi ndër mend. Të paktën jo në agoninë marramendëse të atij takimi të parë.

Madalina dhe Talia u ngjitën lart, që të nxirrnin rrobat nga valixhet, kurse mamaja, në kuzhinë, nisi të rrihte filetot e

shojzës së detit për darkë. Ajo më kërkoi t'i mbushja Madalinës një filxhan me *ellinikós kafés,* çka e bëra, pastaj më tha që t'ia çoja lart, që gjithashtu e bëra, me një tabaka, tok me një pjatë të vogël me *pastelli*[1].

Ndonëse kanë kaluar gjithë këta dhjetëvjetësha qysh atëherë, turpi përsëri vërshon mbi mua si një lëng i ngrohtë, ngjitës, kur kujtoj atë që ndodhi më pas. Edhe sot e kësaj dite unë e shoh atë skenë si në fotografi, si diçka të fiksuar përjetësisht: Madalina që po pi duhan, më këmbë, përpara dritares së dhomës, duke parë detin përmes një palë syzesh të rrumbullakëta me xhama të verdhë, me njërën dorë në ijë, me njërin kyç këmbe të hedhur përmbi tjetrin. Kapela e saj është mbi komo. Mbi komo është një pasqyrë dhe në pasqyrë duket Talia, e ulur buzë shtratit, me shpinë nga unë. Ajo është përkulur poshtë e po bën diçka, mbase po zgjidh lidhëset e këpucëve, dhe unë vë re se e ka hequr maskën, që gjendet në shtrat pranë saj. Një valë të ftohti ma përshkon shtyllën kurrizore dhe mundohem ta ndal, por duart po më dridhen dhe filxhani prej porcelani përplaset pas pjatës, çka e bën Madalinën të kthehet me fytyrë nga unë, dhe Talian të ngrejë kokën. Dhe mua më kap syri shëmbëlltyrën e saj në pasqyrë.

Tabakaja më ra nga dora. Filxhani prej porcelani u thye. Lëngu i ngrohtë u përhap në dysheme dhe tabakaja nisi të rrokullisej nëpër shkallë. Ishte një situatë e papritur, kaotike: unë që po zvarritesha këmbadorazi mbi copat e porcelanit të thyer, me refleksin e të vjellit, por pa vjellë dot, Madalina që thoshte: "Oh, i dashur! Oh, i dashur!", - dhe mamaja që u ngjit lart me vrap, duke bërtitur: "Çfarë ndodhi? Çfarë bëre, Markos?"

"E ka kafshuar një qen, - më kishte thënë mamaja për të më paralajmëruar. - Dhe ka një vrajë". Qeni nuk e kishte kafshuar fytyrën e Talias; ai e kishte ngrënë atë. Dhe mbase edhe kishte fjalë të tjera për ta përshkruar atë që unë pashë në

---

1) Ëmbëlsirë greke, me fara susami, stika dhe mjaltë (*shën. i përkth.*).

pasqyrë atë ditë, por fjala "vrajë" nuk ishte aspak njëra prej tyre.

Më kujtohet që mamaja më kapi për supesh e më ngriti në këmbë, më ktheu me fytyrë nga vetja e më tha:

- Si është puna? Çfarë nuk shkon me ty?

Më kujtohet si ngriti sytë mbi kokën time. Dhe vështrimi i ngriu. Fjalët iu mekën në gojë. Fytyra iu zbardh. Duart i rrëshqitën nga supet e mia. Dhe tamam në atë çast unë u bëra dëshmitar i gjësë më të jashtëzakonshme, i diçkaje po aq të pazakontë sa edhe shfaqja e vetë mbretit Konstantin[1] në derën tonë, veshur me rroba klouni: një lot i vetëm që po rrëshqiste në cepin e syrit të djathtë të mamasë.

- Pra, si ishte ajo? - më pyet mamaja në telefon.

- Kush?

- Kush? Ajo pra, gruaja franceze. Mbesa e pronarit të shtëpisë, profesoresha nga Parisi.

Unë e kaloj receptorin në veshin tjetër. Po më habit fakti që asaj i kujtohet kjo. Gjatë gjithë jetës sime, kam pasur përshtypjen se fjalët që i thosha mamasë, zhdukeshin në hapësirën e mosdëgjimit, si të kishte zhurmë përreth ose sikur linja të shkëputej herë pas here. Ndonjëherë, kur e marr në telefon nga Kabuli, ashtu siç po bëj tani, më krijohet ndjesia se ajo e ka ulur receptorin dhe është larguar nga telefoni dhe unë po flas me hapësirën boshe në kontinentin tjetër, edhe pse e ndiej që im më është ende aty, edhe pse arrij t'ia dëgjoj frymëmarrjen. Herë të tjera, ndërsa i tregoj se çfarë kam parë në klinikë, për shembull ndonjë djalë të vogël në krahët e të atit, të larë në gjak, me një copë metali të ngulur thellë në faqe, me llapën e njërit vesh të këputur, një tjetër viktimë e të

---

1) Konstantini II (lindur më 2.6.1940), mbret i Greqisë nga viti 1964 deri në vitin 1973, kur Greqia u shpall republikë (*shën. i përkth.*).

luajturit në rrugën e gabuar, në çastin e gabuar të ditës së gabuar, dëgjoj befas një zhurmë të fortë në anën tjetër, zëri i mamasë bëhet si i largët dhe i mbytur, me ngritje e ulje, dëgjohet kumbimi i hapave, i diçkaje që po e tërheqin në dysheme dhe unë hesht, pres derisa ajo të kthehet përsëri tek telefoni, çka ajo e bën, gjithmonë paksa pa frymë, e nis të më sqarojë:

- I thashë se isha shumë mirë më këmbë te dritarja. Ia thashë qartë. I thashë: "Talia, do të më pëlqente të qëndroj te dritarja dhe të shoh detin, ndërsa flas me Markosin." Por ajo më thotë: "Do të lodhesh, Odi, duhet të ulesh." Dhe gjëja tjetër që vë re është që ajo po tërheq kolltukun, atë gjënë e madhe prej lëkure që ma bleu vitin e shkuar, dhe po e afron te dritarja. O Zot, ajo është e fuqishme. Ti s'e ke parë kolltukun, sigurisht. E po, sigurisht. - Mandej ajo psherëtin dhe kërkon me një lloj pezmatimi tallës që unë të vazhdoj t'i rrëfej historinë, por në këtë çast edhe unë e kam humbur drejtpeshimin. Efekti i pastër i të tërë kësaj është që ajo më ka bërë të ndihem sikur sapo më kanë qortuar tërthorazi dhe, për më tepër, sikur e meritoj këtë: fajtor për një faj të pashprehur me fjalë, akuza të pashprehura haptazi. Edhe po të vazhdoj t'ia rrëfej ngjarjen tani, ajo më duket e pavlerë për vetë veshët e mi. Kjo as nuk krahasohet me dramën e kolltukut ndërmjet mamasë sime e Talias. - Si e kishte emrin ajo, ma thuaj prapë? - më pyet e më kërkon mamaja tani. - Pahri, më duket, apo jo?

Unë i kam folur mamasë për Nabin, që ishte një mik shumë i mirë për mua. Ajo e njeh jetën e tij në vija të përgjithshme. E di gjithashtu që shtëpinë në Kabul ai ia ka lënë me testament mbesës së tij, Pahrit, që është rritur në Francë. Por unë nuk i kam treguar gjë mamasë për Nila Vahdatin, për arratisjen e saj në Paris, pasi i shoqi pësoi iskeminë në tru, dhe as për gjithë ata dhjetëvjetësha që Nabi i kaloi duke u kujdesur për Sulejman Vahdatin.

Çfarë historie! Shumë paralele me efekt bumerangu. Si të jesh duke lexuar me zë të lartë padinë e ngritur kundër teje.

- Pahri. Po. Ishte njeri i mirë, - i them. - Dhe i ngrohtë. Veçanërisht për një profesoreshë.

- Çfarë ishte ajo, ma thuaj prapë, kimiste?

- Matematikane, - i them, duke e mbyllur kapakun e laptopit. Ka nisur sërish të bjerë dëborë, lehtë-lehtë: flokë të vegjël fluturojnë në ajër në errësirë dhe ndalen mbi xhamin e dritares sime.

Unë nis t'i tregoj mamasë për ardhjen e Pahrit në Kabul verën e fundit. Ajo ishte vërtet njeri shumë i dashur. E butë, e dobët, me flokë gri, me një qafë të gjatë me dy damarë të plotë ngjyrëblu që i dukeshin qartë, me një buzëqeshje të ngrohtë, që zbulonte hapësirën midis dhëmbëve të përparmë. Ajo dukej paksa më e moshuar nga sa ishte në të vërtetë. Artrit i ashpër reumatoid. Në mënyrë të veçantë duart si kthetra, edhe pse arrinte t'i përdorte ende, por ditët e saj ishin të numëruara, ajo e dinte këtë. Dhe kjo më bën të mendoj për ditët e mamasë sime.

Pahri Vahdati qëndroi një javë me ne në shtëpinë në Kabul. Kur ajo mbërriti nga Parisi, unë e shëtita nëpër shtëpi. Ajo e kishte parë shtëpinë për herë të fundit në vitin 1955 dhe dukej shumë e habitur që i kishte aq të gjalla kujtimet për këtë shtëpi, për pamjen e përgjithshme, për dy shkallët midis dhomës së ndenjjes dhe dhomës së ngrënies, për shembull, ku thoshte se ulej dikur nën dritën e diellit të mëngjesit të vonë dhe lexonte librat e saj. Ajo ndihej e habitur se sa e vogël ishte shtëpia në krahasim me atë që ishte ruajtur në kujtesë. Kur e ngjita lart, e dinte se cila kishte qenë dhoma e saj e gjumit, edhe pse aty tani banon një koleg gjerman imi, që punon për *World Food Program*. Më kujtohet se si iu mek fryma, kur pa dollapin e vogël e të ulët në qoshe të dhomës, një nga të paktat mbijetoja të fëmijërisë së saj. Më kujtohet nga letra që më kishte lënë Nabi, pak përpara se të vdiste. Ajo u afrua pranë tij dhe përkëdheli me mollëzat e gishtave bojën e lirë jeshile, gjirafat e majmunët bishtgjatë të zbërdhulur nga koha në kanatin e tij. E ktheu kokën nga unë dhe unë vura re se si i ishin njomur

paksa sytë, ndërsa më pyeste gjithë druajtje e si duke kërkuar ndjesë nëse do të ishte e mundur ta merrte me vete në Paris. Dhe më kërkoi të paguante, për ta zëvendësuar me një tjetër. Kjo ishte e vetmja gjë që ajo donte nga ajo shtëpi. Unë i thashë se e kisha për kënaqësi t'ia jepja.

Më në fund, përveç dollapit të vogël, të cilin e nisa me anije disa ditë pas largimit të saj, Pahri Vahdati u kthye në Francë vetëm me blloqet me vizatime të Sulejman Vahdatit, me letrën e Nabit e me disa poezi të së ëmës, që i kishte ruajtur Nabi. E vetmja gjë tjetër që më kërkoi ajo gjatë qëndrimit të saj këtu, ishte që ta ndihmoja të shkonte në Shadbag, që të mund të shihte fshatin ku kishte lindur dhe ku shpresonte të gjente vëllanë tjetër të saj nga babai, Ikbalin.

- Them se ka për ta shitur shtëpinë, - thotë mamaja, - tani që u bë e saj.

- Në fakt, ajo më tha se mund të qëndroj sa të dua, - i përgjigjem unë. - Pa qira.

Arrij ta shoh shumë qartë se si përdridhen e shtrëngohen fort gjithë mosbesim buzët e mamasë. Ajo jeton në ishull. Ajo nuk u zë besë qëllimeve të njerëzve që jetojnë në kontinent, i sheh vëngër aktet e tyre të dukshme të mirësisë. Pikërisht kjo ishte një nga arsyet që - unë e dija qysh fëmijë - do të më nxiste të largohesha një ditë nga Tinosi, sapo të më krijohej mundësia. Mua më pushtonte njëfarë dëshpërimi, sa herë që i dëgjoja njerëzit të flisnin në këtë mënyrë.

- Si po të shkon puna me atë folenë e pëllumbave? - ia ndryshoj unë temën e bisedës.

- M'u desh të hiqja dorë për pak kohë. Më lodh shumë.

Mamaja u vizitua te një neurolog në Athinë gjashtë muaj më parë, me këmbënguljen time, pasi Talia më tregoi se mamasë vazhdimisht i binin gjërat nga dora. Ishte Talia që e shoqëroi atje. Qysh prej asaj dite që shkoi te neurologu, mamaja e ka marrë me shumë revan. E di prej *e-mailëve* që më dërgon Talia. Ka lyer shtëpinë, ka rregulluar tubat e ujit që rridhnin, është munduar ta bindë Talian për të bërë një dollap të ri në

katin e dytë e, madje, edhe për të zëvendësuar tjegullat e thyera të çatisë, edhe pse, falë Zotit, Talia u dha fund të gjitha këtyre. Dhe tani i ka shkuar mendja për një fole pëllumbash. E përfytyroj mamanë me mëngët të përveshura lart, me çekiçin në dorë, me djersën që i rrjedh nëpër shpinë, duke ngulur gozhdë e duke zdrukthuar pllaka druri. Në garë me neuronet e saj që po vdesin. Duke i shfrytëzuar në maksimum sa është ende në kohë.

- Kur do të kthehesh në shtëpi? - më pyet im më.

- Së shpejti, - ia kthej. "Së shpejti" iu përgjigja edhe një vit më parë, kur ajo më bëri të njëjtën pyetje. Kanë kaluar dy vjet qysh kur isha për herë të fundit në Tinos.

Pason një heshtje e shkurtër.

- Mos prit shumë gjatë. Dua të të shoh përpara se të më futin në atë mushkërinë prej hekuri[1]. - Ajo qesh. Është një zakon i vjetër i saj ky, kjo lloj talljeje me fatin e keq, kjo përbuzje e saj për shfaqjen më të vogël të keqardhjes për veten. Dhe ka një efekt paradoksal e të përllogaritur - unë e di - që njëherazi e mpak dhe e shton fatin e keq. - Eja për Krishtlindje, po munde. - thotë ajo. - Përpara katër janarit, me çdo kusht. Talia thotë se atë ditë do të ketë një eklips diellor në të gjithë Greqinë. E ka lexuar në internet. Mund ta shikojmë bashkë.

- Do të mundohem, mama, - i them unë.

Ishte njësoj si të zgjoheshe një mëngjes e të gjeje një kafshë të egër që po shëtiste nëpër shtëpi. Asnjë vend nuk më dukej i sigurt. Ajo ishte aty, në çdo qoshe të shtëpisë, sa herë që ktheja kokën pas, si një kafshë në kërkim të presë, duke ecur gjithë kujdes pas gjurmëve të kësaj, duke fshirë vazhdimisht me shami pështymën që i dilte nga goja në faqe.

---

1) Aparat për frymëmarrje artificiale, ku pacienti futej kur nuk ishte në gjendje të merrte frymë vetë dhe i lihej vetëm koka jashtë (*shën. i përkth.*).

Përmasat e vogla të shtëpisë e bënin arratisjen prej saj të pamundur. Në mënyrë të veçantë u tmerrohesha vakteve që hanim në tryezë, kur isha i detyruar të duroja spektaklin që ofronte Talia, ndërsa ngrinte maskën për të futur lugën me ushqim në gojë. Stomaku më përzihej prej asaj që shihja e që dëgjoja. Ajo hante me zhurmë, ndërsa copat e ushqimit gjysmë të përtypur binin vazhdimisht në pjatë, në tryezë ose edhe në dysheme. Ajo ishte e detyruar që të gjitha lëngjet, madje edhe ujin, t'i pinte me pipë, që mamaja e saj i mbante me qese në çantë. Ajo rrufiste me zhurmë e llokoçitje, kur e thithte supën me pipë, dhe gjithmonë e bënte maskën me njollë, ndërsa supa i rridhte anash faqes, nëpër nofull e qafë. Herën e parë kërkova ndjesë për t'u larguar nga tryeza dhe mamaja më hodhi një vështrim të vëngër. Kështu që u detyrova ta stërvitja veten për të mos i hedhur sytë mbi të, por nuk ishte gjë e lehtë. Unë hyja në kuzhinë, dhe ja tek ishte ajo, e ulur, ndërsa Madalina i vendoste balsam në faqe, që të mos i acarohej lëkura. Unë nisa të mbaja një kalendar mendor, nisa të numëroja mbrapsht me mend ditët e atyre katër javëve që Madalina e Talia do të qëndronin me ne, sipas të thënave të mamasë.

Do të kisha dashur që Madalina të kishte ardhur vetëm. Madalina më pëlqente. Ne uleshim, që të katër, në kopshtin e vogël katror përpara derës së jashtme dhe ajo rrufiste kafen e ndizte cigaret njërën pas tjetrës, ndërsa këndet e fytyrës i mbuloheshin nga hijet e ullirit tonë dhe një kapelë kashte ngjyrë ari si kovë, që te kushdo tjetër do të dukej si diçka absurde, te mamaja për shembull, por kurrsesi jo tek ajo. Madalina ishte një nga ata njerëz që eleganca u vjen në mënyrë të shpenguar, si të jetë një aftësi gjenetike, njësoj si aftësia për ta kthyer gjuhën si tub. Me Madalinën, bisedat nuk ishin kurrë të mërzitshme; ajo ishte një burim i pashtershëm ngjarjesh e historish. Një mëngjes na tregoi për udhëtimet e saj: në Ankara, për shembull, ku kishte ecur në breg të lumit Enguri Su dhe kishte pirë çaj jeshil të përzier me raki. Ose kur kishte qenë në Kenia tok me zotin Janakos dhe kishin shëtitur midis akacieve

gjembaçe të hipur mbi elefantë; ata madje ishin ulur për të ngrënë qull me miell misri dhe pilaf me qumësht kokosi me fshatarët vendas. Historitë e Madalinës zgjonin një shtysë të vjetër tek unë, një nevojë që e kisha pasur gjithnjë për t'u sulur nëpër botë, për të mos u tutur përpara asgjëje. Në krahasim me të sajën, jeta ime në Tinos më dukej tmerrësisht e zakonshme. Unë e shihja jetën si një shpalosje pa mbarim të asgjësë dhe e kisha kaluar shumicën e viteve të fëmijërisë në Tinos duke u përpëlitur, me ndjenjën e të qenit i huaj për veten, si një përfaqësues i vetes sime, sikur vetja ime e vërtetë të gjendej diku tjetër, në pritje që të bashkohej me këtë vete të zgavërt, boshe. Unë ndihesha si një skllav i arratisur. Një refugjat në vetë shtëpinë time.

Madalina tha se në Ankara kishte qenë në një vend të quajtur *Kuđulu Park* dhe kishte parë mjellmat që rrëshqisnin mbi ujë. Ajo tha se uji ishte marramendës.

- Po dërdëllis ca si shumë, - shtoi ajo pastaj, duke qeshur.

- Aspak, - ia ktheu mamaja.

- Është një zakon i vjetër. Gjithmonë flas shumë. Përherë kështu kam qenë. A të kujtohet se sa të mërzitja kur nuk më mbyllej goja në klasë? Ti kurrë nuk bëje gjëra që s'duheshin, Odi. Ti ishe gjithmonë shumë e përgjegjshme dhe studioze.

- Janë interesante këto historitë e tua. Ti ke bërë një jetë interesante.

Madalina shqeu sytë.

- E po, ti e di mallkimin kinez[1].

- A të pëlqeu Afrika? - e pyeti mamaja Talian.

Talia mbështeti shaminë në faqe dhe nuk ktheu përgjigje. Unë u ndjeva i lumtur. Ajo kishte një të folur tejet të çuditshme. Si me gojën plot me ujë, një përzierje llokoçitjesh e thuthuqësie.

- Oh, Talias nuk i pëlqen të udhëtojë! - tha Madalina, duke e fikur cigaren. Ajo e tha këtë si të ishte një e vërtetë e pabesueshme. Nuk ishte nevoja ta shihje Talian për të parë a

1) Jetofsh në kohëra interesante (*shën. i përkth.*).

po e pohonte apo po e kundërshtonte. - Ajo nuk di t'i shijojë ato.

- E po, edhe mua s'më pëlqen, - tha mamaja, duke iu drejtuar përsëri Talias. - Më pëlqen të qëndroj në shtëpi. Besoj se unë kurrë nuk kam gjetur një arsye bindëse për t'u larguar nga Tinosi.

- Kurse unë nuk kam gjetur asnjë për të qëndruar, - tha Madalina. - Përveç teje, natyrisht. - Dhe preku kyçin e dorës të mamasë. - A e di se cila ishte frika më e madhe që pata kur ika prej këtu? Shqetësimi më i madh? Si do t'ia dilja mbanë pa Odin. Të betohem, ky mendim më nguroste të gjithën.

- Duket që ia ke dalë mbanë mjaft mirë, - tha mamaja me zë të ngadaltë, duke i larguar sytë nga Talia.

- Ti nuk e kupton, - tha Madalina dhe unë e mora vesh që ai që nuk e kuptonte, isha unë, sepse vështrimi i saj ishte drejtuar mbi mua. - Unë nuk do t'ia kisha dalë mbanë aspak pa mamanë tënde. Ajo më ka shpëtuar.

- Tani po që po llomotit ca si shumë, - tha mamaja.

Talia ngriti kokën lart me sy të picërruar. Po shihte një avion, lart në qiellin blu, që po shenjonte trajektoren e vet me një vijë të hollë e të gjatë tymi.

- Prej tim eti, - tha Madalina, - Odi më shpëtoi prej tim eti. - Nuk isha më i sigurt nëse po më drejtohej përsëri mua. - Ai ishte një nga ata njerëzit e lindur për të qenë të egër. Kishte sy të kërcyer dhe një qafë të trashë e të shkurtër, me një nishan të zi në pjesën e prapme. Dhe grushte. Grushte si varé. Ai kthehej në shtëpi dhe nuk ishte nevoja të bënte asgjë, mjaftonte trokitja e çizmeve në korridor, tringëllima e çelësave, hungërima e tij. Kur ishte i nxehur, gjithmonë shfrynte me hundë dhe picërronte sytë, si të ishte duke rënë në mendime të thella, pastaj fërkonte mjekrën e thoshte: "Mirë, moj çupëlinë, mirë", - dhe atëherë e kuptoje se po vinte, po lëshohej stuhia drejt teje e nuk mund të ndalej më. Asnjeri s'më ndihmonte dot. Ndonjëherë, mjaftonte që ai të fërkonte mjekrën ose të shfrynte nëpër mustaqe dhe mua më erreshin sytë.

Qysh prej asaj kohe kam ndeshur vetëm burra si puna e tij. Do të kisha dashur të ishte ndryshe. Por kështu ka qenë. Dhe ajo që kam mësuar, është se mjafton që të gërmosh paksa nën sipërfaqe, dhe do të zbulosh se të gjithë janë njësoj, më pak ose më shumë. Disa duken më të edukuar, më të sjellshëm; kanë një lloj sharmi, ose shumë sharm, dhe këta arrijnë të të mashtrojnë. Por ja që ata janë thjesht djem të vegjël të dëshpëruar që vijnë vërdallë në gjendje tërbimi. Ata ndihen të mashtruar: nuk u është dhënë ajo që u takon. Askush nuk i ka dashur aq sa duhej. Dhe pa dyshim që presin t'i duash. Atyre u pëlqen t'i mbash, t'i përqafosh, t'u ofrosh siguri. Por është gabim t'ua japësh. Sepse nuk e pranojnë dot. Ata nuk mund të pranojnë të vetmen gjë për të cilën kanë nevojë. Ata në fund të urrejnë për këtë. Dhe kjo nuk merr kurrë fund, sepse ata nuk arrijnë kurrë të të urrejnë aq sa duhet. Nuk merr fund kurrë: mjerimi, kërkesa për ndjesë, premtimet, ngrënia e premtimeve, dëshpërimi. Burri im i parë ashtu ishte.

Unë mbeta pa gojë. Askush nuk kishte folur kaq hapur në praninë time më parë, vetëkuptohet që mamaja jo e jo. Asnjeri nga ata që njihja unë, nuk e zbulonte fatin e mbrapshtë të vet në këtë mënyrë. Ndihesha i vënë në siklet nga Madalina, por njëherazi e admiroja natyrën e saj të hapur.

Kur përmendi burrin e saj të parë, vura re se, për herë të parë qysh kur e kisha takuar, një hije e errët mbuloi fytyrën e saj, diçka përndjekëse, lënduese, që nuk përkonte aspak me të qeshurën e saj energjike e ngacmuese dhe me fustanin e derdhur ngjyrë kungulli me lule, që kishte veshur. Më kujtohet se atëherë mendova që ajo duhej të kishte qenë vërtet aktore shumë e mirë, përderisa arrinte ta mbulonte zhgënjimin dhe lëndimin me një lustër dashamirësie. Si një maskë - mendova - dhe u kënaqa me veten për analogjinë e zgjuar që gjeta.

Më vonë, kur u rrita, nuk e kisha më të qartë. Kur e kujtoja sërish atë çast, seç gjeja diçka në mënyrën se si ajo heshti kur përmendi burrin e saj të parë, se si i uli sytë poshtë, u përcoll dhe buzët iu drodhën lehtë. Dhe po ashtu më dukej

se kishte diçka edhe në energjinë e saj të pashtershme, në humorin e saj, në sharmin e gjallë, në mënyrën se si i lëshonte qortimet butë-butë si me parashutë, të shoqëruara me një të qeshur e shkelje syri. Mbase të dyja ishin shtirje, ose mbase nuk ishte asnjëra. Tani unë nuk e dija më se cili ishte aktrimi e cili reagimi i vërtetë, çka më bënte ta shihja të paktën si një aktore më interesante.

- Sa herë jam turrur me vrap drejt kësaj shtëpie, Odi? - tha Madalina. Dhe tani ajo po buzëqeshte përsëri. - Të shkretët prindërit e tu. Por kjo shtëpi ishte parajsa ime. Vendstrehimi im. Ashtu ishte. Një ishull i vogël brenda ishullit të madh.

Mamaja iu përgjigj:

- Ti gjithmonë ke qenë e mirëpritur këtu.

- Ishte mamaja jote që i dha fund asaj dhune, Markos. A ta ka treguar ndonjëherë?

Unë iu përgjigja se nuk e kishte bërë.

- Kjo nuk më habit aspak. Kjo është Odelia Varvarisi për ty. - Mamaja po paloste e shpaloste cepin e përparëses në prehrin e saj, me një pamje sikur po ëndërronte me sy hapur. - Një natë erdha këtu, me gjuhën që më rridhte gjak, me një tufë flokësh të shkulur nga tëmthi, me veshin që ende po më kumbonte nga goditja. Në atë kohë im atë tregohej shumë i egër me mua. O Zot, në ç'gjendje që isha! Në ç'gjendje! - Me mënyrën se si po e përshkruante Madalina këtë ngjarje, mund të mendoje se po fliste për një drekë të shkëlqyer ose për një roman të bukur. - Mamaja jote nuk bëri asnjë pyetje, sepse e njihte situatën. Pa dyshim që e njihte. Ajo thjesht m'i nguli sytë për një kohë të gjatë, mua që po qëndroja aty, duke u dridhur, dhe tha - edhe sot e kësaj dite më kujtohet, Odi - ajo tha: "E po, kjo punë duhet të marrë fund." Dhe shtoi: "Tani do shkojmë t'i bëjmë një vizitë tët eti, Madi". Dhe unë që fillova t'i lutesha... Kisha frikë se do të na vriste të dyjave. Por ti e di si është jot ëmë. - Unë iu përgjigja se e dija dhe mamaja m'i nguli sytë me bisht të syrit. - Pra, nuk hante pykë. Kishte marrë atë pamjen e saj karakteristike. - Jam e

bindur që edhe ti e di se çfarë pamjeje... - Ajo doli jashtë, por jo pa marrë pushkën e gjahut të babait të vet. Gjatë gjithë kohës që ecëm drejt shtëpisë sime, unë mundohesha ta ndalja, duke i thënë se ai nuk më kishte lënduar edhe aq shumë. Por ajo nuk ma vinte veshin. Ne trokitëm në derë dhe ja tek u shfaq im atë në prag dhe Odi ngriti pushkën dhe ia mbështeti në mjekër e i tha: "Bëje prapë këtë që ke bërë, dhe unë do të kthehem e do të të qëlloj në surrat me këtë pushkë".

Im atë puliti sytë... për një çast iu lidh gjuha. Nuk tha dot asnjë fjalë. Dhe do ta dish pjesën më të bukur, Markos? Unë ula sytë poshtë dhe pashë një pellg të vogël, një pellg me... e po, besoj se e merr me mend... një pellg të vogël që po shpërndahej ngadalë në dysheme midis këmbëve të tij të zbathura. - Madalina u dha flokëve pas dhe tha, me një tjetër shpërthim të qeshure: - Dhe kjo, i dashuri im, është ngjarje e vërtetë.

Nuk ishte nevoja ta thoshte këtë. Unë e dija që ishte e vërtetë. Unë dallova në atë veprim besnikërinë e thjeshtë e të ashpër të mamasë, vendosmërinë e saj si shkëmb graniti. Impulsin, nevojën e saj për të qenë ndreqësja e çdo padrejtësie, mbrojtësja e turmës së nëpërkëmbur. Dhe u binda që ishte plotësisht e vërtetë prej hungërimës me gojë të mbyllur që nxori mamaja, kur dëgjoi atë hollësi të fundit. Ajo nuk e miratoi. Me siguri iu duk gjë e pështirë... Sipas saj, njerëzit, edhe pse mund të kishin pasur një sjellje të qortueshme gjatë jetës, meritonin sadopak dinjitet pas vdekjes. Veçanërisht të afërmit.

Mamaja lëvizi në karrige e tha:

- Pra, Talia, nëse nuk të pëlqen të udhëtosh, çfarë të pëlqen të bësh?

Vështrimet tona u drejtuan nga Talia. Gjatë gjithë asaj kohe kishte folur vetëm Madalina dhe mua më kujtohet që, ndërsa qëndronim të ulur aty në oborr e dielli lëshonte njolla drite përreth nesh, unë mendova se kjo dëshmonte aftësinë

e saj për ta thithur të gjithë vëmendjen drejt vetes, për të përthithur gjithçka në vorbullën që krijonte ajo, në mënyrë që prania e Talias të harrohej krejtësisht. Dhe po ashtu i lashë hapësirë edhe idesë se ato ishin përshtatur me një dinamikë të tillë nga nevoja: vajza e heshtur, e eklipsuar vazhdimisht nga nëna e saj e vetëkënaqur, që i ndryshonte drejtimin vëmendjes; dhe se narcizmi i Madalinës mbase ishte një veprim dashamirësie, një akt mbrojtjeje.

Talia mërmëriti diçka.

- Me zë pak më të lartë, e dashur, - u dëgjua sugjerimi i Madalinës.

Talia pastroi fytin: një tingull krrokatës, si kollë me gëlbazë.

Tani për herë të parë vura re ngjyrën e syve të saj: jeshile si bari i pashkelur i kullotës, flokët pisë të zinj, dhe lëkurën e lëmuar si të së ëmës. Po pyesja veten a kishte qenë e pashme dikur, e mbase edhe e bukur si Madalina.

- Tregoju për orën diellore, e dashur, - tha Madalina.

Talia mblodhi supet.

- Ajo ka ndërtuar një orë diellore, - tha Madalina. - Mu në kopshtin tonë të pasmë. Verën që kaloi. Dhe nuk e ndihmoi asnjeri. Andreasi jo e jo. Por as unë nuk e ndihmova, - gugati ajo.

- Ekuatoriale apo horizontale? - e pyeti mamaja.

Një vezullim habie u shfaq në sytë e Talias. Një lloj reagimi i vonuar. Si një njeri që ecën në një rrugë të mbushur me kalimtarë në një qytet të huaj dhe veshi i kap fjalë të gjuhës së vet.

- Horizontale, - u përgjigj ajo, me atë zërin e vet të çuditshëm.

- Dhe çfarë përdore për shtyllë?

Sytë e Talias u ndalën mbi mamanë.

- Preva një kartolinë.

Për herë të parë tani unë kuptova se si mund të shkonin gjërat ndërmjet atyre të dyjave.

- Kur ishte e vogël e kishte zakon t'i zbërthente të gjitha lodrat që i blinim, - tha Madalina. - I pëlqenin lodrat mekanike, ato me mekanizma brenda. Jo se luante me to, apo jo, e dashur? - Jo, ajo i thyente, gjithë ato lodra të shtrenjta; sapo ia dhuronim, i hapte, të shihte ç'kishin brenda. Mua gjithmonë më ikte truri nga kjo. Por Andreasi - më duhet ta pranoj që ai ka meritën e vet në këtë drejtim - Andreasi më thoshte ta lija të lirë, sepse kjo tregonte se ç'mendje kureshtare kishte ajo.

- Po qe se ke qejf, mund të ndërtojmë bashkë një, - tha mamaja. - Një orë diellore e kam fjalën.

- Unë tani di si ta ndërtoj.

- Më kujdes kur flet, e dashur, - tha Madalina, duke zgjatur njërën këmbë e duke e përthyer pastaj, si të ishte duke bërë nxehjen përpara se të kërcente. - Teta Odi po mundohet të të ofrojë ndihmën e saj.

- Mbase ndërtojmë ndonjë gjë tjetër, - tha mamaja. - Mund të ndërtojmë diçka tjetër.

- Oh! Oh! - bëri Madalina, duke e nxjerrë tymin e duhanit me vrull. - S'më besohet që ende s'ta kam thënë, Odi. Kam lajme të mira. Gjeje pak.

Mamaja mblodhi supet.

- Do t'i kthehem aktrimit! Do të luajmë një film. Më kanë ofruar një rol, rolin kryesor në një film gjigant. A e beson?... E kam marrë tekstin me vete. Do të ta jap ta lexosh, Odi, por kam frikë se s'do të të pëlqejë. Gjë e keqe është kjo? Do të ndihesha e dërrmuar, s'e kam problem të ta them. S'kam për ta përballuar dot. Xhirimet fillojnë në vjeshtë.

Të nesërmen, pasi hëngrëm mëngjes, mamaja më mori veçan.

- Mirë, pra, si është puna? Çfarë nuk shkon me ty?

I thashë se s'po e kuptoja për çfarë e kishte fjalën.

- Të këshilloj të heqësh dorë nga ato gjeste idiote. Nuk të shkojnë, - më tha ajo.

Ajo kishte një mënyrë karakteristike të picërrimit të syve dhe të animit të kokës paksa anash. Edhe sot e kësaj dite kjo bën efekt të plotë mbi mua.

- Nuk e bëj dot, mami. Mos më detyro ta bëj.

- E pse jo, tamam-tamam?

Më doli nga goja vetvetiu, përpara se të arrija ta ndalja:

- Ajo është përbindësh.

Buzët e mamasë u mblodhën. Ajo nuk më pa me zemërim, por me vështrimin e njeriut të zhgënjyer, sikur sapo t'ia kisha thithur të gjithë gjakun. Kishte një lloj dorëzimi përfundimtar në atë vështrim. Si një skulptor që më në fund e përplas në tokë daltën dhe çekiçin, duke hequr dorë nga një bllok gëlqeror që nuk ka për të marrë kurrë formën që ka përfytyruar ai.

- Ajo është një njeri që ka pësuar diçka të tmerrshme. Përdore prapë atë fjalë për të dhe ke për ta parë. Ke për ta parë se ç'do të ndodhë.

Pak më vonë ja tek ishim unë e Talia, duke ecur nëpër një rrugë të shtruar me kalldrëm, të kufizuar prej muresh guri nga të dyja anët. Unë po tregoja kujdes që të isha vazhdimisht disa hapa përpara, që kalimtarët ose - mos e dhëntë Zoti - ndonjë nga shokët e shkollës të mos mendonin se ishim të dashur, çka ata do ta mendonin, gjithsesi. Kushdo mund të na shihte. Dhe unë shpresoja që të paktën ajo largësi midis nesh të tregonte pakënaqësinë, mospranimin tim. Për lehtësimin tim, ajo nuk bëri asnjë përpjekje që të më arrinte. U kaluam pranë fermerëve të lodhur e të përzhitur nga dielli, që po ktheheshin në shtëpi nga pazari. Gomarët e tyre zvarritnin hapat nën peshën e rëndë të koshave me gjëra të pashitura, ndërsa potkonjtë e tyre trokisnin në rrugë. Unë i njihja shumicën e fermerëve, kështu që e mbaja kokën ulur dhe i largoja sytë prej tyre.

Unë e çova Talian në plazh dhe zgjodha një gji shkëmbor,

atë ku shkoja ndonjëherë edhe vetë, sepse e dija që nuk do të kishte aq shumë njerëz sa në plazhet e tjera, si *Agios Romanos*, për shembull. Përvesha pantallonat dhe kërceva nga një shkëmb i thepisur tek tjetri, duke zgjedhur një vend aty ku valët përplaseshin dhe tërhiqeshin pas. Hoqa këpucët dhe futa këmbët në një pellg të vogël që ishte krijuar në një gropë të formuar nga gurët. Një gaforre po ecte në drejtim të kundërt me gishtat e mi. Kurse Talia u ul në të djathtën time, në një shkëmb aty pranë, pak më lart.

Qëndruam aty të ulur për një kohë të gjatë pa thënë asnjë fjalë, duke parë dallgët e detit që përplaseshin pas shkëmbinjve. Një erë e fortë dhe e ftohtë më fishkëllente në veshë, duke ma shpërndarë aromën e kripës në fytyrë. Një pelikan po fluturonte mbi ujin ngjyrë gurkali, me krahët të tendosur plotësisht. Dy zonja në krah të njëra-tjetrës ishin futur në ujë deri në gjunjë dhe i kishin ngritur fundet lart. Andej nga perëndimi, shihja ishullin, ngjyrën e bardhë mbizotëruese të shtëpive e të mullinjve me erë, ngjyrën jeshile të fushave të elbit, ngjyrën kafe të errët të maleve tërë thepa, nga derdheshin përrenj përmbytës çdo vit. Im atë kishte vdekur në njërin prej atyre maleve. Ai punonte në një gurore mermeri jeshil dhe një ditë, kur mamaja ishte gjashtëmuajshe shtatzënë me mua, kishte rrëshqitur në një shkëmb dhe kishte rënë njëqind këmbë poshtë. Mamaja tha se kishte harruar të lidhte rripin e sigurisë.

- Nuk ke pse e bën, - tha Talia.

Unë po mundohesha të qëlloja me guralecë një kazan të vjetër aty pranë dhe ajo i kishte ngulur sytë mbi mua. Nuk po e kuptoja.

- Si është puna?

- Dua të them, boll e mbajte veten më të madh. As mua nuk më pëlqen kjo gjë më shumë se ty.

Era po ia valëviste flokët dhe ajo po e mbante maskën të shtrënguar fort pas fytyrës. Po vrisja mendjen nëse jetonte çdo ditë me një frikë tillë, me frikën se një vrundull ere do t'ia shkulte maskën nga fytyra dhe asaj do t'i duhej që ta ndiqte

pas, me fytyrën të zbuluar. Nuk i ktheva fare përgjigje. Hodha një tjetër guralec, përsëri jo në shenjë.

- Ti je idiot, - tha ajo.

Pas njëfarë kohe, ajo u ngrit në këmbë, ndërsa unë bëra sikur do të qëndroja. Pastaj hodha sytë pas supit tim dhe e pashë që po ecte në drejtim të kundërt me plazhin, drejt rrugës, kështu që mbatha këpucët dhe e ndoqa pas për në shtëpi.

Kur u kthyem, mamaja po merrej me gjellën në kuzhinë, kurse Madalina ishte ulur pranë saj dhe po lyente thonjtë e po pinte cigare, duke e shkundur hirin në një pjatë. Më shkuan ngjethma tmerri, kur pashë se ajo pjatë ishte e kompletit prej porcelani që mamaja kishte trashëguar nga gjyshja e vet. Ishte e vetmja gjë vërtet me vlerë që ajo kishte, ky komplet prej porcelani, dhe ajo rrallë e zbriste nga sirtari i sipërm pranë tavanit, ku e mbante.

Madalina po u frynte thonjve pas çdo lyerjeje dhe po fliste për Patakosin, Papadhopulosin dhe Makarezosin, tre kolonelët që kishin drejtuar grushtin e shtetit - Grushti i Shtetit i Gjeneralëve, siç njihej asokohe - po atë vit në Athinë. Ajo po thoshte se njihte një dramaturg - një "burrë shumë, shumë të mirë", siç po e përshkruante ajo - që e kishin burgosur, ngaqë e kishin akuzuar si komunist të fshehtë.

- Që është absurde, sigurisht! Krejtësisht absurde! E di ti se ç'u bën atyre njerëzve ESA[1], që t'i detyrojë të flasin? - Ajo po e thoshte këtë me zë të ulët, sikur policia ushtarake të ishte fshehur diku në shtëpinë tonë. - U futin një zorrë nga pas dhe e hapin rubinetin e ujit deri në fund. Është e vërtetë, Odi. Të betohem. Ata i ngjyejnë leckat në gjëra të fëlliqura, në të fëlliqurat të njeriut - e kupton? - dhe ua futin njerëzve në gojë.

- E tmerrshme! - tha mamaja me zë të thatë.

Unë po pyesja veten nëse po ndihej ajo që tani e lodhur nga Madalina. Vërshimi i opinioneve të fryra politike të Madalinës, përrallat e festave ku kishte marrë pjesë tok me

---

1) Policia Ushtarake Greke (*shën. i përkth.*).

burrin e saj, poetët, intelektualët dhe muzikantët me të cilët kishte tokur gotat e shampanjës, ajo listë e gjatë me ato udhëtime të panevojshme e të pakuptimta që ajo kishte bërë në vende të tjera. Pikëpamjet e saj për katastrofën nukleare, mbipopullimin dhe ndotjen e mjedisit. Mamaja e duronte Madalinën, i dëgjonte historitë e saj me një vështrim të thatë, por unë e dija që ajo përbrenda nuk e pëlqente. Ajo me siguri mendonte se Madalina po shiste mend. Me siguri ndihej në siklet nga ajo.

Pikërisht kjo është ajo që e malcon, që e helmon dashamirësinë e mamasë, veprimet e saj të guximshme në mbrojtje të të tjerëve: detyrimi për t'i qenë mirënjohës që i mbështjell ata. Kërkesat e saj, detyrimet që të ngarkon ajo. Mënyra se si i përdor ajo këto veprime mirëbërëse, si të jenë monedha të shkëmbyeshme, me të cilat blen besnikërinë dhe devotshmërinë. Tani e kuptoj unë pse Madalina u largua vite më parë. Litari që të tërheq për të të shpëtuar nga rryma, mund të të shndërrohet në një lak rreth qafës. Njerëzit gjithmonë e kanë zhgënjyer mamanë në fund, përfshi edhe mua. Ata nuk arrijnë t'ia kthejnë atë për të cilën i detyrohen, jo në mënyrën që e pret këtë ajo. Çmimi ngushëllues për mamanë është kënaqësia e zymtë se fjalën e fundit e thotë gjithmonë ajo, se është e lirë t'i japë vendimet nga llogorja e avantazhit strategjik, sepse është përherë ajo personi me të cilin janë sjellë në mënyrën e gabuar.

Dhe kjo më ngjall një ndjenjë trishtimi për atë që zbuloj për mamanë time: për nevojën e saj për të tjerët, për ankthin e saj, për frikën nga vetmia, për tmerrin se njerëzit mund ta braktisin. Dhe ç'mund të mendohet për mua, për mua që e kam kuptuar shumë mirë këtë anë të mamasë, që e di me saktësi se për çfarë ka nevojë ajo, dhe prapë ia kam mohuar, me ndërgjegje të plotë e kokëfortësi, dhe jam kujdesur që të kemi një oqean, një kontinent, ose më saktë, të dyja bashkë, midis nesh, për pjesën më të madhe të tre dhjetëvjetëshave?!

- Ata nuk e kuptojnë ironinë e fatit... junta, - po thoshte Madalina, - që i shtypin ashtu njerëzit. Në Greqi! Në vend-

lindjen e demokracisë...! Ah, ja ku qenkeni! Hë pra, si ia kaluat bashkë të dy? Çfarë bëtë?

- Luajtëm në plazh, - tha Talia.

- Ia kaluat mirë? A u kënaqët?

- Ia kaluam shumë mirë, - foli përsëri Talia.

Mamaja i hodhi sytë gjithë mosbesim nga unë tek Talia dhe përsëri tek unë, por Madalinës i ndriti fytyra dhe duartrokiti në heshtje.

- Shumë mirë! Tani që nuk kam për se të shqetësohem më për mënyrën se si merreni vesh ju të dy, unë me Odin mund të kalojmë më shumë kohë bashkë. Si thua, Odi? Kemi ende kaq shumë gjëra për t'i treguar njëra-tjetrës.

Mamaja i buzëqeshi dhe zgjati dorën të merrte një lakër.

Qysh prej këtij çasti, mua me Talian na linin të merreshim me lojërat tona. Supozohej se do të eksploronim ishullin, do të luanim në plazh, do të argëtoheshim në të gjitha mënyrat me të cilat pritet të argëtohen fëmijët. Mamaja na paketonte secilit nga një sanduiç dhe ne dilnim bashkë nga shtëpia, pasi hanim mëngjesin.

Me t'u larguar nga rrezja e shikimit të tyre, zakonisht ndaheshim nga njëri-tjetri. Në plazh, unë hyja në det për të notuar ose qëndroja shtrirë në një shkëmb, pa bluzë, ndërkohë që Talia shëtiste në breg për të mbledhur guaska ose përvidhej shkëmbinjve në ujë, që nuk ishte gjë e mirë, sepse dallgët ishin shumë të larta. Shpesh dilnim të shëtitnim mes shtigjeve që gjarpëronin nëpër vreshtat e fushat e elbit, me sytë të ngulur mbi hijet tona në tokë, secili i kredhur në mendimet e veta. Më së shumti vinim vërdallë pa ndonjë qëllim. Asokohe Tinosi nuk shquhej shumë për turizëm. Në të vërtetë ishte një ishull fermerësh, njerëzit e siguronin jetesën me lopët e dhitë, ullinjtë dhe grurin. Ne përfundonim të mërzitur diku, duke e ngrënë drekën pa folur asnjë fjalë, nën hijen e një peme a të një mulliri

me erë, duke kundruar përroskat, fushat me shkurre gjithë gjemba, malet, detin.

Një ditë shkova në qytet. Ne jetonin në bregun jugperëndimor të ishullit dhe qyteti i Tinosit ishte vetëm pak milje larg më këmbë, në jug. Aty ishte një kinkaleri e vogël e një vejani fytyrërëndë që quhej zoti Rusos. Në vitrinën e dyqanit të tij të vogël mund të gjeje gjithçka, që nga makinat e shkrimit të viteve '40, çizme pune prej lëkure, erëtregues, qirinj gjigantë prej dylli, ndonjë kryq dhe, pa dyshim, edhe fotografi të ikonës *Panagia Evangelistria*. E mbase edhe një krah gorille. Gjithashtu, ai ishte edhe një fotograf amator dhe në pjesën e pasme të dyqanit kishte një dhomë të errët ku zhvillonte filmat. Kur pelegrinët vinin në Tinos çdo gusht për të parë ikonën, zoti Rusos u shiste filma dhe ua lante fotografitë me njëfarë çmimi në dhomën e errët.

Rreth një muaj më parë, mua më kishte kapur syri një aparat fotografik në vitrinën e dyqanit të tij, në një kuti të përdorur lëkure, ngjyrë ndryshku. Një herë në disa ditë, unë shkoja në dyqan, ia ngulja sytë aparatit fotografik dhe e përfytyroja veten në Indi, me rripin e kutisë prej lëkure varur në sup, duke fotografuar orizoret dhe plantacionet e çajit që kisha parë në *"National Geographic"*. Do fotografoja edhe *Inca Trail*-in. Mbi gamile, në një kamion të vjetër që nxirrte tym ose më këmbë, do ta duroja vapën përvëluese, derisa të gjendesha përpara Sfinksit dhe Piramidave, do t'i fotografoja edhe ato dhe mandej do t'i shihja fotografitë e mia të botuara në faqet e ndritshme të revistave. Dhe ishte pikërisht ky aparat fotografik që më bëri të shkoja edhe atë ditë te dyqani i zotit Rusos, edhe pse ishte i mbyllur; unë vetëm po qëndroja aty jashtë, me kokën të mbështetur pas xhamit të vitrinës, duke parë ëndrra me sy hapur.

- Çfarë aparati është ai?

E largova paksa kokën nga xhami dhe pashë aty shëmbëlltyrën e Talias. Ajo po fshinte faqen e majtë me shami.

- Aparat, - mblodha supet unë.

- Duket si një *C3 Argus*, -tha ajo.

- Po ti nga e di?

- Është i vetmi aparat fotografik tridhjetepesëmilimetërsh më i shitur në botë gjatë tridhjetë vjetëve të fundit, - tha ajo me një ton paksa qortues. - Por s'ke ç'i sheh: është i shëmtuar. Duket si një copë tullë. Domethënë ti do që të bëhesh fotograf? Kur të rritesh, domethënë. Kështu thotë mamaja jote.

Unë u ktheva nga ajo.

- Mamaja ime ta tha ty këtë?

- Edhe çfarë pastaj?

Mblodha supet. Nuk më vinte mirë që mamaja i kishte diskutuar këto gjëra me Talian. Vrisja mendjen se si ia kishte thënë. Ajo ishte e aftë që të nxirrte nga arsenali i vet një të folur tallëse e përbuzëse për gjërat që i konsideronte pompoze ose si sorollatje të kota. Ajo mund t'i bënte aspiratat të dukeshin të pavlera përpara vetë syve të tu: "Markosi do që ta marrë botën mbarë më këmbë dhe ta fiksojë në aparatin e tij".

Talia u ul në këmbësore dhe e ngriti fundin mbi gjunjë. Ishte ditë e nxehtë, dielli ta kafshonte lëkurën si të kishte dhëmbë. Zor se të kapte syri ndonjë njeri në rrugë, me përjashtim të një çifti pleqsh që po çapiteshin shpinëkërrusur. Burri, Demisi, kishte vënë një kapelë gri të sheshtë dhe kishte veshur një xhaketë bojëkafe që dukej shumë e trashë për kohën. Më kujtohet që fytyra i kishte marrë një shprehje të ngurtësuar, sytë i ishin bërë gapërr, ashtu siç ndodh shpesh me pleqtë, si të jenë vazhdimisht të habitur nga ajo surprizë e përbindshme që është pleqëria: vetëm disa vjet më vonë, kur i hyra mjekësisë, dyshova më në fund se ai mund të vuante nga parkinsoni. Ata më përshëndetën me dorë, ndërsa kalonin përpara meje, dhe ua ktheva edhe unë përshëndetjen me dorë. I pashë që e vunë re Talian, i ndalën hapat për një çast, pastaj nisën të ecnin sërish.

- Ke aparat fotografik? - më pyeti Talia.

- Jo.

- Ke bërë ndonjëherë fotografi?

- Jo.
- Dhe do që të bëhesh fotograf.
- Të duket e çuditshme?
- Paksa.
- Domethënë, po qe se do të doja të bëhesha polic, edhe kjo do të të dukej e çuditshme, ngaqë unë s'i kam vënë kurrë pranga njeriu?!

E ndjeva në mënyrën se si iu zbut vështrimi i syve që, po të mundej, do të ishte duke buzëqeshur.

- Domethënë që ti je një trap i zgjuar, - tha ajo. - Po të jap një këshillë: mos e përmend aparatin fotografik në sy të mamit tim, sepse ka për të ta blerë. Ajo vdes t'i kënaqë të tjerët. - Dhe e afroi përsëri shaminë te faqja. - Por druaj se Odelisë nuk ka për t'i pëlqyer. Besoj se ti e di edhe vetë këtë.

Po më bënte përshtypje të thellë e njëherazi po ndihesha në siklet nga fakti që ajo kishte kuptuar kaq shumë gjëra në kaq pak kohë. Mbase ishte ajo maska - mendova unë - që i ofronte përparësinë për të qenë e mbuluar, lirinë për t'i vëzhguar gjërat, për t'i shqyrtuar mirë ato, deri në përimtime.
- Ajo me siguri do të të detyrojë ta kthesh prapë në dyqan.
- Unë psherëtiva. Ishte e vërtetë. Mamaja nuk i lejonte të tilla gjëra, aq më tepër po të bliheshin me pará. Talia u ngrit në këmbë dhe shkundi pluhurin nga pas. - Pa më thuaj, a ke ndonjë kuti në shtëpi?

Madalina po pinte verë me mamanë në kuzhinë dhe unë me Talian ishim lart në dhomë, duke lyer me bojë të zezë një kuti këpucësh. Kutia ishte e Madalinës dhe kishte brenda një palë këpucë elegante jeshile, me taka të larta, ende të mbështjella me letër të hollë.

- Ku mendon t'i veshë këto? - e pyeta Talian.

E dëgjoja zërin e Madalinës në katin e parë, që po tregonte për një episod në kursin e aktrimit, kur instruktori i kishte

kërkuar një herë të bënte një ushtrim: të hiqej sikur ishte një hardhucë që po qëndronte pa lëvizur mbi një shkëmb. Pasoi një shpërthim të qeshure, e saja!

Ne e lyem kutinë për herë të dytë dhe Talia tha që duhej t'i jepnim edhe një shtresë të tretë, që të siguroheshim se nuk kishim harruar asnjë cep. Ngjyra e zezë duhej të ishte uniforme dhe e pandërprerë.

- Ky është aparati fotografik, - tha ajo, - një kuti e zezë me një vrimë që lejon të hyjë drita, dhe me diçka që e përthith dritën. Më jep një gjilpërë.

Unë i zgjata një gjilpërë qepëse nga të mamasë. Më e pakta që mund të them, është se isha skeptik lidhur me perspektivën e këtij aparati të bërë vetë, që nuk do të hynte në punë për asgjë. Një kuti këpucësh me një gjilpërë? Por Talia i ishte vërsulur këtij projekti me një vendosmëri e vetëbesim të tillë, saqë mua m'u desh t'i hapja rrugë idesë se edhe mund të funksiononte. Ajo më bënte të mendoja se dinte gjëra që unë nuk i dija.

- Bëra ca përllogaritje, - tha ajo, duke e shpuar kutinë me kujdes me gjilpërë. - Pa lente, nuk e përqendrojmë dot një vrimë gjilpëre në një fytyrë të vogël, kutia është shumë e gjatë. Por ka gjerësinë e duhur. Sekreti është që të hapim një vrimë me përmasat e duhura. Besoj se një vrimë gjashtë-milimetërshe është tamam. Ja pra. Tani na duhet një kapak.

Në katin e parë, zëri i Madalinës ishte shndërruar menjëherë në mërmërimë. Nuk e dëgjoja dot se çfarë po thoshte, por arrija të kuptoja se po fliste më ngadalë se më parë, duke i shqiptuar fjalët mirë, dhe unë po e përfytyroja të përkulur përpara, me bërrylat mbështetur mbi gjunjë, me sytë ngulur mbi ata të dëgjuesit, pa i pulitur për asnjë çast. Me kalimin e viteve unë arrita ta njihja mjaft mirë këtë ton zëri. Kur njerëzit flasin në këtë mënyrë, ata janë duke nxjerrë në shesh diçka, po rrëfejnë një të fshehtë, po tregojnë për një katastrofë, po i përgjërohen atij që i dëgjon. Është mënyra shablon me të cilën lajmësit që trokasin në derë, njoftojnë për numrin e të

vrarëve nga lufta, mënyra me të cilën avokatët u shpjegojnë favoret e vetëshpalljes fajtor klientëve të tyre, policët që ndalojnë makinat në tre të mëngjesit, burrat që tradhtojnë gratë. Sa herë e kam përdorur unë vetë në spitalet e Kabulit? Sa herë i kam futur unë vetë familje të tëra në një dhomë të qetë, u kam kërkuar të ulen, kam tërhequr edhe një karrige për vete, dhe kam mbledhur forcat për t'u dhënë lajmin, gjithmonë duke iu trembur reagimit që do të pasonte?

- Po flet për Andreasin, - tha Talia me zë të thatë. - Vë bast që po. Janë zënë keq. Ma jep pak ngjitësen dhe gërshërën.

- Si është ai? Përveçse që është i pasur, domethënë.

- Kush, Andreasi? Është njeri i mirë. Udhëton shumë. Kur kthehet në shtëpi, vijnë gjithmonë shumë njerëz për vizitë. Njerëz të rëndësishëm: ministra, gjeneralë, nga këta pra. Ata pinë pranë vatrës së zjarrit dhe flasin gjatë gjithë natës, shumicën e kohës për biznes dhe politikë. Unë i dëgjoj nga dhoma ime lart. Më duhet të qëndroj në dhomën time, kur Andreasi ka të ftuar. Nuk duhet të zbres poshtë. Por ai më bën dhurata. Dhe ka paguar edhe një mësues, që të vijë në shtëpi. Dhe më drejtohet gjithmonë me dashamirësi.

Ajo ngjiti një copë drejtkëndëshe kartoni, që gjithashtu e kishte lyer me bojë të zezë, mbi vrimën e gjilpërës.

Në katin e parë u bë qetësi. Unë po ndërtoja skenën në mendjen time. Madalina që po qante pa zë, duke fshirë herë pas here cepat e hundës me shami, si t'i kishte mbetur ndopak akullore e mpiksur, mamaja aspak e gjindshme, që e shihte me një buzëqeshje të lehtë shpuese, a thua se diçka e hidhur po i shkrihej nën gjuhë. Mamaja nuk e duron dot kur njerëzit qajnë në prani të saj. Ajo as sytë nuk ua hedh syve të fryrë, fytyrave lutëse. E konsideron të qarën si shenjë dobësie, një thirrje të tepruar për vëmendje, dhe sigurisht që nuk e justifikon këtë. Ajo është e paaftë për ta ngushëlluar tjetrin. Duke u rritur, unë arrita të kuptoja se ngushëllimi nuk ishte një nga zakonet e saj të forta. Keqardhja duhet të jetë personale,

mendon ajo, jo të ekspozohet. Një herë, kur isha i vogël, e pyeta nëse kishte qarë kur vdiq im atë.

- *Gjatë funeralit. E kam fjalën, gjatë varrimit.*

- *Jo, nuk qava.*

- *Ngaqë nuk ishe e trishtuar?*

- *Ngaqë nuk i hynte në punë njeriu nëse isha apo jo.*

- *Por, po të vdes unë, a do të qash, mami?*

- *Le të shpresojmë që s'kemi për ta përjetuar kurrë këtë, - tha ajo.*

Talia mori kutinë me letër fotografie dhe tha:

- Merr fenerin.

U futëm brenda dollapit të mamasë, e mbyllëm kanatin mirë dhe u siguruam që të mos hynte pikë drite duke vendosur peshqirë te pragu i tij. Kur mbetëm në errësirë të plotë, Talia më kërkoi të ndizja fenerin, që e kishim mbuluar me disa shtresa celofani të kuq. E vetmja gjë që arrija të shihja nën atë ndriçim të dobët, ishin gishtat e Talias që prenë një copë letër fotografie dhe e futën në kutinë e këpucëve në anën e kundërt të vrimës së gjilpërës. E kishim blerë atë letër në dyqanin e zotit Rusos një ditë më parë. Kur po i afroheshim banakut, zoti Rusos ia kishte ngulur sytë Talias përmbi syzet e veta dhe kishte thënë:

- Grabitje është kjo?

Talia kishte drejtuar gishtin tregues nga ai dhe kishte lëvizur gishtin e madh sikur po tërhiqte çarkun.

Talia e mbylli kapakun e kutisë së këpucëve dhe e mbuloi vrimën e gjilpërës me kapakun prej kartoni. Në errësirë tha:

- Nesër ke për të bërë fotografinë e parë të karrierës sate.

Nuk mund të thosha nëse po tallej me mua apo jo.

Ne zgjodhëm plazhin. E vendosëm kutinë e këpucëve në një shkëmb të sheshtë dhe e fiksuam mirë aty; Talia tha se s'duhej të lëvizte fare, kur ta hiqnim kapakun prej kartoni.

Ajo m'u afrua dhe po shihte që përmbi kuti, si të ishte duke parë përmes një lenteje.

- Është pamje e përkryer, - tha ajo.

- Pothuajse. Veçse na duhet një njeri.

Ajo më pa në sy, e kuptoi se çfarë doja të thosha e m'u përgjigj:

- Jo. Nuk kam për të qenë unë.

Ne debatuam për pak çaste dhe ajo më në fund pranoi, por me kusht që të mos i dukej fytyra. I hoqi këpucët, eci këmbëzbathur mbi një radhë shkëmbinjsh pak më tej aparatit, duke i hapur krahët si një ekuilibriste në tel. U ul në shkëmb me fytyrën nga perëndimi, në drejtim të Sirosit dhe Kitnosit. Fryu flokët që të mos i dukeshin rripat lidhës të maskës prapa kokës, dhe ktheu paksa kokën drejt meje që përmbi supin e saj.

- Mos harro, - bërtiti ajo, - numëro deri në njëzet.

Dhe u kthye me fytyrë nga deti.

Unë u përkula mbi kuti, duke parë shpinën e Talias, atë konstelacion shkëmbinjsh përreth saj, rripat e shkumës së detit të gërshetuar ndërmjet tyre si gjarpërinj të ngordhur, një varkë të vogël me vela që lundronte më tej, dallgën që ngrihej, përplasej me forcë në breg e tërhiqej sërish. Hoqa kapakun nga vrima e gjilpërës dhe nisa të numëroja.

*Një... dy... tre... katër... pesë...*

Po qëndrojmë të shtrirë në shtrat. Në ekranin e televizorit dy njerëz me fizarmonika po konkurrojnë me njëri-tjetrin, por Xhiana ia ka ulur zërin. Rripat e dritës së mesditës hyjnë nga hapësirat e grilës dhe kryqëzohen mbi mbeturinat e picës margarita që kishim porositur si shërbim në dhomë, për ta ngrënë për drekë. Atë na e solli një djalë i gjatë e i dobët, me flokë të lëpirë prapa, me xhaketë të bardhë e kravatë të zezë. Në tryezën me rrota që solli ai në dhomë ishte vendosur një vazo e gjatë dhe e hollë me një trëndafil të kuq. Ai e ngriti kapakun që mbulonte picën, me një kënaqësi të madhe dhe

bëri një lëvizje dore si një prestigjator drejt spektatorëve të tij pas shfaqjes së lepurit në kapelën bosh.

Përreth nesh, mbi çarçafët e mbledhur, janë shpërndarë fotografitë. Unë i kam treguar Xhianës fotografitë e udhëtimeve që kam bërë gjatë këtij një viti e gjysmë: Belfast, Montevideo, Tenzhir, Marsejë, Lima, Teheran. I tregoj fotografitë e komunitetit ku qëndrova në Kopenhagen, mes një grupi danezësh bitnikë me bluza të grisura dhe kapuça leshi, që kishin krijuar një komunitet me vetëqeverisje në një bazë ushtarake të dikurshme.

- Po ti ku je? - më pyet Xhiana. - Ti nuk je në fotografi.

- Më pëlqen më shumë të jem prapa aparatit, - i them. Dhe është e vërtetë. Unë kam bërë me qindra fotografi, por vetë nuk gjendem në asnjërën prej tyre. Gjithmonë i porosit fotografitë në dy kopje. Një e mbaj për vete dhe një ia dërgoj Talias me postë në shtëpi.

Xhiana më pyet se ku i gjej paratë për udhëtimet, dhe unë i shpjegoj se i nxjerr nga paratë e trashëgimisë. Kjo është deri diku e vërtetë, sepse trashëgimia është e Talias, jo imja. Ndryshe nga Madalina, që për arsye të kuptueshme nuk u përmend kurrë në testamentin e Andreasit, Talia ishte aty. Dhe presupozohej që unë të mbaroja universitetin me ato para.

*Tetë... nëntë... dhjetë...*

Xhiana ngrihet duke u mbështetur mbi bërryla dhe shtrihet në shtrat për së gjeri, mbi trupin tim, ndërsa gjinjtë e saj cekin lëkurën time. Ajo kap paketën dhe ndez një cigare. E kam takuar një ditë më parë, në "*Piazza di Spagna*". Unë isha ulur në shkallët prej guri që lidhin sheshin me kishën në kodër. Ajo m'u afrua dhe më tha diçka në italisht. Dukej si ato vajzat e shumta italiane që kisha parë të vinin vërdallë në kishat dhe sheshet e Romës pa kurrfarë synimi, që pinin duhan, qeshnin e flisnin me zë të lartë. Unë mohova me kokë dhe thashë:

- Më fal?

Ajo buzëqeshi, lëshoi një "Ah!" dhe me një anglishte me theks të rëndë më tha:

- Çakmak. Për cigaren.

Unë mohova me kokë dhe i thashë me anglishten time me theks të rëndë se nuk e pija duhanin. Ajo buzëqeshi. Sytë i kishte të ndritshëm e shumë të gjallë. Dielli i mëngjesit rrezatonte përreth fytyrës së saj si të ishte diamant.

Unë dremit për disa çaste dhe zgjohem nga një gisht që më shpon në brinjë.

- *La tua ragazza*? - thotë ajo. Ajo ka gjetur fotografinë e Talias, atë që unë i kisha bërë shumë vjet më parë me aparatin fotografik të sajuar vetë në shtëpi. - E dashura jote?

- Jo, - i përgjigjem.

- Motra jote?

- Jo.

- *La tua cugina*? Kushërira?

Unë mohoj me kokë.

Ajo e shqyrton fotografinë me vëmendje edhe për pak çaste, ndërsa thith cigaren.

- Jo, - thotë ajo me zë të mprehtë, madje, për habinë time, edhe e zemëruar. - *Questa é la tua ragazza!* E dashura jote. Po, ashtu është, ti je gënjeshtar!

Dhe pastaj, për tmerrin tim, ajo shkrep çakmakun dhe i vë flakën fotografisë.

*Katërmbëdhjetë... pesëmbëdhjetë... gjashtëmbëdhjetë... shtatëmbëdhjetë...*

Rrugës për te stacioni i autobusit vë re se nuk e kam më fotografinë. U them se duhet të kthehem pas. Nuk kam rrugë tjetër, duhet të kthehem pas. Alfonsoja, një *huaso*[1)] kilian i gjatë e i hollë, me buzë të holla, që ka ardhur me ne si shoqëruesi ynë vullnetar, i hedh një vështrim pyetës Gerit. Geri është amerikan. Ai është drejtuesi i grupit tonë prej tre vetash. Ai ka flokë ngjyrë lajthie dhe puçrra në fytyrë. Fytyra e tij flet qartë për jetën e vështirë që bën. Geri është me humor të keq, të përkeqësuar edhe më nga uria, mungesa e alkolit dhe skuqja

---

1) Fshatar dhe kalorës kilian (*shën.i përkth.*).

e pështirë në pulpën e djathtë, që iu bë pas fërkimit me një gëmushë një ditë më parë. Unë i takova të dy në një klub të mbushur plot në Santiago, ku, pas një gjysmë duzine me *piscolas*[1], Alfonsoja sugjeroi që të ngjiteshim te ujëvara *Salto del Apoquindo,* ku e çonte shpesh i ati, kur kishte qenë fëmijë.

U ngjitëm atje të nesërmen dhe natën e kaluam pranë ujëvarës. Pimë marihuanë, ndërsa gurgullima e ujit na kumbonte në veshë dhe një qiell i hapur i pikëzuar me yje na qëndronte përsipër. Tani po ktheheshim në *San Carlos de Apoquindo* për të marrë autobusin.

Geri ngre strehën e kapelës së tij të gjerë dhe fshin ballin me shami.

- Është tri orë rrugë, Markos, - thotë ai.

- *Tres horas, hágale comprender?* - përsërit Alfonsoja.

- E di.

- Dhe prapë do të kthehesh?

- Po.

- *Para una foto?* - thotë Alfonsoja.

Unë pohoj me kokë. Nuk flas shumë, sepse e di që ata nuk do të më kuptojnë. Edhe unë vetë nuk po arrij ta kuptoj veten.

- Ti e di që do ta humbasësh rrugën, - thotë Geri.

- Mundet.

- Atëherë të priftë e mbara! - thotë Geri, duke më zgjatur dorën.

- *Es un griego loco,* - thotë Alfonso.

Unë qesh. Nuk është hera e parë që më quajnë "grek të çmendur". Tokim duart. Geri rregullon rripat e çantës së shpinës dhe të dy vijojnë rrugën nëpër shtegun përgjatë malit. Geri ma bën edhe një herë me dorë pa e kthyer kokën pas, ndërsa marrin një kthesë rrethore. Në fakt më duhen katër orë të kthehem pas, sepse e humbas rrugën, ashtu siç e kishte

---

1) Pije alkolike shumë popullore në Kili: koktej me raki (*pisko*) dhe koka-kola (*shën.i përkth.*).

parashikuar Geri. Kur mbërrij te vendi i kampingut, jam i rraskapitur nga lodhja. Kërkoj gjithandej, nëpër shkurre, nëpër shkëmbinj. Më pushton tmerri, ndërsa kërkoj më kot. Dhe pastaj, tamam në çastin kur jam duke hequr dorë dhe po e përgatit veten për më të keqen, më kap syri shkëlqimin e diçkaje të bardhë pranë disa gëmushave në një baltovinë të cekët. Fotografia ka ngecur midis ca ferrave. Unë e marr dhe ia fshij pluhurin, ndërsa sytë më vishen nga lot lehtësimi.

*Njëzet e tre... njëzet e katër... njëzet e pesë...*

Në Karakas fle nën një urë. Në Bruksel, në një motel të rinjsh. Ndonjëherë zë edhe ndonjë dhomë të mirë hoteli, bëj një dush të mirë me ujë të nxehtë, rruhem, ha i veshur me rrobë dhome. Shikoj televizor me ngjyra. Qytetet, rrugët, fshatrat, njerëzit që kam takuar, të gjitha nisin të zbehen. I them vetes se jam në kërkim të diçkaje. Por gjithmonë e më shumë më duket sikur po endem pa qëllim, po pres që të më ndodhë diçka, diçka që do të ndryshojë gjithçka, diçka që e kam pritur gjatë gjithë jetës sime.

*Tridhjetë e katër... Tridhjetë e pesë... Tridhjetë e gjashtë...*

Dita e katërt në Indi. Po çapitem nëpër një rrugë gjithë pluhur mes bagëtive, ndërsa bota tundet e gjitha nën këmbët e mia. Kam vjellë gjatë gjithë ditës. Lëkura më është zverdhur si *sari*, dhe më duket sikur po ma rrjepin fasha-fasha duar të padukshme. Kur nuk eci dot më, shtrihem në anë të rrugës. Një burrë plak nga ana tjetër e rrugës hedh diçka në një kazan të madh prej hekuri. Prapa tij gjendet një kafaz, brenda kafazit një papagall kuqeblu. Një vendas lëkurerrët po shtyn një karrocë të mbushur plot me shishe boshe ngjyrë jeshile. Kjo është gjëja e fundit që mbaj mend.

*Dyzet e një... dyzet e dy...*

Zgjohem në një dhomë të madhe. Ajri është shumë i nxehtë dhe mban erë si pjepër i prishur. Jam shtrirë në një shtrat dopio me kornizë hekuri, mbi një dyshek jo më të trashë se një libër. Dhoma është e mbushur me shtretër si ky imi.

Shoh krahë skeletikë që varen anash tyre, këmbë si kunja shkrepësesh që dalin jashtë çarçafëve të ndotur, gojë të hapura, me dhëmbë të rënë. Në tavan, ventilatorë që nuk punojnë. Mure të veshura me njolla myku. Nga dritarja pas kokës sime hyn ajër i nxehtë e i lagësht dhe një dritë dielli që të vret sytë. Një infermier, një mysliman i shëndoshë e vetullngrysur, që quhet Gul, më thotë se mund të vdes nga hepatiti.

*Pesëdhjetë e pesë... Pesëdhjetë e gjashtë... Pesëdhjetë e shtatë...*

Unë kërkoj çantën time të shpinës.

- Çfarë çante? - thotë Guli shpërfillshëm. Nuk më ka mbetur asgjë: rrobat, paratë, librat, aparati fotografik. - Vetëm këtë të ka lënë hajduti, - thotë Guli me anglishten e tij të çalë, duke bërë me gisht drejt parvazit të dritares mbi kokën time. Është fotografia. Unë e marr në dorë. Talia, flokët e saj që valëviten nga era, uji që shkumon përreth saj, këmbët e saj të zbathura mbi shkëmb, Egjeu që shpaloset përpara syve të saj. Një nyje më mblidhet në fyt. Nuk dua të vdes këtu, mes këtyre njerëzve të huaj, kaq larg prej saj. Dhe e vendos fotografinë përsëri në parvazin e dritares.

*Gjashtëdhjetë e gjashtë... Gjashtëdhjetë e shtatë... Gjashtëdhjetë e tetë...*

Djali në shtratin pranë meje ka fytyrën e një burri, gjithë rrudha, me faqe të fishkura, të futura brenda. Në pjesën e poshtme të barkut ka një masë të fryrë me përmasat e një topi bullingu. Çdo herë që një infermier e prek aty, ai mbyll sytë, i shtrëngon qepallat fort dhe nga goja i del një ofshamë e heshtur agonie. Këtë mëngjes, njëri nga infermierët, jo Guli, po mundohet t'i japë barnat, por djali tund kokën sa nga njëra anë në tjetrën, ndërsa nga fyti i dalin ca tinguj si të limës mbi dru. Më në fund infermieri ia hap gojën me forcë dhe ia ngjesh pilulat me zor. Kur ai largohet, djali kthen kokën ngadalë drejt meje. Ne e shohim njëri-tjetrin në sy në hapësirën midis shtretërve tanë. Një lot i vogël i rrjedh nga syri dhe i rrokulliset në faqe.

*Shtatëdhjetë e pesë... Shtatëdhjetë e gjashtë... Shtatëdhjetë e shtatë...*

Vuajtja, dëshpërimi në këtë vend janë si dallgë. Ata dalin nga çdo shtrat, përplasen pas mureve të veshura me myk, tërhiqen rishtas mbrapsht e mandej përplasen pas teje. Ata mund edhe të të mbytin. Unë fle shumë. Kur nuk fle, kam shumë kruarje. Pi barnat që më japin ata, dhe më zë gjumi përsëri. Përndryshe, shoh rrugën e zhurmshme jashtë fjetores, rrezet e diellit që bien mbi tendat e pazarit dhe dyqanet e çajit nëpër rrugicë. Shoh fëmijët që gjuajnë bilat e mermerit në trotuaret e kredhura në baltë, gratë plaka të ulura te pragu i derës, shitësit endacakë të veshur me *dhotis*, ulur mbi rrogozat e tyre, duke gërryer pjesën e brendshme të një are kokosi, duke shitur lulevargje ngjyrë pjepri. Dikush lëshon një piskamë që të shpon veshët nga ana tjetër e dhomës. Më del gjumi.

*Tetëdhjetë e tre... tetëdhjetë e katër... tetëdhjetë e pesë...*

Mësoj se djali quhet Manar. Do të thotë "dritë që të drejton". E ëma ka qenë prostitutë, i ati hajdut. Ai ka jetuar me tezen e dajën që e rrihte. Asnjeri nuk e di me saktësi se çfarë sëmundjeje ka, vetëm se ajo që ka, po e vret. Askush nuk vjen ta shohë dhe, kur të vdesë pas një jave, e shumta pas një muaji ose dy, askush nuk ka për të ardhur që ta marrë trupin e tij. Askush nuk ka për ta qarë. Askush nuk ka për ta kujtuar. Ai do të vdesë aty ku ka jetuar, në njerim. Kur e zë gjumi, unë e gjej shpesh veten me sytë nga ai, tek tëmthat e bërë gropë, te koka shumë e madhe për supet e tij, te vraja me ngjyrë në buzën e tij të poshtme, ku, siç më ka thënë Guli, e kishte zakon të fikte cigaren tutori i së ëmës. Mundohem t'i flas në anglisht dhe pastaj me ato pak fjalë urdu që di, por ai pulit sytë i lodhur. Ndonjëherë unë bashkoj duart dhe formoj hije kafshësh në mur që të arrij t'i rrëmbej një buzëqeshje.

*Tetëdhjetë e shtatë... tetëdhjetë e tetë... tetëdhjetë e nëntë...*

Një ditë Manari bën shenjë me gisht drejt diçkaje jashtë dritares mbi kokën time. Unë ndjek drejtimin e gishtit të tij,

ngre kokën, por nuk shoh asgjë tjetër përveç hapësirave blu të qiellit midis reve, fëmijëve në rrugë që po lagin njëri-tjetrin me ujin e një çezme, një autobus që ecën duke rënkuar. Dhe pastaj vë re se ai po bën me gisht drejt fotografisë së Talias. Unë e marr nga parvazi i dritares dhe ia zgjat. Ai e afron pranë fytyrës, nga cepi i djegur, dhe ia ngul sytë për një kohë të gjatë. Unë vras mendjen se mos është oqeani ai që po e tërheq. Pyes veten a e ka shijuar ndonjëherë ujin e kripur ose a i janë marrë ndonjëherë mendtë duke parë valën që tërhiqet nga këmbët e tij. Ose, mbase, edhe pse nuk ia sheh fytyrën, ai nuhat se ka diçka të përbashkët me Talian, me dikë që e di se ç'është dhembja. Ai ma kthen fotografinë. Unë mohoj me kokë.

- Mbaje, - i them.

Një hije mosbesimi i bie mbi fytyrë. Unë buzëqesh. Dhe, edhe pse nuk jam i sigurt, më duket sikur më buzëqesh edhe ai.

*Nëntëdhjetë e dy... nëntëdhjetë e tre... nëntëdhjetë e katër...*

Unë e mund hepatitin. Por për çudi nuk mund të them në është i kënaqur apo i zhgënjyer Guli, të cilit i dëshmova se e kishte gabim. Por e di që e habit së tepërmi fakti që e pyes nëse mund të qëndroj vullnetarisht për të ndihmuar. Ai ul kokën, ngrys ballin. Dhe unë detyrohem të flas me një nga kryeinfermierët.

*Nëntëdhjetë e shtatë... nëntëdhjetë e tetë... nëntëdhjetë e nëntë...*

Dhoma e larjes mban era urinë dhe sulfur. Çdo mëngjes unë e çoj Manarin aty, duke e mbajtur trupin e tij të zhveshur në krahë, duke treguar kujdes që të mos e trondit. E kam parë se si e mbanin vullnetarët më parë, si e hidhnin në shpinë si të ishte një thes me oriz. Unë e ul me ngadalë në stol dhe pres që t'i normalizohet frymëmarrja. E lag trupin e tij të vogël e të brishtë me ujë të ngrohtë. Manari gjithmonë qëndron i ulur në heshtje, me durim, me pëllëmbët e duarve mbi kupat e gjunjëve,

me kokën të ulur. Ai është si një burrë plak kockë e lëkurë i mbushur me frikë. Unë e kaloj sfungjerin me shkumë mbi kafazin e tij të kraharorit, mbi nyjet e dala të shtyllës kurrizore, mbi kockat e shpinës që i kërcejnë si lopata peshkaqeni. Pastaj e kthej përsëri në shtrat dhe i jap barnat. Ai ndihet mirë, kur ia masazhojnë shpinën dhe këmbët, kështu që unë e bëj çdo ditë, ngadalë. Kur e zë gjumi, gjithmonë e ka fotografinë e Talias gjysmë të futur nën jastëk.

*Njëqind e një... Njëqind e dy...*

Unë dal të bëj shëtitje të gjata më këmbë nëpër qytet, pa kurrfarë qëllimi, qoftë edhe thjesht për t'u larguar nga spitali, nga ajo frymëmarrje kolektive sëmundjeje dhe vdekjeje. Eci nëpër muzgjet gjithë pluhur në rrugët ndanë mureve të zhgarravitura me grafit, ndanë dyqaneve të ngjitura me njëri-tjetrin, duke u shkëmbyer me vajzat e vogla që mbajnë koshat e mbushur me pleh të papërpunuar mbi kokët e tyre, gra të veshura me të zeza që ziejnë leckurinat e tyre nëpër kazanë gjigantë prej alumini. Dhe mendoj vazhdimisht për Manarin, teksa eci nëpër ato rrugica të ngushta, ndërkohë që Manari pret të vdesë në atë dhomë të mbushur plot me silueta të thyera si e tij. Mendoj vazhdimisht për Talian e ulur në shkëmb, duke parë detin. E ndiej se diçka po ndodh brenda meje, diçka po më përthith si një vorbull e nënujshme. Dhe unë dua t'i jepem i gjithi, të përmbytem prej saj. Dua që të heq dorë nga gjithçka, të dal nga ajo vete që jam tani, ta flak tutje atë, ashtu siç zhvesh gjarpri lëkurën e vjetër.

Nuk po them se ishte Manari ai që ndryshoi gjithçka. Jo ai. Unë u enda nëpër botë edhe për një vit tjetër, përpara se ta gjeja veten në një tryezë në një qoshe salle të njërës prej bibliotekave të Athinës, me sytë ngulur mbi një aplikim për një shkollë mjekësie. Midis Manarit dhe këtij aplikimi janë dy javët që kalova në Damask, nga të cilat nuk kam asnjë kujtim, përveç fytyrave të qeshura të dy grave me sy të lyer rëndë, secila me nga një dhëmb floriri. Si dhe të tre muajt e kaluar në Kajro në bodrumin e një shtëpie karakatinë, pronari i së cilës

pinte hashash. Unë i lashë paratë e Talias nëpër autobusët e Islandës, nëpër rrugët e Mynihut, duke i rënë pas një orkestre të pavlerë. Në vitin 1977 theva një bërryl në një protestë kundërnukleare në Bilbao.

Por gjatë atyre çasteve të qeta, gjatë atyre rrugëtimeve të gjata, në fundin e një autobusi a në shtratin e një kamioni, mendja më kthehej gjithmonë te Manari. Më kujtohej ai, angështia e ditëve të tij të fundit dhe dëshpërimi im përballë asaj situate, që e shndërronte gjithçka që kisha bërë, gjithçka që kisha dashur të bëja, në një gjë po aq të pavlerë e të parëndësishme sa edhe premtimet e vogla që i bëjmë vetes, kur biem për të fjetur, premtime që i harrojmë sapo na del gjumi sërish.

*Njëqind e nëntëmbëdhjetë... njëqind e njëzet...*

Unë e lëshoj kapakun.

Një natë në fund të asaj vere, mësova se Madalina do të nisej për në Athinë dhe do ta linte Talian me ne, të paktën për njëfarë kohe.

- Vetëm për disa javë, - tha ajo.

Ishim shtruar për të ngrënë darkën, që të katër, një supë me fasule të bardha, që mamaja e Madalina e kishin gatuar bashkë. Hodha vështrimin drejt Talias, për të kuptuar se mos unë isha i vetmi të cilit ia kishte dhënë atë lajm Madalina. Dhe me sa u duk, isha. Talia po hante e qetë duke e afruar lugën te goja e duke e ngritur paksa maskën çdo herë. Tani mënyra se si fliste dhe si hante, nuk më shqetësonin më, ose, të paktën, nuk më shqetësonin më shumë se ato të një personi që i lëvizin protezat e dhëmbëve, siç do të ndodhte disa vjet më vonë me mamanë.

Madalina tha se do të dërgonte njerëz ta merrnin Talian, pasi të mbaronin xhirimet e filmit, çka duhej të ndodhte diku përpara Krishtlindjeve.

- Në fakt, unë do t'ju marr të gjithëve në Athinë, - tha ajo, me fytyrën që i vezullonte nga buzëqeshja e zakonshme dashamirëse. - Dhe do të shkojmë të gjithë bashkë të shohim premierën! A nuk do ishte e mrekullueshme kjo, Markos? Të katër ne, të veshur shik, duke kërcyer vals me shumë stil në kinema?

I thashë se do të ishte, edhe pse e kisha të vështirë ta përfytyroja mamanë me një fustan elegant ose duke kërcyer.

Madalina po më shpjegonte se si do të shkonin gjërat për bukuri, se si do t'i riniste Talia mësimet me të filluar shkolla pas disa javësh, në shtëpinë tonë, afërmendsh, me mamanë si mësuese. Ajo tha se do të na dërgonte letra, kartolina dhe fotografi nga xhirimet e filmit. Tha edhe shumë gjëra të tjera, por unë nuk i dëgjova të gjitha. Unë po ndieja një lloj lehtësimi të jashtëzakonshëm dhe një padurim të hapur. Tmerri se verës po i vinte fundi, më shtrëngonte si lëmsh në stomak, më shtrëngonte gjithmonë e më shumë për çdo ditë që kalonte, ndërsa unë mundohesha t'i jepja zemër vetes për ndarjen që do të vijonte. Tani unë zgjohesha çdo mëngjes me padurimin për të parë Talian në tryezë, për të dëgjuar tingujt e çuditshëm të zërit të saj. Pa e mbaruar mirë mëngjesin, ne ishim jashtë duke u kacavjerrë nëpër pemë, duke ndjekur njëri-tjetrin nëpër fushat me elb, duke lëshuar kushtrime lufte, ndërsa hardhucat largoheshin me vrap nëpër këmbët tona. Ne silleshim sikur kishim gjetur thesare nëpër shpella, gjenim ato zona të ishullit që kishin jehonën më të pastër e më kumbuese. Fotografonim mullinjtë me erë dhe foletë e pëllumbave me aparatin tonë primitiv dhe ia çonim ato zotit Rusos, që i lante për ne. Ai madje na linte të hynim në dhomën e tij të errët dhe na fliste për zhvilluesit e ndryshëm të filmave, fiksuesit dhe tretësirat e larjes.

Natën që Madalina dha lajmin e saj, ajo me mamanë pinë verë në kuzhinë. Ishte Madalina ajo që piu më shumë, ndërsa unë me Talian ishim lart, duke luajtur tavëll. Talia kishte pozi-

cionin *mana* dhe i kishte futur tashmë gjysmën e gurëve të saj në kuadratin e vet.

- Ajo ka një të dashur, - tha Talia, ndërsa hidhte zaret.

Unë kërceva përpjetë.

- Kush?

- "Kush" thotë. Kush thua ti?

Gjatë verës kisha mësuar që t'i lexoja shprehjet e fytyrës së Talias në sytë e saj dhe ajo tani po më shihte sikur unë të isha duke qëndruar në breg të detit e po e pyesja se ku ishte uji. Unë e mblodha veten në çast.

- E di se kush, - i thashë, me faqet që po më përvëlonin. - Doja të thosha kush është... ti e kupton... - Unë isha vetëm një djalë dymbëdhjetëvjeçar. Në fjalorin tim nuk gjendeshin fjalë të tilla si "i dashuri".

- S'e merr dot me mend? Regjisori.

- Atë do të thosha edhe unë.

- Eliasi. Ai i kreh flokët si në vitet '20. Ka edhe një palë mustaqe të holla. Besoj se kjo e bën ti duket vetja si trimosh. Ai është qesharak. Sigurisht që i është mbushur mendja se është artist i madh. Edhe mami ashtu mendon. Veç ta shohësh kur është me atë, komplet e druajtur dhe e nënshtruar, a thua se e ndien të nevojshme të përkulet përpara tij e t'i thurë lavde për gjenialitetin e tij. S'arrij ta kuptoj si nuk e vë re ajo.

- Do të martohet me të teta Madalina?

Talia mblodhi supet.

- Ajo s'di fare si t'i zgjedhë burrat. Fare! - Dhe tundi zaret në dorë e u duk se po mendohej. - Me përjashtim të Andreasit, mbase. Ai është njeri i mirë. Mjaftueshëm i mirë. Por, sigurisht që ajo do ta lërë. Asaj gjithmonë i pëlqejnë bastardët.

- Do të thuash, si babai yt?

Ajo ngrysi paksa vetullat.

- Im atë ishte një i panjohur që ajo e takoi rrugës për në Amsterdam. Në një stacion treni gjatë një stuhie. Kaluan një

pasdite bashkë. Unë as që e kam idenë se kush është ai. Madje as ajo vetë.

- Oh! Më kujtohet që ajo tha diçka për burrin e saj të parë. Tha që ai pinte. Thjesht mendova...

- E po, ka qenë fjala për Dorianin, - tha Talia. - Ai ishte ashtu. - Ajo futi edhe një tjetër gur nga të sajët në kuadratin e vet. - Ai e rrihte. Ai, sa hap e mbyll sytë, mund të shndërrohej nga një njeri i dashur dhe i këndshëm në një njeri të tërbuar. Tamam si moti, ashtu siç ndryshon moti papritur! Ashtu ishte ai. Pjesën më të madhe të ditës e kalonte duke pirë, nuk bënte pothuajse asgjë dhe vetëm vinte vërdallë nëpër shtëpi. Kur pinte, harronte fare. Mund të linte çezmën hapur, për shembull, dhe mund ta përmbytte shtëpinë me ujë. Më kujtohet që një herë harroi të fikte sobën dhe pothuajse shkrumboi gjithçka. - Ajo formoi një kullë të vogël duke i vënë gurët e tavllës njëri përmbi tjetrin. Dhe për njëfarë kohe u mor me të, pa thënë asnjë fjalë. - E vetmja gjë që Doriani donte vërtet, ishte Apolloja. Të gjithë fëmijët e lagjes e kishin frikë... Apollon e kam fjalën. Dhe pothuajse asnjëri prej tyre nuk e kishte parë atë; kishin dëgjuar vetëm të lehurën e tij. Por kaq u mjaftonte. Doriani e mbante të lidhur në pjesën e pasme të kopshtit. Dhe e ushqente me copa të mëdha mishi qengji.

Talia nuk shtoi asgjë më shumë. Por unë e pata mjaft të lehtë ta përfytyroja. Doriani që vdiq, qeni i harruar, që vinte vërdallë nëpër oborr. Një derë shtëpie e hapur.

- Sa vjeç ishe atëherë? - e pyeta me zë fare të ulët.

- Pesë.

Dhe pastaj i bëra atë pyetjen që e kisha pasur në mendje qysh prej fillimit të verës.

- A nuk mund... dua të them... a ka ndonjë gjë që mund të bëhet...?

Talia ktheu kokën nga ana tjetër.

- Të lutem mos më pyet, - tha ajo me zë të rëndë, që mua më dha të kuptoja se po ndiente një dhembje të thellë. - Kjo më lodh.

- Më fal! - i thashë.

- Një ditë do të ta tregoj.

Dhe ajo ma tregoi, ca kohë më vonë. Operacioni plastik i dështuar, plaga operatore e infektuar që e çoi në mënyrë katastrofike në gjendje septike: veshkat u ndalën së funksionuari, mëlçia po ashtu; ata u detyruan ta hiqnin indin e transplantuar dhe tok me të edhe atë që kishte mbetur nga faqja e majtë, si dhe një pjesë të nofullës. Ndërlikimet e kishin detyruar të qëndronte në spital për gati tre muaj. Kishte qenë fare pranë vdekjes, duhej të kishte vdekur. Pas kësaj, ajo nuk kishte ndër mend t'i linte ta preknin përsëri.

- Talia, - i thashë, - më vjen keq për atë që ndodhi kur u takuam.

Ajo më vështroi. Shkëlqimi i njohur lozonjar iu kthye sërish në sy.

- Duhet të të vijë keq. Por unë e dija që përpara se të përpëliteshe ashtu mbi dysheme.

- Çfarë dije?

- Që ti je trap.

Madalina u largua dy ditë përpara se të niste shkolla. Ajo kishte veshur një fustan të ngushtë pa mëngë, me ngjyrë të verdhë gjalpi, kishte vënë një palë syze dielli me skelet të trashë dhe një shall të bardhë mëndafshi në kokë, të lidhur shtrënguar, që të mos i lëviznin flokët. Ishte veshur si të kishte frikë se mund të humbiste ndonjë pjesë të trupit të saj, tamam sikur, me plot kuptimin e fjalës, të ishte duke i mbajtur pjesët e veta së bashku. Në portin e qytetit të Tinosit, ajo na përqafoi të gjithëve. Talian e shtrëngoi më fort e më gjatë se ne të tjerët, duke i mbajtur buzët të mbështetura mbi ballin e saj, në një puthje të zgjatur, të pandërprerë. Syzet e diellit nuk i hoqi për asnjë çast.

- Më përqafo, - e dëgjova të pëshpëriste.

Talia iu bind, me lëvizje të ngurta.

Kur trageti gjëmoi dhe nisi të largohej, duke lënë pas një gjurmë shkume uji, mendova se Madalina do të dilte te kiçi, do të na përshëndeste e do të na dërgonte puthje me dorë. Por ajo u drejtua për te bashi dhe u ul në një ndenjëse. Dhe nuk e ktheu më kokën nga ne.

Kur u kthyem në shtëpi, mamaja na tha të uleshim. Ajo qëndroi më këmbë përpara nesh e tha:

- Talia, dua që ta dish se nuk është nevoja ta mbash më atë gjë në këtë shtëpi. Jo për mua. Dhe as për atë. Do ta mbash vetëm nëse dëshiron ti vetë. Për këtë nuk kam ç'të them tjetër.

Vetëm në atë çast unë e kuptova atë që mamaja e kishte kuptuar prej kohësh. Që ajo maskë kishte qenë për Madalinën. Për ta mbrojtur atë nga sikleti dhe turpi.

Për një kohë të gjatë, Talia nuk bëri asnjë lëvizje e nuk tha asnjë fjalë. Pastaj, ngadalë, ngriti duart lart dhe i zgjidhi rripat e maskës në zverk. E uli maskën. Unë e pashë drejt e në fytyrë. Në çast ndieva një nevojë të fuqishme për t'i larguar sytë prej saj, njësoj si kur dëgjon një zhurmë të fuqishme të papritur. Por nuk e bëra. I mbajta sytë mbi fytyrën e saj. Dhe e detyrova veten që të mos i pulisja qepallat.

Mamaja tha se do të më jepte edhe mua mësime në shtëpi, derisa të kthehej Madalina, kështu që Talia nuk do të mërzitej duke qëndruar vetëm. Ajo na bënte mësim në mbrëmje, pasi hanim darkë, dhe na jepte detyra shtëpie, që t'i bënim në mëngjes, gjatë kohës kur ajo ishte në shkollë. Dukej si diçka që do të funksiononte, të paktën teorikisht.

Por, që të mësonim, veçanërisht gjatë kohës kur mamaja nuk ishte në shtëpi, doli se ishte diçka krejtësisht e pamundur. Lajmi i shfigurimit të Talias ishte përhapur në të gjithë ishullin dhe njerëzit trokisnin vazhdimisht në derën tonë, të nxitur nga kërshëria. Mund të mendoje se në ishull befas nuk kishte mbetur asnjë kokërr grurë ose hudhër e, madje, asnjë kokërr kripë

dhe i vetmi vend ku mund t'i gjeje, ishte shtëpia jonë. Dhe ata pothuajse nuk bënin asnjë përpjekje për ta fshehur qëllimin e tyre të vërtetë.

Te dera, ata gjithmonë i shqyenin sytë për të parë përtej supeve të mia. Zgjatnin qafën, ngriheshin në majë të gishtave. Shumica e tyre nuk ishin as fqinjë. Ata përshkonin milje të tëra më këmbë për një filxhan me sheqer. Afërmendsh që kurrë nuk i lashë të hynin brenda. Në njëfarë mënyre ndieja kënaqësi kur ua mbyllja derën në fytyrë. Por po ashtu ndihesha i trishtuar, i shkurajuar, i vetëdijshëm se, po të rrija këtu, këta njerëz do të ndikonin thellë në jetën time. Në fund, unë do të bëhesha njësoj si ata.

Fëmijët ishin edhe më keq e më të pacipë. Çdo ditë i kapja që silleshin vërdallë përreth shtëpisë, ngjiteshin mbi mur. Unë isha duke shkruar dhe Talia më prekte në sup me lapsin e saj, ktheja kokën dhe gjeja një fytyrë, e ndonjëherë më shumë se një, ngjitur pas xhamit të dritares. Gjërat nisën të shkonin aq keq, sa ne u detyruam të rrinim në katin e dytë e t'i mbanim perdet të mbyllura. Një ditë hapa derën dhe gjeta te pragu një djalë nga të shkollës, Petrosin, dhe tre shokë të tij. Ai më zgjati një grusht plot me monedha vetëm për ta parë një herë. Iu përgjigja që jo. Ku mendonte se ishte ai, në cirk?

Në fund, u detyrova t'ia tregoj të gjitha mamasë. Kur e dëgjoi këtë, fytyra i mori një ngjyrë të kuqe të thellë. Shtrëngoi dhëmbët fort.

Të nesërmen në mëngjes ajo i kishte vënë librat tanë dhe dy sanduiçë mbi tryezë. Talia e kuptoi shumë më parë se unë dhe u mblodh si gjethe. Dhe nisi të kundërshtonte fuqishëm, kur erdhi koha të dilnim nga shtëpia.

- Teta Odi, jo!
- Ma jep dorën!
- Jo. Të lutem!
- Hajde. Ma jep dorën!
- Nuk dua të vij.

- Do të vonohemi.

- Të lutem mos më detyro, teta Odi!

Mamaja e ngriti Talian nga karrigia duke e tërhequr për duarsh dhe duke i ngulur një vështrim që unë e njihja mjaft mirë. Nuk kishte gjë në botë që mund t'i kundërshtonte asaj tani.

- Talia, - i tha ajo, duke ia dalë mbanë që të tingëllonte njëherazi e butë dhe e vendosur. - Unë nuk kam turp prej teje.

Ne dolëm nga shtëpia, që të tre: mamaja, me buzët të shtrënguara fort, duke ecur përpara e vendosur, si të ishte duke çarë përmes një ere të tërbuar, me hapa të vegjël, të shpejtë. Unë arrija ta përfytyroja mamanë duke ecur në të njëjtën mënyrë drejt shtëpisë së Madalinës, shumë vjet më parë, me pushkën në dorë.

Njerëzve u mbetej fjala në grykë e na i ngulnin sytë fort, kur kalonim përpara tyre nëpër rrugicat gjithë erë. Ata ndalnin hapat, që të na shihnin. Disa prej tyre edhe na tregonin me gisht. Unë mundohesha të mos i shihja. Ata ishin thjesht hije fytyrash ngjyrë dylli me gojë të hapura, në rrethinat e vështrimit tim.

Në oborrin e shkollës, fëmijët na hapën rrugë për të kaluar. Dëgjova disa vajza që britën. Mamaja u hodh drejt tyre si një top bullingu drejt birilave, duke e tërhequr Talian pas vetes. Ajo çau përpara drejt një cepi të oborrit, ku gjendej një stol. U ngjit vetë në stol, ndihmoi edhe Talian që të ngjitej aty dhe pastaj fërshëlleu me gishta tri herë. Një mërmërimë e përshkoi të gjithë oborrin e shkollës.

- Kjo është Talia Janakosi, - bërtiti mamaja. - Që sot e tutje... - ajo heshti. - Kushdo që është duke qarë tani, ta qepë gojën përpara se unë t'i jap një arsye të vërtetë për ta bërë. Tani, që sot e tutje, Talia do të jetë nxënëse në këtë shkollë. Dhe unë pres që ju ta trajtoni mirë e të silleni mirë me të. Po qe se më vijnë fjalë që jeni tallur, kam për ta gjetur se kush e ka bërë dhe do t'ju bëj të mallkoni veten që e bëtë. Ju e dini që unë e bëj. Nuk kam ç'të them më për këtë gjë.

Ajo zbriti nga stoli, duke e mbajtur Talian për dore dhe u drejtua për në klasë. Që nga ajo ditë, Talia nuk e mbajti më maskën, as në shtëpi, as jashtë saj.

Disa javë përpara Krishtlindjeve të atij viti, morëm një letër nga Madalina. Xhirimet e filmit kishin pësuar disa vonesa të papritura. Në fillim DIF, - shkruante Madalina, dhe Talia na shpjegoi mua e mamasë se bëhej fjalë për drejtorin e fotografisë -, kishte rënë nga shkallët dhe kishte thyer krahun në tri vende. Pastaj moti i keq i kishte vështirësuar xhirimet në të gjitha vendet.

*"Kështu që tani jemi paksa "në gjendje pritjeje", siç thonë ata. Nuk do të kishte qenë një gjë edhe aq e keqe, sepse kjo na jep kohën e nevojshme për të ndrequr disa pasaktësi në skenar, po qe se nuk do ta shtynte për më vonë takimin tonë. Ndihem e dërrmuar, të dashurit e mi. Më mungoni shumë të gjithë, veçanërisht ti, Talia, shpirti im. Kam nisur të numëroj ditët, derisa të vijë pranvera, këto xhirime të marrin fund dhe unë të jem përsëri pranë teje. Ju kam të treve në zemër në çdo çast të ditës."*

- Ajo nuk do të kthehet, - tha Talia me zë të thatë, duke ia zgjatur letrën mamasë.

- Sigurisht që do të kthehet! - thashë unë, si budalla, i habitur. U ktheva nga mamaja e po prisja që ajo të thoshte diçka, të paktën të nxirrte një fjalë inkurajuese nga goja. Por ajo e palosi letrën, e la mbi tryezë dhe, pa thënë asnjë fjalë, shkoi të vinte ujin në zjarr për të bërë kafen. Dhe mua më kujtohet që po mendoja se ajo po tregohej e pandjeshme me Talian, që nuk po i thoshte asnjë fjalë ngushëlluese, edhe pse e dinte se Madalina nuk do të kthehej më. Por unë nuk e dija - ende jo - se sa mirë kuptoheshin ato të dyja me njëra-tjetrën, mbase shumë më mirë nga sa e kuptoja unë secilën prej tyre. Mamaja

e respektonte shumë Talian e nuk mund ta mbante me shpresa të rreme. Nuk mund ta fyente atë me të tilla gjëra.

Pranvera erdhi, me gjithë lavdinë e saj me ngjyrë të gjelbër, dhe iku përsëri. Ne morëm nga Madalina vetëm një kartolinë dhe një letër që dukej si e shkruar me shumë ngut, në të cilën na thoshte se kishin pasur përsëri probleme me xhirimet, këtë herë me financuesit, që i kishin kërcënuar se nuk do t'u jepnin asnjë kacidhe për shkak të vonesave. Në këtë letër, krejt ndryshe nga e para, ajo nuk e përcaktonte më kohën se kur mund të kthehej.

Një pasdite të ngrohtë në fillim të verës - ka qenë viti 1968 - unë me Talian shkuam në plazh me një vajzë që quhej Dori. Asokohe, Talia kishte një vit që jetonte me ne në Tinos dhe shfigurimi i saj nuk nxiste më pështpërima e vështrime ngultazi drejt nesh. Ajo ende ishte dhe do të ishte vazhdimisht e qarkuar nga një rreth kërshërish, por edhe kjo po shuhej pak nga pak. Tani ajo kishte shoqet e veta, ndërmjet tyre edhe Dorin, që nuk trembeshin më nga pamja e saj e jashtme, shoqe me të cilat hante drekën, bënte thashetheme, luante pas shkollës, mësonte. Ajo ishte shndërruar, sado e pagjasshme të duket, në një njeri pothuajse të zakonshëm dhe mua më duhet ta pranoj se kisha nisur t'i admiroja banorët e ishullit, që e kishin pranuar si të ishte njëra prej tyre.

Atë pasdite, të tre e kishim bërë në plan që të notonim, por uji ishte ende i ftohtë dhe ne qëndruam për pak kohë të shtrirë në shkëmbinj e u larguam shpejt prej aty. Kur u kthyem tok me Talian në shtëpi, e gjetëm mamanë në kuzhinë, duke qëruar karotat. Mbi tryezë pamë një letër të pahapur.

- Ta ka dërguar njerku yt, - tha mamaja.

Talia e mori letrën dhe u ngjit sipër në dhomë. Kaloi një kohë e gjatë, përpara se të zbriste sërish poshtë. Ajo e hodhi letrën mbi tryezë, u ul dhe mori një thikë e një karotë.

- Ai do që unë të kthehem në shtëpi.

- E kuptoj, - tha mamaja. Mua m'u duk se dëgjova një dridhje fare të lehtë në zërin e saj.

- Jo tamam në shtëpi. Ai më thotë se do të më çojë në një shkollë private në Angli. Se mund t'i filloj mësimet në vjeshtë. Do të paguajë ai, thotë.

- Po për teta Madalinën? - thashë unë.

- Ajo ka ikur. Me Eliasin. Janë arratisur.

- Po filmi?

Mamaja dhe Talia panë njëra-tjetrën në sy dhe pastaj të dyja njëherazi më vështruan mua, dhe vetëm tani unë e kuptova atë që ato e kishin ditur prej kohësh.

Një mëngjes të vitit 2002, më se tridhjetë vjet më vonë, ndërsa po bëj përgatitjet e fundit për t'u larguar nga Athina e për të shkuar në Kabul, gjej nekrologjinë e Madalinës në një gazetë. Mbiemri i saj tani është Kuris, por unë dalloj në fytyrën e kësaj gruaje të moshuar atë shkëlqimin e njohur të syve dhe përvijimet e bukurisë së rinisë. Në paragrafin e shkurtër nën fotografi shkruhet se në rininë e vet ka qenë aktore për disa kohë, përpara se të themelonte kompaninë e vet teatrore andej nga fillimi i viteve '80. Kritika kishte vlerësuar pozitivisht për disa prej pjesëve teatrore të vëna në skenë nga kompania e saj, në mënyrë të veçantë për "*Udhëtim i gjatë drejt natës*" e Juxhin O'Nillit, "*Pulëbardhat*" e Çehovit dhe "*Fejesat*" e Dimitrios Mpogrisit. Në nekrologji thuhet se ajo ishte e mirënjohur në komunitetin artistik të Athinës për veprat e saj të bamirësisë, mendjemprehtësinë, sensin e elegancës, festat e gjalla dhe vullnetin për të ndërmarrë projekte edhe për pjesë teatrore jo shumë të njohura. Aty shkruhet gjithashtu se ajo vdiq pas një beteje të gjatë me emfizemën e mushkërive, por nuk thuhet asgjë për ndonjë bashkëshort a fëmijë të lënë pas. Dhe habitem edhe më tepër, kur mësoj se ajo ka jetuar për më shumë se dy dhjetëvjetësha në Athinë, në një shtëpi as gjashtë blloqe larg vendit ku banoja unë në Kolonaki.

E ul gazetën. Për habinë time, ndiej një lloj acarimi me

këtë grua që nuk e kam parë për më se tridhjetë vjet. Një lloj nevoje për të mos e pranuar këtë histori dhe fundin e saj. Unë gjithmonë e kisha përfytyruar me një jetë gjithë trazira, të pakontrolluar, vite plot me vështirësi e mbrapshtësi: rrëzime e rinisje nga e para, dështime, pendime, si dhe histori dashurish të dëshpëruara, mendjelehta. Përherë e kisha gjykuar si një njeri që do të shkatërronte veten e do ta gremiste në një nga ato vdekjet e parakohshme që njerëzit i quajnë gjithmonë tragjike. Madje një pjesë imja, edhe e kishte vlerësuar për faktin që ajo e kishte njohur mirë vetveten dhe e kishte sjellë Talian te ne në Tinos, për ta shpëtuar nga ajo Madalinë katastrofike, që mund ta dëmtonte. Por tani e shoh Madalinën po me atë sy që e shikonte edhe mamaja: Madalina, kartografja e ulur përpara një tryeze, duke vizatuar me qetësi hartën e së ardhmes së saj, duke lënë jashtë kufijve vajzën e vet, që i është shndërruar në barrë. Dhe kishte pasur edhe sukses të bujshëm, të paktën kështu thuhet në këtë nekrologji, në këtë përmbledhje të shkurtër të një jete të pasur me arritje, lavdi, respekt.

Unë e ndiej se nuk e pranoj dot këtë: suksesi dhe arratisja drejt tij pa u ndëshkuar. Është krejtësisht absurde. Ku është çmimi që duhej të paguante, ndëshkimi përkatës?!

Dhe prapë, ndërsa e palos gazetën, një lloj dyshimi i bezdisshëm nis të lindë brenda meje. Një lloj frike e lehtë se mos e kam gjykuar Madalinën shumë ashpër, se ne të dy - ajo dhe unë - nuk jemi edhe aq të ndryshëm. A nuk ishim përvëluar që të dy për t'u arratisur, për të gjetur një jetë të re, identitete të reja? Në fund të fundit, a nuk e kishim çliruar që të dy veten duke i ngritur spirancat që na mbanin të palëvizur në breg? Por e flak tutje këtë ide, them me vete se ne nuk ngjajmë aspak, ndërsa e ndiej se zemërimi që më ka pushtuar tani, mund të jetë thjesht një maskë e zilisë sime, ngaqë ajo arriti një sukses më të madh se ai që arrita unë.

E bëj shuk gazetën. Po qe se Talia do ta marrë vesh këtë lajm, të paktën të mos e mësojë prej meje.

Mamaja largoi me thikë lëkurat e karotave nga tryeza dhe i mblodhi në një tas. Ajo i urrente njerëzit që e shpërdoronin ushqimin. Me ato lëkura ajo mund të përgatiste një kavanoz me marmeladë.

- E po, Talia, tani të duhet të marrësh një vendim të rëndësishëm, - tha ajo.

Talia më habiti kur u kthye nga unë e më pyeti:

- Çfarë do të kishe bërë ti, Markos?

- Oh, unë e di se ç'do të kishte bërë ai, - ndërhyri shpejt mamaja.

- Unë do të kisha shkuar, - iu përgjigja Talias, duke parë nga mamaja e duke ndier kënaqësi në rolin e atij njeriut kryengritës, siç më përfytyronte im më. Por sigurisht që edhe e kisha me gjithë mend. S'më besohej që Talia po ngurronte. Unë do ta kisha rrëmbyer atë mundësi, sapo të më jepej: Një shkollë private. Në Londër.

- Duhet të mendohesh për këtë, - i tha mamaja.

- Jam menduar, - tha Talia duke ngurruar. Pastaj, edhe me më shumë druajtje, ndërsa ngrinte kokën për ta vështruar mamanë në sy, vazhdoi: - Por nuk dua që ta pranoj.

Mamaja e uli thikën dhe m'u duk se më kapi veshi një shfryrje të lehtë. Mos kishte qenë duke e mbajtur frymën? Por, edhe nëse ishte e vërtetë, në fytyrën e saj nuk dukej asnjë gjurmë lehtësimi.

- Përgjigjja ime është po, mirë bën. Sigurisht që mirë bën.

Talia u zgjat mbi tryezë dhe preku kyçin e dorës së mamasë.

- Falemnderit, teto Odi!

- Do ta them vetëm një herë këtë, - fola unë. - Për mua po bën gabim. Për mua po gaboni që të dyja.

Ato kthyen kokën nga unë.

- Ti do që unë të iki, Markos? - tha Talia.

- Po, - thashë unë. - Do të më marrë malli për ty, shumë,

e di këtë. Por nuk mund të heqësh dorë nga një shkollë private. Pasi ta mbarosh atë, do të shkosh në universitet. Mund të bëhesh shkencëtare, profesoreshë, shpikëse. A nuk është kjo ajo që ti dëshiron? Ti je njeriu më i zgjuar që kam njohur. Mund të bëhesh gjithçka që dëshiron.

Dhe pastaj zëri m'u pre menjëherë.

- Jo, Markos, - tha Talia me një ton të rëndë. - Jo, nuk mundem.

Ajo e tha këtë me një vendosmëri që i mbyllte të gjitha shtigjet pë të kundërshtuar.

Shumë vjet më vonë, kur nisa specializimin në kirurgjinë plastike, kuptova diçka që nuk e kisha kuptuar atë ditë, ndërsa debatoja me Talian në kuzhinë, që ajo të ikte nga Tinosi për të vazhduar shkollën në Angli. Mësova se bota nuk e sheh anën tënde të brendshme, ajo nuk e vret aspak mendjen për shpresat dhe ëndrrat e tua, si dhe për dëshpërimet që fshihen nën atë strukturë kockash e lëkure. Ja pra, kaq e thjeshtë ishte, kaq absurde dhe mizore njëherazi. Pacientët e mi e dinin këtë. Ata e shihnin atë që ishin, që mund të ishin ose që mund të shpresonin të ishin në strukturën e tyre kockore, në hapësirën midis syve, në gjatësinë e mjekrës, në pozicionin e majës së hundës, në formën e kurrizit të hundës.

Bukuria është një dhuratë e jashtëzakonshme, e pamerituar, që u ofrohet pa kurrfarë logjike njerëzve të përzgjedhur fare rastësisht.

Dhe kështu, unë e zgjodha profesionin tim për t'u dhuruar një shans edhe njerëzve si Talia, për të korrigjuar, me çdo lëvizje të bisturisë, një padrejtësi arbitrare, për të mbajtur njëfarë qëndrimi kundër një bote që më dukej poshtëruese, kundër asaj bote në të cilën një kafshim qeni mund t'i rrëmbente të ardhmen një vajze të vogël, mund ta dëbonte nga shoqëria, mund ta shndërronte në objekt përbuzjeje.

Të paktën kjo është ajo që them me vete tani. Por besoj se kishte edhe arsye të tjera pse e zgjodha kirurgjinë plastike. Paratë, për shembull, prestigji, pozicioni shoqëror. Të them

se e zgjodha vetëm prej Talias, do ta kisha fare të thjeshtë; edhe pse si ide mund të duket shumë e bukur, në fakt është një gjë shumë e zakonshme dhe e baraspeshuar. Në kam mësuar vërtet diçka në Kabul, kjo është që sjellja njerëzore është e ndërlikuar, e paparashikueshme, dhe nuk shqetësohet aspak për simetritë e përshtatshme. Por unë e gjej ngushëllimin këtu, tek ideja e këtij modeli, te rrëfimi i historisë sime, që merr trajtë ngadalë, si një fotografi në dhomën e errët: një histori që zbulohet pak nga pak dhe vërteton fuqishëm mirësinë që kam dashur të shoh përherë brenda vetes. Kjo histori më jep zemër.

Gjysmën e kohës si kirurg plastik e kalova në Athinë, duke zhdukur rrudhat, duke ngritur qepallat, duke ngushtuar nofullat, duke u dhënë formën e përkryer hundëve të shtrembra. Gjysmën tjetër e kalova duke bërë atë që doja vërtet të bëja, duke bredhur nëpër botë: në Amerikën Qendrore, në Afrikën Nënsahariane, në Azinë Jugore, në Lindjen e Largët, duke punuar me fëmijët, duke ndrequr qiellzat dhe buzët e çara qysh në lindje, duke ndrequr dëmtimet e tjera të fytyrës, duke hequr tumoret e saj. Puna në Athinë nuk ishte aspak dinjitoze, por paguhej mirë dhe më dhuroi luksin që të përballoja punën vullnetare nëpër botë për javë e muaj me radhë.

Dhe pastaj, andej nga fillimi i vitit 2002, mora një telefonatë nga një grua që e njihja. Quhej Amra Ademoviç. Ishte ndihmësmjeke nga Bosnja. Ishim takuar në një konferencë në Londër disa vjet më parë dhe kishim kaluar një fundjavë të këndshme bashkë, të cilën asnjëri prej nesh nuk kishte tentuar ta përsëriste, edhe pse i kishim ruajtur lidhjet dhe ishim takuar ndonjëherë si shokë. Ajo më tha se po punonte në Kabul tani, për një organizatë jofitimprurëse, dhe se ata kërkonin një kirurg plastik për fëmijët: qiellza e buzë të çara, defekte të fytyrës të shkaktuara nga plumbat e shpërthimet, gjëra të tilla. Pranova menjëherë. Ideja ishte që të qëndroja vetëm tre muaj. U nisa andej nga fundi i pranverës 2002. Dhe nuk u ktheva kurrë pas.

Talia vjen të më presë në port. Ajo ka vënë një shall jeshil prej leshi dhe ka veshur një pallto të trashë ngjyrë trëndafili të zbërdhulur mbi një triko dhe një palë xhinse. Tani, flokët i ka lëshuar mbi supe dhe i ka ndarë me vizë në mes. Ata i janë zbardhur krejt dhe është pikërisht kjo - dhe jo dëmtimi në pjesën e poshtme të fytyrës - që më detyron të bëj një hap prapa e t'ia ngul sytë fort. Jo se kjo më habit: Talia nisi të thinjej aty nga mesi i të tridhjetave dhe për dhjetë vjet flokët iu bënë të bardhë si pambuku. E di që edhe unë kam ndryshuar: kam një bark kryeneç që nuk pranon të bjerë, një tërheqje të vijës së flokëve mbi ballë, por njeriu nuk e vë re plakjen në trupin e vet, ajo është po aq tinëzare sa edhe e paperceptueshme për të. Flokët e bardhë të Talias janë një provë e pakundërshtueshme se ajo ka nisur marshimin e pashmangshëm drejt pleqërisë dhe, për pasojë, edhe unë vetë i kam hyrë po kësaj rruge.

- Do të kesh ftohtë, - thotë ajo, duke shtrënguar shallin e vet pas qafës. Është janar, mëngjes i vonë me një qiell gri. Era e ftohtë i bën gjethet e thara të kërcasin në pemë.

- Në do ta njohësh vërtet të ftohtët, eja në Kabul, - i them unë. Dhe marr valixhen në dorë.

- Si të thuash ti, doktor. Do të marrim autobusin apo do të shkojmë më këmbë? Zgjidh ti.

- Shkojmë më këmbë, - i përgjigjem.

Ne drejtohemi për në veri. Kalojmë nëpër qytetin e Tinosit. Në portin e brendshëm janë ankoruar varka peshkimi e jahte. Janë ngritur kioska që shesin kartolina dhe bluza pambuku. Njerëzit pinë kafe të ulur nëpër tryezat e vogla të rrumbullakëta të kafeneve, duke lexuar gazetën ose duke luajtur shah. Kamerierët po nguten të vendosin kompletet prej argjendi mbi tryeza, për t'i pasur gati për drekë. Pas një ore a dy, kuzhinat do të lëshojnë përreth aromën e peshkut të gatuar.

Talia nis të më tregojë gjithë gjallëri për një kompleks vilash njëkatëshe të lyera me bojë të bardhë, që po ndërtohen në qytetin e Tinosit e që shohin në drejtim të Mikonosit dhe

Egjeut. Pritet që ato të popullohen nga turistët ose të pasurit që vijnë të kalojnë verën këtu, që janë dyndur në Tinos qysh prej viteve '90. Thotë se vilat do të kenë edhe pishinë në oborr, edhe palestër fitnesi.

Ajo ka vite që më dërgon mesazhe, me anë të të cilave më mban në dijeni për këto ndryshime që po i ofrojnë një tjetër jetë Tinosit: hotelet buzë detit me tasat e satelitëve dhe internetin jokabllor, klubet e natës, baret e tavernat, restorantet dhe dyqanet që i thithin turistët, taksitë, autobusët, turmat e njerëzve, gratë e huaja që qëndrojnë shtrirë në plazh pa të sipërmet e rrobave të banjës. Tani fermerët ngasin makina në vend të gomarëve, sigurisht, ata fermerë që kanë mbetur këtu. Shumica e tyre kanë ikur vite më parë, por disa po kthehen sërish, për ta kaluar në ishull periudhën e pensionit.

- Odit nuk i pëlqejnë aspak, - thotë Talia; e ka fjalën për shndërrimet. Por ajo më ka shkruar edhe për këtë: për dyshimet e një banoreje të vjetër të ishullit lidhur me të ardhurit rishtarë dhe ndryshimet që mbartin ata.

- Kurse ty nuk më duket se të bëjnë përshtypje ndryshimet, - i them.

- S'ka kuptim të ankohesh për një gjë të pashmangshme, - thotë ajo. E mandej shton: - Odi më thotë: "E po, ty të takon ta thuash këtë, Talia. Ti nuk ke lindur këtu.". - Ajo qesh me zë të lartë, me gjithë shpirt. - Dhe unë që besoja se pas dyzet e katër vjetësh në Tinos e kisha fituar të drejtën për t'u quajtur vendase. Por pa shiko se ç'thotë ajo.

Edhe Talia ka ndryshuar. Edhe pse ka veshur pallto, unë e vë re që i janë zgjeruar paksa vithet, është bërë më e rrumbullakët, por mishi nuk i është lëshuar, e ka ende të ngjeshur. Dhe komentet e saj për gjërat që bëj unë, që besoj se asaj i duken pa vlerë, kanë fituar një lloj qesëndisjeje dashamirëse, një lloj talljeje të lehtë. Shkëlqimi në sytë e saj, e qeshura me gjithë shpirt, skuqja e vazhdueshme e faqeve: të gjitha këto të krijojnë përshtypjen sikur është një grua fermeri. Një grua pa

pretendime dhe miqësore, dashamirësia e së cilës flet qartë për një autoritet të fuqishëm dhe një forcë karakteri që nuk do të bëje mirë ta vije në provë.

- Si po të ecën biznesi? - e pyes. - A ke ende punë?

- Herë pas here, - thotë Talia. - Ti e di ç'kohëra kanë ardhur.

Ne tundim kokën mendueshëm që të dy. Në Kabul kisha parë lajmet për reformat dhe shkurtimet e reja ekonomike në Greqi. Te CNN-i kisha parë djem të rinj grekë me maska duke qëlluar policët me gurë përpara ngrehinës së Parlamentit, policë me veshje speciale duke hedhur gaz lotsjellës nëpër protesta e duke vringëllirë shkopinjtë e gomës.

Talia nuk ka ndonjë biznes në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Përpara epokës dixhitale, ajo ishte një grua që i vinte ndoresh për gjithçka: shkonte në shtëpitë e njerëzve dhe instalonte transistorë në televizorët e tyre, zëvendësonte marrësit e vjetër të sinjalit në radiot e vjetra; e thërrisnin për të rregulluar termostatin e frigoriferit, për të ndrequr rubinetat e prishur. Njerëzit e paguanin me aq sa mundnin. Por edhe kur nuk kishin me ç'të paguanin, ajo prapë i ndihmonte. "Nuk është se kam vërtet nevojë për pará, - më kishte thënë ajo. - Unë e kam si lojë. Ende kam një ngacmim brenda vetes për t'i hapur gjërat e për t'i parë se si funksionojnë përbrenda". Sot ajo është si një departament teknologjie informatike që edhe drejtohet, edhe ka për vartëse një grua të vetme. Çdo gjë e ka mësuar vetë. Për një pagesë minimale, ajo u rregullon kompjuterat njerëzve, ndryshon parametrat e IP-ve, zgjidh problemet që shkaktojnë ngrirjen e programeve ose të dokumenteve, ngadalësinë e kompjuterit, dështimet në përditësimin ose hapjen e tij. Unë vetë e kam marrë në telefon nga Kabuli më shumë se një herë, për shkak të nevojës së dëshpëruar për ndihmë me IBM-në time të ngrirë.

Kur mbërrijmë në shtëpinë e mamasë, ndalemi për disa çaste jashtë në oborr, pranë pemës së vjetër të ullirit. Shoh gjurmët e punëve frenetike të mamasë: muret e lyera rishtazi

me bojë, foleja e pëllumbave e lënë përgjysmë, një çekiç dhe një kuti e hapur gozhdësh mbi një pllakë prej druri.

- Si është ajo? - e pyes.

- Oh, si gjembaç, si gjithmonë. Prandaj ia instalova edhe atë gjënë, - ajo bën me dorë drejt një tasi sateliti të vendosur në tarracë. - Shohim bashkë telenovela të huaja. Telenovelat arabe janë më të bukurat, ose më të këqijat, varet se nga ç'këndvështrim i sheh. Mundohemi të kuptojmë intrigat që zhvillohen aty. Dhe kjo bën që t'i mbajë kthetrat e saj larg meje! - Ajo hap derën e përparme. - Mirë se erdhe në shtëpi! Po shkoj të të përgatit diçka për të ngrënë.

Më duket gjë e çuditshme të qenët përsëri në këtë shtëpi. Syri më kap disa gjëra të reja, si kolltuku prej lëkure ngjyrëgri në dhomën e ndenjjes dhe një tryezë e vogël e bardhë prej thuprash pranë televizorit. Por çdo gjë tjetër është pak a shumë aty ku ka qenë. Tryeza e kuzhinës, tani me një mbulesë prej kadifeje me ca forma patëllxhanësh e dardhësh, karriget prej bambuje me shpinore të drejtë, llamba e vjetër me vajguri me mbajtësen prej thuprash, oxhaku i nxirë nga tymi, fotografia ime me mamanë: unë me bluzë të bardhë, mamaja me fustanin e mirë, fotografi që ende gjendet e varur në mur mbi trarin mbështetës në dhomën e ndenjjes; kompleti i porcelanit i mamasë ende në raftin e sipërm.

Dhe prapë, ndërsa lëshoj valixhen në tokë, më duket sikur gjej një vrimë të zgavërt në mes të gjithçkaje. Ata dhjetë vjet të jetës së mamasë sime me Talian këtu, ata janë të errët, janë hapësira boshe brenda meje. Unë nuk kam qenë këtu. Nuk kam qenë gjatë gjithë atyre vakteve që mamaja e Talia kanë ngrënë bashkë në këtë tryezë, gjatë të qeshurave që kanë ndarë bashkë, zënkave, grindjeve nga mërzia, sëmundjeve, gjatë të gjitha atyre ritualeve të thjeshta që janë pjesë e një jete të tërë. Rikthimi në shtëpinë e fëmijërisë më duket paksa çorientues,

njësoj si të lexosh fundin e një romani të nisur e të lënë mënjanë shumë kohë më parë.

- Si thua, të të bëj ca vezë? - thotë Talia, që ka vënë tashmë përparësen dhe po hedh vajin në tigan. Ajo lëviz në kuzhinë me shumë siguri, sikur t'i përkasë plotësisht asaj.

- Mirë. Ku është mamaja?

- Po fle. Pati një natë të vështirë mbrëmë.

- Po shkoj t'i hedh një sy.

Talia më hedh një vështrim të mprehtë që nga bufeja.

- Po e zgjove, do të kesh të bësh me mua, doktor.

Unë ngjit në majë të gishtave shkallët që të çojnë në dhomën e gjumit. Dhoma është kredhur në errësirë. Një rrip i hollë drite arrin të depërtojë nëpër perdet e mbyllura dhe bie mbi shtratin e mamasë. Ajër i rënduar nga sëmundja. Nuk është thjesht aromë; përkundrazi, është e pranishme si diçka fizike. Çdo mjek e njeh atë: sëmundja depërton si përrua në një dhomë. Qëndroj për disa çaste te pragu i derës dhe pres derisa të më mësohen sytë. Errësira ndërpritet nga një drejtkëndësh i ndritshëm në dollap, në anën e shtratit nga, besoj, tani fle Talia. Ana ime e dikurshme. Është një kompozim fotografish i përpunuar në kompjuter: një fushë me orizore e shtëpi prej druri me çati me tjegulla gri, që shkrihet me një pazar të mbushur me njerëz, ku dhi kockë e lëkurë varen nëpër çengelë e mandej me pamjen e një burri lëkurerrët që po qëndron pranë një lumi të turbullt e po lan dhëmbët me gishta.

Marr një karrige dhe ulem pranë shtratit të mamasë. Tani që sytë më janë mësuar me errësirën dhe arrij ta shquaj qartë, më duket sikur diçka këputet brenda meje. Më habit fakti që im më është mpakur kaq shumë. Që tani. Pizhamet me lule i rrinë të gjera në supet e vogla, mbi gjoksin e rrafshët. Nuk më bën përshtypje mënyra se si po fle ajo: me gojën të hapur e cepat e buzëve të varura, si të jetë duke parë një ëndërr të keqe. Nuk më pëlqen të shoh se si i kanë lëvizur protezat nga vendi, ndërsa fle. Qepallat i dridhen lehtë. Unë rri ulur aty

për njëfarë kohe. Dhe pyes veten: "E ç'prisje ti?!" Dhe dëgjoj trokitjen e orës në mur, përplasjen e pirunit të Talias pas tiganit, ku po skuq vezët në katin e parë. Dhe nis të vëzhgoj hollësitë e rëndomta të jetës së mamasë në këtë dhomë: televizori me ekran të sheshtë i varur në mur, kompjuteri në cep të dhomës, një lojë sudoku e papërfunduar mbi komodinë, syzet e vendosura si shenjuese të faqes; telekomanda e televizorit, shishja me lot artificialë, një tubet me krem kortizonik; një tubet për ngjitjen e protezave; një shishe e vogël me barna dhe, në dysheme, një palë shapka me pellush ngjyrë midhjeje. Dikur ajo nuk do t'i kishte mbathur kurrsesi ato. Pranë shapkave, një qese me pampersa. Unë nuk i lidh dot këto gjëra me mamanë tani. Më duket sikur ato i përkasin një njeriu të huaj. Një njeriu të pafuqishëm, të padëmshëm. Dikujt me të cilin nuk do të mund të zemërohesha kurrë.

Përbri shtratit, vështrimi rrëshqet sërish mbi kompozimin fotografik. Mandej mbi të tjera fotografi. Dhe, më në fund, më vetëtin në mendje: Unë i njoh këto fotografi. I kam bërë vetë ato. Atëherë, kur isha... Çfarë? Duke marrë botën mbarë më këmbë, besoj. Unë gjithmonë sigurohesha që t'i stampoja fotografitë në dy kopje, që njërën t'ia dërgoja Talias me postë. Dhe ajo i ka ruajtur. Edhe pas gjithë këtyre viteve. Talia. Një ndjenjë ngrohtësie, e ëmbël si mjalti, më përshkon të gjithin. Ajo ka qenë motra ime e vërtetë, manari im i vërtetë, gjatë gjithë këtyre viteve.

Talia më thërret në emër nga kuzhina.

Ngrihem nga karrigia pa bërë zhurmë. Duke dalë nga dhoma, syri më kap diçka. Diçka të varur në mur, poshtë orës. Në errësirën e dhomës nuk e dalloj dot tamam. Hap celularin dhe e shqyrtoj nën dritën e tij të argjendtë. Është një artikull i "*Associated Press*-it" për organizatën jofitimprurëse për të cilën punoj unë në Kabul. Më kujtohet kjo intervistë. Gazetari ishte një djalë i ri koreanoamerikan të cilit i mbahej paksa goja. Ne hëngrëm bashkë *qabuli*: pilaf afganistanas me bollgur, rrush të thatë e mish qengji. Në qendër të artikullit

është një fotografi grupi: unë, disa nga fëmijët, Nabi në rreshtin e fundit, me trupin të tendosur, duart pas shpine, me një pamje sikur po parandien diçka të keqe, gjithë druajtje e dinjitet njëherazi, ashtu siç dalin shpesh afganët në të tilla fotografi. Edhe Amra është aty, me Roshin, vajzën që ka birësuar. Të gjithë fëmijët po buzëqeshin.

- Markos.

E mbyll telefonin celular dhe zbres poshtë.

Talia më vë përpara një gotë me qumësht dhe një pjatë me vezë të skuqura, që ende nxjerrin avull, mbi një shtrat domatesh.

- Në rregull e ke, i kam hedhur sheqer qumështit.

- E mbake mend akoma!

Ajo ulet në tryezë, pa e hequr përparësen. Mbështet bërrylat mbi siprinën e saj dhe më sheh teksa ha, ndërsa fshin herë pas here me shami faqen e majtë.

Më kujtohen të gjitha ato herë që jam munduar t'ia mbush mendjen që të merresha me fytyrën e saj. I thosha se teknikat kirurgjikale kishin përparuar shumë qysh prej viteve '60 dhe se tashmë isha i bindur që, edhe po të mos e shmangia dot plotësisht defektin, të paktën mund ta përmirësoja dukshëm pamjen e fytyrës së saj. Por Talia nuk pranonte, çka më habiste tej mase. "Kjo jam unë", - më thoshte. Një përgjigje e paqartë, merre si ta marrësh, e pakënaqshme, mendoja unë asokohe. E ç'kuptim kishte kjo? Nuk e kuptoja. Unë ushqeja mendime jo shumë dashamirëse për të burgosurit që kishin kaluar një jetë të tërë në burg dhe kishin frikë të dilnin prej aty, kishin frikë të dilnin në liri me kusht, tmerroheshin nga fakti se do të gjenin një jetë të re jashtë, përtej telave me gjemba dhe kullave të rojës.

Oferta ime për Talian është e vlefshme edhe sot e kësaj dite. Dhe ajo prapë nuk ka për ta pranuar. Por tani unë e kuptoj. Ajo ka të drejtë: kjo është ajo. Unë nuk mund të pretendoj që e kuptoj se ç'do të thotë të shohësh çdo ditë një

fytyrë të tillë në pasqyrë, të përballesh çdo ditë me tmerrin e shfytyrimit, të mbledhësh të gjitha forcat për ta pranuar atë ashtu siç është. Gjithë ato përpjekje gjigante, stërmundimi, durimi për ta bërë këtë. Të pranuarit e vetes, që merr formë pak nga pak, vit pas viti, ashtu siç marrin formë shkëmbinjtë nga forca goditëse e dallgëve që përplasen mbi ta. Atij qeni iu deshën vetëm pak minuta për t'i dhënë Talias këtë fytyrë, por asaj i është dashur një jetë e tërë për ta pranuar këtë identitet të ri. Dhe ajo nuk mund të më lejojë që unë të ndryshoj gjithçka me bisturinë time. Do të ishte njësoj si të hapje një plagë të re mbi plagën e vjetër.

Unë nis të ha vezët, duke e ditur që do t'i bëhet qejfi, edhe pse në të vërtetë nuk kam aspak uri.

- Sa të mira qenkan, Talia!

- Hë, si të duket, të ka pushtuar ndopak padurimi?

- Për çfarë e ke fjalën?

Ajo kthehet me shpinë nga unë dhe hap njërin prej sirtarëve të bufesë. Dhe nxjerr një palë syze dielli me xhama drejtkëndësh. Unë ua ngul sytë për një çast. Dhe pastaj më kujtohet: eklipsi diellor.

- Oh, po, sigurisht.

- Në fillim, - thotë ajo, - mendova ta shihnim me anën e një vrime gjilpëre. Por pastaj Odi më tha që do të vije edhe ti. Kështu që mendova: "E po, atëherë u dashka bërë me elegancë".

Ne flasim pak për eklipsin që pritet të ndodhë të nesërmen. Talia thotë se do të fillojë në mëngjes dhe në mesditë do të jetë i plotë. Ajo ka kontrolluar lajmet meteorologjike dhe është ndier e lehtësuar që në ishull nuk do të kemi ditë me re. Pastaj më pyet nëse dua prapë vezë dhe, pasi unë i përgjigjem se po, nis të më tregojë për Internet-Kafenë që është ndërtuar aty ku gjendej dikur kinkaleria e zotit Rusos.

- I pashë fotografitë, - i them. - Në dhomën e gjumit. Edhe artikullin.

Ajo mbledh thërrimet e bukës që kam bërë unë mbi tryezë

dhe i hedh mbi sqollin e kuzhinës pas shpinës së saj, pa parë andej.

- Ah, ishte gjë fare e thjeshtë. E kam fjalën, t'i skanoje dhe t'i hidhje të gjitha në kompjuter. Gjëja më e vështirë ishte t'i ndaje sipas shteteve. M'u desh të ulesha e t'i shqyrtoja me vëmendje, sepse ti kurrë nuk shkruaje asgjë, asnjë pusullë, vetëm dërgoje fotografitë. Dhe ajo ma kërkoi me ngulm këtë, që t'i ndaja sipas vendeve. Ashtu i pëlqente t'i shihte. Dhe ngulte këmbë.

- Kush?

Ajo psherëtin.

- "Kush" thotë. Po Odi. E kush tjetër?

- Ishte ideja e saj?

- Edhe artikulli. E gjeti ajo vetë në internet.

- Mamaja ka bërë kërkime për mua në internet?! - pyes i çuditur unë.

- Nuk duhej t'ia kisha mësuar kurrë këtë. Tani nuk ka zot që ta ndalë. - Ajo qesh. - Çdo ditë kërkon emrin tënd. E kam me gjithë mend. Tani ke një njeri që të gjurmon në hapësirën elektronike, Markos Varvaris.

Mamaja zbret në kuzhinë në drekë. Ka veshur një rrobë dhome ngjyrëblu të errët dhe shapkat me pellush që i kisha parë ndërkaq në dhomë. Flokët duket që i ka krehur. Ndihem i lehtësuar, kur e shoh të ecë normalisht, ndërsa zbret shkallët dhe hap krahët drejt meje, me një buzëqeshje të përgjumur.

Ne ulemi në tryezë e mbushim nga një filxhan me kafe.

- Ku është Talia? - më pyet ajo, duke i fryrë filxhanit të kafes.

- Ka dalë të blejë ca gjëra. Për nesër. Yti është ai, mama? - unë bëj me shenjë drejt bastunit që gjendet në mur pranë kolltukut të ri. Nuk e kisha vënë re kur hyra në fillim në kuzhinë.

- Oh, nuk para e përdor. Vetëm në ditët e këqija. Dhe sidomos kur bëj ecje të gjata. Edhe atëherë, më shumë e marr për siguri, - thotë ajo me një ton shpërfillës, çka më jep të kuptoj se ajo e përdor shumë më tepër nga sa e pranon me gojë. - Je ti që më shqetëson. Lajmet për atë vend të tmerrshëm. Talia nuk do që unë t'i dëgjoj. Thotë se do të më acarojnë.

- E po, kemi ca incidente atje, - them unë, - por në përgjithësi njerëzit vazhdojnë rrjedhën normale të jetës. Dhe unë tregoj vazhdimisht kujdes, mama. - Sigurisht, nuk mund t'i tregoj për të shtënat me armë kundër shtëpisë sonë ose për atë valë sulmesh kundër punonjësve të huaj, ose se, që "të tregosh kujdes", do të thotë të mbash me vete një revolver 9 mm, kur del jashtë qytetit me makinë. Janë gjëra që, pa dyshim, as nuk duhet t'i çoj nëpër mend që t'ia them.

Mamaja gjerb një gllënjkë kafe dhe picërron paksa sytë. Nuk më detyron të flas. Dhe unë nuk e di në është gjë e mirë kjo, apo jo. Nuk jam i sigurt në është kredhur në vetvete tani, ashtu siç ndodh gjithmonë me pleqtë, apo kjo është thjesht një taktikë e saj për të mos më vënë me shpatulla për muri, për të mos më detyruar ta gënjej ose për të mos i thënë asaj të vërteta që mund ta tronditin.

- E ndiem mungesën tënde për Krishtlindje, - thotë ajo.

- Nuk munda të largohesha, mama.

Ajo pohon me kokë.

- Tani je këtu. Kjo ka rëndësi.

Unë rrufit kafen. Më kujtohet kur isha i vogël dhe kur unë e mamaja e hanim mëngjesin në këtë tryezë, çdo ditë, në heshtje, thuajse në mënyrë solemne, përpara se të niseshim për në shkollë të dy bashkë. Flisnim fare pak me njëri-tjetrin.

- Ti e di, mama, unë jam në merak edhe për ty.

- Nuk është nevoja. Unë i dal mjaft mirë për zot vetes, - një vezullim ky i krenarisë sfiduese të dikurshme, si një dritë e zbehtë mes mjegullës.

- Por edhe për sa kohë?

- Për aq kohë sa të mundem.

- Po kur të mos mundesh më, çfarë do të ndodhë? - Unë nuk po e sfidoj. Po e pyes, sepse vërtet nuk e di. Nuk e di se çfarë roli do të luaj unë nëse vërtet do të luaj ndonjë rol.

Ajo më hedh një vështrim të butë. Pastaj shton një lugë sheqer në filxhanin e kafes dhe e përzien ngadalë.

- Është për të qeshur, Markos, por shumica e njerëzve gënjejnë veten. Ata besojnë se e jetojnë jetën ashtu siç duan ata. Por ajo që i drejton vërtet, është gjëja së cilës ata i druhen më shumë. Gjëja që nuk e duan.

- S'po të kuptoj, mama.

- E po, ja, merr shembullin tënd, që ike prej këtu. Jetën që ke bërë. Ti kishe frikë se mos mbeteshe i ngujuar këtu. Me mua. Kishe frikë se unë do të të mbaja këtu me forcë. Ose merr Talian, për shembull. Ajo qëndroi këtu, sepse nuk donte të ishte më një objekt ku do t'i ngulnin sytë njerëzit.

E shoh të provojë kafen e t'i hedhë një tjetër lugë sheqer. Më kujtohet se sa i dobët më dukej vetja, kur mundohesha dikur, kur isha fëmijë, ta kundërshtoja. Ajo më fliste në një mënyrë që nuk më linte shteg për kundërshtime, më vërsulej si dallgë me të vërtetën e thënë haptazi, plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë. Unë gjithmonë mposhtesha pa pasur kohë që të mund të shqiptoja qoftë edhe një fjalë të vetme. Dhe gjithmonë kjo më dukej e padrejtë.

- Po ti, mama? - e pyes. - Çfarë të frikëson ty? Cila gjë është ajo që ti nuk do ta doje?

- Që t'u bëhem barrë njerëzve.

- Nuk do t'u bëhesh.

- Oh, për këtë ke të drejtë, Markos.

Një shqetësim përhapet brenda meje prej kësaj vërejtjeje të përzishme. Mendja më shkon menjëherë te letra e Nabit, te rrëfimi i tij pas vdekjes. Pakti që kishte bërë me Sulejman Vahdatin. Nuk mund të mos rri pa menduar se edhe mamaja mund ta ketë bërë një pakt të ngjashëm me Talian, se ajo ka zgjedhur Talian që ta shpëtojë, kur të vijë koha. E di që Talia

do të mund ta bënte. Ajo tani është grua e fortë. Ajo do ta shpëtonte mamanë.

Mamaja heton fytyrën time.

- Ti ke jetën dhe punën tënde, Markos, - thotë ajo, tani me zë më të butë, duke ia ndryshuar paksa rrjedhën bisedës, si të ketë lexuar mendjen time e të ketë dalluar shqetësimin tim aty. Protezat, pampersat, shapkat me pellush: të gjitha këto më kanë bërë ta nënvlerësoj. Por ajo ende e thotë vetë fjalën e fundit. Gjithmonë ka për ta thënë. - Nuk dua të të bëhem barrë ty.

Ja më në fund një gënjeshtër, kjo fjalia e fundit e saj, por është një gënjeshtër dashamirëse. Nuk jam unë njeriu të cilit ajo nuk do t'i bëhet barrë. Ajo e di këtë shumë mirë. Unë nuk jam këtu, unë jam mijëra kilometra larg. Gjërat e pakëndshme, shërbimi, lodhja, të gjitha do të binin mbi kurrizin e Talias. Por mamaja po më përfshin edhe mua, po më jep edhe mua diçka që nuk e kam fituar, diçka që as nuk jam përpjekur ta fitoj.

- Nuk ka për të ndodhur, - i them me zë të dobët.

Mamaja buzëqesh.

- Meqë ra fjala te puna jote, besoj se e di që unë nuk e miratova vërtet vendimin tënd për të vajtur në atë vend.

- I kisha ca dyshime, po.

- Nuk e kuptoja dot se pse doje të shkoje atje. Pse duhej të hiqje dorë nga gjithçka: spitali, paratë, shtëpia në Athinë, gjithë ato gjëra për të cilat kishe punuar aq shumë, për të shkuar në atë vend të dhunshëm.

- Kisha arsyet e mia.

- E di, - ajo afron filxhanin me kafe te buzët dhe e ul sërish poshtë pa e rrufitur. - Për dreq nuk jam e mirë në këto gjëra, - thotë ajo ngadalë, pothuajse si me druajtje. - Por ajo që dua të të them tani Markos, është që je bërë njeri për së mbari. Më ke bërë të jem krenare për ty, Markos.

Unë ul kokën dhe shoh duart e mia. I ndiej fjalët e saj se si depërtojnë brenda meje. Ajo më ka ngurosur krejt. Më ka

kapur të papërgatitur. Për atë që më tha. Ose për dritën e butë në sytë e saj, kur e tha. Nuk e di se ç'përgjigje pret tani nga unë.

- Falemnderit, mama, - ia dal mbanë të mërmërit unë.

Unë nuk mund të them më asnjë fjalë dhe për disa çaste qëndroj i heshtur. Ajri midis nesh është i ngarkuar me të gjitha gjërat e çuditshme dhe me vetëdijesimin për kohën e humbur, për të gjitha mundësitë e shpërdoruara.

- Kam dashur të të pyes për diçka, - më thotë ajo.

- Për çfarë?

- Xhejms Parkinson. Xhorxh Hantington. Robert Grejvs. Xhon Daun. Dhe tani ky Lu Gerigu im. Si ka mundësi që njerëzit kanë përvetësuar edhe emrat e sëmundjeve?

Unë pulit qepallat dhe po ashtu edhe im më, pastaj ajo ia plas së qeshurës e po ashtu edhe unë. Edhe pse përbrenda ndiej të më thyhet diçka me krakëllimë.

Të nesërmen në mëngjes, qëndrojmë shtrirë në shezlongë në kopsht. Mamaja ka veshur një shall të trashë dhe një xhup gri, kurse këmbët i ka mbuluar me një batanije të hollë, për t'i mbrojtur nga era e ftohtë. Ne gjerbim kafen dhe cimbisim copat e kekut me aromë kanelle që ka blerë Talia me këtë rast. Kemi vënë syzet e posaçme për të parë eklipsin dhe vështrojmë drejt qiellit. Pjesa veriore e diellit është ngrënë paksa, ai ka marrë pak a shumë formën e mollës së kafshuar në laptopin "*Apple*" që Talia po e mban të hapur për të postuar vëzhgimet e veta në forumin në internet. Njerëzit kanë dalë në rrugë e janë ulur buzë këmbësoreve ose janë ngjitur mbi çatitë e shtëpive për të shijuar spektaklin. Disa prej tyre kanë shkuar tok me familjet e tyre në anën tjetër të ishullit, ku Shoqata e Astronomëve Grekë ka vendosur teleskopë.

- Kur pritet që të arrijë kulmin? - pyes unë.

- Rreth orës dhjetë e gjysmë, - thotë Talia. Ajo ngre syzet

dhe kontrollon orën e dorës. - Për nja një orë a diçka më shumë. - Pastaj fërkon duart gjithë entuziazëm dhe shtyp diçka në tastierë.

Unë vështroj ato të dyja: mamaja me syzet e errëta, me duart gjithë damarë blu të mbështetura në kraharor, Talia që shtyp tastet me tërbim, ndërsa flokët e bardhë i dalin nga kapuçi prej leshi.

"Je bërë njeri për së mbari."

I shtrirë në divan një natë më parë, m'u kujtuan sërish fjalët që më tha mamaja, dhe mendja më shkoi te Madalina. Më kujtohet tani që, kur isha fëmijë, ankohesha vazhdimisht për gjërat që im më nuk i bënte, por ama që mamatë e tjera i bënin: që të më kapte për dore kur ecnim; të më ulte në prehrin e vet, të më tregonte përralla, kur të më vinte për të fjetur, të më puthte në faqe për të më uruar natën e mirë. Këto gjëra më mungonin vërtet. Por gjatë gjithë atyre viteve, unë kisha qenë i verbër ndaj një së vërtete më madhështore, që ishte e pavlerësuar dhe e papranuar, e groposur thellë nën ankimet e mia. Dhe ishte pikërisht kjo: mamaja ime nuk do të më braktiste kurrë. Kjo ishte dhurata e saj për mua, bindja e çeliktë se mamaja ime nuk do të ma kishte bërë kurrë mua atë që bëri Madalina me Talian. Ajo ishte mamaja ime dhe ajo nuk do të më braktiste kurrë. Kjo ishte gjëja që unë e kisha pranuar dhe që madje thjesht e kisha pretenduar. Por nuk e kisha falënderuar kurrë mamanë për këtë më shumë nga sa kisha falënderuar diellin që ndrinte mbi mua.

- Shikoni! - thërret Talia e ekzaltuar.

Befas, përreth nesh: në tokë, në mure, mbi rrobat tona, shfaqen drapërinj të vegjël drite vezulluese: dielli në formë drapri që depërton midis gjetheve të pemës sonë të ullirit. Mua më kap syri një drapër vezullues edhe në kafen brenda në filxhan dhe një tjetër drapër që po vallëzon mbi lidhësen e këpucës sime.

- Zgjati duart, Odi, - thotë Talia. - Shpejt!

Mamaja shrin duart me pëllëmbët lart. Talia nxjerr nga xhepi një xham me formë katrore, ndërsa merr frymë shpejt.

- Shiko këtu, Markos! - thotë mamaja, që nuk po e përmban më buzëqeshjen, si një vajzë e vogël e mrekulluar. Nuk e kam parë kurrë të buzëqeshë kaq pastër, në mënyrë kaq të shpenguar.

Ne qëndrojmë të ulur aty që të tre, duke parë këto ylbere të vogla që dridhen në duart e mamasë, dhe unë ndiej një lloj trishtimi e një dhembje të vjetër, që m'i kanë ngulur që të dyja kthetrat në fyt.

"Je bërë njeri për së mbari".

"Më ke bërë krenare, Markos".

Unë jam pesëdhjetë e pesë vjeç. Dhe kam pritur një jetë të tërë që t'i dëgjoj këto fjalë. A mos është shumë vonë për këtë tani? Për ne të dy? A mos ndoshta kemi shpërdoruar shumë gjëra për një kohë shumë të gjatë? Unë dhe mamaja ime? Një pjesë imja më thotë që të vazhdojmë ashtu siç kemi bërë deri më tani, të sillemi sikur nuk e dimë se sa të papërshtatshëm kemi qenë për njëri-tjetrin. Do të ishte më pak e dhembshme kështu. Mbase do të ishte më mirë sesa kjo dhuratë e vonuar. Kjo pamje fluturake, e mjegullt, e brishtë dhe drithëruese e mënyrës se si mund të kishin shkuar gjërat në mes nesh. Gjithë ç'do të rezultonte, do të ishte vetëm pendimi, them unë me vete. E ç'e mirë do të vinte nga pendimi? Pendimi nuk do të kthente dot asgjë pas. Ajo që ne kemi humbur, është e pakthyeshme.

Dhe prapë, ndërsa mamaja ime thotë:

- A nuk është gjë e bukur, Markos?

Unë i përgjigjem:

- Po, mama. E bukur është.

Dhe, ndërkohë që diçka nis të kriset e të hapet plotësisht brenda meje, unë zgjat dorën drejt dorës së saj dhe ia shtrëngoj në timen.

# Nëntë

## *Dimër 2010*

Kur isha e vogël, bashkë me tim atë ndiqnim një ritual në darkë. Pasi kisha thënë njëzet herë *bismilah* dhe babai më çonte në shtrat, ai ulej buzë shtratit dhe me gishtin e madh e treguesin niste të largonte ëndrrat e këqija nga koka ime. Gishtat e tij shëtitnin nga balli im drejt tëmthave, kërkonin me durim pas veshëve të mi, në zverk, dhe ai bënte "plluq" me gojë, si shishja kur i heq tapën, sa herë që largonte ndonjë ëndërr të keqe nga truri im. Ai i fuste ato ëndrra, njërën pas tjetrës, në një thes të padukshëm mbi prehrin e vet dhe ia shtrëngonte grykën fort. Pastaj gjurmonte ajrin, për të gjetur aty ëndrrat e bukura, për të mbushur me to hapësirën e ëndrrave të mbetur bosh për shkak të atyre që kishte larguar prej meje. E shihja se si e përkulte kokën lehtë dhe ngryste vetullat, ndërsa gërmonte me sy nga njëri cep i dhomës në tjetrin, si të ishte duke përgjuar një muzikë që vinte nga larg. Unë mbaja frymën, në pritje të çastit kur mbi buzët e tij do të shpërthente buzëqeshja dhe ai do të këndonte: "Oh, ja tek qenka njëra!" Ai i bënte pëllëmbët si kupë dhe priste që ëndrra të zbriste ngadalë mbi to, si një gjethe që bie nga pema, butë-butë, shumë butë, sepse, siç thoshte im atë, gjërat e mira në këtë botë janë të brishta

dhe mund t'i humbasësh lehtë. Pastaj i vendoste ato duar mbi kokën time, fërkonte pëllëmbët mbi ballin tim dhe m'i fuste ëndrrat e lumtura në tru.

- Çfarë do të shoh sonte në ëndërr, baba? - e pyesja unë.

- Ah, sonte. E po, sonte do të shohësh një ëndërr speciale, - thoshte ai gjithmonë, përpara se të fillonte të ma tregonte. Dhe sajonte aty për aty një përrallë. Në njërën nga ëndrrat që më kishte futur në kokë, unë bëhesha piktorja më e famshme në botë. Në një tjetër, isha mbretëreshë në një ishull të magjepsur dhe kisha një fron fluturues. Ai më dha, madje, edhe një ëndërr me ëmbëlsirën time të parapëlqyer, *Jell-O*. Unë kisha fuqinë që, me një të tundur të shkopit magjik, ta shndërroja gjithçka në *Jell-O*: autobusin e shkollës, *Empire State Building*, madje tërë oqeanin Paqësor, po të doja. Më shumë se një herë unë me shkopin tim magjik e kisha shpëtuar planetin nga një meteor që ishte gati për t'u përplasur me të. Babai im, që kurrë nuk fliste shumë për të atin, më thoshte se e kishte trashëguar prej tij këtë aftësi për të rrëfyer përralla. Ai thoshte se, kur kishte qenë fëmijë, i ati e merrte ndonjëherë pranë vetes - kur ishte me humor të mirë, çka nuk ndodhte shpesh - dhe i tregonte përralla me xhinde, diva e zana.

Ndonjëherë ndërronim rolet me babanë. Ai mbyllte sytë dhe isha unë që i rrëshqisja duart mbi fytyrën e tij, duke filluar nga balli e duke i zbritur mbi rrudhat në faqe e mbi mustaqet e dendura.

- Atëherë, çfarë do të shoh unë sot në ëndërr? - pëshpërinte ai, duke më kapur duart. Dhe atëherë buzëqeshte fort. Sepse ai e dinte qysh më parë se çfarë ëndrre i jepja unë atij. Ishte gjithmonë e njëjta ëndërr. Ajo ëndërr ku ai dhe motra e tij e vogël qëndronin shtrirë nën një pemë molle të lulëzuar dhe bënin gjumin e drekës. Dielli ua ngrohte fytyrën, drita e tij binte mbi bar, mbi gjethet dhe petlat e luleve mbi kokët e tyre.

Unë isha fëmijë i vetëm dhe shpesh ndihesha e vetmuar. Pasi linda unë, prindërit e mi, që ishin njohur në Pakistan kur

të dy ishin pothuajse nga dyzet vjeç, vendosën që të mos e vinin më fatin në provë. Më kujtohet se me sa zili i shihja fëmijët e lagjes a të shkollës, që kishin motra e vëllezër të tjerë. Se sa më habiste mënyra se si e trajtonin disa prej tyre njëri-tjetrin, pa e vlerësuar fatin e tyre të mirë: ata silleshin si qen të egër. E pickonin, e qëllonin, e shtynin, e tradhtonin njëri-tjetrin me çdo mënyrë që mund t'u shkonte në mendje. Dhe qeshnin me këtë. Nuk i flisnin njëri-tjetrit. Unë nuk e kuptoja këtë. Unë, që e kisha kaluar pjesën më të madhe të fëmijërisë e përvëluar për një motër a vëlla. Ajo që vërtet do të kisha dashur, ishte një motër binjake, një foshnjë që do të kishte qarë pranë meje në djep, do të kishte fjetur pranë meje, do të ishte ushqyer me qumësht gjiri njëherazi me mua. Diçka që do ta doja thellësisht e pa kushte dhe në fytyrën e së cilës do të shihja përherë fytyrën time.

Dhe kështu, motra e vogël e babait, Pahri, u bë shoqja ime sekrete, e padukshme për cilindo tjetër përveç meje. Ajo u bë motra ime, motra që gjithmonë kisha dashur të kisha. Unë e shihja në pasqyrën e banjës çdo mëngjes, ndërsa lanim dhëmbët duke qëndruar në krah të njëra-tjetrës. Ne visheshim bashkë. Ajo më shoqëronte për në shkollë dhe ulej në bankë me mua: edhe pse i mbaja vazhdimisht sytë mbi dërrasën e zezë, unë arrija ta shihja me bisht të syrit profilin e saj dhe flokët e zinj. Unë e merrja me vete te lodrat gjatë pushimit, duke ia ndier praninë pas meje, kur shkisja në rrëshqitëse, kur kërceja nga njëri tra në tjetrin në paralelen e shkallëzuar. Pas shkolle, kur ulesha në kuzhinë për të vizatuar, edhe ajo zhgarraviste me durim pranë meje ose shihte nga dritarja, derisa mbaroja unë, dhe pastaj që të dyja turreshim jashtë e luanim me litar, ndërsa hijet tona binjake kërcenin lart e poshtë mbi asfalt.

Asnjeri nuk e dinte që unë luaja me Pahrin. As vetë im atë. Ishte sekreti im.

Ndonjëherë, kur ishim vetëm fare, ne hanim rrush dhe flisnim e flisnim pa pushim: për lodrat, për kornflekset që na

pëlqenin, për filmat vizatimorë, për fëmijët e shkollës që nuk i donim, për mësuesit e ashpër. Neve na pëlqente e njëjta ngjyrë (e verdha), e njëjta akullore (vishnje e errët), i njëjti emision televiziv ("*Alfi*") dhe të dyja donim që, kur të rriteshim, të bëheshim artiste.

Afërmendsh, në përfytyrimin tim ne ishim identike, sepse, tek e fundit, ne binjake ishim. Ndonjëherë unë gati arrija ta shihja - ta shihja vërtet, dua të them - në rrethinat e vështrimit tim. Unë mundohesha ta vizatoja dhe, çdo herë, gjithmonë e bëja me sy në ngjyrë jeshile të hapur si të mitë, me të njëjtët kaçurrela si të mitë, me të njëjtët qerpikë të gjatë. Po të më pyeste njeri, i thosha se kisha vizatuar veten time.

Historia se si im atë e kishte humbur të motrën, ishte po aq e njohur për mua sa edhe historitë e mamasë për Profetin, histori që do t'i dëgjoja sërish më vonë, kur prindërit të më regjistronin në shkollën e së dielës në xhaminë e *Haywards-it*. E prapë, edhe pse e kisha mësuar përmendsh, unë çdo natë doja të dëgjoja historinë e Pahrit, e rrëmbyer nga forca e saj tërheqëse. Mbase kjo vinte thjesht ngaqë kishim të njëjtin emër. Ndoshta kjo ishte arsyeja pse mua më dukej sikur ekzistonte një lloj lidhjeje ndërmjet nesh, një lidhje e zbehtë, e ngarkuar me mistere, por gjithsesi e vërtetë. Por ishte më shumë se kaq: Unë ndihesha sikur ajo që i kishte ndodhur asaj, kishte ndikuar edhe mbi mua, më kishte prekur edhe mua. Më dukej se ne ishim të ndërlidhura me fije të padukshme, në një mënyrë që unë nuk e kuptoja dot plotësisht, përtej emrave tanë, përtej lidhjes fisnore: të dyja bashkë ne formonim një nga ato lodrat që marrin trajtë vetëm kur bashkohen të gjitha pjesët e tyre.

Unë isha e sigurt se, po ta dëgjoja me vëmendje të plotë atë histori, do të zbuloja aty diçka për veten time.

- A mendon se babai yt ishte i trishtuar? Ngaqë e shiti atë?

- Disa njerëz arrijnë ta fshehin mjaft mirë trishtimin e tyre, Pahri. Ashtu ishte ai. Në dukje nuk të linte të kuptoje

asgjë. Ishte burrë i ashpër. Por besoj se po, besoj se përbrenda ishte i trishtuar.

- Po ti?

Im atë do të buzëqeshte e do të thoshte:

- E pse duhet të jem, kur të kam ty? - Por edhe në atë moshë, unë arrija ta vija re trishtimin. Ai ishte si një nishan qysh në lindje në fytyrën e tij.

Gjatë gjithë kohës që flisnim kështu, në mendjen time shpalosej fantazia: unë do t'i kurseja të gjitha paratë e mia, nuk do të shpenzoja asnjë qindarkë për karamele e ëmbëlsira prej xhelatine dhe, kur kumbaraja ime të mbushej plot - që nuk ishte një kumbara në formë derrkuci, por një sirenë e ulur në një shkëmb - do ta hapja, do t'i futja paratë në xhep e do të dilja nëpër botë për të kërkuar motrën e vogël të tim eti, kudo që të ndodhej ajo dhe, kur ta gjeja, do ta blija përsëri dhe do t'ia sillja babait në shtëpi. Unë do ta bëja të lumtur tim atë. Nuk kishte gjë tjetër në këtë botë që ta dëshiroja më fort sesa të isha unë ajo që do t'ia largonte trishtimin.

- Pra, çfarë ëndrre do të shoh unë sonte? - më pyeste babai.

- Ti e di se çfarë.

Një tjetër buzëqeshje.

- Po e di.

- Babi?

- Mmm?

- Ai ishte motër e mirë ajo?

- Ishte e përkryer.

Ai më puthte në faqe dhe më mbulonte mirë me batanije rreth qafës. Te pragu i derës, pak përpara se të fikte dritën, i ndalte hapat.

- Ishte e përkryer, - thoshte përsëri ai. - Siç je edhe ti.

Unë prisja derisa ta mbyllte derën dhe pastaj çohesha nga shtrati, merrja një jastëk tjetër dhe e vendosja pranë timit. Mua më zinte gjumi çdo natë duke ndier dy zemra binjake që më rrihnin në kraharor.

Shoh orën e dorës, ndërsa kaloj nga *Old Oakland Road*-i në Autostradën Kombëtare 101. Ka shkuar tashmë dymbëdhjetë e gjysmë e drekës. Do të më duhen të paktën dyzet minuta për të mbërritur në Aeroportin Ndërkombëtar të San Franciskos, po të mos ketë ndodhur asnjë aksident ose po të mos jetë duke u bërë ndonjë rregullim segmenti në autostradën 101. Ana pozitive është që ajo ka marrë një avion ndërkontinental dhe do t'i duhet të kalojë nëpër të gjitha hallkat e sigurisë, e kjo mbase më jep mua pak kohë. Unë kaloj në autostradë dhe e shtoj shpejtësinë e *Lexusi*-t në pothuajse 130 kilometra në orë.

Më vjen ndër mend një copëz bisede që kam bërë me babanë një muaj më parë. Një copëz magjike bisede, si një flluskë kalimtare normaliteti, si një xhep i vogël ajri në fundin e thellë, të errët, të ftohtë të oqeanit. Po ia sillja drekën pak me vonesë dhe ai ktheu kokën drejt meje nga kolltuku ku ishte ulur, e më qortoi, me një ton të butë kritik, se isha programuar gjenetikisht për të mos qenë korrekte në orar.

- Si mamaja jote, iu prehtë shpirti në paqe pranë Zotit. Por gjithsesi, - vazhdoi ai duke buzëqeshur, si të ishte duke më ngushëlluar, - çdo njeri duhet ta ketë një huq, diku.

- Domethënë, ky është tipari dallues që ka zgjedhur Zoti për mua, - i thashë unë, duke ia vënë në prehër pjatën me pilaf e bizele, - vonesa e zakonshme.

- Por më duhet të shtoj që e ka bërë pa dashje, pa e pasur mendjen. - Babai zgjati duart drejt të miave. - Vetëm për një grimë, për një grimë, ai nuk të bëri pothuajse plotësisht të përkryer.

- E po, po të duash, unë mund të të zbuloj edhe ca defekte të tjera të miat.

- Ti i mban të fshehura ato, kështu?

- Oh, i kam bërë stivë. Dhe po pres t'i nxjerr kur ti të plakesh plotësisht e të mos jesh më në gjendje të kujdesesh për veten.

- Unë që tani jam një plak që nuk kujdeset dot për veten.

- Mos dashke që tani të ndiej keqardhje për ty?

Unë hap radion dhe e kaloj nga një stacion tek tjetri, nga muzika kauntri te muzika xhaz e pastaj te lajmet. Në fund e fik. Ndihem nervoze dhe e paqetë. Marr celularin nga ndenjësja e pasagjerit. Formoj numrin e shtëpisë dhe e lëshoj telefonin në prehër.

- Alo?

- *Salaam*, baba. Jam unë.

- Pahri?

- Po, baba. Si jeni ti me Hektorin aty, a jeni mirë?

- Po. Ai është djalë i mrekullueshëm. Na bëri vezë. Vezë të skuqura. Ku je ti?

- Në makinë, - i them unë.

- Po shkon te restoranti? Sot e ke pushim, apo jo?

- Jo, po shkoj në aeroport, baba. Po shkoj të marr dikë.

- Mirë, po i them mamasë të na bëjë drekën, - thotë ai. - Mund të na e sjellë nga restoranti.

- Në rregull, baba.

Për lehtësimin tim, ai nuk e përmend përsëri. Por ka ditë kur nuk resht: "Pse nuk më thua ku është ajo, Pahri? Mos po i nënshtrohet ndonjë operacioni? Mos më gënje! Pse më gënjejnë të gjithë? Mos ka ikur gjë? Ka shkuar gjë në Afganistan? Atëherë do të shkoj edhe unë. Do të nisem për në Kabul dhe s'ka burrë që të më ndalojë." Dhe japim e marrim në këtë mënyrë: Babai i acaruar, duke dihatur, unë që e mbaj me gënjeshtra e në fund mundohem t'ia largoj mendjen duke i treguar katalogët për rregullimin e shtëpive ose me ndonjë emision televiziv. Ndonjëherë funksionon, por ka raste kur ai u bën rezistencë gënjeshtrave të mia. Mërzitet aq shumë, sa shpërthen në lot e bëhet histerik. Godet kokën me grushte dhe tundet para e mbrapa në karrige, duke dënesur, ndërsa këmbët i dridhen dhe atëherë mua më duhet t'i bëj një *ativan* për ta qetësuar. Pres derisa i mjegullohen sytë, dhe, kur kjo ndodh, lëshohem pafuqishëm në divan, pa frymë, gati për t'ia plasur të qarit edhe vetë. Gjithë përmallim, shoh derën e jashtme dhe

e vetmja gjë që do të doja të bëja në ato çaste, është që të dilja prej aty dhe të ecja kuturu pa u ndalur. Pastaj babai rënkon në gjumë dhe unë shpërthej në të qara, me një ndjenjë faji që më vlon përbrenda.

- A mund të flas pak me Hektorin, baba?

E ndiej prekjen e receptorit të telefonit ndërsa kalon nga një dorë në një tjetër. Në sfond dëgjohen zhurmat e një loje, mërmërimat e turmës, pastaj shpërthim duartrokitjesh.

- Hej, çupë!

Hektor Huarezi jeton në anën tjetër të rrugës. Kemi kohë që jemi fqinjë dhe këto vitet e fundit jemi bërë miq. Ai vjen në shtëpinë tonë disa herë në javë dhe ha ushqime jo fort të shëndetshme e sheh shfaqje pa vlerë në televizor, më së shumti emisione *reale* me njerëz të zakonshëm. Ne përtypim picën e ftohtë dhe tundim kokën në shenjë mohimi, teksa shohim si të magjepsur ato sjellje qesharake e shpërthime zemërimi në ekran. Hektori ka qenë marins, i caktuar në Afganistanin Jugor. Disa vjet më parë u plagos rëndë nga një shpërthim bombash amatore. Të gjithë banorët e lagjes dolën ta prisnin përpara shtëpisë së tij, kur më në fund ai u kthye nga spitali i veteranëve. Prindërit e tij kishin varur një pankartë "Mirë se erdhe në shtëpi, Hektor!" përpara derës së shtëpisë, me tullumbace e shumë lule. Të gjithë duartrokitën kur prindërit e tij e parkuan makinën para derës së shtëpisë. Disa prej fqinjëve kishin sjellë torta. Njerëzit e falënderonin për shërbimet e tij. Ata i thoshin: "Bëhu i fortë tani. Zoti të bekoftë!" Babai i Hektorit, Cezari, erdhi disa ditë më vonë në shtëpinë tonë për të instaluar një platformë për karrigen me rrota, të njëjtë me atë që kishte ndërtuar edhe përpara derës së shtëpisë së tij, me një shtizë me flamurin amerikan. Më kujtohet që, ndërsa punonim me platformën, unë ndieja një nevojë për t'i kërkuar ndjesë Cezarit për atë që i kishte ndodhur Hektorit në vendlindjen e tim eti.

- Ç'kemi? – i them. – Desha t'ju pyesja si po ia çoni.

- Gjithçka po shkon më së miri, - thotë Hektori. – Hëngrëm bukë. Pamë "*The Price is right*" [*Çmimi i saktë*]. Tani po

argëtohemi me "The 5th *Wheel*" [*Rrota e pestë*]. Pastaj do shohim "*Family Feud*" [Feud familjar].

- Oh! Më falni!

- Për çfarë, *mija*? Ne po ia kalojmë më së miri. Apo jo, Abi?

- Falemnderit që i skuqe vezë, - i them unë.

Hektori e ul zërin paksa.

- Në fakt, ishin krepa. Dhe e gjen dot? Atij i pëlqyen. Hëngri katër copë.

- Të detyrohem vërtet.

- Hej, mua vërtet më pëlqen ajo piktura e re, çupë. Ajo me atë fëmijën me atë kapelën qesharake. Ma tregoi Abi. Dhe ishte shumë krenar. Kurse unë mendova: "Ta hajë dreqi. Ke arsye për të qenë krenar, o burrë."

Unë buzëqesh ndërsa ndryshoj korsinë për të lejuar të kalojë një makinë me bagazh të madh.

- Mbase tani e di se çfarë duhet të të bëj dhuratë për Krishtlindje.

- Do të më tregosh përsëri pse ne të dy s'martohemi dot bashkë? – thotë Hektori. Dëgjoj babanë që proteston në sfond dhe Hektorin që qesh, duke u larguar nga receptori. – Po bëj shaka, Abi. Më i butë me mua. Unë të ngelem në dorë. – Dhe pastaj më drejtohet mua. – Më duket se yt atë sapo më mallkoi me atë pashton e vet.

Unë e kujtoj që t'i japë babait barnat e drekës dhe e mbyll telefonin.

Është njësoj si të shohësh fotografinë e një personaliteti të famshëm radioje. Ata gjithmonë janë krejt ndryshe nga si i ke përfytyruar ti në mendjen tënde, kur ua ke dëgjuar zërin në radion e makinës. Së pari, ajo tani është një grua e moshuar. Ose të paktën i ka hyrë asaj rruge. Sigurisht që e dija këtë. Unë i kisha bërë llogaritë dhe kisha arritur në përfundimin se

ajo duhej të ishte në fillimet e të gjashtëdhjetave. Vetëm se është shumë e vështirë që ta lidhësh këtë grua të dobët me flokë gri me atë vajzën e vogël që kisha përfytyruar unë gjithmonë: një vajzë trevjeçare me flokë të zinj kaçurrelë dhe vetulla të gjata që gati i bashkohen mbi hundë, njësoj si të miat. Dhe është më e gjatë nga sa e kam përfytyruar unë. Arrij ta dalloj këtë, edhe pse ajo po qëndron e ulur në një stol pranë një kioske që shet sanduiçë, duke parë përreth si të ketë humbur. Ajo ka supe të ngushta, trup të brishtë, fytyrë të këndshme dhe flokët i ka tërhequr pas e i ka fiksuar me një shirit të thurur me dorë. Në veshë ka vënë një palë vathë prej xhadeiti. Ka veshur pantallona xhinse me ngjyrë të zbehtë, një pulovër të gjatë ngjyrë salmoni dhe një shall të verdhë, që e ka hedhur rreth qafës me një elegancë europiane. Më shkruante në *e-mailin* e saj të fundit se do të mbante shall, që unë të mund ta dalloja menjëherë.

Ajo nuk më ka parë ende dhe për një çast unë ngadalësoj hapat në mes të udhëtarëve, që shtyjnë mbajtëset e valixheve nëpër terminal, e shoferëve të taksive, që mbajnë në duar tabela me emrat e klientëve. Zemra nis të më rrahë me tërbim në kafazin e kraharorit. Them me vete: "Kjo është. Kjo është ajo. Kjo është vërtet ajo." Dhe mandej sytë na takohen e pohimi se më ka njohur, përhapet në fytyrën e saj. Ajo më përshëndet me dorë.

Ne takohemi te stoli. Ajo buzëqesh dhe mua më dridhen gjunjët. Ajo ka buzëqeshjen e babait: me përjashtim të hapësirës sa një kokërr orizi midis dhëmbëve të përparmë. Mënyra se si i ulet paksa poshtë këndi i majtë i buzës, se si i ngrihen muskujt e fytyrës dhe gati ia mbyllin sytë, koka e përkulur paksa anash. Ajo ngrihet në këmbë dhe unë vë re duart, nyjet me gunga, gishtat e harkuar anash në drejtim të kundërt me gishtin e madh, gungat sa një kokërr qiqër në kyçet e duarve. Ndiej një pështjellim në stomak, më duket diçka shumë e dhembshme.

Ne përqafohemi dhe ajo më puth në të dyja faqet. Lëkurën e ka të butë si najlon. Kur tërhiqem pas, ajo vazhdon t'i mbajë

duart të mbështetura mbi supet e mia dhe e kundron fytyrën time si të jetë duke admiruar një pikturë. Në sytë e saj shoh një vel lotësh. Ata vezullojnë nga lumturia.

- Të kërkoj ndjesë për vonesën.

- S'ka për se, - thotë ajo. - Më në fund, ja ku jemi bashkë. Jam shumë e lumtur - *S'ka pëhse. M n fund, ja ku jemi bask*! Theksi francez tingëllon edhe më i rëndë kështu drejtpërdrejt, nga sa tingëllon në telefon.

- Edhe unë jam e lumtur, - i them. - Si shkoi fluturimi?

- Mora një pilulë, përndryshe e di që s'fle dot. Kam për të ndenjur zgjuar gjatë gjithë kohës. Ngaqë jam shumë e lumtur dhe e entuziazmuar. - Ajo nuk i ndan sytë nga unë, a thua se ka frikë se mos prish magjinë, po t'i largojë prej meje: derisa fortafolësit mbi kokët tona i këshillojnë pasagjerët që të njoftojnë për ndonjë valixhe të lënë përreth pa zot. Fytyra e saj sikur ngryset paksa.

- A e di Abdullai që jam këtu?

- I thashë që do të sillja një mysafire në shtëpi, - i përgjigjem.

Më vonë, ndërsa ulemi në makinë, unë i hedh një vështrim vjedhurazi. Është gjëja më e çuditshme. Më duket çuditërisht si iluzion fakti që Pahri Vahdati është ulur në makinën time, pak centimetra larg meje. Për një çast e shoh fare qartë: shallin e verdhë përreth qafës, pushin e dobët në vijën e flokëve mbi ballë, nishanin bojëkaf prapa veshit të majtë, por pas një çasti tiparet e saj mjegullohen, si të jem duke e parë përmes një palë syzesh me xhama të turbullt. Për disa sekonda më duket sikur po më merren mendtë.

- Je mirë? - thotë ajo, duke m'i ngulur sytë, ndërsa vë rripin e sigurimit.

- Vazhdoj të mendoj se mos më zhdukesh nga çasti në çast.

- Si?

- Thjesht... është e pabesueshme, - i them, duke qeshur me nervozizëm, - që ti ekziston vërtet, që je vërtet këtu.

Ajo pohon me kokë, duke buzëqeshur.

- Ah, edhe për mua. Edhe për mua është e çuditshme. Ti e kupton: gjatë gjithë jetës sime nuk kam ndeshur ndonjë njeri me të njëjtin emër si imi.

- As unë, - unë ndez makinën. - Pra, më trego diçka për fëmijët e tu.

Ndërsa dal nga parkingu, ajo nis të më tregojë për ata, duke i përmendur me emra, sikur unë t'i kem njohur gjatë gjithë jetës, si të jemi rritur bashkë, si të kemi shkuar bashkë nëpër piknikë, kampe ose t'i kemi kaluar bashkë pushimet e verës në hotele në breg të detit, duke bërë varëse me guaska a duke mbuluar njëri-tjetrin me rërë.

Sa do të doja të kishte qenë kështu.

Ajo më thotë se Aleni, djali i saj - "dhe kushëriri yt", shton ajo, - dhe gruaja e tij, Ana, janë bërë me një fëmijë të pestë, me një vajzë të vogël, dhe janë shpërngulur në Valencia, ku kanë blerë më në fund një shtëpi.

- *Finalement*, e lanë atë apartamentin e shëmtuar të Madridit! - Fëmija i saj i parë, Izabela, që kompozon muzikën e emisioneve televizive, ka fituar më në fund të drejtën për të kompozuar kolonën zanore të një filmi të rëndësishëm. Kurse burri i Izabelës, Alberti, tani është kryekuzhinier në një restorant të mirënjohur në Paris. - Edhe ti ke një restorant, apo jo? - pyet ajo. - Më duket se ma ke thënë këtë në njërin prej *e-maileve* që më ke dërguar.

- Në fakt, restoranti ishte i prindërve. Im atë e kishte pasur gjithmonë ëndërr të kishte një restorant të vetin. Unë i ndihmoja aty. Por m'u desh ta shisja përpara disa vjetësh. Pasi mamaja vdiq dhe babai u bë... invalid.

- Ah, më vjen keq!

- Nuk ka për se. Unë nuk isha e prerë për punën në restorant.

- E besoj këtë. Ti je artiste.

Unë i kisha treguar kalimthi, herën e parë që kishim folur

bashkë, kur më kishte pyetur se me se merresha, se një ditë ëndërroja të vazhdoja një shkollë arti.

- Aktualisht jam *transkriptuese*. - Ajo më dëgjon me vëmendje, ndërsa unë i shpjegoj se tani punoj për një firmë që përpunon të dhënat financiare të kompanive për hartimin e listës "*Fortune 500*" për 500 kompanitë më të pasura në Amerikë. - Plotësoj formularët për këto kompani. Broshurat, listën e klientëve, listën e *e-maileve*, gjëra të këtilla. Gjëja kryesore që duhet të dish, është si të shtypësh në kompjuter. Dhe pagesa është e kënaqshme.

- E kuptoj, - më thotë. Ajo mendohet për një çast, pastaj shton: - A të duket interesante kjo punë?

Jemi duke kaluar pranë *Redwood City*-t tani. Unë zgjatem mbi prehrin e saj dhe i bëj shenjë me gisht nga dritarja e pasagjerit.

- E sheh atë ndërtesën atje? Atë të lartën me atë shenjën blu?

- Po.

- Atje kam lindur unë.

- Ah, *bon*! - Ajo kthen kokën dhe vazhdon ta shohë edhe ndërsa e lëmë pas. - Je me fat.

- Pse?

- Që e di se ku ke ardhur në jetë.

- Them se nuk e kam vrarë ndonjëherë mendjen për këtë.

- *Bah*, sigurisht që s'ke pse. Por është e rëndësishme ta dish këtë, të njohësh rrënjët e tua. Të njohësh se ku i ke pasur fillesat e tua si njeri. Po qe se nuk e di, vetë jeta jote të duket joreale. Si gjëegjëzë. *Vous comprenez*?[1)] Si të kesh humbur fillimin e historisë dhe tani je në mesin e saj e po mundohesh që ta kuptosh.

Besoj se kështu ndihet babai këto ditë. Jeta e tij është plot me hapësira boshe. Çdo ditë është një histori turbulluese, një gjëegjëzë që të mundon për t'ia gjetur kuptimin.

---

1) Më kupton? (*shën. i përkth.*).

Ne bëjmë në heshtje me makinë disa kilometra.

- A më duket interesante puna që bëj? - i them pastaj. - Një ditë u ktheva në shtëpi dhe gjeta ujin që derdhej nga sqolli i kuzhinës. Në dysheme ishte një gotë e thyer dhe soba me gaz ishte harruar ndezur. Aty e kuptova që s'mund ta lija më vetëm. Dhe ngaqë s'e përballoja dot ekonomikisht që të merrja një kujdestare për të, u detyrova të gjeja një punë që mund ta bëja në shtëpi. "Interesante" nuk ishte pjesë e ekuacionit.

- Dhe shkolla e artit mund të presë.

- Duhet të presë.

Druaj se më tej ajo do të vijojë të thotë se sa me fat është babai që ka një vajzë si unë, por, për lehtësimin dhe mirënjohjen time, ajo vetëm pohon me kokë, ndërsa hedh sytë nga njëra tabelë qarkullimi tek tjetra. Njerëzit e tjerë, në mënyrë të veçantë afganët, vazhdimisht vënë në dukje se sa me fat është babai, se ç'vajzë e bekuar jam unë. Ata flasin për mua gjithë admirim. Më bëjnë të dukem si shenjtore, vajza që me heroizëm i ka thënë jo një jete pa probleme e me privilegje, për të qëndruar në shtëpi e për t'u kujdesur për të atin. "Por në fillim për të ëmën, - thonë ata, me zërat që tingëllojnë me një nuancë keqardhjeje. - Gjithë ato vite përkujdesjeje për të. Sa e rëndë ka qenë. Ja tani, edhe i ati. Ajo nuk ka qenë ndonjëherë e bukur, sigurisht, por e kishte një mëtonjës. Dhe ai na ishte amerikan, djalë i shkëlqyer. Ajo mund të ishte martuar me të. Por nuk e bëri. Për hir të prindërve. Sa gjëra ka sakrifikuar ajo! Ah, sikur çdo prind të kishte një vajzë të tillë!" Ata lavdërojnë humorin tim të mirë. Mrekullohen me kurajën dhe mirësinë time, ashtu siç ndodh me ata që kanë një shformim fizik ose u merret goja.

Por unë nuk e shoh veten sipas këtij këndvështrimi të tyre. Për shembull, ka mëngjese kur e shoh babanë të ulur buzë shtratit, me sytë gjithë sklepa të ngulur mbi mua, duke pritur gjithë padurim që unë t'ia fut këmbët e thara e gjithë njolla në shapka, duke thirrur emrin tim me një zë krrokatës e me një pamje prej fëmije në fytyrë. Ai e lëviz hundën si një

brejtës i frikësuar dhe unë zemërohem me të, kur bën kështu. Zemërohem me të për mënyrën se si sillet. Unë e bëj fajtor atë për kufijtë e ngushtë të ekzistencës sime, e fajësoj se është arsyeja që po shteron vitet më të bukura të jetës sime. Ka ditë kur e vetmja gjë që do të dëshiroja vërtet, është që të isha e lirë, pa të, pa nevojat dhe kërkesat e tij. Unë nuk jam aspak shenjtore.

Dal nga autostrada në *Thirteenth Street*. Ca kilometra më tej hyj në rrugicën tonë, në *Beaver Creek Court*, dhe e fik makinën.

Pahri hedh sytë nga dritarja drejt shtëpisë sonë njëkatëshe: dera e garazhit me bojën e rrjepur, dritarja me kornizë prej druje ulliri, dy luanët prej guri si roja në të dyja anët e derës së jashtme, të cilët nuk më bën zemra t'i shes, sepse babai i adhuron, edhe pse tani dyshoj se nuk ka për ta vënë re mungesën e tyre. Ne kemi jetuar në këtë shtëpi qysh prej vitit 1989, kur unë isha shtatë vjeç, në fillim me qira e mandej babai ia bleu pronarit në vitin 1993. Mamaja vdiq në këtë shtëpi, në një mëngjes gjithë diell Krishtlindjesh, në një shtrat spitali që unë e kisha vendosur për të në dhomën e miqve, ku ajo kaloi tre muajt e fundit të jetës. Ma kërkoi ajo vetë që t'ia vendosja shtratin në atë dhomë, për shkak të pamjes përtej dritares. Thoshte se ia përmirësonte humorin. Ajo rrinte shtrirë në shtrat me këmbët e ënjtura ngjyrëgri dhe i kalonte ditët duke parë nga dritarja në drejtim të fundit të rrugicës sonë qorre, drejt kopshtit të përparmë të shtëpisë dhe panjës japoneze që kishte mbjellë vetë disa vjet më parë, shtratin e luleve në formë ylli, barin e ndërprerë nga një rruginë e ngushtë e shtruar me guralecë, kodrat në largësi, që merrnin ngjyrë të verdhë të thellë në mesditë, kur dielli shkëlqente pingul mbi majat e tyre.

- Jam shumë nervoze, - thotë Pahri me zë të qetë.

- Është e kuptueshme, - i them unë. - Kanë kaluar pesëdhjetë e tetë vjet.

Ajo ul kokën dhe sheh duart e veta njëra mbi tjetrën në prehër.

- Unë pothuajse nuk kujtoj asgjë prej tij. Ajo që kujtoj, nuk është fytyra ose zëri i tij. Por vetëm që në jetën time gjithmonë e kam ndier mungesën e diçkaje. E diçkaje të mirë. E diçkaje... Oh, nuk di si ta shpreh! Kjo është e gjitha.

Unë pohoj me kokë. Mendoj se bëj mirë t'i them se sa mirë e kuptoj. Dhe gati sa nuk e pyes a ka pasur ndonjë ndjesi ndonjëherë për ekzistencën time.

Ajo luan me fundet e lira të shallit.

- A mendon se mund t'i kujtohem?

- Do të dish të vërtetën?

Ajo heton fytyrën time.

- Po, natyrisht.

- Mbase është më mirë që të mos të kujtojë.

Më vjen ndër mend doktor Bashiri, mjeku i familjes sonë prej vitesh. Ai më kishte thënë se babai kishte nevojë për regjim, për rregull në jetën e vet. Sa më pak surpriza...

Unë hap derën.

- E ke problem të qëndrosh në makinë edhe për një minutë? Do të çoj në shtëpi shokun tim dhe pastaj ti mund të takosh babanë.

Ajo vendos dorën mbi sy dhe unë nuk pres që të shoh nëse po fillon të qajë.

Një të premte, kur isha njëmbëdhjetë vjeç, të gjitha klasat e gjashta të shkollës sime shkuan të kalonin një natë në akuariumin e *Monterey Bay*-it. Gjatë gjithë javës përpara asaj së premteje, shokët e mi të klasës vetëm për këtë flisnin, qoftë në bibliotekën e shkollës, qoftë në oborrin e saj, ndërsa luanin me top në pushim të madh: sa do të kënaqeshin, sidomos pas orarit të mbylljes së akuariumit, kur do të mbeteshin të vetmit vizitorë. Ata do të ishin të lirë të shihnin gjithçka - madje të

veshur me pizhame - që nga peshqit çekiç e deri te dragonjtë e detit dhe sepjet. Mësuesja jonë, zonja Gilespi, na tha se tendat për ngrënien e darkës do të ngriheshin përreth akuariumit dhe nxënësit do të mund të zgjidhnin ndërmjet sanduiçit me gjalpë kikirikësh e marmeladë dhe makaronave me djathë. "Për ëmbëlsirë si t'ju pëlqejë: ose kek me çokollatë, ose akullore me vanilje." Nxënësit do të flinin atë natë në dyshekët-thes dhe do të dëgjonin historitë që do t'u lexonin mësuesit. Ata do të flinin në mes të kuajve të detit, sardeleve e peshkaqenëve leopardë, që rrëshqisnin midis fijeve të gjata të leshterikëve valëvitës. Të enjten, padurimi i nisjes ishte elektrizues. Edhe nxënësit më të prapë të klasës bënë të pamundurën që të silleshin mirë, nga frika se edhe prapësia më e vogël mund t'u kushtonte vajtjen në akuarium.

Për mua qe paksa si të shihja një film entuziazmues, por në një ekran pa zë. Unë ndihesha e shkëputur nga gjithë ai gëzim, e ndarë nga ajo situatë festive: ashtu siç ndihesha gjithmonë çdo dhjetor, kur shokët e mi të klasës ktheheshin në shtëpi dhe gjenin bredhin e stolisur, çorapet e gjata të kuqe të varura mbi vatrën e zjarrit dhe piramidat me dhurata. Unë i thashë zonjës Gilespi se nuk do të shkoja me ta. Dhe, kur ajo më pyeti pse, iu përgjigja se dita e ekskursionit përkonte me një festë myslimane. Por nuk isha e sigurt në më besoi apo jo.

Natën e ekskursionit ndenja në shtëpi dhe bashkë me prindërit po shihja serialin televiziv "*Vrasje - shkroi ajo*" ["*Murder, she wrote*"]. Mundohesha të përqendrohesha te filmi e të mos mendoja për ekskursionin, por mendja hidhej me kryeneçësi tek ai. Përfytyroja shoqet e mia të klasës në atë çast, të veshura me pizhame, me fenerë elektrikë në duar, me ballin mbështetur pas xhamit të akuariumit gjigant të ngjalave. Ndieva sikur m'u kris diçka në kraharor dhe u tulata edhe më tepër në divan. Babai, i rehatuar mirë në divanin tjetër, futi një kikirik të pjekur në gojë dhe po qeshte me atë që tha Enxhela Lensbëri. Pranë tij, mamaja, po më shihte me një pamje të

menduar, me vështrim të mjegulluar, por, kur sytë u ndeshën, tiparet e saj u qartësuan menjëherë dhe ajo më buzëqeshi - një buzëqeshje vjedhurazi, e fshehtë; edhe unë gërmova brenda vetes e gjeta një buzëqeshje për të.

Atë natë pashë në ëndërr sikur isha në plazh: qëndroja në këmbë në ujin e oqeanit që më vinte deri te beli, ndërsa mbi sipërfaqen e tij xixëllonin me mijëra nuanca të ngjyrave blu e jeshile: xhadeiti, safiri, smeraldi, gurkali, që fërkoheshin butësisht pas ijëve të mia. Nëpër këmbë më rrëshqisnin legjione të tëra peshqish, sikur oqeani të ishte akuariumi im personal. Ata më fërkoheshin pas gishtave të këmbëve dhe më kilikosnin kaviliet, si mijëra ngjyra të ndritshme e vezulluese që vërtiteshin si shigjeta mbi rërën e bardhë.

Të dielën e po asaj jave, babai më bëri një surprizë. Ai e mbylli restorantin, çka nuk e bënte kurrë, dhe na çoi mua me mamanë tek akuariumi në *Monterey Bay*. Babai fliste me entuziazëm gjatë gjithë rrugës: Sa shumë që do të kënaqeshim! Sa me padurim po priste të shihte veçanërisht peshkaqenët! Çfarë do të hanim për drekë. E, ndërsa ai fliste, mua m'u kujtua se si më çonte dikur, kur isha e vogël, në kopshtin zoologjik në *Kelley Park* dhe në kopshtet japoneze aty pranë, për të parë krapin *koi*, se si ai u vinte emra të gjithë peshqve dhe si ia shtrëngoja unë dorën fort e mendoja se kurrë nuk do të kisha nevojë për njeri tjetër gjatë gjithë jetës sime. Tek akuariumi, unë i shëtita pavionet e ndryshme pa ma bërë syri tërr dhe mundohesha t'i jepja përgjigje sa më të sakta babait, që më pyeste për llojet e ndryshme të peshqve. Por vendi ishte shumë i ndritshëm e kishte shumë zhurmë, pavionet më të bukura ishin të mbushura plot me njerëz. Ky vend nuk përkonte aspak me përfytyrimin që kisha krijuar unë për natën e ekskursionit. Ishte një stërmundim i vërtetë. Mua po më shteronin të gjitha energjitë, ndërsa përpiqesha me të gjitha forcat që të sillesha sikur po ia kaloja shumë mirë. Ndieva se po më niste dhembja e stomakut, ndaj u larguam prej aty vetëm një orë a diçka më shumë pasi kishim hyrë brenda. Rrugës për

në shtëpi, babai më hidhte vazhdimisht një vështrim të ashpër, sikur po bëhej gati të thoshte diçka. I ndieja se si nguleshin sytë e tij mbi mua. Dhe bëja sikur flija.

Një vit më vonë, vajzat e moshës sime nisën të lyenin sytë me rimel e buzët me shkëlqyes. Ato shkonin në koncertet e "*Boyz II Men*", në mbrëmjet e vallëzimit, në parkun "*Great America*", ku këlthisnin lirisht nëpër të përpjetat e të tatëpjetat spirale të Demonit[1]. Nxënëset e klasës sime u regjistruan në ekipet e basketbollit dhe si tifoznxitëse. Vajza që ulej pas meje në lëndën e spanjishtes, me lëkurë të zbehtë e fytyrën me quka, u regjistrua në një ekip noti dhe një ditë më sugjeroi, ndërsa po futnim gjërat tona në çantë pasi kishte rënë zilja, që ta provoja edhe unë. Ajo nuk mund ta kuptonte: Prindërit e mi do të tmerroheshin për vdekje, po qe se unë do të guxoja të dilja me rroba banje në vende publike. Jo se unë vetë e doja një gjë të tillë. Mua më vinte tmerrësisht turp nga trupi im: isha e dobët mbi bel dhe shpërpjesëtimisht e trashë nën të, a thua se forca e rëndesës e kishte tërhequr tërë peshën e trupit tim në gjysmën e tij të poshtme. Unë dukesha si ato figurat që formojnë fëmijët, kur përziejnë dhe ribashkojnë pjesët e trupit të njeriut, ose, më saktë akoma, si ato figurat me pjesë të keqvendosura enkas, për t'i bërë të tjerët që të qeshin. Mamaja më thoshte se unë kisha "kocka të forta". Ajo thoshte se i ngjaja mamasë së saj, se edhe ajo kishte pasur të njëjtën strukturë trupore si e imja. Më në fund reshti, mbase ngaqë e kuptoi se nuk ishte "kockëfortë" fjala që një vajzë do të donte të dëgjonte.

Unë u mundova ta bindja tim atë që të më linte të regjistrohesha në ekipin e volejbollit, por ai më mori në krahë dhe m'i vuri duart butësisht pas kokës. Kush do të më çonte në stërvitje? - nisi të arsyetonte ai. Kush do të më shoqëronte gjatë ndeshjes? "Oh, sa do të kisha dashur ta kishim atë luks, Pahri, si prindërit e shoqeve të tua, por neve na duhet të sigurojmë jetesën, mua dhe mamasë sate. Unë nuk mund të

---

1) Hekurudha me trenin e shpejtë (*shën. i përkth.*).

lejoj që ne të jetojmë me asistencë sociale. Ti më kupton, zemra ime. Unë e di që ti më kupton."

Por pavarësisht nga nevoja për të siguruar jetesën, im atë e gjente kohën për të më çuar me makinë në kursin e gjuhës farsi në *Campbell*. Çdo të martë pasdite, pasi mbaroja shkollën, unë ulesha në klasën e kursit dhe, njësoj si një peshk i detyruar të notojë kundër rrymës, edhe unë mundohesha ta lëvizja stilolapsin përkundër natyrës së vetë dorës sime, nga e djathta në të majtë. Iu luta babait që të mos më çonte më në kursin e gjuhës farsi, por ai kundërshtoi. Më tha se do ta vlerësoja më vonë dhuratën që po më bënte. Ai tha se, nëse kultura do të ishte shtëpi, gjuha do të ishte çelësi që do të hapte të gjitha dyert e saj. Pa të, thoshte ai, përfundon i humbur, pa një shtëpi të mirëfilltë ose një identitet të ligjshëm.

Dhe pastaj vinin të dielat, kur vija në kokë një shall të bardhë prej pambuku dhe ai më çonte në xhami në *Hayward* për mësimet e Kuranit. Dhoma ku mësonim ne, rreth një duzinë vajzash afgane, ishte e vogël, nuk kishte ajër të kondicionuar dhe mbante erë rrobash të palara. Dritaret ishin të ngushta e të hapura shumë lart, njësoj si ato dritaret e burgjeve që shohim gjithmonë nëpër filma. Gruaja që na bënte mësim, ishte e shoqja e një shitësi në Fremont. Mua më pëlqente më shumë kur ajo na tregonte historitë e jetës së profetit Muhamed, që më dukeshin interesante: se si e kishte kaluar ai fëmijërinë në shkretëtirë, se si i ishte shfaqur engjëlli Gabriel në shpellë dhe e kishte urdhëruar që të recitonte disa vargje, se si të gjithë ata që e takonin, magjepseshin nga fytyra e tij dashamirëse dhe rrezëllitëse. Por ajo e kalonte pjesën më të madhe të kohës duke na këshilluar e duke hartuar një listë të gjatë me gjërat e kulturës europiane që ne duhej t'i shmangnim me çdo kusht, për të qenë bija të devotshme myslimane: afërmendsh, para së gjithash e mbi të gjitha, djemtë, por edhe muzikën rrep, Madonën, "*Melrose Place*", fundet e shkurtra, kërcimin, notin në publik, të qenët vajzë tifoznxitëse, alkolin, proshutën, sallamin me mish derri, hamburgerat jo "hallall" dhe një sërë

gjërash të tjera. Unë qëndroja ulur në dysheme, duke djersitur nga vapa, me këmbët që më mpiheshin, me një nevojë urgjente për ta hequr atë shall nga koka, por, sigurisht, kjo ishte diçka që nuk mund ta bëje në xhami. Ngrija kokën e hidhja sytë drejt dritareve, por ato lejonin të shiheshin vetëm rripa të ngushtë qielli. Mezi e prisja çastin kur do të dilja nga xhamia, kur ajri i freskët do të më përplasej në fytyrë dhe unë do të ndieja një lloj lehtësimi përbrenda kraharorit, sikur nyja e pakëndshme që ishte formuar aty, po zgjidhej më në fund.

Por, derisa vinte ai çast, e vetmja mënyrë për t'u arratisur prej aty ishin mendimet e mia. Herë pas here e gjeja veten duke menduar për Xheremi Varvikun e orës së matematikës. Xheremia ishte një djalë i bardhë me sy blu dhe me flokët kaçurrela si të zezakëve. Ishte një djalë i heshtur dhe i zymtë. Ai i binte kitarës në një grup muzikor: në shfaqjen e përvitshme të talenteve të shkollës, ata luajtën një version të shkalluar të "*House of the Rising Sun*" ["*Shtëpia e diellit që ngrihet lart*"]. Në klasë, unë ulesha katër tryeza pas tij, në anën e majtë. Ndonjëherë e përfytyroja veten duke e puthur: duart e tij në zverkun tim, fytyra e tij kaq pranë simes, sa e gjithë bota eklipsohej. Në të gjithë trupin më përhapej një ndjesi, sikur një pendë e ngrohtë po lëvizte butësisht mbi barkun tim, mbi këmbët e mia. Afërmendsh që kjo s'do të mund të ndodhte kurrë. Ne nuk mund të ishim kurrë çift, Xheremia dhe unë. Edhe nëse ai kishte një ide sado të vogël për ekzistencën time, ai kurrë nuk e kishte lënë të kuptohej, çka nuk e kisha problem, gjithsesi. Sepse kështu mund të pretendoja që e vetmja arsye pse ne të dy nuk mund të ishim bashkë, ishte fakti që atij nuk i pëlqeja.

Gjatë verës punoja në restorantin e prindërve. Kur isha më e vogël, e kisha për kënaqësi të madhe të pastroja tryezat, të vendosja pjatat dhe enët prej argjendi, të palosja kartëpecetat, të vendosja një lule të kuqe në vazon e vogël të rrumbullakët në qendër të tryezës. Mua më dukej se isha e domosdoshme në biznesin e familjes, sikur restoranti do të dështonte, po qe

se nuk do të isha unë aty, për të mbushur plot shishkat e kripës e të piperit.

Kur hyra në gjimnaz, ditët në "Qebaptoren e Abit" u bënë të gjata e të nxehta. Gjërat aty nuk e kishin më atë shkëlqimin e tyre të dikurshëm. Frigoriferi i vjetër i pijeve me gaz në një qoshe tani bënte zhurmë, mbulesat e kadifenjta të tryezave ishin zbërdhulur, kupat plastike ishin gjithë njolla, emrat e gatimeve në menutë e laminuara ishin zbehur: "Qebap *Caravan*", "Pilaf *Khyber Pass*", "Pulë *Silk Route*". Po ashtu edhe fotografia me kornizë të shtrembër e vajzës afgane të nxjerrë nga "*National Geographic*", ajo vajza me sy jeshilë si deti: a thua se ishte bërë rregull që të gjitha restorantet afgane duhej të kishin sytë e saj, që të shikonin ngultazi që nga muri. Pranë saj, babai kishte vendosur një pikturë në vaj të minareve të mëdha në Herat, që unë e kisha bërë kur kisha qenë në klasë të shtatë. Më kujtohet se sa krenare isha ndier atëherë, kur ai e vendosi atë aty dhe unë shihja klientët që hanin qebapin e qengjit nën kryeveprën time.

Në orën e drekës, ndërsa unë me mamanë bënim ecejake që nga avujt aromatikë të kuzhinës tek tryezat ku u shërbenim drekën punonjësve të zyrave, punëtorëve dhe policëve, babai merrej me regjistrin. Ai, me përparësen e vetë të bardhë gjithë njolla vaji, me atë gëmushë qimesh gri në kraharor, që i dilte mbi kopsën e sipërme, me parakrahët e trashë e gjithë lesh, i buzëqeshte e përshëndeste me dashamirësi çdo klient që hynte në restorant: "Përshëndetje, zotëri! Përshëndetje, zonjë! Mirë se erdhët në "Qebaptoren e Abit". Unë jam Abi. Çfarë dëshironi të porositni?". Mua më ngjethej mishi, ngaqë ai nuk e kuptonte që tingëllonte si një guak nga Lindja e Mesme në një serial televiziv komik të dobët. Dhe pastaj, pas çdo gatimi që shërbeja, dëgjoja babanë që i binte këmborës së vjetër prej bakri. Kishte nisur si lojë, besoj, kjo puna e këmborës, të cilën ai e kishte varur në mur prapa banakut. Tani çdo tryezë ku shërbehej porosia, përshëndetej nga kumbimi i përzemërt

i këmborës prej bakri. Klientët e rregullt ishin mësuar me të, atyre pothuajse nuk u bënte më fare përshtypje, kurse klientët e rinj e konsideronin më së shumti si pjesë të sharmit ekscentrik të vendit, edhe pse herë pas here kishte nga ata që ankoheshin.

- Ti nuk do që t'i biesh më këmborës, - tha babai një natë. Ishte pranverë dhe unë isha në vitin e katërt të shkollës së mesme. Ne ishim në makinë jashtë restorantit, pasi e kishim mbyllur, duke pritur mamanë, që kishte harruar pilulat antiacide dhe ishte kthyer brenda për t'i marrë. Babai kishte një shprehje të lodhur në fytyrë. Kishte qenë me humor të keq gjatë gjithë ditës. Një shi i imët po binte atë natë. Ishte vonë dhe vendet e parkimit ishin zbrazur, me përjashtim të disa makinave e të një furgoni të parkuar përpara një dyqani pastrimi kimik: brenda furgonit dukeshin dy djem, ndërsa tymi i duhanit dilte në formë spiraleje nga dritaret e tij.

- Ishte më argëtuese kur nuk pritej që t'i bija, - i thashë.

- Çdo gjë është e tillë, besoj, - lëshoi ai një psherëtimë të thellë.

Më kujtohet se si lumturohesha, kur isha e vogël, kur babai më ngrinte lart duke më mbajtur për sqetullash e më linte t'i bija këmborës. Kur më ulte sërish poshtë, fytyra më rrezëllinte nga krenaria e lumturia.

Babai ndezi radiatorin e makinës dhe kryqëzoi krahët.

- Rrugë e gjatë deri në Baltimorë.

Unë iu përgjigja gjithë ngazëllim:

- Mund të marrësh avionin e të vish të më takosh në çdo kohë.

- Të marr avionin në çdo kohë, - përsëriti ai me shpoti. - Unë e siguroj jetesën me qebap, Pahri.

- Atëherë do të vij unë të të takoj.

Babai ktheu kokën nga unë e më hodhi një vështrim të lodhur. Melankolia e tij ishte e ngjashme me errësirën përreth, që po dyndej drejt dritareve të makinës.

Çdo ditë për një muaj rresht unë kisha kontrolluar kutinë postare, ndërsa zemra më regëtinte nga një gufim shprese, sa

herë që makina e postës hynte në rrugicë. Futja zarfet brenda në shtëpi dhe mbyllja sytë e mendoja: "Kjo mund të jetë dita!" Pastaj i hapja sytë sërish e rrëmoja nëpër zarfet: fatura e kuponë lotarie. Dhe, më në fund, të martën e një jave më parë, hapa më në fund një zarf dhe gjeta fjalët që i kisha pritur aq gjatë gjithë padurim: "Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë..."

Kërceva përpjetë. Bërtita: një britmë e vërtetë fytgër-vishtëse që më bëri të më mbusheshin sytë me lot. Pothuajse brenda një sekonde në të gjithë trurin tim u përhap një imazh: një ekspozitë e hapur në një galeri, unë e veshur me një fustan të thjeshtë, të zi dhe elegant, e rrethuar nga kritikë mirëdashës e kritikë vetullngrysur, duke u buzëqeshur e duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre, ndërsa admiruesit e mbledhur grupe-grupe kundronin pikturat e mia në kanavacë dhe kamerierët me dorashka të bardha fluturonin nëpër sallë për të shërbyer verë, fileto të vogla salmoni në formë katrore me kopër ose shpatare spërënge të mbuluara me krem pane. Dhe po provoja një shpërthim të papritur euforie, nga ai lloji që të bën t'i përqafosh edhe të panjohurit e të vallëzosh me ta me hapa gjigantë.

- Jam i shqetësuar për mamanë tënde, - tha babai.

- Do t'ju marr në telefon përnatë, të premtoj. Ti e di që do ta bëj.

Babai pohoi me kokë. Gjethet e panjës pranë hyrjes së parkingut u shkundën nga një shkulm i papritur ere.

- A u mendove pak më gjatë, - tha ai, - për atë që diskutuam?

- E ke fjalën për kolegjin parauniversitar?

- Vetëm për një vit, ndoshta dy. Thjesht për t'i dhënë mamasë kohën e nevojshme që të ambientohet me idenë. Dhe pastaj mund të aplikosh përsëri.

Unë u drodha nga një shpërthim i papritur zemërimi.

- Baba, ata njerëz kontrolluan me imtësi pikët e mia të testit, si dhe notat e mia, dhe shqyrtuan edhe të ardhurat e mia, dhe m'i vlerësuan aq shumë pikturat, saqë jo vetëm më pranuan, por edhe më ofruan një bursë. Ky është një nga

institutet më të mira të artit në vend. Nuk është një shkollë që mund t'i thuash jo kollaj. Ky shans nuk vjen për herë të dytë.

- Kjo është e vërtetë, - tha ai, duke drejtuar trupin në ndenjëse. I afroi duart pranë gojës në formë kupe dhe i ngrohu me frymë. - Sigurisht që e kuptoj. Dhe sigurisht që jam i lumtur për ty. - Unë arrija t'ia lexoja përpëlitjen në fytyrë. Dhe frikën po ashtu. Jo thjesht frikë për atë që mund të më ndodhte mua tri milje larg shtëpisë. Por frikën nga unë, frikën se mos më humbiste mua. Frikën nga pushteti që do të fitoja unë, përmes mungesës sime, për ta dëshpëruar atë, për t'ia shqyer zemrën e lënduar e të prekshme, njësoj si një doberman që i sulet një koteleje.

Më shkoi përsëri mendja te motra e tij. Në atë kohë, lidhja ime me Pahrin, prania e së cilës kishte qenë dikur si një shungullimë thellë brenda meje, tani ishte shuar prej kohësh. Rrallë e sillja në mendje. Ndërsa vitet kishin shkuar, ajo kishte mbetur në vend, kurse unë isha rritur dhe e kisha lënë pas, ashtu siç kisha lënë pizhamet dhe kafshët e parapëlqyera prej pelushi. Por tani e solla sërish në mendje dhe kujtova fijet që na lidhnin të dyjave. Nëse ajo që i kishin bërë asaj, ishte si një dallgë që përplaset larg në breg, tani ishte po kjo dallgë që, e prapsuar, kishte rrethuar këmbët e mia e po tërhiqej prej tyre.

Babai pastroi fytin dhe hodhi vështrimin tej dritares, drejt qiellit të errët e reve që kishin mbuluar hënën, ndërsa sytë i ishin njomur nga emocionet.

- Çdo gjë do të më bëjë të të kujtoj ty.

Në atë mënyrë të butë e disi në panik me të cilën i tha ai këto fjalë, unë kuptova se im atë ishte një njeri i lënduar, se dashuria e tij për mua ishte e vërtetë, e gjerë dhe e përhershme si qielli, dhe se ajo gjithmonë do ta lëshonte peshën e vet mbi mua. Ishte nga ai lloj dashurie që, herët a vonë, të mbështet me shpatulla pas një qosheje muri dhe ti ose do të çash rrugën për të qenë e lirë, ose do t'i bësh rezistencë forcës së saj, që të bën të mpakesh çdo ditë në diçka më të vogël se vetja jote.

Unë zgjata dorën nga ndenjësja e pasme e kredhur në errësirë dhe i preka fytyrën. Ai e mbështeti faqen në pëllëmbën e dorës sime.

- Ç'po bën kjo që po vonohet kaq shumë?! - mërmëriti ai.

- Po mbyll dyert, - i thashë. Ndihesha e shteruar. Pashë mamanë që u ngut të hynte në makinë. Pikat e imëta të shiut ishin shndërruar tani në litarë të fuqishëm.

Një muaj më vonë, disa javë përpara se unë të nisesha për të parë kampusin e universitetit, mamaja shkoi te doktor Bashiri dhe i tha se pilulat antiacide që i kishte dhënë ai, nuk ia kishin lehtësuar dhembjen e stomakut. Ai e dërgoi të bënte një ekografi. Dhe ata gjetën një tumor me përmasat e një arre në vezoren e saj të majtë.

- Baba?

Ai është ulur në kolltukun e tij me shpinore të shtrirë dhe po qëndron si i ngrirë, me trupin të përkulur përpara. Ka veshur tutat dhe këmbët poshtë i ka mbuluar me një shall të leshtë me kuadrate. Ka veshur trikon me jakë V që i bleva një vit më parë, mbi një këmishë fanellate që e ka mbërthyer deri në fyt. Ai kështu ngul këmbë t'i veshë këmishët tani, me jakën të mbërthyer, çka e bën të duket njëherazi si çilimi dhe i brishtë, si një njeri që i është dorëzuar pleqërisë. Sot duket pak i ënjtur në fytyrë dhe ballin ia mbulojnë tufa flokësh të pakrehur. Po shikon "*Kush do të bëhet milioner?*" me një pamje të zymtë e të turbullt në fytyrë. Kur e thërras, sytë e tij vazhdojnë të qëndrojnë të ngulur mbi ekran, si të mos më ketë dëgjuar, mandej shkulen prej aty me një pamje të bezdisur. Në qepallën e poshtme të syrit të majtë i ka dalë një byc i vogël. Dhe ka nevojë të rruhet.

- Baba, a mund t'ia ul zërin televizorit për një sekondë?

- Po shoh, - thotë ai.

- E di. Por të ka ardhur një mysafire. - Unë i kisha folur një ditë më parë për ardhjen e Pahri Vahdatit dhe ia përsërita edhe një herë në mëngjes. Por nuk e pyes nëse i kujtohet apo jo. Kjo është një nga gjërat që e kam mësuar qysh në fillim, që të mos e vë përpara asnjë trysnie, sepse kjo e bën të ndihet në siklet dhe të marrë një qëndrim vetëmbrojtës e, madje, edhe e bën të dhunshëm ndonjëherë.

Unë marr pultin e vendosur në krahun e kolltukut dhe ia ul zërin televizorit, duke e përgatitur veten për stuhinë. Herën e parë që reagoi në këtë mënyrë, unë isha e bindur që ishte një skenë teatrore, një rol i luajtur mirë. Por, për lehtësimin tim, babai nuk bën asnjë kundërshtim tjetër përveç një psherëtime të gjatë nën hundë.

Unë bëj me shenjë drejt Pahrit, që po pret në korridor, në pragun e dhomës së ndenjjes. Me hapa të ngadaltë, ajo vjen drejt nesh dhe unë i afroj një karrige pranë kolltukut të babait. Trupi i saj është një përzierje ankthi e entuziazmi tani, unë arrij ta dalloj mjaft mirë. Ajo ulet buzë karriges, me trup të tendosur e të përkulur përpara, me fytyrë të zbehtë, gjunjët të bashkuar, duart të kapërthyera mbi njëra-tjetrën në prehër, me buzë të shtrënguara aq fort, sa i janë zbardhur krejt. Sytë i mban të ngulur mbi babanë, si të ketë vetëm pak minuta për të qëndruar me të dhe po mundohet ta regjistrojë përgjithmonë në kujtesë fytyrën e tij.

- Baba, kjo është shoqja për të cilën të kam folur.

Ai ia ngul sytë gruas me flokë gri përbri tij. Këto kohët e fundit ai i sheh njerëzit në një mënyrë që të ligështon krejt: edhe kur i sheh drejt e në sy, është e pamundur të thuash se çfarë po ndodh brenda tij. Ai të sheh me një vështrim të shpërqendruar, të kredhur diku në vetvete, si të ketë pasur ndër mend të shihte diçka tjetër, por sytë i kanë rënë rastësisht mbi ty.

Pahri pastron fytin. Dhe prapë zëri i dridhet ndërsa flet.

- Ç'kemi, Abdulla? Unë quhem Pahri. Është një mrekulli që po të takoj.

Ai pohon lehtë me kokë. Unë arrij ta dalloj se si përhapen pasiguria e pështjellimi në fytyrën e tij, si valë spazmash muskulore. Dhe e kalon vështrimin nga fytyra ime tek ajo e Pahrit. E hap gojën në një gjysmëbuzëqeshje, ashtu siç bën gjithmonë, kur mendon se po i punojnë ndonjë rreng.

- Se ç'ke një theks... - thotë më në fund.

- Ajo jeton në Francë, - i them unë. - Dhe, baba, duhet të flasësh anglisht. Ajo nuk e kupton gjuhën farsi.

Babai pohon me kokë.

- Domethënë ti jeton në Londër? - i thotë ai Pahrit.

- Baba!

- Çfarë ka? - Kthehet ai gjithë inat nga unë. Pastaj e kupton dhe qesh paksa me turp, përpara se të nisë të flasë anglisht.

- Jeton në Londër?

- Në fakt, në Paris, - thotë Pahri. - Jetoj në një apartament të vogël në Paris. - Ajo nuk i largon sytë prej tij.

- Gjithmonë e kam pasur ndër mend ta çoja gruan time në Paris. Sulltana, kështu quhej ajo, iu prehtë shpirti në paqe. Gjithmonë më thoshte: "Abdulla, mëço në Paris. Kur do të më çosh në Paris?"

Në të vërtetë, mamaja nuk i kishte qejf udhëtimet. Ajo nuk arrinte ta kuptonte pse duhej të hiqte dorë nga rehatia dhe familjariteti i shtëpisë së saj e t'i hynte angarisë së fluturimeve e ulje-ngritjeve të valixheve. Ajo nuk kishte ndonjë parapëlqim as për aventurat e gjellëtarisë: koncepti i saj për ushqimin ekzotik ishte "pula me lëng portokalli" e porositur në *fast food*-in kinez në *Taylor Street*. Është vërtet magjepsëse se si babai, ndonjëherë, e kujton atë me një saktësi të habitshme, ndërkohë që më të shumtën e herëve është tmerrësisht i pasaktë. Atij i kujtohet, për shembull, zakoni i saj për t'ua hedhur kripën ushqimeve me pëllëmbën e dorës, ose zakoni për t'i ndërprerë njerëzit gjatë bisedës në telefon, ndërkohë që ballë për ballë nuk e bënte kurrë. Unë kam përshtypjen se imazhi i mamasë tek ai po venitet, fytyra e saj po shndërrohet në hije, kujtimi i saj po mpaket çdo ditë që kalon, si rëra që rrjedh nga

një grusht i mbyllur. Ajo po shndërrohet në një siluetë fantazmë, në një guaskë të zgavërt, të cilën ai ndihet i detyruar ta mbushë me hollësi imagjinare e veçori të sajuara karakteri, a thua se, të kesh kujtime të rreme, është më mirë se të mos kesh kujtime fare.

- Në fakt, është një qytet i këndshëm, - thotë Pahri.

- Mbase e çoj ndonjë ditë. Por tani ajo ka kancer. Ka atë sëmundjen e femrave ... - si e quajnë? - atë...

- Kancer i vezoreve, - i them unë.

Pahri pohon me kokë, ndërsa vështrimi i zhvendoset tani nga babai tek unë dhe përsëri tek ai.

- Gjëja që ajo do të donte më shumë është që të ngjitej në kullën Eifel. E ke parë ti? - e pyet babai.

- Kullën Eifel? - Pahri Vahdati qesh. - Oh, po. Përditë. Në fakt, është e pamundur të mos e shoh.

- A je ngjitur aty? Deri në majë?

- Jam ngjitur, po. Është shumë bukur atje lart. Por unë kam frikë nga vendet e larta, kështu që nuk ndihem gjithmonë rehat. Në majë fare, në një ditë të bukur me diell, mund të shohësh mbi gjashtëdhjetë kilometra larg. Por pjesa më e madhe e ditëve në Paris nuk janë edhe aq të mira dhe me aq shumë diell.

Babai hungërin. Pahri, që ka marrë zemër, vazhdon të flasë për kullën, se sa vjet u deshën që të ndërtohej, se si nuk ishte parashikuar që të qëndronte aty edhe pas Panarit të Artit Botëror të vitit 1889, por ajo nuk mund t'i lexojë sytë e babait, ashtu siç mundem unë. Shprehja e tyre është shuar. Ajo nuk e kupton që ai e ka humbur, që mendimet e tij kanë ndryshuar drejtim, si gjethet që i merr era. Pahri i afrohet më pranë.

- A e dije, Abdulla, - thotë ajo - që atyre u duhet ta lyejnë kullën një herë në shtatë vjet?

- Si the se quheshe? - pyet babai.

- Pahri.

- Ky është emri i vajzës sime.

- Po, e di.

- Ju keni të njëjtin emër, - thotë babai. - Ju të dyja keni të njëjtin emër. Pra, ja tek e ke. - Ai kollitet dhe nis të kruajë një të çarë të vogël mbi krahun e kolltukut prej lëkure.

- Abdulla, a mund të të bëj një pyetje?

Babai mbledh supet.

Pahri sheh nga unë si të jetë duke më kërkuar leje. Unë i bëj shenjë me kokë se mund të vazhdojë. Ajo përkulet përpara mbi karrige.

- Si e zgjodhe emrin e vajzës sate?

Babai i hedh sytë drejt dritares, ndërsa me thonj vazhdon ende të kruajë pikën mbi krahun e kolltukut.

- A të kujtohet, Abdulla? Pse pikërisht këtë emër? - Ai mohon me kokë. Dorën grusht e afron te trikoja dhe e mbështet në grykë. Buzët i lëvizin fare lehtë, ndërsa nis të mërmëritë nën hundë, një mërmërimë ritmike kjo që ai e bën gjithmonë, kur nis ta brejë ankthi ose kur nuk e gjen dot përgjigjen e diçkaje, kur zbrazëtia e pushton dhe ai përpëlitet mes një brufullime mendimesh pa lidhje, duke pritur gjithë dëshpërim që mjegulla të shpërhapet. - Abdulla? Çfarë është ajo? - thotë Pahri.

- Asgjë, - mërmërin ai.

- Jo, ajo këngë që po këndon, çfarë është ajo?

Ai kthen kokën nga unë, me një pamje të dëshpëruar. Ai nuk e di.

- Është një ninullë, - them unë. - A të kujtohet, baba? E ke mësuar kur ke qenë fëmijë. Më ke thënë që ta ka mësuar mamaja jote.

- Po.

- A mund të ma këndosh? - i thotë Pahri me shumë ngut, ndërsa zëri i meket. - Të lutem, Abdulla, a mund ta këndosh?

Ai ul kokën dhe e tund ngadalë në shenjë mohimi.

- Vazhdo, baba, - i them unë me zë të butë. Dhe e mbështet dorën mbi supin e tij kockë e lëkurë. - Nuk ka problem.

Gjithë ngurrim, me një zë të lartë që i dridhet dhe pa i ngritur sytë lart, babai këndon disa herë të njëjtin dyvargësh.

*Unë gjeta një zanë të vogël e të trishtuar,*
*Nën hijen e një peme letre.*

- Ai thoshte se kishte edhe dy vargje të tjera, - i them Pahrit, - por që ai nuk i mbante mend.

Pahri Vahdati lëshon befas një të qeshur që tingëllon si një e qarë e thellë, grykore, dhe mbulon gojën me dorë.

- Ah, *mon Dieu*![1] - pëshpërit ajo. Heq dorën nga goja dhe në gjuhën farsi këndon:

*Unë njoh një zanë të vogël e të trishtuar,*
*që era e natës e mori me vete.*

Balli i babait ngryset krejt. Për një çast kalimtar, mua më duket se dalloj një vezullim të lehtë drite në sytë e tij. Por mandej ai shuhet sërish dhe fytyra e tij merr përsëri atë pamjen pa shprehje. Ai mohon me kokë.

- Jo. Jo, unë them që nuk vazhdon ashtu, aspak.

- Oh, Abdulla...! - thotë Pahri.

Duke buzëqeshur, me sytë të veshur nga lotët, Pahri zgjat duart drejt atyre të babait dhe i merr në të vetat. Ajo puth trinën e secilës prej tyre dhe i mbështet pëllëmbët në faqet e veta. Babai buzëqesh dhe edhe sytë e tij njomen nga një vel lotësh. Pahri sheh nga unë, duke larguar me përplasje qepallash lotët e lumturisë, dhe unë e kuptoj se ajo beson që ka depërtuar tek ai. Që me këtë këngë magjike e ka thirrur të shfaqet vëllanë e humbur, ashtu siç shfaqet xhindi në përralla. Ajo beson se ai e ka njohur tani. Por ajo do ta kuptojë shumë shpejt se ky është një reagim instinktiv i tij, një përgjigje ndaj prekjes së saj të ngrohtë e ndjenjave që po shpalos ajo. Është thjesht një instinkt kafshëror, asgjë më shumë. Këtë unë e di me një siguri të dhembshme.

---

1) O Zot! (frëngjisht) (*shën. i përkth.*).

Pak muaj përpara se doktor Bashiri të më jepte numrin e një spitali, unë dhe im më shkuam bashkë në malet *Santa Cruz* dhe e kaluam fundjavën në një hotel. Mamasë nuk i pëlqenin udhëtimet e gjata, por shpesh ne bënim udhëtime të shkurtra, unë dhe ajo, përpara se sëmundja ta vinte vërtet përfund. Babai rrinte në shtëpi dhe merrej me restorantin, ndërsa unë e çoja mamanë me makinë në *Bodega Bay*, në Sausalito ose në San Francisko, ku qëndronim gjithmonë në një hotel pranë *Union Square*-it. Ne rehatoheshim në hotel, kërkonim shërbim në dhomë dhe hanim duke parë filma të zgjedhur në televizor. Më vonë, zbrisnim te Moli - mamaja ngecte tek të gjitha dyqanet që i rripnin turistët - blinim akullore dhe kundronim fokat që kërcenin mbi ujë atje tej, te skela. Ne hidhnim monedha në kutitë e hapura përdhe të kitaristëve të rrugës dhe në çantat e pantomimistëve: burra me trupin të lyer si robot. Gjithmonë shkonim në Muzeun e Artit Modern dhe, me krahun shkuar rreth krahut të saj, unë i tregoja veprat e Riverës, Kalos, Matisit, Polokut. Përndryshe shkonim në ndonjë kinema, çka im më e kishte për kënaqësi të madhe, dhe shihnim dy a tre filma njërin pas tjetrit e dilnim prej aty, pasi errej, me sytë që na bënin xixa, veshët që na kumbonin ende, dhe gishtat që mbanin erë kokoshka.

Me mamanë ishte më e lehtë, gjithmonë kishte qenë kështu: më pak e ndërlikuar, më pak e rrezikshme. Me të nuk ishte nevoja ta përmbaja veten kaq shumë. Nuk kisha pse të tregoja kujdes gjatë gjithë kohës për ato që mund të thosha, nga frika se mos i lëndoja ndonjë plagë. Të qenët vetëm me të në ato fundjava jashtë qytetit ishte njësoj si të gjendeshe e mbështjellë, për disa ditë, nga një re e butë, dhe gjithçka që më kishte shqetësuar deri në ato çaste, tani dukej mijëra milje larg.

Ne po festonim përfundimin e një tjetër cikli kimioterapie, që ishte gjithashtu edhe i fundit. Hoteli ishte një vend i bukur, i veçuar. Aty kishte një banjë termale, qendër fitnesi, dhomë

lojërash me një ekran të madh televizori e një tryezë bilardoje. Dhoma jonë ishte një kabinë me një verandë prej druri, prej nga shihnim pishinën, restorantin dhe pyjet e bredhave, kryet e të cilëve arrinin deri te retë. Disa prej pemëve ishin kaq pranë, sa mund të dalloje edhe nuancat më të imëta të ngjyrës së një ketri që i ngjitej trungut me vrik. Mëngjesin tonë të parë atje, mamaja më zgjoi e më tha:

- Shpejt, Pahri, duhet ta shohësh këtë.

Jashtë dritares, një dre po qëmtonte gjethet e shkurreve.

Unë e shtyja karrocën e saj nëpër kopsht.

- Unë jam vërtet spektakël, - thoshte mamaja. E ndalja pranë shatërvanit dhe ulesha në stol pranë saj, ndërsa dielli na ngrohte fytyrat dhe ne kundronim kolibrat që suleshin si shigjetë drejt luleve, derisa mamanë e zinte gjumi dhe unë e ktheja përsëri në kabinë.

Një të diel pasdite, pimë çaj dhe hëngrëm kruasantë në ballkonin jashtë restorantit, që ishte një sallë e madhe me një kupolë si të katedraleve, me rafte librash, një ëndërrkapës[1] të varur në mur dhe një vatër zjarri prej guri. Në një tryezë të ulët, një burrë me fytyrën si dervish dhe një vajzë me flokë të hollë biondë po luanin një lojë letargjike pingpongu.

- Duhet të bëjmë diçka me këto vetulla, - tha mamaja. Ajo kishte veshur një pallto dimri mbi pulovër dhe një beretë të kuqërremtë prej leshi, që e kishte punuar vetë me shtiza një vit e gjysmë më parë, kur, siç thoshte edhe vetë, kishte filluar "festa".

- Do të t'i vizatoj unë, - i thashë.

- Atëherë m'i bëj dramatike.

- Si të Elizabeta Tejlorit në rolin e Kleopatrës?

Ajo buzëqeshi lehtë.

- E pse jo?

---

1) Një zbukurim si rrjetë merimange, tradicional për disa nga kulturat amerikane autoktone, që shërben për të kapur ëndrrat e këqija e për të lejuar vetëm të mirat (*shën. i përkth.*).

Ajo rrufiti një gllënjkë të vogël çaji. Buzëqeshja ia nxirrte edhe më në pah të gjitha rrudhat e fytyrës.

- Abdullanë e njoha në kohën kur shisja plaçka në një qoshe rruge në Peshavar. Më tha se kisha vetulla shumë të bukura.

Çifti që po luante pingpong, i la pallaskat. Ata u mbështetën tani pas një parmaku prej druri dhe zunë të pinin me radhë një cigare, duke vështruar qiellin, që ishte i pastër e i ndritshëm, me përjashtim të pak reve puplore. Vajza kishte krahë të gjatë e shumë të dobët.

- Lexova në gazetë se sot do të hapet një panair punimesh artizanale në *Capitola*, - thashë unë. - Po qe se ke dëshirë, shkojmë me makinë dhe e shohim. Mund edhe ta hamë darkën atje, nëse të pëlqen.

- Pahri!

- Po?

- Dua të të them diçka.

- Mirë.

- Abdullai ka një vëlla në Pakistan, - tha mamaja. - Një vëlla nga babai. - Unë ktheva kokën me rrëmbim nga ajo. - Ai quhet Ikbal. Ka djem. Jeton në një kamp refugjatësh pranë Peshavarit. - Unë e ula filxhanin e çajit, bëra të thosha diçka, por ajo ma preu fjalën në buzë. - Ja, po ta them tani. Dhe kjo është e vetmja gjë që ka rëndësi, apo jo? Yt atë ka pasur arsyet e veta. Jam e sigurt që do t'i kuptosh me kalimin e kohës. Gjëja më e rëndësishme tani është që ai ka pasur një vëlla nga babai dhe që i ka dërguar pará për ta ndihmuar ekonomikisht.

Ajo më tregoi se si babai, për vite me radhë, i kishte dërguar këtij Ikbalit - që ishte xhaxhai im, mendova unë me një marramendje të brendshme - një mijë dollarë çdo tre muaj, me anë të *Western Union*-it, që i derdhte në një bankë në Peshavar.

- Pse po ma thua tani? - e pyeta.

- Sepse mendoj se duhet ta dish, edhe pse ai nuk e mendon

kështu. Dhe shumë shpejt do të jesh ti ajo që do të merret me financat, kështu që do ta kishe zbuluar vetë, gjithsesi.

Unë ktheva kokën nga ana tjetër dhe pashë një mace, me bishtin të ngritur përpjetë, që po qëndronte pranë çiftit të pingpongut. Vajza zgjati dorën që ta përkëdhelte, dhe macja në fillim u kreshpërua. Por pastaj u mblodh kutullaç mbi parmak dhe e la vajzën t'i përkëdhelte veshët e mandej shpinën. Mendja po më shpërthente. Unë kisha të afërm jashtë Shteteve të Bashkuara.

- Do të merresh ti me llogaritë edhe për një kohë të gjatë, mama, - thashë unë. Dhe bëra përpjekjet maksimale që ta fshihja dridhjen e zërit.

Pasoi një heshtje e rëndë. Dhe, kur ajo nisi të fliste sërish, tonin e zërit e kishte më të ulët, më të ngadaltë, ashtu siç më fliste kur isha e vogël, kur shkonim në xhami për të marrë pjesë në ndonjë funeral dhe ajo përkulej mbi mua e më shpjegonte me durim se si duhej t'i hiqja këpucët te dera, se si duhej të mos bëja zë gjatë lutjeve, të mos lëvizja e të mos ankohesha, dhe se bëja mirë të shkoja atë çast në banjë, që të mos kisha nevojë për të shkuar më vonë.

- Jo, - tha ajo. - Dhe mos mendo se do ta bëj. Koha ime ka ardhur. Duhet të përgatitesh për këtë.

Unë nxora nga goja një brufullimë ajri; diçka e fortë më ngeci në fyt. Diku më tej u dëgjua zhurma e një sharre elektrike, vajtimi në kreshendo i së cilës nuk përkonte aspak me heshtjen e drurëve.

- Yt atë është si fëmijë. Tmerrohet nga ideja se mund të mbetet vetëm. Ai pa ty do ta humbiste rrugën, Pahri, dhe nuk do ta gjente dot më... kurrë.

Unë e detyrova veten që të shihte pemët, ndërsa drita e diellit binte mbi gjethet e tyre halore e mbi lëvoret e ashpra të trungjeve. E kafshova fort majën e gjuhës me dhëmbët prerës. Sytë m'u mbushën me lot dhe shija e bakërt e gjakut më mbushi gojën.

- Një vëlla! - thashë unë.

- Po.

- Kam shumë pyetje.

- M'i bëj sonte. Po të mos ndihem e lodhur, do të të tregoj gjithçka që di.

Unë pohova me kokë. Dhe e ktheva me një gllënjkë çajin e mbetur në filxhan, që ishte ftohur tashmë.

Në një tryezë aty pranë, një çift me moshë të mesme po shfletonin faqet e gazetës. Gruaja, me flokë të kuq e fytyrë që rrezatonte ndershmëri e sinqeritet, po na shihte qetësisht që përmbi faqen e gazetës, duke i kaluar sytë sa nga unë te mamaja, te bereta e saj, te duart e saj gjithë njolla mavi, sytë e futur thellë në gropat e tyre dhe trupi i dobët. Kur sytë e mi u ndeshën me të sajtë, ajo buzëqeshi lehtë, si të ishim duke ndarë bashkë një sekret, dhe unë e kuptova se edhe ajo kishte kaluar nëpër të njëjtën rrugë.

- Pra, si thua, mama? Për panairin, ke dëshirë të shkojmë?

Sytë e saj u ndalën mbi mua. Ata dukeshin shumë të mëdhenj për kokën e saj, kurse koka shumë e madhe për supet.

- Mund të gjej ndonjë kapelë të re, - tha ajo.

E lashë pecetën mbi tryezë, shtyva karrigen prapa dhe dola në anën tjetër. Lirova frenat e karriges me rrota dhe e largova nga tryeza.

- Pahri! - tha mamaja.

- Po?

Ajo ktheu kokën pas dhe e ngriti që të më shihte. Drita e diellit gjeti rrugë midis gjetheve të një peme dhe e mbuloi me quka të ndritshme fytyrën e saj.

- A e kupton se sa të fortë të ka bërë Zoti? - tha ajo. - Sa të fortë e të mirë të ka bërë Ai?

Nuk është e mundur të shpjegosh se si funksionon mendja e njeriut. Në këtë çast, për shembull. Nga mijëra e mijëra çaste që unë me tim më kemi ndarë bashkë përgjatë viteve, ky është ai që ndriçon më shumë nga të gjithë, ai që vibron me zukamën më të zëshme në kokën time: mamaja që ngre kokën pas për të më parë mua, me fytyrën lart, gjithë ato pika marra-

mendëse drite që xixëllojnë në fytyrën e saj, dhe ajo që më pyet nëse e di unë se sa të fortë e të mirë më ka bërë Zoti.

Pasi babanë e zë gjumi në kolltukun e tij, Pahri ia mbërthen me kujdes zinxhirin e trikos dhe ia ngre shallin, që t'ia mbulojë kraharorin. Ajo ia kalon një tufë flokësh pas veshit dhe qëndron në këmbë përpara tij, duke e kundruar për disa çaste, teksa ai fle. Edhe mua më pëlqen ta shoh babanë, ndërsa fle, sepse atëherë nuk të duket se ka diçka që s'shkon. Kur ai mbyll sytë, vagëllimi i tyre humbet, vështrimi i përhumbur po ashtu, dhe ai duket po ai njeriu që ka qenë gjithmonë. Në gjumë, ai duket më i pranishëm, sikur diçka nga vetja e tij e dikurshme është kthyer përsëri tek ai. Dhe unë pyes me vete nëse arrin ta përfytyrojë Pahri tani, teksa sheh fytyrën e tij të mbështetur në jastëk, se si ka qenë ai dikur, se si qeshte ai dikur.

Ne kalojmë nga dhoma e ndenjjes në kuzhinë. Unë marr një tenxhere në bufe dhe e mbush me ujë te sqolli.

- Dua të të tregoj disa prej këtyre, - thotë Pahri, me një zë disi entuziast. Ajo është ulur në tryezë dhe po shfleton me të shpejtë një album me fotografi, që e kishte nxjerrë më parë nga valixhja.

- Kam frikë se kafja nuk do të jetë e standardit parisian, - i them duke kthyer kokën nga ajo, ndërsa hedh ujin në ekspresin e kafes.

- Ja ku po ta them se nuk jam ndonjë snobiste kafeje. - Ajo e ka hequr shallin e verdhë dhe ka vënë syzet për afër, përmes të cilave po sheh fotografitë.

Kur ekspresi nis të gurgullojë, unë ulem në tryezën e kafes pranë Pahrit.

- *Ah oui. Voila*[1]! Ja ku është, - thotë ajo. E kthen albumin dhe e shtyn drejt meje.

---

1) Ah, po. Ja! (*shën. i përkth.*).

Gishtat e saj trokasin mbi fotografinë.

- Ky është vendi. Këtu kam lindur unë... dhe babai yt. Edhe vëllai ynë Ikbal po ashtu. Në Shatbag.

Kur më mori për herë të parë në telefon nga Parisi, ajo përmendi emrin e Ikbalit, ndoshta si provë për të më bindur që nuk po gënjente për identitetin e saj. Por unë e dija që ajo po thoshte të vërtetën. Unë e ndieva qysh në çastin kur ngrita receptorin dhe ajo shqiptoi emrin e tim eti në veshin tim e më pyeti a ishte ky numri i tij i telefonit. Dhe unë i thashë: "Po, kush jeni ju?" - e ajo m'u përgjigj: "Unë jam e motra". Zemra më rrahu me tërbim në kraharor. Kërkova në çast një karrige ku të ulesha, ndërsa gjithçka përreth meje befas u krodh në një qetësi aq të plotë, sa mund të dëgjoje edhe pikën e ujit, kur binte. Ishte tronditëse, po, kjo lloj skene tipike për aktet e treta të dramave, por që rrallë u ndodh njerëzve në jetën e vërtetë. Por, në një tjetër plan, në një plan më të brishtë, qendra e të cilit do të ishte thyer e do të ishte ndarë copash, po qe se unë do të arrija ta formuloja me zë, telefonata e saj nuk ishte tamam surprizë. Përkundrazi, ishte si ta kisha pritur, madje gjatë gjithë jetës sime, që në një formë marramendëse, në një rrethanë ose në një rast, ose në një çast fatlum, ose çfarëdolloj emri t'i vëmë çastit, unë dhe ajo, ne të dyja, do ta gjenim njëra-tjetrën një ditë.

Unë e mora në dorë receptorin lëvizës të telefonit dhe dola në kopshtin e pasmë e u ula në një karrige pranë parcelës me perime, ku kisha vazhduar të kujdesesha për specat dhe kungujt gjigantë që kishte mbjellë mamaja. Dielli më ngrohte qafën, ndërsa ndeza një cigare me duart që më dridheshin.

- Unë e di cila je ti, - i thashë, - e kam ditur gjatë gjithë jetës sime.

Në anën tjetër të telit ra heshtja, por unë pata përshtypjen se ajo po qante pa zë dhe se e kishte larguar receptorin nga buzët, që unë të mos dëgjoja asgjë.

Ne folëm në telefon për gati një orë. Unë i thashë se e dija çfarë i kishte ndodhur, se si i kërkoja gjithmonë tim eti që

të ma rrëfente historinë e saj, kur më çonte për të fjetur. Pahri tha se ajo nuk e kishte ditur as vetë historinë e saj dhe mbase edhe do të kishte vdekur pa e marrë vesh kurrë, po të mos kishte qenë për dajën nga njerka, Nabin, që kishte lënë një letër për të, përpara se të vdiste në Kabul, ku, mes të tjerash, sqaronte në mënyrë të hollësishme ngjarjet që kishin rrethuar fëmijërinë e saj. Letra i ishte dhënë dikujt që quhej Marko Varvaris, një kirurg që punonte në Kabul, i cili e kishte kërkuar Pahrin në Francë. Gjatë verës, Pahri kishte shkuar me avion në Kabul, ishte takuar me Marko Varvarisin dhe ai e kishte ndihmuar që të shkonte të shihte Shadbagun.

Andej nga fundi i bisedës, unë e ndieva që ajo i mblodhi një herë të tëra forcat e mandej tha:

- E po, tani besoj se jam gati. A mund të flas me të tani?

Në atë çast u detyrova t'i tregoja gjithçka...

E afroj tani pranë vetes albumin dhe shqyrtoj fotografinë që po shenjon Pahri me gisht. Shoh një shtëpi të strukur prapa ca mureve të larta, të lyera me bojë të bardhë të ndritshme, mbi të cilat janë vendosur spirale telash me gjemba. Një shtëpi ose, më saktë, ideja tragjikisht e gabuar e një shtëpie, me tri kate, me bojëra rozë, jeshile, të verdhë e të bardhë, me parapete, kulla të ulëta, ullukë me majë, mozaikë dhe xham pasqyrues. Një ndërtesë pa shije, tmerrësisht larg idesë së shtëpisë.

- Oh, o Zot! - marr frymë thellë unë.

- *C'est affreux, non?*[1] - thotë Pahri. - Afganët i quajnë *Pallatet e Drogës*. Kjo këtu është e një krimineli lufte mjaft të njohur.

- Domethënë, kjo është gjithë ç'ka mbetur nga Shadbagu.

- Nga fshati i vjetër, po. Kjo dhe disa akra me drurë frutorë ... si e quani ju? ...*Des vergeres*.

- Pemishtë.

- Tamam, - ajo ledhaton me gishta fotografinë e shtëpisë.

---

1) Është e frikshme, apo jo? (*shën. i përkth.*).

- Do të doja ta dija se ku ka qenë shtëpia jonë me saktësi. Dua të them, në raport me këtë *Pallat Droge*. Do të kisha qenë e lumtur po ta dija vendin e saktë.

Ajo më tregon për Shadbagun e ri: një qytet i vërtetë, me shkolla, klinika, një lagje tregtare e, madje, edhe një hotel të vogël, që është ndërtuar rreth dy milje larg vendit ku gjendej fshati i vjetër. Në këtë qytet e kishin kërkuar ajo dhe përkthyesi i saj vëllanë e saj nga babai. Unë i mësova këto gjatë asaj bisede të parë, të gjatë, me Pahrin dhe mësova edhe që askush në qytet nuk dukej se e njihte Ikbalin, derisa ajo kishte ndeshur një burrë plak, një shok të tij fëmijërie, që ishte takuar me Ikbalin në kohën kur ai dhe familja e tij po qëndronin në fushën e zbrazët pranë mullirit të vjetër me erë. Ikbali i kishte treguar plakut se, gjatë kohës që jetonte në Pakistan, kishte marrë rregullisht pará nga vëllai i tij më i madh që jetonte në Kaliforninë Veriore. "Unë e pyeta, - tha Pahri në telefon, - unë e pyeta: "A ta tha Ikbali emrin e këtij vëllai?" Dhe burri plak m'u përgjigj "Po, Abdulla". Dhe atëherë, *alors*, pas kësaj, pjesa tjetër nuk qe e vështirë. Për të të gjetur ty dhe babanë tënd, e kam fjalën... Unë e pyeta shokun e Ikbalit se ku ndodhej Ikbali tani, - tha Pahri. - E pyeta se ç'ishte bërë me të, dhe plaku më tha se nuk e dinte. Por dukej shumë nervoz dhe nuk më pa në sy, kur m'i tha këto fjalë. Ndaj unë mendoj, Pahri, unë kam frikë se atij i ka ndodhur diçka e keqe."

Ajo shfleton tani faqet e albumit dhe më tregon fotografitë e fëmijëve të saj: Aleni, Izabela, Tierri, dhe fotografitë e nipërve e të mbesave, në festat e ditëlindjeve, pastaj të veshur me rroba banje buzë pishinës. Shtëpia e saj në Paris, muret me bojë blu pasteli dhe grilat e mbyllura mirë, raftet e librave. Zyra e saj e rrëmujshme në universitet, ku kishte dhënë matematikë përpara se artriti reumatoid ta detyronte të dilte në pension të parakohshëm.

Unë vazhdoj të shfletoj faqet e albumit, ndërsa ajo më tregon se kush është aty: shoqja e saj e vjetër, Koleta; burri i Izabelës, Alberti; burri i Pahrit, Eriku, që ka qenë dramaturg

dhe vdiq nga infarkti në vitin 1997. Ndalem te një foto e atyre të dyve, pabesueshmërisht të rinj, të ulur në krah të njëri-tjetrit mbi ca jastëkë ngjyrë portokalli në një restorant, ajo e veshur me bluzë të bardhë, ai me një bluzë pambuku, me flokë të gjatë e të kapur pas bishtkali.

- Kjo ka qenë nata kur u njohëm, - thotë Pahri. - Ishte e paramenduar.

- Ka fytyrë dashamirëse.

Pahri pohon me kokë.

- Po. Kur u martuam, mendova: "Oh, ne do të kalojmë shumë kohë bashkë. - Thashë me vete: - Më së paku tridhjetë vjet, mbase dyzet. Pesëdhjetë, po të jemi me fat. E pse jo?" - Ajo ia ngul sytë fotografisë, si e përhumbur për një çast, pastaj buzëqesh lehtë. - Por koha është si sharmi. Asnjëherë nuk ke aq sa beson. - E shtyn albumin dhe rrufit kafen. - Po ti? Nuk je martuar asnjëherë?

Unë mbledh supet dhe hap faqen tjetër.

- Një herë kam qenë në prag.

- Më fal, "në prag"?

- Dua të them që gati sa s'u martova. Por nuk arritëm kurrë në stadin e shkëmbimit të unazave.

Kjo nuk është e vërtetë. Ishte e dhembshme dhe e tmerrshme. Edhe tani, kujtimi i saj është si një dhembje e butë brenda kafazit të kraharorit tim.

Ajo ul kokën.

- Më fal! Jam shumë e keqe.

- Jo. S'ka problem. Ai gjeti dikë më të bukur e më pak... të ndërlikuar, besoj. Meqë ra fjala te bukuria, kush është kjo? - Dhe unë tregoj me gisht drejt një gruaje me një pamje vetëtitëse, me flokë të gjatë e sy të mëdhenj. Në këtë fotografi, ajo ka dalë me cigare në dorë, me pamje të mërzitur, me bërrylin mbështetur në ijë, kokën e ngritur lartë me shpërfillje, por vështrimin e ka depërtues, provokues.

- Kjo është mamaja. Mamaja ime, Nila Vahdati. Ose ajo që besoja unë se ishte nëna ime. Më kupton?

- Qenka llahtarisht e bukur! - them unë.

- Ishte. Vrau veten. Në vitin një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër.

- Më vjen keq.

- *Non, non.*[1] Nuk ka për se. - Ajo e fshin fotografinë me gishtin e madh. - Mamaja ishte elegante dhe e talentuar. Ajo lexonte libra dhe kishte opinione të forta që ua shprehte gjithmonë njerëzve. Por po ashtu ishte edhe thellësisht e dëshpëruar. Gjatë gjithë jetës sime, ajo më ka zgjatur një lopatë e më thoshte: "Mbushi këto vrima brenda meje, Pahri". - Unë pohoj me kokë. Më duket se e kuptoj një pjesë të kësaj. - Por unë nuk mundesha. Kurse, më vonë, nuk doja ta bëja. Bëra gjëra të pamenduara. Gjëra të këqija. - Ajo mbështetet në karrige, me supe të kërrusura, dhe i lëshon duart e holla e të bardha mbi prehër. Mendohet për një çast e mandej thotë: - *J'aurais dû être plus gentille.* Duhej të isha treguar më e dhembshur me të. Është diçka për të cilën njeriu s'do të pendohet kurrë. Nuk do t'i thuash kurrë vetes, kur të plakesh: "Ah, sa do të kisha dashur të mos isha treguar e mirë me atë njeri!" Këtë nuk do ta mendosh kurrë. - Për një çast fytyra e saj merr një pamje si të vrarë. Duket si një vajzë e vogël e dëshpëruar. - Nuk do të kishte qenë aq e vështirë, - thotë ajo me zë të lodhur. - Unë duhej të kisha qenë më e dashur. Duhej të kisha qenë më shumë si ti.

Ajo lëshon një psherëtimë të thellë dhe e mbyll albumin. Pas një çasti heshtjeje, thotë me zë të gëzuar:

- *Ah, bon.*[2] Tani dua të të pyes për diçka.

- Patjetër.

- A do të më tregosh ca nga pikturat e tua?

Ne i buzëqeshim njëra-tjetrës.

---

1) Jo, jo. (*shën. i përkth.*).

2) Ah, mirë (*shën. i përkth.*).

Pahri qëndron një muaj me babanë dhe me mua. Mëngjeseve, ne hamë bashkë në kuzhinë: kafe e zezë dhe toast për Pahrin, kos për mua dhe bukë me vezë të skuqura për babanë, diçka që atij ka nisur t'i shijojë këto vitet e fundit. Unë kisha frikë se gjithë ato vezë që hante, do t'ia rritnin nivelin e kolesterolit, dhe e pyeta doktor Bashirin gjatë njërës prej vizitave të babait. Doktor Bashiri më buzëqeshi me buzë të mbyllura e më tha: "Oh, nuk do të shqetësohesha për këtë". Dhe kjo më dha siguri aty për aty, deri pak çaste më vonë, kur po e ndihmoja tim atë në makinë që të lidhte rripin e sigurisë e më vetëtiu në mendje se doktor Bashiri në të vërtetë kishte nënkuptuar që: "E kemi kapërcyer atë stad tashmë".

Pasi mbarojmë mëngjesin, unë mbyllem në zyrën time, që në fakt është dhoma ime e gjumit, ndërsa Pahri i bën shoqëri babait gjatë kohës që unë punoj. Me kërkesën e saj, unë i kam shkruar një listë me oraret e emisioneve televizive që i pëlqejnë atij, kohën se kur duhet të marrë barnat e mëngjesit, çfarë gatimesh të thata i pëlqejnë dhe kur pritet që t'i kërkojë. Ishte ideja e saj që unë t'i shënoja të gjitha këto në letër.

- Mund të hysh sa herë të duash në dhomë e të më pyesësh, - i thashë unë.

- Nuk dua të të shqetësoj, - m'u përgjigj ajo. - Dua ta njoh. Unë dua ta njoh atë.

Unë nuk i them dot se ajo s'ka për ta njohur kurrë ashtu siç do të donte ta njihte. E prapë i tregoj disa truke se si t'ia dalë mbanë në situata të vështira. Për shembull, nëse babai fillon të nervozohet, unë zakonisht ia dal mbanë, edhe pse jo gjithmonë, që ta qetësoj, çka ende nuk e kuptoj se si, duke i zgjatur menjëherë një katalog mobiliesh ose një fletushkë reklame. Unë mbaj gjithmonë një stivë me të tilla gjëra.

- Po qe se do që ta zërë gjumi, çoje televizorin te kanali i motit ose te ndonjë lojë golfi. Por mos e lër kurrë të shohë emisione gatimi.

- Pse?

- Ato e acarojnë dhe unë nuk e kuptoj pse.

Pas drekës, dalim që të tre për një shëtitje. Të shkurtër fare, për shkak të atyre të dyve, sepse babai lodhet shpejt, kurse Pahri vuan nga artriti. Babai çapitet gjithë ankth midis meje e Pahrit, me sytë që vështrojnë gjithçka me dyshim, i veshur me trikon e vet të leshtë, me beretën në kokë dhe këpucët prej cohe me pellush nga brenda. Në lagjen tonë është një shkollë e mesme, me një fushë futbolli të pamirëmbajtur, dhe përbri saj një park lojërash, ku e çoj zakonisht babanë. Ne gjithmonë ndeshim aty një ose dy nëna të reja, me karrocat e foshnjave pranë tyre, ndonjë fëmijë që vjen vërdallë në këndin e lojërave, dhe herë pas here ndonjë çift adoleshentësh që i kanë bishtnuar shkollës e po lëkunden gjithë përtesë në shilarës duke pirë duhan. Ata rrallë i hedhin sytë drejt babait, por, edhe kur e bëjnë, me një shpërfillje të ftohtë e ndonjëherë edhe me njëfarë përbuzjeje të lehtë, a thua se im atë nuk duhej ta kishte lejuar veten që të plakej ose të sëmurej.

Një ditë, ndërsa bëj një pushim të shkurtër nga puna ime e hyj në kuzhinë për të mbushur filxhanin me kafe, i gjej që të dy duke parë një film. Babai në kolltukun e tij, me këpucët që i dalin nga shalli me të cilin ka mbuluar këmbët, me kokën të zgjatur përpara, me gojën paksa të hapur, me vetullat të bashkuara, ndoshta nga përqendrimi, ose, ndoshta, nga pështjellimi. Dhe Pahri e ulur pranë tij, me duart njërën mbi tjetrën në prehër e me këmbët të kryqëzuara te kyçet.

- Kush është kjo? - thotë babai.

- Kjo është Latika.

- Kush?

- Latika, vajza e vogël që jetonte në atë lagjen e varfër. Ajo që nuk arriti të kërcente mbi tren.

- Nuk duket si vajzë e vogël.

- Po, por kanë kaluar shumë vjet, - thotë Pahri. - Tani është rritur, ti e kupton.

Një ditë të javës së mëparshme, te parku i lojërave, ne ishim ulur në një stol, që të tre, dhe Pahri tha:

- Abdulla, a të kujtohet që, kur ke qenë i vogël, ke pasur një motër të vogël?

Ajo nuk arriti as të mbaronte fjalinë, kur babai ia plasi të qarit.

Pahri ia mbështeti kokën në gjoksin e vet e nisi të thoshte:

- Më fal, më fal! - vazhdimisht e vazhdimisht, gjithë panik, duke ia fshirë faqet me duart e veta, por babai vazhdonte të dridhej nga dënesat kaq fort, sa nisi të mbytej.

- Po këtë a e njeh, Abdulla? - thotë Pahri tani. - Babai hungërin. - Është Xhamali. Ai djali i lojës në televizor.

- Nuk është ai, - ia kthen babai me ton të ashpër.

- Nuk të duket si ai?

- Ai tani po shërben çaj!

- Po, por ajo ishte... si i thoni ju... ka ndodhur më parë. Ishte më parë. Ishte...

- "Kujtim", - mërmërit unë me buzët në filxhanin e kafes.

- Ai tani është në emisionin televiziv. Kurse, kur po shërbente çajin, ishte më përpara.

Babai pulit qepallat me një fytyrë pa shprehje. Në ekran, Xhamali dhe Salimi janë ulur buzë tarracës së një ndërtese të lartë dhe këmbët u varen poshtë.

Pahri e sheh sikur pret që, nga çasti në çast, diçka brenda tij të zgjohet.

- Dua të të bëj një pyetje, Abdulla, - thotë ajo. - Po qe se një ditë fiton një milion dollarë, çfarë do të bëje me to? - Babai ngërdheshet, e lëshon peshën e trupit në kolltuk dhe rehatohet në të. - Kurse unë e di se çfarë do të bëja, - thotë Pahri. - Babai e sheh me një vështrim pa shprehje. - Po qe se do të fitoja një milion dollarë, do të blija një shtëpi në këtë rrugë. Kështu që unë dhe ti do të ishim fqinjë dhe unë do të vija këtu përditë, që të shihnim televizor bashkë.

Babai buzëqesh.

Por vetëm pak çaste më vonë, kur jam kthyer në dhomën

time dhe kam vënë kufjet në vesh e kam nisur të shtyp përsëri në kompjuter, dëgjoj diçka që përplaset dhe babanë që po bërtet në gjuhën farsi. I heq kufjet nga veshët dhe sulem në kuzhinë, ku e gjej Pahrin të mbështetur pas murit, pranë furrës me mikrovalë, me duart të bashkuara në mënyrë mbrojtëse nën mjekër dhe babanë me sy të shqyer, që po e qëllon në sup me bastunin e tij. Copat e një gote të thyer vezullojnë pranë këmbëve të tyre.

- Nxire përjashta këtë! - bërtet im atë, sapo më sheh. - Dua që kjo grua të shporret nga shtëpia ime.

- Baba!

Pahri është zbehur në fytyrë. Nga sytë po i rrjedhin lot.

- Ule shkopin, baba, për atë Zot! Dhe mos bëj asnjë hap përpara. Do të çahesh te xhamat.

Unë ia heq shkopin nga dora me mundim, sepse ai më bën goxha rezistencë të mirë.

- Dua që kjo grua të ikë! Ajo është hajdute!

- Çfarë po thotë? - pyet Pahri me zë të përvajshëm.

- Ajo më vodhi barnat!

- Ato janë barnat e saj, baba, - i them unë, ia hedh njërën dorë në sup dhe e nxjerr nga kuzhina. I tërë trupi i dridhet. Ndërsa kalojmë pranë Pahrit, ai pothuajse i vërsulet përsëri dhe mua më duhet që ta mbaj fort.

- Mirë, mjaft me kaq, baba! Dhe ato janë barnat e saj, jo të tuat. Ajo i merr barnat për duart e veta. - Unë kap një katalog shitjesh në tryezën e kafes, ndërsa i afrohemi kolltukut të tij.

- Unë nuk i zë besë asaj gruaje, - thotë babai, duke u lëshuar rëndë në kolltuk. - Ti nuk e njeh. Por unë e njoh. Unë e njoh hajdutin, sapo ta shoh! - Ai dihat ndërsa ma rrëmben katalogun nga dora e nis t'i shfletojë faqet me nervozizëm. Pastaj e përplas në prehrin e vet e sheh nga unë, me vetullat të ngritura përpjetë: - Dhe ishte edhe një palo gënjeshtare. E di se çfarë më tha ajo grua mua? E di se çfarë më tha? Që është motra ime! Motra ime! Prit, prit kur ta dëgjojë këtë Sulltana.

- Në rregull, baba. Ne do t'ia themi mamasë të dy bashkë.

- Grua e çmendur!

- Ne do t'ia themi mamasë që të dy dhe pastaj që të tre do ta nxjerrim jashtë nga shtëpia atë grua. Tani, qetësohu, baba. Çdo gjë shkon më së miri. Ja.

Dhe unë e çoj televizorin te kanali i motit dhe ulem pranë tij, duke ia përkëdhelur supin, derisa dridhjet e trupit i reshtin dhe frymëmarrja i normalizohet. Nuk kalojnë as pesë minuta dhe e zë gjumi.

Në kuzhinë, Pahri është ulur në dysheme dhe është mbështetur pas sqollit. Duket e tronditur. Ajo po fshin sytë me një kartëpecetë.

- Më vjen shumë keq, - thotë ajo. - Nuk u tregova e kujdesshme.

- Nuk ka problem, - i them unë, duke marrë anash sqollit furçën dhe kacinë. Kapsula të vogla ngjyrë portokalli e rozë janë shpërndarë mbi linoleum midis copave të gotës së thyer. Unë i mbledh një nga një dhe pastaj mbledh copat e xhamit në kaci.

- *Je suis une imbécile*[1]. Por kisha kaq shumë dëshirë t'ia thosha. Mendoja se, mbase, po t'i them të vërtetën... nuk e di se ç'më shkrepi në kokë.

Unë i hedh copat e gotës së thyer në koshin e plehrave. Pastaj ulem galiç, hap jakën e bluzës së Pahrit dhe ia kontrolloj supin, ku babai po e qëllonte me bastun.

- Do të të mavijoset. Dhe këtë e them nga përvoja.

Pastaj ulem në dysheme pranë saj.

Ajo hap pëllëmbën e dorës dhe unë i jap kapsulat.

- A bëhet shpesh kështu?

- Ka ditët e veta agresive.

- Mbase duhet të kërkosh ndihmë profesionale, apo jo?

Unë psherëtij, duke pohuar me kokë. Kohët e fundit e kam menduar shpesh çastin e pashmangshëm kur do të zgjohem

---

1) Unë jam budallaqe (*shën. i përkth.*).

në një shtëpi bosh, kurse babai do jetë i mbledhur kruspull në një shtrat të huaj, me sytë të ngulur mbi një tabaka me mëngjesin, që po ia sjell në person i panjohur. Babai i zhytur në një kolltuk në një dhomë argëtimi, duke dremitur.

- E di, - i them, - por është ende shpejt. Dua të kujdesem vetë për të, për sa kohë të jetë e mundur.

Pahri buzëqesh dhe shfryn hundët.

- E kuptoj.

Nuk jam e sigurt se më kupton tamam. Unë nuk mund t'ia them arsyen tjetër. Atë arsye që as me vete nuk arrij ta pranoj dot. Të vërtetën se sa më frikëson liria, pavarësisht nga dëshira e përhershme për ta pasur. E frikësuar për çka mund të më ndodhë, se si do t'ia dal mbanë vetëm, kur babai të mos jetë më. Gjatë gjithë jetës sime, unë kam jetuar si një peshk në një akuarium prej xhami të mbrojtur e të sigurt, prapa një barriere po aq të papërshkueshme sa edhe të tejdukshme. Kam qenë e lirë ta kundroj botën vezulluese nga ana tjetër, ta përfytyroj veten time në të, po qe se më pëlqen. Por unë gjithmonë kam qenë e përmbajtur, e mbrojtur mirë nga kufijtë e fortë, të pathyeshëm të ekzistencës që ka ndërtuar im atë për mua, në fillim me ndërgjegje, kur isha e vogël, dhe pa dashje tani, tani që ai po shuhet ditë pas dite. Kam përshtypjen se unë jam mësuar me këtë xham dhe më tmerron ideja se, kur të thyhet ai, kur të mbetem vetëm, do ta gjej veten jashtë, në hapësirën e pamatë e të panjohur, dhe do të endem vërdallë e dëshpëruar, e humbur dhe frymëmekur.

E vërteta që unë rrallë e pranoj, është se gjithmonë kam pasur nevojë ta ndiej peshën e babait mbi shpinën time.

Përndryshe, pse u tregova aq e gatshme që të hiqja dorë nga ëndrra për të vazhduar një shkollë arti, pa bërë as rezistencën më të vogël, kur babai më kërkoi të mos shkoja në Baltimorë? Pse e lashë Nilin, burrin me të cilin isha fejuar disa vjet më parë? Nili kishte një firmë të vogël për instalimin e paneleve diellore. Ai kishte një fytyrë katrore me rrudha, por unë e pëlqeva qysh në çastin kur e pashë për herë të parë,

në "Qebaptoren e Abit", kur kërkova të merrja porosinë e tij dhe ai ngriti kokën nga menuja e më buzëqeshi. Ai ishte i dashur, miqësor e me natyrë të shtruar. Nuk është e vërtetë ajo që i thashë Pahrit për të. Nili nuk më la për një femër më të bukur. Unë e sabotova vetë lidhjen me të. Edhe kur ai më premtoi se do të përqafonte fenë myslimane e do të regjistrohej në një kurs të gjuhës farsi, unë prapë gjeta të meta të tjera tek ai, të tjera justifikime. Mua më pushtoi paniku dhe më në fund u ktheva tek të gjitha skutat, qoshet e plasat e njohura të jetës sime në shtëpi.

Pranë meje, Pahri bën të ngrihet në këmbë. Unë e shoh teksa shtrin rrudhat e fustanit, dhe përsëri ndiej një vërshim habie prej faktit të mrekullueshëm që ajo po qëndron vetëm disa centimetra larg meje.

- Dua të të tregoj diçka, - i them.

Çohem edhe unë në këmbë dhe shkoj në dhomën time. Një nga të mirat e moslargimit prej shtëpisë së prindërve është fakti që askush nuk hyn të sistemojë dhomën tënde të vjetër, askush nuk i çon për shitje në një dyqan gjërash të përdorura lodrat dhe sendet që ke pasur kur ke qenë e vogël. Unë e di mirë që, si një grua që po i afrohet të tridhjetave, kam më shumë nga ç'duhet, relikte të fëmijërisë pranë vetes, shumicën e të cilave të mbledhura në një kuti te këmbët e shtratit tim, kapakun e së cilës po e hap tani. Aty brenda gjenden kukulla të vjetra, një poni ngjyrërozë që më ka rënë dhuratë kur bleva një libër me figura për ngjyrosje, revista me ilustrime, të gjitha kartolinat me urimet për ditëlindjet a për Shën Valentinin që u dërgoja prindërve të mi, kur isha në shkollë fillore, të zbukuruara me fasule në formë veshke, ngjyra me shkëlqim dhe yje të vogla vezulluese. Herën e fundit që fola me Nilin, kur u ndamë përfundimisht, ai më tha: "Unë nuk mund të të pres, Pahri. Unë nuk mund të rri duke të pritur derisa ti të rritesh".

E mbyll kapakun e kutisë dhe kthehem përsëri në dhomën

e ndenjjes, ku Pahri është ulur në divan përballë babait. Ulem edhe unë pranë saj.

- Ja, - i them, duke i zgjatur një tufë me kartolina.

Ajo zgjat dorën tek tryeza për të marrë syzet për afër dhe heq llastikun që i mban bashkë ato kartolina. Ndërsa sheh të parën, ngrys vetullat. Është një fotografi e Las Vegasit, e *Caesars Palace*-it[1] natën, që vezullon nga dritat. Ajo e kthen nga ana tjetër dhe e lexon me zë të lartë.

*21 korrik 1992*

*E dashur Pahri,*

*Nuk do ta besosh dot se sa vapë bën këtu. Sot babait iu dogj dora kur e vendosi pëllëmbën mbi kapakun e motorit të makinës që kemi marrë me qira! Mamaja u detyrua t'i vinte pastë dhëmbësh aty. Në* Caesars Palace, *ka ushtarë romakë me shpata, helmeta dhe mantele të kuqe. Babai u mundua t'ia mbushte mendjen mamasë që të bënte një fotografi aty, por ajo nuk donte. Por unë e bëra një! Do të ta tregoj kur të kthehem në shtëpi. Kaq për tani. Më ka marrë malli për ty. Do të doja që të ishe edhe ti këtu.*

*Pahri.*

*P.S. Ndërsa i shkruaj këta rreshta, jam duke ngrënë parfenë më të mirë me akullore.*

Ajo ndalet te kartolina tjetër. *Hearst Castle*[2]. Dhe e lexon me zë mërmëritës: *"Kishte kopshtin e vet zoologjik! Sa fantastike është kjo! Kangurë, zebra, antilopa, gamile baktriane: janë ato me dy gunga!"* Pastaj një tjetër kartolinë,

---

1) Pallati i Cezarit, ndërtesë luksoze në Las Vegas, që është njëherazi hotel dhe kazino (*shën. i përkth.*).

2) Kështjella e Hërstit: kështjellë në Kaliforni, monument historik kombëtar në SHBA (*shën. i përkth.*).

nga *Disneyland*-i, Miki Mausi me kapelë magjistari, duke bërë me dorë. *"Mamaja ia dha ulërimës kur ai burri i varur ra mbi ne nga tavani! Veç ta kishe dëgjuar!"* Laguna *La Jolla*. Bregdeti malor *Big Sur*. Rruga bregdetare *17 Mile Drive*. Parku Ndërkombëtar *Muir Woods*. Liqeni *Tahoe*. *"Më ka marrë malli për ty. Ti vërtet do ta adhuroje këtë vend. Sa do të doja që të ishe edhe ti këtu!"*

*Sa do të doja që të ishe edhe ti këtu!*

*Sa do të doja që të ishe edhe ti këtu!*

Pahri heq syzet.

- Ti i ke dërguar kartolina vetes sate?

Unë mohoj me kokë.

- T'i kam dërguar ty, - qesh unë. - Tani duket si budallallëk.

Pahri i lë kartolinat mbi tryezën e kafes dhe afrohet pranë meje.

- Më trego.

Unë ul sytë mbi duart e mia dhe rrotulloj orën në kyçin e dorës.

- Unë hiqesha sikur ne të dyja ishim motra. Askush tjetër përveç meje nuk të shihte dot. Unë të thosha ty gjithçka. Të gjitha sekretet e mia. Ti ke qenë reale për mua, gjithmonë pranë meje. Unë ndihesha më pak e vetmuar, ngaqë të kisha ty. Si të ishim *Doppelgängers*[1]. E di këtë fjalë?

Sytë e saj qeshin.

- Po.

- Në përfytyrimin tim, ne ishim si dy gjethe që era i ka hedhur me mijëra milje larg njëra-tjetrës, por që prapë mbahen të lidhura nga rrënjët e thella e të ngatërruara të pemës nga e cila kanë rënë që të dyja.

- Për mua ishte e kundërta, - thotë Pahri. - Ti po më thua që e ke ndier praninë time, kurse unë kam ndier vetëm mu-

---

1) Fjalë për fjalë përkthehet "*sozie*" (nga gjermanishtja). Këtu është përdorur me kuptimin folkloristik "*vete e dytë paranormale*" (*shën i përkth.*).

ngesë. Një dhembje të vagët pa shkak. Unë isha si një pacient që nuk i thotë dot mjekut se ku i dhemb, por vetëm që ka dhembje. - Ajo vë dorën e vet përmbi timen dhe për disa çaste asnjëra prej nesh nuk thotë asnjë fjalë.

Në kolltuk, babai rënkon dhe ndërron pozicion.

- Më vjen vërtet shumë keq, - i them unë.

- Për çfarë?

- Që ju të dy e rigjetët njëri-tjetrin kaq vonë.

- Por ne gjetëm njëra-tjetrën, apo jo? - thotë ajo, me zërin që i meket nga emocionet. - E po, ky është ai tani! Nuk ka problem. Unë ndihem e lumtur: Kam gjetur atë pjesë të vetes që e kisha humbur. - Ajo më përkëdhel dorën. - Dhe të gjeta ty, Pahri.

Fjalët e saj ngacmojnë dëshirat e përvuajtura të fëmijërisë sime. Më kujtohet që, kur ndihesha e vetmuar, pëshpëritja emrin e saj, emrin tonë, dhe mbaja frymën, në pritje për të dëgjuar oshtimën, e bindur se një ditë do ta dëgjoja me siguri. Dhe, teksa e dëgjoj tani Pahrin që shqipton emrin tim, në dhomën time të ndenjjes, më bëhet sikur i shoh ato vite të gjata që na kanë mbajtur larg njëra-tjetrës, të palosen njëri mbi tjetrin, dhe koha, e trajtësuar në një fotografi a kartolinë, nxjerr prej vetes mbijetojën më të çmuar të fëmijërisë sime dhe e ul pranë meje, me dorën në dorën time, duke shqiptuar emrin tim. Emrin tonë. Mua më bëhet sikur po shoh një pjesë që t'i afrohet një tjetre dhe të puthitet me kërcitje në vendin e saj. Dy pjesë të një diçkaje, të ndara shumë kohë më parë, që po bashkohen përsëri tani. Dhe ndiej një trandje të lehtë brenda kraharorit: trokitjet e mbytura të një zemre tjetër, që po nis të rrahë sërish pranë simes.

Në kolltuk, babai ngrihet me vrik mbi bërryla. Ai fërkon sytë dhe sheh nga ne.

- Çfarë po komplotoni ju të dyja, ë?

Dhe buzëqesh.

Një tjetër ninullë. Këtë herë për një urë në Avinjon.

Pahri mërmërin në fillim melodinë e këngës e mandej më reciton fjalët e tekstit:

*Sur le pont d 'Avignon*
*L'on y danse, l'on y danse,*
*Sur le pont d'Avignon*
*L'on y danse tous en rond*[1].

- Ma mësoi mamaja kur isha fare e vogël, - thotë ajo, duke shtrënguar nyjen e shallit, që të mos ia marrë era e fortë. Dita është e freskët, por qielli është blu dhe dielli i fortë. Rrezet e tij bien mbi sipërfaqen ngjyrëgri metalike të lumit Ron dhe thyhen aty në mijëra xixëllima të ndritshme. - Të gjithë fëmijët francezë e dinë këtë këngë.

Ne jemi ulur në një stol prej druri përballë ujit. Ndërsa ajo më përkthen fjalët e ninullës, unë mrekullohem me qytetin që shtrihet përgjatë lumit. Duke qenë se e kam zbuluar kohët e fundit historinë e jetës sime, ndihem e magjepsur prej faktit që gjendem në një vend të mbushur plot e përplot me histori, e gjitha e dokumentuar, e ruajtur mirë. Është një mrekulli e vërtetë. Çdo gjë e këtij qyteti. Unë e ndiej mrekullinë te ajri i pastër, te era që përkund sipërfaqen e ujit dhe e bën atë të përplaset pas pritave prej guri, te drita e ndritshme dhe e plotë, që duket sikur shkëlqen në të gjitha drejtimet. Nga stoli ku jam ulur, arrij të shquaj murin e vjetër që rrethon qendrën e qytetit të lashtë, dhe rrugët e tij të ngushta; kullën perëndimore të Katedrales së Avinjonit dhe statujën e larë në ar të Virgjëreshës Mari që vezullon në majë të saj.

Pahri më rrëfen historinë e urës: një bari i vogël, në shekullin e dymbëdhjetë, pretendoi se një engjëll i kishte thënë

---

1) Mbi urën e Avinjonit / Po vallëzojnë, po vallëzojnë / Mbi urën e Avinjonit / Rrotull - rrotull po vallëzojnë (*shën. i përkth.*).

të ndërtonte një urë mbi lumë, dhe e demonstroi vlefshmërinë e pretendimit të vet duke ngritur një shkëmb masiv e duke e flakur në lumë. Ajo më tregon për varkëtarët në Ron, që u ngjitën në urë për të nderuar padronin e tyre, Shën Nikolasin. Dhe për të gjitha përmbytjet, që përgjatë shekujve i gërryen harqet e urës, derisa e shkatërruan përfundimisht atë. Ajo i thotë këto fjalë me të njëjtën mënyrë energjike, të shpejtë, gjithë nervozizëm, me të cilën ka folur gjatë gjithë kohës, ndërsa më udhëhiqte nëpër Pallatin Gotik të Papëve. Duke hequr kufjet-ciceron nga veshët për të më treguar një afresk, duke trokitur gishtat mbi bërrylin tim për të më tërhequr vëmendjen drejt një xhami me gravura me ngjyra ose drejt trarëve të zbuluar që ndërprisnin njëri-tjetrin mbi kokët tona.

Kur dolëm nga Pallati i Papëve, ajo thuajse i shqiptoi me një frymë emrat e të gjithë shenjtorëve, papëve dhe kardinalëve, që buronin prej saj me vrull, ndërsa ecnim në sheshin përpara katedrales mes tufave të pëllumbave, turistëve, tregtarëve afrikanë me tunika të ndritshme që shisnin byzylykë dhe orë false, muzikantit të ri me syze që, i ulur mbi një arkë mollësh, po luante "*Rapsodinë bohemiane*" me kitarën e vet akustike. Nuk më kujtohet të ketë pasur një elokuencë të tillë gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara, dhe kjo më duket si një taktikë e vonuar, sikur po i vijmë përqark asaj që ajo dëshiron vërtet të bëjë - dhe që do ta bëjmë së shpejti - dhe të gjitha këto fjalë janë si një urë.

- Por shumë shpejt do të shohësh një urë të vërtetë, - thotë ajo. - Kur të mbërrijnë të gjithë. Do të shkojmë të gjithë bashkë në *Pont du Gard*[1]. E ke dëgjuar? Jo? *Oh là là. C'est vraiment merveilleux*[2]. E ndërtuan romakët në shekullin e parë, për të çuar ujin nga Oëri drejt Nimit. Pesëdhjetë kilometra. Është një kryevepër e inxhinierisë, Pahri.

---

1) Në fakt *Pont de Gard* është një urë ujësjellësi mbi lumin Gardon (ose Gard) (*shën i përkth.*).

2) Është vërtet e mrekullueshme (*shën. i përkth.*).

Jam në Francë prej katër ditësh, dhe prej dy ditësh në Avinjon. Pahri dhe unë morëm një *Train à Grande Vitesse*[1] në një Paris të ftohtë, gjithë mjegull dhe dolëm prej tij nën një qiell të pastër, një erë të ngrohtë dhe një kor gjinkallash që këndonin në çdo pemë. Në stacion, unë u nguta si e çmendur për të nxjerrë jashtë bagazhet që kisha me vete, dhe pothuajse ngela në tren e ia dola të kërceja prej tij tamam në çastin kur dyert u mbyllën pas shpinës sime. Dhe tani po them me vete që të mos harroj t'i tregoj babait se si, po të isha vonuar tri sekonda më shumë, do të kisha përfunduar në Marsejë.

- Si është ai? - më pyet Pahri në Paris, në taksinë që marrim nga aeroporti "Sharl dë Gol" drejt apartamentit të saj.

- Ka hyrë më thellë në atë rrugë, - i them unë.

Babai tani jeton në një institut për të moshuarit. Kur shkova ta shihja ndërtesën për herë të parë dhe drejtoresha, Peni, një grua e gjatë dhe e dobët me flokë kaçurrela ngjyrë lule-shtrydheje, më shëtiti nëpër të, mendova: "Nuk qenka edhe aq keq!"

Pastaj e shqiptova me zë të lartë:

- Nuk qenka edhe aq keq!

Vendi ishte i pastër, me dritare që binin mbi kopsht, ku, siç më tha Peni, ata organizonin festë për çaj çdo të mërkurë në orën katër e gjysmë. Në holl mbante erë kanelle e stika pishe. Punonjësit, shumicën e të cilëve tani i njoh me emra, dukeshin të sjellshëm, të durueshëm, kompetentë. Unë kisha përfytyruar gra plaka me fytyra të fishkura, me trupa që u dridheshin e mezi mbaheshin në këmbë, duke folur me vete, të ulura përpara ekranit të televizorit. Por shumica e njerëzve aty nuk ishin edhe aq pleq. Shumë prej tyre nuk ishin as në karrige me rrota.

- Them se prisja një situatë më të keqe, - thashë unë.

- Vërtet? - tha Peni, duke lëshuar një të qeshur të këndshme, profesionale.

---

1) Tren me shpejtësi të madhe (*shën. i përkth.*).

- Kjo ishte fyese. Më fal!

- Aspak. Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm për imazhin që kanë krijuar njerëzit për të tilla vende. Sigurisht, - shtoi ajo që përmbi sup, me një nuancë të errët paralajmëruese, - kjo është zona e njerëzve që kanë nevojë për kujdes modest. Nisur nga ajo që po më thua ti për babanë tënd, nuk jam e sigurt se ai do t'ia dilte mbanë mirë këtu. Kam përshtypjen se Pavioni i Kujdesit për Problemet me Kujtesën do të ishte më i përshtatshëm për të. Ja ku jemi.

Ajo përdori një kartë çelës, që të futeshim brenda. Pavioni i mbyllur nuk mbante erë stikash pishe e kanelle. Unë ndieva një ngjethje të brendshme dhe impulsi i parë ishte që të kthehesha pas e të dilja prej aty. Por Peni ma vuri dorën në krah e më përkëdheli. Dhe më pa me një vështrim tejet të dhembshur. Unë e detyrova veten që të vazhdonte të shihte atë Institut, e kërrusur nga një ndjenjë gjigante faji.

Mëngjesin përpara se të nisesha për në Europë, shkova të shihja babanë. Kalova nëpër hollin e pavionit të kujdesit modest dhe përshëndeta me dorë Karmenin, që është nga Guatemala dhe u përgjigjet telefonatave. Kalova nëpër sallën e komunitetit, një dhomë e mbushur plot me pleq që po dëgjonin një kuartet harqesh të nxënësve të shkollës së mesme të veshur me kostume; lashë pas dhomën shumëfunksionëshe me kompjuterat, raftet e librave, tryezat e dominove, tabelën me udhëzimet dhe njoftimet e ndryshme: "A e dini që soja redukton kolesterolin tuaj të keq?", "Mos harroni "*Puzzles*" dhe "*Reflection Hour*" këtë të martë në orën 11:00 paradite!"

Dhe hyra në pavionin e mbyllur. Përtej asaj dere nuk bëjnë festa për çaj, nuk luajnë bingo. Asnjeri nuk e fillon mëngjesin këtu me *tai chi*[1]. Unë shkova në dhomën e babait, por ai nuk ndodhej atje. Shtratin e tij e kishin rregulluar, ekrani

---

1) Një lloj gjimnastike që ndihmon për relaksimin dhe forcimin e trupit e të mendjes, largimin e stresit, që përdoret tek të moshuarit ose individë me sëmundje të ndryshme (*shën. i përkth.*).

i televizorit ishte i fikur dhe në tryezën pranë kokës së shtratit gjendej një gotë e mbushur përgjysmë me ujë. U ndieva paksa e lehtësuar. E kam tmerr ta gjej babanë në atë shtrat spitali, të shtrirë anash, me njërën dorë të futur nën jastëk, me sytë futur thellë në zgavrat e tyre, që më shohin me një vështrim pa shprehje.

Unë e gjeta tim atë në dhomën e veprimtarive argëtuese, të kredhur në karrigen me rrota, pranë dritares që binte në kopsht. Kishte veshur pizhame fanellate dhe në kokë mbante beretën e vet. Në prehër kishte atë që Peni e kishte quajtur *përparëse veprimtarie*. Ajo ka rripa që ai mund t'i lidhë e t'i zgjidhë, edhe kopsa që atij i pëlqen t'i mbërthejë e t'i zbërthejë. Peni thotë që kjo ia mban gishtat gjallë.

Unë e putha në faqe dhe tërhoqa një karrige për t'u ulur pranë tij. Dikush e kishte rruar, ia kishte lagur flokët dhe ia kishte krehur. Fytyra i mbante era sapun.

- Pra, nesër është dita e madhe, - i thashë. - Nesër nisem me avion për në Francë, për të takuar Pahrin. Të kujtohet që të thashë se do të shkoja?

Babai puliti sytë. Edhe përpara se të pësonte iskeminë, ai kishte nisur të mbyllej në vetvete, të kridhej në periudha të gjata heshtjeje, me një pamje të dëshpëruar. Qysh prej iskemisë, fytyra e tij ngjan edhe më shumë me një maskë: goja e ngrirë në një buzëqeshje të përhershme mirësjelljeje, që nuk i reflektohet kurrë në sy. Nuk ka thënë asnjë fjalë qysh kur i ra iskemia. Ndonjëherë buzët i hapen dhe ai lëshon një tingull fërshëllyes "Aaaah!", me një ngritje të mjaftueshme të zërit në fund, sa për ta bërë të duket si një pasthirrmë habie, ose sikur befas e ka kuptuar atë që po i them unë.

- Ne do të takohemi në Paris dhe pastaj do të marrim trenin për të shkuar në Avinjon. Është një qytet në jug të Francës. Është vendi ku jetonin papët në shekullin e katërmbëdhjetë. Domethënë, do të shohim shumë gjëra. Por gjëja më fantastike është që Pahri u ka thënë edhe fëmijëve të saj se unë do shkoj atje dhe ata do të vijnë të më takojnë.

Babai vazhdoi të buzëqeshte, ashtu siç bëri një javë më parë, kur Hektori erdhi ta shihte, ose ashtu siç bëri kur i tregova aplikimin tim për në Kolegjin e Arteve dhe të Shkencave Humanitare në Shtetin e San Franciskos.

- Mbesa jote, Izabela, dhe burri i saj, Alberti, kanë një shtëpi pushimesh në Provansë, pranë një qyteti të quajtur Lë Bo. Unë e kërkova në internet, baba. Është një qytet me pamje të mrekullueshme. Është ndërtuar në majë të atyre shkëmbinjve gëlqerorë në Malet *Alpilles*. Atje mund të shihen rrënojat e një kështjelle mesjetare dhe poshtë duken pllajat dhe pemishtat. Do të bëj shumë fotografi dhe do të t'i tregoj kur të kthehem.

Pranë nesh, një grua plakë e veshur me një rrobë dhome po bashkonte me kënaqësi të dukshme pjesët e një pamjeje formuese. Në tryezën tjetër, një tjetër grua me flokë të bardhë të fryrë po mundohej të rregullonte lugët, pirunët dhe thikat në një sirtar me ndarje. Në ekranin e madh të televizorit në qoshe, Riki dhe Lusi po ziheshin me fjalë, ndërsa ishin të dy të lidhur bashkë me pranga në kyçet e duarve.

Babai ia bëri:

- Aaaah!

- Aleni, nipi yt, dhe gruaja e tij, Ana, do të vijnë nga Spanja me të pesë fëmijët e tyre. Unë nuk i di emrat e të gjithëve, por jam e sigurt se do t'i mësoj. Dhe pastaj, dhe kjo është gjëja që e lumturon më shumë Pahrin, do të vijë edhe nipi tjetër yti, më i vogli, Tierri. Ajo ka vite që nuk e ka parë. Pra, do të jetë një bashkim i madh familjar.

Unë e putha përsëri në faqe pak më vonë, kur u ngrita për të ikur. E mbështeta faqen pas së tijës, ndërsa m'u kujtua se si vinte ai të më merrte në kopsht dhe shkonim me makinë te "*Denny*" për të marrë mamanë në punë. Ne uleshim në një kthinë, në pritje që mamaja ta linte ndërresën, dhe unë e haja të gjithë akulloren që më sillte menaxheri i lokalit, ndërsa i tregoja babait vizatimet që kisha bërë atë ditë. Me sa durim që i shihte ai të gjitha, duke i shqyrtuar me kujdes, duke pohuar me kokë... Babai bëri përsëri buzëqeshjen e tij të zakonshme.

- Ah, pothuajse harrova, - shtova. U përkula mbi të dhe bëra ritualin tonë të zakonshëm të ndarjes, duke ia fërkuar faqet me gishta e duke i ngjitur ato drejt ballit e tëmthave të tij, e mandej mbi flokët gri të rrallë dhe në lëkurën e ashpër pas veshëve, duke larguar kështu të gjitha ëndrrat e këqija nga koka e tij. Hapa thesin e padukshëm përpara tij, hodha aty të gjitha ëndrrat e këqija dhe ia shtrëngova grykën fort. - Ja ku i mbylla!

Babai nxori një tingull grykor.

- Pafsh ëndrra të lumtura, baba! Do të shihemi pas dy javësh.

Dhe në atë çast më vetëtiu në mendje se ne nuk kishim qenë kurrë kaq gjatë larg njëri-tjetrit.

Ndërsa largohesha prej aty, kisha një ndjesi të theksuar se babai po më ndiqte pas me sy. Por, kur ktheva kokën për ta parë edhe një herë, ai e kishte ulur kokën dhe po luante me një kopsë të *përparëses së veprimtarisë*.

Pahri po flet për shtëpinë e Izabelës dhe të Albertit tani. Ajo ma ka treguar në fotografi. Është një shtëpi ferme e bukur, e stilit provansal, e ndërtuar me gurë, e vendosur në kodrat Luberon, me drurë frutorë dhe një pjergull përpara derës kryesore, me tjegulla prej terakote dhe trarë të zbuluar brenda.

- Në fotografinë që të tregova, nuk mund ta shohësh, por përpara ka një pamje fantastike të Maleve *Vaucluse*.

- A do të na nxërë dot të gjithëve brenda? Do të bëhemi shumë veta në shtëpi.

- *Plus on est de fous, plus on rit*[1)], - thotë ajo. - Si është shprehja?

- Sa më shumë, aq më të lumtur.

- *Ah voilà. C'est ça*[2)].

- Po fëmijët? Ku janë...

---

1) Sa më shumë njerëz gazmorë të mblidhen, aq më argëtuese do të jetë situata. (*shën i përkth.*).

2) Ah po. Kjo është (*shën i përkth.*).

- Pahri!

Unë kthej kokën nga ajo.

- Po?

Ajo zbraz mushkëritë me një frymënxjerrje të gjatë.

- Tani mund të ma japësh.

Unë pohoj me kokë. Dhe zgjat duart drejt çantës që ndodhet midis këmbëve të mia.

Ndoshta mund ta kisha gjetur disa muaj më parë, kur e çova tim atë në institutin për të moshuarit. Por valixhja që mora në dollapin në korridor, e vënë stivë mbi dy të tjerat, i nxuri të gjitha plaçkat e tij. Vetëm më vonë gjeta më në fund forca që të sistemoja dhomën e gjumit të prindërve. Hoqa nga muri letrën e vjetër dhe e leva murin me bojë. Hoqa shtratin e tyre me përmasat e një shtrati mbretëreshe, komonë e mamasë me pasqyrën ovale, nxora nga dollapi kostumet e babait, fustanet dhe bluzat e mamasë të mbuluara me qese plastike. Formova kështu një pirg në garazh për një a dy rrugë deri në qendrën e rrobave të përdorura "*Goodwill*". Çova tryezën time në dhomën e tyre, që tani e përdor si zyrë dhe do ta kem dhomë pune, kur të fillojë shkolla në vjeshtë. Zbraza edhe kutinë që gjendej te këmbët e shtratit tim. Në një qese të zezë, futa të gjitha lodrat e vjetra, të gjitha fustanet e fëmijërisë, të gjitha sandalet dhe këpucët e tenisit që i kisha mbajtur më gjatë nga ç'duhej. Nuk mund t'i shihja më kartolinat që u kisha dërguar prindërve të mi për ditëlindje ose për Ditën e Baballarëve a për Ditën e Nënave. Nuk më zinte gjumi natën, kur mendoja se ato ishin aty, te këmbët e mia. Ishte shumë e dhembshme.

Vetëm pasi pastrova dollapin e korridorit dhe nxora prej tij dy valixhet e tjera për t'i çuar në garazh, dëgjova një kërcitje brenda njërës prej tyre. E hapa zinxhirin dhe gjeta brenda saj një pako të mbështjellë me një letër të trashë bojëkafe. Një zarf ishte ngjitur pas pakos. Mbi të, në anglisht, ishin shkruar fjalët "Për motrën time, Pahrin". Në çast e njoha shkrimin e dorës të babait që nga ditët kur punoja në "Qebaptoren e

Abdullait", kur merrja porositë e klientëve që ai i linte te kasa.

Unë ia zgjat tani pakon Pahrit, të pahapur.

Ajo ul kokën drejt prehrit dhe ledhaton me gishta fjalët e shkruara në zarf. Në anën tjetër të lumit nisin të bien kambanat e kishës. Mbi një shkëmb në buzë të ujit, një zog shqyen mbetjet e një peshku të ngordhur.

Pahri fut dorën në çantën e vet e rrëmon mes gjërave që gjenden aty.

- *J'ai oublié mes lunettes,* - thotë ajo. - Kam harruar syzet për afër.

- Dëshiron që të ta lexoj unë me zë të lartë?

Ajo mundohet ta shqitë zarfin nga pakoja, por dita e sotme nuk është ditë e mbarë për duart e saj, kështu që, pas disa përpjekjesh, ma zgjat pakon mua. Unë e shqit zarfin dhe e hap. Mandej hap letrën që ndodhet aty brenda.

- E ka shkruar në gjuhën farsi.

- Por ti mund ta lexosh, apo jo? - thotë Pahri, me vetullat të harkuara gjithë shqetësim. - Ti mund të ma përkthesh.

- Po, - i them, duke ndier një ngazëllim të lehtë përbrenda, mirënjohje, edhe pse shumë vonë, për gjithë ato të marta pasdite kur babai më shoqëronte me makinë për në kursin e gjuhës farsi në *Campbell*. Mendja më shkon përsëri tek ai tani: i kërrusur dhe i përhumbur, duke ecur nëpër shkretëtirë me këmbët që i merren, ndërsa rruga pas tij mbulohet me të gjitha gjërat e vogla që ia ka rrëmbyer jeta.

Unë e shtrëngoj letrën fort, që të mos ma marrë era e marrë. Dhe i lexoj Pahrit tri fjalitë e shkruara me shkrim dore.

*"Ata po më thonë që do të kridhem në ujë, ku së shpejti do të mbytem. Por, përpara se të hyj aty, po e lë këtë në breg për ty. I lutem Zotit që ti ta gjesh, motër, që të dish se çfarë gjendej në zemrën time, ndërsa uji më mbulonte krejt."*

Madje edhe është datuar. Gusht 2007.

- Gushti i vitit 2007, - them unë. - Kur u diagnostikua me alzhajmer.

Tre vjet përpara se unë të dëgjoja zërin e Pahrit.

Pahri pohon me kokë, ndërsa fshin sytë me shpinën e dorës. Një çift të rinjsh kalon përpara nesh me një biçikletë dyshe: vajza në timon, bionde, me fytyrë rozë dhe e dobët; djali pas, me lëkurë bojëkafe dhe rrica të dendura. Mbi barin pak hapa më tej, një vajzë adoleshente, me një fund të shkurtër të zi lëkure, është ulur dhe flet me celular, duke tërhequr rripin e një qeni të vogël terrier ngjyrë qymyri.

Unë e gris letrën që mbështjell pakon. Brenda është një kuti e vogël çaji, në kapakun e së cilës paraqitet figura e zbërdhulur e një indiani me mjekër, veshur me një tunikë të gjatë të kuqe. Ai po mban në duar një filxhan me çaj që nxjerr avull, sikur po ia zgjat dikujt. Avulli që del nga filxhani, është fshirë pothuajse krejt dhe tunika nga e kuqe është bërë rozë. Unë e hap kapakun. Brenda gjej pendë të të gjitha ngjyrave e të të gjitha formave. Pendë të shkurtra, në ngjyrë jeshile të errët; pendë të gjata me bisht të zi, me ngjyrë xhenxhefili; një pendë ngjyrë pjeshke me një nuancë të lehtë lejlaje, me siguri e ndonjë rose të egër; pendë bojëkafe me pika të errëta në pjesën e mesit; një pendë jeshile palloi me një sy të madh në krye.

Dhe kthehem nga Pahri.

- E di ti ç'kuptim ka kjo?

Me mjekrën që i dridhet, Pahri tund kokën ngadalë në shenjë mohimi. Ajo ma merr kutinë nga dora dhe sheh brendinë e saj.

- Jo, - thotë ajo. - Vetëm se, kur ne e humbëm njëri-tjetrin, unë dhe Abdullai, ai u lëndua shumë më tepër se unë. Unë qeshë më me fat, sepse më mbrojti mosha e vogël. *Je pouvais oublier.* Unë e kisha luksin për të harruar. Kurse ai jo. - Ajo ngre një pendë, fërkon me të kyçin e dorës, duke e parë sikur po shpreson që ajo të ngjallet e të nisë të fluturojë. - Nuk e di se ç'kuptim kanë këto pendë, çfarë historie kanë, por e di që duan të thonë se ai ka menduar për mua. Gjatë gjithë këtyre viteve. Ai nuk më ka harruar kurrë.

Unë ia hedh krahun në sup, ndërsa ajo qan në heshtje.

Shoh pemët e përndritura nga dielli, lumin që rrjedh pas shpinës sonë, nën një urë, *Pont Saint-Bénezet,* ura për të cilën bën fjalë ninulla. Në fakt është një gjysmë ure, sepse i kanë mbetur vetëm katër nga harqet e saj origjinale. Ajo përfundon në mes të lumit. Si të jetë përpjekur të zgjatet drejt anës tjetër, të bashkohet me të, por energjitë i janë shuar në mes.

Natën, në hotel, unë rri shtrirë në shtrat dhe shoh retë që mbulojnë hënën e madhe të fryrë që varet mbi dritaren tonë. Poshtë dritares, disa taka trokasin mbi kalldrëm. Të qeshura e biseda. Motoçikleta që nguten. Nga restoranti në anën tjetër të rrugës vjen tringëllima e gotave mbi tabaka. Tingujt e një pianoje vërshojnë nga dritarja dhe përfundojnë në veshët e mi.

E kthej kokën në anën tjetër dhe shoh Pahrin që po fle e qetë në shtratin tjetër. Nën dritën e hënës fytyra i duket e zbehtë. Shoh babanë në fytyrën e saj, babanë të ri, gjithë shpresa, të lumtur, ashtu siç ka qenë dikur, dhe tani e di që unë gjithmonë do ta gjej atë, kur të shoh Pahrin. Ajo është gjaku im. Dhe së shpejti unë do takohem me fëmijët e saj, me nipërit e mbesat e të gjithë ata kanë po ashtu gjakun tim në deje. Unë nuk jam vetëm. Një lumturi e papritur më pushton të tërën. Ndiej një lloj ngazëllimi brenda vetes dhe sytë më njomen nga shpresa e mirënjohja.

Ndërsa shoh Pahrin teksa fle, më vjen përsëri në mendje loja që luanim me babanë kur më vinte për të fjetur. Largimi i ëndrrave të këqija nga koka, futja e ëndrrave të mira. Më kujtohet ëndrra që i jepja unë atij. Me kujdes, që të mos e zgjoj Pahrin, e zgjat dorën drejt saj dhe ia mbështet pëllëmbën butë-butë mbi ballë. Dhe mbyll sytë:

Është një pasdite tërë diell. Ata janë përsëri fëmijë, vëlla e motër, të vegjël, me sy të qashtër e gjithë gjallëri. Ata qëndrojnë të shtrirë në një parcelë bari të gjatë, nën hijen e një peme molle të lulëzuar. Bari nën shpinën e tyre është i ngrohtë dhe dielli ua përkëdhel fytyrën, duke depërtuar nëpër lulet mbi kokët e tyre. Ata po dremitin në krah të njëri-tjetrit, të

kënaqur, koka e tij e mbështetur në një rrënjë peme të trashë, kurse e saj në pallton që e ka mbështjellë ai si jastëk për të. Me sy gjysmë të hapur, ajo sheh një mëllenjë të zezë që është ndalur mbi një degë të pemës. Rryma ajri të freskët valëviten përmes gjetheve e zbresin poshtë.

Ajo e kthen kokën për të parë atë, vëllanë e saj të madh, aleatin e saj në gjithçka, por fytyra e tij është shumë pranë dhe ajo nuk e sheh dot të gjithën. Vetëm thellomën midis vetullave, kurrizin e hundës, harkimin e qerpikëve. Por ajo nuk e ka problem. Ajo është e lumtur, sepse i mjafton që është pranë tij, me të, me vëllanë e saj, dhe, ndërsa gjumi e kaplon ngadalë, ajo ndien të mbështillet nga një valë qetësie absolute. Dhe mbyll sytë. E zë gjumi, një gjumë i patrazuar, gjithçka është e kulluar dhe rrezatuese.

# Falënderime

Më duhet të sqaroj disa gjëra logjistike, përpara se të kaloj te falënderimet. Fshati i Shadbagut është i sajuar, edhe pse ekziston mundësia që një fshat me të njëjtin emër të gjendet diku në Afganistan. Edhe në është kështu, unë nuk kam qenë kurrë aty. Ninulla e Abdullait dhe Pahrit, veçanërisht referenca te "zana e vogël e trishtuar" është frymëzuar nga një poezi e poetit të ndjerë, të madh persian *Forough Farrokhzad*. Së fundi, titulli i këtij libri është frymëzuar deri diku nga poezia e këndshme e Uilljam Blejkut "*Kënga e dados*" [*Nurse's song*].

Do të doja të falënderoja *Bob Barnett*-in dhe *Deneen Howell*-in që kanë qenë udhëheqës kaq të mrekullueshëm dhe mbrojtës të këtij libri. Falënderoj *Helen Heller*-in, *David Grossman*-in, *Jody Hotchkiss*-in. Falënderoj *Chandler Crawford*-in, për entuziazmin, durimin dhe këshillat e saj. Shumë falënderime për miqtë e "*Riverhead Books*": *Jynne Martin*, *Kate Stark*, *Sarah Stein*, *Leslie Schwartz*, *Craig D. Burke*, *Helen Yentus* e shumë të tjerë që po më mbeten pa përmendur, por të cilëve u jam thellësisht mirënjohës që më ndihmuan t'ua nis këtë libër lexuesve.

Falënderoj formatuesin e mrekullueshëm të tekstit, *Tony Davis*-in, që merr përsipër shumë më tepër nga sa i kërkon detyra e tij.

Një mirënjohje shumë e veçantë i takon botueses sime, *Sarah McGrath*-it, tejet të talentuar, për intuitën dhe vizionin e saj, udhëzimet e saj të buta dhe për ndihmesën që më dha për t'i dhënë formë këtij libri, me më shumë mënyra nga sa arrij unë të mbaj mend. Nuk e kam shijuar kurrë më shumë se kaq procesin e botimit, *Sarah*.

Së fundi, falënderoj *Susan Petersen Kennedy*-in dhe *Geoffrey Kloske*-n, për besimin e patrandur që kanë tek unë dhe te shkrimet e mia.

Falemnderit dhe *Tashakor* të gjithë miqve e të afërmve të mi, që më kanë qëndruar gjithmonë në krah dhe më kanë duruar me dashamirësi. Si përherë, falënderoj gruan time të bukur, *Roya*-n, jo thjesht sepse ka lexuar dhe redaktuar variantet e ndryshme të këtij libri, por edhe sepse është përkujdesur për jetën tonë, ditë pas dite, pa asnjë pështërimë proteste, në mënyrë që unë të mund të shkruaja. Pa ty, *Roya*, ky libër do të kishte vdekur diku në njërin prej paragrafëve të faqes së parë. Të dua.